



ITALI – SHQIPËRI

**INSTRUMENTE LIGJORË DHE TEKNIKA TË LUFTËS KUNDËR
KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL
PËRBALLJE PËRVOJASH**

ITALY-ALBANIA
LEGAL MEASURES AND TECHNIQUES TO FIGHT AGAINST TRANSNATIONAL ORGANIZED CRIME
A COMPARISON OF EXPERIENCES



unieri

advancing security, serving justice,
building peace



Ministria e Drejtësisë



COOPERAZIONE
ITALIANA

cooperazione.italiani.it



Shkalla e Magistraturës



unieri

advancing security, serving justice,
building peace

Botues
UNICRI
Viale Maestri del Lavoro 10, 10127 Torino (Italia)
Tel: +39 011 65 37111
Fax: +39 011 63 13368
Email: unicri@unicri.it

Në bashkëpunim me

Drejtorinë Kombëtare Antimafie
Shkollën e Magjistraturës në Tiranë
Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë

Për botuesin
Sandro Calvani
Drejtor i UNICRI

Shpërndarja

*Pikëpamjet e shprehura u takojnë autorëve dhe nuk përfaqësojnë
domosdoshmërisht pikëpamjen e UNICRI-t.
Përmbajtja e këtij manuali mund të përmendet apo risillet me kusht që të
përmendet burimi. UNICRI do të donte të kish një kopje të dokumentit në të
cilin do përdorej apo përmendej përmbajtja e këtij manuali.*

ITALI – SHQIPËRI:
INSTRUMENTE LIGJORË DHE TEKNIKA TË
LUFTËS KUNDËR
KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL
PËRBALLJE PËRVOJASH

nën kujdesin e Corrado Lembo,
Koordinator shkencor i Kursit të trajnimit
për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore
(Tiranë, 5-16 mars 2007; Romë, 15-19 tetor 2007;
Tiranë, 12-16 nëntor 2007)

TREGUES – PËRMBLEDHJE

FALËNDERIME	9
HYRJE nga SANDRO CALVANI.....	11
PROGRAMI I KURSIT	13
PARATHËNIE nga CORRADO LEMBO	45

PJESA E PARË

TIPARE STRUKTUREORE DHE FORMA TË SHFAQJES SË KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL

- 1.1. Lufta kundër krimit të organizuar transnacional
në hapësirën juridike dhe gjyqësore evropiane.
nga GIUSTO SCIACCHITANO 47
- 1.2. “Mafiet e reja”. Struktura dhe format e shfaqjes së krimit të
organizuar transnacional: analizë e përvojës gjyqësore italiane.
nga LUCIO DI PIETRO 57
- 1.3. Krimet e prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.
nga ANTONIO LAUDATI 96
- 1.4. Shënime mbi trafikun e armëve në Itali,
në dritën e hetimeve më të fundit.
nga MASSIMILIANO D’ANGELANTONIO 120
- 1.5. Trafiku i qenieve njerëzore në Shqipëri.
nga ARQILE KOÇA 127
- 1.6. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Itali:
probleme dhe perspektiva në kuadrin e
bashkëpunimit ndërkombëtar.
nga LUCIO DI PIETRO 169
- 1.7. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri.
Problematika dhe perspektiva në kuadrin e
bashkëpunimit ndërkombëtar.
nga SKËNDER KAÇUPI 182
- 1.8. Terrorizmi ndërkombëtar
nga MICHELE DEL PRETE 192

P J E S A E D Y T Ë

LUFTA KUNDËR KRIMIT EKONOMIKO-FINANCIAR NË KUADRIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

- 2.1. Lufta financiare kundër pastrimit të parave ndërkombëtar.
Roli i Zyrës së Informacionit Financiar.
nga RENATO RIGHETTI..... 235
- 2.2. Krimi i organizuar në fushën ekonomiko-financiare në Shqipëri:
analizë e fenomeneve dhe strategjive të luftës.
nga BIBIL METE 249
- 2.3. Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Itali.
nga LUCIO DI PIETRO 255
- 2.4. Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Shqipëri.
nga AMARILDO LAÇI..... 261
- 2.5. Ndëshkimi i fenomenit të korrupsionit në Shqipëri
pas ndryshimeve të fundit të Kodit penal dhe të Kodit
të procedurës penale.
nga ARBEN KRAJA 274
- 2.6. Prokurimet e veprave publike dhe infiltrimet mafioze:
analizë e protokolleve hetimore.
nga CORRADO LEMBO 285
- 2.7. Veprimtaria e luftës kundër krimit të organizuar në sektorin e
prokurimeve publike: shënime mbi kontrollet administrative
antimafie në prokurimet publike.
nga BRUNO FRATTASI..... 332
- 2.8. Sekuestrimi dhe konfiskimi në legjislacionin e
luftës kundër pastrimit të parave.
nga ALBERTO CISTERNA 356
- 2.9. Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar:
kërkimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi.
nga GIOVANNI MELILLO. 384
- 2.10. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme në Shqipëri,
në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar.
nga ARTUR SELMANI 441

P J E S A E T R E T Ë

ASPEKTE PROCEDURALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR: PROCESI PENAL, VLERËSIMI I PROVËS DHE RELACIONI PËRFUNDIMTAR I PROKURORIT

- 3.1. Administrimi i procesit penal në Shqipëri.
nga INA RAMA 457
- 3.2. Krimi i organizuar dhe legjislacioni shpërblyes në Itali.
nga CORRADO LEMBO 482
- 3.3. Arsyetimi i provës, rregulla të vlerësimit dhe pranimit
të provës dhe relacioni përfundimtar i prokurorit.
Përdorimi i sistemeve dhe teknologjive në relacionin
përfundimtar të prokurorit.
nga FILIPPO SPIEZIA..... 552

FALËNDERIME

Ky botim është fryt i veprimtarisë shkencore didaktike të zhvilluar gjatë kurseve të trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të organizuar në kuadrin e Projektit “*Asistencë për Shqipërinë në fushën e parandalimit të krimit dhe të administrimit të drejtësisë*”, realizuar nga Michela Cornetto (përgjegjëse e projektit) me mbikëqyrjen e Judit Timaffy, Shefe e Zyrës për Reformën në Drejtësi në Institutin e Kombeve të Bashkuara për Kërkimin mbi Krimin dhe Drejtësinë Penale (UNICRI).

Projekti u zhvillua nën mbikëqyrjen shkencore të Këshilltarit Corrado Lembo, Prokuror pranë Drejtorisë Kombëtare Antimafie dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë Shqiptare dhe Shkollën e Magjistraturës në Tiranë.

Falënderojmë veçanërisht dhe i jemi thellësisht mirënjohës Këshilltarit Corrado Lembo, për profesionalizmin e pashoq dhe aftësinë e jashtëzakonshme me të cilën luajti rolin që i ish besuar, si dhe Sokol Pashon, Drejtor i Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare, dhe Arta Mandron, Përgjegjëse për Programin e Trajnimit të Vazhduar në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë, për punën e shkëlqyer që kryen në vend pranë institucioneve të cilave u përkasin dhe si anëtarë të Komitetit Shkencor.

Organizimi i *Kursit* u bë më i lehtë nga gatishmëria e disa magistratëve të Drejtorisë Kombëtare Antimafie, të cilët i falënderojmë, dhe që, së bashku me përfaqësues të lartë të Forcave të Rendit dhe të institucioneve të tjera publike, përgatitën trajtesa komplekse dhe të shtjelluara mbi temat e ndryshme të trajtuara.

Një falënderim veçanërisht i ndjerë është për Krye Prokurorin kombëtar antimafie që, me një ndjeshmëri të thellë institucionale, bëri të mundur që Seksioni i *Kursit* i mbajtur në Romë të zhvillohej në mjediset prestigjioze të Drejtorisë Kombëtare Antimafie.

Falënderojmë të gjithë Pjesëmarrësit pasi ndihmuan në suksesin e *Kursit* dhe në vendosjen e një dialogu frytdhënës dhe në shkëmbimin e përvojave.

Falënderojmë gjithashtu për punën e çmuar dhe të zgjuar të koordinimit organizativ dhe mbështetjes logjistike, Teresa Guglielmo dhe Valerio Galli, bashkëpunëtorë të Këshilltarit Lembo, Eda Osmanin, nëpunëse pranë Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare dhe Gentian Jahjollin, stazhier pranë UNICRI, bashkëpunimi i mirë i të cilëve qe mjaft i vyer më shumë se një herë.

Së fundi, një falënderim i veçantë për përkthyeset mjaft të mira, Alketa Ylli dhe Anila Ismaili. Mirënjohje e veçantë për Alketa Yllin jo vetëm për

saktësinë e rrallë me të cilën përktheu nga gjuha shqipe relacionet e bashkëkombësve të vet, por edhe për mënyrën e përkryer me të cilën organizoi shërbimin e përkthimit. Punës së saj plot durim i detyrohet suksesi i ditëve të studimit dhe botimit të këtij vëllimi.

Lipset të kujtojmë se realizimi i këtij botimi dhe i gjithë projektit u mundësuan falë financimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane.

HYRJE

Ndikimi që krimi i organizuar ka në rajonin e Ballkanit kërkon përpjekje gjithnjë e më të mëdha në luftën kundër këtij fenomeni.

Shqipëria merr pjesë në nisma kundër krimit të ndërmarrë nga komuniteti ndërkombëtar në plotësim e mbështetje të përpjekjeve të kryera nga çdo vend.

Në vitin 2005 Partia Demokratike, e mbështetur nga aleatët e vet, arriti një fitore vendimtare në zgjedhjet politike. Qeveria e re mori përsipër të ulë krimin dhe korrupsionin në vend. Kalimi i qetë i pushtetit përfaqësoi një hap të rëndësishëm përpara drejt afirmimit të demokracisë.

Ekzistenca e grupeve kriminale të organizuara në territor dhe ndikimi i ushtruar mbi realitetin e vështirë socio-ekonomik të Shqipërisë, i bëjnë urgjente disa reforma, ndër të cilat përditësimin e legjislacionit dhe fuqizimin e institucioneve të ngarkuara me luftën kundër fenomenit të krimit.

Në vitin 2002, në procesin e përshtatjes së legjislacionit ndaj standardeve ndërkombëtare, Shqipëria ratifikoi Konventën e O.K.B.-së për Luftën Kundër Krimit të Organizuar (UNTOC) dhe protokollin shtesë që rregullojnë përkatësisht trafikun dhe kontrabandën e qenieve njerëzore. Në shkurt 2008 u ratifikuan edhe protokollin i dytë e i tretë mbi trafikun e armëve. Nga viti 1995 Shqipëria është vend anëtar i Këshillit të Evropës. Në vitin 2001 ajo u bë anëtare e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) dhe në vitin 2006 ajo ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC).

Në muajt e parë të vitit 2008 kanë hyrë në fuqi Konventa e Këshillit të Evropës mbi luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe Konventa për luftën kundër pastrimit të parave, zbulimin dhe konfiskimin e të ardhurave të paligjshme, të dyja të firmosura në vitin 2007.

Në këto rrethana, veprimtaria trajnuese e zhvilluar nga UNICRI iu gjegj kërkimit të Shqipërisë për të përfutur përvijën më të mirë ndërkombëtare dhe italiane, duke parë si objektiv parësor përgjigjen efikase dhe të mirëbashkënduar ndaj kërcënimit që shfaq krimi i organizuar.

Ky botim pasqyron një veprimtari trajnuese të konceptuar në bazë të veçantive të realitetit shqiptar. Metoda novatore e përdorur bëri të mundur vendosjen e një dialogu të ngjeshur dhe frytdhënës mbi secilën prej temave të trajtuara, duke nxitur shkëmbimin e përvijave tekniko-praktike dhe duke rritur një përballje të shëndoshë.

Larmia e madhe e kërkimit të rrugëve shqiptare drejt çlirimit prej frikës pati nevojë për zgjidhje krijuese, një administrim të mirë të njohurive dhe

aleanca të shëndosha, tre mjete thelbësore pune këto në shërbim të UNICRI-së.

Sandro Calvani, Drejtor i UNICRI

PROGRAMI I KURSIT

***KURS TRAJNIMI
PËR GJYQTARË, PROKURORË DHE OFICERË
TË POLICISË GJYQËSORE
Tiranë, 5 - 16 mars 2007***

**Kurs trajnimi për gjyqtarë,
prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore**

(Tiranë, 5 – 16 mars 2007)

Java e Parë 5-9 Mars 2007

CERIMONIA E HAPJES

Kryeson: **Dr.Arta Mandro, Përgjegjëse për Programin e Trajnimit të Vazhduar në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë.**

10.00 – 10.15 **Z.Vladimir Kristo, Zëvendës Ministër i Drejtësisë Shqiptare**

10.15 – 10.30 **Sh.T.Ambasadori Attilio Massimo Iannucci, Ambasador i Italisë në Shqipëri**

10.30 – 17.00 **Dr.Judit Timaffy, Funkcionare e UNICRI, Koordinatore e Zyrës për Reformën në Drejtësi dhe Trajnimin**

10.45 – 11.00 **Këshilltar Corrado Lembo, Prokuror Kombëtar Antimafie, Drejtorja Kombëtare Antimafie, Koordinator Shkencor i Kursit**

11.00 – 11.15 **Dr.Ariana Fullani, Drejtoreshë e Shkollës së Magjistraturës në Tiranë**

11.30 **Hapja e punimeve të Kursit**

Seksioni I
11.30 – 13.30

Nocioni, struktura dhe format e shfaqjes së krimit të organizuar, teoria e praktika: analizë e përvojës juridike në kuadrin transnacional.

Lektor: *Këshilltar Lucio di Pietro,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA

- Nocioni:

- analizë e instrumenteve ligjorë ndërkombëtarë
- shqyrtim dhe krahasim i legjislacionit italian dhe shqiptar.

- Karakteristika strukturore të organizatave kriminale transnacionale:

- të ashtuquajturat *mafie historike* italiane (*cosa nostra*, *'ndrangheta*, *camorra*, *sacra korona unita*)
- të ashtuquajturat *mafie të reja* (organizatat kriminale shqiptare, ruse, kineze, nigeriane, etj.)

- Forma të shfaqjes:

- infiltrimet e krimit të organizuar në shoqëri (politika, sipërmarrja publike dhe private, profesionet, etj.,)

Çështje të natyrës procedurale, duke iu referuar në veçanti drejtimit dhe koordinimit të hetimeve, dhe aspekteve specifike të marrjes së provave për qëllime të procesit penal.

Lektor: *Këshilltar Corrado Lembo,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA.

- organizma dhe instrumente hetimorë të luftës kundër krimit të organizuar, duke iu referuar në veçanti aspekteve të legjislacionit;
- vijon: drejtim dhe koordinim i hetimeve në varësi të efikasitetit të veprimit penal;
- instrumente të tjerë specifikë të luftës kundër krimit të organizuar në përvojën italiane dhe shqiptare; përvoja e Drejtorisë Kombëtare Antimafie;

Seksioni II
15.00 – 17.30

Grupet e punës:

Analizë e diskutim i rasteve gjyqësore në të cilat ka rezultuar përfshirja e krimit të organizuar: importim dhe drejtim i hetimeve në varësi të procesit.

Lektorë: *Këshilltar Corrado Lembo,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA
Këshilltar Lucio di Pietro,
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA

Dita e dytë, 6 mars 2007

Seksioni III
9.00 – 12.00

Teknika hetimore të luftës kundër krimit të organizuar, veçanërisht në lidhje me hetimet pasurore.

Lektorë: *Këshilltar Alberto Cisterna,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA
Dr. Bilbil Mete, Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme

- metoda e instrumente “tradicionale” të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar: përgjimet telefonike dhe në natyrë;
- strategji të luftës dhe teknike hetimore dhe verifikimi të dimensionit të sipërmarrjes së krimit të organizuar dhe të formave të reja të shfaqjes së tij;
- riinvestim i të ardhurave të veprimtarive të paligjshme, teknika hetimore dhe metoda investigimi në lidhje me krimin ekonomik-financiar; pastrim parash, sekuestrim dhe konfiskim i të mirave dhe të ardhurave të paligjshme; problematika juridike dhe operative në lidhje me natyrën e të mirave që i nënshtrohen sekuestrimit dhe/ose konfiskimit (të luajtshme, të paluajtshme, ndërmarrje, aksione në shoqëri, gjendje krediti në llogari bankare, depozita kursimi, bono thesari); administrim gjyqësor i të mirave të sekuestruara;

- protokolle hetimore në lidhje me kontrolle bankare;
Instrumente dhe forma të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me hetimet pasurore;

Seksioni IV
15.00 – 17.30

Grupet e punës:

Diskutim i një apo më shumë rasteve gjyqësore ku janë përdorur bashkëpunëtorët e drejtësisë

Lektorë: *Këshilltar Alberto Cisterna,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA
Dr.Bilbil Mete, Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme

Dita e tretë, 7 mars 2007

Seksioni V
9.00 – 12.00

Teknika të administrimit të procesit

Lektor: *Këshilltar Corrado Lembo,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA

- debati gjyqësor dhe “procesi i drejtë” në përvojën gjyqësore italiane;
- kërkimi, marrja dhe vlerësimi i provës në procesin penal të llojit akuzator; formim i parakohshëm i provës: sigurimi i provës;
- marrja në pyetje, shqyrtimi, kundërsqyrtimi, rishqyrtimi: strategjitë, teknikat dhe rregullat procedurale;
- relacioni i fundit i prokurorit: teknika të argumentimit dhe bindjes.

Korrupsioni dhe krimet që lidhen me të

Lektorë: *Dr. Gilbert Flam,*
Zëvendës Prokuror pranë Gjykatës së Lartë të Parisit;
Dr. Ina Rama,
Gjyqtare në Gjykatën e Krimeve të Rënda në Tiranë.

- analizë e konventave ndërkombëtare;
- shqyrtimi i instrumenteve legjislativë kombëtarë: krahasimi mes Italisë dhe Shqipërisë;
- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit;
- korrupsioni i funksionarëve publikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë;
- korrupsioni brenda forcave të Policisë dhe organeve gjyqësore;
- teknika procedurale: hetimet, marrja e provave, faza përgatitore e procesit.

Seksoni VI
15.00 – 1730

Grupet e punës:

Shqyrtim i rasteve gjyqësore në të cilat përdorimi i instrumenteve dhe teknikave novatore kanë shërbyer mjaft për drejtimin e procesit dhe vërtetimit të të vërtetës.

Lektorë: *Dr. Gilbert Flam,*
Zëvendës Prokuror pranë Gjykatës së Lartë të Parisit;
Dr. Ina Rama,
Gjyqtare në Gjykatën e Krimeve të Rënda në Tiranë.

Dita e katërt, 8 Mars 2007

Seksioni VII

9.00 – 12.00

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar, dhe krijimi i një hapësire juridike të përbashkët të sigurisë dhe drejtësisë.

Lektor: *Këshilltar Alberto Cisterna,*
Prokuror Kombëtar Antimafje, DNA

- struktura të koordinimit dhe bashkëpunimit gjyqësor dhe të policisë në kuadrin evropian dhe rakordimi i tyre me autoritetet gjyqësore kombëtare: a) Eurojust; b) Rrjeti gjyqësor Evropian; c) Magjistratët e ndërlidhjes; d) Olaf; e) Europol; f) struktura të tjera të koordinimit dhe bashkëpunimit (SIS “*Shengen Information System*” për *border control*). Shkëmbimi i informacioneve dhe bashkëpunimi gjyqësor me vendet e Evropës lindore, me vendet e Amerikës latine dhe me SH.B.A.).
- instrumente të bashkëpunimit gjyqësor dhe të policisë: a) nga ekstradimi në urdhrin e arrestit evropian, b) videokonferenca ndërkombëtare: referime ligjore dhe raste; c) përgjimet telefonike, në natyrë, satelitore dhe telepatike, nevojat investiguese dhe mbrojtja e privacisë; d) instrumentet e luftës kundër *cybercrime*: kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar (në veçanti, Konventa e Këshillit të Evropës mbi *cybercrime*), modele dhe probleme juridike dhe operative; e) skuadra të përbashkëta hetimore; f) dorëzime të kontrolluara dhe operacione infiltrimi; g) arrestim i shtyrë në kohë; h) vëzhgime ndërkufitare.

Pastrimi i parave me origjinë të paligjshme

Lektor: *Këshilltar Gianfranco Donadio,
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA*

- analizë e konventave ndërkombëtare;
- shqyrtim i instrumenteve ligjorë kombëtarë: krahasimi mes Italisë dhe Shqipërisë;
- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit;
- teknika procedurale: hetimet, marrja e provës, faza përgatitore e procesit;
- shqyrtimi i instrumenteve *ad hoc*: sekuestrimi, konfiskimi i të mirave;
- sekretit bankar dhe të ashtuquajturat operacione të dyshimta;
- procedimi administrativ e raportimit të operacioneve të dyshimta dhe ai gjyqësor (funksionari i Zyrës Italiane të Këmbimeve).

Seksioni VIII

15.00 – 17.30

Grupet e punës.

Shqyrtimi i rasteve gjyqësore në të cilat janë përdorur instrumente të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar dhe i rasteve të pastrimit të parave.

Dita e pestë, 9 Mars 2007

Seksioni IX
9.00 – 12.00

Krimet e prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike

Lektor: *Këshilltar Antonio Laudati,*
 Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA

- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e ndëshkimit të krimit;
- teknika hetimore të luftës kundër trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike: agjenti provokator, blerja e simuluar, operacione me infiltrim: nocioni, parakushtet dhe kufizimet: elementët e përbashkët dhe dallues me aksione të tjera të simuluar nga ana e organeve të policisë gjyqësore italiane (në lidhje me pastrimin e parave: neni 12-kuater, paragrafi 1, dekreti ligji n.306, dt. 8 qershor 1992, i kthyer në ligj me ndryshime, në ligjin n.356, dt. 7 gusht 1992); në lidhje me shfrytëzimin e prostitucionit dhe të pornografisë së të miturve, turizmit seksual në dëm të të miturve (neni 14, paragrafi 1 e 2, ligji n.269, dt. 3 gusht 1998; në lidhje me terrorizmin (neni 4, dekreti ligji n.374, dt. 18 tetor 2001, kthyer në ligjin n.438, dt.15 dhjetor 2001; trafiku i qenieve njerëzore (neni 10, i ligjit n.228, dt. 11 gusht 2003). Rregullimi i përgjithshëm i operacioneve të infilttruara i ndërfutur nga neni 9 i ligjit n.146, dt. 16 Mars 2006, “ratifikim dhe zbatim i Konventës dhe i Protokolleve të Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme më 15 Nëntor 2000 dhe më 31 Maj 2001 (Shtojca e G.Z. n.85, dt. 11 prill 2006).
- teknika procedurale: hetimet, marrja e provës, faza përgatitore e procesit.

Trafiku ndërkombëtar i armëve

Lektor: *Kapiten Massimiliano D'Angelantonio,*
R.O.S. Karabinierë

- analizë e konventave ndërkombëtare;
- shqyrtim i instrumenteve ligjore kombëtare; krahasim mes Italisë dhe Shqipërisë;
- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve në lidhje me trafikun e armëve;
- teknika hetimore dhe procedurale

Seksioni X

15.00 – 17.00

Grupet e punës:

Përvojat hetimore në lidhje me ndëshkimin e trafikut të armëve dhe/ose të lëndëve narkotike në Shqipëri; bashkëpunim dhe koordinim me autoritetet italiane në parandalimin dhe ndëshkimin e këtyre krimeve; përvoja të përfutuara dhe trajtim i propozimeve të reja.

JAVA E DYTË 12 mars – 16 mars 2007

Dita e parë, 12 Mars 2007

Seksioni XI
9.00 – 12.00

Trafiku i qenieve njerëzore dhe krimet që lidhen me të

Lektor: *Dr.Arçile Koça,*
Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

- analizë e konventave ndërkombëtare, konventat e OKB-së dhe legjislacioni Evropian: trafiku i grave dhe i të miturve me qëllim shfrytëzimin seksual (funksionar i BE dhe IOM);
- shqyrtim i instrumenteve ligjorë kombëtarë: krahasimi mes Italisë dhe Shqipërisë (ekspert italian dhe shqiptar).

Lektor: *Këshilltar Francesco Mandoi,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA

- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e ndëshkimit të krimit;
- teknika procedurale: hetimet, marrja e provës, përgatitja e procesit;
- mbrojtja e viktimave dhe problematikat në lidhje me marrëdhëniet me familjen e origjinës në Shqipëri.

Seksioni XII
15.00 – 17.30

Grupet e punës.

Raste të veçanta të shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe/ose grave, dhe i dhunës në familje: teknika të marrjes në pyetje të viktimave, mbrojtja për qëllime gjyqësore, veprimtari të rikuperimit të viktimave; këshillohet formimi i grupeve të përziera: gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore.

Dita e dytë, 13 Mars 2007

Seksioni XIII

9.00 – 12.00

Përdorimi i sistemeve dhe teknologjive në relacionin e fundit të prokurorit (për shembull përdorimi i power point në prezantimin relacionit të fundit të prokurorit). Probleme juridike dhe tekniko-operative.

Masa shpërblyese, rënduese të posaçme dhe regjimi i burgimit të posaçëm për krime të krimit të organizuar në të drejtën penale substanciale, procedurale dhe të burgimit.

*Lektorë: Dr.Arben Kraja,
Prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë
Dr.Filippo Spiezia,
Magjistrat në Prokurorinë e Gjykatës së Salernos*

Bashkëpunëtorët e drejtësisë

*Lektor: Këshilltare Teresa Maria Principato,
Prokurore Kombëtare Antimafie, DNA*

Seksioni XIV

15.00 – 17.30

*Grupet e punës:
Shqyrtim i rasteve gjyqësore.*

Dita e tretë, 15 Mars 2007

Seksioni XV

9.00 – 12.00

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar dhe krijimi i një hapësire juridike të përbashkët të sigurisë dhe drejtësisë

Lektorë: *Këshilltar Giustino Sciacchitano,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, DNA
Dr. Alion Cenolli,
Funksionar i Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare,
Pedagog në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë

- nevoja për një strategji ndërkombëtare të luftës kundër krimit të organizuar dhe instrumente ligjore ndërkombëtare;
- instrumente ligjorë të përgatitur nga BE në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; udhëzimet e Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut (modeli evropian i “procesit të drejtë”, e drejta e juridiksionit dhe barazia përpara organeve të drejtësisë; nocioni i akuzës në fushën penale; para-paraqitja në gjykim, pavarësia dhe asnjënjësia e gjyqtarit; kohëzgjatja e arsyeshme e procesit; garancitë procedurale; e drejta për një shkallë të dytë të gjykimit; prezumimi i pafajësisë);
- Kushtetuta evropiane, karta e të drejtave themelore të B.E., Gjyqtari i brendshëm dhe Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut: kontrollet ndërkombëtare mbi respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Seksioni XVI

15.00 – 17.30

Grupet e punës:

Rastet gjyqësore në lidhje me pastrimin e parave: hetime dhe bashkëpunim gjyqësor mes Italisë dhe Shqipërisë.

Dita e katërt, 16 Mars 2007

Seksioni XVII

9.00 – 12.00

Terrorizmi ndërkombëtar

Lektor: *Dr. Michele del Prete,*
Magjistrat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Napolit

- analizë e konventave ndërkombëtare;
- shqyrtim i instrumenteve ligjore kombëtare: krahasimi mes Italisë dhe Shqipërisë;
- instrumente të bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit;
- teknika procedurale: hetimet, marrja e provës, përgatitja e procesit.

Seksioni XVIII

15.00 – 17.30

Grupet e Punës:

Analizë dhe diskutim i rasteve gjyqësore të rëndësishme në lidhje me terrorizmin.

***KURS TRAJNIMI
PËR GJYQTARË, PROKURORË DHE OFICERË
TË POLICISË GJYQËSORE
Romë, 15 - 19 tetor 2007***

Kurs trajnimi për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore

(Romë, 15 – 19 tetor 2007)

Dita e Parë, 15 Tetor 2007

- Kryeson:** **Këshilltar [Kësh.] Lucio di Pietro,**
Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie
- 9.15 – 9.30** Përshëndetja e Delegacionit të Republikës së Shqipërisë
- 10.00 – 12.30** Vizitë tek RACIS-it (*Raggruppamento Carabinieri Investigazioni Scientifiche*)
[Grupimi i Karabinierëve i Investigimeve Shkencore]
- 13.00 – 14.00** Mëngjes i ofruar nga Z.Komandant i ROS-it
(*Raggruppamento operativo speciale dei Carabinieri*)
[Grupimi Operativ Special] i Karabinierëve
- 15.00 – 17.00** Vizitë në Komandën e ROS-it të Karabinierëve: Struktura dhe detyrat e ROS-it. Teknika investiguese të luftës kundër krimit të organizuar në mënyrë të veçantë në bashkëpunimin me policinë gjyqësore shqiptare.

Dita e Dytë, 16 Tetor 2007

- 10.00 – 10.30** Sistemi i tenderimeve dhe prokurimeve publike në përvojën shqiptare
(Relator: *për t'u caktuar nga delegacioni shqiptar*).
- 10.30 – 11.15** Veprimtaria e luftës kundër krimit të organizuar në sektorin e tenderimeve dhe prokurimeve publike: **a)** *Shënime mbi kontrollet administrative antimafie në tenderimet dhe prokurimet publike* (Relator: Prefekti Dr. Bruno Frattasi, Kryetar i Komitetit Koordinues për mbikëqyrjen e lartë mbi Veprat e Mëdha);

- 11.15 – 12.00** b) Tenderimet dhe prokurimet e veprave publike dhe infiltrimet mafioze: analizë e protokolleve hetimore (Relator: Kësh. Corrado Lembo, Zëvendës Prokuror kombëtar i antimafia-s).
- 12.00 – 12.30** Diskutim
- 15.00 – 16.00** Konfiskimi i sendeve që vijnë nga vepra penale në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar (Relator: Ksh. Alberto Cisterna, Prokuror Kombëtar antimafie).

Dita e Tretë, 17 Tetor 2007

- 10.00 – 12.00** Vizitë në SCICO (Servizio Centrale Investigativo contro la Criminalità Organizzata della Guardia di Finanza) [Shërbimi Qendror Investigues Kundër Krimin të Organizuar i Rojes së Financës]. *Struktura dhe detyrat e SCICO-s. Lufta ndaj riciklimit dhe krimin ekonomik-financiar: teknika ndëshkuese.*
- 15.00 – 17.00** *Krimi i organizuar dhe legjislacioni lehtësues (për ata që bashkëpunojnë): Ballafaqime të eksperiencave.* (Relatorë: një magjistrat ose një oficer i policisë gjyqësore, për t'u caktuar nga delegacioni shqiptar; Kësh. Corrado Lembo, Prokuror Kombëtar Antimafie).

Dita e Katërt, 18 Tetor 2007

- 10.00 – 11.00** *Teknika e luftës kundër pastrimit ndërkombëtar të parave* (Relatorë Dr. Renato Righetti, Shef i Shërbimit të veprimtarisë kundër pastrimit të parave, Zyra e Italianëve dhe Këmbimeve; Dr. Nicola Mainieri, Shef i Drejtorisë së Punëve të Përgjithshme dhe Kusdërshtimeve, Zyra e Italianëve dhe Këmbimeve).
- 11.00 – 12.00** Diskutim.

15.00 – 17.00 Vizitë në Drejtorinë Investigative Antimafie [DIA].

Dita e Pestë, 19 Tetor 2007

10.00 – 12.00 Vizita në Zyrën e Komisarariatit të Lartë Anti-Korrupsion.

***KURS TRAJNIMI
PËR GJYQTARË, PROKURORË DHE OFICERË
TË POLICISË GJYQËSORE
Romë, 12 - 16 nëntor 2007***

Kurs trajnimi për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore

(Tiranë, 12 – 16 nëntor 2007)

Dita e Parë, E Hënë, 12 Nëntor

ITALI – SHQIPËRI: KRAHASIM I SISTEMEVE GJYQËSORE

9.00 – 9.30 Prezantim i kursit nën kujdesin e një përfaqësuesi të UNICRI dhe të Këshilltarit Corrado Lembo

9.30 – 10.30 *Sistemi gjyqësor i Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në përvojën konkrete.*

Lektor: *Dr. Vangjel Kosta,*
Trajnues në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë

10.45 – 11.45 *Sistemi gjyqësor i Republikës së Italisë, veçanërisht në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në përvojën konkrete.*

Lektor: *Këshilltar Francesco Mandoi,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, Drejtorja Kombëtare Antimafie, Romë

12.00 – 12.30 *Debat apo ndërhyrje të parashikuara në lidhje me tema të trajtuara nga lektorët.*

Pasdite

13.30 – 16.30 *Debat mbi rastet e shqyrtuara në seksionin e paradites*

Dita e dytë, E Martë, 13 Nëntor

**KRIMI I ORGANIZUAR, EKONOMIA DHE POLITIKA:
KRAHASIM PËRVOJASH**

9.30 – 10.30 *Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Shqipëri.*

Lektor: *Dr. Amarildo Laçi,*
Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda

10.45 – 11.45 *Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Itali*

Lektor: *Këshilltar Lucio di Pietro,*
Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie,
Drejtoria Kombëtare Antimafie, Romë

12.00 – 12.30 *Debat apo ndërhyrje të parashikuara mbi temat e trajtuara nga lektorët.*

Pasdite

13.30 – 16.30 *Debat mbi rastet e shqyrtuara në seksionin e paradites*

Dita e tretë, E Mërkurë, 14 Nëntor

**VEPRIMTARIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE
NJERËZORE NË ITALI E NË SHQIPËRI: KRAHASIM
PËEVOJASH**

9.30 – 10.30 *Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri: probleme dhe perspektiva në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.*

Lektor: *Dr. Skënder Kaçupi,
Pedagog në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë*

10.45 – 11.45 *Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri: probleme dhe perspektiva në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.*

Lektor: *Këshilltar Lucio di Pietro,
Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie,
Drejtoria Kombëtare Antimafie, Romë*

12.00 – 12.30 *Debat apo ndërhyrje të parashikuara mbi temat e trajtuara nga lektorët.*

Pasditë

13.30 – 14.30 *Banka të dhënash të gjurmëve të gishtave. Hetime shkencore dhe teknika të identifikimit në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar.*

Lektor: *Toger Kolonel Gianfranco De Fulvio,
Komandant i Repartit të Daktiloskopisë parandaluese.
RACIS karabinierë, Romë.*

14.45 – 16.30 *Debat mbi rastet e shqyrtuara në seksionin e paradites*

Dita e katërt, E Enjte, 15 Nëntor

**LUFTA KUNDËR TË ARDHURAVE NGA KRIMI NË KUADRIN E
BASHKËPUNIMINDËRKOMBËTAR**

9.30 – 10.30 *Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave të paligjshme në Shqipëri në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar*

Lektor: *Dr. Artur Selmani,*
Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

10.45 – 11.45 *Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave të paligjshme në Shqipëri në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar.*

Lektor: *Këshilltar Alberto Cisterna,*
Prokuror Kombëtar Antimafie, Drejtoria Kombëtare Antimafie, Romë

12.00 – 12.30 *Debat apo ndërhyrje të parashikuara mbi temat e trajtuara nga lektorët.*

Pasditë

13.30 – 16.30 *Debat mbi rastet e shqyrtuara në seksionin e paradites*

Dita e pestë, E Premte, 16 Nëntor

**MUNDËSI PËR BASHKËPUNIM MES ORGANIZMAVE TË
POLICISË GJYQËSORE PËR LUFTËN KUNDËR TË ARDHURAVE
NGA KRIMI**

9.00 – 9.45 *Prezantim i një mundësie për bashkëpunim mes
organizmave të policisë gjyqësore për luftën kundër të
ardhurave nga krimi*

Lektor: **Kolonel Ignazio Gibilaro,**
Komandant SCICO Roja e Financës, Romë

10.00 – 10.45 *Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe kërkimi i të
ardhurave nga krimi*

Lektor: **Këshilltar Giovanni Melillo,**
Prokuror Kombëtar Antimafie,
Drejtoria Kombëtare Antimafie, Romë

11.00 – 12.00 *Përfundim i Kursit dhe ceremonia e dorëzimit të
diplomave*

PARATHËNIE

Koordinimi shkencor i *Kursit të trajnimit për gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore*, i cili m'u besua nga UNICRI, për më shumë se një arsye, nuk qe aspak i lehtë. Vështirësia më e madhe lidhej me faktin që fusha në fjalë është mjaft e gjerë dhe objekt studimi i shumë studiuesve dhe operatorëve të së drejtës, që kanë theksuar shpesh larminë dhe ndryshueshmërinë e madhe që këto dukuri kanë. Në të vërtetë, këto dukuri duket se janë pjesë e një “sistemi kriminal” që tashmë ndikohet fort nga globalizimi i ekonomisë dhe avantazhet që rrjedhin për organizatat kriminale nga ekzistenca e zonave me “ligjshmëri të ndryshueshme”, që ende janë të pranishme në realitetin evropian¹. Me fjalë të tjera, na u desh të shkëpusnim nga *deti i madh* i argumenteve që kanë nevojë për një përthellim tekniko-operativ, ato që shfaqin më shumë interes, pa lënë pas dore trajtimin e temave të mëdha me karakter të përgjithshëm që shërbejnë gati si sfond për të parat. Kështu pra, duke kryer një analizë detyrimsht përmbledhëse, të instrumenteve ligjorë të përgatitur nga Bashkimi Evropian në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, *filli i kuq* i Kursit u shtjellua, në pjesën e parë, përmes analizës së tipareve të larmishme strukturore dhe të formave kryesore në të cilat shfaqet krimi i organizuar, duke mbajtur parasysh skenarët gjeo-kriminalë me interes të veçantë për pjesëmarrësit në seksionet e kursit. Në pjesën e dytë, u trajtua tema, komplekse dhe e gjerë, e luftës kundër krimit ekonomiko-financiar, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në pjesën e tretë, u shqyrtuan tema në lidhje me kërkimin, marrjen dhe vlerësimin e provës në debatin gjyqësor, në perspektivën e veçantë të prokurorit, dhe hartimi i relacionit përfundimtar të prokurorit, edhe me ndryshime në dritën e teknologjive moderne informatike.

Natyrisht, itinerari didaktik, shkencor dhe operativ u përgatit – e ndonjëherë dhe ndryshua kundrejt atij fillestar – duke pasur mirë parasysh udhëzimet dhe sugjerimet e sjella nga Kolegët e nderuar të Shkollës së Magjistraturës dhe të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, të cilët, së bashku me funksionarët e UNICRI ndihmuan në mënyrë përcaktuese në suksesin e *Kursit*.

Struktura e kursit e mbështetur tek dialogu krijoi mundësinë për të trajtuar disa tema tejet të rëndësishme, përtej skemave tradicionale së të ashtuquajturit leksion klasik dhe me një prerje krejt të re shpjegimi:

¹ Shih lidhur me këtë P.L.VIGNA, *Sistema criminale e società*, në A.V., *Sistema criminale ed economia*, Padova, 1998, 3.

këmbimi, njëri pas tjetrit, i lektorëve italianë dhe shqiptarë në shtjellimin e argumenteve bëri që, ashtu siç dhe kishin për qëllim organizatorët, të nxitej një përballje e ngjeshur e analizave dhe përvojave, të përgatitura e të përjetuara, si të thuash, *në terren*, në Itali e në Shqipëri, duke u ndalur veçanërisht në fenomenet kriminale objekt shqyrtimi dhe në teknikat e luftës të përdorura përkatësisht në të dy vendet. Debati që pashmangshmërisht “lindi” nga ky ndërtim didaktiko - shkencor, nga një seksion në tjetrin, fitoi tipare mjaft konkrete dhe u mbështet gjithë kohës në përvojat profesionale të pjesëmarrësve – lektorë dhe dëgjues – të cilët, në grupet e punës të pasdites, duke diskutuar gjallërisht për raste praktike, nuk harruan për asnjë çast objektivin qendror të kursit: përballjen e përvojave të ndryshme hetimore dhe gjyqësore për të gjetur e përcaktuar teknika të përbashkëta të luftës kundër krimit të organizuar transnacional.

Më konkretisht, *Kursi* u shtjellua përgjatë një itinerari, hera-herës të vështirë (për shkak të vështirësisë së veçantë që paraqisnin argumentet e trajtuar), por gjithnjë interesant për nga larmia dhe thellësia e ndihmesës së gjithë lektorëve dhe pjesëmarrësve.

Na duhet sidoqoftë të tërheqim vëmendjen për diçka. Jo të gjithë lektorët, italianë dhe shqiptarë, u kujdesën të dorëzonin kumtesat e tyre me shkrim në kohën e duhur për botimin e këtij vëllimi. Nevoja të pashmangshme organizative na detyrojnë të bëjmë pa ndihmën e çmuar të tyre, të paktën në përmbledhjen e dokumentacionit shkencor të *Kursit*. U kërkojmë ndjesë lektorëve të nderuar dhe lexuesve të duruar të këtij libri.

CORRADO LEMBO
Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie

PJESA E PARË

TIPARE STRUKTUREORE DHE FORMA TË SHFAQJES SË KRIMIT TË ORGANIZUAR TRANSNACIONAL

1.1. Lufta kundër krimit të organizuar transnacional në hapësirën juridike dhe gjyqësore evropiane.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar dhe krijimi i një hapësire gjyqësore të përbashkët të sigurisë dhe drejtësisë. Karta e të drejtave themelore të B.E.. Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

§ 1. E drejta komunitare.

Tema që më është caktuar (hapësira juridike dhe gjyqësore evropiane) ka të bëjë me një prej objektivave më të lartë dhe ambiciozë ndër objektivat që Bashkimi Evropian kërkon të arrijë dhe, është i tillë sa që do të ndryshonte thellësisht si rendin kushtetues të Shteteve anëtare ashtu dhe marrëdhëniet mes tyre dhe B.E., si i tillë.

Hapësirë juridike e përbashkët do të thotë në fakt të duash që në Evropë të hyjë në fuqi e njëjta normë e të drejtës civile apo penale dhe jo vetëm norma homogjene të shpallura nga vendet anëtare.

Hapësirë juridike e përbashkët do të thotë të njohësh menjëherë e automatikisht në të gjithë Evropën vlefshmërinë e një vendimi apo urdhri gjyqësor të nxjerrë nga një Gjyqtar i cilitdo prej vendeve anëtare.

Këto propozime, në vlerën e tyre reale janë revolucionare ndaj sistemit tradicional të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar: ato shkojnë përtej koncepteve dhe parimeve tradicionale të bashkëpunimit që mbështeten ende në marrëdhëniet mes Shteteve, pra në vullnetin e Shteteve për t'i dhënë njëri-tjetrit ndihmë të ndërsjellë në fushën penale.

Ky sistem tradicional i ndihmës parashikon që dy Shtete, edhe kur kanë një traditë të ndryshme juridike, sociale, politike, vendosin të bashkëpunojnë në fusha të caktuara dhe për këtë qëllim lidhin traktate, dy apo shumëpalëshe në të cilët tregojnë mënyrat me të cilat realizohet ky

bashkëpunim: në fushën penale dy mënyrat kryesore të bashkëpunimit janë letërporosia dhe ekstradimi.

Me këto traktate dy Shtetet njohin se kanë të dy njëjtat vlera themelore dhe vullnetin për të ndjekur e arritur të njëjtat objektiva, ndonëse kanë legjislacione të ndryshme dhe duke mos prekur prerogativat shtetërore të sovranitetit dhe të qenit unik të juridiksionit.

Por Evropa kërkon të kryejë në këto momente një kapërcim të këtyre parimeve dhe të bëjë një hap përpara në këtë fushë.

Me traktatet evropiane tashmë ka marrë formë bashkëndarja e parimeve të lirisë, të drejtësisë, të të drejtave të njeriut, si dhe vetëdija se këto parime edhe garantohen realisht për gjithë shtetasit në hapësirën gjeopolitike që është Evropa (Traktati i Mastridit – neni 6); nuk është e nevojshme pra që çdo herë të kujtohen në traktate apo të verifikohet ekzistenca e tyre përmes një procedure gjyqësore.

Vendet e Evropës që tashmë bëjnë pjesë në këtë Bashkim të ri mund të nisin të kapërcejnë metodat tradicionale të bashkëpunimit mes Shteteve të ndryshme, duke iu dashur të kuptojnë se bashkëpunimi gjyqësor ndodh tanimë brenda një entiteti të ri, pra me mënyra që mbajnë parasysh realitetin e ndryshëm politik.

Ky objektivi që ende nuk është arritur plotësisht është përcaktuar dora dorës që Komuniteti i ri Evropian arrinte objektiva të tjerë dhe fitonte vetëdije për kërkesat e reja dhe nevojën për të përballuar sfida të reja.

Një prej tyre ishte dhe është ajo e kriminalitetit të organizuar transnacional.

§ 2. *Kriminaliteti i organizuar transnacional.*

Kriminaliteti i organizuar ka ndryshuar thellësisht kohët e fundit: krahas atij që mund të quajmë tradicional sepse është rrënjësor në një territor të caktuar me degëzime dhe kontakte me organizata të tjera (mafia siciliane, kartelat kolumbiane dhe të ngjashme) është dhe kriminaliteti që sot quhet transnacional: ai formohet nga grupe personash që u përkasin vendeve të ndryshme, etnive të ndryshme, të bashkuar jo më nga prejardhja e përbashkët por vetëm nga interesi i përbashkët dhe që veprojnë njëkohësisht në më shumë se një vend.

Grupet me këtë përbërje veprojnë në hapësirën shumë të gjerë që duke nisur nga Shqipëria e Ballkani shtrihet në gjithë Evropën Qendrore Lindore

dhe deri në Rusi; kalojnë aty të gjitha trafiqet e paligjshme të drejtuara nga krimi i organizuar: droga, armët, trafiku i qenieve njerëzore, klandestinët, makinat e vjedhura, pastrimi i parave me prejardhje të paligjshme, të mirat strategjike si burimet energjetike dhe të tjera.

Po në këtë hapësirë ka bërë vend edhe kriminaliteti i organizuar me prejardhje perëndimore, duke gjetur në të lehtësira për të cilat do flasim më tej.

Trafiku i drogës dhe trafiku i qenieve njerëzore, siç dihet, mbajnë vendet e para për fitimet që arrin të marrë kriminaliteti i organizuar.

Për sa i takon drogës Shqipëria është sot një nga terminalet më të mëdhenj të drejtimeve të trafikut, si të heroinës ashtu dhe të kokainës; Polonia është ndër prodhuesit kryesorë botërorë të drogave sintetike dhe në veçanti të metanfetaminave; drejtimi ballkanik pas fundit të luftës në këtë rajon, u riaktivizua në tri nënndarje: rruga në veri (që kalon përmes Ukrainës, Rumanisë, Hungarisë); rruga qendrore tradicionale (që nga Turqia kalon përmes Bullgarisë, Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë); rruga e jugut (që përshkon Turqinë dhe Greqinë dhe mbërrin në Itali nëpërmjet detit).

Sipas vlerësimeve të Europolit çdo vit, 250 tonelata kokainë transportohen nga vendet e Amerikës së Jugut nëpërmjet detit apo ajrit, dhe pikat kryesore të mbërritjes gjenden si në Evropën Perëndimore (Spanjë, Holandë, Itali, Britani e Madhe) ashtu dhe në Evropën Qendrore-Lindore dhe në Shqipëri në pritje për ta shpërndarë në vendet e Bashkimit Evropian².

Gjithashtu, jo më pak shqetësuese është përhapja e dy fenomeneve të trafikut të qenieve njerëzore dhe e trafikut të klandestinëve.

Në lidhje me fenomenin e parë, hetimet tregojnë se ai përkon në njëfarë mënyre me trafikun e drogës: në të dyja rastet ka një vend të origjinës, një vend tranziti dhe një vend destinacioni; veprimtaria kriminale fillon në vendin e origjinës së viktimës (zakonisht në një vend lindor), vazhdon më pas në vende të tjera ku u shitet organizatave të tjera kriminale dhe u nënshtrohet dhunës fizike dhe psikike, plotësohet në vendin e destinacionit (vend i Evropës Perëndimore (ku futet në prostitucion dhe në punë të tjera të detyruara).

Kjo gjendje alarmante ka pasur jehonë të madhe në organizmat ndërkombëtarë, dhe sidomos në Bashkimin Evropian.

² Overview of the cocaine problem in the E.U. Raport i paraqitur nga Europoli në mbledhjen e Grupit Horizontal për Drogën në Bruksel në 16/01/2006.

Kuptuam kështu se fenomeni i kriminalitetit të organizuar kish marrë përmasa të tilla dhe ish futur kaq shumë në strukturat organizative të shumë vendeve, saqë ish bërë një rrezik serioz për vetë sigurinë e këtyre vendeve; kjo gjë bënte që rreziku lidhej me kolektivitetin në përgjithësi dhe që lufta kundër këtij rreziku nuk i takonte më vetëm vendeve të veçanta por merrej përsipër si veprimtari e mirëfilltë nga B.E., si e tillë.

Lufta kundër kriminalitetit të organizuar u bë kështu një problem politik përveç se tekniko-juridik, aq sa Bashkimi Evropian e konsideroi një ndër objektivat që duhen arritur përmes organizmave të tij.

§ 3. Traktatet themeluese të B.E. dhe dokumentet komunitarë në fushën penale.

Fillimi i këtij përfitimi të ri politik mund të themi se përkon me Traktatin e Mastridit (7 shkurt 1992).

Ky traktat përcakton për herë të parë në nenin K 1 se për qëllime të realizimit të objektivave të Bashkimit, Shtetet anëtare e konsiderojnë, ndër të tjera, si çështje me interes të përbashkët bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile dhe penale, bashkëpunimin e policisë për luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe format e tjera të rënda të kriminalitetit të organizuar.

Sigurisht që ky është një hap i rëndësishëm por udha do të jetë ende e gjatë sepse vendet nuk janë shumë të prirura të lëshojnë hapësira në fushën e të drejtës penale.

Në shumë dokumente të mëtejshëm dhe veçanërisht me Rekomandimet dhe Rezolutat e B.E. shtyhen vendet anëtare të përfaqsin legjislacionet e tyre kombëtare për arritjen e objektivit të përbashkët.

Plani i Veprimit kundër kriminalitetit të organizuar të 28 prillit 1997, pasi kujtoi urgjencën dhe rëndësinë politike që i jepet nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeveritë çështjes së luftës kundër kriminalitetit të organizuar, tregon tema të ndryshme në të cilat duhet të kryhet përafrimi i legjislacionit dhe i fton vendet të mbajnë parasysh sa është bërë në këtë fushë brenda vetë B.E. dhe në organizma të tjerë ndërkombëtarë (OKB, Interpol, GAFI) dhe të punojnë së bashku me vendet candidate për të hyrë në Evropë, apo me vende të tjera si Rusia dhe Ukraina.

Është i qartë në këto pohime vullneti evropian për të vepruar në mënyrë të tillë që të zgjerohet hapësira ku përgatiten zgjidhjet e politikës gjyqësore,

duke përfshirë vende të reja dhe organizata ndërkombëtare, me qëllim që të arrijmë të kemi norma të reja të bashkëndara në nivel ndërkombëtar.

Duke analizuar dokumentat evropiane në fushën e drejtësisë del qartë se secili prej tyre lidhet me atë të mëparshëm dhe tregon një objektiv të ri për të ardhmen.

Në fushën tonë, Traktati i Amsterdimit (2 tetor 1997), paraqet shumë interes për pohimet politike dhe rezultatet konkrete që ka frymëzuar.

Ai pohon para së gjithash se objektivi i përgjithshëm i Bashkimit është t'u japë shtetasve të tij një nivel të lartë sigurie në një hapësirë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, duke zhvilluar ndër Shtetet anëtare një veprimtari të përbashkët në sektorin e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësore në fushën penale. Në nenin 32 parashikon gjithashtu që Këshilli duhet të vendosë kushtet dhe limitet brenda të cilave autoritetet e një vendi mund të veprojnë në territorin e një Shteti tjetër anëtar në lidhje me këtë të fundit.

Traktati tregon pra vijat programuese për të kapërcyer konceptin e përafrimit të legjislacioneve me qëllimin e krijimit të një hapësire juridike e gjyqësore të përbashkët, dhe ngre një objektiv që do të realizohet më pas nga Këshilli i Evropës në Tamperrë (krijimi i Eurojust) dhe nga Konventa evropiane për ndihmën gjyqësore në fushën penale (skuadra hetimore të përbashkëta).

Meqë Rezoluta e Parlamentit Evropian e datës 15 nëntor 1997, ndër të tjera, vinte në dukje faktin që nuk ekzistonte ende një përkufizim për kriminalitetin e organizuar, Veprimi i Përbashkët i datës 12 dhjetor 1998 kërkon të plotësojë këtë boshllëk duke futur për herë të parë, edhe pse jo një përkufizim, të paktën një kriter për të përcaktuar nëse jemi para një grupi kriminal të organizuar.

Dokumenti kërkon të gjejë edhe një pikë takimi mes legjislacioneve të vendeve latine që e njohin krimin e organizuar (Italia, Franca, Spanja) dhe atij të vendeve anglo-saksone që, ndryshe nga të parat, njohin konspiracionin (conspiracy).

Është e rëndësishme të vërejmë se në përgatitjen e këtij teksti ndihmoi shumë përvoja legjislative italiane që, në kodin e saj penale, e parashikon prej kohësh krimin e bashkëpunimit në krim (neni 416) dhe bashkëpunimin në krim të llojit mafioz (neni 416 bis).

Në nivel ndërkombëtar, parashikimi më i plotë që synon të përcaktojë grupin kriminal të organizuar gjendet në nenin 2 të Konventës së Kombeve

të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transnacional (Konventa e Palermos, 2000).

Siç thamë, Këshilli i Evropës në Tamperrë (15 tetor 1999) realizon disa nga udhëzimet e traktatit të Amsterdami për një akses më të mirë ndaj drejtësisë në Evropë, për njohjen e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore, dhe krijon organizmin e ri të bashkëpunimit gjyqësor Eurojust që do të ngrihet me Vendimin e Këshillit të datës 28 shkurt 2002.

Ai pohon gjithashtu se në Evropë procedura zyrtare e ekstradimit duhet të anulohet.

Një vit më pas, në Tamperrë nënshkruhet Konventa Evropiane për ndihmën gjyqësore në fushën penale (Bruksel 29 maj 2000).

Është një Konventë me mjaft risi në shumë pika të saj, gjë që do të thotë se janë të nevojshme disa ndryshime në legjislacionin e brendshëm të vendeve anëtare.

Mjafton të përmendim këtu formalitetet e reja për kërkesën e letërporosive, dërgimin spontan dhe të drejtpërdrejtë të informacioneve, transferimin e përkohshëm të personave të burgosur, krijimin e skuadrave hetimore të përbashkëta, përgjimet telefonike.

Skuadrat hetimore të përbashkëta, mundësia e krijimit të të cilave ish parashikuar që me Traktatin e Amsterdami, janë sigurisht mjeti më i ri për thjeshtimin e hetimeve që duhet të kryhen në më shumë se një vend të Bashkimit Evropian.

Është e qartë se sa ky mjet i ri operativ ndryshon bashkëpunimin tradicional mes Shteteve: ai, në njëfarë mase, mund të mbërrijë të kapërcejë formalitetet e letërporosisë pasi dy Autoritetet veprojnë së bashku, në të dy vendet, për të mbledhur provat e nevojshme në çështjet e nisur në njërin prej tyre; por kjo bën që një vend të lejojë që në territorin e vet mund të veprojnë njëkohësisht Autoriteti i një vendi tjetër me pasojën që, siç do ta shpjegojmë pas pak, dobësohet vetë parimi i sovranitetit.

Mbërritëm kështu në dy aktet e fundit komunitare: në Vendimin e Këshillit që themelon Eurojust dhe në Vendimin Kuadër të datës 13 qershor 2002 në lidhje me urdhrin e arrestit evropian.

Eurojust është organizmi gjyqësor evropian që bashkërendon të gjitha hetimet kundër formave të rënda të kriminalitetit të organizuar, që mund t'u japë shtysë hetimeve, që mund t'u kërkojë autoriteteve të çdo vendi të vlerësojnë mundësinë e krijimit të skuadrave hetimore të përbashkëta dhe të

sigurojnë informacione të ndërsjella mes autoriteteve të përfshira në rastet e veçanta.

Bëhet fjalë për një organizëm të ri mjaft të rëndësishëm që lejon një bashkërendim real mes hetimeve ekzistuese në më shumë se një vend anëtar me shkëmbimin e menjëhershëm dhe informal të akteve, dokumenteve, informacioneve.

Prokurorët dhe gjyqtarët evropianë patën që në krye mundësi të përcillnin aktet drejtpërsëdrejti mes tyre, por krijimi i Eurojust-it realizon një tjetër hap: sanksionohet në të vetëdija se lufta kundër krimit të organizuar, duke qenë një objektivi parësor i Bashkimit Evropian, duhet të bëjë që hetimet mes vendeve anëtare duhet të trajtohen në një këndvështrim komunitar.

Urdhri i arrestit evropian është mishërimi i parimit të vendosur në Amsterdam dhe theksuar sërish në Tamperrë, për njohjen e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore.

Nga pranimi i njohjes së vendimeve vijon objektivi përfundimtar i Bashkimit që ka të bëjë me angazhimin në program për heqjen në Evropë të procedurës zyrtare të ekstradimit.

Ekstradimi është mbështetur gjithnjë nga disa parime, dhe i është nënshtruar verifikimit nga ana e Shtetit të kërkuar, për ekzistencën e elementëve që do të provonin – në mënyrë pak a shumë të thelluar – përgjegjësinë e personit që duhet dorëzuar. Procedura ka qenë gjithnjë mjaft e gjatë dhe komplekse; duke qëndruar kështu vërtet larg njohjes së menjëhershme të vendimit të gjyqtarit të vendit kërkuar.

Në hapësirën e re gjyqësore evropiane ku ka të paktën një kriter për të përcaktuar nëse jemi përpara një grupi kriminal të organizuar, vendimi i dhënë nga gjyqtari duhet të gjejë zbatim të menjëhershëm, kështu që nuk do të flitet më për ekstradim por për diçka të ndryshme që do të jetë rrjedhojë e situatës së re.

Urdhri i arrestit evropian flet në fakt për dorëzim të personit dhe thjeshton ndjeshëm procedurat, në mënyrë të tillë që të mund të arrihet, brenda një kohe të shkurtër, një nga rezultatet maksimale të bashkëpunimit gjyqësor.

Në këtë pikë është e nevojshme të vërejmë se përfitimet e fundit të të drejtës evropiane kanë sjellë një ndryshim themelor në politikën ndërkombëtare dhe kushtetuese të çdo Shteti.

Secili prej tyre, duke zbatuar në të vërtetë parimin e traktateve të Bashkimit sipas të cilit lufta kundër kriminalitetit është një objektiv komunitar, ka pranuar të shohë të zbehura konceptet themelore të sovranitetit dhe të kompetencës ekskluzive në veprimtarinë e luftës, si dhe atë në lidhje me ndjekjen e shtetasit të vet, në favor të një veprimtarie të përbashkët dhe për një të mirë të përbashkët.

Shpjegohet kështu njohja e ndërsjellë dhe e menjëhershme e vendimeve gjyqësore të huaja, mundësia e ndërhyrjes për Eurojust, mundësia e krijimit të skuadrave hetimore të përbashkëta, mundësia e ekstradimit edhe të shtetasit. Evropa kërkon të rrezojë poshtë kështu edhe të fundit pengesa që kanë mbetur: ato juridike dhe gjyqësore.

§ 4. Të drejtat e njeriut.

Një tjetër aspekt themelor në ndërtimin e Bashkimit Evropian është ai lidhur me të drejtat e njeriut.

Në vitin 1950 u nënshkrua në Romë Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Bëhet fjalë për konventën më të vjetër dhe të rëndësishme evropiane që, së bashku me protokollet shtesë, përbën një lloj “Magna Charta” në nivel evropian të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Konventa hapet duke shpallur të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e individit; vijon duke u marrë me format e ndryshme të lirisë: të shprehjes, të mbledhjes, por edhe me të drejtat subjektive si prona, arsimi, procesi i drejtë.

Tejet i rëndësishëm është Protokollin i gjashtë shtesë i vitit 1983, në të cilin parashikohet heqja e dënimit me vdekje.

Konventa, për respektimin e normave të saj parashikon dy organe të posaçme:

- a.** Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut;
- b.** Komisioni evropian i të drejtave të njeriut.

Gjykata, duke filluar nga viti 1969 njeh që të drejtat themelore, siç rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta në Shtetet anëtare dhe nga kushtetutat, bëjnë pjesë në parimet juridike të përgjithshme për të cilat ajo garanton respektimin: Gjykata, ka për detyrë të verifikojë respektimin e të

drejtave themelore duk iu referuar si legjislacioneve kombëtare ashtu dhe atyre komunitare.

Jurisprudenca e Gjykatës shpuri në kodifikimin e këtyre parimeve në traktatet e Bashkimit Evropian.

Traktati i Mastridit në nenin e tij 6 (ex neni F) pohon se “Bashkimi mbështetet në parimet e lirisë, të demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore dhe në shtetin e të drejtës, parime që janë të përbashkëta për Shtetet anëtare.

Bashkimi Evropian respekton të drejtat themelore siç garantohen nga Konventa evropiane për të drejtat e Njeriut, nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950, dhe siç rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të Shteteve anëtare, pasi janë parime të përgjithshme të të drejtës komunitare.

Traktati i Amsterdimit thelloi më tej aspektet sociale dhe të drejtat individuale dhe kolektive, duke përcaktuar gjithashtu mosdiskriminimin sipas seksit, racës, fesë, etnisë, aftësisë së kufizuar.

Në vitin 1999 Këshilli i Evropës në Këln krijoi “Kartën e të drejtave themelore” duke pasur për qëllimin rritjen e mbrojtjes së tyre, duke i bërë më të dukshme në dritën e evolucionit të shoqërisë, të përparimit social dhe të zhvillimeve shkencore.

Karta rendit tri kategori së të drejtave:

- drejtën e lirisë dhe të barazisë;
- të drejtën e votës dhe të lirisë së lëvizjes në Shtete anëtare;
- të drejtat ekonomike dhe sociale.

Projekti i kartës nga njëra anë është njohës për sa u përket “të drejtave tradicionale” të parashikuara tashmë në tekstet e akteve të tjera evropiane, nga ana tjetër është novator pasi u referohet “të drejtave të reja”, siç janë mbrojtja e të dhënave personale, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e fëmijëve dhe e të moshuarve, e drejta për strehim.

Shpresa e shumë vendeve dhe e vetë Parlamentit evropian ishte që Karta të mund të bëhej pjesë e Korpusit të traktateve të Bashkimit Evropian; ndërsa Këshilli i Evropës i mbledhur në Nisë, e shpalli Kartën e të Drejtave themelore por nuk e përfshiu atë në traktate.

Edhe pse nuk ka vlefshmëri detyruese, duhet parë se ç’rol do i lihet asaj në praktikën e zbatimit.

Sidoqoftë Karta ka sot një rëndësi të vetën duke dëshmuar ndjenjën e përbashkët evropiane që përbëhet nga të drejta dhe fitore të rëndësishme civile dhe duke shfaqur karakterin e thellë të Evropës, që nuk është vetëm ekonomik.

KËSHILLTAR GIUSTO SCIACCHITANO
Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie

Tiranë, Mars 2007

1.2. “Mafiet e reja”. Struktura dhe format e shfaqjes së krimit të organizuar transnacional: analizë e përvojës gjyqësore italiane.

§ 1. Roli i Drejtorisë Kombëtare të Antimafias në luftën ndaj “Formave të reja të Mafias”.

Drejtoria Kombëtare e Antimafias, duke filluar nga viti 1994, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë studimit dhe analizës së realiteteve kriminale të huaja që veprojnë në Itali³, të ngjashme me të ashtuquajturat mafie tradicionale (*Cosa Nostra*, *Camorra*, etj.), pra realitete që bëjnë pjesë (apo mund të bëjnë pjesë) në format e parashikuara nga neni 416/bis i k.p. Në mënyrë të veçantë, organizatat e personave që synojnë të kryejnë krime si dhe të ushtrojnë e administrojnë veprimtari ekonomike, nëpërmjet kontrollit të territorit, përdorimit të kërcënimit apo të dhunës, duke iu përmbajtur rreptësisht rregullit të heshtjes (heshtje e brendshme), çka i detyron viktimat dhe dëshmitarët e fakteve kriminale të heshtin (heshtje e jashtme).

Drejtoria Kombëtare e Antimafias e ka përqendruar vëmendjen e saj kryesisht mbi këto realitete të huaja:

- shqiptare;
- rumune;
- bullgare;
- afrikano-veriore, veçanërisht ajo nigeriane dhe magrebine;
- amerikano-jugore, sidomos ajo kolumbiane;
- ruse;
- kineze.

Drejtoria Kombëtare e Antimafias, nëpërmjet një studimi dhe një analize të hollësishme të materialit të mbledhur vit pas viti pranë Drejtorive të Rrethit apo Distriktuale Antimafie si dhe pranë Prokurorive, lidhur me krime të ndryshme të kryera nga kriminaliteti i organizuar, si dhe nëpërmjet të dhënave të përftuara pranë D.I.A dhe Shërbimeve Ndërajonale, ka arritur në këto përfundime të përgjithshme:

- a) çdo realitet kriminal mbart një karakteristikë të vetën që lidhet me kulturën e vendit të origjinës;

³ Bëhet fjalë për organizata të huaja, ndërkombëtare dhe/ose transnacionale, të cilat janë quajtur ndryshe “mafie të tjera” dhe, më pas, “mafie të reja”.

- b) organizatat e huaja kriminale parapëlqejnë zakonisht të vendosen në ato zona ku prania e “mafieve tradicionale” është më e vogël (pra jo në zonat jugore, me përjashtim të Campania-s);
- c) këto organizata priren ti shmangen lidhjes së aleancave me “mafiet tradicionale”, me përjashtim të disa veprimtarive të paligjshme;
- d) anëtarët e këtyre organizatave janë kryesisht klandestine.

Sikurse format tradicionale të kriminalitetit të organizuar italian, dhe organizatat e huaja kriminale, priren që një pjesë të kapitaleve të krijuara si rezultat i përfitimeve nga veprimtari të paligjshme, ta përdorin për financimin e aktiviteteve të tjera kriminale, ndërsa pjesën tjetër në të ashtuquajturat parajsë fiskale si dhe në investime në vendet e tyre të origjinës.

§ 2. *Kriminaliteti shqiptar.*

Me hapjen e kufijve, si pasojë e ngjarjeve politike të vitit 1991, u shënua një eksod i madh i shtetasve shqiptarë drejt vendeve evropiane, ndër të cilat dhe Italia. Për rrjedhojë, autoritetet italiane ndërmorën një sërë masash të nevojshme për të përballuar këtë fluks emigracioni. Por, nga ana tjetër, këto masa bënë që të lindte e të zhvillohej trafiku i klandestinëve, kryesisht nëpërmjet kanalit të Otrantos, të cilët mbërrinin në brigjet puljeze.

Ky trafik klandestinësh, i cili siguron përfitime të mëdha, fillimisht u kryesua nga organizata e tipit mafioz që vepron në Pulje, e njohur ndryshe me emrin *Sacra Corona Unita* (“S.C.U.”) (*Sakra Korona Unita*).

Më pas, emigracioni klandestin u administrua nga grupet kriminale shqiptare, në bashkëpunim me kriminalitetin puljez, i cili mbulonte veprimtarinë e imbarkimit të klandestinëve në këmbim të sasive të lëndëve narkotike, kryesisht të atyre të lehta.

Me kalimin e kohës, kjo veprimtari kriminale, e quajtur ndryshe “*smuggling*” (favorizim i emigracionit), është zvogëluar mjaft, kjo si pasojë e luftës efikase në të dy brigjet e Adriatikut si dhe e faktit se flukset emigruese tashmë kanë zgjedhur linja të tjera.

Në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, e njohur ndryshe “*trafficking*”, vërehet një ulje e flukseve që ndjekin rrugën detare si dhe prirja për ta zëvendësuar këtë linjë me atë tokësore, duke u mbështetur në organizatat ekzistuese në Vendet kufitare (Slloveni, Kroaci, Rumani,

Moldavi, etj.), me synim futjen në territorin Italian të femrave me qëllim shfrytëzimin e tyre për prostitucion.

Në këto vitet e fundit, mafia shqiptare ka marrë pjesë gjerësisht në veprimtaritë kriminale të cilat lidhen me fluksin emigrues që prek Vendlin tonë, sikurse trafiku ndërkombëtar i lëndëve narkotike të çdo lloji, duke luajtur një rol kryesues. Sipas të dhënave zyrtare, si rrjedhojë dhe e veprimeve ushtarake në rajonin e Kosovës, numri i shtetasve shqiptarë (klandestinë dhe me dokumente të rregullta), e ka kaluar shifrën e 100.000 personave.

Duhet theksuar se vetëm një pjesë e klandestinëve shqiptarë ndalet në zonat në të cilat shkelin për herë të parë me hyrjen në territorin e Vendlin tonë. Në të vërtetë ata transferohen, në mënyrë të organizuar, kryesisht në qytetet e pjesës qendrore dhe veriore të Italisë.

Një prani e konsiderueshme e shtetasve shqiptarë është regjistruar në Lombardi (Milano), në Piemonte (Alessandria dhe Asti), në Liguria (Genova), në Emilia-Romagna (Rimini), në Marche (Ascoli Piceno dhe pescara), në Abruzzo (Teramo), por dhe në Campania (Caserta), në Puglia (Brindisi), e në një masë më të vogël në ishujt e Italisë.

Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim në këtë raport (01.07.2005 – 30.06.2006), numri i shtetasve shqiptarëve (duke nënkuptuar me këtë dhe numrin e personave që i përkasin etnive të ndryshme që kanë fituar shtetësinë shqiptare, apo të shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi) të arrestuar në Itali kap shifrën e më shumë se 1.000 personave, ndërsa numri i personave nën hetim është shumë më i lartë.

Zakonisht, grupet kriminale shqiptare përbëhen nga persona me prejardhje nga të njëjtat qytete, lagje, apo dhe familje. Ato karakterizohen nga një strukturë përgjithësisht horizontale, brenda së cilës njihet vetëm një kryetar. Këto grupe, për të afirmuar pushtetin e tyre që vështirë mund t'u mohohet, përdorin metodën e ngjalljes së frikës e terrorit.

Veprimtaritë kryesore kriminale të kryera nga grupet e organizuara kriminale shqiptare janë:

- Shfrytëzimi i prostitucionit, kryesisht në dëm të femrave, shpesh të moshave të reja, të cilat hyjnë në Itali në mënyrë klandestine, dhe jo rrallë herë, të sekuestruara në vendet e origjinës. Disa prej proceseve kryesore, të ndjekura e të përfunduara në Itali, në ngarkim të shtetasve shqiptarë, na kanë shpënë, ndër të tjera, në mbështetje të akuzës për krimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe vënies në kushtet e skllavërisë.

Organizatave shqiptare që merren me shfrytëzimin e prostitucionit janë të pranishme pothuaj në të gjithë territorin kombëtar. Ndonjëherë, në bashkëpunim me organizatat vendase të llojit mafioz (sikurse në rastin e Campania-s), ato arrijnë të realizojnë format e bashkëjetesës dhe të ndarjes së territorit, duke shmangur në këtë mënyrë përplasjet mes tyre.

Është vërtetuar se grupet shqiptare gëzojnë pothuaj monopolin e shfrytëzimit të prostitucionit në Itali, e në disa raste, të drejtën e kontrollit dhe të shoqërimit në rrugë të femrave të shndërruara në kushtet e skllavërisë, ua kalojnë grupeve rumune.

Mjaft alarmues është dhe fenomeni i trafikimit të të miturve, të cilët i nënshtrohen një veprimtarie tejte të lodhshme në kërkimin e lëmshës, ose përdoren për tregun e birësimeve të paligjshme apo të atij të pedo-pornografisë.

Ndër hetimet më të rëndësishme të kryera gjatë periudhës së marrë në shqyrtim, vlen të përmendim:

- hetimi i kryer nga Autoriteti Gjyqësor i Torino-s, ndaj eksponentëve të një organizate kriminale që merrej me favorizimin e emigracionit klandestin dhe shfrytëzimit të prostitucionit, i cili përfundoi me arrestimin, në nëntor të vitit 2005, të 10 personave, ndër të cilët një shqiptar dhe 7 italianë. Gjatë fazës së hetimeve, u sekuestruan 4 llogari bankare që i përkisnin shtetasve me kombësi të ndryshme, ndër ta një shqiptar, si dhe 6 apartamente që ndodheshin në kryeqendrën piemonteze e që përdoreshin nga kjo organizatë për prostitucionin e femrave.

- Hetimi *Harem*, i bashkërenduar nga D.D.A e Catanzaro-s, i cili përfundoi në tetor të vitit 2005, me ekzekutimin e vendimit, në Itali, në Shqipëri, dhe në vende të tjera evropiane, ndër të cilat Gjermania dhe Ukraina, për masën e sigurisë të burgimit pa afat, lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake në ngarkim të 80 personave, në pjesën më të madhe shtetas shqiptarë, si përgjegjës, në bashkëpunim dhe me shtetas italianë, për bashkëpunim në krim me synim favorizimin dhe shfrytëzimin e prostitucionit, favorizimin e emigracionit klandestin, si dhe për bashkëpunim në krim me synim trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike të importuara nga Shqipëria si dhe të armëve të cilat hynin në territorin italian nëpërmjet po atyre kanaleve që përdoreshin për drogën, me të cilat furnizoheshin dhe organizatave “ndrangetiste” (të *Ndrangheta-s*) të bregdetit të Jonit;

- hetimi *Albanera*, i bashkërenduar nga D.D.A e Perugia-s, ndaj një organizate shqiptare, e krijuar si një shoqëri mafioze e armatosur, me synim kontrollin e lokaleve të natës që ndodheshin në hinterland të kryeqendrës së

qarkut të Umbria-s, ku ndër të tjera merrej dhe me shfrytëzimin e prostitucionit dhe me kryerjen e veprimtarive të mashtrimit, i cili përfundoi me arrestimin e 3 personave, që konsideroheshin si drejtuesit e kësaj organizate;

- hetimi *Galassia*, ndaj një grupi kriminal i cili përbëhej nga 5 shtetas shqiptarë dhe 2 shtetase ruse, ndaj të cilit u mor masa e sigurisë me burg pa afat, masë kjo e marrë me vendimin e datës 19.01.2006 të Autoritetit Gjyqësor të Modena-s, si përgjegjës për kryerjen e krimit të emigracionit klandestin, favorizimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit, dhunës seksuale, etj.;

- hetimi *Free Slave*, i kryer nga Autoriteti Gjyqësor ligur, i cili përfundoi me arrestimin e 2 shtetasve shqiptarë dhe 2 shtetasve rumunë të cilët bënin pjesë në organizatën kriminale që merrej me trafikun e qenieve njerëzore dhe me shfrytëzimin e prostitucionit;

- trafikimi i sasive të konsiderueshme të lëndëve narkotike, që jo rrallë herë, kryhet në bashkëpunim me shtetas italianë apo me organizata të tjera të huaja.

Nga analiza e dinamikës kriminale, ka dalë në pah se organizatat kriminale shqiptare fillimisht janë njohur në Itali si “organizata shërbimi”, në kuptimin se në krahasim me organizatat tradicionale që veprojnë në territorin italian, u shfaqën si grupe të afta të kryenin furnizimin me lëndë narkotike, duke shmangur kështu rreziqet e transportimit dhe të ruajtjes së kësaj të mire të paligjshme me të cilat mund të ndesheshin grupet apo organizatat kërkuese.

Këto karakteristika vërehen qartësisht në hetimet e kryera nga Prokuroritë e rrethit në të gjithë territorin kombëtar.

Në këto vitet e fundit organizatat shqiptare kanë zënë një vend kryesor në trafikimin e lëndëve narkotike, çka ka përcaktuar – në disa raste – kushtet e vartësisë së grupeve të përbëra nga shtetas italianë që bashkëpunojnë me ta dhe, – pothuaj në pjesën më të madhe të hetimeve – një marrëdhënie “klientelizmi” të grupeve që i përkasin organizatave të mëdha të llojit mafioz që veprojnë në këtë fushë (*mafia, ndrangheta dhe camorra*), pasi këto të fundit pothuaj e kanë braktisur traditën e kërkimit të rrugëve të drejtpërdrejta të importimit të këtyre lëndëve.

Sistemet e importimit të mbikëqyrura janë nga më të ndryshmet. Për këtë qëllim, përdoren si mjetet e përdorura për trafikimin e personave (që duket se përbën prirjen aktuale të skafistëve shqiptarë) ashtu dhe ato të transportit në rrugë detare me anë të trageteve, me automjete që vihen në

përdorim posaçërisht, apo, në disa raste kuptimplote që lidhen me grupet kriminale në Shqipëri, mjetet normale lundruese që përdoren për shkëmbimin tregtar midis Italisë dhe këtij rajoni.

Pra, rezultatet hetimore kanë vënë në pah faktin se në atë Shtet vepronë organizata të mëdha të cilat janë të lidhura me burimet e furnizimit me lëndë të parë apo më lëndë të gatshme për konsum, si dhe faktin se ato zotërojnë mjetet e nevojshme financiare, logjistike dhe materiale për të mundësuar vazhdimësinë e furnizimit të tregut italian, pavarësisht luftës që është zhvilluar ndaj tyre deri tani në Itali.

Duhet theksuar se organizatat shqiptare gëzojnë mbështetjen e ambienteve institucionale: çka është përfutur nga hetimet e shumta të cilat kanë vërtetuar marrëdhëniet e fshehta me përfaqësues të disa Institucioneve dhe Forcave të Policisë.

Ndër hetimet e kryera në harkun kohor korrik 2005 – qershor 2006, për nga rëndësia e tyre, vlen të përmendim.

- hetimin e quajtur *Spada*, ndaj përfaqësuesve të një organizate që merrej me importimin nga Shqipëria të sasive të konsiderueshme të lëndëve narkotike, i cili përfundoi me arrestimin e 12 personave, kryesisht me kombësi shqiptare si dhe me sekuestrimin e 33 kg heroinë dhe 1,2 kg kokainë;
- hetimi *Castrista* si rezultat i të cilit u arrit shpërbërja e një organizate kriminale multietnike e përbërë nga italianë, shqiptarë dhe amerikanojugorë, përgjegjës për trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike, të llojit kokainë dhe heroinë, të importuara përkatësisht nga Peruja dhe nga Shqipëria e që shpërndaheshin me pakicë në disa qytete të Molise-s dhe të Puljes, si dhe për favorizim të emigracionit klandestin dhe për shfrytëzim të prostitucionit dhe arrestimi i 15 personave në datën 16.06.2006 në zbatim të një vendimi për marrjen e masës së sigurisë me burg pa afat, i lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake i Campobasso-s, me kërkesë të D.D.A.;
- hetimi për trafik lëndësh narkotike ndaj eksponentëve të një grupi të përbërë nga shtetas shqiptarë dhe nga përfaqësues të një grupi kalabrez që vepron në Umbria;
- hetimi *Sabbia*, i cili bëri të mundur shpërbërjen e një organizate multietnike që vepron në qarkun *Marche (Marke)*, në fushën e trafikut të lëndëve narkotike, e drejtuar nga afrikano-veriorë dhe e përbërë edhe nga shtetas shqiptarë e maqedonas;
- hetimi *Dead Row* ndaj një organizate që vepron në fushën e trafikut të lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe heroinë, e përbërë nga shtetas

shqiptarë (10), afrikano-veriorë (15) dhe italianë (2), të gjithë të arrestuar në datën 01.02.2006 me vendim për masa shtrënguese të Autoritetit Gjyqësor bolonjz;

- hetimi i Autoritetit Gjyqësor torinez, i cili përfundoi me dhënien e masës së sigurisë me burg pa afat ndaj 34 personave, në pjesën dërrmuese shqiptarë, përfaqësues të një shoqate që vepronte në fushën e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike midis Italisë dhe Ballkanit, si dhe me sekuestrimin e 319 kg heroinë, 2 kg kokainë, të 3 automjeteve dhe 2 kamionëve.

- hetimi *Quo Vadis* i Autoritetit Gjyqësor piemontez, që përfundoi me arrestimin e 15 shtetasve shqiptarë, përgjegjës për trafik ndërkombëtar lëndësh narkotike dhe me sekuestrimin e 75 kg kokainë dhe 10 automjeteve;

- hetimi *Aquila* i korrikut 2005, ndaj eksponentëve të një organizatë kriminale, kryesisht italo-shqiptare, që vepronte në Sardenjë, në fushën e trafikut të kokainës me prejardhje nga Holanda, e cila pasi mbërrinte në Sardenjë nga porti i Olbia-s destinohej për tregun e Bregut të Gjëlber.

- trafiku i armëve dhe i mjeteve të tjera luftarake, me prejardhje nga Shqipëria dhe nga vendet e ish Jugosllavisë;

- vjedhja e automjeteve me cilindrat të madhe të kryera në Itali, për t'u transportuar më tej në Shqipëri dhe në vendet e Lindjes së Mesme.

Dhe pse ndodhemi përballë pranisë së grupeve që përdorin metoda mafioze (ashpërsia e rregullave të sjelljes, metodat e kërcënimit dhe të dënimit të bashkëpunëtorëve “heshtja e brendshme dhe e jashtme”), vetëm në disa procese gjyqësore ka qenë e mundur, sikurse për “format e reja” të mafies, t'u ngarkohej të pandehurve dhe akuza për kryerjen e krimit për sa në nenin 416 bis të K.P.

Gatishmëria me të cilën garantohet mbrojtja e bashkëpunëtorëve të arrestuar nga ana e atyre që arrijnë ti shpëtojnë arrestimit (që zakonisht strehohen në Shqipëri), shqetësimi që shfaqet për të siguruar heshtjen e viktimave të krimeve të kryera si dhe përpjekjet e menjëhershme për të korrupuar apo për të kushtëzuar magjistratët të cilët shqyrtojnë rastet në Shqipëri – rrethana këto që janë vërtetuar nga përgjimet telefonike të kryera e që përbëjnë të vetmin mjet efikas të luftës ndaj veprimtarisë së këtyre organizatave – mbështesin tezën se organizatat shqiptare që veprojnë në territorin italian mbartin në vetvete karakteristika mafioze.

Një nga fenomenet kriminale që rrit ndjeshëm alarmin shoqëror është ai i vjedhjeve të shumta të kryera nga persona që i përkasin etnisë shqiptare, në

banesat private, që në pjesën më të madhe janë vila të izoluara në pjesën veriore të Italisë, por dhe në rajone si Kampania, Sicili dhe Pulje. Jo rrallë herë autorët e këtyre vjedhjeve, gjatë kryerjes së veprave kriminale, nën efektin e dosave të mëdha të kokainës përdorin dhunën, qoftë dhe seksuale, ndaj viktimave. Nga disa hetime, të përfunduara me arrestimin e anëtarëve të këtyre grupeve kriminale të organizuara, është arritur të vërtetohet bashkëpunimi i disa personave të etnisë shqiptare me subjekte të tjera që i përkasin etnisë rumune dhe sllave.

Në lidhje me sa më sipër, vlen të përmendim hetimin e titulluar *Vesta*, në përfundim të të cilit, me vendimin për marrjen e masës së sigurisë me burg pa afat, u arrestuan 112 shtetas të huaj, pjesa më e madhe e tyre me origjinë shqiptare, rumune dhe sllave, si përgjegjës për dhjetëra vjedhje të kryera në vilat e izoluara në Veri. Në bazë të kontrolleve të kryera, u arrit të sekuestroheshin disa mijëra euro, bizhuteri, makina me cilindratë të madhe, sasi të konsiderueshme lëndësh narkotike (kokainë) si dhe një numër i madh armësh automatike.

Theksojmë gjithashtu se për sa i përket periudhës në shqyrtim, falë dhe bashkëpunimit me autoritetet shqiptare, në të gjithë territorin italian, në veçanti në Veri, është bërë i mundur arrestimi i disa personave në kërkim, si në Shqipëri ashtu dhe në Itali, të akuzuar për disa krime të rënda.

Përdorimi nga ana e eksponentëve të këtyre organizatave kriminale të dokumenteve të falsifikuara me qëllim shmangien e masave të dëbimit apo të jetesës në kushtet e klandestinitetit, e bën më të vështirë luftën ndaj tyre nga ana e Magjistraturës dhe e Forcave të Rendit.

Është vënë re dhe një rritje e veprimeve të dhunshme (vrasje apo tentativa vrasjeje) mes grupeve kriminale shqiptare ose midis këtyre të fundit dhe grupeve të etnive të tjera, kjo si rezultat i luftës për pushtet për kontrollin e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, të trafikut të qenieve njerëzore dhe të shfrytëzimit të prostitucionit. Në lidhje me sa më sipër, mund të shprehemi se strukturat kriminale shqiptare janë shndërruar tashmë në referentë të karteleve më të njohura të narko-trafikanëve amerikano-jugorë.

Duhet vënë gjithashtu në pah shtimi i numrit të grave që marrin pjesë në kryerjen e krimeve të ndryshme (trafik lëndësh narkotike, rrëmbime, shfrytëzim i prostitucionit, zhvatje, etj.), shpesh duke kryer dhe role parësore. Ndër hetimet e shumta vlen të përmendim atë të kryer nga Prokuroria e Triestes në përfundim të të cilit u arrit arrestimi, në datë 13.03.2006, i gjashtë personave, përgjegjës për trafik klandestinësh mes

Shqipërisë dhe Italisë së Veriut, trafik që realizohej nëpërmjet territorit të ish Jugosllavisë, Kroacisë dhe Sllovenisë. Në krye të organizatës, e përbërë nga italianë, shqiptarë, kosovarë, sllovenë e kroatë, ishte një grua shqiptare, banuese prej disa vitesh në Pordenone, e cila mbështetej dhe nga personi me të cilin bashkëjetonte, edhe ai shtetas shqiptar.

Për sa i përket pastrimit të parave dhe investimit të kapitaleve me prejardhje nga veprimtari të paligjshme, duhet vënë në dukje numri i madh i transaksioneve të kryera midis Italisë dhe Shqipërisë në harkun kohor prej janarit 1994 deri më sot, e që arrijnë shifrën e disa mijëra miliardë liretave.

Qarqet italiane më të prekura nga këto transaksione janë Torino, Milano, Varese, Bari dhe Romë.

Gjithnjë duke iu referuar këtyre hamendësimeve të mundshme të krimit dhe veprimtarive ekonomike të zhvilluara nga shtetas shqiptarë me banim në Itali, është vënë re se këtyre të fundit u është lëshuar një numër gjithmonë në rritje i kodeve fiskale dhe se disa shoqëri financiare të ngritura në Shqipëri administrohen bashkërisht nga shtetas shqiptarë dhe italianë.

Shtojmë gjithashtu se hetime të kryera këto kohët e fundit kanë vënë në pah faktin se organizatat kriminale shqiptare investojnë shuma të mëdha parash, të përfutuara nga veprimtari të paligjshme, jo vetëm në Shqipëri por dhe në Kosovë, për blerjen e pasurive të patundshme apo në veprimtari tregtare.

Por gjithsesi, vazhdojnë ende të ekzistojnë vështirësi operative për një bashkëpunim të frytshëm midis Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë dhe Prokurorive italiane, si për shkak të mungesës së strukturave, të mjeteve dhe profesionalizmit ende jo të lartë të magistratëve shqiptarë, ashtu dhe si pasojë e mungesës së mjeteve efikase dypalëshe të bashkëpunimit gjyqësor (një traktat ekstradimi, një marrëveshje për dorëzimin e përkohshëm me qëllim pjesëmarrjen në proces ose për pjesëmarrjen në proces, me anë të video konferencës, të shtetasit të dënuar e që s'mund të ekstradohet, një traktat për transferimin e çështjeve gjyqësore), të cilat në këtë fazë bashkëpunimi të organeve të drejtësisë shqiptare dhe atyre italiane janë bërë më se të domosdoshme.

Megjithatë është e udhës të theksojmë se pavarësisht vështirësive që hasen në këtë drejtim, bashkëpunimi gjithsesi ka shënuar rritje, duke arritur në nivele të kënaqshme.

Prej disa kohësh, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë është ngritur një zyrë e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila ka për detyrë tu sigurojë autoriteteve gjyqësore të huaja një ndihmesë efikase si dhe

shpejtësinë e nevojshme në shqyrtimin e letërporosive të dërguara nga këto të fundit. Është ngritur gjithashtu dhe një grup prokurorësh dhe oficerësh të Policisë Gjyqësore të specializuar në fushën e kriminalitetit të organizuar si dhe janë ndërmarrë nisma me synim krijimin e një banke të dhënash, sipas modelit që ekziston pranë Drejtorisë Kombëtare të Antimafies, për mbikëqyrjen e organizatave kriminale dhe për administrimin sa më të mirë të proceseve.

Duke iu referuar veprimtarisë së Drejtorisë Kombëtare të Antimafies, theksi duhet vënë tek marrëdhëniet e krijuara me Prokurorinë e Përgjithshme shqiptare si dhe tek firmosja në datën 28.10.1997 i një Protokollit midis P.N.A. dhe Prokurorisë së Përgjithshme me synim shkëmbimin e shpejtë të informacioneve dhe të dhënave që lidhen me kriminalitetin e organizuar të llojit mafioz.

§ 3. *Kriminaliteti rumun.*

Grupet kriminale rumune, me një shtrirje të vazhdueshme, në këto vitet e fundit janë organizuar në struktura më të përshtatshme, kjo si pasojë e bashkëpunimit me grupet kriminale shqiptare dhe ukrainase në trafikimin e qenieve njerëzore, në emigracionin klandestin dhe në shfrytëzimin e prostitucionit, kryesisht në zonat e Italisë së Veriut.

Në kryerjen e këtyre veprimtarive të paligjshme, kriminaliteti rumun përdor metoda thellësisht të dhunshme, duke përdorur mjete të dhunës fizike apo psikologjike ndaj grave të reja të shfrytëzuara, që shpesh herë ndodhen në kushtet e skllavërisë, e në disa raste u shiten grupeve të etnive⁴ të tjera.

Në periudhën midis tetorit 2005 – qershorit 2006, si pasojë e aksioneve të policisë janë arrestuar dhjetëra shtetas rumunë përgjegjës për krimet e renditura më sipër.

Shtetasit rumunë të arrestuar gjatë periudhës që merr në shqyrtim ky raport, arrijnë shifrën e 547 personave.

Grupet kriminale rumune kryejnë dhe akte rrëmbimi. Përmendim kështu vrasjen me synim rrëmbimin, të kryer në datën 26.05.2006 ndaj pronarit të një dyqani bizhuterish, që ndodhet në qarkun e Romës, vepër kjo e kryer

⁴ *Tregtia e njerëzve shpesh herë kryhet në mënyrë të dukshme, sikurse është e vërtetë se organizatat vendase që veprojnë në Rumani, për transportimin e klandestinëve në Itali midis Kroacisë dhe Sllovenisë, botojnë dhe oferta transferimi të paligjshëm në reklamën e gazetave apo shkruajnë nëpër muret e qytetit fjali të tilla si “Shpie njerëz në Itali, ofrohet shoqërimi për në Itali, seriozitet maksimal dhe përvojë për transferimin në Itali”.*

nga dy shtetas rumunë, të cilët u identifikuan menjëherë nga Karabinierët të cilët u kapën në Vjenë dhe në një qytet të Rumanisë.

Grupet kriminale rumune janë të specializuara në sektorin e krijimit, falsifikimit dhe përdorimit të mjeteve elektronike të pagesave (kartat e kreditit). Disa prej anëtarëve të këtyre grupeve merren vetëm me gjetjen e grupeve magnetike dhe kodeve PIN të këtyre mjeteve të pagesave, të tjerë me riprodhimin e kartave magnetike, dhe të tjerë më pas me blerjen e të mirave materiale apo me tërheqjen e të hollave pranë sporteveve automatike e më tej ma pastrimin e parave të përfutuara në mënyrë të paligjshme. Ndër hetimet e kryera deri tani mund të përmendim hetimin me emrin e koduar *Clone*, ndaj një organizate kriminale transnacionale falë të cilit, gjatë periudhës korrik 2005 – pranverë 2006 u bë i mundur arrestimi i 21 shtetasve rumunë, 9 prej të cilëve ndodheshin në territorin italian dhe 12 të tjerët në Shtete të ndryshme evropiane; hetimin *Nasolie*, i cili përfundoi në maj të 2006, me dhënien e 14 masave shtrënguese nga ana e Autoritetit Gjyqësor të Rexhio Emilias (*Reggio Emilia*) si dhe hetimin *Carta Bianca*, i cili çoi në arrestimin e 13 personave, anëtarë të një organizate italo-rumune, për bashkëpunim në krim me synim krijimin dhe përdorimin e paligjshëm të kartave të kreditit.

Nga hetimet e kryera këto kohët e fundit është vënë re një interesim në rritje i kriminalitetit rumun për kontrabandën e cigareve. Ndaj këtij krimi janë kryer, nga ana e forcave të Karabinierëve, një sërë arrestimesh në Romë dhe në Kampania. Në veçanti, nga hetimet e kryera ndaj një organizate transnacionale me qëllim trafikun e t.l.e., u arrit arrestimi i 4 shtetasve rumunë dhe 5 shtetasve italianë, ndër këta të fundit një subjekt që konsiderohej si përfaqësues i rëndësishëm i klanit *Pianese*, që vepron në Qualiano (NA) si dhe sekuestrimi i 20 kuintalëve duhan me një vlerë prej 350.000 euro.

§ 4. Kriminaliteti bullgar.

Organizatrat kriminale bullgare veprojnë në fushën e trafikut të qenieve njerëzore, favorizimit të emigracionit klandestin, vënies në kushtet e skllavërisë dhe shfrytëzimit të prostitucionit ndër femrat e moshave të reja. Në lidhje me sa më sipër, përmendim hetimin e kryer nga D.D.A e Trieste-s Elvis – Bulgaria (janë 116 personat nën hetim), në përfundim të të cilit u arrit të jepej, nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake, masa e sigurisë me burg pa afat ndaj 41 shtetasve bullgarë (disa arrestime u kryen në Bullgari dhe në Gjermani), për bashkëpunim në krim me synim emigracionin klandestin,

trafikun e femrave dhe të fëmijëve të futur në territorin italian nëpërmjet kalimit të kufijve tokësorë verilindorë me Austrinë dhe Slloveninë, vënien në kushtet e skllavërisë, trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike (kokainë, me prejardhje nga Amerika e Jugut, e cila magazinohet në portet e Detit të Zi), të monedhave të falsifikuara (euro dhe dollarë amerikanë) si dhe për vjedhje të shumta e krime të tjera (kontrabanda e cigareve, mashtrimi me anë të pagesës në mënyrë elektronike dhe pastrim parash).

Ekzekutimi i masave të arrestit, kontrollit dhe sekuestrimit në Bullgari u bë i mundur dhe falë memorandumit të nënshkruar në Romë në 17.06.2005, mes Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës Bullgare dhe Drejtorisë Kombëtare të Antimafias, me objekt shkëmbimin e ndërsjellë e të shpejtë së të dhënave dhe informacioneve midis dy vendeve, me synim luftën ndaj kriminalitetit të organizuar dhe pastrimit të parave të përftuara nga krimi.

Ndër veprimtaritë e paligjshme të kryera në Itali dhe në Vende të tjera të Bashkimit Evropian, përmendim vjedhjet që kryejnë me mjaft mjeshtëri, ditë për ditë, përgjatë gjithë kohës dhe me një lëvizshmëri të admirueshme në të gjithë territorin, femrat nomade, shpeshherë të mitura e që s'mund të ndëshkohen, të etnisë Sinta (një nga dialektet bullgare).

Të miturit rekrutohen ndër familjet më të varfra të zonës veri-qendrore të Bullgarisë. Ata jepen me qira nga prindërit e tyre për një periudhë të caktuar kohore dhe përkundrejt një shpërblimi, tek eksponentë të organizatave kriminale të cilët i përdorin më pas për kryerjen e vjedhjeve të çantave, apo për të kërkuar lëmshë.

Duhet theksuar se hetimet e ndërmarra ndaj këtyre organizatave janë mjaft të vështira për tu realizuar, si për shkak të maskimit të apartamenteve që zotërojnë pasi, zakonisht, përdorin dokumente të rreme çka pengon identifikimin e tyre, ashtu dhe për shkak të lëvizshmërisë së jashtëzakonshme në të gjithë territorin apo gjetjes së përkthyesve të besueshëm, të aftë të përkthejnë dialektet e pakuptueshme për llogari të Forcave të Rendit të cilat merren me kryerjen e përgjimeve telefonike.

Grupet kriminale bullgare veprojnë dhe në fushën e trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Këtë na e dëshmon hetimi i koduar *Magna Charta*, i ndërmarrë ndaj një grupi transnacional i përbërë kryesisht nga persona të etnisë bullgare e që, në bashkëpunim me përfaqësues të "ndrangheta" kalabreze, vepronte në qarkun e Torinos, si dhe në atë të Lombardisë dhe Venetos. Nga hetimet u vërejt ekzistenca e një grupi bullgar aktiv në disa vende evropiane që merrej me importimin në Itali të sasive të konsiderueshme të kokainës e cila magazinohet në Karaibe e më pas, me

anë të korrierëve ovulatorë dhe dërgesave portuale, kalonte tranzit nga Spanja.

Ndërsa në lidhje me trafikun e armëve, vlen të përmendim hetimin e koduar *Sofia*, ndaj një organizate me përkatësi bullgare, me qëllim importimin nga Italia të armëve. Gjatë fazës së hetimeve u bë i mundur arrestimi i 2 shtetasve bullgarë dhe u sekuestruan 42 pistoleta jo konvencionale, të kal. 6,35 me municionet e tyre përkatëse.

Në periudhën 01.07.2005 – 30.06.2006 janë arrestuar gjithsej, për krime të ndryshme, 59 shtetas bullgarë.

§ 5. *Kriminaliteti afrikano-verior, në veçanti ai nigerian dhe magrebin.*

Pjesa më e madhe e shtetasve afrikanë e pranishme në disa qytete italiane, përbëhet kryesisht nga klandestinë me prejardhje nga Vende të Afrikës së Veriut dhe karakterizohet nga një varfëri e tejskajshme. Fillimisht, shumë prej klandestineve zëvendësuan, sidomos në zonat jugore të Italisë, krahun e punës vendas (puna për mbledhjen e domateve apo të produkteve të tjera bujqësore, etj.), përkundrajt një shpërblimi mjaft të ulët krahasuar me atë që përftonin këta të fundit.

Pjesa më e madhe e klandestineve merret me shitjen e veshjeve të falsifikuara, të prodhuara nga organizatat kriminale, me vjedhje, rrëmbime dhe shpërndarje me pakicë të lëndëve narkotike. Si rrjedhojë e trafikimit të lëndëve narkotike, ata vihen në kontakt, me synim sigurimin e furnizimeve, me grupe të lidhura me organizatat kriminale të tipit mafioz.

Por shfrytëzimi i bashkëkombësve me qëllime prostitucioni përbën dukurinë më shqetësuese, çka lidhet ngushtë dhe me problemet me karakter sanitar.

Në disa qytete dhe arterie kombëtare vërehet një prani e madhe e grave me ngjyrë, kryesisht nigeriane, të cilat me të mbërritur në Itali në bazë të premtimeve për punë, duke mos qenë në gjendje të paguajnë çmimin e hyrjes klandestine, i parapaguar nga organizata të mirëfillta mafioze që veprojnë në vendet e tyre të origjinës, detyrohen me anë të kërcënimit, e shpesh herë dhe me anë të dhunës, të prostituojnë.

Pjesa më e madhe e vajzave të “trafikuar” është me prejardhje nga zonat e Jugut të Nigerisë, sidomos nga qytetet e Benin City, Lagos, apo nga qytete të tjera në brendësi të territorit vendas dhe i përkasin fiseve Igbo, Yoruba, Bini, Edo.

Të gjitha janë gra të reja apo shumë të reja, me një moshë mesatare nga 17 deri në 30 vjeç; disa prej tyre janë të martuara e me fëmijë, shpesh herë të braktisura nga bashkëshortët. Shumë prej tyre kanë qenë studente apo në marrëdhënie pune dhe kanë përjetuar një periudhë periferie (kryesisht në Benin City dhe Lagos).

Grupet kriminale nigeriane që veprojnë në Itali karakterizohen nga copëzime etniko-fisnore të cilat i bashkëngjiten strukturave të shumta kriminale, që përbëhen nga disa familje të pakta në numër, qendra e të cilave ndodhet në Nigeri.

Fenomeni i kriminalitetit të organizuar nigerian ka shënuar rritje të vazhdueshme në të gjithë territorin italian. Ai është i përqëndruar në disa qytete si në Romë, Torino, Padova, Bresha, Milano, Rimini, Palermo dhe Kaliari. Në këto qytete, shtetas nigerianë kanë hapur restorante, kanë krijuar shoqëri import – eksporti, markete, disko klube, qendra bukurie.

Sikurse thamë, dukuria e shfrytëzimit të prostitucionit, që lidhet me atë të emigracionit klandestin nigerian përbën tashmë një fakt mjaft shqetësues. Kjo, sidomos në zonat jugore, kryesisht në Kazerta (Caserta), ku ekzistojnë koloni prostitutash të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre çdo ditë, përgjatë gjithë harkut kohor të ditës. Ato dhe shfrytëzuesit e tyre tolerohen nga kriminaliteti i organizuar kazertan, dhe pse kjo e fundit nuk ka treguar asnjëherë kurrfarë interesi për kontrollin e prostitucionit.

Kjo tolerancë shpjegohet me faktin se: prostitutat dhe tutorët e tyre shpesh herë janë “roje të kamorrës” në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe se këta shfrytëzues janë të detyruar të paguajnë një lloj “qiraje” për territoret që i përkasin grupeve të veçanta të kriminalitetit vendas.

Nëpër rrugët që përbëjnë udhën e gjatë domiciane e cila përshkon vijën bregdetare të disa qyteteve të qarkut të Caserta-s (Castelvoturno, Mondragone, Baia Domitia, etj.), të cilat duhet të ishin qytete bregdetare të ngjashme me “Riminin e Jugut”) gjejmë vazhdimisht gra me ngjyrë të cilat qëndrojnë në pritje të klientëve dhe të meshkujve po me ngjyrë të cilët, si gjatë ditës ashtu dhe gjatë natës shpërndajnë, me pakicë, e haptazi, lëndë narkotike të të gjitha llojeve (heroinë, kokainë, etj).

Ndër të tjera, udha domiciane shpesh herë është shndërruar në një teatër të larjeve të hesapeve për sundimin e territorit mes njerëzve të “mafies” nigeriane dhe asaj shqiptare, ku dhe kjo e fundit vepron në fushën e trafikëve të paligjshme.

Sikurse theksuam, vajzat nigeriane të shfrytëzuara i nënshtrohen formave të skllavërisë, kjo falë bestytnive apo besimeve të ndryshme fetare

që ekzistojnë në vendet e tyre të origjinës. Në të vërtetë e ashtuquajtura mafie nigeriane ia “beson” këto vajza, grave me prejardhje po nigeriane të quajtura “madame” të cilat bëjnë të mundur që ato tu nënshtrohen, më synim detyrimin për tu shitur, riteve të tmerrshme magjistare ‘woodoo’ (shprehur: “juju”).

Po kaq shqetësues është dhe fenomeni i trafikut të lëndëve narkotike. Duhet nënvizuar se, në këto vitet e fundit, Nigeria është afirmuar si vendi me një numër të madh organizatash narkotrafikante: dhe pse nuk është prodhuese droge, Vendi shquhet për një trafik të gjerë, i prirur më shumë drejt ri-eksportimit se sa drejt tregut të brendshëm, duke u shndërruar kështu në një nga udhëkryqet më kryesore të drogës në Afrikë si dhe në një vend ideal për magazinimin e sasive të mëdha të lëndëve narkotike.

“Zotërinjtë” nigerianë të drogës në të vërtetë mund të përdorin dy kushte mjedisore mjaft të favorshme:

- krahun e ri të punës i shumtë në numër, shturja e të cilit dëshmon për humbjen dhe shpërbërjen e vlerave shoqërore si rrjedhojë e një qeverisjeje disa vjeçare të paaftë, çka ka bërë që në mjaft etni të konsolidohet bindja se ligjet dhe rregullat përbëjnë një pengesë për suksesin individual, ndaj shoqëria nigeriane i pranon dhe i adhuron të pasurit, pavarësisht mënyrës së përfimit të pasurisë nga ana e tyre (si për shembull dhe në dëm të një të huaji), me kusht që pasuria tu shpërndahet të afërmve dhe njerëzve në nevojë;

- shturja dhe korrupsioni i sistemit politik e shoqëror, i cili nuk është në gjendje të zotërojë mjetet efikase të luftës – më se kuptimplotë në këtë drejtim është pozicioni i paqartë i autoriteteve që prej vitesh luftojnë ndaj trafikut të lëndëve narkotike, pozicion ky që luhet midis vullnetit ndëshkues bazuar në modelet perëndimore dhe një tolerance të hapur ndaj këtij trafiku të paligjshëm.

Në këtë kontekst, është rritur ndjeshëm tranzitimi i lëndëve narkotike që vijnë nga Brazili, nga Kolumbia, nga Pakistani apo nga Tailanda, me destinacion Evropën dhe Shtetet e Bashkuara.

Nigeria zë vendin e tretë në botë për numrin e shtetasve të saj të arrestuar jashtë vendit, Trafikantët nigerianë (sikurse ata amerikano-jugorë, libanezë dhe izraelitë), kanë shfrytëzuar dhe rrjetet ekzistuese të kontrabandës së armëve, të fildishit dhe të gurëve të çmuar. Nga të dhënat e fundit rezulton se në Nigeri veprojnë rreth 400 qendra të krimit, 136 prej të cilave janë të specializuara në trafikun e drogës, dhe gjysma e tyre me shtrirje ndërkombëtare.

Në vendin tonë, subjektet me prejardhje nga kjo zonë gjeografike duket se po zënë një rëndësi gjithnjë e më të madhe, kjo nën dritën dhe të ndryshimeve të mëdha në vendet e origjinës, si dhe të nivelit të lartë të rritjes demografike që i karakterizon. Bëhet fjalë për subjekte pothuaj tërësisht me prejardhje nga zonat më të shtypura të Nigerisë (ku shpesh herë mbizotërojnë marrëdhënie shoqërore para-kapitaliste, me një kulturë të tipit rural) të cilët më të mbërritur në Itali duhet të përballen me:

- përfshirjen, sikurse thamë, në sektorin më pak të dëshiruar e më pak të siguruar të tregut të punës, duke qenë se janë pa dokumente të rregullta qëndrimi, e për pasojë mund të bien pre e kërcënimeve apo shantazheve.

- vështirësitë e përshtatjes me kushtet e reja, thellësisht të ndryshme, të shoqërisë urbane – industriale.

Këto mangësi shpesh herë shpjen në lënien pas dore të nigerianëve, duke favorizuar, gjithnjë e më shumë, prirjen për tu organizuar e për tu vendosur në komunitete të pavarura, që gjithsesi edhe brenda tyre paraqesin konflikte të mëdha fisnore. Në të gjithë gadishullin një vend të rëndësishëm zë dhe fenomeni i shoqatave të ndihmës së ndërsjellë të cilat shpesh herë fshehin, sikurse do të shohim më tej, qëllime aspak të pastra.

Pjesa qendrore dhe jugore e gadishullit, me përjashtim të Lacios dhe Kampanias, duket se paraqesin më tepër interes për vendosjen dhe përqendrimin e emigrantëve nigerianë. Ndërsa prania e tyre në ishuj është pothuaj e papërfillshme. Të dhënat vërtetojnë prirjen e pothuaj të gjitha etnive, drejt zonave më tërheqëse për ta, sikurse zonat ku zhvillimi industrial është më i përparuar.

Trafikantët nigerianë shquhen për aftësitë e tyre në gjetjen e tregjeve më fitimprurëse si dhe në shfrytëzimin e mundësive: kjo aftësi është rrjedhojë e një strukture kriminale të organizuar më së miri, e aftë të përthithë në kohë reale çdo informacion mbi luhatjen e tregjeve të drogës. Takimet e herë pas hershme – duke shfrytëzuar dhe rastet e krijuara nga mbledhjet ndërkombëtare që realizohen nga shoqata të ndryshme kulturore apo të ndihmës së ndërsjellë nigeriane – për shkëmbimin e të dhënave, luajnë një rol vendimtar për vetë grupet, anëtarët e të cilëve shpesh herë lidhen mes tyre nga lidhje fisnore apo të klaneve, çka e vështirëson mjaft veprimtarinë e mundshme të infiltrimit.

Grupet kriminale të përmendura më sipër kanë një strukturë vertikale, në të cilën dallohet figura e një apo dy kryetarëve domosdoshmërisht nigerianë, të cilët mund të mos kenë asnjë kontakt me bazën e cila përbëhet nga

korrierët, por drejtojnë në nivel ndërkombëtar marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme.

Meqenëse nuk janë dhe aq të lidhura me territorin, në rast të kërcënimit nga forcat e policisë, këto grupe kriminale janë në gjendje të zhvendosen me mjaft lehtësi në zona të tjera pa u shkaktuar dëme të konsiderueshme trafikeve të tyre të paligjshme, dhe në përgjithësi arrijnë të bashkëjetojnë me realitete të tjera kriminale, qofshin këto vendase apo ekstrakomunitare, duke shmangur kështu dhunën e panevojshme, çka bën që në dukje të shfaqen si organizata kriminale jo të nivelit të lartë, por që nga ana tjetër arrijnë të realizojnë me efikasitet veprimtari të paligjshme prej të cilave përfitojnë miliarda.

Në bazë të hetimeve të kryera nga Forcat e Policisë, nigerianët trafikojnë të gjitha llojet e drogave, nga kokaina deri tek heroina, nga kanabis deri tek drogat sintetike, dhe pse tre të parat janë më të preferuarat si për nga përfitimet e mëdha që sjellin ashtu dhe për nga lehtësia në sigurimin e tyre: heroina blihet drejtpërdrejt e në sasi të mëdha në tregjet aziatike, e pas magazinimit në Nigeri, transportohet, në rrugë detare apo ajrore, drejt vendeve konsumatorë, duke përdorur linjat drejt Italisë, Greqisë dhe Spanjës. Blerja drejtohet nga shtetas nigerianë banues në vendet që renditëm më lart, të cilat përbëjnë ndalesën përfundimtare të organizatave, “koka” e të cilave ndodhet gjithmonë në vendet e origjinës. Kokaina importohet gjithnjë nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me prodhuesit në Amerikën e Jugut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë dhe me të njëjtat mënyra që renditëm më lart. Lidhjet sigurohen nga subjekte përfaqësues të një komuniteti të madh nigerian të cilët kanë qëndrim të përhershëm e të rregullt në Amerikën e Jugut.

Të gjithë korrierët janë të pajisur me leje qëndrimi të rregullta, e zakonisht të padënuar më parë. Pas një numri të caktuar udhëtimesh, “digjen”, pra nuk përdoren më. Në këtë mënyrë ata mbajnë lidhje vetëm me atë që i urdhëron të kryejnë udhëtimin si dhe me subjektin pritës në vendin e destinacionit, e për pasojë nuk janë në gjendje të zbulojnë asgjë për organizatën; disa herë shpërfillin dhe praninë e një bashkëpunimi kriminal mbi supet e tyre. Me këtë lloj ndarje organizata synon të sigurojë mbijetesën e vet ndaj hetimeve të mundshme që mund të kryhen kundrejt anëtarëve të saj.

Korrierëve nuk u jepet mundësia të zgjedhin drejtimin që duhet të ndjekin, drejtim ky që u jepet nga një anëtar i organizatës, e cila vendos për zhvendosjet e herë pas hershme që duhen kryer, për ndryshimet e papritura të programit të udhëtimit qoftë dhe “i copëzuar”, si dhe ndalesat

aeroportuale qe duhet të përdoren. E gjitha kjo për të humbur gjurmët duke i çuar në drejtimin e gabuar: për të bërë të mundur një gjë të tillë, ndër të tjera organizata prenoton dhe paguan biletat e avionit të cilin korrieri nuk do ta përdorë kurrë, pasi shpesh herë marrin drejtimin e linjave hekurudhore.

Çdo udhëtim i siguron korrierit një të ardhur prej rreth 3.000 euro, i cili, brenda një periudhe të shkurtër kohore, kryen udhëtime të shumta, pasi organizatat kriminale parapëlqejnë furnizimet e shpeshta e në sasi të vogla (deri në 1 kilogram e ca për çdo korrier) se sa ato në sasi të mëdha e në mënyrë periodike.

Lehtësia e madhe me të cilën Forcat e Policisë shquajnë korrierët me kombësi afrikane në stacionet aeroportuale evropiane dhe ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i ka shtyrë organizatat kriminale nigeriane të përdorin, gjithnjë e më shumë, korrierë të kombësive të tjera: është vënë re se parapëlqehen të përdoren persona të seksit femëror, me prejardhje nga Evropa apo nga Amerika e Jugut, e në veçanti nga Brazili. Kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë më korrierët nigerianë, apo afrikanë, por thjesht që grupet kriminale janë organizuar për të shmangur mundësinë e zbulimit. Ndonjëherë ndodh që bashkë me korrierët e kombësive të tjera të udhëtojnë dhe korrierët nigerianë, të cilët me sjelljet e tyre thellësisht të acaruar, arrijnë të tërheqin vëmendjen e forcave të policisë, duke iu nënshtuar kështu kontrolleve të rastit, duke bërë të mundur nga ana tjetër që korrierët e vërtetë të kalojnë lehtësisht. Në fakt, këto subjekte luajnë rolin e “kontrollorëve” të mbarëvajtjes së operacionit, duke iu përcjellë kështu anëtarëve të tjerë të dhënat mbi çdo lloj pengese që mund të haset gjatë transportimit të lëndëve narkotike, duke i njoftuar menjëherë për arrestimin apo ndalimin e korrierit nga ana e policisë.

Kryerja e pagesave të drogës bëhet ose nëpërmjet dërgesave të kryera pranë agjencive të ndryshme të *Money Transfer* drejtpërdrejt nga trafikanti, ose, duke përdorur persona të cilët u drejtohen këtyre agjencive për të kryer pagesën në favor të furnitorit, banues në një tjetër Shtet, apo në qytete të tjera të gadishullit tonë.

Përdorimi i *money transfer* përbën mjetin kryesor të ri-investimit të parave që rrjedhin nga kryerja e veprimtarive të paligjshme: në fakt ky sistem përdoret si për të paguar furnizimet e kryera nga korrierët, apo për shpenzimet që lidhen me trafikun e lëndëve narkotike (pagesa e biletave të udhëtimit, qëndrimi në hotele, etj.), ashtu dhe për shfrytëzimin e prostitucionit dhe të krimeve të tjera që lidhen me të, dhe dërgimit në Nigeri të shumave të parave të përfutuara nga trafiket e paligjshme.

Një tjetër mënyrë, disi më e tërhequr në krahasim me atë që përmendëm më lart, përbëhet nga pagesa jashtë me jashtë, drejtpërdrejt në favor të majës së organizatës në Nigeri.

Gjithashtu përdoret shpesh dhe dërgesa e parave drejtpërdrejt nëpërmjet korrierit.

Nuk ekziston asnjë bashkëpunim konkret me autoritetet nigeriane. Vetëm kohët e fundit janë ndërmarrë disa nisma në këtë drejtim, si të domosdoshme për luftën ndaj kësaj forme të rrezikshme të kriminalitetit.

Megjithatë, Drejtoria Kombëtare e Antimafias në datën 11.11.2003 ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Prokurorinë e Përgjithshme të Nigerisë, me synim shkëmbimin e shpejtë e të ndërsjellë të informacioneve dhe të të dhënave që lidhen me kriminalitetin e organizuar.

Ndër hetimet më të rëndësishme të kryera gjatë periudhës së marrë në shqyrtim nga ky raport, vlen të përmendim:

- hetimi *Fantasia 2*, ndaj 80 personave nën hetim që i përkisnin një organizate kriminale kryesisht të etnisë nigeriane (por dhe algjeriane), që vepronte në qarkun e Kazertas (Caserta), me degëzime në provinca të tjera në Italinë qendrore dhe veriore (Romë, Firenze, Peruxhia, Bolonjë dhe Bresha), në fushën e trafikut të lëndëve narkotike (kokainë dhe heroinë) si dhe të trafikut të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual të vajzave të reja.

- hetimi *Niger*, e kryer nga D.D.A. e Torino-s ndaj një organizate kriminale që vepronte në kryeqendrën piemonteze, në Romë si dhe në qarqe të tjera të Italisë qendrore dhe veriore, në fushën e trafikut të lëndëve narkotike, të favorizimit të emigracionit klandestin dhe në atë të shfrytëzimit të prostitucionit. Gjatë hetimeve, u vunë re konflikte, dhe të ashpra, midis dy grupeve kriminale nigeriane, mes *Eye* (shoqatë për magjinë dhe fenë) dhe *Black Axe*, për kontrollin e veprimtarive të paligjshme.

- hetimi *Itako*, i kryer nga D.D.A. e Napoli-t e cila përfundoi me ekzekutimin, në shkurt 2006, të masës së sigurisë me burg pa afat, ndaj 3 nigerianëve dhe një napolitani anëtar i klanit Di Lauro, si përgjegjës për trafikun ndërkombëtar të heroinës së importuar nga Britania e Madhe.

- hetimi *Aye Mi Assman*, i cili përfundoi në prill 2006, me dy urdhra për burgim pa afat, të lëshuara nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake i Ferrarës ndaj 2 organizatave nigeriane që bashkëpunonin mes tyre të cilat merreshin me shpërndarjen e lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe marjuhanë në

provincën emiliane. Gjatë hetimeve u krye arrestimi i 32 shtetasve nigerianë;

- hetimi *Little Cut 2* i D.D.A. së Romës që përfundoi në prill 2006 me ekzekutimin e një vendimi për masën e sigurisë me burg pa afat ndaj 14 personave, nigerianë dhe italianë, për bashkëpunim në krim me synim trafikun e kokainës që vinte nga Spanja dhe nga Holanda nëpërmjet korrierëve ovulatori;

- hetimi *Area Franca*, i Autoritetit Gjyqësor të Santa Maria Capua Vetere (CE), ndaj 16 personave të konsideruar si përgjegjës të trafikut dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike. Nga hetimet u vërtetua se disa grupe vendase kazertane e blinin drogën nga një organizatë nigeriane, e cila vepronte në provincën e Kazertas;

- hetimi *Multilevel 2*, i cili përfundoi në maj 2006 me ekzekutimin e një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat i lëshuar nga Gjyqtari për hetimet Paraprake të Modena-s ndaj 9 personave me etni nigeriane, të konsideruar si përgjegjës për vënien në kushtet e skllavërisë me synim shfrytëzimin e prostitucionit të vajzave të reja afrikano-veriore të blera në Vendet e tyre të origjinës të cilat, me anë të dhunës, detyrohen të prostitudojnë për t'i paguar kështu *madem-ës* borxhin e udhëtimit, i cili luhatej nga 80 mijë deri në 100 mijë euro.

Janë 391 shtetasit nigerianë të arrestuar gjatë periudhës 01.07.2005 – 30.06.2006.

Në Itali veprojnë dhe organizatat kriminale me origjinë magrebine, të cilat merren me trafikun e lëndëve narkotike, me favorizimin e emigracionit klandestin dhe trafikun e qenieve njerëzore, me synim shfrytëzimin e prostitucionit dhe falsifikimit të dokumenteve të identitetit. Këto organizata përbëhen nga shtetas me prejardhje nga Maroku, Tunizia, Algjeria, Libia dhe nga Mauritania, të cilët veprojnë në grupe të vogla, kryesisht në kryeqendrat e provincave të Italisë qendrore dhe veriore.

Ndër hetimet më kryesore të kryera ndaj kriminalitetit të organizuar magrebin përmendim:

- hetimi *Adib*, i DDA së Katanaxaros i cili përfundoi në shkurt 2006 me arrestimin e 30 personave nga Eritrea, Sudani, Egjipti, Maroku, Algjeria dhe të 2 grave bullgare, të konsideruar si pjesëtarë të një organizate e cila vepronte kryesisht në Krotonë e që merrej me trafikun e emigracionit klandestin, sidomos nga Libia, nëpërmjet zbarkimit të mijëra njerëzve në brigjet siciliane (Agrigento, Lampedusa, Pozzallo (RG), etj);

- hetimi *Addhib*, ndaj një organizate kriminale magrebine e cila vepronte në provincën e Barit dhe merrej me falsifikimin e dokumenteve dhe me favorizimin e emigracionit klandestin; hetimi *Black Jeans*, i cili përfundoi në shkurt 2006, me ekzekutimin e urdhrin për masën e sigurisë me burg pa afat i lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake i Lucca-s ndaj 30 personave (kryesisht marokenë, por dhe tunizinë dhe italianë), të cilët bënë pjesë në një organizatë që vepronte në Viarexhio (Viareggio) në trafikun e kokainës dhe të hashashit, të lëndëve narkotike të cilat shpërndareshin në lokalet e natës të rivierës versiljeze si dhe në provincat e Livorno-s, Massa Carrara-s dhe Padova-s.

- hetimi *Tunisi 3*, i cili përfundoi në mars 2006 me ekzekutimin e një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake të Ankonës, ndaj 8 personave të konsideruar si përgjegjës të një shoqate kriminale tunizine me synim trafikun e heroinës dhe të kokainës në disa qytete të provincës së Ankonës.

- hetimi *Contrition*, i cili përfundoi në prill 2006 me ekzekutimin e një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake ndaj 19 personave, kryesisht të etnisë magrebine, pjesëtarë të një organizate, me degëzime në Emilja-Romanja, Lombardi dhe Toskanë, që merrej me trafikun e lëndëve narkotike (hashash dhe kokainë), të importuara nga Maroku dhe nga Spanja.

- hetimi *New Kebab*, i DDA së Firences, i cili përfundoi në qershor 2006 me arrestimin e më se 40 personave pjesëtarë të 2 organizatave magrebine, të lidhura mes tyre për trafikimin dhe shpërndarjen e hashashit dhe kokainës në Toskanë, Emilja Romanja, Lombardi, Piemonte dhe Lacio. Nga hetimet u bë e mundur të zbuloheshin lidhja mes kësaj organizate dhe një grupi kriminal shqiptar që herë pas here kryente furnizimet me lëndë narkotike. Si rezultat i hetimeve u arrit të sekuestroheshin 1.300 kg hashash, 6 kg kokainë dhe disa automjete që përdorreshin për transportimin e drogës dhe të 150.000 eurove;

Janë 3.675 shtetasit magrebinë të arrestuar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim në këtë raport.

§ 6. Kriminaliteti amerikano-jugor, në veçanti ai kolumbian.

Kriminaliteti amerikano-jugor është i pranishëm në Itali me trafikun ndërkombëtar të kokainës e, në një masë më të vogël, me emigracionin klandestin dhe me shfrytëzimin e prostitucioni të ushtruar në brendësi të banesave private dhe në lokalet e natës të drejtuara nga italianë. Këto veçori janë vënë në pah nga hetimi i cili përfundoi në prill 2006 me ekzekutimin e

një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat ndaj 9 personave, 5 prej të cilëve uruguajanë, të hetuar për bashkëpunim në krim me synim favorizimin e emigracionit klandestin dhe shfrytëzimin e prostitucionit të vajzave të rekrutuara në zonat më të varfra të Uruguait, të cilat veprimtarinë e prostitucionit e ushtronin në katër apartamente dhe në një Hotel, të ndodhura në Milano dhe në Komo, që iu nënshtruan sekuestrimit nga Autoriteti Gjyqësor.

Një tjetër hetim i titulluar *Montevideo*, është kryer nga Prokuroria e Republikës pranë Gjykatës së Teramos. Ky hetim u mbyll me arrestimin, si pasojë e ekzekutimit të një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat i lëshuar nga Gjyqtari për Hetimet Paraprake, e 23 personave, 17 prej të cilëve uruguaijanë, të konsideruar si përgjegjës për bashkëpunimin në krim, favorizim të emigracionit klandestin dhe detyrim dhe shfrytëzim të prostitucionit. Gjatë hetimeve u vërtetua se organizata italo-uruguajane, kishte rekrutuar në Uruguaj, në baze të mashtrimit për punë, të 50 vajzave të cilat, të pajisura me dokumente të rreme, kishin mbërritur në Spanjë, e më pas në Itali, vende në të cilat kishin ushtruar prostitucionin.

Një tjetër hetim i titulluar *Trans-Colombia*, i cili nisi në tetor 2005 nga Autoriteti Gjyqësor roman, ndaj një organizate italo-kolumbiane që merrej me emigracionin klandestin, vënien në kushtet e skllavërisë, shfrytëzimin e prostitucionit dhe shpërndarjes së kokainës, coi në arrestimin e 7 shtetasve kolumbianë dhe 4 shtetasve italianë. Hetimi vuri në pah veprimtarinë e prostitucionit të 30 transeksualëve me prejardhje nga Kolumbia, nga Ekuadori dhe nga Spanja, të cilët e ushtronin këtë aktivitet në apartamente (22 në pronësi të organizatës të cilat iu nënshtruan sekuestrimit) si dhe ri-investimin e të ardhurave nga prostitucioni për blerjen e kokainës.

E ashtuquajtura mafie kolumbiane në thelb përbëhet nga grupe kriminale (“kartele”), të cilat marrin emrin në bazë të veprimtarisë së tyre territoriale (Cali, Medellín, Santa Marta, Magdalena, etj.), zakonisht të pavarura e që kryesisht ose përjashtimisht merren me prodhimin, eksportimin dhe shpërndarjen e sasive të konsiderueshme të kokainës së rafinuar në Kolumbi, ose e blerë në vende të tjera të interesuara për kultivimin, sikurse Ekuadori, Bolivia, Peruja, Venezuela, Brazili dhe Argjentina⁵, ekspertë në përpunimin e përbërësit bazë në zonat e tranzitit dhe të magazinimit të lëndëve narkotike me destinacion eksportimin drejt vendeve të tjera të kontinentit.

⁵ Argjentina është prodhuesi më i madh i prekursorëve të Amerikës së Jugut, për shkak të pranisë së numri të madh të industrive kimike të Kontinentit.

Duke iu referuar linjave të përdorura për importimin e lëndëve narkotike, Spanja dhe Holanda përbëjnë qendrat kryesore evropiane për magazinimin e më pas hedhjen e drogës në tregun evropian. Sasitë e konsiderueshme transportohen në rrugë detare ose nëpërmjet përdorimit sistematik të korrierëve, shpesh herë të pa dënuar, të cilët nëpërmjet udhëtimeve të shpeshta mbartin sasi të vogla lëndësh narkotike. Organizatat kolumbiane që merren me trafikun e lëndëve narkotike kanë luajtur rolin e bazave të qenësishme logjistike në territorin italian të cilat dhe pse e konsiderojnë “ndrangheta” si pikën e referimit në nivel kombëtar, ruajnë marrëdhëniet dhe me organizatat e tjera të tipit mafioz, apo të huaja, ndër të cilat ato shqiptare dhe nigeriane.

Interes paraqet fakti se Shqipëria është përzgjedhur si vend për magazinimin e kokainës. Arsyet e një zgjedhjeje të tillë duhet ti kërkojmë, nga njëra anë në bashkëjetesën dhe bashkëpunimin e disa sektorëve të aparatit të policisë dhe të politikës së atij Vendi që është në gjendje të garantojë kushtet e mjaftueshme të sigurisë për veprimet e trafikut të paligjshëm dhe, nga ana tjetër, në perspektivën e përdorimit të linjave të kontrabandës së cigareve për importimin e kokainës në Itali, nëpërmjet qarkut të Puljes, me anë të motoskafeve të shpejtë.

Në rastin e trafiqeve të mëdha të kokainës, të ashtuquajturat kartelet kolumbiane jo rrallë herë përbëjnë struktura të “joint-ventures” me qëllim, si kryerjen e transporteve të suksesshme ashtu dhe, sidomos, ndarjen e rreziqeve që rrjedhin nga veprimet e luftës ndaj këtij fenomeni të ndërmarra nga Forcat e Policisë.

Aktualisht mund të përjashtohet fakti se grupet kriminale kolumbiane ushtrojnë dhunë në Itali për të siguruar trafiqet e tyre të paligjshme.

“Kartelat” kolumbiane priren gjithnjë e më shumë të pastrojnë të ardhurat e përfutuara nga trafiku i madh i lëndëve narkotike në investime pasurish të patundshme si dhe në veprimtari prodhuese kryesisht në vendet e bashkimit Evropian, ndër të cilat Italia.

Ndërsa për sa i përket pastrimit dhe transportimit të parave të përfutuara nga shitja e kokainës me prejardhje kolumbiane, rezultatet hetimore më të fundit afirmojnë faktin se rifutja në Kolumbi e të ardhurave nga trafiku i paligjshëm është kryer

- me anë të mekanizmave kompleksë të sistemit trekëndor të vëna në përdorim nga shoqëri pranuese, përmes lëshimit paralelisht të faturave të falsifikuara për të justifikuar shumat e mëdha të parave të destinuara për tu dërguar në Kolumbi;

- përmes transportimit në rrugë detare, nga Evropa drejt Kolumbisë, të parave në të holla;

Ndër hetimet e kryera gjatë periudhës 01.07.2005 – 30.06.2006, ndaj trafikut të lëndëve narkotike, përmendim:

- hetimin e DDA së Milano-s, i koduar me emrin *Skipper 2*, i cili përfundoi në shkurt 2005 me arrestimin e 26 personave (në Lombardi, Kampania, Kalabri, Emilja Romanja, Belgjikë, Spanjë dhe Kolumbi), si përgjegjës për bashkëpunim në krim me synim trafikun ndërkombëtar të kokainës së eksportuar nga karteli kolumbian i Norte del Valle, i cili duke ndjekur linjën afrikane (gjiri i Guinesë), nëpërmjet Spanjës dhe Hollandës mbërrinte në Itali.

- hetimi i DDA së Napoli-t, i koduar *Mito 3*, në përfundim të të cilit, mars 2006, u arrit të arrestoheshin 22 persona si përgjegjëse të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Nga hetimet rezultoi gjithashtu se eksponentë të klanit *Annunziata* të Boscoreale-s, nëpërmjet degëve të saj në Piemonte dhe në Veneto, furnizoheshin me kokainën që arrinte nga Gjermania dhe nga Holanda, ku, për llogari të kartelit të kryesuar nga vëllezërit Mejia Numera, vepronte një broker (agjent) kolumbian;

- hetimi i kryer nga DDA i Romës, me emrin e koduar *Ibisco*, përfundoi në mars 2006 me ekzekutimin e urdhrin për masën e sigurisë me burg pa afat lëshuar nga Gjyqtari për hetimet Paraprake, ndaj 27 personave (5 prej të cilëve të arrestuar në Spanjë dhe në Marok) pjesëtarë të një organizate “ndrangetiste” e cila vepronte në kryeqytet, në bashkëpunim dhe me *Cosa Nostra*, si dhe duke përdorur mjete lundrimi me ekuipazhe të kombësisë greke, për transportimin e sasive të konsiderueshme të kokainës dhe hashashit nga Amerika Jugore dhe Evropa nëpërmjet Marokut, ishujve të Kepit të Gjellbër dhe Spanjës;

- hetimi i koduar *Narcos*, i ndërmarrë nga Autoriteti Gjyqësor i Breshas, lidhur me blerjen e sasive të konsiderueshme të kokainës nga ana e Iacomino Tommaso, eksponent i kupolës së klanit Birra-Iacomino. Iacomino, person në kërkim që jetonte në Kolumbi, kujdesej për importimin e lëndëve narkotike në Itali, përmes linjës Kolumbi – Spanjë – Itali dhe Kolumbi – Portugali – Itali. Kokaina ishte e destinuar dhe për klanet e tjera që vepronin në zonën vezuviane të qarkut të Napolit, sikurse klani Chierchia, Aquino dhe Gallo (të ashtuquajturit Kavalierë). Gjatë hetimeve, me raportimin dhe të Policisë Gjyqësore italiane, Polizia Kolumbiane arrestoi në datën 27.04.2006 Iacomino-n.

Për sa i përket pranisë së personave me kombësi italiane në Kolumbi, për shkak të trafikut ndërkombëtar të kokainës, duhet nënvizuar se në 14.02.2006, me kërkesë të Autoriteteve italiane, Policia Kolumbiane arrestoi personin në kërkim me origjinë milaneze Zappa Renato. Që në fillim të viteve nëntëdhjetë, Zappa luante rolin e ndërmjetësit mes narko-trafikanëve italianë dhe kartelit kolumbian *Los Mellizos*, i kryesuar nga vëllezërit Mejia Munera. Një prej vëllezërve, me emrin Viktor Manuel, është cilësuar si një nga eksponentët e kupolës së organizatës paraushtarake kolumbiane me emrin A.U.C. (Autodefensas Inudas De Colombia), organizatë kjo që prej më se 20 vjetësh i kundërvihet, përkrah forcave ushtarake, grupeve të guerrillasve të cilët kontrollojnë prodhimin e kokainës.

Po kështu, në përfundim të hetimit *Dama Bianca*, gjithnjë me raportim të Policisë Gjyqësore italiane, Policia kolumbiane arrestoi në Bogota, në momentin kur po hipte në një avion me destinacion Italinë, një të hetuar milanez. Në momentin e arrestimit iu gjetën 9,5 kg kokainë të fshehura në çantën e dorës e në disa radiografi⁶.

Duke iu referuar kriminalitetit amerikano-jugor që vepron në Itali, duhet vënë në pah se sidomos në qytetet e mëdha të Italisë veriore, veprojnë dhe banda të përbëra nga të rinj, shpesh të mitur, që kryejnë krime kundër pasurisë (vjedhje, rrëmbime dhe zhvatje) si dhe me shpërndarjen me pakicë të lëndëve narkotike. Shpesh herë këto banda, me etni kolumbiane, ekuadoriane dhe peruane, përballen dhe me përleshje të ashpra⁷.

Janë 156 personat me origjinë amerikano-jugore të arrestuara gjatë periudhës 01.07.2005 – 30.06.2006.

Në datën 28.04.2003 është nënshkruar një memorandum midis Prokurorisë së Përgjithshme të Kolumbisë dhe Drejtorisë Kombëtare të Antimafias, që ka si objekt shkëmbimin e shpejtë e të ndërsjellë të informacioneve dhe të dhënave midis dy vendeve, në luftën ndaj krimit të organizuar dhe pastrimit të të ardhurave nga krimi.

⁶ Kjo gjë është përdorur më shumë se një herë, me sukses, për të kapërvyer kontrollat me rreze X në aeroport, nga ana e korrierëve të rinj italianë, të padënuar më parë, të angazhuar herë pas here nga organizata e trafikuesve të lëndëve narkotike që, në këmbim, u paguan atyre shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit. Burimi R.O.S. – relacion mbi krimin transnacional – Janar-qershor 2006.

⁷ Bandat më të njohura janë ato të quajtura Latin King dhe Neta, që veprojnë në provincën e Xhenovës (Genova), Torinos e Milanos, Komandot (Commando), që veprojnë në zonë milanze, Vatos, Los Templados, Forever, Soldatos, Latinos, etj..

§ 7. *Kriminaliteti rus dhe i vendeve të tjera të ish Bashkimit Sovjetik.*

Kriminaliteti i organizuar i vendeve të ish Bashkimit Sovjetik (e ashtuquajtura mafie ruse) përbëhet nga një mori grupesh kriminale, me origjinë të ndryshme e jo domosdoshmërisht të lidhura mes tyre.

Ky kriminalitet karakterizohet dhe nga “synime imperialiste”, sidomos ndaj vendeve të Evropës lindore (Bullgaria, Hungaria, Republika Ceke dhe Polonia).

Organizatrat kriminale të ish Bashkimit Sovjetik disponojnë burime të shumta financiare të përfutuara kryesisht me anë të “privatizimeve” të kryera si pasojë e ndryshimeve të skenarëve politikë të brendshëm. Në fakt, grupet kriminale ruse kanë përfutur sasi të mëdha titujsh përfaqësues të pasurisë kombëtare si dhe burime pasurish të patundshme dhe kontrollin e shumëfish të ndërmarrjeve dhe bankave.

Grupet kriminale ruse janë konsoliduar më tej përmes zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre në administratën lokale dhe në Parlament.

Këto grupe merren me trafikun ndërkombëtar të armëve⁸, materialeve strategjike, të fituara përmes procesit të çmilitarizimit të strukturave shoqërore si dhe të kontrabandës, në kohë më të hershme, të cigareve.⁹

Në Rusi ekziston ende korrupsioni i gjerë i funksionarëve (apo ish funksionarëve) publikë, çka përcakton një prani të pazakontë të profesioneve nga më të ndryshmet në gjirin e kriminalitetit të organizuar (ushtarakë, administratorë, politikanë dhe teknikë).

“Mafia ruse” ka njohur një përhapje të gjerë në disa vende si në Britaninë e Madhe, ku tregon interes dhe për furnizimin me armë të I.R.A.-s, në Zvicër dhe Austri, ku ka interesa të fuqishme financiare, në Gjermani, ku drejton shtëpi luksi të prostitucionit si dhe kontrabandën e materialit strategjik, në USA, ku ruan lidhjet dhe me kriminalitetin italo-amerikan. Në mënyrë të veçantë në Nju Jork vepron një organizatë që, ndër të tjera, merret dhe me trafikun e lëndëve narkotike, pastrimit të parave, shfrytëzimit të prostitucionit dhe “racket” të tregut të benzinës.

⁸ Më dt.16.10.2005, në Mosciano Sant’Angelo (TE), Policia e Shtetit, pas kontrollit të kryer në autostradë në dy furgona që kalonin, procedoi me arrestimin e 6 shtetasve ukrainas dhe me sekuestrimin e dy granatave hedhëse me kal. 540 mm, dhe një mekanizëm elektrik shpërthimi. Burimi R.O.S. – relacioni mbi krimin transnacional, gjashtëmuajori i 2° 2005.

⁹ Më 26.11.2005, në Castel Volturno (CE), Arma territoriale e Karabinierëve i dërgoi A.GJ. 3 shtetas ukrainas klandestinë për kontrabandë cigaresh, pasi u gjetën në zotërim të 7.240 Kg cigare.

Hetimet e kryera në këto kohët e fundit në vendin tonë kanë vënë theksin dhe në veprimtarinë e dëndur kriminale të këtyre grupeve në Rusi (rërëmbim personash, kontrolle të shoqërive dhe vrasje) si dhe në projektet ekonomike në Itali (eksportimi i arit, blerja e fabrikave të peshkut, tregtia e prodhimeve të naftës, etj.).

Mund të themi se rastet e ngjarjeve kriminale të zhvilluara në Itali nga shtetas të ish Bashkimit Sovjetik, të provuara nga pikëpamja gjyqësore, karakterizohen¹⁰:

- nga prania e aftësive të mëdha financiare;
- nga mosha relativisht e re e personave të përfshirë në veprimtaritë kriminale;
- nga një mungesë në dukje e lidhjeve me organizatat kriminale italiane.

Në qytetet përgjatë bregdetit të Adriatikut janë vënë re forma embrionale organizative me qëllim shfrytëzimin e emigracionit klandestin dhe të shfrytëzimit të prostitucionit (në lokalet e natës dhe në rrugë), ky i fundit i shoqëruar dhe nga veprime të dhunshme dhe me një rrjet të dëndur kontrolli në këtë territor, të vajzave të reja, kryesisht ukrainase, moldave dhe ruse, që jo rrallë herë u shiten grupeve kriminale të etnive të tjera (sidomos shqiptare).

Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim në këtë raport, është shënuar një rritje e numrit të shtetasve ukrainas të ngulur në Qarkun e Kampanias. Gratë, zakonisht, nisin udhën e prostitucionit apo kryejnë punë të ndryshme si punëtore shtëpie apo si infermiere në kushtet e shtëpisë, ndërsa burrat punojnë në fabrikat e tekstilit apo në sektorin e bujqësisë.

Në Kampania kohët e fundit kanë ndodhur ngjarje të përgjakshme, ndër të cilat vrasja e kryer në prill 2006 në Poxhomarino (Poggiomarino) (NA) me pistoletë të kalibrit 7,65 të dy ukrainasve të cilët ishin ndërlihdës në transportin e veshjeve, ushqimeve dhe parave mes ukrainasve të përqëndruar në qarkun e Napolit dhe familjarëve të tyre në Atdhe¹¹.

Lidhjet e kriminalitetit ukrainas me kamorrën janë vërtetuar dhe nga hetimi i kryer nga DDA i Napoli-t që përfundoi me lëshimin e masës së

¹⁰ Burim informacioni D.I.A.

¹¹ Pak përpara vrasjes, ish gjetur në lokalitetin e afërt Palma Campania (NA), një furgon i braktisur brenda të cilit u gjetën gëzhoja të kal.7,65. Ky automjet rezultoi se ish pronësi e një prej dy shtetasve ukrainas të vrarë. Duhet kujtuar se Palma Campania është vendi nga ku nisen autobusët për në Ukrainë dhe ku zhvillohet tregu klandestin e mallrave drejt Ukrainës.

sigurisë me burg pa afat ndaj 20 personave, kryesisht më kombësi ukrainase (shumë prej të cilëve ende në kërkim) si përgjegjës për bashkëpunim në krim të tipit mafioz më synim kryerjen e zhatjeve në dëm të bashkëkombësve. Hetimet vërtetuan veprimtarinë, në kryeqendrën kampane dhe në Kazerta të tre grupeve të ndryshme kriminale me etni ukrainase të cilat, në bashkëpunim dhe me shtetas kampanë kryenin kontrollin e disa vendparkimeve për furgonë që transportonin mallra dhe njerëz mes Ukrainës dhe Italisë si dhe zhatje në dëm të shoferëve të automjeteve dhe të udhëtarëve.

Dyshohet për prani të kriminalitetit rus, sidomos me qëllim pastrimin e të ardhurave të realizuara nga kryerja e shkeljeve penale, në Lombardi, (Milano), në Lacio (Romë), Toskanë (Firence), në Emilja Romanja (Modena, Bolonja e Rimini), në Piemonte, në Veneto (Verona), në Friuli-Venecia Xhulia (Friuli Venezia Giulia) dhe në Marke (Marche) (Ankona/Ancona).

Në mënyrë të veçantë, janë vërtetuar blerje¹² të dyshimta nga ana e shtetasve të ish Bashkimit Sovjetik të ndërmarrjeve bujqësore dhe të industrive të prodhimit të konsumit të gjerë (këpucë, veshje, elektroshtëpiakë, etj.) për eksportimin në vendet e origjinës dhe të të gjithë Evropës lindore. Hipotezat investiguese i konsiderojnë këto si blerje të kryera me para që rrjedhin nga veprime kriminale të kryera në vendet e origjinës.

Janë shënuar dhe blerje të strukturave të hoteleri – turizmit përgjatë brigjeve romanjole dhe markexhane: mendohet se këto blerje synojnë kontrollin e turizmit, nga vendet e ish Bashkimit Sovjetik drejt Italisë, shpesh herë i lidhur me të ashtuquajturin *shopping tour*, që praktikohet kryesisht në qytetin e Rimini-t.

Gjithashtu, përgjatë rivierës ligure janë shënuar investime në sektorin e pasurive të paluajtshme si dhe prania e shtetasve të ish Bashkimit Sovjetik në administrimin e shoqërive të ndërmjetësisë financiare. Ndërsa në Lombardi është verifikuar prania e shtetasve rusë që merren me rindërtimin e pasurive të paluajtshme me vlera të mëdha si dhe në administrimin e shoqërive të import – eksportit.

Por për fat të keq, gjatë hetimeve hasen vështirësi të shumta në ngritjen e akuzave për krimet për sa në nenet 648 bis e ter të k.p., pasi shpesh herë nuk është e provueshme ekzistenca e krimit të prezumuar¹³.

¹² Burim informacioni D.I.A.

¹³ Përballë vështirësisë për të dokumentuar krimin e prezumuar, merr rëndësi të madhe protokollin i bashkëpunimit i nënmshkruar në Romë më 20.01.2006 mes Ministrisë së Punëve të brendshme të Republikës së Italisë dhe Ministrisë homologe të federatës ruse që,

Ndër veprimtaritë kriminale më karakteristike të kryera në Itali nga grupet kriminale të ish Bashkimit Sovjetik, vëmë theksin në trafikun e lëndëve narkotike sintetike sikurse *exctasy* dhe *eva*, të hashashit (vendet e ish Bashkimi Sovjetik zënë vendin e parë në prodhimin botëror të këtyre lëndëve) dhe të heroinës që rrjedh nga kultivimi i lulëkuqes së opiumit në territoret e Republikave të Azisë qendrore (Taxhikistan, Uzbekistan, Kazakistan, Kirgistan), të atyre “trans-kaukazike” (sidomos Azerbajxhan). Këto Republika të Azisë qendrore shërbejnë dhe si vende për tranzitimin e më pas për shpërndarjen e heroinës më prejardhje nga Jug-lindja aziatike në qendrat kryesore të konsumit të Shteteve të tjera të ish Bashkimit Sovjetik, të Evropës dhe të SHBA.

Në datën 14.02.2001, Prokurori Kombëtar i Antimafias ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës, më synim shkëmbimin e shpejtë e të ndërsjellë të informacioneve, të të dhënave mbi krimet e kriminalitetit të organizuar dhe pastrimit të parave që rrjedhin nga veprimtaritë e paligjshme.

Memorandume të ngjashme janë nënshkruar mes Prokurorit Kombëtar të Antimafias dhe Prokurorëve të Përgjithshëm të Federatës Ruse (14.05.2002), të Letonisë (28.02.2002), të Kazakistanit (28.05.2003), të Lituanisë (27.09.1999), të Estonisë (26.04.2004) dhe të Uzbekistanit (30.05.2005).

Shtetasit rusë që janë arrestuar gjatë periudhës së marrë në shqyrtim nga ky raport, janë 23, ndërsa shtetasit ukrainas të arrestuar në gjashtëmujorin e parë të 2006 janë 32.

§ 8. Kriminaliteti kinez.

Pranitë e para në Itali të shtetasve kinezë hasen në vitet menjëherë pas luftës së dytë botërore, kur një numër i kufizuar të mërguarish, kryesisht me prejardhje nga rajoni i Zhejiang, u vendosën në pjesën veriore dhe qendrore të Italisë.

Në dhjetëvjeçarët e mëvonshëm, grupe familjare kineze u ngulën kryesisht në qytetet e Romës dhe Milano-s ku hapën dhe disa restorante.

Komuniteti kinez në Itali është rritur ndjeshëm si rrjedhojë e masave të marra në këto vitet e fundit për legalizimin, por sidomos si pasojë e hapjes

sigurisht, do të ndihmojë bashkëpunimin mes dy Vendeve në luftën kundër pastrimit të parave.

së Kinës ndaj perëndimit, pas ngjarjeve të njohura ndryshe me emrin Sheshi Tien'anmen.

Rajonet në të cilat shënohet një numër i madh lejesh qëndrimi të lëshuara në favor të shtetasve të Republikës Popullore Kineze, dhe të një numri më të vogël në favor të shtetasve me prejardhje nga Kina Nacionaliste (Taiwani), apo të atyre me prejardhje nga Hong Kongu dhe nga Makao, janë Lombardia, Lacio, Toskana, Emilja Romanja, Piemonte, Veneto dhe Friuli-Venecia-Xhulia.

Në këto vitet e fundit, komunitetet kineze janë përqendruar në rajonet e ishujve dhe në ato jugore (prania kineze vetëm në krahinën e Napolit arrin shifrën e mbi 2000 personave).

Qytetet në të cilat shënohet një numër i madh shtetasish kinezë janë Milano (9.000 prani të rregullta), Firenze dhe Prato (15.000), Roma (5.000), e më pas Torino, Trieste, Udine, Modena dhe Rexhio Emilia.

Sektorët e tregtisë që zhvillohen nga komunitetet kineze në Itali ato të restoranteve, të veshjeve, të import-eksportit të prodhimeve të artizanatit dhe ato ushqimore si dhe ato të hotelerisë, turizmit dhe reklamës.

Duhet theksuar se shtrirja e madhe tregtare është shoqëruar nga një zhvillim i bashkëpunimit të kinezëve të Republikës Popullore të emigruar, të quajtur Huaqiao, i cili lindi me qëllim mbrojtjen e interesave të emigrantëve si dhe me krijimin, për këtë qëllim, të revistave në gjuhën amtare.

Është vërtetuar se jo rrallë herë, persona me peshë të organizatave kriminale kineze janë përpjekur (ndonjëherë dhe duke ia arritur qëllimit) të zënë poste të rëndësishme në shoqatat që përmendëm më sipër, me qëllim përfitim të një prestigji dhe autoriteti më të madh ndër bashkatdhetarët dhe për t'u shndërruar në partnerë të organizatave ndërkombëtare, qofshin ato italiane apo kineze.

Por çka përbën shqetësim më të madh është fenomeni i emigracionit klandestin, kryesisht nga krahina e Zhejiang. Linjat e këtij emigracioni ndahen nëpërmjet qyteteve të ndryshme evropiane për të përfunduar më pas, në mënyrë të organizuar, në Itali. Drejtuesit e trafikut të klandestinëve kanë shfrytëzuar dhe linjat detare, nga brigjet ballkanike deri në ato puljeze, të rrahura nga skafistët që kryejnë dhe kontrabandën e cigareve, si dhe të lëndëve narkotike.

Për të mbërritur në Itali, çdo klandestini i duhet të paguajë një shumë që luhetet nga 20 deri në tridhjetë milionë lireta, shpesh herë të parapaguara nga organizatat që në Kinë drejtojnë këtë lloj trafiku; për pasojë, klandestini

shndërrohet në borxhli, e pra, i gatshëm të kryejë veprime të paligjshme për të shlyer këtë borxh.

E njëjta gjë ndodh dhe me ata që shërbejnë si krah pune i paguar shumë pak, kryesisht në ndërmarrje klandestine: ata shpesh herë, si punëtorë krah, mund të tërhiqen nga persona të së njëjtës etni e që kryejnë veprimtari të paligjshme.

Nga hetimet e kryera është vënë në pah se në Itali nuk vepron vetëm një organizatë kriminale kineze, por disa grupe kriminale, zakonisht të përbëra nga persona që bashkëpunojnë në vartësi të prejardhjes nga qytetet e Kinës Popullore.

Çdo grup është i përbërë nga një numër personash që luhetet nga dhjetë deri në pesëdhjetë, e që shpesh herë i përkasin të njëjtës familje, anëtarët e të cilit kryejnë krime pothuaj vetëm në dëm të bashkëkombësve¹⁴.

Çdo grup ka një kryetar¹⁵, anëtarësimi në grup kryhet nëpërmjet ceremonive fillestare¹⁶. Lidhja brenda familjes apo grupit është shumë e

¹⁴ Familja kineze paraqitet në tre lloje të ndryshme: familja elementare (burrë, grua, fëmijë), familja e zgjeruar (që përfshin prindërit e kreut të familjes), familja e shtrirë (që është bashkimi i grupeve të ndryshme familjare). Nga këto forma lind familja ekonomike – e quajtur “chia” – e cila është një bërthamë familjare që, përveç se ka një pronë të përbashkët, i ndaj të ardhurat nga puna të anëtarëve të vet.

¹⁵ Përgjithësisht grupet kanë një kryetar të vetëm, të cilit i takojnë vendimet. Vetëm prej tij merren urdhërat, që për më shumë u komunikohen zëvendës kryetarëve që më pas i bëjnë anëtarët t’i zbatojnë ato. Struktura pra është shumë hierarkike, me një kryetar që ka drejtimin strategjik dhe zëvendës kryetarët që kanë detyrën e lidhjes me çdo anëtar.

Në rast mungese të kryetarit që pengon çdo mundësi lidhjeje, edhe telefonike, caktohet një zëvendës kryetar me detyrën ta zëvendësojë atë.

Struktura e një grupi mund të shtrihet aty ku grupi ka një rëndësi më të madhe dhe ku prek disa Shtete, apo disa qytete apo sektorë. Në këto raste çdo nëngrup vepron në fakt në mënyrë të pavarur dhe përgjigjet për punën e vet vetëm përpara kryetarit të gjithë piramidës kriminale. Disa herë nëngrupet as nuk janë në dijeni të faktit që i përkasin të njëjtit grup kriminal. Është kryetari ai që vendos nëse niveli i informacioneve duhet të mbërrijë tek çdo anëtar apo duhet të ndalet në nivele të ndërmjetme.

Së fundi, një grup mund të vetë degëzime të vogla, zakonisht të përbëra nga dy apo tre persona, që njihen vetëm nga kryetari i cili i përdor vetëm për punë që konsiderohen “të rezervuara” si veprime kundër anëtarëve të të njëjtit grup apo për mbledhjen e informacioneve që nuk ngjall dyshime.

Shpesh grupet kanë një anëtar që kryen “detyrën e “këshilltarit të grupit”; bëhet fjalë zakonisht për një këshiltar teknik që ka detyrë të studiojë taktikat e ndërhyrjeve.

¹⁶ Në ceremoninë e anëtarësimit duhet të jenë të pranishëm të paktën 7 ithtarë të organizatës; të gjithë, ndër të cilët edhe kandidati, e shpojnë gishtin e një dore me majën e një thike apo sidoqoftë me një armë të ftohtë që është e përshtatshme për një vrasje. Secili nga të pranishmit lënë të bien disa pika nga gjaku i tyre në një enë të vetme që përmban një

fortë, ndaj dhe koncepti i hakmarrjes¹⁷ është tejet i rrënjosur, çka bën që shpesh herë të përftojë veçoritë e një gjakmarrjeje.

Në përgjithësi kinezët e konsiderojnë shtetin si një entitet mjaft të largët dhe të pa aftë ti mbrojë ata, pa bërë dallimin këtu mes vendit të tyre të origjinës dhe atij në të cilin jetojnë. Sigurisht, kjo si pasojë dhe e faktit se ata i konsiderojnë funksionarët e shtetit, të çdo lloj niveli, si të korruptuar e të korruptueshëm.

Grupet kriminale kineze, që krahasohen me ato të mafieve të ashtuquajtura tradicionale, shpesh herë, për të arritur synimet e tyre, përdorin dhunën dhe kërcënimin, vënë në përdorim rregullin e heshtjes si dhe prirjen drejt zotërimit të territorit në të cilin veprojnë.

Veprimtaritë thelbësore të grupeve kriminale kineze që veprojnë në Itali janë:

- trafiku i klandestinëve dhe i krimeve që lidhen me falsifikimin e dokumenteve;

- rrëmbimi i personave me qëllim zhvatjen kryesisht në dëm të bashkëkombësve, shpesh herë të lidhura me marrjen e shumave që janë paguar për kalimin e paligjshëm të kufirit, për biletat e udhëtimit si dhe për hyrjen klandestine në Itali;

- zhvatja¹⁸ në dëm të pronarëve të restoranteve dhe të titullarëve të ndërmarrjeve të vogla të veshjeve;

- rrëmbimet¹⁹.

distilat orizi (ky i fundi është simbol i jetës); kështu, me radhë, duke shqiptuar fjalët e një betimi, pijnë nga ena).

“Shpata e gjakut” është zakonisht një paralajmërim për vdekje. Qëndron në dërgimin tek personi i caktuar të disa gladiolave të lulëzuara, në ngjyrë të kuqe. Ky paralajmërim është detyruar për gjithë grupin që e ka nxjerrë atë. Në kohët e fundit disa grupe, në Itali, dërgimi i luleve është zëvendësuar me dërgimin më modern të fishekëve të një arme zjarri.

¹⁷ Hakmarrja konsiderohet si një detyrim sidomos në rastin e vrasjes së një mashkulli në familje.

¹⁸ Zhvatja është forma më tipike me anë të së cilës grupet kriminale kineze grumbullojnë paratë. Zakonisht ajo kryhet me nëpërmjet sistemit të dhënies “së mbrojtjes”, me përdorimin e dhunës dhe të kërcënimit si para ashtu dhe pas kërkesës për zhvatje.

Në Itali ende nuk është arritur një sistem i përgjithshëm mbrojtje përkundrejt pagesës së një tarife fikse nga pala e të zhvaturit, sikurse ndodh në Francë apo në Spanjë. Pra kërkesat i referohen një shume çfarëdo parash por që zakonisht arrin në 50 ose 100 milionë. Megjithatë duke u bazuar në thëniet e shtetasve kinezë të cilët kanë bashkëpunuar gjatë hetimeve të kryera, pothuaj të gjithë titullarët e restoranteve apo të punishteve i janë nënshtruar zhvatjes ose tentativës për zhvatje.

- rifitimi i të drejtave me anë të metodave kërcënuese dhe të dhunshme;
- organizimi i lojërave të fatit²⁰;
- shfrytëzimi i prostitucioni, nën formën e sallave të masazhit²¹, e së fundmi dhe në rrugë;
- mbajtja e paligjshme e armëve;
- vrasja e pjesëtarëve të grupeve kriminale kundërshtarë;
- evazoni fiskal në veprimtaritë tregtare;
- falsifikimi dhe tregtimi i mallrave të çdo lloji, të prodhuara dhe të importuar në pjesën më të madhe nga Kina;

Janë verifikuara gjithashtu, kryesisht në Piemonte, raste të përfshirjes së shtetasve kinezë në trafikun e lëndëve narkotike, por në përgjithësi dhe pse

¹⁹ Sigurisht që rrëmbimet ndaj familjeve kineze kanë shënuar një zhvillim të madh sidomos në qytete si Roma dhe Milano, apo dhe në Firenze / Prato. Zakonisht rrëmbyesit veprojnë të maskuar me maska në fytyrë të bëra me çorapet e grave. Në datën 29.07.2005 Karabinierët, pranë një kazinoje në zonën e Ca' të Noghera Mestre (Ve) arrestuan një person në kërkim, Hu Bingqui, ndaj të cilit Autoriteti Gjyqësor i Milanos dhe i Pratos kishte lëshuar urdhër për masën e sigurisë me burg pa afat, si përgjegjës, në bashkëpunim me të tjerë, për vrasjen e dyfishtë ndaj bashkëkombësve, i kryer në provincën e Trevizos më 4.11.2004 gjatë një tentative për rrëmbim. Lhu, i konsideruar si një prej eksponentëve më të rëndësishëm të kriminalitetit kinez në Itali, rezultoi të ishte i përfshirë dhe në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

²⁰ Në brendësi të grupeve klandestine, lojërat më të përdorura janë: poker, ndonjëherë sipas modelit oriental, majon, e cila është një lojë tipike kineze por që për shkak të ngadalësisë së saj nuk bën të mundur humbjen apo fitimin e shumave të mëdha, dominoja, lojë e njohur dhe në Itali, por me nivel pikësh më të larta. Kjo është loja më e përhapur në këto grupe pasi si rezultat i shpejtësisë me të cilën zhvillohet, lejon fitimin apo humbjen e shifrave të konsiderueshme në pak kohë.

Burime të ndryshme kanë dëshmuar se disa grupe përdorin dhe lojërat e fatit për tu zhvatur para viktimave të tyre, kryesisht titullarë të aktiviteteve prodhuese. Ata ftohen për një lojë pokeri, duke mos pasur mundësi të tërhiqen nga frika e kërcënimeve të mundshme. Në përfundim të çdo dore loja ndërpritet dhe ai apo ata që është duke fituar duhet të ndajë shumën e fituar me anëtarin e grupit kriminal që e ndihmon atë.

²¹ Po përhapet prostitucioni, të dhëna për të cilin ka më shumë në Milano e në Torino; dhe në këtë qytet të fundit është zbukuar një organizatë që sillte në Italiu shtetasë kineze për t'i futur në prostitucion në shtëpi publike. Gratë e përfshira transferohen nga një shtëpi në tjetrën, që shpesh reklamohen si “qendra masazhi” dhe priren të çlirohen dhe të bëhen ato vetë menaxhuese të shtëpive të reja dhe mbledhëse klandestinesh të reja.

është në rritje, ky fenomen është ende në shkallën e shpërndarjes në brendësi të komunitetit kinez²².

Për sa i përket marrëdhënieve me kriminalitetin italian, duhet theksuar se vetëm në vitet e fundit janë vërejtur raste të grupeve kriminale të përziera, pra të përbëra nga kinezë dhe italianë, që krahas zhvatjes dhe rrëmbimeve kryejnë dhe sekuestrime.

Sektorët ekonomikë në të cilët komuniteti kinez zë peshën më të madhe, janë ato sektorë karakteristikë të fazës së parë të zhvillimit të një komuniteti emigrantësh: restorantet, përpunimi i lëkurës, tekstilet (degët tradicionale ekzistojnë dhe në tokën mëmë), artizanati i vogël i lidhur me rrethin e tregtarëve dhe ambulantëve, lodra, sende të ndryshme). Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimin e madh ekonomik që po karakterizon komunitetin kinez, është e mundur që në një të ardhme të afërt do të hasim ekspansionin e sektorëve ekonomikë të ndryshëm nga ai tradicional. Gjithsesi, fushat ekonomike aktuale janë ata sektorë në të cilët shfaqet dukshëm puna e zezë, çka përbën një ndër faktorët kryesorë të zhvillimit të komuniteteve kineze të emigrantëve. Zhvillim i cili shoqërohet nga mungesa e respektimit të normave që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike e në veçanti ato të punës – orari i punës, normat mbi higjienën dhe sigurinë, destinacioni i përdorimit të një pasurie të paluajtshme, ku secili prej tyre përbën një tjetër faktor të zhvillimit ekonomik.

Rëndësi të veçantë paraqet fakti – dhe ai i lidhur me një ekonomi që ndodhet në fazën e parë të zhvillimit të saj – se komuniteti kinez priret të mbështetet shumë pak në veprimet bankare. Hetimet gjyqësore kanë vënë në dukje se çdo transaksion financiar kryhet, rregullisht, duke përdorur para në të holla, bëhet fjalë për shpenzimet e administrimit të veprimtarive tregtare të ligjshme apo për financime të emigracionit klandestin.

Veçori dalluese e komuniteteve të emigrantëve janë dhe marrëdhëniet e ngushta me tokën amë që, nën profilin ekonomik, marrin formën e një prirje në rritje për të ri-investuar në Kinë një pjesë të konsiderueshme të fitimeve që realizohen në Itali.

Duke iu referuar transaksioneve financiare të paligjshme, vlen të përmendim dy hetime të cilat kanë vënë në pah zakonin e kinezëve për t'iu drejtuar mjetit të korrupsionit në përpjekjet për të shmangur kontrollin e

²² Më 22/7/2005, në Montecchio a Mare (VC) Arma territoriale arrestoi 2 shtetas kinezë që u gjetën që zotëronin 300 tableta ecstasy gati për t'u shpërndarë brenda një diskoteke. 300 tableta të tjera ecstasy janë sekuestruar, më 24.09.2005, po në këtë lokalitet.

Forcave të Rendit, çka ka bërë të mundur përcaktimin e dy bankave abuzive, një në Romë dhe një në Milano.

Hetimi i parë, me emrin e koduar *Ultimo Imperatore*, i kryer nga DDA i Romës, përfundoi në korrik 2005 me arrestimin e 9 personave (5 kinezë dhe 4 italianë), si përgjegjës për bashkëpunim në krim më synim pastrimin e parave dhe ushtrimin abuziv të shërbimeve bankare. Të hetuarit pastronin shuma të mëdha parash, pjesërisht me prejardhje nga veprimtari të paligjshme, fitime të siguruara nëpërmjet import-eksportit të produkteve të falsifikuara në Kinë. Hetimet vërtetuan 30 operacione të importimit të mallit, të imbarkuara në portin e Singaporit, të shoqëruara nga dokumentacion i rremë dhe ri-investimin e këtyre të ardhurave në blerjen e pasurive të paluajtshme si në Kinë ashtu dhe në Romë (në lagjet Esquilino, Prenestino dhe Casilino, aty ku dhe përqendrimet e komuniteteve kineze janë më të mëdha). Në lagjen Esquilino, grupi kriminal kishte hapur një lloj sporteli bankar, në gjendje të ofronte shërbime kreditimi në favor të shtetasve të huaj, kryesisht me etni kineze. Shumat që mblihdeshin çdo ditë luhateshin nga 500.000 deri në 1.000.000 Euro dhe transferoheshin në filialin e Bankës Kombëtare të Punës me anë të një furgoni që shërben për transportimin e sendeve me vlerë. Në këtë mënyrë i hapej udhë një tregu financiar paralel, në të cilin rezultonin të përfshirë dhe funksionarë të B.N.L, të cilët, me anë të lëshimit të faturave për operacionet e importimit të mallrave, kryenin dhe eksportimin abuziv, kryesisht të valutave, drejt tregjeve aziatike.

Hetimi i dytë i koduar me emrin *Oro del Dragone*, vërtetoi, në korrik 2005, ekzistencën e një veprimtarie të paligjshme të ndërmjetësismit bankar, e cila kryesohej nga 2 shtetas kinezë dhe 3 italianë, me synim plotësimin e nevojave financiare të anëtarëve të komuniteteve kineze. Nga hetimet u vu re se një agjenci *Money Transfer* vepronte si të ishte një bankë e vërtetë klandestine, duke qarkulluar para, që në 3 vitet e fundit kapte shifrën e 31 milion eurove, e që i referohej të paktën 20.000 operacioneve të dërgimit të parave jashtë vendit.

Gjatë mbledhjeve të bashkërendimit të punës, të zhvilluara pranë Drejtorisë Kombëtare të Antimafias, me Prokurorë të Republikës si dhe në takimet me organizmat e ndryshme të Policisë Gjyqësore u arrit të përcaktoheshin disa problematike që lidhen me hetimet ndaj kriminalitetit kinez:

Një nga problemet që është hasur më shpesh nga Prokurorët dhe nga Forcat e Policisë është ai që lidhet me përdorimin e përkthyesve. Në të vërtetë, me përjashtim të rasteve të mungesës së besueshmërisë tek këta të

fundit, duhet theksuar se pjesa më e madhe e kinezëve që jetojnë në Itali, sikurse thamë, e ka prejardhjen nga Zhejiang ku flitet një dialekt mjaft i vështirë për t'u kuptuar, ndaj dhe janë të paktë specialistët e përkthimit. Për më tepër, përkthyesit e gatshëm për të bashkëpunuar, pikërisht pse janë paktë në numër, janë lehtësisht të identifikueshëm nga komunitete e përkatësisë, e për rrjedhojë të ekspozuar nda rrezikut të kërcënimit.

Pra ky problem mund të paraqitet nga dy këndvështrime, ai që lidhet me numrin e përkthyesve dhe ai që lidhet me identitetin e tyre.

Në lidhje me këndvështrimin e parë, ka lindur problemi i pamundësisë për t'iu drejtuar autoriteteve kineze për specializimin e përkthyesve në dialektin e Zhejiang, kjo si pasojë e rrezikut të përhapjes së informacionit pranë komuniteteve kineze. Është konsideruar si më e përshtatshme mundësia e specializimit duke iu drejtuar enteve privatë, si për shembull Universiteteve apo strukturave të ngjashme).

Në lidhje me këndvështrimin e dytë, në bazë të normativës në fuqi, mundësia për të mbajtur të fshehtë identitetin është e përealizueshme. Pra nevojitet parashikimi i normave të reja – sigurisht që nuk mund t'i referohen vetëm luftës ndaj kriminalitetit kinez, por të kenë dobi të përgjithshme – të cilat duhet të jenë aktive në dy drejtime: duhet të mbajnë të fshehtë identitetin fizik dhe të emrit, me një rregullim që vlen si gjatë fazës së parë të hetimeve ashtu dhe në atë të gjykimit.

Ndërfutja e këtij rregullimi do të mund të zgjidhte thelbin e problemit, duke pasur parasysh dhe vështirësitë që hasen nga normativa në lidhje me likuidimin e pagesës së përkthyesve, parashikuar në nenin 11 të Ligjit nr. 319, 8 korrik 1980, e cila parashikon njoftimin e palëve për urdhrin për pagesën.

Megjithatë janë vërejtur mëdyshje për ndërfutjen në sistem të normave që do t'i hiqnin mbrojtjes mundësinë për t'i konsideruar të vlefshme rastet e paaftësisë apo të mospërputhshmërisë.

Gjatë mbledhjeve të ndryshme të koordinimit të zhvilluara pranë Drejtorisë Kombëtare të Antimafias, është vënë theksi në dobinë e mosbllokimit të menjëhershëm të kufijve ndaj trafikantëve klandestinë, kur këta zbulohen, si dhe të shtyrjes së kryerjes së arrestimeve me synim ndjekjen e linjave të përdorura prej tyre, për të zbuluar kështu dhe lidhjet e mundshme.

Duke marrë shkas nga normativa në fushën e lëndëve narkotike (neni 98 T.U.) mbi të cilën u hartua legjislacioni i mëtejshëm në fushën e sekuestrimit të personave me qëllim zhvatjen (neni 7 D.L. 15/1/1991, nr. 8),

pastrimit të parave dhe zhvatjeve (neni 10 D.L. 31/12/1991, nr. 419), mund të parashikohen dhe norma të ngjashme të cilat mund të përfshihen në T.U. në kuadrin e normave që rregullojnë emigracionin, në nenin 12, paragraf 4 bis, i cili parashikon se kur është i nevojshëm përfitimi i elementëve të provës, apo përcaktimi dhe kapja e përgjegjësve të krimeve të parashikuara në paragraf 1 dhe 3, Prokurori, me anë të një dekreti të arsyetuar, mund të vonojë ekzekutimin ose mund të urdhërojë vonesën e ekzekutimit të masave që parashikojnë një masë sigurie, arrestimin apo ndalimin e personit të dyshuar.

Qëndrueshmëria e lidhjeve të kriminalitetit kinez me vendin e origjinës bën të nevojshme që organet hetimore të kenë mundësinë e kontakteve organike me autoritetet kineze. Aktualisht, parësore janë kontaktet e policisë, por do të ish e dobishme që këto lidhje të shtriheshin dhe në fushën gjyqësore.

Një veçori dalluese e marrëdhënieve me Kinën, e cila pasqyrohet drejtpërdrejt dhe në hetimet, është mundësia e përfitimit të informacioneve mbi numrat telefonikë kinezë.

Por, nga ana tjetër u vërejt se Telecom Italia nuk e ka mundësinë e numrave telefonikë të huaj, e në këtë rast, duke u gjetur para këtij problemi, kërkoi bashkëpunimin e shoqërive të huaja, por përgjigja iu dha pas një kohe relativisht të gjatë.

Megjithatë, nëpërmjet Ministrisë së Jashtme u bë e mundur të vërtetohej se Telekomia kinez nuk i ofron publikut një shërbim të tillë informativ i cili do ish në gjendje të zbulonte mbajtësin e numrit duke u nisur nga numri telefonik që disponohet. Anasjelltas, ofron një shërbim të gjetjes së numrit të telefonit me anë të një përdoruesi të caktuar. Për përfitimin e këtyre të dhënave mund të ndiqen dy rrugë: ose duke iu drejtuar Interpolit, ku Kina është anëtarësuar, ose duke iu drejtuar drejtpërdrejt konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Shanghai.

Një tjetër problem që ka dalë në pah gjatë kryerjes së hetimeve është dhe ai i mungesës, në pasaportat e emigrantëve, së të dhënave lidhur me qytetin e origjinës, çka i pengon organet kompetente të arrijnë në përfundime rreth lidhjes mes subjekteve nën hetim, të cilët shpesh herë janë të lidhur për nga përkatësia e së njëjtës zonë gjeografike. Për të kapërcyer këtë problem, organeve kompetente u sugjerohet që gjatë marrjes në pyetje tu kërkojnë shtetasve kinezë qytetin e origjinës. Ndër hetimet e kryera gjatë muajve të fundit ndaj kriminalitetit kinez, përmendim:

- hetimin *Lanterne Rosse* e DDA së Napoli-t që përfundoi në maj 2006 me arrestimin e 10 personave, nga të cilët 6 kinezë, pjesëtarë të një grupi italo-kinez që merrej me importimin e mallrave të falsifikuara në rajonin e Zeijang, përmes portit të Napolit dhe të Civitavecchia-s. Nga hetimet u vu re se shtetasit italianë kryenin rolin e spedicionerëve si dhe atë të ndërmjetësve me funksionarët e doganave për të bërë të mundur futjen në mënyrë të paligjshme të këtyre mallrave në Itali.

- hetimin që lindi si rrjedhojë e një kontrolli që u ushtrua në portin e Napoli-t në mars 2006 ndaj një konteneri që vinte nga Hong Kongu me destinacion një shoqëri në Ascoli Piceno si rezultat i të cilit u arrit të zbuloheshin mijëra palë çorape të falsifikuara që kapnin shifrën e rreth 300.000 Euro,

- hetimin e Autoritetit Gjyqësor i Napolit, i nisur në mars 2006 si rrjedhojë e një sekuestrimi të kryer nga Forcat e Karabinierëve të N.A:S. pranë Portit të Napoli-t të 17.5 tonelatave produkte ushqimore kineze, me bazë mishi e të destinuara për tregun roman, importimi i të cilave është i ndaluar në zonën evropiane,

- hetimin që lidhet me një krim të kryer në datën 22.05.2006 në San Giuseppe Vesuviano (NA) nga 6 shtetas kinezë të cilët pasi ushtruan kontrollin me maska në hotelin Villa Paradiso, që administrohej nga dy bashkëkombës të tyre, vranë një shtetas kinez dhe plagosën tre. Viktimat, të gjithë tregtarë të veshjeve në zonën e Prato-s, shkonin vazhdimisht në lokalitet vezuviane për të kryer dorëzimin e veshjeve në ndërmarrjet kineze që ushtronin veprimtaritë e tyre në këtë zonë.

Për sa i përket kriminalitetit aziatik, duhet theksuar fakti se nga hetimi i kryer së fundmi, me emrin e koduar *Thaisex* ndaj një organizate transnacionale që merrej me emigracionin klandestin dhe me shfrytëzimin e prostitucionit të vajzave të reja tajlandeze, të cilat detyroheshin të ushtronin prostitucionin në apartamente që ndodheshin në qytete të ndryshme italiane (Asti, Alessandria, Pavia, Vercelli, Verbania, Ferrara e Napoli). Hetimi, i cili përfundoi me lëshimin e një urdhri për masën e sigurisë me burg pa afat ndaj 16 personave me etni kryesisht tajlandeze, ndaj të cilëve rëndonin dhe krimet e trafikut të qenieve njerëzore dhe të vënies në kushtet e skllavërisë, vuri në pah se gratë, të cilat shpesh herë shiteshin nga vetë të afërmit tek organizatat kriminale, mashtroheshin nëpërmjet premtimeve për punë dhe hynin në Itali me viza për motive turizmi, duke paguar shumën prej 2.500 Euro për të gjitha shpenzimet e udhëtimit tek një agjenci në Bangkok.

Janë 78 shtetasit kinezë të arrestuar në Itali gjatë periudhës 01.07.2005 – 30.06.2006.

Në datën 17.01.2001 është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit mes Drejtorisë Kombëtare të Antimafias dhe Autoritetit Gjyqësor homolog të Republikës Popullore Kineze, që synon luftën ndaj kriminalitetit të organizuar dhe pastrimit të parave që vijnë si rezultat i krimit.

KËSHILLTAR LUCIO DI PIETRO
Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie

Tiranë, Mars 2007

1.3. *Krimet e prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike.*

§ 1.

Ndërkombëtarizimi në rritje dhe tashmë i plotë dallon sot organizatat e mëdha kriminale dhe, në veçanti, ato të llojit mafioz. Aftësia e jashtëzakonshme për të grumbulluar pasuri të krimit të organizuar, përbën tashmë një nga rreziqet më të mëdha për demokracitë moderne dhe sistemin ekonomik, të cilët rrezikojnë të kushtëzohen fort nga aspekti ngushtësisht kriminal dhe, edhe më shumë, nga ai socio-ekonomik i strukturave të mirëfillta transnacionale.

Organizatrat kriminale që veprojnë në sektorin e trafikut të kokainës shfaqin në fakt një aftësi të theksuar për të depërtuar në sistemin social të vendeve të ndryshme, duke vepruar në shkallë ndërkombëtare, me mënyra të caktuara që shquhen për nivel të lartë sipërmarrjeje e që përfshijnë botën ekonomike.

Përmes hedhjes në qarkun financiar të të ardhurave jashtëzakonisht të mëdha që rrjedhin nga tregtia e lëndëve narkotike, të cilave u shtohen të ardhurat e grumbulluara nga ekonomi të jashtme drejtpërsëdrejti të lidhura me trafikun (prodhim dhe shitje e prekursorëve²³ dhe e lëndëve kimike bazë²⁴; krijimit të veprimtarive tregtare për transportin dhe shpërndarjen; strukturave të llojit të ndryshëm për administrimin e të ardhurave dhe riinvestimin e tyre), organizatat kriminale që menaxhojnë trafikun e kokainës, që vazhdon të jetë trafiku më i pasur, janë sot në gjendje të kushtëzojnë zgjedhjet ekonomike të Shteteve të tërë.

Sinergjitë operative që vendosen mes organizatave kriminale që veprojnë në vende të ndryshme, sjellin forcimin e mëtejshëm të grupeve të veçanta, hallka të një sistemi të përgjithshëm kriminal dhe ekonomik.

Njëherësh, zhvillimi i metodologjive të përdorura për trafikun e kokainës, vazhdon të shënjojë përmirësim, sidomos në metodologjitë mirëfilltasi operative: nga përmirësimi i sistemeve të komunikimit mes elementëve të ndryshëm funksionalë të trafikut të lëndëve narkotike, në zhvillimin e kërkimit teknik për të gjetur formula të reja për fshehjen dhe

²³ Lëndë që bëhen pjesë e procesit kimik duke qëndruar të bashkuara me molekulën e produktit përfundimtar, që përbëhet nga lënda narkotike.

²⁴ Tretës, reagentë dhe katalizatorë që lehtësojnë procesin kimik pa u bërë pjesë e molekulës së produktit përfundimtar.

transferimin e drogës, deri në përdorimin e kanaleve të sofistikuara financiarë ndërkombëtarë për marrjen e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike.

§ 2.

Treguesit kryesorë që rezultojnë nga hetimet me shtrirje më të gjerë, na japin mundësi të dallojmë disa vende që janë më të ekspozuar ndaj riskut.

Në të vërtetë, analiza e modeleve globale vë në dukje një përqendrim të trafikut të kokainës në Amerikë dhe në Evropë, por më së fundi edhe në Australi dhe Afrikë, ndonëse kjo e fundit si një zonë ekskluzive tranziti dhe magazinimi të përkohshëm.

Përpunimi i skemave dinamike interpretuese shfaqet sidoqoftë më i përshtatshëm dhe më funksional ndaj nevojave për hetim, duke dalluar në to elementë të rëndësishëm dhe duke i plotësuar me treguesit e llojit demoskopik dhe financiar në lidhje me ekzistencën e krimit.

Shembulli i parë i ndërkombëtarizimit të krimit të organizuar italian erdhi me krijimin e njohur të një grupi të *Cosa nostra* në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në krye të shekullit, apo të atij që quhet "*siderno group*" në Kanada, i krijuar nga emigrantë kalabrezë, apo i grupeve kalabreze në Australi, ku u ndërtua një qytet i quajtur "nuova Plati".

Hopi cilësor mes *mafies së vjetër* dhe asaj *bashkëkohore*, mjaft transnacionale, ndodh pikërisht me përhapjen e trafikut të lëndëve narkotike, rreth viteve '70.

Në vitet '80, në ishullin e Karaibeve Aruba, familja mafioze *Caruana – Cuntrera* dhe kartela (grupi) kolumbiane Medellin vendosën të krijojnë një aleancë, duke parashikuar shkëmbimin e heroinës evropiane me kokainën e prodhuar në Kolumbi dhe duke monopolizuar faktikisht, tregun e lëndëve narkotike të Atlantikut.

Sot, panorama ndërkombëtare në këtë sektor të trafikut, edhe për shkak të dukurive gjithnjë e më të shpeshta të *ndotjes* mes organizatave të ndryshme, duket të jetë në ndryshim e zhvillim të shpejtë dhe karakterizohet gjithnjë e më shumë nga sinergji të nevojshme dhe nga aleanca instrumentale grupi, që herë pas here krijohen mes strukturave kriminale të pranishme në Itali dhe jashtë saj. Pra me fjalë të tjera, duket se i gjeget sidomos nevojës për të kërkuar rrugë të reja e më të sigurta, për të përmirësuar shfrytëzimin e tregjeve të paligjshme dhe për të eksperimentuar kanale të papërdorur më parë për rikuperimin dhe riinvestimin e fitimeve të kapitalizuara.

Në Itali dallon një veprimtari e jashtëzakonshme dhe një ripërtëritje e vazhdueshme e aleancave mes grupeve, dhe në veçanti e *'ndrangheta-s*, e cila ka ndikim të madh në krimin e brendshëm dhe, në nivel ndërkombëtar, ka një shtrirje të thellë në pikat kryesore të trafikut të lëndëve narkotike të Evropës dhe të Amerikës së Jugut.

Italia ndër të tjera, për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike të veçantë, duke qenë drejtim i flukseve me origjinë nga Amerika e Jugut, përveç atyre të Afrikës dhe Evropës Jugore, është drejtpërsëdrejti e përfshirë në të gjitha drejtimet e trafiqeve të drogës që kryqëzohen në pellgun e Mesdheut: nga ato të Lindjes së Mesme tek ato me prejardhje nga vendet e tjera evropiane apo drejtpërsëdrejti nga Amerika e Jugut.

Në këtë kuadër, përhapja e grupeve të huaja gjithnjë e më shumë të strukturuar dhe më të rrezikshme për sigurinë publike kombëtare, nxori në pah edhe për trafikun e kokainës, ekzistencën e aleancave kriminale me etni domenikane, nigeriane dhe serbo-shqiptare, përveç atyre tradicionale kolumbiane.

Faktorë të shumtë na bëjnë të mendojmë gjithashtu se është e mundur risjellja e modeleve të integruara, pra që plotësojnë njëri-tjetrin, një farë *joint-venture*, mes anëtarëve të grupeve kriminale shqiptare dhe kolumbiane, për të realizuar në Vendin e Shqiponjave një platformë alternative për magazinimin e kokainës, sipas drejtimeve të caktuara që janë bërë të ditura gjatë hetimeve specifike.

§ 3.

Në të vërtetë, gjithnjë e më shpesh, trafikantët e kokainës përzgjedhin drejtime të pazakonta, më të komplikuar, që sidoqoftë paraqesin më pak rrezik për sekuestrimin e ngarkesave.

Flukset e lëndëve narkotike vazhdojnë sidoqoftë të varen nga parametra kryesisht të konsoliduar, pasi janë më se të përcaktuara zonat e prodhimit të kokainës.

Aktualisht, makroflukset e kokainës prekin çdo kontinent, dhe në veçanti Afrikën, ku organizatat kriminale lokale duhet të magazinonjë sasi shumë të mëdha të lëndës narkotike.

Sidoqoftë, lëndët narkotike të sekuestruara na Itali, vazhdojnë të vijnë kryesisht nga Kolumbia, nga Venezuela dhe Vendet e Karaibeve, përmes:

- *drejtimit latino-amerikan* (nga vendet prodhuese, drejt Argjentinës, Paraguajit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Evropës);
- *drejtimit të Paqësorit të Veriut* (nga vendet prodhuese, nëpërmjet Meksikës, drejt brigjeve perëndimore të Amerikës së Veriut);
- *drejtimi i Atlantikut* (nga Venezuela, Kolumbia, Brazili dhe Argjentina drejt Evropës);
- *drejtimi afrikan* (nga Kolumbia, Peruja, Argjentina dhe Brazili drejt vendeve të Afrikës qendrore-perëndimore).

Elasticiteti i madh i drejtimeve ka të bëjë edhe me mënyrat e transportit, maskimin dhe fshehjen e ngarkesave.

Për ngarkesat e mëdha të kokainës, mjete që përdoret më shpesh vazhdon të jetë ai detar, por vazhdojnë përpjekjet për ta kryer këtë transport me mjet ajror. Zgjedhja e ngarkesave për maskim, në përgjithësi, është e orientuar drejt strukturave të ambalazhimit apo brenda vetë mallrave (mermer, fruta, peshk, dru, etj.), duke përdorur ngarkesën e maskimit (lëkurë, veshje, metrazhe, etj.), duke fituar hapësira të posaçme në faqet e brendshme të kontenerëve, me mënyra që në rast sekuestrimi të drogës, priren të shmangin çdo formë përgjegjësie për spedicionerët dhe shoqëritë referuese.

Për ngarkesat më të vogla, përdoret mjete ajror, persona korrierë (gëlltitje ovulesh me drogë, fund i dyfishtë e i fshehur të bagazheve personale), në rrugë tokësore (në automjete të përgatitura enkas, me hapësira të fshehura në lonzherone, në dyer, në sedilje, në serbatorin e karburantit, në gomën rezervë, në kutinë e kamios, et.) dhe pjesërisht treni.

Teknikave më të sofistikuara të përzierjes me lëndë apo materiale të tjera (polimere të plastikës, etj.,) për nxjerrjen e të cilave organizatat kriminale përdorin ekspertë të proceseve kimike, u shtohen edhe teknika shumë të thjeshta, si për shembull, kavitate brenda bombulave apo pushkëve të zhytjes apo brenda konfeksioneve të produkteve ushqimore.

Faktori që ndikon më fort në ndryshimin e drejtimeve është sigurisht siguria që vjen nga mundësi fshehjeje pranë porteve të nisjes dhe mbërritjes, nevoja për të përdorur shoqëri lundrimi dhe/ose ekuipazhe që bashkëpunojnë dhe, për rrjedhojë, për t'iu nënshtruar drejtimeve të caktuara tregtare.

Kanalet e zgjedhur herë pas here për spedicionin e ngarkesave ndikohen edhe nga marrëveshje grupi mes prodhuesve dhe organizatave blerëse, ndonjëherë nga nevoja për të gjetur zona për magazinim të përkohshëm, jo

larg nga pikat e mbërritjes. Pikërisht në këto nevoja mund të përqendrohen edhe operacionet e mundshme *undercover* të Policisë Gjyqësore.

Ajo çka është mësuar si rezultat i disa hetimeve ka mundur faktikisht të provojë se sa të vështirë e kishin organizatat kriminale që nuk kishin mundësi të kontrollojnë mjetin për të transferuar kokainën, ndërsa strukturat kriminale, me origjinë kolumbiane, kishin madje edhe kontroll të drejtpërdrejtë të shoqërive të lundrimit.

Lidhur me këtë, gjithnjë e më shpesh ka rezultuar të jenë të përfshira grupe greke, të cilat janë të ngarkuara të merren me transportin e drogës në mjete detare.

Gjithashtu, ndër faktorët ndikues, duhet të kujtojmë përdorimin e shkëmbimit, i cili nuk mjaftohet vetëm me shkëmbimin e kokainës me lloje të tjera të lëndëve djegëse (kryesisht heroinë dhe *ecstasy*), por ka të bëjë edhe me furnizimin me armë të terrorizmit ndërkombëtar, edhe sepse këto organizata kanë nën kontroll një pjesë të prodhimit botëror të drogës, si në krahun lindor, ashtu dhe në atë perëndimor.

Së fundi, edhe e sidomos në fushën e telekomunikacioneve, zhvillimi i teknologjisë u ofron sot organizatave kriminale instrumente të sofistikuar, që mund t'u shpëtojnë teknikave të përdorura kundër tyre: steganigrafia (fshehja e një *file* teksti në një figurë, që nga ana e vet transmetohet me e-mail), transmetimi i figurave të një teksti të shkruar (fotografi e një letre të transmetuar me telefon celular MMS dhe "3", duke shfrytëzuar pamundësinë e aparateve në gjendje të kryejnë këtë lloj përgjimi) dhe shifrimi janë vetëm disa prej llojeve më të përdorshëm të sistemeve të përdorur nga organizata e narko-trafikanëve për të mbrojtur përmbajtjen e komunikimeve nga përgjime a zbulime të mundshme.

Përvojat në hetime dhe bashkëpunim ndërkombëtar që janë fituar në këto vite të fundit, kanë bërë të mundur përcaktimin e hallkave funksionale që përdoren nga pjesa më e madhe e organizatave transnacionale me origjinë kolumbiane, që karakterizohen nga:

- *një organizatë leader* në Kolumbi, përgjegjëse për organizimin e trafikut, pronare dhe furnizuese e lëndës narkotike, në gjendje të financojë të gjitha nismat për shtrirjen fitimprurëse të trafikut (krs. Realizimin e platformave logjistike në vende të tjera, funksionale për përhapjen e lëndës narkotike);

- *celula shpërndarëse*, çdonjëra prej të cilave merret, në mënyrë të pavarur, me përcaktimin dhe realizimin e magazinave të fshehta e të përshtatshme (për ruajtjen dhe magazinimin e lëndës narkotike) dhe të blerësve, por që karakterizohen edhe nga bashkëpunimi i ndërsjellë, në kuptimin e furnizimit të ndërsjellë të lëndës narkotike, për t'iu përgjigjur çdo kërkesë që mund t'i drejtohet përgjithësisht organizatës;

- *celula logjistike për realizimin e spedicioneve në rrugë detare*, që përbëhen nga ekspertë në veprimtarinë e import-exportit; kjo gjë realizohet përmes anijeve tregtare të marra me qira apo përkohësisht të blera (për periudhën e nevojshme për një spedition të caktuar e që më pas rishiten), apo të përdorura me mashtrim (ndërkohë që shoqëria pronare e anijes dhe/ose ekuipazhi i saj nuk janë në dijeni). Në dy rastet e para (marrje me qira dhe blerje e përkohshme), përgjegjësit e strukturës logjistike kanë për detyrë të gjejnë ekuipazhin “që pranon” dhe ngarkesën e maskimit, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për ta bërë të besueshëm speditionin tregtar të lejueshëm dhe për të mbrojtur përgjegjësit nga kapja në rast sekuestrimi të lëndës narkotike;

- *supervisorë*, që kanë për detyrë të verifikojnë burimet dhe besueshmërinë e blerësve, të mbajnë lidhjet mes tyre dhe referentëve të *kartelave* apo grupeve furnizuese në Kolumbi, të kryejnë apo jenë të pranishëm, herë pas here, në marrjen e drogës nga magazinat e fshehta, duke verifikuar dorëzimin e rregullt të sasive të porositura; së fundi, të kujdesen për marrjen e të ardhurave përkatëse dhe për dorëzimin tek agjentët e caktuar (*broker*), herë pas herë, nga përgjegjësit e shpërndarjes;

- *brokers (agjentët)*, që kanë për detyrë të tërheqin nga supervisorët (dhe jo drejtpërsëdrejti nga blerësit, për nevoja të qarta të ndarjes në zona) dhe të dërgojnë në Kolumbi të ardhurat nga trafiku, si me dorëzim të drejtpërdrejtë, ashtu dhe përmes operacioneve bankare apo operacioneve të tjera financiare që përcaktohen po prej këtyre operatorëve;

- *përfaqësuesit e bazës*, kryesisht amerikano jugorë, të ngarkuar nga përgjegjësit kolumbianë për shpërndarjen me gjetjen e blerësve në Evropë dhe dërgimin e kërkesave për drogë tek furnizuesit në Kolumbi. Duke operuar në pavarësi të plotë, përfaqësuesit e bazës kujdesen edhe të organizojnë fazat e transferimit të lëndës narkotike tek blerësit, duke përcaktuar lokalitetin më të përshtatshëm, në varësi të sasive të magazinuara në magazinat e ndryshme të fshehta, në vend apo jashtë tij. Disa përfaqësues të bazës, me aftësi operative në sektorin e import-exportit, mund të ngarkohen nga përgjegjësit e shpërndarjes me ruajtjen dhe magazinimin e

partive të kokainës në magazinat e ndërmarrjeve tregtare të kontrolluara. Në këtë rast, atyre u ofrohen dy mundësi:

- të blejnë, pasi të kenë paguar paradhënie një përqindje, gjithë sasinë e magazinuar në magazinën që u përket atyre, duke kryer pagesën e pjesës tjetër pas realizimit të shitjeve në favor të blerësve që gjenden në mënyrë të pavarur apo që u janë rekomanduar atyre nga përgjegjësit e shpërndarjes (që vihen në lëvizje nga të tjerë përfaqësues baze amerikano-jugorë);
 - të merren vetëm me ruajtjen e lëndës narkotike të kontrolluar, duke u bërë vetë ata pronarë të një kuote që është pjesë e gjithë ngarkesës së magazinuar, jo më e vogël se 30% dhe duke lehtësuar veprimtaritë e tërheqjes sistematike të drogës nga ana e supervisorëve, të cilët do të kujdesen për dorëzimin tek përfaqësuesi i bazës, që nga ana e tij është i ngarkuar të merret me transferimin tek blerësit.
- *një celulë e ngarkuar me marrjen e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike, që shpesh vepron si në vendin e destinacionit ashtu dhe në atë të tranzitit, me hallka në vende të tjera, që krijohen nga shoqëri që shpesh përdorin qarqet e pastrimit të parave nga trafiku i lëndëve narkotike.*

§ 4.

Organizatat kolumbiane janë sinonim i prodhimit dhe furnizimit me kokainë, njësoj si grupet kriminale turke dhe kineze të trafikut të heroinës.

Kartelat apo grupet historike të Cali dhe Medellin, të cilave u janë bashkuar me kalimin e kohës mijëra grupe më të vogla, kanë zotëruar gjithmonë potenciale financiare dhe kanë vendosur në Itali qendra të rëndësishme logjistike, të ngarkuara të merren me mbylljen e transaksioneve të drogës me organizata italiane duke realizuar në territorin tonë, edhe fazat përfundimtare të përpunimit.

Në të vërtetë, të shumtë janë treguesit e bashkëpunimit të fuqishëm mes kartelave kolumbiane dhe grupeve kriminale kombëtare apo etnike; i shpeshhtë është përdorimi, në rrugë ajrore, i korrierëve të vendeve të destinacionit të kokainës, ndërsa në transportin e drogës në rrugë tokësore, të gjitha shtetet duket se janë zonë si destinacioni ashtu dhe tranziti për kokainën.

Për sasi shumë të mëdha, kartelat kolumbiane luajnë zakonisht rolin e mbledhjes edhe për vende të tjera prodhuese, duke u kujdesur për ofertën në

tregun kërkues, ndërsa familjet mafioze që janë vendosur në këto territore, sigurojnë kryerjen e transaksioneve.

Siç thamë më lart, spedicionet e kokainës kryhen kryesisht nëpërmjet detit, gjatë drejtimeve që kolauduara me kalimin e kohës: disa prej tyre nga Kolumbia mbërrijnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada dhe në një pjesë të Evropës së Veriut, në veçanti në Belgjikë dhe Hollandë, ku më pas malli shpërndahet në pjesën tjetër të kontinentit evropian; të tjera, nga portet e Venezuelës, mbërrijnë sidomos në Spanjë, vend i privilegjuar edhe për ngjashmërinë gjuhësore dhe kulturore si dhe për ekzistencën e bazave kriminale më se të rrënjosura, ku magazinohen sasi të konsiderueshme, ndërsa subjekte rezidente aty kujdesen për transportin e mëtejshëm në rrugë tokësore.

Po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, si zona transporti dhe magazinimi, vendet e Afrikës qendrore dhe veriore që lagen nga Atlantiku. Së fundi, është vërtetuar se anijet që ngarkojnë ngarkesën e paligjshme nga brigjet e veri-lindjes së Brazilit për të zbarkuar kokainën, pasi përshkojnë Atlantikun, me mjete të shpejta lundrimi apo me peshkarexha që qëndrojnë në Afrikën veri-perëndimore (Senegal, Mauritani dhe Togo). Këto mjete lundrimi, që mbajnë flamur senegalez apo spanjoll, vazhdojnë më pas udhëtimin e tyre deri në Evropën perëndimore, ose kthehen për të magazinuar ngarkesën në vendet afrikane perëndimore, ku presin anëtarë të organizatave kriminale kolumbiane, franceze dhe italiane.

Në Senegal, kokaina që vjen nga Argjentina, Brazili, Kolumbia dhe Peruja mbërrin në rrugë ajrore, me tranzit në ishujt e Kepit të Gjelbër, në Bregun e Fildishtë dhe në Gambi, përmes korrierëve, që në pjesën më të madhe të tyre janë të racës së bardhë dhe/ose metise, e ndonjëherë rezidentë në Evropë. Ndërsa përmes drejtimeve detare, kontenierët me ngarkesa të ndryshme maskimi, pasi tranzitohen për në Ishujt e Kepit të Gjelbër, mbërrijnë në portin e Dakarit. Nga këtu, falë nivelit të lartë të korrupsionit dhe mungesës së kontroleve specifike, një pjesë e lëndës narkotike magazinohet ose ridërgohet drejt porteve të tjera të Evropës së Veriut dhe të detit të Mesdheut si dhe drejt vendeve të Evropës lindore (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Rumania dhe Sllovenia).

Për sasi më të vogla, për të cilat familjet mafioze nuk luajnë asnjë rol ndërmjetësimi, veprimtaritë e furnizimit kohë pas kohe sigurohen nga shtetas kolumbianë që nuk janë anëtarë të *kartelave*. Për sasi të tilla, të transportuara nga vendet e origjinës në Itali në rrugë ajrore, përdoren gjithnjë e më shpesh korrierë të kombësive të ndryshme, ndër të cilët domenikanë dhe nigerianë, ndonjëherë të organizuar në struktura të

mirëfillta të vendosura në Itali, që kanë bashkëpunëtorë të vendosur në vendet latino-amerikane. Në disa raste të tjera, sipas logjikës së tregut, kokaina shkëmbehet me heroinën dhe me armë.

Përvoja e fituar në hetime gjatë viteve të fundit nga karabinierët dhe që është mbështetur gjerësisht nga rezultatet e arritura gjatë operacioneve më të fundit, vë në dukje se si ngjarje gjeografikisht të largëta, janë në gjendje të sjellin pasoja të menjëhershme në skenarët e kriminalitetit të huaj, por edhe të ndikojnë në ata të vendeve të destinacionit.

Në këto rrethana, Kolumbia vazhdon të mbetet partner i privilegjuar i organizatave tona që merren me trafikun e lëndëve narkotike, dhe për këtë arsye, zhvillimi politik dhe social i vendit të prekur nga narko-terrorizmi, pasqyrohet menjëherë në tregun botëror të lëndëve narkotike.

Fenomeni është favorizuar në fakt nga fuqizimi gjithnjë e më i madh i organizatave terroriste të brendshme, dhe aktualisht prodhimi i kokainës kontrollohet për rreth 70% të saj nga *FARK (FARC)* (Forcat e Armatosura Revolucionare Kolumbiane) me rreth 15.000 luftëtarë), për rreth 20% të tyre paraushtarakë (me rreth 12.000 militantë) dhe vetëm një pjesë e vogël nga *UÇK (ELN)* (Ushtria Çlirimtare Kombëtare me rreth 5.000 vetë).

Ndër të tjera duket se nuk ka efikasitet legjislativ i krijuar prej gati pesë vjetësh në Kolumbi, në lidhje me sekuestrimin e pasurive pronë e trafikantëve të lëndëve narkotike dhe të familjarëve të tyre; megjithatë, për angazhimin entuziast dhe bujar që shprehet nga forcat e policisë, të cilat kanë arritur të fitojnë një profesionalizëm të mirë në këtë sektor specifik, mund të mendohet që kjo dukuri do të ketë prirje për tu zmbursur.

Nga të dhënat jo zyrtare të përpunuara nga Policia e Antidrogës kolumbiane, sipërfaqja aktuale e plantacioneve të destinuara për prodhimin e kokainës është e barabartë me rreth njëqind e dyzetë hektarë, ndërsa rreth gjashtëmijë hektarë duket të jenë të destinuar për lulëkuqen e opiumit dhe po kaq hektarë për prodhimin e kanabisit, me një prodhim vjetor prej 800 tonelata kokainë, 7 heroinë dhe 7.500 marjuhanë. Vlerësime të kohëve të fundit flasin për rendimente shumë të larta, të barabarta me më shumë se gjashtëqind herë se vlera e blerjes fillestare.

Ndërsa në lidhje me pozicionin e veçantë gjeografik dhe me afërsinë ndaj vendeve kryesore prodhuese, Venezuela shfaqet pothuaj në të gjitha hetimet në nivel transnacional, si një bazë e mirëfilltë nga ku nisen sasi të mëdha kokaine – përveç sasive të heroinës dhe marjuhanës – duke përdorur të gjitha drejtimet dhe mjetet e mundshme të transportit, dhe në veçanti ato detare.

Për këtë arsye mjetet e transportit tokësor, ajror, detar dhe lumor i zënë vend njëri-tjetrit në kërkim të zgjidhjeve e mundësive gjithnjë të reja: nga përdorimi i kamionëve që vijnë nga Kolumbia dhe që janë të përgatitur me fund të fshehtë apo ngarkesa me produkte frigoriferike që u ulin riskun e kontrollit, deri në lançimin e objekteve pluskues e hermetikë nga avionë turistikë, të cilët rikuperohen më pas nga motoskafe të shpejtë në zona detare ose lumore, fantazia kriminale e organizatave kryesore furnizuese nuk ka kufi.

Jashtëzakonisht të sofistikuar duket të jenë teknikat e magazinimit, me groposje të ngarkesave të drogës në gropa, që gërmohen brenda në *kolona* ose në *pyll*. Vetëm pas përfundimit të negociatave, sasi të lëndës narkotike u dorëzohen blerësve, zakonisht duke shkuar në porte të caktuara ku ndodhen edhe mjete të fuqishme lundrimi. Nga portet tregtare të La Guaira dhe Puerto Cabello, të dyja porte që kanë rezultuar nga hetimet më të fundit të kryera nga R.O.S. dhe nga D.C.S.A., shoqëri tregtare në sektorin e import-exportit ofrojnë më pas maskim për ngarkesat që, pasi kanë kaluar tranzit përmes ishujve të Karaibeve, marrin drejtim për nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm, që sigurisht deri tani është mbajtur më pak parasysh, del nga sekuestrimet e kohëve të fundit të sasive të mëdha të prekursorëve kimikë të transportuar në vendin e caktuar, përgjithësisht përmes lumit: në fakt, nuk përjashtohet fakti që nga Venezuela të nisen sasi të mëdha të këtyre lëndëve për të mbërritur më tej, përmes Orinokut, në Kolumbi, ku veprojnë laboratorë klandestinë.

Ia vlen të përmendim këtu debatin e Asamblesë Kombëtare të Venezuelës për miratimin e një ligji organik mbi krimin e organizuar, që parashikon mundësinë për të kryer operacione në maskim dhe të dorëzimit të kontrolluar, dhe një legjislacion specifik për monitorimin e prekursorëve dhe të lëndëve kimike bazë.

Këto problematika përfshijnë edhe Argjentinën e cila, ndonëse nuk është një vend prodhues, sidomos në zonën veriore karakterizohet nga trafiqe të mëdha të drogës, që ndihen fort nga kushtet gjeografike dhe nga numri i pakët e mjeteve të përdorura nga forcat e armatosura të policisë për të monitoruar fluturimet e ulëta të avionëve turistikë që përdorin pista private dhe/ose klandestine.

Shtimi i numrit të korrierëve me kombësi argjentinase ka shumë të ngjarë të jetë ndikuar edhe nga kriza ekonomike që rëndoi mbi mbarë vendin.

Futja e kokainës në Argjentinë ndodh kryesisht nga Bolivia dhe, vetëm në një masë më të vogël, nga Kili, Paraguaj dhe Brazili, përmes rrugëve tokësore ose, ndryshe, ajrore. Në përgjithësi, pas magazinimit, lënda narkotike transportohet për në Evropë ose në Afrikën e Jugut, nga ku vazhdon sidoqoftë drejt vendeve evropiane, Azisë dhe Australisë, përmes korrierëve që hipin në avionë ose anije, pakove postare dhe ngarkesave tregtare të transportuara përmes detit.

Kjo prirje konfirmohet edhe nga përfundimi i sekuestrimeve kryesore të kryera në Argjentinë gjatë vitit të fundit: lloji i lëndës narkotike të sekuestruar në fakt është i klorhidruar me kokainë, gjë që të bën të mendosh se laboratorët klandestinë për përpunimin e kokainës në Argjentinë nuk janë në funksionim, me përjashtim të atyre që ndodhen gjatë vijës kufitare me Bolivinë.

Megjithatë, nga informacione të policisë, në territorin argjentinase duket se kalojnë edhe kontenerë që vijnë nga Paraguaj dhe që janë të destinuar të shkojnë në vende të treta ku, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk u nënshtrohen kontrolleve doganore.

Në kuadrin e programit të sigurisë së qeverisë aktuale argjentinase, flitet shumë e veçanërisht për luftën kundër fenomenit të trafikut të lëndëve narkotike dhe plani përkatës i veprimit parashikon fuqizimin e njësisive të luftës, krijimin e një organi gjyqësor të përbërë nga magjistratë të specializuar në sektorin specifik dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

Edhe në Brazil trafiku i kokainës është në rritje: vendi është shndërruar në një platformë për magazinimin e sasive të mëdha, një zonë e rëndësishme për kalimin tranzit për tregjet përfundimtare dhe një lloj rezervuari që ushqen me krahë pune dhe mundëson rekrutimin e korrierëve, si brazilianë ashtu dhe të huaj, me rrugë dhe mënyra transporti të ndryshme.

Duhet përmendur këtu edhe vendosja e organizatave kriminale furnizuese në zonën veriore të vendit dhe, në veçanti, në territorin e pyllit brazilian të Amazonës, në afërsi të lumeve Iqà, Lana, Amazonas, Japurà, Waupés dhe Negro. Ndër të tjera, në këtë vijë, në zonat kufitare me Perunë, Kolumbinë dhe Venezuelën ekzistojnë kultivime të vogla të *epadusë*, një varietet i kokainës me princip të ulët aktiv, që konsumohet nga indiosit.

Ndërsa për trafikun, pozicioni i favorshëm gjeografik i Brazilit ndikon në mënyrë përcaktuese mbi rolin që luan ky vend që, përveç se rezulton vendi i dytë konsumator në botë, përbën një pikë kalimi natyrore për të transferuar drogën drejt tregjeve ndërkombëtare.

Kokaina futet në Brazil nëpërmjet rrugës tokësore, lumore dhe ajrore nga Bolivia, Peruja dhe Kolumbia, si për të plotësuar kërkesën e brendshme, ashtu dhe për të qenë sërish e destinuar për në tregun evropian dhe atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës: nëpërmjet detit për ngarkesat më të mëdha dhe nëpërmjet tokës për ato më të vogla.

Sipas rezultateve të hetimeve të kryera nga policia braziliane, shpesh nuk ekziston një ndarje e qartë mes veprimtarive tregtare të ligjshme dhe trafikut të drogës, aq sa shpesh operatorë të njohur ekonomikë rezultojnë se ofrojnë maskimin për transportin e drogës apo kanalet për riinvestimin e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike. Lidhur me këtë, monitorime të kohëve të fundit mbi ecurinë e flukseve financiare në Brazil kanë mundësuar evidentimin e rritjes së ndjeshme të agjencive bankare në rajon si ajo e Amazonës, Rondonisë dhe Akres, që sigurisht nuk karakterizohen nga një zhvillim paralel dhe po aq i lulëzuar ekonomik.

Rekrutimi i korrierëve, kryesisht afrikanë dhe evropianë, tanimë ndodh pothuaj vetëm në Kontinentin e Vjetër, pra në Evropë, si për të shmangur kontrollet doganore, ashtu dhe për shkak të shkëmbimeve tashmë të konsoliduara të *ecstasy* apo amfetaminave për të marrë kokainë ose heroinë.

Rrugët më shumë të përdorura nga korrierët, sidomos të papunë, apo në vështirësi të mëdha ekonomike, shkojnë drejt Lisbonës dhe Madridit.

Nga ana tjetër, shpërndarja e drogës në Rio de Zhaneiro dhe në San Paolo, rezultojnë të kontrollohet nga organizatat kriminale (*Primo Comando della Capotale – PCC (Komanda e Parë e Kryeqytetit), Comando Vermelho dhe Terceiro Comando*) që, në qytetin e parë, kanë marrë përsipër një kontroll të hollësishëm, madje duke nxitur manifestime proteste (mbyllje të përkohshme të ushtrimeve tregtare në lagje të tëra) gjatë ndërhyrjeve ndëshkuese të policisë dhe magistraturës, në të dytin merren drejtpërsëdrejti me shpërndarjen e madhe në tregjet e huaja, pa vendosur ndarje të ngurta influence për grupet më të vogla të ngarkuara të merren me shpërndarjen me pakicë.

Duket se përfaqëson një rast më vete Republika Domenikane që, përveç faktit që nuk është një ndër vendet prodhuese, përfaqëson edhe një treg të vogël për trafikun e lëndëve narkotike.

Në fakt ky vend përfaqëson një rrugë të rëndësishme alternativë për transportin e drogës së destinuar për tregun e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe, ndonëse në një masë më të vogël, për tregun evropian. Përtej pozicionit të favorshëm në qendër të dy Amerikave, ekzistenca e organizatave kriminale të integruara nga domenikanë, portorikanë dhe

kolumbianë, të aftë të vendosin lidhje me grupe të tjera kriminale, përmes shtrirjeve në SH.B.A. (Nju Jork, Boston dhe San Huan) dhe në shumë vende të B.E.-së, ndër të cilët Italia, që luan një rol vendimtar. Nga analizat e situatës të përgatitura nga *UNODC* (United Office on Drugs and Crimes), përgjithësisht çdo vit kalojnë nga Karaibet rreth 250 tonelata kokainë që shkojnë drejt Majemit dhe Nju Jorkut, ndërsa 180 tonelata të tjera janë të destinuara për në Evropë. Mënyrat e përdorura nuk janë shumë të ndryshme nga modulet e konsoliduara:

- spedicione nëpërmjet korrierit apo përmes hedhjes në det të pakove që përmbajnë lëndë narkotike, të transportuara me avionë që fluturojnë ulët për t'iu shmangur kontrollit të radarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe që më pas rekuperohen nga mjete të vogla lundrimi dhe/ose motopeshkarexha;
- mjete detare, motoskafë të shpejtë për të transferuar ngarkesat nga brigjet e afërta kolumbiane dhe venezueliane në ishujt e Karaibeve ose, për ngarkesa më të mëdha, përmes kontenierëve të imbarkuar në anije të mëdha tregtare transoceanike.

Në krahun afrikan, Nigeria, komb me popullsi të madhe që shquhet për një paqëndrueshmëri të fortë politike dhe nga një multietni e theksuar, ndahet në grupe etnike mazhoritare të myslimanëve HAUSA dhe në grupe të të krishterëve YOROBA dhe IBO. Për shkak të kushteve të vështira socio-ekonomike dhe luftërave fetare, janë larguar nga vendi drejt vendeve më të zhvilluara flukse të mëdha emigrantësh (si drejt kontinentit afrikan ashtu dhe drejt vendeve të Bashkimit Evropian dhe, në veçanti drejt Italisë). Ndër të tjera, vërehen shtrirje të organizatave kriminale nigeriane në panoramën botërore, nga Londra deri në Nju Jork, përmes Singaporit dhe San Paolos, për të përfunduar kështu në vendet e Evropës lindore. Jashtë Nigerisë, nigerianët eksportojnë një kriminalitet të shtrirë apo pervaziv, i cili ka lidhje të fuqishme me kriminalitetin nigerian në vend.

Nigeria, ndonëse nuk është një nga vendet prodhuese të drogave të rënda, është skenë e një trafiku të ngjeshur të kokainës, përveç trafikut të heroinës, duke qenë udhëkryq kyç për drogën në Afrikë, duke shfrytëzuar të rinjtë, një krah pune i shumtë në numër. Në përgjithësi, ngarkesat me lëndë narkotike vijnë nga Brazili, Kolumbia, Pakistani ose nga Tailanda, me destinacion Evropën dhe Shtetet e Bashkuara.

Përveç marrëdhënieve të konsoliduara mes nigerianëve dhe organizatave kolumbiane dhe boliviane për transportin e kokainës, është vërejtur kohët e

fundit nga Brazili një drejtim i ri i korrierëve afrikano-jugorë që vepronin ndërmjet San Paolos dhe Johaneshburgut, pasi ishin rekrutuar më parë nga organizatat nigeriane në Hollandë.

Falë pranisë ushtarake të Nigerisë në Liberi, për shembull, porti i lirë i Monrovisë u shndërrua në një pikë shpërndarjeje. Trafikantët përfitojnë edhe nga emigracioni në vendet fqinjë për të furnizuar tregjet lokale (në veçanti atë të Lomesë, Dualasë, Kotonusë, Niamejit ose N'Djamenës).

Në këto rrethana, rëndësi të veçantë merr Afrika e Jugut, nga ku kalon pothuaj 3% e trafikut ajror botëror; sipas vlerësimeve të *South African Narcotics Bureau* (SANAB), trafikantët nigerianë, afrikano-jugorë, libanezë dhe izraelitë duhet të kenë konvertuar për trafikun e lëndëve narkotike rrjetet e kolauduara të kontrabandës së armëve, fildishit dhe gurëve të çmuar. Në veçanti, korrierët nigerianë shkojnë nga Afrika e Jugut në Brazil me fluturime tregtare të drejtpërdrejta, duke përdorur pasaporta afrikano-jugore të falsifikuara, dhe e shpien kokainën në Afrikën e Jugut për ta dërguar më pas në Gjermani, Itali, Luksemburg, Vendet e Ulëta dhe Zvicër.

Interesi i organizatave nigeriane duket se po zhvendoset nga trafiku i heroinës tek ai i kokainës, duke iu drejtuar tregut më fitimprurës evropian. Në veçanti, kokaina transferohet në vendet që tradicionalisht kanë qenë prodhues drejtpërsëdrejti në SHBA dhe në Evropë, duke përdorur ndihmën teknike të dhënë nga bashkëkombës që qëndrojnë në mënyrë të rregullt dhe të përhershme në Amerikën e Jugut.

Flukset e të ardhurave nga trafiku i drogës drejtohen për në Nigeri ose jashtë saj, përmes *Money Transfer* ose përmes korrierëve, duke u rinvestuar në trafikun e lëndëve narkotike ose duke u konvertuar në automjete me cilindratë të madhe, që më pas eksportohen në Nigeri.

Edhe Maroku, vendi që zë vendin e parë si prodhues i *hashashit* dhe derivatëve të *cannabis indica*, sipas analizës së gjendjes aktuale të përgatitur nga eksperti i antidrogës së D.C.S.A. në Rabat, po fiton gjithnjë e më shumë rolin e një vendi tranzit të kokainës së magazinuar në Afrikën perëndimore dhe që i drejtohet Evropës, ku Spanja vazhdon të konsiderohet një nga pikëmbërritjet më të rëndësishme.

Në krahun lindor, Hong Kongu, duke mos qenë një koloni britanike që nga korriku i vitit 1997 u bë një nga provincat e Kinës Popullore, por vazhdon të ketë sidoqoftë regjimin ekonomik dhe administrativ të impostuar sipas modelit anglez. Zona dhe Administrimi i Posaçëm dallojnë nga fakti që janë *leader* botëror në shpërndarjen e kontenierëve dhe konsiderohen

aeroporti i dytë botëror për tranzitin e mallrave dhe personave. Edhe për këtë arsye, u bë një nga qendrat më të rëndësishme për administrimin, magazinimin dhe shpërndarjen e drogës. Për sa i takon trafikun të kokainës, lëndë narkotike tejet e kërkuar nga përdoruesit lokalë të drogës, Hong Kongu bëhet jashtëzakonisht i rëndësishëm për shkak të grumbullimit të kapitaleve shumë të mëdha që krijohen nga trafiku i lëndëve narkotike. Organizatat furnizuese kolumbiane parapëlqejnë t'i pastrojnë të ardhurat nga trafiku i lëndëve narkotike përmes kanaleve bankare dhe financiare të Hong Kongut, ku ndër të tjera, sipas të dhënave të Financial Bureau, shkëmbimi i heroinës me kokainën si dhe furnizimi nga Kina i prekursorëve kimikë që duhet të përdoren më pas në fazat përkatëse të përpunimit është gati shumëvjeçar. Flukset e trafikun të kokainës mbërrijnë nga Amerika e Jugut, me mjete ajrore apo detare, duke kaluar kështu nëpër vendet e Azisë, të Oqeanisë dhe të Evropës.

Një terren i mirëfilltë të cilin e synojnë organizatat terroriste kriminale, që shpesh janë të lidhura me ato terroriste, është sot Kamboxhia, një teatër i operacioneve të pastrimit të parave të ardhura nga trafiku i lëndëve narkotike të cilat realizohen në sajë të lulëzimit të kazinove në kryeqytetin kamboxhian dhe për shkak të lehtësisë mjaft të madhe për të hapur e mbyllur institute ndërmjetësimi të kredisë, jetëgjatësia e të cilëve mbaron edhe vetëm me kryerjen e një operacioni financiar të vetëm. *Afere* që vështirë se do administroheshin në Tailandë apo në vende të tjera të juglindjes aziatike, mund të realizohen me kaq lehtësi në Kamboxhia.

Magazinimi i sasive shumë të mëdha të kokainës, e importuar sidomos nga organizata kamerunase dhe nigeriane që janë vendosur në Pon-Pen, ndodh në krahinën veriore të vendit (Siam Riep) dhe në zonat bregdetare të Sihanukvilles.

Gjithashtu, sipas informacioneve të marra nga rrethi i bashkëpunimit ndërkombëtar, disa ngarkesa lëndësh narkotike që janë të destinuara për tregun evropian, ka të ngjarë të kalojnë përmes portit të Gioia Tauro (në Rexhio Kalabri (Itali)).

Analiza e të dhënave të marra nga shërbimet e sigurimit ka vënë në dukje edhe rritjen e investimeve në veprimtari infiltrimi të kryera në Tailandë nga ana e organizatave amerikano jugore të pranishme në rajon, të cilat shënjojnë edhe rritjen e trafikun të kokainës.

Dhe së fundi përmendim shkurt Poloninë, ku portet që dalin në Detin Balltik si Stettino, Danzica Gdynia dhe Sopot vazhdojnë të shërbejnë,

përveçse për trafikun dhe magazinimin e sasive të mëdha të heroinës, edhe për furnizimet e kokainës të marra nga organizata amerikano jugore që, duke përdorur kontenierë të transportuar nga mjete detare, i dërgojnë ngarkesat nga Argjentina, Kolumbia, Peruja dhe Venezuela, duke i magazinuar më tej në Poloni, në pritje për t'i shpërndarë në vende të tjera evropiane.

Siç e thamë të lart, në Itali, analizat e kryera gjatë viteve të fundit në sektorin e trafikut të lëndëve narkotike, konfirmojnë epërsinë e organizatave kalabreze, në mënyrë të veçantë, të atyre që ndodhen gjatë bregut jonik-rexhiokalabrez, të cilat kanë prej kohësh referentë fiks dhe me baza si në vendet prodhuese, ashtu dhe në ato të tranzitit të kokainës.

Përmes degëzimeve të shtrira në territorin kombëtar dhe lidhjeve të qëndrueshme e funksionale me organizata kriminale me bazë siciliane, kampane (qarku me kryeqendër Napolin) dhe puljeze, *'Ndrangheta* drejton dhe fetë të madhe të trafikut italiane të lëndëve narkotike, nga faza e importimit deri tek ajo e shpërndarjes përfundimtare, duke përdorur degëzimet e veta edhe për mbledhjen dhe riinvestimin e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike. Të çuditshme në lidhje me këtë janë ndërveprimet, siç ka rezultuar nga hetimet, mes strukturave kriminale kataneze (Sicili) që i përkasin *Cosa Nostra* dhe përfaqësuesve të organizatave kalabreze të bregdetit jonik, që kanë krijuar konsorciume të mirëfillta, edhe për rekuperimin në det të sasive të mëdha të lëndëve narkotike, përmes sistemit të të ashtuquajturve pika të anijeve dhe përdorimit të anijeve peshkarexha.

Kalimi, nga veprimtaritë tradicionale parazitare në trafikun më fitimprurës të lëndëve narkotike, nuk mund të mos mbështetet në lidhjet e gjera e të forta të *'Ndrangheta-s* me *filialet* e veta përtej oqeanit, të cilat janë krijuar nga grupe kalabreze rezidente, prej shumë vjetësh, në vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada apo Australi. Gjithashtu, konsiderohet se këto organizata janë shumë të pranishme edhe në vende si Argjentina, Franca, Gjermania, Holanda, Belgjika dhe Spanja.

Ndërsa në rrjetin shpërndarës kombëtar *përfaqësuesit vendas* të *'ndrangheta-s* del se kanë prej kohësh epërsi mbi të tjerët dhe vazhdojnë më tej punën e tyre të proselitizimit përmes thithjes së grupeve të tjera, të cilat shërbejnë vetëm për shpërndarjen, dhe elementi që shquhet për më shumë egërsi në kërcënim, është prania e fortë e organizatave kalabreze brenda qarqeve më të kualifikuara ndërkombëtare.

Dhe është pikërisht kjo aftësi e jashtëzakonshme për të krijuar marrëdhënie me organizata kryesore botërore, e në veçanti me *kartelat* kolumbiane dhe organizatat terroriste (F.A.R.C. dhe paraushtarakë të Audefensas Unidas de Colombia) që në Kolumbi marrin pjesë bashkërisht në veprimtari të prodhimit dhe furnizimit të drogës, faktor i cili i ka dhënë mundësi *'ndrangheta-s* të fitojë rëndësi absolute në sektorin e trafikut të kokainës në rrafsh ndërkombëtar, ndërsa në atë kombëtar, shënjohe bashkëpunime me grupeve me bazë kamorriste.

Në këto rrethana, del të jetë vendimtar roli i *brokerave*, në lidhje shumë të ngushtë me grupet kryesore furnizuese kolumbiane, të cilat rezultojnë të jenë në gjendje të përshtatin kërkesën me ofertën, në sajë të njohjes shumë të thellë të dinamikës së trafikut të lëndëve narkotike dhe të besueshmërisë që gëzojnë organizatat që ata përfaqësojnë. Ky rol luhet si nga elementë historikë, ashtu dhe nga persona më pak të njohur në aspektin mirëfilltasi kriminal, por që janë në gjendje krijojnë e mbajnë lidhje të një niveli jashtëzakonisht të lartë me grupet kolumbiane dhe të propozohen para tyre si ndërmjetës për sasi të mëdha importi edhe në kontinente të tjera, si Australia, ku veprojnë referentët e tyre të përhershëm.

Në një analizë të fundit, mund të themi se karakterizimi i grupeve kryesore të *'ndrangheta-s* vjen nga marrëdhëniet e fuqishme me *kartelat kolumbiane* më të rëndësishme, në lidhje me të cilët zhvillimi ndërkombëtar ka mundësuar shtrirjen e rrjeteve më të sofistikuara të fshehjes dhe përpunimit të teknikave të disimulimit dhe të riinvestimit. Kjo vlen edhe ndaj strukturave napoletane ose puljeze, që, brenda hapësirës më të ngushtë Shenghen, e sidomos në Hollandë e në Gjermani, kërkojnë të vendosin përmes përfaqësuesve të tyre lidhje me *brokerat* ose celulat e grupeve kolumbiane, për të realizuar importime më të segmentuara.

Edhe klanet e *Kamorrës* napoletane rezultojnë të kenë pasur gjithnjë lidhje dhe afere me furnizuesit kryesorë amerikano-jugorë të kokainës. Për shembull, prej vitesh, klani i njohur Fabbrocino është i pranishëm në Amerikën e Jugut, sidomos në Venezuelë dhe në Paraguaj, duke rritur më tej interesat e tyre kriminalë dhe ekonomikë dhe duke kërkuar përsëri lidhje të drejtpërdrejta me *kartelat* e trafikut të lëndëve narkotike dhe degëzimet e tyre në Evropë.

Në këtë kuadër, porti i Salernos vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm, si kanal i privilegjuar hyrjeje për lëndën narkotike që është e destinuar për

tregjet klandestine italiane dhe evropiane, siç konfirmuar edhe nga sasitë e mëdha të sekuestruara vazhdimisht nga Forcat e Policisë.

Krijimi i lidhjeve të pavarura me furnitorët e mëdhenj amerikano-jugorë ka bërë të mundur që organizatat kamorriste të kenë edhe një rol ndërmjetësimi në trafikun e kokainës, drejt veriut të Evropës dhe Gjermanisë në veçanti.

Në këto rrethana, ndihet e madhe prania e kamorristëve napoletanë në Spanjë, që vazhdon të jetë pikë kyç mes Amerikës së Jugut dhe Evropës për sa i takon trafikun të kokainës.

Megjithatë, ndryshe nga sa thuhet në pohimet tradicionale të burrave të besës në lidhje me një kundërshti që supozohet të jetë mes mafies dhe botës së trafikun të lëndëve narkotike, merr pjesë edhe *Cosa nostra*, ndonëse *kultivohet* pothuaj vetëm nga elementë që tradicionalisht janë marrë me veprimtari të paligjshme, përbën për këto organizata burimin më të madh të fitimit.

Në të vërtetë, ndërsa me drejtimin e drejtpërdrejtë të tregtisë së paligjshme merren organizata të tjera italiane dhe të huaja, shumë më të pranishme në treg, e ndryshme është situata në kuadrin e investimeve financiare të trafikun të lëndëve narkotike, ku vendosen lidhje mes strukturave kryesore të kriminalitetit botëror dhe rëndësia e *Cosa Nostra* vazhdon të mbetet e madhe, siç dëfton edhe niveli i arritur në nivel ndërkombëtar nga *familja venezuelane* e *Cosa Nostra* në krye të të cilës qëndrojnë të njohurit Pasquale CONTRURE dhe Alfonso CARUANA, me prejardhje siciliane (AG).

Niveli kriminal i familjes argjentinase që është shtrirë me veprimtarinë e vet në të paktën tri kontinente, ka bërë që jo rastësisht ithtarët e CARUANA-CUNTRERA të quhen nga shtypi ndërkombëtar *Rotschild*-ët e drogës.

Ndër të tjera u mvishet grupeve CARUANA-CUNTRERA sekuestrimi më i madh i lëndës narkotike që është kryer deri tani në Itali: 5.400 kilogramë kokainë të sekuestruara, në vitin 1994, në Borgaro Torinese (TO) dhe që bëjnë pjesë në një trafik të përgjithshëm të më shumë se 12.000 kilogramë.

Ende sot kemi arsye të besojmë se, ndonëse janë dhënë dënime të rënda për krerët e grupit, dy familjet vazhdojnë të menaxhojnë veprimtari të

mëdha të paligjshme, duke mbajtur lidhje të forta me *Cosa Nostra* të Palermos dhe Agrixhentos.

§ 5.

Përsa i takon pastrimit të parave dhe rinvestimit të të ardhurave nga trafiku i kokainës, janë domethënëse rezultatet më të fundit të hetimeve në lidhje me operativitetin e qendrave të ndërmjetësimit ekonomiko-financiar të krijuara në vend nga shoqëri që, duke u mbështetur në profesionistë, janë në gjendje të garantojnë menaxhimin e kapitaleve të lëndës narkotike, në fakt karakterizohen vazhdimisht nga mungesa në dukje e lidhjeve mes organizatave të ndryshme që bashkëpunojnë me njëra tjetrën, duke u bërë në këtë mënyrë absolutisht të padepërtueshme. Qarkullimi i të ardhurave nga trafiku i drogës bëhet përgjithësisht përmes negocimit të garancive bankare dhe të sigurimeve që kryhen me anë të sistemeve të sofistikuar bankare, rinvestimit të kapitaleve të lëvruara të barazvlefshme me ato që duhen pastruar, me mosmbulimin e kredive dhe me marrjen për rrjedhojë të garancive nga ana e bankave kredidhënëse.

Lidhur me këtë, përveç teknikave tradicionale të pastrimit të parave, që nuk janë braktisur asnjë herë nga organizatat kriminale, është monitoruar së fundi një sistem kompleks për qarkullimin e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike. Përmes një sërë veprimesh bankare në *vende offshore*, krijohet, për llogari të një "*Shoqërie*", që vepron në Itali dhe kontrollohet nga organizata, likuiditet për shuma të barazvlefshme me ato që duhet të pastrohen (kryesisht në bankat e Hong Kongut dhe të Singaporit). Këto shuma, pas disa veprimesh të kryqëzuara bankare ndërmjet disa instituteve kredidhënëse të Singaporit, Zelandës së Re dhe Australisë, shkonin në një llogari rrjedhëse australiane, që i takonte personit referent të organizatës në atë vend. Në lidhje me veprimtari paralele import-exporti, referentit italian të institutit australian të përfshirë i kërkohet një financim i kundërgarantuar nga kapitale që tashmë ishin bërë të disponueshëm nga referenti i organizatës jashtë vendit. Së fundi, pasi verifikohet ekzistenca e tyre, instituti bankar australian lëvronte financimin për një shumë të barazvlefshme me garancitë e dhëna: mosrimbursimi i huasë, së dhënë në Itali, ligjëronte pretendimin e Institutit lëvruar mbi garancinë, duke plotësuar konkretisht pastrimin e kapitaleve të paligjshme.

Të vepruarit e mekanizmave kaq të sofistikuar të ndërmjetësimit sjell gjithnjë përfshirjen e specialistëve që janë në gjendje të garantojnë një menaxhim profesional të procedurave në fjalë. Gjithashtu, për globalizimin

e tregjeve dhe procesin e financiarizimit të kapitaleve të organizatave kriminale, këto të fundit parapëlqejnë *parajsat financiare off shore*, apo qendrat që janë përfshirë në të ashtuquajturën *black list (listën e zezë)* të hartuar nga Qeveria italiane që nga vitit 1992, të cilës i referohen zakonisht edhe autorët e mashtrimeve në dëm të Shtetit apo të komunitetit ndërkombëtar, si dhe autorët e krimeve fiskale dhe tatimore.

Në këto rrethana, rezultatet më të rëndësishme të hetimeve vënë në pah se disa prej këtyre vendeve kanë fituar me kalimin e kohës një specializim të theksuar si në sektorin bankar ashtu dhe në atë të shoqërive dhe financiar, duke ofruar paketa të kualifikuara shërbimesh, ndërsa të tjerë, të cilët përfaqësojnë të ashtuquajturat *qendra emergjente*, janë ende në kërkim të metodologjive që u mundësojnë atyre përfitim të një përqindjeje të majme të transaksioneve.

Sot, klasifikimi i ri mbi rrezikshmërinë e vendeve të ndryshme i cili është adoptuar nga *Off shore Banking Supervisor* u ka zënë vendin analizave dhe klasifikimeve të mëparshme. Por, pavarësisht nga ndarjet e bëra në varësi të treguesve të përcaktuar, shfaqen tipare të përbashkëta ndër të cilët dallohen: niveli shumë i ulur i taksave për çdo transaksion; garancia absolute e sekretit bankar dhe tregtar; shpejtësia e veprimeve financiare e lejuar nga kuadri ligjor i brendshëm përkatës; pamundësia për të kërkuar ndihmë gjyqësore nga ana e vendeve të interesuara; pozicioni i favorshëm gjeografik, pothuaj gjithmonë ishullor; kursi i përshtatshëm i këmbimit dhe mundësia për të tregtuar valuta të tjera pa kufizime të llojit.

Por transferimi i të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike mund të kryhet edhe përmes veprimeve të rreme apo reale të import-exportit. Duke lëshuar fatura të rreme në lidhje me veprime tregtare me jashtë drejt një tjetër vendi, të cilat nuk ekzistojnë dhe janë të barazvlefshme me shumat e transferuara, apo duke blerë, përmes shoqërive të kontrolluara dhe drejtpërsëdrejti në vendet e destinacionit të mira apo lëndë të para, që më pas transferohen në zonat e prejardhjes së lëndës narkotike dhe paguhen në të holla.

Ky qe rasti i shoqërive që vepronin në sektorin e tregtisë me shumicë dhe me pakicë të metaleve të çmuara, të përpunuara e gjysmë të përpunuara apo krejt të papërpunuara, të skorieve dhe nënprodukteve, siç rezultuar nga shumë veprimtari hetimore që bënë të zbulohet një sistem i kolauduar dhe i përsëritshëm që, përmes importimit të metaleve nga jashtë vendit dhe

faturimit të rremë ose mbifaturimit të veprimeve tregtare, bënte të mundur marrjen e të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike.

Edhe pastrimi i parave përmes shërbimeve të ofruara nga disa *Off shore profit center* në Internet përbën një faktor konkret risku: librezat elektronike të prurësit, kartat e kredisë në llogari anonime që kryesisht janë disponibël në vendet e Evropës lindore, letërnjoftime dhe pasaporta dhe tituj honorifikë. Keto janë vetëm disa nga mundësitë me të cilat përballet pastruesi i parave duke përdorur rrjetin e Internetit, ku çdo veprim lëvizjeje i kapitaleve në rrjetin telematik mund të përfaqësojë një tufë *bit*-esh destinuar përpunuesve të instituteve të kredisë të shtrirë në mbarë sipërfaqen e globit. Sistemet e *cyberpagesës* zhdukin sot problemin më të madh të pastrimit të parave krijuar nga vështirësia e qarkullimit fizik të sasive të jashtëzakonshme të parave. Kështu, edhe një herë hyn në lojë aftësia kriminale e pastruesit të parave për të shfrytëzuar në avantazh të vet dallimet mes standardeve të sigurisë mes një vendi e një tjetri, si përmes sistemeve të bazuara në përdorimin e rrjeteve telematike ashtu dhe zgjidhjeve që mbështeten në magazinimin e vlerave në karta inteligjente apo në *smart card*.

Së fundi, teknika më e vjetër dhe artizanale për transportimin e valutës jashtë vendit rezulton të jetë përdorimi i korrierëve, që ka sigurisht avantazhin për ta ndërprerë gjurmën që krijon lidhjen mes veprimtarisë prodhuese të parave me vendosjen e tyre në sistemin financiar.

Më në përgjithësi, nga analiza e sistemeve të përdorura për pagesën e furnizimeve të kokainës, shfaqet si një faktor i përbashkët, dallimi absolut mes flukseve të parave dhe atyre të drogës. Në të vërtetë ndahet dhe shihet më vete koha e riinvestimit nga ajo e trafikut. Kjo gjë ka bërë të mundur krijimin e figurave profesionale të veçanta që, duke u përfshirë plotësisht nga konteksti kriminal tradicional, merren vetëm me pastrimin e të ardhurave.

Edhe përdorimi i strukturave të *Money Transfer* (që shpesh janë të lidhura me *Phone Centers*) është dokumentuar gjerësisht në hetime të shumta të kryera ndaj grupeve kriminale që merren me trafikun e kokainës. Ky qark siguron në të vërtetë jo vetëm shpejtësinë e transaksionit, por edhe mundësi të mëdha fshehjeje: raportimi i mundshëm i veprimit të dyshuar kryhet nga agjencia financiare dhe nga operatorët e fundit, por, në praktikën aktuale, kjo gjë përbën një mundësi krejt teorike. Përdorimi i *Money Transfer* nga

ana e organizatave kriminale nigeriane të pranishme në vendin tonë, është provuar gjatë veprimtarive hetimore dhe gjyqësore, ndonëse lëvizja valutore me këtë instrument nuk duket të jetë shumë e lartë.

Përfituesit e derdhjeve nuk janë nevojshëmërisht rezidentë në Afrikë apo, në veçanti, në Nigeri, por në vende të Bashkimit Evropian, sidomos në Itali dhe Holandë, në Shtetet e bashkuara dhe në Kanada, duke konfirmuar ekzistencën e lidhjeve të gjera ndërkombëtare.

Në Itali, pikërisht në lidhje me fluksin e emigracionit, kemi parë një përhapje tejet të madhe të njësive financiare të *Money Transfer*, si *Western Union* dhe *Money Gram107*, që për të përshpejtuar afatin e dorëzimit të parave, përdorin një rrjet nën-agjentësh ose personash të nënautorizuar, të cilët tashmë janë të pranishëm pothuaj në çdo vend të botës.

Ndër vendet që preken më shumë nga marrja e flukseve të mëdha të parave që vijnë nga vendi ynë, Rumania, Maroku, Nigeria, Ukraina, Ekuadori dhe Kolumbia. Procedura operative është shumë efikase dhe e shpejtë, edhe pse hallka e dobët e zinxhirit, në aspektin e kontrollit, përfaqësohet pashmangshmërisht nga personi që vepron si nënagjent apo i nënautorizuar, i cili nuk zotëron (dhe shpesh nuk ka asnjë interes ta zhvillojë më tej) një aftësi specifike për të përcaktuar operacione që mund të jenë të dyshuara e që duhet t'i njoftohen agjentit, mbi të cilin rëndon konkretisht detyrimi për të raportuar. Meqë ndër nigerianët ndihet shumë përkatësia etnike dhe fisnore, edhe në grupet kriminale kjo karakteristike kryeson dhe është tipike e lidhjeve ndërkombëtare: shumë shpesh partneri i huaj është një i afërm, apo sidoqoftë, një person i cili i përket të njëjtit trung familjar në kuptimin e gjerë të tij.

Lidhur me këtë, ndërsa për disa aspekte është relativisht e mundur të ndikosh në veprimtaritë kriminale të zhvilluara nga organizatat në shkallë botërore, duket se është shumë më e vështirë të përcaktosh dhe, për rrjedhojë, të luftosh fluksin e parave që rrjedh prej tyre. Në fakt është e kuptueshme vështirësia apo, deri dhe pamundësia për të mbërritur deri në origjinën e parave, cilado qoftë ajo, pasi këto para të jenë hedhur në tregjet financiare. Jo rastësisht pika më e ngjashme mes kimit të organizuar dhe botës së ekonomisë së ligjshme arrihet në kuadrin financiar. Për këtë arsye, hetimore duhet të orientohen duke pasur parasysh se një luftë efikase kundër fenomeneve kriminale duhet të bëjë të mundur edhe përcaktimin e kanaleve të riinvestimit të këtyre parave.

Lidhur me këtë vërejmë se nocioni i pastrimit të parave i përftuar nga legjislacioni penal italian mbështetet në një përkufizim i cili është zgjeruar me kalimin e kohës si në aspektin e krimeve të supozuara ashtu dhe në atë të veprimeve a qëndrimeve të rëndësishme, edhe duke vënë krahas pastrimit të parave në kuptimin e ngushtë të tij (zëvendësim, transferim apo fshehje) figurat e krimit të përdorimit e investimit të të ardhurave të paligjshme në veprimtari ekonomike ose financiare dhe të transferimit me mashtrim të vlerave. E megjithatë, në aspektin e verifikimit, ajo që e bën të ndryshëm hamendësimin e pastrimit të parave nga legjislacioni italian kundrejt sistemeve të tjera penale, është dallimi mes autorit të krimit të supozuar dhe pastruesit të parave. Në të vërtetë, kërkohet që ky i fundit të mos ketë bashkëpunuar në krimin kryesor, arsye për të cilën pastrimi i parave përfytyrohet si një aspekt më vete, ndonëse i ngjashëm me atë të prodhimit të të ardhurave të paligjshme.

Dispozitat në fuqi për të luftuar krimin e organizuar në rrafshin ekonomiko-financiar, bëjnë sidoqoftë të mundur përdorimin efikas të mundësive të ndryshme e kompozite për të hetuar.

Ka qenë me të vërtetë mjaft efikas përdorimi sinergjik i moduleve të ndryshme juridiko-operative, që priret të shfrytëzojë plotësisht plotësueshmërinë që ekziston mes kuadrit ligjor me karakter ndëshkues dhe atij kryesisht parandalues dhe të përfitojë sa më shumë nga veprimi i luftës, duke luftuar qendrat e organizatës kriminale si në rrafshin *ushtarak* ashtu dhe në atë ekonomiko-financiar.

Së fundi, duket se është e pamundur të mos mendojmë në nivel ndërkombëtar për një luftë të përbashkët kundër fenomeneve kriminale, ndaj të cilëve pastrimi i kapitaleve është një aspekt ngushtësisht i lidhur.

§ 6.

Kundrejt një skenari kaq kompleks dhe të shtrirë, ku metodologjitë dhe metodat tradicionale hetimore janë të pamjaftueshme për të përcaktuar pikat e dobëta të organizatave që merren me trafikun e lëndëve narkotike, duket se është e domosdoshme edhe të përshtatim legjislacionin kundër kësaj veprimtarie, duke njësuar njëherësh legjislacionin procedural të vendeve të ndryshme, të paktën të atyre evropiane.

Rëndësia e këtij fenomeni kërkon një strategji ndërkombëtare të përbashkët, që duhet shtrirë në pesë sektorë ndërhyrjeje, të cilët tregohen mjaft qartë nga Konventa e Vjenës e vitit 1988, si plotësues dhe të pandarë mes tyre:

- përcaktim i burimeve të prodhimit dhe shpërndarjes së hallkave të para të zinxhirit të organizimit përmes të cilit menaxhohet trafiku;
- luftë kundër kontrabandës së të ashtuquajturve prekursorë, pra të atyre lëndëve që shërbejnë për proceset kimike sintetike të lëndës narkotike;
- luftë kundër shpërndarjes me pakicë;
- ndihmë e ndërsjellë gjyqësore ndërkombëtare;
- marrje e pasurisë së grumbulluar përmes riinvestimit të të ardhurave nga trafiku i lëndëve narkotike dhe përcaktim i kanaleve të përdorur për pastrimin e parave.

Nëse dimensionin transnacional që ka fituar sot trafiku i kokainës karakterizon çdo veprimtari hetimorë që, edhe kur zhvillohet ende në nivel lokal, priret të marrë tipare përtejterritoriale, bashkëpunimi ndërkombëtar përfaqëson një parakusht për çdo veprimtari të përbashkët luftar.

Për këtë arsye, vetëm nëpërmjet veprimtarive hetimore që përfshijnë të gjitha vendet e prekura nga degëzimet e veçanta të trafikut të lëndëve narkotike dhe, analizës së informacioneve që mund të merren përmes kanaleve të bashkëpunimit, sot është e mundur të realizohen operacione të cilat janë në gjendje të ndikojnë në mënyrë domethënëse mbi këtë fenomen, duke zbuluar edhe flukset e parave që rrjedhin prej tyre.

KËSHILLTAR ANTONIO LAUDATI
*Prokuror Kombëtar Antimafie
 Drejtoria Kombëtare Antimafie*

Tiranë, Mars 2007

1.4. *Shënime mbi trafikun e armëve në Itali, në dritën e hetimeve më të fundit.*

§ 1. *Shënime mbi trafikun e armëve në Itali.*

E privilegjuar nga flukset e emigracionit klandestin, Italia është një pikë kyçe e mjeteve të reja kriminale ku përputhen interesa dhe aleanca funksionale ndërmjet organizatave mafioze siciliane, kalabreze, napoletane e puljeze, me ato kolumbiane, domenikane, nigeriane, turke, kineze, por mbi të gjitha me organizatat serbo-kroate e kosovaro-shqiptare, ku këto të fundit janë të përfshira tërësisht në të gjitha llojet e trafiqeve ta paligjshme, ndër të cilat edhe në trafikun e armëve.

Në lidhje me këtë fakt, dhe marrëdhëniet tregtare ose strategjike favorizojnë trafikun e armëve drejt Italisë, dhe pse në një mënyrë më pak të dukshme krahasuar me trafikun e drogës.

Fakti që, në harkun kohor të viteve të fundit, sekuestrimet e bëra nga sektorët specifikë kanë qenë sporadike, nuk duhet të nënvleftësojë fenomenin i cili, nëse ballafaqohet me të dhënat që kemi, vë në dukje përdorimin e gjerë të armëve të luftës dhe të materialeve eksplozive në krimet më të shëmtuara të kryera nga organizatat e tipit mafioz.

Ndër faktorët kryesorë, është sigurisht kriza ballkanike dhe mungesa e stabilitetit politik në këtë Rajon, të cilat, deri më sot, kanë ofruar mundësi të mëdha për furnizimin me armë dhe materiale shpërthyesë të organizatave mafioze por dhe të atyre terroriste, të brendshme apo ndërkombëtare.

Lehtësia e madhe e organizatave, sidomos ato serbo-kroate, maqedonase dhe kosovaro-shqiptare, për të siguruar në mënyrë periodike furnizim me armë luftime të sofistikuara e me një rrezikshmëri të madhe, lidhet me ngjarjet e rëndësishme të ndodhura në këto vitet e fundit, të cilat kanë ndryshuar rrënjësisht realitetin politiko-shoqëror të shumë vendeve të Evropës lindore.

Nga përpunimi i të dhënave të fundit, të përfutuara nga sektorët përkatës mbi këtë trafik, vihet re një përfshirje e disa grupeve kroato-boshnjake të lidhura me organizatat kriminale ruse.

Për trafikun e armëve përdoren gjerësisht rrugët ballkanike (rruga përmes Ballkanit), të dhënat e fundit i referohen sekuestrimit të kryer në

portin e Gioia Tauro (RC)²⁵ të disa mijërave armëve luftarake me prejardhje nga Rumania e me destinacion Shtetet e Bashkuara.

Në përgjithësi, nga analizat që lidhen me zhvillimin e strukturave kriminale dhe të fenomeneve kriminale, rezulton se për sa i përket trafikut ndërkombëtar të armëve, organizatat kriminale të hetuara përdorin në mënyrë paralele kanalet që përdoren si për trafikun e klandestinëve ashtu dhe për trafikun e lëndëve narkotike.

Nevoja për të ulur çmimin dhe për të gjetur rrugë e mënyra mundësisht të sigurta, sikurse ato nga toka, nëpërmjet kufijve veri-lindorë të Italisë ose në rrugë detare në drejtim të brigjeve Puljeze, ka bërë që të vihen në lojë mekanizma të bashkërenduar më së miri.

Pikërisht për këtë arsye Italia, brenda një kohe të shkurtër, është shndërruar në një nga kryqëzimet më kryesore edhe për trafikun e armëve, i cili organizohet nga grupe kriminale shqiptare por dhe nga ato malazeze të cilat shfrytëzojnë rrugët tradicionale të kontrabandistëve puljeze. Sot Italia konsiderohet jo vetëm si një vend tranziti por dhe si vend destinacioni përfundimtar.

²⁵. *Kryer në prill 2004 nga autoritetet doganore*

Gjithnjë e më shumë vihen re kontakte të shpeshta të organizatës kriminale *ndrangheta* me organizata ballkanike që merren me trafik armësh dhe lëndësh eksplozive. Kohët e fundit është vëre re se sasi të mëdha armësh janë destinuar për organizatën kriminale *ndrangheta*, disa prej të cilave janë sekuestruar, e në veçanti:

- më datë 8 maj 2004, në provincën e Reggio Calabria-s, më shumë se 100 kg lëndë eksplozive, ndër të tjera dhe një kallëp 500 gr eksploziv plastik i tipit SEMTEX me prejardhje ballkanike (e tipit ushtarak me fuqi të madhe e quajtur PEP 500, prodhuar në qytetin Ivan Grad, aktualisht Berane, në Mal të Zi). Përfundimi i hetimeve çoi në arrestimin e 14 personave, anëtarë të Cosca IAMONTE, që vepron në Reggio.

- Më datë 27 nëntor 2004, në provincën e Reggio Calabria-s u sekuestruan 4,5 kg eksploziv PEP 500, me prejardhje nga fabrika që përmendëm më lart në Mal të Zi. Përfundimi i hetimeve çoi në arrestimin e 4 personave, anëtarë të së njëjtës organizatë, Cosca IAMONTE.

- Më datë 20 dhjetor 2005, në komunën e Rosarno (RC), u sekuestrua një sasi e konsiderueshme municioni me origjinë ballkanike dhe një bazukë e prodhuar në Jugosllavi, me tre predha.

- Më datë 20 qershor 2005, në komunën e Gioia Tauro (RC), u sekuestruan 4 bomba dore, 1 kandelë eksplozivi tutagex me prejardhje nga Ballkani, i predhëlëshues 64 mm, prodhim jugosllav, 2 kallashnikovë AK 47, 3 pistoleta dhe 1 detonator.

- Më datë 22 dhjetor 2005, në komunën e Villa San Giovanni (RC), u sekuestrua një sasi e konsiderueshme armësh me prejardhje nga Ballkani.

Hetimet kanë nxjerrë në pah faktin se nuk ka mënyra standard për fshehjen e për transportin e armëve, por në bazë të analizave vihet re se mbart të njëjtat karakteristika me ato të trafikut të lëndëve narkotike, si përdorimi i linjave tokësore për transportin e ngarkesave modeste, i automjeteve të manipuluar, përdorimi i rrugëve detare, në brendësi të kontenierëve të kamufluar me ngarkesa të ndryshme.

Shpërndarja në territor sigurohet kryesisht nga celula serbo-kroate dhe shqiptare që veprojnë në Itali duke iu referuar organizatave kriminale që veprojnë në vendet e tyre të origjinës. Sekuestrimet e kryera janë më të shumta në Rajonet me kriminalitet të lartë si dhe me përqendrim të lartë të subjekteve me origjinë nga Ballkani.

Mjaft shqetësues e i rrezikshëm është fakti i bashkëpunimit të grupeve terroriste në trafikun ndërkombëtar të armëve e të drogës, si nëpërmjet kërkesave për bashkëpunim (ujdi) ashtu dhe nëpërmjet kontrollit të plotë të prodhimit të heroinës dhe të kokainës nga organizatat terroriste.

Sot, organizatat fundamentaliste islamike, por dhe grupet separatiste kaukaze e ballkanike, të cilat kontrollojnë një pjesë të madhe të prodhimit të opiumit kryejnë transporte në këmbim të armëve e të municioneve, këto organizata bashkëpunojnë dhe me organizatat paraushtarake kolumbiane të cilat kontrollojnë pothuaj gjithë prodhimin e kokainës.

Për sa më lart, vërtetohet dhe nga përfundimet e hetimeve me emrin e koduar DECOLLO të kryera nga R.O.S. (Grupi Operativ Special) i Karabinierëve ndaj një organizate kriminale ndërkombëtare e cila kishte për qëllim trafikun e disa mijërave kilogramëve kokainë nga Amerika e Jugut drejt Afrikës, Evropës dhe Australisë. Në këtë kuadër, hetimet kanë dokumentuar ndërthurjen në shkallë botërore mes krimit të organizuar dhe atij eversiv, bazuar jo vetëm në arsyet ideologjike por dhe në favoret e ndërsjella për të gëzuar mbështetjen e njëkohshme në disa shtete.

Në frontin ballkanik, një hetim i koduar me emrin *Red Scorpion*, i kryer nga karabinierët e R.O.S. në fillim të vitit 2004, ka konfirmuar praninë e shkëmbimeve të mëdha të favoreve mes organizatave kriminale serbo-kroate dhe organizatave tradicionale mafioze italiane.

Këto struktura, dhe pse të përbëra nga një numër i vogël ushtarësh, në brendësi të tyre kanë rezultuar mjaft efikase dhe në gjendje të drejtojnë segmente të ndryshme të organizatës apo celula të cilat veprojnë në mënyrë të përsosur.

Në hetimin e fundit është bërë i mundur shqyrtimi i dinamikave kriminale të organizatës në vendin e origjinës, duke forcuar kështu bashkëpunimin me policinë kroate e boshnjake.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi policor i promovuar nga karabinierët e R.O.S. bëri të mundur kryerjen e një hetimi të pavarur, nga ana e Zyrës për luftën kundër krimit të organizuar në Zagreb (USKOK), ndaj shtetasve të saj për të cilët ishte lëshuar një urdhër arresti nga ana e Autoritetit Gjyqësor italian.

§ 2. Operacioni Red Scorpion.

Në veçanti, gjatë muajit janar 2004, karabinierët e R.O.S., në bashkëpunim me Komandën Territoriale dhe me organet kompetente policore të Kroacisë dhe Bosnjës, nisën të zbatojnë masat shtrënguese të vendosura nga Autoritetet Gjyqësore të Milano-s dhe Trieste-s ndaj dhjetëra shtetasve të hetuar për bashkëpunim me organizatat kriminale me qëllim trafikun e armëve si dhe për mbajtje, me qëllim shitjen, e sendeve të vjedhura.

Ndërhyrjet e kryera në Itali, në provincat e Milano-s, Lecce-s, Trieste-s dhe Vicenza-s, ishin me interes për Kroacinë dhe për Republikën serbe të Bosnje-Hercegovinës, ku ishin lokalizuar 4 persona të hetuar ndaj të cilëve ishte lëshuar dhe një urdhër arresti ndërkombëtar.

Këto urdhra arrestimi u lëshuan si rezultat i hetimeve të hollësishme të kryera nga Prokuroria e Milano-s, në bashkëpunim me atë të Trieste-s si dhe me karabinierët e sektorit të Antikrimit të Milano-s, që në nëntor 2002, ndaj një organizate kriminale serbo-kroate e cila merrej me trafik armësh ndërmjet Bosnjës, Kroacisë dhe Italisë.

Hetimi nisi pas blerjes së parë të dy pistoletave automatike Scorpion dhe të dy pistoletave gjysmë automatike Crevna Zastava nga ana e GRANULIC Milorad²⁶, referenti kryesor i organizatës në Itali, ku falë infiltrimit²⁷ të agjentëve nga radhët e karabinierëve, u bë e mundur që:

²⁶ Lindur në Banja Luka (Bosnjë), më 01.04.1960

²⁷ ish neni 12 i ligjit P.L. të dt. 8 qershor 1992 nr. 306, i kthyer në ligj më 7 gusht 1992, nr. 356

- më datë 16.01.2003, pranë kufirit italo-sllloven të Fermeti-t (TS), të sekuestroheshin nga policia sllovene, e vënë në lëvizje nga R.O.S., 2 pistoleta automatike SCORPION dhe 1 pistoletë gjysmë automatike ZASTAVA si dhe të arrestoheshin dy korrierë, PODRIC Damir, shtetas kroat dhe BALTIC Vehida, shtetase boshnjake, të cilët udhëtonin në një autobus të linjës;

- më datë 07.11.2002, në Milano të sekuestroheshin 2 pistoleta automatike të markës SCORPION dhe 3 pistoleta gjysmë automatike (1 CREVNA ZASTAVA mod.70, kal. 7,65, 1 CESKA ZBROJOVKA – PRAHA, kal. 6,35 dhe 1 BERETTA mod. 950) të pajisura me municion dhe me silenciator, të lëna në ruajtje të personave që punonin për llogari të personave nën hetim;
- më datë 29.11.2002, në Milano të sekuestroheshin 2 pistoleta automatike SCORPION dhe 5 pistoleta gjysmë automatike (1 Automatic Clement's Patent kal. 6,35 dhe 4 CREVNA ZASTAVA mod. 70, kal. 7,65) dhe të arrestoheshin CUFFARI Felice e DELLA RUPE Alessio, të cilët ishin blerësit e ngarkesës;
- më datë 07.01.2003, po në Milano, të sekuestroheshin 2 pistoleta automatike SCORPION dhe 3 pistoleta gjysmë automatike të cilat ishin porositur nga katanezi SCOLLO Agatino Maurizio, person me precedent penal, ndaj të cilit u lëshua urdhër arresti pasi në momentin e sekuestrimit ai u largua dhe më vonë u bë identifikimi i tij.

Hetimet u kryen duke përdorur në mënyrë progresive dhe sistematike teknikat të cilat bënin të mundur verifikimin e roleve, të bazës logjistike si dhe të kanaleve të furnizimit të armëve, duke analizuar dhe lidhjet që ekzistonin midis organizatës nën hetim dhe strukturave të ndryshme kriminale italiane, ndër të cilët ARCIDIACONO Umberto, person me precedent penal për rrëmbim personi me qëllim përfitimi, dhe i famshmi EPAMINONDA Angelo, i njohur me pseudonimin Tebano, një prej drejtuesve të një klani të rrezikshëm sicilian me bazë operative në Milano.

Në frontin e brendshëm del në pah implikimi i GRANULIC i cili armët dhe lëndët eksplozive ia ka dorëzuar drejtpërdrejt, në Sicili²⁸, familjes mafioze Enna, e cila drejtohet nga Gaetano LEONARDO, i njohur me pseudonimin Tanu u' Liuni.

Boshnjaku i lart përmendur i ka furnizuar me një pistoletë e cila më pas do të përdorej për të kryer një atentat ndaj këtij të fundit, por që nuk u arrit të finalizohet.

- me datë 01.02.2003, në Trieste, të sekuestroheshin 2 pistoleta automatike SCORPION dhe 2 pistoleta gjysmë automatike CREVNA ZASTAVA, si dhe të arrestoheshin 4 persona, ndër ta dhe shtetasi GRANULIC Milorad, të cilët po transportonin ngarkesën nga Zagrebi (Kroaci) në Lombardi.

²⁸ GRANULIC është martuar me CAVALLO Filippa, lindur në Piazza Armerina (EN) më 04.06.1960, banuese në rrugën Monza, nr. 25.

Në frontin e jashtëm, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me organet e policisë kroate u bë i mundur identifikimi i komponentëve kryesorë të organizatës që rezultojnë si më poshtë:

- një celulë, e përbërë nga shtetasi boshnjak KOVACEVIC Mirko, *alias* “Mirkan” dhe nga kroatët SADZIC Ahmet e SADZAK Vinko, me detyrë gjetjen e armëve dhe të municioneve, mundësisht me silenciatorë, në Bosnjë e në Kroaci;
- një celulë, që merrej me transportin e ngarkesave të paligjshme në territorin italian, e përbërë nga boshnjakët TOMINAC Sanjia dhe URBAN Katica si dhe nga shtetasi kroat PODRIC Damir, të cilët përdornin automjete të predispozuara²⁹ ose autobusë të linjës dhe herë pas here shfrytëzonin korrierë të rastit;
- një celulë që merrej me magazinimin dhe shitjen e armëve në Itali e përbërë nga shtetasi algjerian ABDELLAH Ammar, i cili vepronte nën drejtimin dhe kontrollin e GRANULIC.

Gjithashtu, në nëntor të vitit 2002, gjatë operacionit, veprimtaritë teknike shënonin shqetësimin e të hetuarve për disa sekuestre të kryera nga forcat e policisë ndërkombëtare në zonën e Prijedor, si pasojë e të cilave transportet e armëve të programuara për trafikim u ndërprehen.

Në fakt, në atë periudhë, në pjesën veriore të Republikës Serbe, MSU – SFOR kishin ndërmarrë një operacion policor me përmasa të mëdha duke sekuestruar kështu sasi të konsiderueshme armësh e municionesh.

Në frontin financiar, hetimi bëri të njohur dhe ofroi mundësi monitorimi të disa transfertave në të holla, në bazë të të cilave u arrit të vërtetohej se qarkullimi i tyre bëhej me anë të Money transfer WESTERN UNION.

§ 3. Përfundime.

Në përfundim, nga përvoja e përfituar, del në pah domosdoshmëria për të luftuar rrezikun e përbashkët të trafikut ndërkombëtar të armëve nëpërmjet hetimeve të përbashkëta jo vetëm me qëllim sekuestrimit, por dhe shkëmbimin e informacioneve në lidhje me mënyrën e transportimit, të drejtimeve, të vendeve të magazinimit si dhe të vendeve të furnizimit.

²⁹ Ngarkesat e paligjshme fshiheshin në brendësi të kamionëve o automjeteve që përdoreshin.

Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë policor ndërkombëtar, është gjithashtu i rëndësishëm plotësimi i detyrave të përcaktuara në luftën ndaj këtij trafiku si dhe ndaj trafikut të lëndëve narkotike, të qenieve njerëzore, të qarkullimit të kapitaleve, të cilat padyshim janë të lidhura me njëra- tjetrën.

KAPITEN MASSILIAMO D'ANGELANTONIO
R.O.S Karabinierëve

Tiranë, Mars 2007

1.5. Trafiku i qenieve njerëzore në Shqipëri.

§ 1. Kuptimi i fenomenit të trafikimit.

Edhe pse në fillim të viteve 90' trafikimi i qenieve njerëzore, si formë e skllavërisë moderne mori përmasa të veçanta, si dukuri shoqërore ka një histori të gjatë dhe ka qenë i pranishëm gjatë gjithë fazave të zhvillimit shoqëror. Karakteristika kryesore e zhvillimit të fenomenit është shfaqja e tij në forma gjithnjë e më të kamufluara dhe gjithmonë nën petkun e ndihmës për prosperitet të individëve që bëhen viktima.

Pavarësisht se në kuadrin e përgjithshëm evidentohet një evoluim nga një skllavëri klasike ku në mënyrë të hapur njeriu konsiderohej si mall i tregtueshëm drejt një detyrimi për punë e shërbime, duhet thënë se gjithsesi format e egra të skllavërisë nuk janë zhdukur përfundimisht. Trafikimi i qenieve njerëzore në format dhe përmasat që ai mori pas viteve 90' bëri që nga shumë studiues të konsiderohej si formë moderne e skllavërisë.

Aktualisht mund të thuhet se skllavëria nuk pranohet nga asnjë shtet por faktet tregojnë se rreth 27 milionë njerëz jetojnë në kushte skllavërie apo të ngjashme me të në të gjithë botën³⁰.

Në këndvështrimin historik, tregtia me njerëz ka pasur dy qëllime kryesore: shfrytëzimin e punës dhe shfrytëzimin e seksit. Këto dy drejtime nuk kanë përjashtuar qëllimet e tjera. Gjithsesi njihen katër forma kryesore të skllavërisë:

1. **Skllavëria në formën e zotërimit të tjetrit (skllavëria klasike).** Këta skllavëer konsiderohen si pronë e të zotërve dhe mund të këmbehen me mallra ose të holla. Pasardhësit e tyre do të kenë të njëjtin status.
2. **Vartësia me borxh** apo puna në vartësi është forma më e përhapur e skllavërisë. Varfëria ekstreme i detyron njerëzit të ofrojnë veten apo fëmijët si kolateral për borxhet që marrin. Ata janë të detyruar të punojnë deri në shlyerjen e borxheve por skema të ndryshme të rritjes së interesit e bëjnë të pamundur shlyerjen. Kështu borxhet trashëgohen te fëmijët duke krijuar një rreth vicioz që mund të zgjasë disa breza.

³⁰ American Antislavery Group, www.iAbolish.org.

3. **Skllavëria seksuale** që synon detyrimin kryesisht të grave dhe fëmijëve të prostituojnë. Format e përfshirjes dhe mbajtjes në këtë gjendje janë të shumta.
4. **Puna e detyruar** e cila rezulton kur persona të ndryshëm joshen nga oferta mashtruese pune dhe pastaj e gjejnë veten të punojnë në kushte skllavërie, pa u paguar ose me përfitime minimale, objekt të dhunës dhe abuzimit.

Format moderne të skllavërisë janë të orientuara kryesisht drejt shfrytëzimit skllavërues të fëmijëve për shërbime të ndryshme dhe skllavërisë seksuale, mes të cilave, trafikimi i qenieve njerëzore është ndër format më tipike. Kjo tregon se ndërsa deri dje baza e skllavërisë ka qenë dhunimi i të drejtave dhe lirive bazuar në dallimet klasore, format moderne bazohen në dhunimin e të drejtave dhe lirive të grupeve sociale vulnerabël nga grupe sociale më të fuqishme.

Ndërkohë që skllavëria dhe tregtia e njerëzve për qëllime të shfrytëzimit të punës ka pasur ulje-ngritjet e saj në historinë e zhvillimit shoqëror, skllavërimi seksual ka një kurbë më të qëndrueshme. Gjatë gjithë historisë mund të konstatojmë një shfrytëzim konstant kryesisht të femrave për qëllime seksuale. Kurba e zhvillimeve dhe ndryshimeve të tregtisë së njerëzve dhe skllavërimit të tyre ka ndjekur historinë e zhvillimit shoqëror, kulturat dhe traditat e ndryshme njerëzore. Në këtë kontekst, zhvillimet historike (politike e social-ekonomike) të ndodhura në fund të viteve 80' dhe në fillim të viteve 90' u pasndodhën nga një tendencë në rritje të formave moderne të skllavërisë të cilat vetëm në aspektin formal ndryshojnë nga format klasike të saj.

§ 2. Gjendja e trafikimit.

“Kisha dëgjuar për trafikimin, por kurrë s’e kisha imagjinuar kaq tjetërsues deri në momentin kur vetë e përjetova. Kisha qeshur kur dëgjoja shprehjen “Gjallë por i vdekur nga brenda”. E tillë jam unë, por ju s’mund ta kuptoni”³¹.

³¹ Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, Eksperiencë nga Puna trevjeçare me viktimat e trafikut, intervistë me M, 20 vjeç.

§ 3. *Gjendja e trafikimit në planin ndërkombëtar.*

Fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore përbën anën më të errët që ka shoqëruar dhe po shoqëron proceset globalizuese.

Si një formë veçanërisht abuzive e krimit ekonomik, trafikimi, në disa tipare kryesore, nuk ka ndryshuar shumë; viktimat rekrutohen nga vendet e pazhvilluara nga pikëpamja ekonomike dhe transportohen në vendet e destinuara që janë më të pasura.

Format e shfrytëzimit, nga të cilat burojnë fitimet e jashtëzakonshme, janë nga më të ndryshmet, por të gjitha ato kanë në bazë të tyre ushtrimin e shfrytëzimit dhe të abuzimit të qenieve njerëzore. Këto forma mund të ndryshojë nga shfrytëzimi për qëllime seksuale apo pune, në shërbime skllavëruese si punëtoresh të shtëpiake, punëtoresh nëpër agjenci kriminale, për dhurim organesh, për shërbimin ushtarak të detyruar apo shërbime të tjera të detyruara dhe martesë të ndërmjetësuar, birësime të paligjshme etj..

Trafikantët shpesh i lëvizin viktimat prej komuniteteve të tyre për në zona të tjera – brenda vendeve të tyre apo në vende të huaja – ku viktima është e izoluar dhe mund të mos jetë në gjendje të flasë gjuhën apo të mos njohë kulturën. Në shumë raste, viktimat nuk kanë dokumente imigracioni ose kanë dokumente false të ofruara nga trafikantët. Ç’është më e rëndësishme, viktimat humbin rrjetin e tyre të mbështetjes tek familjet dhe miqtë, duke u bërë kështu më të prekshëm ndaj kërkesave e kërcënimeve të trafikantëve.

Asnjë vend apo rajon i botes nuk ka mbetur pa u prekur nga ky fenomen si vend origjine, tranziti apo si vend destinacioni. Duke ju referuar disa shifrave të publikuara kryesisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit, shifrat e trafikimit rezultojnë mjaft shqetësuese. Kështu rreth 800.000-900.000 persona trafikohen çdo vit (trafikim ndërkufitar). Rreth 2.000.000 persona në total (trafikim ndërkufitar + trafikim të brendshëm). Prej tyre rreth 700.000 janë gra e fëmijë. Rreth 7-8 miliardë dollarë amerikanë janë të ardhurat vjetore nga trafikimi në shkallë ndërkombëtare. Rreth 90% e femrave të huaja që punojnë në industrinë e seksit në Evropën Juglindore janë viktima të dyshuara të trafikimit. Rreth 10-15% e tyre janë të mitura. Rreth 18.000-20.000 persona trafikohen çdo vit për në SHBA³². Rreth 120.000 gra e fëmijë janë trafikuar çdo vit për në vendet e BE³³. Gjatë vitit 2001, të paktën 700.000 dhe ndoshta deri edhe katër milionë burra, gra e fëmijë në mbarë botën u blenë, shitën, transportuan dhe u mbajtën kundër vullnetit të tyre në

³² Raport i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi trafikimin e personave, viti 2002.

³³ Raport i Komisionit Evropian, viti 2001.

kushte të ngjashme me skllavërinë³⁴. Në këtë formë moderne të skllavërisë, të njohur si “trafikimi i personave,” trafikantët përdorin kërcënimet, poshtërimet dhe dhunën për t’i detyruar viktimat të angazhohen në akte seksuale apo të punojnë në kushte të krahasueshme me skllavërinë për përfitime financiare për trafikantët.

Megjithatë duhet thënë se shifrat që jepen në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore nuk paraqesin realitetin për shkak të vështirësive që mbart evidentimi i rasteve të trafikimit. Tendenca është që gjithmonë situata reale të jetë më e rëndë se ajo e raportuar. Në lidhje me këtë fakt EUROPOL konstaton se, “*Numri i përgjithshëm i viktimave të trafikuarra për në vendet e BE-së është ende i panjohur dhe vetëm vlerësimet e përgjithshme janë të vlefshme. Ajo që është e qartë, është fakti se, numri i viktimave është shumë herë më i lartë se numri i dhënë në statistikat zyrtare në çështjet e hetuara në vendet e BE-së*”³⁵. Linjat kryesore të trafikimit janë ato që nisin nga vendet e pazhvilluara apo në tranzicion drejt vendeve më të zhvilluara. Kështu mund të dallojmë linjat që nisin nga Vendet e Evropës Lindore e Rusia drejt vendeve të BE-së, nga vendet e Evropës Lindore drejt SHBA-së, nga vendet e Azisë (kryesisht Kina), drejt vendeve të Evropës perëndimore, nga vendet e Azisë drejt SHBA-së, nga vendet e Afrikës drejt vendeve të BE-së, nga vendet e Amerikës Latine drejt SHBA-së.

Duke folur për grupet sociale të rrezikuara nga trafikimi mund të thuhet se askush nuk është i mbrojtur nga kërcënimi i trafikimit. Megjithatë, nga analiza e fenomenit dhe e praktikave të deritanishme, grupet sociale më të rrezikuara janë femrat e reja, fëmijët, meshkujt e rinj.

Trafikimi për shfrytëzim seksual mbetet kategoria më e gjerë që përbën këtë krim. Ndërsa format e tjera të trafikimit, si shfrytëzimi i punës, futja në një agjenci kriminale dhe dhurimi i organeve vazhdojnë të rriten, fakt mbetet që shfrytëzimi i një femre të re dhe i fëmijëve në industritë e seksit të vendeve më të pasura, gjeneron shumë më tepër të holla se sa shfrytëzimi i qenieve njerëzore si skllavër pune, apo se një pagesë e njëhershme për heqjen e një organi trupor.

Tendencat aktuale tregojnë se përfshirja e moshave gjithnjë e më të vogla në industrinë e seksit po bëhet e evidente. Tendencë tjetër në planin ndërkombëtar është synimi për të zhvendosur sa më larg viktimat e trafikimit. Në këtë mënyrë mundësia për të ruajtur kontrollin mbi to është më e madhe. Baza social-ekonomike e fenomenit janë raportet kërkesë –

³⁴ Raport i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi trafikimin e personave, viti 2002.

³⁵ EUROPOL, Raport mbi Krimin e Organizuar, viti 2000.

ofertë që përcaktojnë tendencën e lëvizjes nga vendet e pazhvilluara në ato të zhvilluara bazuar në shfrytëzimin dhe abuzimin e qenieve njerëzore.

Trinomi: KËRKESË-OFERTË-KONTROLL I TYRE NGA INDIVIDË APO RRJETE KRIMINALE NËPËRMJET SHFRYTËZIMIT TË VIKTIMAVE³⁶, përbën bazën kuptimore të fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore.

§ 4. Gjendja e trafikimit në planin rajonal.

Duke analizuar fenomenin në planin rajonal, konstatohet se me përfundimin e luftës së ftohtë dhe rënies së “murit të Berlinit” një varg procesesh u zhvilluan si në planin ekonomik-social ashtu dhe atë politik.

Situata ekonomike e krijuar si rezultat i dështimit të sistemit komunist krijoi probleme të mëdha ekonomike në popullsinë e rajonit. Numri i madh i të papunëve shkaktoi shumë vështirësi në familjet e tyre. Ata nuk ishin në gjendje të gjenin një punë të përshtatshme për të siguruar jetesën e vet dhe të familjeve të tyre duke kërkuar çdo mënyrë që do t’u siguronte të ardhura. Kuptohet se një pjesë e tyre në këto përpjekje ranë viktimë të trafikimit. Situata sociale, veçanërisht e femrave rezultoi të ishte mjaft e dobët. Kjo, si për shkak të pozicionit social të tyre në familje e në shoqëri, ashtu dhe për shkak të nivelit të njohjes së fenomenit të trafikimit dhe rreziqeve që mbarte me vete. Por jo vetëm kaq. Procesi i rënies së bllokut lindor u shoqërua dhe me një sërë procesesh politike si shpërbërja e shteteve dhe krijimi i shteteve të rinj, proces që doemos u shoqërua me një sërë problemesh të kontrollit të popullsisë, të kontrollit të kriminalitetit, të kontrollit të kufijve etj., duke krijuar një shtrat mjaft të përshtatshëm për një aktivitet kriminal intensiv në përgjithësi e sidomos në drejtim të trafikimit të qenieve njerëzore.

Vendet e rajonit tonë janë kryesisht vende origjine dhe tranziti me tendencë gjithnjë e më të madhe për t’u bërë vende destinacioni për shkak të masave të marra nga shtetet në luftën kundër trafikimit ndërkombëtar. Format kryesore të trafikimit për nga qëllimi i shfrytëzimit janë kryesisht trafikimi i femrave për prostitucion dhe trafikimi i fëmijëve për shfrytëzimin e lypjes dhe për birësime të paligjshme.

³⁶ ICMPD, manual i gjyqtarit dhe prokurorit, Vjene 2004, fq 24.

§ 5. Gjendja e trafikimit në planin e brendshëm.

Në lidhje me situatën e brendshme mund ta analizojmë atë në kuadër të problematikës së rajonit, për shkak të rrethanave të ngjashme në të cilat u zhvillua ky fenomen duke ruajtur kështu karakteristikat kryesore që analizuam më lart. Megjithatë, duhet thënë se Shqipëria, për shkak të disa rrethanave specifike të zhvillimeve social-ekonomike e politike pasqyron karakteristikat e saj individuale. Sikurse dhe në vendet e tjera të rajonit, fenomeni filloi të zhvillohet e të marrë përmasa të frikshme pas viteve 90' e, kryesisht pas viteve 93', 94'. Krahas trafikut të lëndëve narkotike, trafikimi i qenieve njerëzore u bë një nga aktivitetet kriminale më atraktive. Çorientimi i vlerave njerëzore pasoi procesin e ndryshimit të sistemit duke vënë në plan të parë pasurimin e menjëhershëm, pavarësisht nga mjetet që përdoren. Vlerësimi i terrenit të favorshëm në vendet ku shqiptarët emigruan, rënia në kontakt me elementet kriminalë të atyre vendeve filloi të stimulonte kryesisht trafikimin e vajzave shqiptare të cilat ishin në një pozitë social-ekonomike dëshpëruese. Në vitet 1993, 1994, 1995 vihen re procese trafikimi të kryera nga individë të veçantë, fenomen i cili në vitet në vazhdim erdhi duke u organizuar duke arritur kulmin në vitet 1997-2001. Ai u organizua fillimisht në grupe klanesh të pavarura të bazuara në lidhjet familjare, fisnore apo shoqërore. Format kryesore të trafikimit janë trafikimi i femrave për shfrytëzimin e prostitucionit dhe trafikimi i fëmijëve për lypje. Në praktikën hetimore ende nuk kemi pasur ndonjë rast të trafikimit të meshkujve. Për një periudhë kohe të gjatë 1994-2002, Shqipëria prezantohej si një vend origjine por kryesisht tranziti për viktime të ardhura nga vende të tjera të rajonit³⁷. Kjo u siguronte trafikantëve siguri nga hakmarrja e familjarëve të viktimave, çka u rrezikohej nga trafikimi i vajzave shqiptare. Për një kohë të gjatë ky fenomen u godit kryesisht mbi bazën e hakmarrjes dhe vetëgjyqësisë së familjeve të prekura, për shkak të strukturave shtetërore të dobëta, të papërgatitura apo të korruptuara. Vetëm pas vitit 2001, mund të flitet për një reagim serioz të Shtetit duke goditur kryesisht lëvizjen e paligjshme me gomone për në Itali. Pas vitit 2002-2003, Shqipëria nuk është parë më si vend i përshtatshëm për tranzitimin e viktimave duke bërë që aktualisht ajo të konsiderohet si një vend kryesisht origjine me tendencë në rritje destinacioni për qëllime të prostitucionit. Sipas vlerësimeve zyrtare, mendohet se rreth 8.000 femra shqiptare shfrytëzohen në vende të ndryshme të Evropës³⁸. Rekrutimi i viktimave shqiptare bëhet kryesisht në zonat rurale ku më të prekura kanë qenë zonat e rretheve

³⁷ Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tirane 2005, fq.174.

³⁸ Strategjia Kombetare.

Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Lushnje, Berat, Pukë edhe pse nga ky fenomen janë prekur pothuaj të gjitha rrethet.

Sipas raportit të dytë vjetor për viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore 2005, Shqipëria është kryesisht një vend origjine për trafikimin e qenieve njerëzore, përfshirë edhe trafikimin e brendshëm. Në një shkallë më të vogël, Shqipëria është edhe një vend tranziti dhe destinacioni. Viktimat shqiptare trafikohen kryesisht për shfrytëzim seksual, paçka se një numër i ndjeshëm trafikohet edhe për punë dhe lypje të detyruar. Ka shumë faktorë të cilët i bëjnë viktimat e mundshme të jenë të pambrojtura përpara trafikimit. Ndër to përfshihen kushtet ekonomike, lidhjet familjare, arsimi dhe papunësia. Shkaqet kryesore brenda Shqipërisë përfshijnë lidhjet e dobëta familjare, dhunën dhe abuzimin në familje, mungesën e shanseve ekonomike, përjashtimin social dhe varfërinë³⁹. Shumë viktimat të trafikimit të brendshëm ose ato që rekrutohen për prostitucion, vijnë nga zona të izoluar rurale të Shqipërisë, në disa prej të cilave vazhdon të sundojë e drejta kanunore.

Hë për hë, në Shqipëri nuk ka një regjistër zyrtar të centralizuar me të dhëna për viktimat e trafikimit, apo një metodikë standard për mbledhjen e informacionit për viktimat. Secila organizatë i mbledh të dhënat sipas rasteve të cilat ndihmon. Shqipëria renditet në Nivelin 2 në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për trafikimin e qenieve njerëzore për vitin 2006. Në raport thuhet se qeveria e Shqipërisë nuk i zbaton plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit, por se po bën përpjekje të konsiderueshme për t'i plotësuar këto standarde.

Nga studimi i rasteve të ndjekura nga Prokuroria Shqiptare ka rezultuar se mekanizmi i përdorur nga trafikantët ka qenë: – rekrutimi i vajzave në Shqipëri duke përdorur kryesisht mashtrimin për martesë, bashkëjetesë të lumtur diku jashtë vendit, – qëndrimi në një vend të Shqipërisë në pritje për t'u larguar jashtë, – lëvizja kryesisht me gomone me drejtim kryesor Italinë, – transportimin e tyre në territoret e huaja ku më parë kanë banuar vetë apo bashkëpunëtorët, – “përgatitja” për punë nëpërmjet dhunës e nënshtrimit total, – vendosja në rrugë.

Femrat shqiptare janë trafikuar kryesisht në Itali, Greqi por dhe në Belgjikë e Britaninë e Madhe.

Trafikimi stimulohet nga kufiri me vende të BE, nga pozicioni gjeografik, pasja e deteve e liqeneve, etj.,

³⁹ IOM, Raporti i dytë vjetor për viktimat e trafikimit në Evropën Juglindore 2005.

Goditja e linjave detare kryesisht të linjave që kryheshin ilegalisht me skafe, bëri që linjat e brendshme sikurse ato rajonale të orientoheshin drejt veriut, drejt, Kosovës, Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë duke bërë që trafikimi i femrave shqiptare, brenda Shqipërisë, të ndiqte tashmë drejtimin e kundërt.

Po kështu trafikimi i fëmijëve paraqitet problematik. Fëmijët e shtresave të dobëta shoqërore e më tepër fëmijë romë apo egjiptianë kanë qenë grupet sociale më të prekura nga ky fenomen. Ata janë trafikuar kryesisht në Greqi e më pak në Itali për qëllime lypjeje dhe birësimi të paligjshëm.

§ 6. Faktorët dhe kushtet që nxisin trafikimin e qenieve njerëzore.

Natyra e vështirë e të kuptuarit të këtij krimi, nevoja e veçantë e trajnimit të strukturave, vështirësitë në mbledhjen dhe administrimin e provave në një proces penal të tillë, vartësia mjaft e lartë e suksesit të një procedimi nga bashkëpunimi i viktimave të trafikut (të cilat jo rrallë, për shkaqe të ndryshme, i kanë çuar drejt dështimit proceset), paragjykimet e strukturave shtetërore ndaj viktimave, ekzistenca e provave në vende të tjera dhe vështirësitë e njohura të bashkëpunimit ndërkombëtar etj., përligjin përpjekjet e fokusuara në njohjen dhe përballjen me faktorët kriminogjenë të këtij kriminaliteti me synim marrjen e masave parandaluese.

Zakonisht, në analizën që u bëhet faktorëve që ndikojnë në këtë lloj kriminaliteti për shkak të karakteristikës kryesore të saj që është lëvizja nga një rajon i pazhvilluar në një rajon të zhvilluar, faktorët i kategorizojmë në a) faktorë shtytës dhe b) faktorë tërheqës. Me “faktorë shtytës” kuptohen ata faktorë që gjenerohen në vendet e origjinës së viktimave dhe shtyjnë viktimat të bien pre e trafikimit. Me “faktorë tërheqës” kuptohen ata faktorë që gjenerohen në vendet e destinacionit dhe tërheqin apo lehtësojnë trafikimin e viktimave.

Sikurse është thënë dhe më lart, tre janë elementët bazë që qëndrojnë në thelb të trafikimit:

- Situata e vështirë ekonomike por jo vetëm, në vendet e origjinës, e cila nuk ofron perspektivë për një përmirësim të situatës. Kjo bën që gjithmonë të ketë persona e veçanërisht femra të gatshme për të rënë pre e trafikimit.
- Rritje konstante të kërkesës në tregjet e vendeve të destinacionit për shërbime të lira seksuale apo tregjet e tjera të punës.

- Individë apo grupe kriminale që përpiqen të kontrollojnë këtë situatë “kërkesë-ofertë” duke shfrytëzuar viktimat për të nxjerrë përfitime⁴⁰.

§. 7. *Faktorë shtytës.*

- Diferencat në zhvillimin ekonomik-social mes vendeve e rajoneve janë shkaku kryesor global i stimulimit të trafikimit. Varfëria dhe humbja e perspektivës dhe mundësive në vendet e origjinës.
- Shpresa për një jetë më të mirë dhe prosperitet, është një faktor i qenësishëm i çdo qenieje njerëzore për të arritur atë në një kohë reale.
- Regjimi i fortë i migrimit i vendosur nga shtetet më të fuqishme e të përparuara për të ruajtur standardet e veta të jetesës.
- Mungesa e mjeteve financiare të individëve për të siguruar migrim.
- Situata social – ekonomike e paqëndrueshme dhe tranzicioni i gjatë e i vështirë.
- Luftërat rajonale apo të brendshme kanë detyruar mjaft njerëz t’i nënshtrohen dhe trafikimit me qëllimin e vetëm për t’u larguar prej tyre.
- Persekutimi, dhuna politike, etnike, sociale.
- Fatkeqësitë mjedisore. Të tilla fatkeqësi si shpërthimi i Cernobilit apo fatkeqësi të tjera natyrore në vendet e origjinës.
- Shoqërimi i shkatërrimit të sistemeve politike me shturje të vlerave morale. Pasurimi me çdo kusht dhe çdo mjet u konsiderua si një vlerë e vetë sistemit. Prostitucioni nuk u konsiderua më si diçka e keqe, dhunimi i të drejtave të tjetrit u justifikua.
- Problemet sociale të familjeve në vendeve të origjinës (diskriminimi gjinor, dhuna në familje, abuzimi, etj.,).
- Niveli arsimor i ulët sidomos në zonat rurale. Humbja e vëmendjes së Shtetit për ngritjen arsimore, përqendrimi i familjeve në problemet ekonomike duke hequr apo mos çuar fëmijët në shkolla.
- Padijenja dhe mungesa e informimit për rreziqet dhe pasojat e trafikimit. Shteti nuk zhvilloi një propagandë njohëse në lidhje me këtë rrezik.

⁴⁰ ICMPD, Manual i gjyqtarit dhe prokurorit, fq.24.

- Struktura shtetërore jo të afta, jo të besueshme, të korruptuara.
- Mungesa e legjislacionit të përshtatshëm dhe e strukturave e mjeteve të papërshtatshme.
- Niveli i ulët i dënueshmërisë.

§ 8. *Faktorë tërheqës.*

- Shpresa e punësimit dhe e një jete më të mirë
- Të mirat materiale e jo materiale që lidhen me vendet e destinacionit
- Tregu i qëndrueshëm i punës në vendet e destinacionit
- Kërkesa e vazhdueshme për krah të lirë pune
- Trajtimi i përmirësuar social
- Reklamimi vezullues i jetës në vendet e perëndimit
- Kërkesat në rritje në industrinë e seksit në Evropën perëndimore e shoqëruar me mundësinë ekonomike të realizimit⁴¹
- Mungesa e edukimit dhe sensitivitetit të popullsisë europerëndimore në lidhje me trafikimin.

§ 9. *Faktorë karakteristike për Shqipërinë.*

§ 9.1. *Faktorë shtytës*

- Niveli i ulët ekonomik e sidomos i femrave në zonat rurale
- Niveli i lartë i papunësisë, sidomos ndër femrat
- Pozita sociale e femrës në disa zona, sidomos rurale. Diskriminimi gjinor dhe dhuna brenda familjes shqiptare dhe në përgjithësi pozita e gruas në shoqëri është parë nga shumë studiues si një faktor tipik për Shqipërinë por jo vetëm, kryesisht në trafikimin e femrave. Strukturat patriarkale që gjithandej mbajnë femrat në kushtet e

⁴¹ D. Scharie Tavcer (criminologist) Causal Factors in the Crime of Trafficking of Women for Sexual exploitation from Moldova. Në një deklaratë të Partisë Social Demokrate Gjermane është thënë se rreth 1 milion burra në ditë përdorin shërbime seksuale nga rreth 400.000 prostituta. http://www.iuscrim.mpg.de/forsch/krim/tavcer_e.html.

nënshtrimi të gruas ndaj burrit, mosnjohja prej tyre e të drejtave të veta, pabarazia ekonomike e sociale⁴².

- Mungesa e informimit në lidhje me rrezikun e trafikimit, format e rekrutimit.
- Mosstabiliteti politik në vend. Trazirat e herëpashershme që kanë shoqëruar këto 15 vjet kanë pasur një ndikim veçanërisht negativ e sidomos ngjarjet e vitit 1997.
- Tranzicioni i gjatë dhe i vështirë. Me kalimin e viteve është goditur mjaft rëndë shpresa e shqiptarëve për një zhvillim dhe prosperitet real.
- Efektiviteti i pamjaftueshëm i Shtetit për të goditur krimin.
- Mungesa e besimit për shkak të korrupsionit. Në mjaft procedime penale është konstatuar se trafikantët kanë korruptuar punonjës policie kryesisht të pikave të kalimit kufitar, si për t'i lejuar të kalojnë viktimat, ashtu dhe me rastin e riatdhesimit të tyre duke i ricikluar ato.
- Qenia kufi me vendet destinacion lehtëson së tepërmi trafikantët dhe grupet kriminale në aktivitetin e tyre.
- Kontrolli kufitar i dobët. Pas marrjes së masave për kontrollin më të mirë të kufijve detarë, linjat e trafikut u orientuan drejt të ashtuquajturit kufi të gjelbër.
- Informaliteti i jetës dhe ekonomisë. Anarkia në jetën shoqërore, anarkia ekonomike dhe informaliteti i tyre krijojnë lehtësi për autorët dhe vështirësi për organet e drejtësisë në grumbullimin e provave dhe të përfitimeve kriminale.
- Lëvizjet masive dhe anonimiteti. Mungesa e regjistrimit të shtetasve dhe adresave të tyre është një pengesë e madhe në ndërtimin e çdo strategjie dhe aksioni në luftën kundër këtij kriminaliteti.
- Regjimi tejet i ashpër e deri diskreditues në marrjen e vizave për jashtë dhe në përgjithësi politika e migrimit që ndjekin vendet si Italia dhe Greqia etj.,⁴³.

⁴² Maria Grazia Giammarinaro, Trafficking in women and girls, UN expert Group on trafficking in women and girls, 2002.

⁴³ Po aty, fq.9 thekson se "...hapja e mundësive për migrim legal është një nga rrugët për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Shtërngimi i politikave imigruese nga vendet

- Humbja e besimit të popullit te aftësia e politikës për një përparim të shpejtë.
- Mbështetja nga struktura politike apo shtetërore i aktiviteteve të paligjshme⁴⁴.

§ 9.2. *Faktorët tërheqës.*

- Afërsia e vendeve të BE-së (Itali, Greqi, etj.,..).
- Propaganda e njëanshme e emigrantëve (historitë e dhimbshme nuk përfliten).
- Reklamimi vezullues i mediave Italiane dhe Greke që arrijnë të depërtojnë në Shqipëri. Mungesa e emisioneve që lidhen me fenomenin.
- Qëndrimi favorizues ndaj prostitucionit i vendeve anëtare të BE-së.
- Qëndrimi jo aktiv i shteteve të BE-së në lidhje me “punën në të zezë”.
- Prezenca e trupave ushtarake perëndimore në Kosovë.

§ 10. *Trafikimi dhe krimi i organizuar.*

Edhe pse nga pikëpamja teorike pranohet se trafikimi mund të kryhet dhe nga një person, në fakt ai është një nga aktivitetet më atraktive të grupeve kriminale të organizuara. Krimi i organizuar që deri para viteve 90’ operonte në një territor të kufizuar, aktualisht po ndjek shembullin e bizneseve të ligjshme në drejtim të globalizimit të tij. Duke synuar kontrollin e tregjeve, sikurse bizneset e ligjshme, kërkon fitimet maksimale dhe përpiqet të dobësojë sistemet e kontrollit për të pakësuar rreziqet. Grupet kriminale që merren me trafikimin e qenieve njerëzore shfrytëzojnë mundësitë e tregut për shërbime seksuale dhe krahun e lirë të punës nga njëra anë (kërkesën) si

e destinacionit dhe tranzitit rrit vulnerabilitetin e popullsisë emigruese dhe favorizon qëllimet e trafikantëve”.

⁴⁴ IOM, *Victims of trafficking in the Balkans*, 2001, fq.33, studim mbi trafikimin e femrave dhe fëmijëve në Ballkan 2001 “rreth 10% e vajzave shqiptare të trafikuar theksuan se punonjës policie ishin përfshirë në trafikimin e tyre”.

dhe situatën e vështirë dhe të cenueshme të grave dhe fëmijëve të shumë vendeve (oferta)⁴⁵.

E nisur fillimisht si një ndërmarrje me baza familjare, fisnore apo shoqërore, trafikimi i qenieve njerëzore ka marrë përmasat e një aktiviteti gjithnjë e më të organizuar dhe me përfshirje gjithnjë e më të madhe të individëve me kombësi të ndryshme. Kështu nga praktika hetimore ka rezultuar që grupet kriminale shqiptare kanë bashkëpunuar me grupet kriminale Italiane ku fillimisht trafikantët shqiptarë luanin rolin e furnizuesit të tregut të seksit në Itali me femra shqiptare, dhe ata italianë duke qenë se njihnin terrenin, organizonin shfrytëzimin. Por gjithnjë e më tepër grupet shqiptare synuan të jenë në krye të aktivitetit duke krijuar grupe të tyre dhe me drejtim po prej tyre duke marrë dhe kontrollin në këtë aktivitet⁴⁶. Në këto situata ata vendosen bashkëpunim të jashtëm me grupet italiane për ndarje zonash apo duke rekrutuar italiane brenda grupit për shërbime të ndryshme. Karakteristika e grupeve kriminale shqiptare që merren me trafikimin e qenieve njerëzore, në dallim nga ato që merren me trafikun e lëndëve narkotike, është se nuk arrijnë të krijojnë organizata të mëdha, por mbeten në grupe relativisht të vogla të cilat më tepër paraqesin karakteristika të grupeve të strukturuar kriminale sesa të organizatave kriminale. Në to nuk vihet re ndonjë organizim formal apo hierarkik por më tepër një raport horizontal mes anëtarëve të grupit në raport me rolet dhe kontributin e secilit në aktivitet. Në dallim nga grupet e tjera, grupet shqiptare dallohen për karakterin e fortë etnik të tyre⁴⁷. Personat me kombësi jo shqiptare sikurse u tha përfshihen vetëm për të kryer shërbime jo parësore. Në këto grupe, edhe pse evidentohet roli i drejtuesit, raportet e tij me grupin nuk janë të natyrës komanduese por të natyrës koordinuese të aktivitetit dhe të mbajtjes së raporteve me grupet e tjera kriminale. Bërthama e grupit përbëhet nga persona që ose kanë lidhje familjare ose kanë lidhje të forta shoqërore ku secili prej tyre ofron në aktivitet viktimën apo viktimat e tij. Një pjesë prej tyre apo persona të tjerë organizojnë mbikëqyrjen e viktimave gjatë shfrytëzimit dhe mbledhin të ardhurat të cilat iu dorëzohen drejtuesit apo elementeve kryesore që bëjnë shpërndarjen. Drejtuesi i grupit aktivizohet në veprime konkrete në rastet e ndëshkimit të viktimave apo të përplasjeve me grupet rivale. Ai aktivizohet gjithashtu në raportet e bashkëpunimit me grupet e tjera kriminale për shërbime të veçanta në varësi

⁴⁵ Projekti Rajonal CARPO, Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg 2005, fq.25.

⁴⁶ EUROPOL 2004, fq.8.

⁴⁷ Projekti Rajonal CARPO, Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg 2005, fq.46.

të nevojës konkrete si dhe në interesimin për lirim të anëtarëve të grupit të kapur nga policia. Kjo bëhet si nëpërmjet korrupsionit të zyrtarëve ashtu dhe nëpërmjet gjetjes së avokatëve të “zotë” për të marrë në mbrojtje anëtarin e grupit. Këto grupe karakterizohen nga brutaliteti ekstrem si në raport me viktimat ashtu dhe me grupet rivale. Në mjaft procese penale janë konstatuar veprime mjaft çnjerëzore të kryera nga trafikantë shqiptarë ndaj viktimave si rrahje sistematike, përdhunime në grup, djegie me cigare, përdorim të ujit të nxehtë për të realizuar aborte të shtatëzanive të padëshiruara të femrave që shfrytëzonin, prerje me thikë, etj., Aktualisht vihet re se tendenca e grupeve kriminale është përfshirja njëkohësisht me trafikimin dhe në kontrabandimin e njerëzve nëpërmjet përfitimeve nga kalimi i paligjshëm i shtetasve të ndryshëm të shumë kufijve. Aktualisht konstatohet bashkëpunimi i grupeve shqiptare, kosovare, serbe, kroate, boshnjake, etj., për të kaluar klandestinë në Itali. Është e qartë se trafikimi si një aktivitet i krimit të organizuar është i lidhur dhe me një sërë aktivitetesh të tjera kriminale. Përveç se me dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm ai është i lidhur me aktivitetin e falsifikimit të dokumenteve, me trafikun e narkotikëve por ai stimulon dhe korrupsionin për shkak të sasive të mëdha të vlerave monetare të siguruar nga ky aktivitet.

Sikurse u theksua dhe më lart, pavarësisht se fenomeni i trafikimit filloi të bëhej prezent dhe shqetësues qysh në vitet 1993, 94’, reagimi i Shtetit në mënyrë të fokusuar fillon pas vitit 2001, me miratimin e ligjit nr.8733, “Për disa ndryshime në K.Penal të Republikës së Shqipërisë”. Deri në atë kohë bëheshin përpjekje për të goditur këtë fenomen nëpërmjet dispozitave mbi prostitucionin dhe shfrytëzimin e tij. Ndryshimet ligjore u shoqëruan dhe me një sërë masash administrative e organizative të cilat rezultuan të suksesshme duke i dhënë një goditje të fortë fenomenit.

§ 11. Trafikimi në legjislacionin tonë të brendshëm dhe praktika gjyqësore.

Baza kushtetuese e dispozitave që godasin trafikimin e qenieve njerëzore lidhet me Pjesën e Dytë të Kushtetutës e cila nga ana e saj ndahet në 6 krahë: Kreu I “Parimet e përgjithshme”, Kreu II i Kushtetutës “Liritë dhe të drejtat vetjake”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, Kreu IV “Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, Kreu V “objektiva sociale” dhe Kreu VI “Avokati i Popullit”. Po kështu, ajo lidhet me nenin 3 të saj kur përcakton ndër të tjera se “**...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij..., janë baza e këtij Shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojtë**”.

Pjesa e II që flet në lidhje me liritë dhe të drejtat themelore, duke bërë një interpretim sistematik, vlerësohet si pjesa më thelbësore e Kushtetutës dhe institucionet shtetërore ekzistojnë në radhë të parë për t'i garantuar ato⁴⁸. Në bazë të interpretimit bashkëkohor ekstensiv të kushtetutës kërkohet që Shteti të mos mjaftohet në vetëkufizimin që të mos shkelë të drejtat, por të marrë masa që krijojnë kushte për mbrojtjen dhe realizimin e tyre⁴⁹.

Kushtetuta paraqet dhe një sërë karakteristikash në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore duke e renditur atë mes akteve me standarde evropiane: - Në klasifikimin e të drejtave dhe lirive themelore, ato vetjake kanë përparësi në raport me të drejtat e tjera politike, ekonomike, kulturore duke ruajtur klasifikimin e njohur dhe nga aktet ndërkombëtare, – Përcakton karakterin e pandashëm, të patjetërsueshëm e të padhunueshëm të tyre (neni 15), – Parashikon mundësinë e zbatimit të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë (neni 4). – Vendos si standarde minimale të mbrojtjes së të drejtave e lirive ato të përcaktuara në Konventën Evropiane (neni 17). Kjo karakteristike duhet parë dhe nen këndvështrimin e nenit 122 të Kushtetutës ku përcaktohet karakteri prioritar i zbatimit të normave të nxjerra nga një organizatë ndërkombëtare, në raport me të drejtën e brendshme, kur marrëveshja është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 26 i Kushtetutës është dispozita që i korrespondon mbrojtjes së të drejtave themelore më të dhunuara gjatë një procesi trafikimi, 24 thuhet: *“Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën dhe shëndetin e njerëzve”*.

Konstatohet se në të nuk gjen pasqyrim paragrafi i parë i nenit 4 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut që bën të ndalueshëm skllavërinë dhe robërinë.

Është e kuptueshme se kjo mungesë reflekton kufizimet e kohës së hartimit të kushtetutës, mosnjohjes së realitetit gjithnjë e më shqetësues të fenomenit të trafikimit, mungesës së një tradite në cenimin e këtyre të drejtave themelore, pasqyron tendencën koncentruese të hartimit të saj, etj.,.

Ky kufizim i Kushtetutës është pasqyruar dhe në Kodin Penal për të cilin do të flasim më vonë.

⁴⁸ Luan Omari, Shteti i së Drejtës, fq.294.

⁴⁹ Kristaq Traja, Drejtësia Kushtetuese, fq.179.

Paraprakisht mund të themi se ajo që konstatohet është se jo vetëm dënimi i skllavërisë e robërisë nuk gjejnë pasqyrim në Kodin Penal, por edhe dënimi i punës e shërbimeve të detyruara (të cilat gjejnë pasqyrim në Kushtetutë) nuk gjejnë në Kodin Penal një paraqitje të plotë, me përjashtim të nenit 114/a që lidhet me shfrytëzimin me dhunë të prostitucionit dhe dispozitave mbi trafikimin.

Duke iu referuar dispozitave të akteve ndërkombëtare mbi trafikimin, të implementuar dhe nga Kodi ynë Penal, rezulton se në një proces trafikimi mund të jenë të pranishme elementet e ushtrimit të tagrave të pronësisë mbi një njeri. Nga shumë çështje të tilla, kryesisht në lidhje me trafikimin e grave dhe të fëmijëve, autorët e këtyre veprave kanë shitur (disa herë pasi kanë bërë vlerësimin fizik dhe ekonomik të viktimave) apo kanë blerë viktimat sikurse skllavërit në sistemin skllavopronar apo më pas gjatë periudhës së tregtisë së skllavëve. Në shumicën e rasteve, situata ku trafikantët i vendosin vajzat është situatë skllavërie dhe robërie, pasi viktimat nuk kanë mundësi të disponojnë me vullnet të lirë për jetën dhe punën e tyre. Ajo gjendje nuk mund të barazohet me konceptin e punës së detyruar për shkak të natyrës permanente të kërcënimit dhe pamundësisë totale për të disponuar për veten. Është e vërtetë se mungesa e këtij disponimi në Kushtetutë nuk e lë tërësisht pa mbrojtje situatën përderisa vetë Kushtetuta përmend si bazë dhe burim të saj Konventën.

Duke kaluar në analizën e Kodit Penal duhet thënë se historia e rregullimeve ligjore në lidhje me trafikimin fillon me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001 “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Para se të kalojmë në një analizë më të detajuar të rregullimit ligjor që Kodi ynë Penal i bën trafikimit duhet të sqarojmë një problem që është mjaft i dukshëm sot si në trajtimet që bëhen nga mediat ashtu dhe në raportimet e ndryshme nga organizma qeveritarë apo jo qeveritarë. Nga padija apo qëllimisht, nocioni i trafikimit të qenieve njerëzore interpretohet në një kuptim më të gjerë nga nocionet e legjisllacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar në lidhje me të, duke përfshirë në të dhe aktivitetin kriminal që lidhet me realizimin e përfitimeve nga ndihma që i jepet një personi tjetër për të kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror shqiptar apo për të hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e një shteti tjetër. Në të drejtën ndërkombëtare ky aktivitet përkufizohet si “kontrabandim i emigrantëve” dhe kuptimi i tij jepet në Protokollin e Parë Shtesë të Konventës së Palermos si “*prokurimi i hyrjes së paligjshme të një personi në një shtet ku ai nuk është as shtetas dhe as rezident i përhershëm, me qëllim marrjen direkt apo*

indirekt të një përfitimi financiar apo të një përfitimi tjetër material". Ky koncept, edhe pse me mjaft probleme në implementim, reflektohet në nenin 298 të Kodit Penal nën titullin "Dhënia ndihmë për kalimin e kufirit". Dallimi dhe lidhja midis këtyre dy koncepteve është i rëndësishëm për shumë aspekte si teorike ashtu dhe praktike. Dallimi esencial qëndron në atë se trafikimi i qenieve njerëzore cenon të drejtat themelore të individit duke e kthyer njeriun në kafshë apo mall nëpërmjet abuzimit me të dhe të drejtat e tij duke keqpërdorur aspiratat e tij për një jetë më të mirë. Kjo është arsyeja që trafikimi i qenieve njerëzore njihet ndryshe dhe si **"skllavëri e kohëve moderne"**. Dallimet kryesore mes tyre janë:

- Kontrabandimi – vepër penale kundër rendit publik e kufijve; trafikimi – vepër penale kundër personit e dinjitetit.
- Kontrabandimi nënkupton kalimin e kufirit; trafikimi mund të kryhet dhe pa kaluar kufirin.
- Kontrabandimi nuk cenon vullnetin e të dëmtuarit; në trafikim ky vullnet është i cenuar.
- Trafikimi nënkupton "viktimë"; kontrabandimi, jo.
- Në trafikim krijohen marrëdhënie shfrytëzimi ose synohen ato, të cilat dallohen nga vazhdimësia; në kontrabandim nuk krijohen të tilla marrëdhënie dhe marrëdhëniet emigrant-kontrabandist ndërpriten në momentin që është realizuar kalimi i kufirit apo dorëzimi i përfitimit.
- Në kontrabandim është emigranti ai që kërkon shërbimin e kontrabandistit ndërsa në trafikim është trafikanti ai që nëpërmjet detyrimit apo shtrembërimit të vullnetit realizon migrimin. Viktima nuk mund të zgjedhë.
- Qëllimi i lëvizjes në kontrabandë është kalimi i kufirit – në trafikim është vendosja e viktimës në një ambient të huaj me pamundësi mbrojtjeje. Në trafikim kemi shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, - në kontrabandë nuk kemi një gjë të tillë.
- Kontrabanda kërkon që kalimi i kufirit të jetë doemos i paligjshëm; në trafikim kjo nuk është domosdoshmëri.
- Në trafikim, viktima nuk është e ndërgjegjshme për atë që e pret pas kalimit të kufirit (shfrytëzimin).

Ligji 8733 i vitit 2001 bëri një përmirësim të ndjeshëm dhe esencial në Kodin Penal. Ndryshimet synuan në realizimin e disa qëllimeve ndër të cilat

në lidhje me objektin e punimit mund të përmenden: – harmonizimi i K.Penal me parimet e Kushtetutës, të së drejtës penale ndërkombëtare dhe me aktet juridike ndërkombëtare të ratifikuara (shtesat në pjesën e përgjithshme të K.penal në lidhje me bazat, parimet dhe detyrat e K.Penal, neni 1/a, 1/b, 1/c), – parashikimin e disa figurave të reja të veprave penale në përputhje me përvojën pesëvjeçare dhe kërkesat e luftës kundër kriminalitetit, posaçërisht atij të organizuar (ndër to dhe trafiket e qenieve njerëzore), – Pajtueshmërinë e K.Penal me akte të tjera juridike ndërkombëtare (kryesisht me Konventën e Palermos), – ashpërsimin e dënimeve për krimet me rrezikshmëri të madhe shoqërore, për të goditur krimin e organizuar⁵⁰.

Është e qartë se dispozitat kryesore që godasin trafikimin e qenieve njerëzore janë nenet 110/a,114/b,128/b të K.Penal. Ndër to, dispozita më e perdorur është 114/b e K.Penal. Për herë të parë këto dispozita shfaqen me Ligjin nr.8733, dt.24.1.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në K.Penal të RSH” dhe me pas ndryshojnë me ligjin Ligji nr.9188 date 12.2.2004 ”Për disa shtesa e ndryshime në K.Penal te RSH”.

Këto ndryshime janë një reflektim i menjëhershëm i detyrimeve të marra nga nënshkrimi i Konventës së Palermos më 15.12.2000.

Neni 110/a: Trafikimi i njerëzve, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 5 deri 15 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.

Neni 114/b: Trafikimi i femrave për prostitucion, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga 7-15 vjet burgim. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarës për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin e saj, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.

Neni 128/b: Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga 10-20 vjet burgim. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm.

⁵⁰ Ismet Elezi, Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal me ligjin nr.8733 dt.24.1.2001, fq.4.

Dispozitat e mësipërme janë të përfshira në Kreun e Dytë “Vepra penale kundër personit”, përkatësisht në seksionet VII, VIII dhe IX, “Vepra penale kundër lirisë së personit”, “Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”, “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”. Në një vështrim të përgjithshëm mund të thuhet se procesi i hartimit dhe implementimit të dispozitave mbi trafikimin është karakterizuar nga një ngutje duke prezantuar dhe mosharmonizim me parimet e përgjithshme që burojnë nga pjesa e përgjithshme apo me jurisprudencën penale në përgjithësi. Parashikimi i trafikimit në tre dispozita e për më tepër në tre seksione të ndryshme pasqyron moskuptimin e thelbit të kësaj vepre që është cenimi i rëndë i lirisë themelore të individit. Trafikimi në thelbin e tij nuk është fenomen i lidhur ekskluzivisht me prostitucionin (edhe pse është forma më e dukshme) sikurse nuk është ekskluzivisht i lidhur me të miturin. Prandaj mendoj se parashikimi i trafikimit në nenet 114/b dhe 128/b pasqyron kufizim konceptual. Trafikimi duhet të parashikohet vetëm në seksionin VII, “Vepra penale kundër lirisë së personit”, duke parashikuar dispozitiv me vete për rastet e cilësuara.

Dispozitat mbi trafikimin, sipas Ligjit 8733, ishin dispozita blankete dhe i referohen përkufizimit të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës së Palermos. Problemi kryesor teorik e praktik në rastin e këtij ndryshimi është fakti se ratifikimi i Konventës së Palermos dhe Protokolleve nga parlamenti është bërë me ligjin nr.8920 dt. 11.7.2002. Në këtë mënyrë, që nga hyrja në fuqi e dispozitave (mars 2001) e deri në ratifikimin e Konventës së Palermos, referimi në Protokollin e Dytë Shtesë nuk ishte ligjor. Kjo ka sjellë një sërë anomalish në zbatimin në praktikë të këtyre dispozitave.

Dispozitat e mësipërme kanë elementet e përbashkëta dhe të dallueshme mes tyre. Të tri dispozitat, për nga vështrimi kuptimor i veprës janë të njëjta. Neni 114/b dhe neni 128/b janë forma të cilësuara të trafikimit të qenieve njerëzore, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal.

- Neni 114/b cilësohet në dy elemente të cilët duhet të jenë të pranishëm njëkohësisht:

- Gjinia e viktimës (femra)
- Lloji i shfrytëzimit në qëllimin e trafikimit (shfrytëzimi i prostitucionit).

- Neni 128/b cilësohet vetëm në moshën e viktimës së trafikut (nën 18 vjeç). Duhet theksuar këtu se përmendja e termit “fëmijë”, në vend të termit “i mitur” është joprofesional. Kjo për shkak se termi “fëmijë” nuk tregon

kufirin e moshës së një personi por tregon raportet midis një të paralinduri dhe një të paslinduri, raporte që nuk kushtëzohen nga mosha.

- Sipas këtyre parashikimeve, sa herë evidentohen elemente të veprës penale të trafikimit dhe i dëmtuari nuk është **femër** dhe **nuk është i mitur** vepra do të kualifikohet sipas nenit 110/a K.P. Ky është rasti kur persona madhorë, meshkuj, trafikohen për qëllime të punëve të detyruara brenda apo jashtë Shtetit sikurse ka ndodhur me popullsi kineze apo të tjerë, për qëllime të heqjes së organeve apo qëllime të tjera. Duhet thënë se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste në praktikë të këtij lloji trafikimi. Kjo mund të shpjegohet si me trashëgiminë psikologjike, me karakterin dhe temperamentin e shqiptarëve ashtu dhe me mosraportimin e tyre.
- Sa herë që do të evidentohen elementet e veprës penale të trafikimit dhe i dëmtuari është **femër**, është e **rritur** por qëllimi i trafikimit **nuk është shfrytëzimi i prostitucionit**, vepra do të kualifikohet po sipas nenit 110/a të K.Penal. Rasti është kur femrat e rritura trafikohen për qëllime të shërbimeve në familje, martesave të detyruara, heqjes së organeve apo për arsye të tjera jashtë shfrytëzimit të prostitucionit. Koncepti i shfrytëzimit të prostitucionit jepet në nenin 114 të K.Penal si “shtytje, ndërmjetësim ose martje shpërblim për ushtrimin e prostitucionit”. Gjithashtu duhet thënë se teoria jonë e së drejtës penale nuk ka përpunuar një kuptim të qartë të termit “prostitucion” në vështirimin që nëse ky koncept do të mbetet në kuadrin e një akti seksual komercial apo do të përfshijë dhe shërbime të tjera komerciale të karakterit seksual. Mendoj se kuptimi që jep neni 114 i K.penal më tepër i afrohet konceptit të favorizimit të prostitucionit se shfrytëzimit të tij. Shfrytëzimi kërkon praninë e domosdoshme të dy elementëve; realizimin e përfitimeve; abuzimin me individin.
- Sa herë që evidentohen elementet e veprës penale të trafikimit dhe i dëmtuari është **i mitur** (edhe pse mund të jetë femër dhe të shfrytëzohet për prostitucion) kualifikimi duhet të jetë sipas nenit 128/b të K.Penal.
- Secila prej dispozitave paraqitet në dy paragrafë, madje në tre duke e cilësuar secilën prej veprave në elementet e bashkëpunimit, kryerjes më shumë se një herë, keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit si dhe vdekjen e të dëmtuarit.

Evidentimi i karakteristikave të mësipërme nuk ka vetëm rëndësi teorike por dhe praktike. Rëndësia praktike e saj qëndron në nevojën e kualifikimit të drejtë të veprimeve të autorëve të këtyre veprave, kur ato janë kryer në kohën që kanë qenë në fuqi këto dispozita në mënyrën si janë parashikuar në ligjin nr.8733 të vitit 2001, pasi këto dispozita më pas pësuan ndryshime.

Ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004, u kanë dhënë këto karakteristika dispozitave mbi trafikimin:

- Nuk janë më dispozita të bardha pasi përshkruan në çdo dispozitë kuptimin e trafikimit (të personave, femrave, fëmijëve).
- Në pjesën përshkruese të dispozitave përfshihet përkufizimi i dhënë nga Konventa duke bërë modifikimet në varësi të elementit cilësues.
- Neni 114/b tashmë përbën formë të cilësuar të trafikimit të personave duke u cilësuar vetëm **në gjininë e viktimës**, duke hequr cilësimin e qëllimit për shfrytëzimin e prostitucionit. Kjo nënkupton që pavarësisht nga qëllimi për të cilin trafikohet një femër, kualifikimi do të bëhet sipas nenit 114/b të K.Penal.
- Me vendosjen e termit “si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”, krijon mundësinë për kualifikim si trafikim edhe në rastet kur qëllimi i shfrytëzimit nuk është një prej atyre që renditet në dispozitë (interpretimi progresiv).
- Përcakton detyrimin që përveç dënimit me burgim të jepet dhe gjobë duke synuar të godasë qëllimin e krimit (fitimet marramendëse).
- Shkëputet nga dënimi fiks (në kundërshtim me parimet) në rastet kur viktima ka pësuar vdekjen sikurse parashikohej më parë.
- Bën të cilësuar në paragraf të dytë çdo vepër për organizuesit, drejtuesit, financuesit e trafikimit.
- Bën të cilësuar në paragraf të pestë kryerjen e veprës nga subjektet e posaçëm duke rritur masat e dënimit me ¼, duke synuar të godasë korrupsionin e strukturave shtetërore çka paraqet një përjasje më të madhe me detyrimet e marra nga instrumentet ndërkombëtarë.

Sipas situatës së sotme të dispozitave, do të aplikohet neni 110/a i K.Penal sa herë që viktimat e trafikimit janë meshkuj madhorë pavarësisht nga lloji i shfrytëzimit në qëllimin e veprës. Do të aplikohet neni 114/b i K.penal sa herë që viktima të trafikimit janë femra madhore (pavarësisht nga lloji i shfrytëzimit) dhe do të aplikohet neni 128/b, sa herë që viktimat e trafikimit

janë të mitur, pavarësisht nga gjinia e tyre dhe pavarësisht nga lloji i shfrytëzimit të synuar.

Nga ana objektive vepra kryhet me anë të rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes apo pritjes së personit duke përdorur kërcënimin, forcën, shtrëngimin, mashtrimin, marrjen me forcë, dredhinë, abuzimin me pushtetin, abuzimin me pozicionin vulnerabël, dhënien apo marrjen e pagesave.

Struktura e konceptit të trafikimit:

1. Rekrutim, transportim, transferim, strehim, pritje

- **të një personi madhor**: me anë detyrimi, marrje me forcë, me mashtrim, abuzim me pozicionin dominues, duke marrë apo dhënë përfitime për të arritur pranimin e një personi që kontrollon viktimiën;
- **të një personi nën 18 vjeç** (pavarësisht nga qëndrimi i të miturit, apo pavarësisht nëse është përdorur një nga format e deformimit të vullnetit të përmendur më lart).

2. Për qëllime shfrytëzimi

- Shfrytëzim të prostitucionit apo shërbime seksuale
- Punë të detyruar apo shërbime të detyruara
- Për skllavëri apo forma te ngjashme
- Heqje organesh Forma të tjera shfrytëzimi Nuk është e rëndësishme nëse viktima në fund, për shkak të parakushteve apo pozicionit lehtësisht të cenueshëm (vulnerabël) kur ka arritur të japë pëlqimin për shfrytëzim.

Subjekti i veprës penale është subjekt i përgjithshëm.

Nga ana subjektive kryhet me dashje direkte dhe kërkon si element të domosdoshëm qëllimin e shfrytëzimit (vetë apo nga të tjerë)⁵¹.

Vepra do të quhet e konsumuar edhe kur personi ka kryer vetëm një nga veprimet: rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, ose pritjen e personave. Ky konkluzion rezulton nga interpretimi gramatikor i dispozitës. Kështu, me **Vendimin e saj nr.6, dt.3.2 2005** ndaj të pandehurve B.S., B.S., E.K., P.L., të akuzuar për trafikim të femrave për prostitucion, Gjykata për Krime të Rënda (lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda) ka argumentuar “*në vështrim teorik, elementet bazë të trafikimit janë tre dhe*

⁵¹ Ismet ELEZI, Komentari i së Drejtës Penale Pj.Posaçme, Tiranë 2005.

konkretisht rekrutimi, zhvendosja dhe shfrytëzimi. Rekrutimi arrihet forcërisht nëpërmjet marrjes me dhunë por më së shumti realizohet nëpërmjet mashtrimit të plotë ose të pjesshëm në lidhje me natyrën e punës, etj.. Zhvendosja nënkupton kalimin e kufirit shtetëror apo të disa kufijve shtetërorë por kjo lëvizje nënkupton dhe atë brenda kufijve shtetërorë. Shfrytëzimi është etapa e fundit pas mbërritjes në destinacionin e fundit të viktimës së trafikuar e cila i nënshtrohet një regjimi shfrytëzimi. Në këtë kuptim, krimi i trafikimit, quhet i konsumuar dhe mjafton vetëm një element që vepra penale të quhet e konsumuar dhe nuk duhet domosdoshmërisht ekzistenca e të tre elementëve së bashku që të ekzistojë krimi i trafikimit. Në rastin konkret, e dëmtuara F.L. është rekrutuar nga i pandehuri BS me anë të mashtrimit të plotë, pasi ky i pandehur duke qenë i martuar, i premtonte të dëmtuarës martesë e bashkëjetesë në Greqi, pra kërkon të trafikojë atë. E dëmtuara më pas zhvendoset nga banesa e saj në fshatin Xhas të rrethit Lushnje dhe dërgohet në Lushnje në pritje për t'u dërguar në Greqi për të shfrytëzuar prostitucionin e saj dhe pavarësisht se elementi i tretë, shfrytëzimi, nuk është realizuar, gjykata çmon se vepra penale konsiderohet e konsumuar". Megjithatë, duhet të kihet parasysh se si teoria dhe praktika ka pranuar se ndër elementët e domosdoshëm që duhet të jenë të pranishëm për të qëndruar figura e veprës është elementi i lëvizjes (transportim, transferim). Nuk ka rëndësi nëse ky element qëndron si fakt apo si synim.

- Nuk është e domosdoshme që shfrytëzimi të bëhet doemos prej atij që kryen rekrutimin apo transportimin ...
- Trafikimi si vepër penale konkurron me kalimin e paligjshëm apo dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm 297, 298 të K.P. Në konceptin bashkëkohor të trafikimit pranohet se kjo vepër nuk është e lidhur domosdoshmërisht me kalimin e kufijve duke pranuar në këtë mënyrë dhe trafikimin e brendshëm e cila konsiderohet si tendencë e ditëve tona.
- Ai konkurron me veprën penale të mbajtjes së lokaleve për prostitucion dhe atë të falsifikimit.
- Një situatë problematike krijohet në raportet midis nenit 114/a dhe dispozitave të trafikimit në rastet kur qëllimi i trafikimit është shfrytëzimi i prostitucionit. Më evidente duket kjo në raport me pikat (4) dhe (5) të nenit 114/a ku duket se ka përplasje midis elementëve të të dy veprave. Kjo të çon në pyetjen nëse këto dy vepra konkurrojnë apo thithen. Këtë e bën më të ndërlikuar interpretimi që do t'i bëhet shprehjes "me qëllim shfrytëzimi" duke krijuar përshtypjen se ndodhemi para dy veprimtarive kriminale të veçuara, e para (trafikimi) që përfundon deri në momentin e fillimit të shfrytëzimit dhe, e dyta (shfrytëzimi). Qëndrimet teorike në këtë pikë kanë

qenë të ndara, por në praktikën gjyqësore jo. Në interpretimet e ndryshme të akteve ndërkombëtare që kanë qenë burim i së drejtës sonë për këtë veprë është pranuar se shfrytëzimi është elementi fundor i trafikimit. Shfrytëzimi është jo vetëm element i anës subjektive por dhe element i anës objektive nëse është i pranishëm. Nëpërmjet formulimit të pranuar synohet të goditet fenomeni që në hapat e para të tij dhe jo të bëhet i dënueshëm në pjesën fundore. Në këtë mënyrë duhet interpretuar se duke penalizuar qëllimin që është një element që i paraprin veprës penale, realizimi i këtij qëllimi, domosdoshmërisht është i penalizuar nga kjo veprë. Në gjykimin tim, trafikimi thith shfrytëzimin e prostitucionit sa herë që këtij shfrytëzimi i paraprin një proces rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehjeje apo pritjeje (por veçanërisht një veprimtari zhvendosjeje të viktimës). Në këtë pikë mendoj se dispozitat e seksionit të VIII në lidhje me veprat kundër moralit dhe dinjitetit duhet të rishikohen për të krijuar një lidhje organike si midis tyre, ashtu dhe me dispozitat mbi trafikimin. Në pjesën e fundit të këtij punimi do të jepen dhe sugjerime në lidhje me këto dispozita. Praktika gjyqësore ka mbajtur po këtë qëndrim. Kështu, në **Vendimin e saj nr. 21 të datës 13.9.2004**, Gjykata për Krime të Rënda (lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda) ka dënuar DF dhe MK vetëm për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion pasi ata nëpërmjet mashtrimit kishin dërguar në Itali të dëmtuarën BC dhe e kishin shfrytëzuar për prostitucion për një periudhë kohe, duke ushtruar ndaj saj dhunë barbare në mënyrë që ajo të mos largohej. Po kështu në **Vendimin nr. 22, datë 24.5.2005, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda** në çështjen ndaj HA dhe AC, të akuzuar për trafikim të femrave për prostitucion thekson *“Gjatë gjyqimit të çështjes në ngarkim të të pandehurve, është provuar me prova të plota bashkëpunimi i të pandehurve në trafikimin e të dëmtuarës BA, i materializuar në formën e “Rekrutimit” dhe të “Transferimit” të saj me anë të “Mashtrimit” me qëllim “Prostituimin” e saj, gjë që ka gjetur pasqyrim adekuat, si në vendimin e Gjykatës së faktit ashtu dhe në arsyetimin sa më sipër të këtij vendimi. Vepra penale quhet e konsumuar pa qenë nevoja e ardhjes së pasojës “Prostituimit” të të dëmtuarës”*.

Është e domosdoshme që në një nga fazat e trafikimit të evidentohet një ndër format e deformimit të vullnetit (kur viktimë është madhor).

Një problem tjetër për t’u diskutuar është nëse për ekzistencën e veprës penale është i mjaftueshëm trafikimi i një personi apo domosdoshmërisht i disa personave, në një rast të vetëm apo në disa raste. Praktika gjyqësore ka pranuar së është e mjaftueshme prezenca e një rasti, pra e trafikimit qoftë dhe të një personi që vepra penale të qëndrojë. Mendoj se këtij qëndrimi duhet t’i përgjigjet dhe formulimi i dispozitës. Kështu, në **Vendimin e saj**

nr. 26, datë 29.9.2004, me të pandehur BG, të akuzuar për veprën penale të trafikimit të femrave për prostitucion”, Gjykata e Krimeve të Rënda ka arsyetuar se “*gjykata nuk pranon arsyetimin e avokatit sipas të cilit për të ekzistuar vepra duhet q ky të jetë si aktivitet i vazhdueshëm dhe jo me një rast. Për të nxjerrë këtë konkluzion gjykata ka arsyetuar se në përkufizimin e trafikimit thuhet mes të tjerash “...ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër”.*

Në **Vendimin e Gjykatës për Krime të Rënda nr. 14, datë 25.6.2004**, në çështjen kundër AK dhe XHK të akuzuar për veprën penale të trafikimit të fëmijëve, gjykata argumenton se këta të pandehur kanë konsumuar këtë veprë pasi “*...duke përfituar nga gjendja e vështirë ekonomike e prindërve të të miturve DF e XHF, duke u premtuar atyre se nga puna e fëmijëve të tyre do t’u dërgonte atyre një shumë të hollash çdo muaj, i kanë marrë të miturit dhe i kanë çuar në Greqi duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme dhe për një periudhë 2 vjeçare, në bashkëpunim mes tyre, kanë shfrytëzuar punën e tyre duke marrë prej të dëmtuarve të gjitha të ardhurat dhe një pjesë të vogël ua dërgonin prindërve të tyre. Herë pas here të pandehurit kanë ushtruar dhunë fizike e psikike duke kërkuar prej tyre më shumë të ardhura”.* Mund të dallojmë në këtë argumentim të gjykatës të tri fazat e një procesi trafikimi (rekrutimin, transportimin dhe mbërritjen në vendin e destinacionit për shfrytëzimin e punës me detyrim të të miturve).

Në përgjithësi praktika gjyqësore ka çarë me vështirësi përmes koncepteve të trafikimit. Pas implementimit të tyre me ligjin 8733 të vitit 2001 e deri në krijimin e Gjykatës për Krime të Rënda, gjykatat kanë mbajtur qëndrime kontradiktore. Kjo në faktin se gjykata, edhe pse kishin hyrë në fuqi dispozitat mbi trafikimin, në shumë raste kanë aplikuar dispozitat mbi shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese. Me krijimin e Gjykatës për Krime të Rënda dhe pas një sërë trajnimesh, këto koncepte po konsolidohen gjithnjë e më mirë.

Në një vendim të saj nr. 649, dt. 20.11.2002, në çështjen në ngarkim të HI i akuzuar për veprën penale të Trafikimit të njerëzve, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatave më të ulëta duke arsyetuar. E pranuar si e vërtetuar ngjarja (1.9.2001), rezulton se Gjykata e Apelit Shkodër e ka cilësuar gabimisht veprën e konsumuar nga i gjykuari si trafikim të njerëzve, parashikuar nga neni 110/a i K.Penal. Në këtë nen, si dispozitë e bardhë, nuk jepet nocioni “trafik njerëzish”, por në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe protokollet shtesë të saj, **të ratifikuar nga vendi ynë**, me trafik njerëzish kuptohet një veprimtari e gjerë e kryer në kushte dhe

rrethana të caktuara të cilat parashikohen hollësisht në nenin 3 të Protokollit nr.1. Veprimet e kryera nga ana e të gjykuarit, që konsistojnë në marrjen dhe transportimin e shtetasve kurdë, edhe duke qenë në dijeni të kalimit të paligjshëm të kufirit nga ana e tyre, nuk mund të kualifikohen si trafik njerëzish, përderisa nuk vërtetohen rrethanat që kërkohen për ekzistencën e figurës së veprës penale të trafikimit të njerëzve...”.

Në formulimet e sotme të dispozitave mbi trafikimin rezultojnë një kontradiktë mes paragrafëve (2) dhe (3). Jo vetëm që termit e përdorur nuk janë në harmoni me konceptet e pjesës së përgjithshme e kryesisht me dispozitat mbi bashkëpunimin, por rezultojnë se personi që organizon, drejton apo financon këtë veprë (që në fakt është bashkëpunëtor dhe me rrezikshmëri më të lartë, paragrafi i dytë) penalizohet më lehtë se një bashkëpunëtor që mund të jetë dhe periferik (paragrafi i tretë).

Përfundimisht mund të konkludohet se Shqipëria është ndër vendet e para që implementoi detyrimet e Konventës së Palermos menjëherë pas nënshkrimit të saj. Sikurse është thënë, implementimi i dispozitave mbi trafikimin e qenieve njerëzore nuk ka qenë organik si me akte të tjera (ligji për ratifikimin e Konventës) ashtu dhe me parimet e pjesës së përgjithshme të K.Penale dhe me jurisprudencën penale në përgjithësi. Dispozitat mbi trafikimin janë mjaft të ngarkuara me koncepte të cilat janë jo vetëm të vështira shpesh herë për t’u kuptuar, por krijojnë vështirësi në harmonizimin e drejtë. Parashikimi në Kodin Penal i veprave penale të “skllavërisë”, “robërisë” apo “punës së detyruar” (ato janë në shumicën e legjislativioneve të Shteteve perëndimore) do të ishte një ndihmesë serioze në luftën kundër trafikimit, veçanërisht në rastet kur nuk do të bëhej e mundur të provoheshin elementët e rekrutimit, transportimit, pritjes, etj., (elementë të anës objektive të trafikimit).

§ 12. Hetimi dhe ndjekja penale e trafikimit. Problematika.

Për shkak të shumë faktorëve, duhet thënë se standardi i sotëm i të provuarit të veprave penale të trafikimit do të dëshirohej të ish më i lartë. Është kjo arsyeja që Gjykata e Lartë në shumë çështje ka vendosur kthimin e çështjes për hetime të tjera në gjykatat më të ulëta. Arsyet e kësaj gjendjeje janë të shumta por mund të përmendim: mungesën e specializimit të strukturave, mjetet e pakta në dispozicion të tyre, nevoja e domosdoshme e mbledhjes së provave jashtë territorit të vendit, ekonomia informale dhe lëvizja e parasë jo nëpër banka, sistemet e kontrollit kufitar jo të mira, etj.,.

Veprat penale të trafikimit kanë veçori të përgjithshme të përbashkëta të cilat kushtëzojnë dhe metodikën e ndjekjes së tyre⁵². Duke analizuar të tri format e trafikimit nga pikëpamja e karakteristikave të tyre kriminale, rezulton se në trafikimin e fëmijëve, nuk është e nevojshme të provohet ndonjë nga mjetet e deformimit të vullnetit. Nga ana tjetër, konstatohet se trafikimi i femrave kryesisht për qëllime të shfrytëzimit të prostitucionit, përbën veprën penale dominuese ndër veprat e tjera, për këtë arsye dhe pjesa në vijim e këtij kreu do të ketë në vëmendje, kryesisht këtë veprë duke përmendur herë pas here dhe elementë karakteristikë për format e tjera të trafikimit.

§ 13. Karakteristikat kriminale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Trafikimi i qenieve njerëzore përbën një proces ku janë të ndërlidhura tre momente: Elementi i parë i tij është **rekrutimi**, i cili përfaqëson gjetjen e njerëzve dhe garantimin e disponibilitetit të tyre për t'u shfrytëzuar e për të siguruar përfitime të mëdha. Ky disponibilitet mund të arrihet forcërisht nëpërmjet marrjes me dhunë, nëpërmjet një mashtrimi të plotë apo dhe të pjesshëm të viktimave në lidhje me natyrën e 'punës' që u shpjegohet se do t'u ofrohet, apo nëpërmjet mashtrimit në lidhje me kushtet financiare apo mjediset e punës ku do të operojnë, ose duke i përdorur të dyja këto. Elementi i dytë që ndjek rekrutimin është **zhvendosja**, e cila e cila përfaqëson lëvizjen e viktimës drejt tregut fitimprurës dhe largimin nga mbrojtja që i siguron ambienti. Kjo lëvizje nuk ka në bazë të saj lirinë e vullnetit të viktimës. Zhvendosja e një personi mund të jetë brenda kufijve apo nëpërmjet kalimit të kufijve. Zhvendosja nënkupton dhe atë të bërë për të kaluar nga një treg në tjetrin apo për të kaluar nga një shfrytëzues në tjetrin nëpërmjet ushtrimit të tagrave të pronësisë. Elementi i tretë pas zhvendosjes është mbërritja në destinacion dhe **shfrytëzimi**. Ky regjim realizohet me anë të një shumëllojshmërie mekanizmesh detyrues, që nga përdorimi apo kërcënimi për përdorim të dhunës, deri në shfrytëzimin e pozicionit të dobët ekonomikisht të viktimës dhe të izolimit të saj.

⁵² Skënder Begeja, Kriminalistika, Tiranë 2004, fq.484.

§ 13.1. Rekrutimi.

Në varësi të nivelit të deformimit të vullnetit që trafikanti i bën viktimës rekrutimi mund të bëhet:

Me detyrim të plotë. Këtu përfshihen rastet kur ndaj viktimave të përdoren format më të rënda të cenimit të vullnetit si: rrëmbimi, dhuna fizike, dhuna psikike, përdhunimi, shitja e fëmijëve, shitja e viktimave nga personat që kanë siguruar kontrollin mbi to. Kështu, në procedimin penal nr.50 të vitit 1995 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë rezultoi se i pandehuri F.K. në bashkëpunim me persona të tjerë ka rrëmbyer të dëmtuarën S.Aa dhe e kanë nisur nëpërmjet Vlorës (me skaf) për në Itali, ku e kanë shfrytëzuar për prostitucion. Në procedimin penal nr. 1 të vitit 2002 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë ka rezultuar se e dëmtuara G.U. është rrëmbyer më 30.12.2001, në afërsi të aksit rrugor Kavajë-Lushnje nga persona të panjohur të cilët udhëtonin në një automjet. Ata i kanë dhënë asaj qetësues dhe e dëmtuara e ka parë veten në bregdet, në afërsi të disa mjeteve të vogla të lundrimit, nga ku dhe në mënyrë të fshehtë është larguar.

Me mashtrim të plotë. Të tilla janë rastet kur viktimat të trafikimit, kryesisht femra mashtrohen për t'u bërë të gatshme të zhvendosen për në drejtim të destinacionit. Mashtrimet janë forma më e përdorur nga trafikantët sipas të dhënave që rezultojnë nga proceset penale të ndjekura nga prokuroria shqiptare. Në procedimin penal nr. 12 të vitit 2002, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mirditë, në ngarkim të Z.L. etj., ka rezultuar se ky i pandehur kishte mashtruar të dëmtuarën L.P. se do të martoheshin së bashku e më pas e ka shitur tek i pandehuri L.K. i cili në bashkëpunim me persona të tjerë kanë bërë transportimin e saj në mënyrë të paligjshme në Itali për shfrytëzimin e prostitucionit. Një situatë mashtrimi është konstatuar dhe në procedimin penal nr.190 të vitit 2005 të Prokurorisë së Sarandës në ngarkim të F.D. e N.K. ku i pari, pasi ka krijuar lidhje dashurore me të dëmtuarën E.SH. e ka mashtruar atë për martesë dhe një jetesë më të mirë në Itali ku më pas, nëpërmjet dhunës e presionit psikologjik të dy e kanë detyruar të ushtrinë prostitucion. Mashtrimi bëhet kryesisht për këto fakte: për jetë më të mirë në vendin e destinacionit, për punë të mirë në vendin e destinacionit, martesë apo bashkëjetesë normale në vendin e destinacionit, për shkollim në atë vend, martesë të ndërmjetësuar jo në vendin e origjinës, udhëtime jashtë shtetit.

Mashtrim me gjysëm të vërteta, duke i premtuar punë në bare, pube, klube nate apo për *striptease* dhe pas mbërritjes në destinacion viktimat vendoset në situatën e shfrytëzimit skllavërues.

Mashtrim apo fshehje e kushteve në të cilat do të ushtrojnë prostitucion duke mos i bërë të ditur – brutalitetin që e pret – kontrollin e plotë nga të tjerë dhe pamundësinë për të marrë vendime dhe zgjedhur klientët dhe llojin e shërbimit – kushtet çnjerëzore të punës – humbjen e kontrollit mbi të ardhurat – moslejimin e legalizimit të qëndrimit – mbajtjen në kushte vulnerabël etj.,.

§ 13.2. *Tranzitimi.*

Qëllimet: 1) Të arrihet tregu fitimprurës. 2) Të largohet nga ambienti i njohur për të humbur mundësinë e mbrojtjes.

Tranzitimi mund të përfshijë: transportin dhe transferimin (strehim, pritje).

Tranzitimi shoqërohet me abuzime të të drejtave, shoqërohet me abuzime fizike, synohet që viktimat të mos disponojnë dokumente identiteti. Tranzitimi mund të shfaqet në disa cikle.

§ 13.3. *Mbërritja në destinacion dhe shfrytëzimi.*

Shfrytëzimi është synimi kryesor i trafikantit dhe për këtë, me arritjen në vendin e destinacionit ai përqendrohet në dy drejtime kryesore:

- realizimin e kontrollit të plotë mbi viktimën
- realizimin e fitimeve maksimale prej saj.

Sjellja kriminale e tij karakterizohet nga këta elementë kryesorë:

- Vendosja në kushte skllavëruese për arritjen e fitimeve maksimale
- Zhvendosja e vazhdueshme e viktimave
- Ushtrimi sistematik i dhunës fizike, psikike dhe seksuale
- Përdorimi i vrasjeve si “leksione”

§ 13.4. *Mënyrat e kontrollit të viktimave.*

- **Detyrimi me anë të borxhit** (për udhëtimin, për mbajtjen në hotele, për qiratë e hoteleve apo shtëpive). Këto detyrime janë të tepruara, të tilla që nuk përfundojnë dhe të shoqëruara me “gjoba” për sjellje të caktuara të viktimave.
- **Izolimi**, i cili mund të jetë Fizik, i shoqëruar me privime të nevojave jetësore (nuk i jepet ushqim, ujë etj.); Kulturor (nuk lejohet të mësojë gjuhën apo të ndjekë kurse shkollimi); Social (nuk lejohet të lidhë kontakte apo shoqëri me persona që janë jashtë skemës së shfrytëzimit).
- **Marrja e dokumenteve** për ta mbajtur në situatë ilegale duke e vënë nën presionin e kapjes nga policia dhe deportim.
- **Marrja me të mirë**, dhe përdorimi i gënjeshtërisë i shoqëruar me premtime për martesë pasi të zgjidhen hallet, duke e lejuar viktimën të dërgojë në familje sasi të vogla të hollash për të ndihmuar familjen apo duke i blerë ndonjë send të çmuar.
- **Ushtrimi i dhunës** fizike, psikike, seksuale. Dhunë periodike. Dhunë seksuale në grup. Shoqërohet me veprime poshtëruese. Dhunë që nuk njih kufij. Synon vartësinë totale psikike nga trafikanti. Ul nevojën e mbikëqyrjes fizike në distancë të afërt.
- **“Dhënia e mësimit”**. Kur viktimë shfaq shenja mosbindjeje. Kur viktimë tenton kontaktin me policinë. Kur viktimë tenton kontaktin me familjarët. Nëpërmjet keqtrajtimit apo ekzekutimit të viktimave të tjera në sy të saj. Synon terrorizimin ekstrem të viktimës dhe vartësinë pa kushte.
- **Kërcënimi për jetën e familjarëve** është një formë tjetër kontrolli e viktimave. Në procedimin penal nr.553 të vitit 2004 të Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Berat ka rezultuar se B.B. dhe G.B. kishin trafikuar shtetasen E.GJ. në Itali ku dhe shfrytëzonin prostitucionin e saj. Njëri prej të pandehurve që ishte në Shqipëri merrte në telefon vazhdimisht të dëmtuarën, duke e kërcënuar se nëse nuk do vazhonte “punën” do të vriste familjarët e saj dhe do të merrte dhe motrën e saj më të vogël për ta trafikuar.
- **Drogimi**. Siguron rendimet më të lartë. Siguron vartësinë ndaj drogës që mund t’ia gjejë trafikanti.

- E vetme në ambient të huaj, e izoluar nga kontakti me bashkëkombësit, me miqtë, me familjen, nuk njih gjuhën, pa identitet zyrtar pasi është pa dokumente, e çorientuar nga lëvizje të shpeshta, objekt dhune brutale, në pamundësi për t'iu drejtuar policisë pasi mund të dëbohet, shërbime të lodhshme e të pasiguruara, nën mbikëqyrje e kërcënime të vazhdueshme ndaj saj dhe familjes, kjo është situata më e zakonshme që haste tek viktimat e trafikimit. Vijimësia e kësaj situatë çon në deformimin e psikikës së viktimës, psikikë e cila mund të kontrollohet nga trafikanti dhe pa qenë në kontakt fizik me viktimën⁵³ duke e shndërruar viktimën në një skllav të vërtetë.

Detyrat e hetimit. Në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore kanë një varg detyrash për të marrë në konsideratë. Këto detyra lidhen me:

- Identifikimin, nëse ndodhemi apo jo para një rasti trafikimi apo para ndonjë veprë tjetër të ngjashme (dhënie ndihme për kalim të paligjshëm, shfrytëzim prostitucioni etj..).
- Përcaktimin e drejtë nëse personi i dëmtuar është ose jo një viktimë trafikimi.
- Marrjen e masave për të siguruar strehimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Kjo bëhet si nëpërmjet përdorimit të vendeve të fshehta të policisë, ashtu dhe nëpërmjet ndihmës që mund të japin OJF-të e ndryshme nëpërmjet strehëzave që kanë në dispozicion.
- Marrjen e masave për mbrojtjen e familjes së viktimës nga kërcënimet e trafikantëve. Vlerësimi i rrezikut për viktimën dhe familjen duhet të jetë në vijimësi në çdo fazë të procesit.
- Sigurimi i mbrojtjes ligjore për viktimën nëpërmjet ofrimit të asistencës falas, veçanërisht kur viktima është i mitur. Sigurimi i kontaktit me familjen.

§ 14. Nisja e hetimit.

Hetimi i çështjeve të trafikimit mund të nisë në dy mënyra kryesore. Nëpërmjet vënies në lëvizje nga kallëzimi i viktimës së trafikuar ose nëpërmjet ngritjes së hetimit mbi bazën e grumbullimit të informacionit inteligjent apo kallëzimit të personave të tjerë. Hetimi i nisur mbi bazën e kallëzimit të viktimave të trafikimit njihet ndryshe si **hetim reaktiv**, ndërsa

⁵³ ICMPD, Manual i trajnimit për Prokurorët dhe Gjyqtarët, Vjenë 2004, fq.36.

nisja e hetimit jo mbi bazën e kallëzimit të viktimës njihet ndryshe si **hetim proaktiv**. Nga praktika e deritanishme konstatohet se hetimet proaktive të strukturave policore pothuajse janë inekzistente. Pothuajse të gjitha procedimet penale të trafikimit të qenieve njerëzore, janë ndërtuar mbi bazën e një hetimi reaktiv. Shembull i qartë për këtë ishte dhe pasqyrimi i bërë në media i aktivitetit të trafikimit të fëmijëve rom nga Shqipëria në Greqi⁵⁴. Kjo është një shenjë që tregon se strukturat tona policore nuk janë ende në nivelin e duhur. Duke konsideruar se edhe në hetimet reaktive të kryera ka ende mjaft probleme, pjesa e mëposhtme e punimit do t'i referohet kryesisht hetimit reaktiv.

§ 14.1. Identifikimi i viktimës.

Identifikimi i një viktime si e tillë, është një nga detyrat më të vështira të prokurorit apo oficerit. Në mënyrën e sjelljes së tij ai duhet ta konsiderojë si viktimë të trafikimit, por në ndërgjegjen e tij profesionale duhet të ketë parasysh të gjitha versionet e mundshme. Ai duhet të bëjë kujdes të mos e ngatërrojë me veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm apo me vepra të tjera që lidhen me prostitucionin.

Duhet të kihen parasysh disa parime në momentin e identifikimit:

- Në intervistën e parë duhet të konsiderohet vetëm si viktimë potenciale.
- Identifikimi i plotë si viktimë trafikimi duhet të jetë vetëm rezultat i hetimit të plotë të elementëve të veprës penale.
- Për shkak të natyrës komplekse të veprës dhe nevojës së reflektimit të viktimës ndaj Stresit Post-Traumatik është e nevojshme kalimi i njëfarë kohe.
- Është e nevojshme të mblidhen prova të tjera veç deklarimeve.
- Teknika e pyetjes së viktimës së dyshuar synon detajet të cilat kanë vlerë të dyfishtë.
 - evidentimin e gënjeshtres, ose në të kundërt,
 - rritjen e besueshmërisë së deklaramit në gjyq

Për këtë, kontakti permanent psikologjik është kyçi i të kuptuarit të situatës.

⁵⁴ Top Chanel, emisioni “Fiks-Fare”, datw 14, 15-11-2006.

§ 15. Disa indikatorë të evidentimit të viktimave.

a) Kufizime të lirisë personale.

- Kufizim të zgjerimit të shoqërisë dhe të kontakteve sociale, – mbyllja në një ambient të izoluar, – vëzhgimi i vazhdueshëm i saj nga tutori dhe kontrolli në distancë nëpërmjet telefonave.

b) Mënyra të pagesës

- pamundësi për të vendosur për të ardhurat, nuk ka akses të drejtpërdrejtë mbi to, – pronari i shtëpisë publike ia kalon të ardhurat një të treti, – pagesa ndryshon nga rregullat e përgjithshme për vendaset.
- femra ka borxhe që nuk janë nën kontrollin e saj për të cilat duhet të punojë, - merr vetëm një minimum të ardhurash për mbijetesë.

c) Situata në punë

- kontroll i vazhdueshëm nga tutori, – orë të gjata në ambientet e shfrytëzimit, – nuk është e lirë të refuzojë klientë apo lloj shërbimi, nuk është e lirë të përfundojë punën dhe të kthehet në shtëpi, mbahet në distancë nga femrat e tjera në ambientet e shfrytëzimit.

d) Rekrutimi

- nuk ishte e informuar se do të bënte prostitutën apo për kushtet e prostituimit.

e) Në aspektin objektiv

- femra nuk ka pasaportë, – nuk ka para, – ka gjurmë keqtrajtimi – pamje të parregullt e neglizhente ndaj vetes – nuk guxon të flasë për problemin, – jep idenë se është instruktuar mirë (pasojë e nënshtrimit të psikikës së saj ndaj trafikantit), – përpiqet t’ia mbathë, – e shqetësuar, e paduruar, – shumë e ndjeshme, – shumë e frikësuar.

§ 15.1. *Indikatorë të tjerë.*

- moshja e viktimës – sa më e madhe është moshja, aq më pak mundësi ka për të qenë viktimë dhe e kundërta.
- gjinia e viktimës – femrat, grupi social më i rrezikuar.
- shtetësia e viktimës së mundshme – nëse shtetësia u takon vendeve të pazhvilluara, mundësia është më e madhe.
- vendndodhja e fundit – nëse është gjetur në ambiente të njohura si ambiente shfrytëzimi, mundësia është më e madhe.

Kontakti i parë me viktimën është vendimtar për ecurinë e hetimit dhe bazohet mbi parimet humanitare.

Çfarë duhet kihat parasysh nga prokurori dhe oficeri në vendosjen e marrëdhënieve me viktimën:

- Të trajtohen si viktima të një krimi të rëndë dhe të mos riviktimizohen. Në praktikën e përditshme vihet re që kallëzimet e marra nga policia nuk janë në kushtet e lirisë së vullnetit nga viktimat. Në njëfarë mënyre kallëzimi i tyre nuk është produkt i shprehjes së lirë, por shprehje e një presioni që ose ushtrohet nga policia ose ndjehet në mënyrën e përgjithshme të sjelljes.
- Qëndrimi i qartë, i hapur dhe i ndershëm me viktimat për çdo aspekt siguron besueshmëri, çka jep siguri në bashkëpunim për shkak të bindjes që krijon viktima se prokurori/oficeri kanë vërtet qëllim dënimin e autorit. Shpesh, në procese të tilla është vërejtur një qëndrim i ftohtë dhe formal nga prokurorët dhe oficerët.
- Nevoja e një periudhe reflektimi nëse ndodhet nën efektin e Stresit Post-Traumatik. Është pikërisht ky faktor që çon në deklarime jo të lidhura logjikisht por që nuk njihet sa duhet dhe, për këtë shkak, prokurori apo gjykata e çon drejt mbylljes procesin pasi këtë fakt e interpreton si gënjeshtër të viktimës.
- Përpyekjet për të mos ekspozuar të kaluarën e saj në publik, familje, gjyq. Sa më pak të flitet për të kaluarën e viktimës, aq më komforte do të ndihet ajo. Prokurori nuk duhet jo vetëm të thellohet në jetën e saj morale (nëse nuk është e domosdoshme për hetimin), por nuk duhet të lejojë që kjo të bëhet nga avokati në procesin gjyqësor). Për shkak të paragjyqimit që ndodh ndaj viktimave, shpesh prokurorët nuk e marrin parasysh këtë fakt.

- Përpjekje për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë fizik me trafikantët.

Kontakti psikologjik me viktimën. Në dallim nga hetimi dhe gjykimi i mjaft veprave të tjera penale me të dëmtuar, procedimet penale që lidhen me trafikimin njerëzor, e sidomos ato që lidhen me trafikun e fëmijëve dhe të femrave, kanë një veçori, nënvleftësimi i të cilës, mund të çojë në dëmtimin serioz të procesit. Në këto procedime, mbajtja e një kontakti psikologjik të ngrohte dhe të vazhdueshëm me viktimën është determinant dhe mund të ngrejë cilësisht procesin. Duke analizuar fenomenet psikologjike post-traumatike të viktimës, është e nevojshme që qysh në momentin e parë të kontaktit me viktimën të bëhet kujdes për të mos riviktimizuar ato. Kjo nënkupton shpesh dhe nevojën e pranisë së një psikologu gjatë marrjes në pyetje të tyre. Trajtimi njerëzor, jofyës, i ngrohtë me elementë të transmetimit të besimit të viktimës për rivendosjen e drejtësisë, do të ndikojë dukshëm në një bashkëpunim me të frytshëm të tyre. Ky kontakt psikologjik duhet të vazhdojë dhe në momentin e pyetjes në gjykatë. Viktimës duhet t'i bëhet e qartë se si do të zhvillohen ngjarjet në gjykatë duke i dhënë besim për të mos pasur frikë nga i pandehuri. Përveç sa më sipër, nevoja e një personi të tretë të pranishëm (mundësisht psikolog, punonjës social, apo person tjetër në mungesë të tyre) gjatë procesit të marrjes së deklarimeve nga viktimat e trafikimit është i domosdoshëm dhe për të parandaluar çdo keqkuptim për mënyrën e marrjes së deklarimeve apo probleme të tjera të evidentuara jo rrallë herë në proceset e kësaj natyre.

Qëndrimi ligjor ndaj viktimave të trafikimit njerëzor. Konstatohet se ka një qëndrim jo ligjor ndaj viktimave që për shkak të përfshirjes në trafikim, kanë konsumuar elementë të veprave penale të ndryshme. Në këtë aspekt mbahet mirë parasysh si Konventa e Palermos dhe protokollet e saj shtesë dhe Konventa Evropiane të cilat, pas ratifikimit janë bërë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm. Sipas tyre, përjashtohen nga përgjegjësia penale viktimat e trafikimit kur për shkak se i janë nënshtruar këtij trafikimi, kanë konsumuar elementë të ndonjë veprave penale. Kjo nuk do të thotë që ato të përjashtohen nga kjo përgjegjësi për vepra penale që nuk lidhen me pozitën e tyre si viktimë në trafikim.

Në këtë kontekst duhet të bëhet sidomos kujdes, kur merret në përgjegjësi penale një viktimë trafikimi për kallëzim të rremë apo dëshmi të rreme. Shkaku kryesor që arrihet në këtë situatë është pikërisht mungesa e kontaktit psikologjik të vazhdueshëm me viktimën. Prokurori do të mendojë për përgjegjësi penale të mundshme ndaj viktimës, vetëm pasi të ketë përfunduar përpjekjet për të provuar akuzën ndaj të pandehurit për trafikim. Në këto përpjekje, detyrimisht përfshihen hetimet që lidhen me gjetjen e

shkaqeve të ndryshimit të deklaramit nga viktimat. Nëse ai konkludon dhe provon se kjo është bërë si rezultat i kanosjeve ndaj saj apo familjarëve, këto prova ai duhet t'i përdore për të mbështetur akuzën ndaj të pandehurit. Nëse prokurori provon se "viktima" është duke përdorur drejtësinë, për arritjen e qëllimeve të caktuara, duhet të pushojë akuzën për të pandehurin për trafikim dhe duhet të mendojë për përgjegjësinë penale të "viktimit". Vlerësimi i këtij momenti kërkon të bëhet një analizë e hollësishme e provave, kërkon objektivitet dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie nga prokurorët.

§ 16. Bashkëpunimi me OJF-të që merren me trajtimin e viktimave.

Bashkëpunimi me OJF-të përbën një garanci për mbarëvajtjen e një procedimi penal për trafikim (veçanërisht ato për trafikim të femrave). Në këtë përfundim arrihet po të njohim mirë rolin e këtyre agjencive si dhe fenomenet psikike post-traumatike që ndodhin në ndërgjegjjen e viktimës. Këto fenomene njihen me termin Stresi Post Traumatik dhe reflektohen me deformime të dukshme të psikikës së viktimës që janë pasqyrim i dhunës fizike dhe psikike permanente të ushtruar mbi të. Në këtë mënyrë, duke qene se funksioni kryesor i këtyre OJF-ve është riaftësimi mendor e social i viktimave, mund të arrihet në një bashkëpunim të drejtë me viktimat për të ndërtuar një proces penal të qëndrueshëm. Bashkëpunimi me OJF-të stimulon gjithashtu raportimet e rasteve të trafikimit kur viktimat pranojnë të trajtohen prej tyre, por nuk kanë vendosur të bashkëpunojnë me drejtësinë.

Parimi bazë i bashkëpunimit – ç'është më e mira për viktimën.

Funksionet themelore të agjencive gjatë ndjekjes penale janë:

- Asistenca psikologjike, sociale për rritjen e besimit e sigurisë.
- Shoqërim në seancat hetimore apo gjyqësore që garantojnë një prani efektive të saj.
- Masat mbrojtëse ndaj viktimës (ofrimi i qendrave të strehimit).
- Masat për mbrojtjen e intimitetit të viktimës (sidomos nga mediat).
- Ndërgjegjësimin e viktimës për rolin e saj, dhe për mënyrën e funksionimit të procesit penal hetimor dhe gjyqësor.
- Ndërgjegjësimin e saj për rolin dhe të drejtat e të akuzuarit.

- Qenia “zëdhënëse” e viktimës pranë gjyqësorit për problemet që ajo shfaq dhe që lidhen me gjyqësorin⁵⁵.

Kontakti i vazhdueshëm dhe i ngrohtë me viktimat e trafikimit, transmetimi i besimit mbi drejtësinë, sigurinë personale dhe të familjes, bashkëpunimi sa më i mirë dhe pa paragjykime me OJF-të, mund t’i japë përgjigje një prej pyetjeve dhe problemeve më të vështira që hasen në procedimet penale të trafikimit. Cila është kjo pyetje? – Ajo kishte mundësi të kallëzonte. Pse nuk e bëri këtë? A është vërtetë viktimë dhe nuk ka kallëzuar për shkak të deformimit të psikikës, shkaktuar nga dhuna e trafikantit, apo është në një kontratë civile me të për të nxjerrë përfitime nga ushtrimi i prostitucionit.

§ 17. Veprimet hetimore.

Metodologjia e marrjes së deklarimeve Çfarë duhet pasur parasysh në taktikën e marrjes së deklarimeve nga një viktimë trafikimi.

- Deklarimi të ketë linjë logjike dhe të pasqyrojë rrjedhën e ngjarjeve.
- Me viktimë që vuajnë traumën kërkohen më shumë se një deklaram për të arritur në pikën e mësipërme.
- Shmangia e paragjykimit për besueshmërinë e viktimave të trafikimit për prostitucionin siguron objektivitetin e hetimit.
- Të eksplorohehen sa më shumë detaje – viktimë bëhet e besueshme dhe siguron nivelin e besueshmërisë nga gjykata, prokurori është i përgatitur ndaj pyetjeve të mbrojtjes dhe shton mundësinë e gjetjes së provave të tjera.
- Të bëhet e qarte se eksplorimi i detajeve është nevojë e garantimit të suksesit dhe jo pjesë e kuriozitetit.
- Përdorimi i asociimeve në të kujtuarit e datave, vendeve është i rëndësishëm në lidhjen kronologjike të fakteve.
- Fiksimi kronologjik i momenteve kyç të trafikimit për të vendosur në kohë faktet e tjera.

Kallëzimi dhe deklaramet e viktimës, edhe pse kanë vlerë parësore, nuk presupozon doemos marrjen në cilësinë e të pandehurit dhe zgjedhjen e masës së sigurimit ndaj autorit, sikurse ka ndodhur rëndom në të tilla procese. Ky kallëzim duhet të shërbejë si bazë për nisjen e veprimtarisë hetimore. Dhe vetëm kur arrihet një nivel i kënaqshëm provash të

⁵⁵ ICMPD, Manual i trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Vjenë 2004, fq. 101.

kryqëzuara, mund të kalohet në aktivitet hetimor të hapur. Përveç rasteve të një nevoje të ngutshme për të operuar menjëherë me masa sigurimi, zgjedhja e një strategjie të tillë jep avantazh për të kryer hetime të fshehta duke e mbajtur në “gjumë” autorin, çka jep lehtësi në grumbullimin e provave. Në të kundërt, me shfaqjen e hetimit, i pandehuri do të vërë në lëvizje të gjitha mundësitë e tij për të penguar hetimin. Një avantazh tjetër është se, pas marrjes së masës së sigurimit që shpesh në këto raste është “arrest në burg”, afatet hetimore kufizohen në afatet e paraburgimit dhe prokurori do të duhet që, brenda afatit të paraburgimit, të mbledhë provat e nevojshme, çka shpesh është e vështirë.

Eksperienat më të mira ndërkombëtare në lidhje me hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore prezantojnë një mënyrë racionale në marrjen e deklarimeve nga viktimat. Duke qenë se fenomeni është mjaft kompleks dhe elementët e veprës po ashtu, kanë hartuar një listë përgjithësisht standard me pyetje të cilat verifikohen gjatë marrjes në pyetje të viktimave. Kjo nuk përjashton mundësinë që, në varësi të përgjigjeve apo nga situatat, të mos bëhen pyetje të tjera apo të shmangen një pjesë e atyre të listuara. Një gjë e tillë na jep mundësi të marrim sa më shumë prova nga deklarimi, të evidentojë sa më mirë elementët e veprës penale, të bëjmë sa më të besueshme viktimën.

§ 17.1. Veprimet e mëtejshme hetimore.

- Marrja e të gjitha provave të evidentuara nga deklarimi i viktimës ose siç njihet ndryshe, verifikimi i thënieve.
- Të shoqërohen me regjistrim si foto, video në lidhje me vendet dhe hollësitë për to duke u përqendruar në momentet që nuk janë publike.
- Të pyeten dëshmitarët e evidentuar nga viktima.
- Të fillojë puna për identifikimin e autorëve mbi bazën e të dhënave të marra nga deklaratimet e viktimës.
- Të evidentohen me saktësi vendbanimet, vendet e punës, të frekuentimit të autorëve për të organizuar arrestimet e kontrollat e tyre.
- Të bëhet ekzaminimi mjeko-ligjor i viktimës duke pasur parasysh se edhe pse duhet të këmbëngulim në këtë pikë, do të jetë viktima që do të vendosë. Për të miturit, nevojitet leja e prindit apo e kujdestarit.

- Arrestimi i të dyshuarve dhe kujdesi për respektimin rigoroz të aspekteve procedurale. Situata aktuale prezanton problemin e ndërhyrjeve të menjëhershme të policisë me ndalime shpesh dhe të paligjshme, bazuar këto vetëm në kallëzimin e një viktime të dyshuar. Një situatë e tillë ndodh si për faktin e dëshirës për ta kapur menjëherë autorin, ashtu dhe për shkak të një edukimi profesional jo të mirë të policisë.
- Kontrolli i vendeve dhe sekuestrimi i provave në proces, që kërkon kujdes pasi ai siguron provën dokumentare, e cila ka aftësi bindëse më të madhe, jep mundësi për kryqëzim provash duke mos u mjaftuar vetëm me deklaramë, jep mundësi për të vënë të pandehurin në pozita pohuese dhe bashkëpunuese, siguron besueshmërinë e deklaramëve të viktimës.

Procesi psikologjik që zhvillohet “Nëse konfirmohen deklaramet e viktimës për pjesën më të madhe të saj, pjesë që lidhet me elementë objektivë dhe të mundshëm për t’u verifikuar, atëherë sigurohet besueshmëria e deklaramit dhe për pjesët e tjera të këtij deklarami që lidhen me elementë subjektivë dhe të vështirë ose të pamundur për t’u konfirmuar, por që janë elementë të veprës penale dhe të fajësisë së autorëve”.

- **Rregulli i artë gjatë kontrollit:** Brenda ligjit, të merret gjithçka që mund të përbëjë provë – në rast se nuk je i sigurt, përsëri merre, ajo mund të kthehet në vend përsëri më vonë, por po të lihet pa u marrë, atë mund të mos e gjesësh më kur të vijë koha që të kuptohet rëndësia që mund të ketë pasur materiali si provë⁵⁶.

§ 17.2. *Hetimi financiar.*

Hetimi financiar nënkupton gjurmimin e aseteve të vëna nga autorët si rezultat i aktivitetit kriminal të tyre me synim sekuestrimin e më pas konfiskimin e tyre. Rëndësia e hetimit financiar është e dyfishtë. **Së pari**, është një provë në duart e prokurorit për të mbrojtur akuzën e ngritur duke bindur gjykatën se i pandehuri nuk ka një aktivitet të tillë ligjor që mund të sjellë të ardhurat e hetuara apo pasuritë e sekuestruara. **Së dyti**, është një goditje e rënde për aktivitetin kriminal në trafique, ku qëllimi kryesor është pikërisht realizimi i fitimeve të mëdha, në mënyre të kundërligjshme e të menjëhershme. Në kushtet shqiptare të një ekonomie informale, prokurorët nuk duhet të mjaftohen vetëm me marrjen e vërtetimeve nga zyra të

⁵⁶ ICMPD Manual trajnimi për policinë në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, fq. 92.

ndryshme që merren me regjistrim pasurish. Ata duhet që, nëpërmjet oficerëve e agjentëve të policisë gjyqësore të sigurojnë informacionin e nevojshëm për pasuritë e paregjistruara, për shuma të padepozituara, për shpenzime të paevidentuara dhe në bazë të tyre të zhvillojnë hetimin financiar të autorëve.

Hetimi financiar gjithashtu bën të mundur që nëse gjatë hetimit të procedimit penal nuk do të arrihet të provohet se pasuria në dispozicion të autorit është produkt i veprës penale konkrete që po hetohet, mund të përdoret Ligji “Mbi parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” duke ia kaluar barrën për të provuar ligjshmërinë e kësaj të pasuri autorit të veprës.

§ 17.3. Sigurimi i provës.

Në çështjet penale të trafikimit të qenieve njerëzore sigurimi i provës (dëshmisë së viktimës), neni 316 e në vijim K.Pr.Penale është një element mjaft i rëndësishëm. Përdorimi me efikasitet i dispozitave në lidhje me sigurimin e provës kanë efekt përcaktues për fatin e procesit.

Rëndësia e sigurimit të provës, kryesisht të viktimave, lidhet me faktin se ato janë në presion të vazhdueshëm nga trafikantët, ato janë nën kërcënimin e jetës së tyre apo të familjes, janë nën ndikimin e premtimeve ekonomike apo sentimentale të autorëve, etj.,.

• Sigurimi i provës garanton sukses kur përdoret me zgjuarsi nga prokurori dhe kur siguron këto kushte:

- Kontakt psikologjik të vazhdueshëm me viktimën,
- Marrjen e masave mbrojtëse për të eliminuar përpjekjet e trafikantëve për të vendosur lidhje me viktimën,
- Marrjen e masave mbrojtëse për familjen,
- Përcaktimin e momentit më të favorshëm për realizimin. Vlerësimi i këtij momenti paraqet rëndësi të veçantë. Praktika fillestare e hetimit të këtyre procedimeve paraqet situatën kur sigurimi i provës bëhet menjëherë pas kallëzimit, çka në shumicën e rasteve nuk ka qenë efektive pasi konsumonte fazën e hetimit të fshehur. Momentin e realizimit të sigurimit të provës prokurori duhet ta përcaktojë në raport me:

- nevojën e rikuperimit nga stresi post-traumatik të viktimës, dëshmia e së cilës duhet të sigurohet;
- kohën e nevojshme për të bërë verifikimet e deklarimeve të viktimës pasi mundet që viktimat të bëjnë dhe kallëzim të rremë;

- nivelin e masave mbrojtëse të marra për viktimën dhe familjarët e saj në mënyrë që viktima të jetë e qetë në dëshminë e saj;
- afateve hetimore që ka në dispozicion dhe afatet e paraburgimit;
- presionit të publikut dhe OJF-ve për të përfunduar procesin.

§ 18. Disa probleme të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në nivelet e bazës së policisë, por dhe në disa prokurori rrethesh ka një mungesë të kuptuar të veprës penale të trafikimit në të gjithë elementët e tij e, sidomos në rrezikshmërinë e tij dhe në raportet me dhënien ndihmë për kalim kufiri të paligjshëm.

Marrëdhëniet midis policive të ndryshme dhe prokurorisë nuk janë në nivelin më të mirë të mundshëm. Besimi reciprok i tyre është mjaft i dëmtuar. Prokuroria s'ka besim në aftësitë e policisë dhe, nga ana tjetër, policia nuk ka besim në integritetin e prokurorisë.

Niveli jo i mirë profesional i policisë shprehet kryesisht në arrestimet dhe ndalimet e nxituara të personave të dyshuar duke dëmtuar mjaft rëndë procesin penal, në pamundësinë e saj në menaxhimin e një procedimi që prej fillimit e deri në fund.

Treguesit e performancës së policisë nuk duhet të mbështeten te numri i arrestimeve por te numri i çështjeve penale të ndjekura nga prokuroria si edhe në cilësinë e dosjeve të dorëzuara duke i ndjekur ato deri në përfundim të gjykimit.

Integriteti i prokurorisë është vënë në dyshim nga policia për shkak se hetimi i veprave të referuara prej tyre nuk u jepen atyre për t'u ndjekur, por menaxhohen ose nga vetë prokurorët ose nga oficerët e seksioneve të prokurorisë.

Paqëndrueshmëria e theksuar në detyrë dhe mungesa e një karriere të garantuar në polici ka bërë që dhe ai besim reciprok dhe ekspertizë që mund të jetë fituar nga oficerë të veçantë të goditet. Për nga natyra e tij ky lloj krimi kërkon specializim të posaçëm dhe këto lëvizje, në mënyrë të veçantë dëmtojnë goditjen efektive të trafikantëve. (Mungesa e regjistrimit themeltar, kartave të identitetit).

Mungesa e hetimeve proaktive në fushën e trafikimit ka bërë që prokuroria të mbetet vetëm në hetimin e rasteve të nisura mbi bazë kallëzimi të viktimave apo familjarëve të tyre. Niveli i përdorimit të teknikave speciale të hetimit në këto procedime krahasuar me ato të përdorimit në luftën kundër trafikut të drogës janë mjaft të ulëta.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në polici dhe prokurori edhe pse ka njohur përmirësime nuk i përgjigjet dinamikës së hetimeve. Duke pasur parasysh se në përqindjen më të madhe trafikimi është ndërkombëtar dhe se provat themelore të trafikimit lidhen me vendet e destinacionit, shpejtësia dhe efektiviteti i bashkëpunimit ndërkombëtar marrin prioritet. Burokracia aktuale në ndihmën e ndërsjellë dhe mungesa e hetimeve të përbashkëta nuk janë në favor të efektivitetit të goditjes së krimit.

Hetimi financiar i autorëve aktualisht paraqitet mjaft skematik dhe strukturat janë të patrajnuara në lidhje me të. Dhe, nëse i shton kësaj nivelin lartë të informalitetit të ekonomisë në vend problemi bëhet dhe më i vështirë.

ARQILE KOÇA

Prokuror

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm

Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar

Tiranë, Mars 2007

1.6. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Itali: probleme dhe perspektiva në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

§ 1. Organizatat kriminale transnacionale: dukuria e emigracionit klandestin dhe e trafikut të qenieve njerëzore.

Gjatë njëzet vjetëve të fundit është shënjuar një rritje e ndjeshme e flukseve të paligjshme të emigracionit të krijuar për shkak të rënies së disa mureve, të konflikteve civile dhe ndëretnike, të legjislacioneve demografike dhe gjendjes së varfërisë në të cilën gjenden shumë popullsi.

Këto flukse kanë të bëjnë kryesisht me klandestinë në kërkim të një mundësie për një jetë më të mirë që, me premtimin e gënjeshtërt të një pune apo të një martese, kanë mbërritur në vendet perëndimore, ndër të cilët edhe në Itali, ku përkundrazi janë detyruar të ushtrojnë prostitucion dhe të kryejnë punë “në të zezë” në kushte shumë shpesh çnjerëzore apo të praktikojnë, nëse në një moshë të mitur, lypjen për disa orë në ditë.

Organizatave kriminale transnacionale administrojnë trafikun e klandestinëve përmes rrugëve të ndryshme, të përdorura edhe për trafiqe lëndësh narkotike dhe të armëve.

Çmimi për udhëtimin, në pjesën më të madhe të rasteve i parapagar nga organizatorët e trafikut të paligjshëm, luhetet nga 1.000 deri në 15.000 dhe deri në 35/40 mijë dollarë, sipas vendit të prejardhjes së klandestinit.

Parapagimi i çmimit e bën emigrantin skllav sepse, pasi mbërrin në vendin e destinacionit, duke qenë pa asnjë mjet jetese dhe duke pasur mbi vete barrën e borxhit të marrë, mbetet plotësisht nën prenë e trafikantëve.

Çdo përpjekje për të ngritur krye mbytet nga veprimet e vazhdueshme të dhunës mbi viktimat dhe kërcënimet e rënda, edhe me vdekje, kundrejt familjarëve të tyre që vazhdojnë të jenë në vendet e prejardhjes.

Të ardhurat vjetore nga trafiku⁵⁷ i qenieve njerëzore, që mund të përcaktohet një formë e urryer e skllavërisë moderne, vërtitet sipas vlerësimeve të fundit, mes shtatë⁵⁸ apo trembëdhjetë⁵⁹ miliardë dollarë.

⁵⁷ Tashmë është bërë zakon të bëhet dallim mes ndihmës së organizuar të emigracionit klandestin (smuggling of migrants) dhe trafikut të qenieve njerëzore (trafficking in human beings). Në ndihmën e emigracionit klandestin janë vetë emigrantët që u drejtohen përfaqësuesve të organizatave kriminale që, përmes pagesës së një shifre (çmimi), garantojnë emigracionin. Në këtë rast marrëdhënia kohore mes emigrantit dhe trafikantit

Fitimet jashtëzakonisht të mëdha të investuara sërish nga trafikantët në vende të ndryshme të botës, si në trafike të tjera të të njëjtit lloj ashtu dhe në tregje të paligjshme, si brenda qarqeve ekonomike-financiare të ligjshme, duke u mbështetur edhe në profesionistë të zotë dhe në teknologjitë më moderne dhe të përparuara, duke dëmtuar në këtë mënyrë ekonominë e ligjshme⁶⁰.

Për sa i takon Italisë, kohë pas kohe anije të vjetra dhe gomone zbarkojnë grupe të dëshpëruarish në brigjet e gadishullit, në veçanti ato puljeze, kalabreze dhe siciliane dhe, më së fundi, për shkak të presionit investigues të forcave të rendit dhe të magjistraturës në këto zona, në ato të Adriatikut dhe Venetos.

Njëkohësisht, shumë njerëz mbërrijnë në Itali me mjete ajrore⁶¹ apo përmes rrugësh të vështira e rrezikshme që ndodhen në pikat kufitare mes Italisë e Sllovenisë apo duke qëndruar të fshehur në kontenierë apo përmes udhëtimesh të stërmundimshme në autobuse⁶².

Shumë shpesh tregtia e jetëve njerëzore bëhet në mënyrë krejt të hapur, aq sa është e vërtetë që organizata vendase që veprojnë në Rumani për transportin në Itali të klandestinëve, përmes Kroacisë dhe Sllovenisë, botojnë në gazetatat e revistat e përditshme oferta për transferime të paligjshme përmes njoftimesh të posaçme apo shkruajnë në muret e qytetit fjali të llojit *shpie njerëz në Itali, ofrojmë shoqërim në Itali, seriozitet maksimal dhe përvojë në shoqërim në Itali*⁶³.

Sipas organizatës ndërqeveritare *International Center for Migration Policy Development* e Vjenës, çdo vit futen në mënyrë të paligjshme në

kufizohet me kohëzgjatjen e udhëtimit. Ndërsa në rastin e trafikut të qenieve njerëzore personat që mendojnë të emigrojnë rekrutohen drejtpërsëdrejti nga organizatorë apo nga drejtues të trafikut përmes përdorimit të dhunës, të shantazhit dhe të mashtrimit, për t'iu gjegjur një kërkesë të tregut ekzistues në vendet e destinacionit dhe marrëdhënia mes trafikantit dhe emigrantit vijon edhe në vendin e destinacionit.

⁵⁸ Vlerësimi i Organizatës ndërkombëtare të emigracioneve.

⁵⁹ Vlerësimi i Antislavery International Londër.

⁶⁰ Emblematik është rasti i kroatit Josip Loncaric, i cili, si taksist klandestinësh gjatë kufirit italo-slloven, ka arritur të ketë fitime të mëdha aq sa i dhanë mundësi të krijonte një organizatë të përbërë nga 200 vetë dhe të blejë një kompani ajrore, me seli në Tiranë, të cilën e përdorte për transferime të paligjshme më të lehta të emigrantëve që vinin nga Kina, Filipinet, Bangladeshi dhe nga Evropa Lindore. Loncaric, pas dy vjetësh shpalljeje në kërkim u arrestua në 22.11.2000.

⁶¹ Nigerianë dhe kinezë.

⁶² Gra ukrainase, moldave, ruse, letoneze, estoneze dhe bielloruse.

⁶³ N.M.Pace, Prokuror i Prokurorisë së Triestes, flukset e emigracionit të paligjshëm në Konferencën Ndërkombëtare mbajtur në Napoli më 27-29 maj 1999.

vendet evropiane rreth 400.000 persona dhe në Bashkimin Evropian jetojnë aktualisht nga tre deri në tetë milionë emigrantë klandestinë⁶⁴.

Sipas vlerësimeve të disa organizatave jo qeveritare, më shumë se 500.000 gra janë trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual në Evropë dhe vetëm në Ukrainë ka po kaq gra viktimash të mundshme të këtij tregu kriminal.

Gjithashtu në Japoni, rreth 100.000 gra, për pjesën më të madhe filipinase dhe tajlandeze, dhe gjithnjë e më shumë të mitura, shfrytëzohen për qëllime seksuale.

Në Itali, prostitucioni i personave të trafikuar administrohet, pothuaj si monopol, nga kriminelë sidomos të etnisë shqiptare. Këta të fundit, përmes një dhune të jashtëzakonshme, i detyrojnë gratë dhe vajzat, shpesh në një moshë të mitur dhe jo rrallë të rrëmbyera në vendet e origjinës, të jetojnë në kushte të mirëfillta skllavërie, duke i shtrënguar të shesin në mënyrë çnjerëzore trupin e tyre dhe duke pretenduar nga çdonjëra prej tyre, përfitime që nuk janë më pak se 500 dollarë⁶⁵.

Këta kriminelë janë anëtarë grupesh të organizuara që kanë rregulla të hekurta sjelljeje që, nëse shkelen, mund të ndëshkohen deri dhe me vdekjen e ithtarëve të tyre.

Këto grupe, të rregulluar në mënyrë hierarkike, kanë krijuar një mekanizëm të mirëfilltë industrial i cili ushqehet nga një *“lëndë e parë e pashtershme”* që po ia zë gjithnjë e më shumë vendin fajdes e që transferohet nga një vend prodhues tek një vend konsumator⁶⁶.

Në Itali veprojnë në shfrytëzimin e prostitucionit të bashkëkombësve edhe grupe kriminale afrikane, sidomos nigeriane. Ato karakterizohen nga copëzime etniko-fisnore, degëzime të një strukture kriminale, të përbërë nga pak familje që e kanë qendrën vendimmarrëse në Nigeri.

Koloni të shumta prostitutash veprojnë çdo ditë dhe gjatë gjithë vitit në zona të ndryshme të territorit kombëtar, ku ndodhin gjithnjë e më shpesh

⁶⁴ E.Marotta – veprimtaritë e Europol, relacion në konferencën mbi Konventën e O.K.B.-së.

⁶⁵ Jo rrallë, viktimat e këtij shfrytëzimi ndëshkohen, edhe me vrasjen e tyre, në rast se shkelin rregullat çnjerëzore të diktuar nga “padronët” e tyre (në kohët e fundit, është parë në zonat e veriut dhe të qendrës së Italisë një rritje e krimeve kundër personit).

⁶⁶ Shembull për këtë është hetimi gjyqësor që ka vërtetuar se anëtarët e një organizate kriminale shqiptare, pasi kanë shfrytëzuar pareshtur dhe dhunshëm prostitucionin e disa grave, edhe me përdhunime në grup, i kanë lënë ato shtatzanë dhe, pasi i kanë çuar me forcë jashtë vendit, i kanë bërë të lindin, duke shitur fëmijët e tyre përmes praktikave mashtruese të birësimit, tek çifte që nuk kanë fëmijë të tyre.

përplasje mes njerëzve të *mafieve* nigeriane dhe shqiptare për zotërimin e territorit.

Vënia në kushte skllavërie e vajzave nigeriane, mundësohet edhe nga besimet e tyre fetare. Në fakt, mafia nigeriane, ua beson kontrollin e vajzave që duhen shfrytëzuar grave, edhe ato nigeriane, të quajtura *madame*, të cilat, shumë shpesh, i nënshtrojnë viktimat ndaj riteve të tmerrshme të magjisë *woodoo* për t'i detyruar të shesin trupin e tyre.

Por dukuria e kësaj skllavërie moderne nuk ka të bëjë vetëm me gratë por edhe me të miturit, shpesh fëmijë që shpëputen me forcë nga të afërtit e familjet e tyre apo që shiten pa asnjë skrupull nga prindërit dhe bëhen pre gjithnjë e më shpesh e abuzimeve seksuale dhe e dokumentacionit pornografik apo që përdoren në punë tmerrësisht të rënda apo në veprimtari stërmunduese lypjeje, apo që dyshohet të jenë objekt i trafikut ndërkombëtar të organeve⁶⁷.

Për sa i përket këtij trafiku të fundit, ka raste hetimi sipas të cilave marrja e një organi përfaqëson një mënyrë pagese që klandestini duhet të përballojë në këmbim të transferimit të tij nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit.

§ 2. Perspektiva për një veprimtari luftime efikase: bashkëpunimi gjyqësor dhe i policisë mes vendeve të ndryshme.

Organizatave e huaja (kineze, bengaleze, shqiptare, nigeriane, turke, etj..) që menaxhojnë emigracionin klandestin dhe trafikun e qenieve njerëzore kanë kapërcyer tashmë prej kohësh kufijtë kombëtarë edhe për shkak të mjeteve moderne të transportit dhe të komunikimit, edhe telematikë, dhe për shkak të mundësisë së madhe për të lëvizur që, siç e thamë më lart, u bë e mundur nga heqja e shumë kufijve. Përkrah globalizimit të tregjeve të ligjshme shkon tashmë globalizimi i krimit, i administruar në rrjet nga organizata kriminale transnacionale⁶⁸.

⁶⁷ Shembull për këtë është hetimi i kryer mbi një trafik pamjesh të tmerrshme të pedofilisë të përhapura në gjithë botën përmes internetit, i menaxhuar nga kriminelë me prejardhje ruse dhe një tjetër hetim që kish të bënte me fëmijë të shitur apo të paregjistruar në lindje apo të rrëmbyer apo të zhdukur në mënyrë të mistershme të dyshuar se janë objekt i një trafiku ndërkombëtar organesh.

⁶⁸ Në një konferencë të mbajtur në Kazerta më 8 deri në 10 shtator 2000, e organizuar nga Këshilli i Evropës, në bashkëpunim me Drejtorinë Kombëtare Antimafia dhe Universitetin II të Studimeve të Napolit, që kanë për objekt konferencën e parë panevropiane të Prokurorëve të specializuar në fushën e krimit të organizuar, Prokurori Kombëtar

Më shumë se në një takim, sidomos në takime ndërkombëtare, është theksuar nevoja për një bashkëpunim gjyqësor gjithnjë e më të ngushtë mes Shteteve të ndryshme dhe përgatitjes së menjëhershme të një legjislacioni sa më të ngjashëm të paktën për vendet e Evropës së Bashkuar, për të përballuar në mënyrë më të vendosur përmasat ndërkombëtare të organizatave kriminale që shfrytëzojnë me shume zotësi, dallimet që ekzistojnë mes ligjeve penale kombëtare duke zgjedhur të veprojnë dhe strehohen në territore të qeverisura nga legjislacione më të favorshme për ta.

Bashkimi Evropian është angazhuar prej kohësh në luftën kundër fenomenit të trafikut të qenieve njerëzore. Në fakt, të shumta kanë qenë ndërhyrjet e përbashkëta, konventat, vendimet kuadër të organizmave kompetentë, që kanë synuar të përmirësojnë koordinimin e veprimeve parandaluese dhe ndëshkuese të çdo Shteti. Këto instrumente, të adoptuar në zbatim të nenit K1 të traktatit të Amsterdimit, në të cilin parashikohet detyrimi për Shtetet që të adoptojnë të gjithë instrumentet e bashkëpunimit të nevojshëm për ta bërë efikase veprimtarinë e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, parashikojnë një bashkëpunim të ngushtë mes Forcave të Policisë, Autoriteteve Doganore dhe Autoriteteve të tjera administrative dhe, në zbatim të nenit K3 të po këtij traktati, mes Autoriteteve Gjyqësore⁶⁹.

Nevoja për të përgatitur norma të përbashkëta për të luftuar kriminalitetin e organizuar është ndër një jo vetëm nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe në nivel botëror. Në fakt, O.K.B. ka miratuar një konventë kundër kriminalitetit të organizuar, në të cilën saktësohet një

Antimafia, theksoi se globalizimi i tregjeve tashmë shoqërohet nga krimi, i administruar në rrjet nga organizata transnacionale.

⁶⁹ Trafiku i qenieve njerëzore ka qenë më pas në qendër të punimeve të takimit të kryetarëve të shteteve dhe qeverive të Bashkimit Evropian, mbajtur në Tampere më 15 e 16 tetor 1999. Në dokumentin përfundimtar të takimit, në pikën 23, u theksua edhe një herë se *Këshilli i Evropës është i vendosur të përballojë në burim emigracionin e paligjshëm sidomos duke luftuar ata që merren me trafikun e qenieve njerëzore dhe me shfrytëzimin ekonomik të emigrantëve. Ai kërkon të adoptojë norma që parashikojnë sanksione të ashpra kundër këtij krimi të rëndë. Këshilli ftohet të adoptojë, në bazë të një propozimi të Komisionit një normativë të posaçme. dhe në pikën 48, Këshilli Evropian bie dakord që, për sa u takon legjislacioneve penale kombëtare, përpjekjet që synojnë të sjellin përkufizime, inkriminime dhe sanksione të përbashkëta që duhet të përqendrohen në radhë të parë mbi një numër të kufizuar sektorësh me rëndësi të veçantë ndër të cilët trafiku i qenieve njerëzore dhe, në veçanti, shfrytëzimi i grave dhe shfrytëzimi seksual i të miturve.*

Në këtë takim trafiku i qenieve njerëzore u përcaktua, sëbashku me krimet e tjera, si sektor parësor i *skuadrave hetimore të përbashkëta* (mes dy apo më shumë Shteteve), skuadra të krijuara më pas nga konventa për ndihmën gjyqësore në fushën penale mes Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, adoptuar në Bruksel më 29.05.2000.

koncept mbi krimin e organizuar që përkon me legjislacionet e vendeve që kanë sisteme juridike mjaft të ndryshme mes tyre dhe forcohet sistemi i bashkëpunimit gjyqësor.

Teksti i Konventës u shpall me firmën e Shteteve Anëtare në një konferencë që u mbajt në Palermo në dhjetor 2000.

Iu bashkëngjitën Konventën tre Protokolle, një prej të cilëve pikërisht mbi trafikun e qenieve njerëzore që e detyron çdo Shtet nënshkruar të parashikojë në të drejtën e vet kombëtare këtë krim specifik penal dhe t'i trajtojë me humanizëm viktimat e kësaj tregtie të turpshme sa dhe fitimprurëse.

§ 3. *Legjislacioni italian në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore: në veçanti Ligji i fundit nr.228, i dt. 11.08.2003.*

Në gusht të vitit 2003, legjislacioni italian futi norma specifike të të drejtës penale dhe procedurale penale, që synonin të përmirësonin veprimtarinë e luftës kundër trafikut (*trafficking*) të qenieve njerëzore⁷⁰.

⁷⁰ Me nxjerrjen e D.L.n.286, dt. 25.07.1998 u shpall dhe një Tekst Unik lidhur me rregullimin e emigracionit dhe normave mbi gjendjen e të huajit. Në aspektet e veta penale teksti Unik parashikoi emigracionin e parregullt si shkelje e pastër administrative (ndëshkuar me mospranim dhe dënim) dhe sjelljen e atij që e ka ndihmuar (*smuggling*) si krim. Parashikimet penale që gjenden në nenin 12 të Tekstit Unik ishin dy: ndihma për hyrjen e paligjshme dhe ndihmën për qëndrimin e të huajit të hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin e Shtetit. Krimi i parë, përfaqësuar nga kryerja e thjeshtë e veprimtarive që synojnë të ndihmojnë hyrjen ... ndëshkohej me burgim deri në 3 vjet ... dhe me burgim nga 4 deri në 12 vjet apo nga 5 deri në 15 vjet në rast se ekzistojnë rrethana rënduese. Me Ligjin 30.07.2002, nr.189, me nismë qeveritare, është riformuluar plotësisht neni 12 i Tekstit Unik si më sipër, por dënimet në thelb mbetën të pandryshuara (i referohet leximit të tekstit legjislativ).

Duket e udhës të theksojmë se, parashikimi i ri që përmban Neni 3, pika pesë e nenit 12, për ndihmën që mund të japë në veprimin luftues ndaj organizatave transnacionale që merren me trafikun e qenieve njerëzore. Sipas kësaj norme, për krimet e parashikuara nga paragrafët e mëparshëm, dënimet zvogëlohen deri në gjysëm ndaj të pandehurit që përpiqet të shmangë që veprimtaria kriminale ka pësuar rrjedhoja të tjera, duke ndihmuar konkretisht Autoritetin e Policisë ose Autoritetin Gjyqësor në mbledhjen e elementëve të provës vendimtarë për rindërtimin e fakteve, për gjetjen apo kapjen e një apo më shumë autorëve të krimeve dhe për marrjen e burimeve të konsiderueshme për kryerjen e krimeve. Pra u shtri në fushën e luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, një trajtim sanksionues shpërblyes i cili është eksperimentuar me sukses në luftën kundër terrorizmit si dhe në luftën kundër krimit të organizuar të llojit mafioz dhe kundër trafikut të lëndëve narkotike. Siç mund të vërehet veprat e krimit në fjalë ndëshkojnë *smuggling of migrants* për të cilin u fol në shënimin e mësipërm.

Për të ndëshkuar trafikantët, kuadri ligjor përpara kësaj date mbështetej në një tërësi normash të miratuara në kohë të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme nga ndëshkimi i këtij lloji trafiku. Në veçanti, vepra të krimit që lidheshin me *trafficking* ndëshkoheshin nga norma në lidhje me dhunën private⁷¹ dhe seksuale, të sekuestrimit të personit (edhe për qëllim zhvatjeje), të shtyrjes në prostitucion dhe shfrytëzimit të tij dhe të vënies në skllavëri.

Ligjvënësi italian, duke marrë përsipër luftën kundër këtyre formave moderne të skllavërisë, ndryshoi që në vitin 1996, sipas orientimeve të marra edhe në nivel ndërkombëtar, disa norma kundër dhunës seksuale, duke futur disa figura të reja krimi dhe duke parashikuar sanksione më të rënda se ato të mëparshme. Po ky ligjvënës nxori në vitin 1998 norma kundër shfrytëzimit të prostitucionit, të pornografisë dhe të turizmit seksual në dëm të të miturve, duke pasur për qëllim mbrojtjen e zhvillimit të tyre fizik, psikologjik, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Teksti unik i dispozitave në lidhje me rregullimin e emigracionit dhe normat mbi gjendjen e të huajit, shpallur në vitin 1998⁷², kish parashikuar edhe lëshimin e një lejeje të posaçme qëndrimi për arsye të mbrojtjes sociale së të huajit, të cilit i ofronte edhe mundësinë për t'u bërë pjesë e një programi përkujdesjeje dhe integrimi social në rastet kur do të vërtetoheshin situata dhune apo shfrytëzimi të rëndë kundrejt tij dhe rezulton rrezik konkret për jetën e tij, si pasojë e përpjekjeve për t'u shkëputur nga varësia e një organizata kriminale apo si pasojë e deklaratave të lëshuara prej tij gjatë hetimeve apo gjatë gjykimit.

Por duke mbërritur në një analizë të shpejtë të instrumenteve të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore, parashikuar nga ligji nr.228, i dt. 11 gusht 2003, duhet të vërejmë se ky ligj ka sjellë një formulim gjuhësor më të përshtatshëm ndaj fenomeneve që kërkon të luftojë, në nenet 600 (vënie dhe mbajtje në skllavëri) dhe 602 (blerje dhe tjetërsim i skllavëve) të Kodit Penal, duke parashikuar dënime më të rënda për këto krime. Në veçanti, neni i ri 601 (trafiku i personave) e dënon krimin e *trafficking*⁷³ me burgim nga 8 deri në 20 vjet.

⁷¹ Neni 610 K.P.

⁷² Neni 600 bis dhe vijues i K.P.. Në përputhje me parimet e konventës mbi të drejtat e fëmijëve, ratifikuar me Ligjin n.176, 27 maj 1991, dhe me sa sanksionuar nga deklarata përfundimtare e konferencës botërore të Stokolmit, adoptuar më 31 gusht 1996.

⁷³ Ligji mbi trafikun është miratuar, edhe pse Itali nuk ka ratifikuar ende konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, nënshkruar në Palermo në dhjetor 2000, edhe protokollin shtesë kundër *trafficking* dhe kundër *smuggling*.

Ligji i mësipërm ka parashikuar gjithashtu mundësinë e përdorimit të disa instrumentave thelbësorë për hetimet në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore, si një shkak i posaçëm padënueshmërie për Oficerët e Policisë Gjyqësore që veprojnë si agjentë të infiltruar⁷⁴, mundësinë për të mos nxjerrë apo vonuar akte sekuestrimi, arresti, ndalimi dhe zbatimi të masave të sigurisë, një mundësi më të madhe për të vendosur përgjime bisedash dhe komunikimesh, si dhe një sistem shpërblimi për autorët e veprimeve të trafikut që bashkëpunojnë me drejtësinë⁷⁵.

Risia më e rëndësishme e Ligjit në fjalë është, sipas gjykimit tim, fakti se ka parashikuar që funksionet e Prokurorit për krimet e vënies dhe mbajtjes në skllavëri, trafik të personave dhe blerje e tjetërsim të skllavëve (nenet 600, 601 e 602 k.p.), të ushtrohen vetëm nga magjistratët e 26 Drejtorive të Rrethit Antimafia⁷⁶, duke e caktuar për këtë arsye këtë të fundit të merret me koordinimin e hetimeve të kryera.

§ 4. Teknikat hetimore mbi krimet që lidhen me emigracionin e paligjshëm dhe trafikun e qenieve njerëzore. Hetimet në lidhje me shfrytëzimin e prostitucionit.

Përvoja gjyqësore na mëson se flukset e emigracionit janë të organizuar dhe drejtuar, deri në destinacionin përfundimtar në vendet e Bashkimit Evropian, nga grupe kriminale të të njëjtës etni të klandestinëve (bengalezë, kinezë, nigerianë, filipinas, shqiptarë, etj.,,).

⁷⁴ Neni 10 parag. 1 Ligji 228/2003; ... nuk janë të dënueshëm Oficerët e Policisë Gjyqësore që, gjatë operacioneve specifike të policisë që janë vendosur vetëm për qëllime të marrjes së elementëve të provës lidhur me krimet e parashikuar në nenet 600, 601 dhe 602 të k.p., edhe përmes një personi tjetër, përftojnë, marrin, zëvendësojnë, para, armë, dokumente, lëndë narkotike, të mira apo sende që janë objekt, produkt, fitim apo mjet për të kryer një krim, apo ndryshe pengojnë përcaktimin e prejardhjes apo që mundësojnë investimin e tyre. Për këto hetime, Oficerët dhe Agjentët e Policisë Gjyqësore mund të përdorin dokumenta identiteti apo udhëzime infiltrimi për të krijuar apo vendosur lidhje me subjekte që ndodhen në rrjete komunikimi...

⁷⁵ Këto instrumente mund të përdoren edhe në hetimet në lidhje me krimet siç në nenet 600 bis të k.p. (prostitucioni i të miturve), 600 ter i k.p. (pornografia e të miturve), 600 quarter i k.p. (mbajtje materiali pornografik) dhe 600 *quinquies* i k.p. (nisma turistike që synojnë shfrytëzimin e prostitucionit së të miturve).

⁷⁶ Me D.L. nr.367, dt. 20.11.1991 konvertuar në Ligjin n.8, dt. 20.01.1992 janë krijuar Drejtoritë e Rrethit Antimafia, si seksione brenda Prokurorive të Republikës pranë Gjykatave që ndodhen në kryeqendrat e 26 Rretheve të Gjykatave të Apelit, si dhe Drejtoria Kombëtare Antimafia, e kjo e fundit me funksione koordinuese dhe shtyse kundrejt Drejtorive të Rretheve Antimafia siç përmendur të cilat janë ngarkuar me veprimtarinë luftuese ndaj organizatave kriminale.

Por këto grupe ia besojnë fazën më delikate të udhëtimeve, kryesisht të atyre përmes tokës, organizatave kriminale vendase (slllovene, kroate, etj.) të cilat, kundrejt një shpërblimi, garantojnë një kalim të sigurt përmes kufijve të vendeve të tyre dhe mbërritjen në vendet e destinacionit. Pasi mbërrihet në vendin e duhur (që mund të ndodhen në Itali apo në një vend tjetër të Evropës perëndimore), klandestinët merren përsëri në ngarkim nga të dërguar të organizatës etnike që i dorëzon ata, pasi merr më parë pagesën për udhëtimin, tek marrësit e fundit, pra tek të afërmit e klandestinëve apo në sipërmarrje që do i shfrytëzojnë ata në *punë të zezë* apo tek grupe së të njëjtës etni që do të menaxhojnë prostitucionin e tyre.

Në dy rastet e fundit, nis përgjithësisht (gjithnjë nëse nuk ka ndodhur më parë në vendin e origjinës) vënia e klandestinit në kushte skllavërie.

Përvoja hetimore italiane, sigurisht pozitive dhe e tillë që mund të merret edhe nga vende të tjera, ka nxjerrë në pah se momenti më i rëndësishëm i hetimeve qëndron në aftësinë e kontrollit të fazës përfundimtare të udhëtimit të klandestinëve, pra në atë të futjes së klandestinëve në vendin e destinacionit. Kjo sepse ky kontroll mundëson, pothuaj gjithmonë, gjetjen e përfaqësuesve të krerëve të organizatës etnike (ndonëse ajo nuk merr pjesë, në asnjë mënyrë, në kalimin e kufirit – të një apo më shumë shteteve – në transportin e klandestinëve), përmes identifikimit të të dërguarve të tyre që marrin nga transportuesit *mallin njerëzor*, duke vazhduar të kenë lidhje me krerët e organizatës nga të cilët marrin urdhra.

Do të mjaftonte pra të ndiqnim me kujdes dorëzimin e klandestinëve si dhe zhvendosjet e mëtejshme deri në vendet e destinacionit të fundit dhe, përmes hetimeve të menjëhershme, të gjejmë qoftë edhe një numër të vetëm telefoni që përdoret nga të dërguarit e organizatës etnike apo qoftë edhe vetëm një prej personave që merren me transportin e klandestinëve, pasi të jetë bashkërenduar puna me Policinë e vendeve të tranzitit, dhe ta vëmë atë nën përgjim.

Në këtë mënyrë, marrim vesh me siguri numrat e tjerë telefonikë që përdoren nga përfaqësues të majës së organizatës etnike që nga ana e tyre, do të jenë vënë në përgjim; duke përftuar një rrjet informacionesh që do t'u japë organeve hetimore një sasi të dhënash që do të shërbejnë për hetime mbi trafiqe të ardhshme së të njëjtit lloj.

Në të vërtetë, kur veprojnë në fushën e emigracionit klandestin dhe të trafikut të qenieve njerëzore, grupet etnike të huaja që i administrojnë ato mund të jenë jashtëzakonisht të dobët pasi kanë nevojë të kenë lidhje të

vazhdueshme telefonike si me organizatat vendase që kujdesen për transportin e emigrantëve ashtu dhe me të dërguarit e tyre, me qëllim që të merren vesh për linjat strategjike me qëllim që udhëtimi të ketë sukses.

Por edhe transportuesit e organizatave vendase janë të detyruar të përdorin telefonin për t'u lidhur me të dërguarit e organizatave etnike.

Duhet theksuar më pas që personat e përfshirë në trafik, me kombësi të ndryshme (kinezë, bengalezë, rusë, moldavë, sllovenë, kroatë, etj.), kanë nevojë të kuptojnë komunikimet e shumta që ndodhin gjatë udhëtimit të klandestinëve, prandaj përdorin një gjuhë të përbashkët e shumë shpesh një anglishte të çalë. Kjo rrethanë lehtëson sigurisht punën e organizmave hetues që janë, zakonisht, në gjendje të kryejnë përkthimin simultan në gjuhën e tyre mëmë dhe të ndjekin të gjitha fazat e transferimeve të paligjshme.

Si përfundim, gjatë telefonatave, të gjithë personat e përfshirë në trafik janë të detyruar të përmendin emra, adresa dhe numra telefoni të fshehtë dhe të japin udhëzime mbi mënyrat e pagesës dhe vendet e dorëzimit të klandestinëve.

Në hetimet mbi emigracionin klandestin të paligjshëm dhe mbi trafiket e qenieve njerëzore, duhet vepruar pra me një punë hetimore të vazhdueshme, me durim dhe zgjuarsë që bën të mundur lidhjen e ngjarjeve që në dukje nuk kanë lidhje mes tyre, e që ndër të tjera janë zhvilluar në vende e kohë të ndryshme.

Hetimi duhet të dijë të shfrytëzojë më tej instrumentet e sjellë nga ligji penal dhe procedural penal. Një prej këtyre mjeteve, që gjendet në legjislacionin italian në fuqi, siç u përmend më lart, është ai që i jep mundësi Prokurorit dhe Policisë Gjyqësore të vonojë arrestimin dhe sekuestrimin. E pra, kërkojmë të theksojmë se nëse organizmat hetimorë kanë mundësi të asistojnë në dorëzimin e klandestinëve (përmes tokës, por edhe përmes detit) është e udhës që ata, në kushte të caktuara kohe e vendi, të dinë të zgjedhin nëse do të vijnë me arrestimin e një *passieur*-i të vetëm apo të një *skafisti* të vetëm që janë marrë me trafikun, apo nëse do të vendosin të bëjnë lëvizje të tjera, hetime të mëvonshme, për të identifikuar njëkohësisht kërret e organizatave që kryejnë transportin dhe ata që organizojnë udhëtimet dhe, përmes identifikimit, të mbledhin prova të pakundërshtueshme për të proceduar me arrestimin e tyre, duke shpërbërë në këtë mënyrë gjithë rrjetin e trafikut, duke përdorur, nëse do ish e nevojshme, edhe mjetin e fundit hetimor të infiltrimit të oficerëve të Policisë

Gjyqësore në organizatat kriminale të mësipërme, edhe kjo e parashikuar nga legjislacioni.

Në lidhje me shfrytëzimin e prostitucionit të grave, shumë shpesh të mitura, të emigruara në mënyrë klandestine, në fillim të hetimeve hetuesi nuk është në dijeni të fenomenit kriminal nga i cili lind ky krim, pra trafikun e qenieve njerëzore, meqenëse siç thamë ai lind dhe zhvillohet në territore të largëta kundrejt vendit ku zhvillohen hetimet. Pra puna duhet nisur që nga veprimtaria e shfrytëzimit për të mbërritur deri tek përgjegjësit e trafikut dhe të tregtisë së qenieve njerëzore.

Për një impostim të mirë të hetimeve, duhen mbajtur parasysh rrethanat që prostituta ekstrakomunitare është patjetër në lidhje të vazhdueshme me shfrytëzuesit e vet (blerës apo anëtarë të një organizate etnike që, përmes të dërguarve të vet, merr *mallin njerëzor* në fund të udhëtimit) dhe që veprimtaria e prostitucionit të grave është e dukshme dhe, shumë shpesh, është e dukshme edhe lidhja mes tyre dhe shfrytëzuesve që, ndonëse me kujdes, i mbajnë ato në një kontroll të rreptë, të drejtpërdrejtë apo përmes telefonit me telefona celularë.

Gjithë sa më lart duhet t'i sugjerojnë Prokurorit (që në sistemin italian është *dominus* i hetimeve) t'i japë udhëzime të sakta Policisë Gjyqësore që të mos veprojë gjithnjë e menjëherë me arrestimin e personave (sidomos në rastet kur kjo e fundit gjendet para dorëzimit tek shfrytëzuesi të të ardhurave të veprimtarisë së prostitucionit apo është e pranishme në kohën kur gruaja merret nga shfrytëzuesi).

Duke vepruar në këtë mënyrë, do të ndërpritej çdo mundësi tjetër hetimi mbi bashkëpunëtorët e shfrytëzuesit, mbi gra të tjerë të shfrytëzuara, mbi organizatën që menaxhon prostitucionin dhe mbi trafikun e qenieve njerëzore që qëndron në krye të veprimtarisë së prostitucionit.

Përkundrazi, fillimisht duhet vepruar me një sërë veprimesh të mirëmenduara ndjekjeje dhe vëzhgimi të veprimtarisë së prostitucionit për të kuptuar lëvizjet, vendbanimet (banesa e marrë me qira nga shfrytëzuesi apo hoteli) dhe të vendosen nën përgjim numrat e telefonit fiks përkatës si dhe telefonin celular të prostitutës.

Për të gjetur telefonin celular të prostitutës, Policia Gjyqësore mund të kryejë për shembull kontrollë të shumta mbi identitetin e vet duke simuluar ndër të tjera se nuk ka pikasur dokumente të rremë që janë paraqitur prej saj, të telefonojë në numrat telefonikë në lidhje me telefonatat e fundit të marra apo të kryera prej saj.

Lidhur me këtë, duhet vërejtur se pothuaj të gjitha gratë e shfrytëzuara pajisen me një aparat celular nga shfrytëzuesit të cilët, sidomos në kohët e para të kontrollit të viktimave të tyre, druajnë se ato mund t'u drejtohen Forcave të Policisë apo organizatave humanitare për t'i shpëtuar skllavërisë të cilës i nënshtrohen. Përmes kontrollit të telefonit celular të prostitutës do të mësohet më tej numri telefonik i shfrytëzuesit i cili do të përdorë sigurisht numrin e tij të telefonit për të kryer këto kontrolle.

Në hetimet mbi *trafficking*, rezultojnë mjaft të dobishme veprimtaritë e fazave që kanë të bëjnë me hedhjen dritë mbi historitë dramatike të grave dhe, sidomos mbi marrëdhëniet me shfrytëzuesit e tyre.

Përmes përgjimit të numrit telefonik të shfrytëzuesit është e mundur të identifikohen anëtarët e grupit kriminal që administron veprimtarinë e prostitucionit.

Duhet shtuar se, shumë shpesh, prostitutat janë të detyruara të kryejnë veprimtarinë e tyre me një lloj rotacioni, në qytete të ndryshme së të njëjtit vend, arsye për të cilën duke kontrolluar telefonin celular të tyre do të zbulohen lidhje të tjera telefonike me persona të tjerë që janë po anëtarë të grupeve kriminale që drejtojnë veprimtarinë e prostitucionit.

Duhet thënë së fundi që ky rrjet lidhjesh ka mundësuar gjatë hetimeve të caktuara gjyqësore zbulimin dhe ndjekjen nga afër të fazave përkatëse të blerjes dhe transferimit në Itali të personave të rinj që duhen futur në prostitucion.

Në përvojën konkrete ka rezultuar i suksesshëm shoqërimi i një faze të përgjimit telefonik dhe/ose mjedisor me një fazë të vëzhgimit dhe përgjimit, me qëllim kryerjen e regjistrimeve fotografike ose filmike të takimeve me anëtarë të grupeve të tjera kriminale për shkëmbimin e dokumenteve dhe dorëzimin e shumave të parave të nevojshme për blerjen e grave të tjera të trafikuar.

E rëndësishme është edhe kryerja e veprimeve surprizë si kontrollet që jo rrallë bëjnë të mundur kryerjen e sekuestrimit të fotografive dhe të sendeve të tjera që i përkasin kriminit, si për shembull dokumente për depozita bankare dhe postare që, pasi lexohen me kujdes, mund të shpien në zbulimin e kanaleve të pastrimit të të ardhurave të paligjshme që rrjedhin pikërisht nga trafiku i qenieve njerëzore.

§ 5. Përfundime.

Për të mundur apo sidoqoftë kufizuar veprimtarinë e krimit të organizuar transnacional që merret me trafiket e paligjshme të trajtuara më lart, përveç bashkëpunimit gjyqësor dhe të policisë së Shteteve të ndryshme dhe veprimtarisë ndëshkuese, është e nevojshme të kryejnë një veprimtari parandaluese gjithnjë e më të fortë duke u mbështetur, gjithnjë e më shumë, në bashkëpunimin e vyer të organizatave jo qeveritare.

Sidomos në lidhje me trafikun e qenieve njerëzore, është e nevojshme që në vendet nga ku lind ky trafik të bëhet një punë e madhe edukuese dhe ndërgjegjësuere ndaj grave dhe të miturve viktime të këtij trafiku dhe një stërvitje më e madhe e Policisë dhe Autoriteteve kufitare, si dhe të realizohen fushata aktive dhe të vazhdueshme të shtypit të nivelit ndërkombëtar, meqenëse veprimtaria e parë konkrete luftuese është ajo me karakter kulturor, në kuptimin që e gjithë shoqëria duhet të ndërgjegjësohet dhe rebelohet ndaj fenomenit kriminal që qëndron në burimin e tregut të jetës njerëzore.

LUCIO DI PIETRO

*Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie*

Tiranë, Mars 2007

1.7. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore në Shqipëri. Problematika dhe perspektiva në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

§ 1.

Trafikimi i njerëzve si dukuri sociale është shfaqur në vitet e tranzicionit dhe paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore. Me gjithë masat organizative, teknike etj., që janë marrë për parandalimin e këtij krimi përsëri ai është i pranishëm derisa nuk është zgjidhur problemi kryesor i lëvizjes së lirë të njerëzve në vendet e Evropës.

Dukuria e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh manifestohet e shoqëruar me element agresiv e çnjerëzor dhe, për këtë arsye, është vlerësuar si një nga format moderne të skllavërisë njerëzore.

Përfitimet e mëdha që vinin si rezultat i kësaj veprimtarie kriminale që i kishte qendrat kryesisht në qytetet bregdetare apo kufitare të paprekura nga ndërhyrja e Shtetit dhe nga faktorë të tjerë ekonomikë, politikë dhe socialë, krijoi rrethana të përshtatshme për trafikantët për fillimin dhe lulëzimin në një mase të konsiderueshme të trafikut të femrave për prostitucionin, apo të trafikimit të të miturve jashtë vendit.

Shkalla e këtij lloj krimi është bërë tashmë shqetësuese për institucionet shtetërore, opinionin publik në Shqipëri si dhe për organizatat ndërkombëtare. Shqipëria konsiderohet vend “origjine” dhe tranziti për trafikimin e femrave nga ana e organizatave të specializuara ndërkombëtare që monitorojnë këto dukuri.

Veprimtaria e institucioneve të Drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit në luftë kundër trafikimit është vlerësuar si e pamjaftueshme, jo efektive dhe pa ndikim në uljen e këtij kriminaliteti. Për një kohë të gjatë numri i personave të dënuar për trafikimin e njerëzve ka qenë relativisht i vogël. Pjesa më e madhe e grave dhe e vajzave të reja që trafikoheshin, transportoheshin në Itali e Greqi dhe më pak në vendet e tjera evropiane si: Belgjikë e Hollandë. Femrat e huaja që kalonin tranzit vinin kryesisht nga Moldavia, Rumania dhe më pak nga Ukraina, Rusia e Bullgaria. Gjithashtu edhe mjaft fëmijë, përfshirë edhe djem, trafikoheshin për qëllim mbledhje lëmoshe.

Angazhimi dhe sensibilizimi i shtetit dhe i organizmave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare, kombëtare dhe ndërkombëtare kanë ardhur vazhdimisht në rritje për të luftuar këtë fenomen. Këtij angazhimi i është përgjigjur edhe përmirësimi i situatës ligjore dhe organizative.

Kështu qeveria Shqiptare ka hartuar strategjinë e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore si dhe ka krijuar mekanizma që të mundësojnë realizimin e saj. Pranë Ministrisë së Rendit Publik ndodhet Njësia e Antitrafikimit, e cila koordinon punën e saj me Policinë e Kufirit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe me strukturat analoge të vendeve të tjera apo me agjenci të ndryshme shërbimesh. Gjithashtu gjatë kësaj kohe u ndryshua legjislacioni në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë si dhe u krijua Gjykata e Krimeve të Rënda për gjykimin e veprave penale që lidhen me trafikimin, ajo që bie në sy është padyshim përmirësimi i vazhdueshëm i tij në përfaqje me zhvillimin e ndryshimit të legjislacionit ndërkombëtar. Ky përmirësim vazhdon ende i nxituar jo vetëm nga vullneti politik, por edhe nga vullneti i përgjithshëm i shoqërisë që ekziston për luftimin e kësaj dukurie.

Ligjvënësi shqiptar i ka kushtuar gjithnjë e më tepër rëndësi rritjes së efikasitetit të ligjit kundër trafikimit duke u munduar ta trajtojë atë në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe me zhvillimet më të fundit doktrimore.

Legjislacioni ynë penal nga pikëpamja sasiore ka rritur numrin e dispozitave ligjore që godasin trafikimin, ndërsa nga pikëpamja cilësore ka përmirësuar strukturën e dispozitave ligjore.

Vepra penale e trafikimit është relativisht e re në legjislacionin tonë. Kjo nuk ishte parashikuar si e tillë në ligjin Nr.7895, dt. 27.01.95, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Trafikimi dënohej përmes ndëshkimit që parashikohej në veprat penale:

- Favorizimi i prostitucionit, neni 114
- Mbajtje e lokaleve për prostitucion, neni 115
- Kalimi i paligjshëm i kufirit, neni 297
- Dhënia ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit, neni 298

Pra vetëm këto dispozita godasin indirekt trafikimin.

Pra Kodi Penal i vitit 1995 paraqet një panoramë të dobët ligjore për të luftuar formën moderne të skllavërisë njerëzore.

Shumë shpejt filloi ndryshimi i situatës ligjore duke u parashikuar vepra të reja penale si: shfrytëzimi i prostitucionit i kryer nga organizata kriminale dhe ndërmjetësimi.

Në Ligjin 8279 dt.15.01.1998, iu bënë ndryshime veprave penale të favorizimit të prostitucionit e cila u konceptua e ndryshuar si "shfrytëzim prostitucioni".

Viti 2001 është vitit i ndryshimeve rrënjësore në legjislacionin e Kodit tonë Penal. Ligji 8733 dt. 24.01.2001, parashikoi për herë të parë veprën penale të trafikimit me tre figura vepre, si:

- Trafikimi i njerëzve, neni 110/a
- Trafikimi i femrave për prostitucion, neni 114/b
- Trafikimi i fëmijëve, neni 128/b

Gjithashtu ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal në vitit 2001 prekën edhe dispozita që ishin shtuar në vitin 1998 si p.sh., shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese, neni 114/a. Kjo dispozitë ndryshoi nga pikëpamja cilësore, u hoq parashikimi i kryerjes së veprës penale në bashkëpunim, më shumë se një herë ose personave të ngarkuar me funksione shtetërore.

Në trajtimin e kuptimit të trafikimit të qenieve njerëzore, deri kohët e fundit, ka munguar një përkufizim universal dhe me detyrim ligjor në nivelin rajonal dhe ndërkombëtarë, por kjo situatë ka ndryshuar me botimin e Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, Shtypjen dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve, duke plotësuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Trans-nacional.

Kjo konventë e quajtur zakonisht "Protokolli i Palermos" ka formuluar një përkufizim definitiv ndërkombëtar për krimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Me trafikim personash do të kuptohet rekrutimi, transferimi, strehimi ose pritja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, ose formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të dredhisë, të mashtrimit, të abuzimit të pushtetit, ose të një pozite vulnerabiliteti (lehtësisht e cenueshme), ose i dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi, duke pasur kontrollin mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin në minimum, shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, zgjedhje apo heqje organesh.

Përkufizimi progresiv, modern i dhënë në Protokollin e Trafikimit ka shumë aspekte pozitive që reflektojnë realitetin e trafikimit të kohëve moderne:

- Ky përkufizim njeh të gjitha format e trafikimit dhe nuk e kufizon trafikimin vetëm në shërbimet seksuale. Ai fokusohet në kushtet e

punës së detyruar, zgjedhjes, praktikave skllavëruese dhe skllavërisë, që janë të përcaktuara në ligjin ndërkombëtar.

- Nuk fokusohet vetëm tek vajzat dhe gratë në mënyrë ekskluzive, por dallon që gratë, burrat, vajzat dhe djemtë mund të jenë të gjithë viktima.
- Nuk kërkon që viktima të kalojë ndonjë kufi ndërkombëtar të përcaktuar, duke marrë parasysh që personat gjithashtu trafikohen nga një zonë në tjetrën brenda të njëjtit vend.
- Protokollin kërkon disa forma të shtrembërimit të vullnetit të lirë të viktimës, p.sh. me anë të përdorimit të forcës, mashtrimit ose abuzimit me pushtetin, duke respektuar kështu aftësinë e personave të rritur për të marrë vetë vendime për jetën e tyre, veçanërisht në lidhje me zgjedhjet për punën dhe emigracionin.

Përveç përkufizimit të bërë në Protokollin e Palermos ekzistojnë edhe përkufizime nga organizata të tjera ndërkombëtare, të cilat janë të dobishme në raste të caktuara.

Sipas konventës së Europolit trafikimi i qenieve njerëzore do të thotë nënshtrimi i një personi ndaj një pushteti real dhe të paligjshëm të personave të tjerë duke ushtruar dhunën ose kërcënimet, ose me anë të abuzimit me autoritetin ose me anë të intrigës me qëllim shfrytëzimi për prostitucion, të formave të tjera të shfrytëzimit seksual dhe të sulmeve mbi të miturit ose tregtimit të fëmijëve të braktisur.

Ndërkaq, sipas Këshillit të Evropës trafikimi i grave përfshin:

Trafikimi i grave dhe prostitucioni me dhunë, si çdo transportim legal apo ilegal i grave me ose pa dëshirën e tyre fillestare, për qëllime të fitimeve materiale, me qëllim nënshtrimin e mëvonshëm për prostituim, martesë të detyruar ose për forma të tjera të shfrytëzimit seksual të detyruar. Përdorimi i dhunës mund të jetë fizik, seksual, psikologjik dhe përfshin frikësimin dhe abuzimin e autoritetit ose të një situate varësie.

Kurse përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore sipas BE është:

- *rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pritja e një personi përfshi shkëmbimin/transferimin e kontrollit mbi atë person kur:*
- *(a) përdoren masa detyruese, forca ose kërcënim, përfshi rrëmbimin, ose*
- *(b) përdoret mashtrimi, ose*

- (c) abuzohet me pozitën ose me situatën e dobisë së personit, që është e tillë që për atë person nuk ekzistojnë alternative të tjera të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet abuzimit, ose
- (d) jepen ose merren pagesa/përfitime për të arritur pëlqimin/lejen e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër.
- Për pëlqimin e shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të personit, përfshi të paktën punën/shërbimet e detyruara/të detyrueshme, skllavërinë ose praktika të ngjashme me të, ose
- Për qëllimin e shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, përfshi pornografinë.

Përkufizimi i trafikantit dhe personit të trafikuar është si vijon:

Një trafikant është:

Një person, ose një subjekt që ka për qëllim të kryejë, ose është bashkëpunëtor, apo lejon që të kryhen, ndonjë nga veprimet e përshkruara në përkufizim in e trafikimit.

Një person i trafikuar është:

Një person që rekrutohet, transportohet, blihet, shitet, transferohet, pranohet ose strehohet siç përcaktohet tek trafikimi duke përfshirë një fëmijë, pavarësisht nëse fëmija ka pranuar ose jo.

Viktima janë:

Personat që, si individ ose kolektiv, kanë vuajtur dëmtim, duke përfshirë dëmtimin fizik apo mendor, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose shkelje të të drejtave themelore të tyre, nëpërmjet akteve ose pësimeve në shkelje të ligjeve që kanë të bëjnë me krimin, duke përfshirë ato ligje që parashkruajnë mbi abuzimin kriminal të pushtetit.

Në fushën penale doli ligji Nr.8733, datë 24.01.2001, sipas të cilit u shtua neni 110/a për trafikimin e njerëzve.

Mirëpo, për të harmonizuar formulimin e këtij neni me aktet juridike ndërkombëtare, për të cilat u fol më lart, u pa e nevojshme që, me ligjin Nr.9188, datë 12.02.2004, të bëhet riformulimi i nenit 110/a me përmbajtje si vijon:

“Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve

për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të ngjashme të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose të shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim të transplatimit të organeve si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milion deri në pesë milion lekë. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga katër milion deri në gjashtë milion lekë.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milion deri në tetë milion lekë.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm si dhe me gjobë nga shtatë milion deri në dhjetë milion lekë.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjopa shtohen me 1/4 e dënimit të dhënë” (neni110/a)

Kjo dispozitë është vendosur për të siguruar lirinë e lëvizjes shëndetin dhe jetën e njeriut, rregullat e kalimit të kufirit të shtetit shqiptar. Ajo realizohet me forma e mënyra të ndryshme në rrethana të cilësuar e veçanërisht të cilësuar se gjithmonë ka qëllim për përfitim material apo çdo përfitim tjetër pasuror apo jo pasuror.

Trafikimi në vitet e sotme ka marrë shtrirje të madhe. Liritë dhe të drejtat e personit si dhe dinjiteti i tij moral e shoqëror garantohen vetëm në një shtet juridik. Faktorët që karakterizojnë ato janë:

- Emigracioni bashkë me faktorët më të rëndësishëm shtytës si varfëria, luftërat civile, katastrofat natyrore, rritje e mundësisë për sa i përket transportimit të lirë e të shpejtë e global dhe sistemet e komunikimit që lidhin ato afrojnë kulturat e ndryshme. Kjo e fundit mund të jetë katalizatori i fuqishëm për trafik klandestin.
- Ulja e emigracionit legal në Evropë e Amerikën e Veriut ka dhënë kontributin e saj në lindjen e tregut të zi për aktivitetin e emigrimit. Shqiptarët kanë kërkuar rrugë të shpejta për të arritur mirëqenie: rrugën e trafiqueve të jashtëligjshme.
- Shoqëritë postmoderniste dhe mënyra e jetesës individuale si dhe ndryshimet demografike dhe kulturore kanë çuar në daljen e një lloj

emigrimi tregtar, një proces që është lehtësuar nga ndryshimet e strukturave tradicionale të familjeve, dobësimi i lidhjeve shoqërore e familjare dhe si rrjedhim rritje e potencialit të emigracionit.

- Kërkesa e madhe për krah të lirë sidomos në ato vende që tregu i punës është tej i rregulluar dhe në ato vende me sektorë të gjerë bujqësor. Kërkesa shkakton lindjen e një tregu të zi pune.

Trafikimi i femrave bëhet me çdo mjet: anije, avion, automjete, skaf, gomone duke i transportuar nga territori Shqiptar në territor të huaj nëpërmjet tokës, detit e ajrit. Ky lloj trafikimi kërkon disa aktivitete ndërkufitare si transportimi i organizuar i njerëzve ose bërja e një kontrate ndërmjet kërkesës dhe ofertës në rajone të ndryshme me njëri tjetrin me kufij ndërkombëtar. Trafiku i klandestinëve ka marrë përmasa të tilla sa që mund të quhet biznes shumë fitimprurës ose biznes në hije.

Mashtrim për punë. Të nxitur nga niveli i lartë i papunësisë dhe niveli shumë i ulët ekonomik viktimat ndjekin trafikantët të bindur se do të kenë mundësi të punësohen dhe sigurojnë jetesën dhe familjet e tyre. Punët që premtohen janë "shumë të leverdishme" dhe mundësia për të përfituar prej tyre "rrallë të vjen në jetë". Shpesh punët janë të përshtatshme edhe për fëmijët të cilët me kalimin e kohës, me parat e fituara "mund të ndjekin një shkollë dhe të ecin përpara në jetë".

Mashtrimi për martesë. Trafikantët kanë përdorur shpesh këtë mënyrë rekrutimi. Ata fillimisht krijojnë lidhje dashurie me viktimat e tyre duke e bërë viktimën të besojë se ka gjetur "dashurinë e vërtetë" apo "shpirtin binjak" prej të cilit nuk mund të ndahet më kurrë. Duke i joshur me përshkrime fantastike të mënyrës së ndërtimit të jetës së tyre jashtë shtetit e cila nuk mund të jetë kurrë e tillë këtu ku të mbysin paragjykimet, ata premtojnë paraajsën e vërtetë. Viktimat, shpesh të mitura, i binden në çdo hap partnerit të tyre, pa ditur se po ecin në rrugën drejt "ferrit".

Mashtrim për shkollim. Duke shfrytëzuar pikën e dobët të shumë të rinjve dhe familjarëve të tyre për arsimim dhe përfitim dijesh në shkollë sa më të lartë, trafikantët bëhen garant për sigurimin e mundësive të tilla. Ato krijojnë marrëdhënie besimi shumë të ngushta me viktimat dhe familjet e tyre, shpesh duke shfrytëzuar njohjen nëpërmjet personave të tretë. Shpesh paraqiten nën maskën e një "prindi" që do të kujdeset "si për fëmijën e tij" dhe "rregullojnë" gjithçka që duhet për realizimin e ëndrrës së këtyre viktimave. Viktimat kur arrijnë në perëndim, detyrohen të punojnë si prostituta, në kundërshtim me vullnetin dhe premtimin për studime.

Mashtrim për jetë më të mirë. Pre e kësaj mënyre janë zakonisht ato viktimat që deri tani kanë jetuar një jetë tmerrësisht të vështirë janë ndrydhur, dhunuar apo abuzuar në forma të ndryshme. Trafikantët në këtë rast, shfaqen si “dashamirës” njerëz që u dhemb shpirti për vuajtjet e të tjerëve dhe “sakrifikojnë” për ta, duke pasur besim që një ditë “të mirën” do t’ua shpërblejnë.

Fejesë/martesa e rreme. Pasi identifikojnë viktimat kandidatët studiojnë mënyrën më të përshtatshme për të krijuar besim tek to. Shpesh prezantohen nga të tretët të cilët hyjnë garant tek familjet e viktimave për “njeriun e mrekullueshëm” që po kërkon vajzën e tyre. Fejesa dhe martesa kryhen brenda një kohe shumë të shkurtër. Të lumturuar për “fatin që i trokiti në derë” prindërit në shumë raste, i detyrojnë të pranojnë martesa të tilla, pa marrë parasysh moshën dhe dëshirën e tyre.

Rrëmbim personi. Paraprakisht merren të dhëna rreth jetës së viktimës dhe studiohen lëvizjet e saj. Në momentin e përshtatshëm kryhet rrëmbimi. Ka raste kur viktimat ftohet nga shokët, shoqet apo persona të tjerë të afërt të lidhur me trafikantët për të shkuar në festa, disko, etj. Pranimi i ftesës e bën akoma më të lehtë procesin e rrëmbimit të saj.

Dokumente udhëtimi të rremë. Shpesh trafikantët i detyrojnë viktimat e tyre të udhëtojnë me dokumente të rremë. Qëllimi i përfitimit në këtë rast është jo pasuror.

Lajme të rreme në gazeta/agjenci turistike. Viktimat mund të joshen, çmimet fantastike dhe organizimi “i përkryer” i udhëtimeve turistike etj.,.

Trafikimi i njerëzve, preferencë e krimit të organizuar.

Krimi i organizuar karakterizohet nga qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e veprimtarisë kriminale. Ai kërkon të përdorë operacione të zakonshme biznesi me qëllim që të qarkullojë dhe të investojë fitimet e jashtëzakonshme që kanë ardhur nga aktiviteti i tyre kriminal.

Krimi i organizuar ka norma të rregullta të pashkruara në bazë të të cilave funksionon puna dhe ka struktura të rregullta.

Ai bashkëpunon me disa aktivitete tradicionale kriminale.

Trafikimi është pjesë e krimit të organizuar ndërkombëtar.

Trafikimi i njerëzve është organizuar nga grupe kriminale që trafikojnë klandestinë që gjithashtu përfshihen me lloje të tjera të kriminalitetit të organizuar të tilla si: droga, makinat, armët.

Struktura e këtyre grupeve luhetet nga grupe të vogla amatore deri tek organizatat me strukturë ndërkombëtare. Elementët e krimit të organizuar ndërkombëtar janë:

- I kryer nga grupe të organizatave kriminale
- Ka maksimumin e fitimit (fitim ekonomik)
- Dimension ndërkombëtar

Pasojat e krimit të organizuar për Shqipërinë janë:

- Pengohet integrimi i Shqipërisë në Evropë
- Pengohet seriozisht zhvillimi i vërtetë i ndershëm i vendit
- Krijohet një ekonomi informale
- Reputacioni i vendit jashtë kufijve është njollosur në mënyrë skandaloze

Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit Shtesë.

Është instrument ligjor i fuqishëm në luftën kundër krimit të organizuar.

U nënshkrua më 15 dhjetor 2000 në Palermo të Italisë.

U ratifikua më 11.07.2002 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Përbërja:

- Konventa e OKB kundër Krimit të Organizuar Transnacional
- Protokollit shtesë kundër Prodhimit dhe Trafikimit të Paligjshëm të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve.

Qëllimi:

Ka të bëjë me përpjekjet e Komunitetit Ndërkombëtar për zhvillimin e instrumenteve kundër krimit të organizuar transnacional për arsye se:

- Problemi i krimit të organizuar po bëhet serioz
- Është rritur niveli i bashkëpunimit mes organizatave kriminale
- Globalizimi i ekonomisë hap shanse për krimin e organizuar

Qëllimi primar – Bashkëpunimi ndërkombëtar.

PROF. DR. SKËNDER KAÇUPI
Pedagog në Shkollën e Magjistraturës në Tiranë

Tiranë, nëntor 2007

1.8. Terrorizmi ndërkombëtar.

§ 1. Fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar.

Fenomeni i krimit që njihet ndryshe me emrin terrorizëm ndërkombëtar shfaqet në skenën politike të shoqërive perëndimore që në fund të '800 e në krye të '900, por zhvillohet dhe forcohet sidomos mes gjysmës së viteve '90 dhe në fillimi të vitit 2000.

Në të vërtetë, në tridhjetë vitet e fundit, bota perëndimore është tronditur vazhdimisht nga fenomene terroriste që kanë vënë në rrezik themelet, rregullat e bashkëjetesës civile dhe u kalua kështu nga një fazë në të cilën gjendeshim para një terrorizmi të llojit **nacionalist** autonomist dhe gjeopolitik (p.sh. terroristë që luftonin për çlirimin e territoreve palestineze, por edhe më parë për çlirimin e atyre të Frontit Çlirimtar Kombëtar Algjerian) me ngjyrimet e karakteristika raciale dhe me objektiva të marra në shënjestër nga një terrorizëm **ndërkombëtar dhe fetar**, i cili shfaq për disa aspekte të tij tipare edhe më shqetësues, duke vepruar mbi ndjenjat fetare të ngulitura dhe thellësisht të rrënjosura në disa pjesë të botës dhe, në veçanti në zonat arabe dhe në ato afrikano-veriore.

Ky ndryshim epokal tregohet qartë nga pohimi, që tashmë mbizotëron në skenën ndërkombëtare të lëvizjeve integraliste islamike me impostim të pastër terrorist dhe të afta të shfaqen si zëdhënës të idesë së një ndërkombëtarizmi islamik, që panë në botën perëndimore dhe sidomos tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës armikun që duhet shkatërruar.

Ajo çka tashmë mund të quhet sot terrorizëm ndërkombëtar është me siguri **terrorizmi islamik, fenomen** që, pas atentateve të njohura të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork dhe në Washington u shfaq me gjithë egërsinë dhe dramaticitetin e vet.

Ngjarjet e 11 shtatorit 2001 dhe atentatet e mëtejshme të Madridit në vitin 2004 dhe të Londrës e Sharm el Sheikut në korrik 2005 treguan përfundimisht se sa i mprehtë është për vendet perëndimore kërcënimi nga terrorizmi me matricë islamike.

Sigurisht që, për të shmangur çdo paqartësi, duhet të vëmë menjëherë në dukje se pavarësisht nga elementi i fuqishëm fetar i lëvizjeve integraliste islamike, nuk ekziston sidoqoftë asnjë shenjë barazie mes terrorizmit dhe fesë islamike.

Në të vërtetë, aspekti fetar përfaqëson faktikisht faktorin e vetëm lidhës mes veprimeve të këtyre grupeve të dhunshme, pra, në aspektin e shkakësisë apo qëllimit, ai përfaqëson vetëm mundësinë më të mirë e domethënëse.

Fondamentalizmi dhe fanatizmi fetar që për fat të keq kemi njohur në këto vite të fundit, nuk ka të bëjë aspak me totalitarizmin psikologjik dhe social që karakterizon fenë islamike. Në të vërtetë, sidomos në një këndvështrim antiperëndimor, është një fenomen vetëm politik dhe ka të bëjë me faktorë ekonomikë që nga ana e tyre lidhen me disekuilibra ekonomikë botërorë.

§ 2. Nocioni i terrorizmit dhe burimet kryesore të të drejtës ndërkombëtare.

Diskutohet ende sot se cili është kuptimi më i saktë që i duhet mveshur termit “terrorizëm” (në vetvete dhe në marrëdhënie me nocionin “eversion” (përmbysje), duke pasur parasysh se përmbajtja kuptimore e tij nuk mund të ndikojë në shtrirjen e sferës së inkriminueshmërisë së llojit të krimit në fjalë.

Është vërtet i padiskutueshëm fakti që “terrorizmi” është para së gjithash një koncept politik dhe metajuridik, e për këtë arsye ndikohet nga faktorë historikë, politikë, kulturorë, ideologjikë.

Nga kjo rrjedh sidomos vështirësia për të formuluar një përkufizim universal të vlefshëm, meqë një veprim i dhunshëm që një legjislacion (i mbështetur në një sistem të dhënë ideologjik) mund ta cilësojë si terrorist, për një tjetër legjislacion mund të konsiderohet madje si një veprim themelues i një marrëveshjeje të re kushtetuese.

Pikërisht këto përsiatje e kanë shtyrë një pjesë të mirë të historiografisë filozofike ta konsiderojë këtë nocion të përnjimentë vetëm për shoqëritë demokratike perëndimore, duke shmangur, nga ana tjetër, përdorimin e këtij lloji cilësimi kur forma të dhunshme të opozitës politike shfaqen në sistemet jo demokratike.

Në dritën e sa më sipër, kontributi hermeneutik duket të jetë edhe më i rëndësishëm.

Duke u nisur nga një nocion i terrorizmit me ngjyrim të theksuar sociologjik dhe kriminologjik, lipset menjëherë të vërejmë lidhjen e fortë që ekziston me aspektin leksikor të termit: në të vërtetë nuk ekziston askush që nuk do të shihte tek terrori (nga ku terrorizëm) themelin jo vetëm etimologjik, pra të prejardhjes së fjalës, por edhe atë thelbësor a kuptimor të fenomenit.

Shtyssa drejt një frike kolektive që qëndron me kufijve të pasigurisë individuale, vënia në diskutim e aftësive të aparateve institucionale për të shmangur rreziqet për integritetin social dhe denoncimet e zhurmshme të mjeteve të komunikimit (në të cilat përzihen tërheqja dhe paniku në një lloj reaksioni zinxhir duke lënë hapësirë për të përfytyruar përjasje të mundshme ndaj aftësisë dhe forcës së tyre për t'u organizuar) duke përfaqësuar pikërisht manifestin objektiv të veprimit të këtyre grupeve terroriste. Qëllimi i mirëfilltë që kërkojnë të arrijnë është ngjallja e një gjendjeje paniku, frike kolektive, duke krijuar njëkohësisht një mosbesim të thellë ndaj aftësive të organeve institucionale për të garantuar paprekshmërinë e jetës publike.

Sigurisht që nuk mungojnë përkufizime të shumta të termit terrorizëm në literaturën penaliste, e cila ka ravijëzuar një dimension të dyfishtë, objektiv dhe subjektiv, të këtij fenomeni.

Dimensioni i parë ka të bëjë me ngjyrimet e veçanta të aktit terrorist, që lidhen për më shumë me “cilësinë e personit të dëmtuar, që përfaqëson në njëfarë mënyre institucionet, apo mundësinë e personit të dëmtuar që është në gjendje t'u drejtohet personave të pacaktuar, pra për të ngjallur frikë në komunitet; fakti që viktimat nuk kanë lidhje individuale me terroristin, pasi viktimat zgjidhen jo për marrëdhëniet e tyre individuale me atë që vepron, por për marrëdhëniet e tyre me institucionet ose thjesht për arsye se janë anëtarë të shoqërisë⁷⁷”.

Dimensioni i dytë, me karakter subjektiv, përqendrohet në nevojën që akti terrorist të kryhet për një qëllim politik, i cili mbështetet nga një kundërshtysë e fortë ideologjike⁷⁸.

Është vërejtur në veçanti se “ajo që dallon terrorizmin modern nga forma të tjera dhune politike është karakteri i tij kryesisht simbolik [...]. Në një veprim terrorist dhuna e kryer nuk është qëllim në vetvete, nuk përcaktohet vetëm në marrëdhënie me objektivin që goditet, por krahas dhe

⁷⁷ PALAZZO, *La recente legislazione penale*, II dhe, Cedam, 1982, fq. 96, Krs. gjithashtu ndër shumë autorë RONCO, *Terrorizmi*, në N.ss D.I. Apendiks, Vëll. VII, Utet, 1987, fq. 754; VIGNA, *La finalità di terrorismo ed eversione*, Giuffrè, 1981, p.23 s.; PELISSERO, *Reato politico e flessibilità delle categorie dogmatiche*, Jovene, 2000, p. 244 s.

⁷⁸ Në këtë kuptim LAUDI, fjala *Terrorismo* (e drejta e brendshme), në Enc. Dir. Vol. XLIV, 1992, Giuffrè, p. 356; PANZERA, *Terrorismo* (e drejta ndërkombëtare), këtu, fq.370; RONCO, voce *Terrorismo*, cit. fq. 754; PELISSERO, *Reato politico*, cit., fq. 244; VIGNA, *La finalità*, cit., fq. 42.

përtej atij kërkon të ketë një rëndësi më të madhe, kërkon të përfaqësojë një simbol dhe të përcjellë një mesazh⁷⁹”.

Të dhëna të tjera në lidhje me kuptimin e qëllimit të terrorizmit mund të nxirren nga normativa ndërkombëtare në këtë fushë.

Për këtë qëllim, ndonëse tashmë bart vetëm një vlerë historiko-shkencore pasi nuk ka hyrë kurrë në fuqi, ia vlen sigurisht të përmendim Konventën për parandalimin dhe goditjen e terrorizmit, adoptuar në Gjenevë më 16 nëntor të vitit 1937. Kjo Konventë, në të vërtetë, ndërsa vendos për Shtetet anëtare detyrimin për të futur norma inkriminuese që kanë për qëllim goditjen e sjelljeve terroriste, dha edhe një përkufizim të përgjithshëm të krimit, që duhet kuptuar si një përkufizim që përfshin të gjitha “*ato ngjarje kriminale që drejtohen kundër një Shteti, qëllimi i të cilave apo natyra e të cilave është të ngjallet terror ndër persona të caktuar, grupe personash apo ndaj komunitetit*”.

Ky hap i parë që synonte të luftonte terrorizmin përmes një bashkëpunimi juridik ndërkombëtar nuk pati efektin e dëshiruar dhe më tej nuk u bë më asnjë përpjekje tjetër deri në vitet Gjashtëdhjetë, nën shtysën e fenomeneve të reja terroriste.

Analiza e normativës së këtyre viteve dëshmon qartë vullnetin, nga ana e Komunitetit ndërkombëtar për të zgjidhur problemet që lindën nga format e reja të terrorizmit rast pas rasti, sektor për sektor, në vend të përpunimit të parimeve abstrakte dhe të përgjithshme⁸⁰.

Përpunimi i kategorive specifike në fakt bëri të mundur kapërcimin e problemeve që rrjedhin nga impostime të ndryshme ideologjike të Shteteve (që në përpunimin e parimeve të përgjithshme vështirë se mund të kapërcehen) duke bërë kështu të mundur dhënien e një numri gjithnjë e më të madh miratimesh në lidhje me përkufizimin e krimeve të veçanta⁸¹.

Mossuksesi i përpjekjeve të bëra nga Kombet e Bashkuara gjatë viteve ’70 në fushën e luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar solli nevojën për të

⁷⁹ MARLETTI, *Il terrorismo moderno come strategia di comunicazione*. Disa mendime duke nisur nga rasti i Italisë, në VILLA (a cura di), *La violenza interpretata*, Il Mulino, 1979, fq. 191; C.CUPELLI, *Il nuovo art. 270 bis k.p.: emergenze di tutela e deficit di indeterminatezza?*, në Kas. Pen. 2002, 3, fq. 897.

⁸⁰ Në këtë kuptim PANZERA, *Terrorismo (e drejta ndërkombëtare)*, në Enc. dir., vol. XLIV, Milano. fq. 370.

⁸¹ Në këtë këndvështrim duhen lexuar Konventa e Hagës e dt. 16 dhjetor 1970 për ndëshkimin e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, dhe Konventa e Romës, më dt. 10 mars 1988 për ndëshkimin e veprave kundër lundrimit detar.

programuar një strategji më pak ambicioze dhe, me fjalë të tjera, më lehtë të realizueshme, e cila do të krijonte mundësinë për të kapërcyer vështirësitë e hasura në këtë drejtim dhe që kishin kryesisht të bënin me përmasat e veçanta të organizimit, si dhe me mungesën e homogjenitetit mes Shteteve anëtare.

Në këtë kuptim, rezultate sigurisht më të mira, për një mënyrë të përgjithshme të këndvështrimit të kësaj çështjeje, u arritën në nivel rajonal evropian, me **Konventën evropiane për ndëshkimin e terrorizmit adoptuar në Strasburg më datë 27 janar të vitit 1977**, që neni 1 parashikon detyrimin për Shtetet anëtare për të ndëshkuar një numër të detyruar krimesh me qëllim terrorist, dhe neni 2 i njeh çdonjërit prej këtyre Shteteve aftësinë për të mos i konsideruar krim politik aktet e rënda të dhunës që nuk janë parashikuar nga neni 1 kundër jetës, integritetit të njeriut ose lirisë së njeriut, ashtu si aktet e rënda kundër pasurive që mund të krijojnë një rrezik për paprekshmërinë e jetës publike⁸².

Konventa në fjalë, i cila u bë e zbatueshme në Itali me Ligjin n.719, të dt. 26 nëntor 1985, për të dalluar krimin politik nga ai terrorist mbështetur në karakteristika të llojit objektiv, si mënyra e zbatimit, natyra e pasurisë objekt i sulmit apo sërish rreziku kolektiv për një numër të pacaktuar personash, ndërsa nuk i jepet asnjë rëndësi qëllimit të ndjekur⁸³.

Pavarësisht se Konventa e Strasburgut e vitit 1977 ka arritur të ketë rezultate të mira, edhe një herë ajo nuk dha një përkufizim të përgjithshëm

⁸² Neni 1: “Për qëllime të ekstradimit mes Shteteve kontraktues, asnjë prej krimeve të mëposhtme nuk do të konsiderohet si krim politik apo krim i lidhur me një krim politik, apo krim i mbështetur nga arsye politike: a) një krim për të cilin zbatohen dispozitat e Konventës për ndëshkimin e kapjes së paligjshme të një mjeti ajror, nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970; b) një krim për të cilin zbatohen dispozitat e Konventës për ndëshkimin e veprave të paligjshme të kryera kundër sigurisë së aviacionit civil, nënshkruar në Monreal më dt. 23 shtator 1971; c) një krim i rëndë që sjell atentatin kundër jetës, integritetit fizik apo lirisë personale të personave që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, përfshirë këtu agjentët diplomatikë; d) një krim që sjell rrëmbim, kapjen e një pengu, apo një sekuestrim arbitrar; e) një krim që sjell përdorimin e bombave, granatave, raketave, armëve automatike apo pakove që përmbajnë lëndë shpërthyesë ku përdorimi i tyre përfaqëson një rrezik për njerëzit; f) një përpjekje për të kryer një prej krimeve që i paraprijnë pjesëmarrjes si bashkëpunëtor i një personi që kryen apo tenton të kryejë një krim të tillë.

⁸³ Krs. nenet 1 e 2 të Konventës. Doktrina flet për një prirje ndërkombëtare, përftuar edhe në planin e të drejtës së brendshme, ndaj “depolitizimit të terrorizmit”, si “proces delegjitizimi i terrorizmit si krim politik”, STELLA, *La tutela penale della società*, në MARINUCCI-DOLCINI (nën kujdesin e), *Diritto penale in trasformazione*, Giuffrè, 1985, fq. 87.

të terrorizmit, duke u mjaftuar me renditjen e rasteve kur një krim nuk duhet të konsiderohet politik për qëllime të ekstradimit.

KËRKIMI PËR NJË PËRKUFIZIM TË PËRGJITHSHËM ËSHTË MBËSHTETUR SIDOMOS NË DY BURIME NDËRKOMBËTARE: KONVENTA E NJU JORKUT E VITIT 1999, VENDOSUR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT, DHE VENDIMI KUADËR 2002/475/GAI I BASHKIMIT EVROPIAN.

NË MUNGESI TË NJË MARRËVESHJEJE A KONVENTE GLOBALE NË LIDHJE ME TERRORIZMIN, MIRATIMI I TË CILËS PENGOHET PREJ DISA DHJETËVJEÇARËSH NGA MOSMARRËVESHJA MES SHTETEVE ANËTARE TË OKB-SË NË LIDHJE ME AKTE TERRORISTE TË KRYERA GJATË LUFTËRAVE ÇLIRIMTARE DHE LUFTËRAVE PËR RESPEKTIMIN E PARIMIT TË VETËPËRCAKTIMIT TË POPUJVE, DUHET VËREJTUR SE FORMULIMI I KONVENTËS SË VITIT 1999, E CILA U BË E ZBATUESHME ME LIGJIN 7/2003, KA NJË RËNDËSI KAQ TË MADHE SAQË MERR VLERËN E NJË PËRKUFIZIMI TË PËRGJITHSHËM, I CILI MUND TË ZBATOHET SI NË KOHË PAQEJE ASHRU DHE NË KOHË LUFTE DHE PËRFSHIN ÇDO VEPRIM KUNDËR JETËS APO PAPREKSHMËRISË SE CIVILËVE OSE, NË KOHË LUFTE, KUNDËR “ÇDO PERSONI TJETËR QË NUK DO TË MERRTE PJESË AKTIVE NË VEPRIMET E DHUNSHME GJATË NJË KONFLIKTI TË ARMATOSUR”, ME QËLLIM PËRHAPJEN E FRIKËS NË POPULLSI APO PËR TË DETYRUAR NJË SHTET APO NJË ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE TË KRYEJË APO TË MOS KRYEJË NJË VEPRIM. PËRVEÇSE DALLON NGA KËTA ELEMENTË OBJEKTIVË DHE SUBJEKTIVË, SI DHE NGA IDENTITETI I VIKTIMAVE (CIVILË APO PERSONA QË NUK JANË PËRFSHIRË NË VEPRIME LUFTARAKE), TË GJITHË MENDOJNË SE QË NJË VEPRIM TË KONSIDEROHET TERRORIST DUHET TË PARAQESË NË RRAFSHIN PSIKOLOGJIK KRITERIN E MËTEJSHËM TË MOTIVIT POLITIK, FETAR APO IDEOLOGJIK, NË PËRPUTHJE ME NJË RREGULL ZAKONOR NDËRKOMBËTAR TË NJOHUR NË REZOLUTA TË NDRYSHME TË ASAMBLËSË SË PËRGJITHSHME DHE TË KËSHILLIT TË SIGURISË SË OKB-SË, SI DHE NË KONVENTËN E VITIT 1997 KUNDËR ATENTATEVE TERRORISTE TË KRYERA ME PËRDORIM TË LËNDËVE SHPËRTHYESE.

NDËRSA PËRCAKTIMI I AKTEVE TERRORISTE QË PËRMBAN NENI 1 I VENDIMIT KUADËR TË BASHKIMIT EVROPIAN MBËSHTETET NË RENDITJEN E NJË NUMRI TË KAKTUAR KRIMESH, TË CILËT KONSIDEROHEN SI TË TILLA NGA E DREJTA KOMBËTARE, E QË MUND TË SHKAKTOJNË DËM TË RËNDË NDAJ NJË VENDI APO NJË ORGANIZATE NDËRKOMBËTARE DHE QË KRYHEN ME QËLLIM QË TË FRIKËSOJNË RËNDË POPULLSINË APO PËR TË DETYRUAR PA TË DREJTË PUSHTETET PUBLIKE APO NJË ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE TË KRYEJË APO TË MOS KRYEJË NJË VEPRIM ÇFARËDO, APO TË DESTABILIZOJË RËNDË OSE SHKATËRROJË STRUKTURAT POLITIKE BAZË, KUSHTETUESE, EKONOMIKE APO SOCIALE TË NJË VENDI APO TË NJË ORGANIZATE NDËRKOMBËTARE.

FORMULIMI PËRKUFIZUES I SJELLË NGA VENDIMI KUADËR I VITIT 2002 DALLON NGA AI I KONVENTËS SË OKB-SË E VITIT 1999, NDONËSE NDJEK NJË PJESË TË MIRË TË VIJAVE TË TIJ PËR DY ASPEKTET E MËPOSHTME.

NGA NJËRA ANË, HAPËSIRA ZBATUESE PËR KRIMET TERRORISTE REZULTON TË JETË MË E KUFIZUAR, PASI KA TË BËJË VETËM ME VEPRIME TË KRYERA NË KOHË PAQEJE, SIÇ DEL QARTË NGA PIKA E NJËMBËDHJETË “DUKE E KONSIDERUAR” HYRËSE, QË PËRJASHTON NGA RREGULLIMI VEPRIMET E KRYERA NGA FORCAT E ARMATOSURA NË KOHË KONFLIKTI TË ARMATOSUR”, SIPAS PËRKUFIZIMEVE TË DHËNA NË KËTË KUPTIM NGA E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE: PËR KËTË, PËRKUFIZIMI NË FJALË PËRFSHIN VEPRIMET E KRYERA GJATË KOHËS SË LUFTËS, TË CILAT RREGULLOHEN NGA E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE DHE, NË RADHË TË PARË, NGA KONVENTAT E GJENEVËS DHE NGA PROTOKOLLET PËRKATËSE SHITESË.

NGA ANA TJETËR, VENDIMI KUADËR KA SHTRIRË MË TEJ NOCIONIN E VEPRIMEVE TERRORISTE DUKE PARASHIKUAR QË AJO TË DALLOJNË PËR NGA QËLLIMI EVERSIV, PRA ME FJALË TË TJERA, NGA QËLLIMI “PËR TË DESTABILIZUAR RËNDË APO SHKATËRRUAR STRUKTURAT POLITIKE BAZË, KUSHTETUESE, EKONOMIKE APO SOCIALE TË NJË VENDI APO TË NJË ORGANIZATE NDËRKOMBËTARE”, I CILI MUNGON NË TEKSTIN E KONVENTËS SË VITIT 1999.

NË TË DYJA KËTO PËRKUFIZIME ËSHTË SIDOQOFTË I PRANISHËM NGJYRIMI TIPIK I VEPRIMEVE TERRORISTE I PËRCAKTUAR NGA DOKTRINA MË E REPSEKTUAR NË “DEPERSONALIZIMIN E VIKTIMËS” NË BAZË TË ANONIMATIT TË ZAKONSHËM TË PERSONAVE TË GODITUR NGA VEPRIMET E DHUNSHME, OBJEKTIVI I VËRTETË I TË CILAVE PËRBËHET BGA QËLLIMI PËR TË NGJALLUR FRIKË PA DALLIM NË KOMUNITET DHE PËR TË DETYRUAR NJË QEVERI APO NJË ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE TË KRYEJË APO TË MOS KRYEJË NJË VEPRIM TË CAKTUAR.

REFERIMI NDAJ SITUATAVE TË KONFLIKTIT TË ARMATOSUR PARASHIKUAR NË KONVENTËN E VITIT 1999 DHE, NGA ANA TJETËR MUNGON NË VENDIMIN KUADËR TREGON SEFUNDI DYFISHTËSINË E RREGULLIMIT TË VEPRIMEVE TERRORISTE DHE NEVOJËN PËR TË DALLUAR REGJIMIN JURIDIK NË LIDHJE ME IDENTITETIN E SUBJEKTEVE AKTIVE DHE TË VIKTIMAVE, NË KUPTIMIN QË DUHET TË GJEJË ZBATIM NORMATIVA E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HUMANITARE APO AJO E PËRGJITHSHME NË VARËSI TË FAKTIT NËSE VEPRIMET JANË KRYER NGA SUBJEKTE QË GËZOJNË CILËSINË E “LUFTËTARËVE” APO NËSE JANË DREJTUAR KUNDËR CIVILËVE DHE KUNDËR PERSONAVE QË NUK JANË PËRFSHIRË NË MËNYRË AKTIVE NË KONFLIKT.

NGA KJO RRJEDH QË, NË DRITËN E DISIPLINËS NDËRKOMBËTARE TË MËSIPËRME, DUKE NDRYSHUAR KËTO KRITERE SUBJEKTIVE, AKTET E TERRORIZMIT REZULTOJNË TË PËRFSHIHEN PËRKATËSISHT NË KATEGORINË E KRIMEVE TË LUFTËS APO NË ATË TË KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT.

§ 3. *Mjetet e luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar:*

§ a) *Përgjigjja ndaj sfidës së shpallur nga terrorizmi islamik: përgjigjja amerikane.*

Që të nesërmen e atentateve të 11 shtatorit, fjala më shumë e përdorur nga administrata amerikane ishte “luftë”: sulmi ndaj Amerikës i kryer nga terroristët e Bin Ladenit, apo nga kush për të, duhet të konsiderohet një akt lufte, të cilit mund t’i përgjigjeshe vetëm me luftë.

Nuk është e rëndësishme të vlerësojmë se cila është bazueshmëria dhe ligjshmëria e një impostimi të tillë në aspektin e të drejtës ndërkombëtare: ajo çka vë në dukje është vetëm që logjika e përgjigjes amerikane ndaj sulmit të 11 shtatorit që, në fakt, një përgjigje luftarake. Sigurisht, jo vetëm në kuptimin e qartë që pak javë më vonë Shtetet e Bashkuara të Amerikës sulmuan ushtarakisht Afganistanin, duke pretenduar shprehimisht të drejtën e mbrojtjes së ligjshme kundër një qeverie, asaj të talebanëve, që strehonte dhe mbronte terroristët duke i konsideruara ata përgjegjës për atentatet e Nju Jorkut dhe Washingtoni; dhe as vetëm në kuptimin që, qoftë në bazë të arsyeve shumë më të diskutueshme, në fakt e në të drejtë, që pikërisht logjika e një faze të dytë në “luftën globale ndaj frikës” që nisi në mars të vitit 2003 me pushtimin ushtarak të Irakut. Me fjalë të tjera, përtej këtyre veprimeve ushtarake në kuptimin tradicional, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës zgjodhi ta shtrijë përgjigjen e vet tek terrorizmi ndërkombëtar me matricë islamike duke ndjekur një logjikë emergjence, që i përcaktonte terroristët – kuqo që ata veprojnë nëpër botë – si “luftëtarë – armiq”: si të tillë ata nuk gëzojnë si garancitë e të drejtës penale, ashtu dhe të drejtat, ndonëse të kufizuara, që gëzojnë ligjërisht të burgosurit e luftës në bazë të të drejtës ndërkombëtare humanitare. Kjo gjë do të thotë në praktikë – të paktën për qëllimet fillestare të administratës së Bushit, ashtu siç shprehur në të famshmin *Patriot Act*, vetëm pjesërisht të korrigjuara nga jurisprudenca e mëvonshme e Gjykatës së Lartë – t’u hiqje të arrestuarve çdo garanci të *habeas corpus*, duke kapërcyer kështu në themel çdo pengesë të mundshme që magjistratura amerikane dhe sidoqoftë një përgjigje gjyqësore do të kish mundur të jepte kundër veprimit të luftës që po kryhej nga pushteti ekzekutiv.

§ b) *Përgjigjja evropiane:*

Ka qenë e ndryshme deri në këtë moment përgjigjja evropiane ndaj emergjencës së terrorizmit islamik, që nuk ndryshoi në thelb as mbas atentateve të kryera në vitin 2004 dhe 2005 në Madrid dhe në Londër.

Edhe vendet evropiane, siç të gjithë duhet të kujtojnë, u rreshtuan menjëherë krahas qeverisë së Shteteve të Bashkuara në marrjen e masave parandaluese (me karakter kryesisht administrativ) kundër financimit të terrorizmit ndërkombëtar, duke parashikuar dhe zbatuar të ashtuquajturën ngrirje të pasurive të personave fizikë dhe të organizatave që dyshohen të kenë lidhje me terrorizmin me matricë islamike. Por strategjia e përgjithshme e luftës ndaj emergjencës së terrorizmit – kudo që do ishte në rrezik e mira e lirisë së njeriut – vazhdoi të zhvillohej në radhë të parë në kuadrin e kanaleve të drejtësisë penale, në veçanti përmes rivlerësimit të llojeve të krimit të organizuar, të përcaktuar më parë, që sipas rastit mund të qenë ndryshuar apo shoqëruar nga të tjera, të ndryshuara në lidhje me veçantinë e terrorizmit me matricë islamike.

Në thelb, zgjedhja e të ashtuquajturës përgjigje në rrugë gjyqësore duke u mbështetur në të drejtën penale nuk mund të nënkuptojë tjetër veç hedhje poshtë, nga ana e legjislacioneve evropiane, të logjikës “luftarake” të terroristit si armik. Të kërkosh të vazhdosh të kapësh me mjetet e të drejtës penale fenomenin terrorist do të thotë pra të vazhdosh të besosh në një mjet funksioni i dyfishtë i të cilit (mjet mbrojtës i të mirave juridike të komunitetit dhe, njëherësh, i garancisë për fajtorin, apo të sapo dyshuarit) do të thotë mbi të gjitha të vazhdosh ta japësh përgjigjen e legjislacionit ndaj sfidës terroriste përmes hallkave të procesit dhe të juridiksionit penal.

Pra, të besosh në zbatueshmërinë e një përgjigjeje penalistike është e mundur jo vetëm me kusht që të mbahet seriozisht parasysh nevoja për ta shpallur të pafajshëm të pandehurin, por edhe që të mbahet seriozisht parasysh nevoja për të shpallur të pafajshëm një fajtor, apo sidoqoftë një person që paraqet rrezikshmëri shoqërore, kur akuza nuk arrin të provojë për të fajësinë me mjetet që vë në dispozicion procesi penal.

Natyrisht që e gjitha kjo nuk përjashton konkretisht edhe që një përgjigje “penalistike” nga pikëpamja strukturore mund të bjerë në ujdin me logjika emergjenciale që do ta bënë peshoren të rëndonte më shumë drejt kahut të mbrojtjes së shoqërisë se sa drejt atij të mbrojtjes së të drejtave themelore të të hetuarit – të pandehurit (e më pas të të dënuarit). Në fakt, legjislacione të ndryshme, ndër të cilët edhe ai i Italisë, kanë luajtur rol të mirë në ripropozimin, e sipas rastit në përpunimin e mjeteve të ndëshkimit të

eksperimentuar për një pjesë të mirë të tyre në situata të mëparshme (apo ende aktuale) të “emergjencave kriminale” – nga mafia tek terrorizmat e brendshëm me matricë të ndryshme – duke propozuar kështu një model lufte ndaj terrorizmit islamik në njëfarë kuptimi hibrid: që nuk është njësuar me modelin luftarak amerikan, por karakterizohet nga një këndvështrim i ashtuquajtur i binarit të dyfishtë apo i nënsistemit kundrejt modaliteteve të zakonshme të luftës kundër krimit të zakonshëm.

§ 4. Dispozitat penale në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar parashikuar nga ligjvënësi italian.

§ 4.1. Krimi i organizuar siç parashikuar në nenin 270 bis të kodit penal në luftën kundër kriminalitetit me matricë islamike.

Sidomos në Itali instrumenti i luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar me matricë islamike ka gjetur shprehje në dispozitën në lidhje me krimin e organizuar, siç në nenin 270 bis të kodit penal, futur në versionin e tij fillestar gjatë situatës së emergjencës terroriste të brendshme e të ndryshuar, të nesërmen e datës 11 shtator, me ligjin n.438, të datës 15.12.2001 në mënyrë të tillë që do ta bënte atë të përdorshme edhe në rastet kur objektivi i terroristëve që veprojnë në Itali nuk mund të përcaktohet si subversiv nga legjislacioni kushtetues italian, dhe që sidoqoftë gjendet jashtë territorit kombëtar.

Ky rol shtjellohet jo vetëm dhe jo aq në përgatitjen e një mekanizmi rëndues të caktimit të dënimit për të pandehurin, në rast dënimi për kryerjen e një apo më shumë krimeve: për këtë qëllim, do të mjaftonin në fakt dënimet që parashikohen nga norma të tjera penale (si për shembull neni 280 e 289 i k.p., përkatësisht në lidhje me atentatin dhe sekuestrimin e personit për qëllime terrorizmi dhe subversioni, të cilëve u është shtuar kohët e fundit inkriminimi i ri sipas nenit 280 bis k.p., në lidhje me atentatet kundër sendeve të luajtshme ose të paluajtshme përmes përdorimit të lëndëve shpërthyes apo vrasëse për qëllime të terrorizmit), si dhe rrethana rënduese e përgjithshme sipas nenit 1 të ligjit 15/1980, e zbatueshme për të gjitha krimet e kryera për qëllime terrorizmi dhe eversioni (padyshim përjashtuar krimet qëllimi i të cilave përbën një element pjesë të krimit), dhe që del jashtë mekanizmit të balancimit të rrethanave sipas nenit 69 k.p..

Një nga funksionet thelbësore të kryera nga neni 270 bis të k.p. në sistemin penal është se kërkon ta konsiderojë që në krye personin e dyshuar

si një anëtar të organizatës terroriste në një nënsistem të veçantë të të drejtës substanciale, procedurale dhe të burgut që dallon ndaj atij të zbatueshëm për kriminalitetin e zakonshëm – një funksion krejt i ngjashëm me atë të kryer nga neni 416 bis i k.p. në kuadrin e luftës kundër krimit të llojit mafioz, ndonëse mes dy fenomeneve dhe dy llojeve të krimit të organizuar shquhen ndryshime që do të vihen më tej në dukje.

Por inkriminimi sipas nenit 270 bis k.p., pra instrumenti që trajton krimin e organizuar, zbatuar për terrorizmin islamik ashtu si konkretisht ndodh ende sot, do të duket sikur kryhet një tjetër funksion, sipas të cilit është e mundur të dënohen jo vetëm ato **veprimet instrumentale që ndihin mbijetesën dhe funksionimin e organizatës**, por edhe **veprimet përgatitore të krerjes së krimeve – qëllim**, që ende nuk arrijnë pragun e tentativës së ndëshkueshme dhe, për këtë arsye, do të rezultojnë njësoj të parëndësishme nga pikëpamja penale, në mungesë të llojit të krimit të organizuar.

E pra, pikërisht ky funksion i fundit del në plan të parë në ato raste kur kemi të bëjmë me një terrorizëm që mendohet të ketë potencialitete shumë të mëdha sulmi, edhe për shkak të aftësisë së tij për të përdorur burra e gra që janë të gatshëm të flijohen, por që për fat të mirë godet rrallë, o sepse është diçka e mirëmenduar ose sepse ka mungesë njerëzish dhe mjetesh. Një gjë e tillë kundrejt nevojës për të parandaluar, për sa është e mundur, kryerjen e krimeve katastrofike si ato të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara, por edhe më të afërta në kohë si ai i vitit 2004 në Spanjë dhe 2005 në Britaninë e Madhe dhe në Egjipt.

Ndërsa fakti që në të gjitha legjislacionet evropiane ekzistojnë norma që dënojnë pjesëmarrjen e thjeshtë në organizata kriminale bën të mundur ndërhyrjen e menjëhershme për të penguar – përpara se të jetë shumë vonë – ekzekutimin e planit, edhe në mungesë të ndonjë veprimi ekzekutues në formë tentative, i rëndësishëm nga pikëpamja penale, atëherë kur mund të thuhet se ekziston një strukturë minimale organizate që është në gjendje të ekzekutojë planin e menduar e për të cilin është rënë dakord.

Sigurisht, këto komente të fundit kritikohen shumë sidomos nga doktrina, duke pasur parasysh se një formulim i tillë i krimit penal sjell riskun e zhvendosjes nga plani i një të drejte penale të veprës drejt modelit të një të drejte penale të autorit, apo të rrezikshmërisë individuale, ku dënimi bëhet i dallueshëm nga masa e sigurisë, dhe masa e sigurisë që mund të merret për t'u mbivendosur nga pikëpamja funksionale ndaj një mase parandalimi.

Ja sepse, këtu më shumë se kurrë, roli themelor i interpretuesit, pra i gjyqtarit, është të kërkojë një pikë të pranueshme ekuilibri mes instancave për mbrojtje sociale dhe instancave për mbrojtje të të mirave juridike.

Lidhur me këtë, sipas mendimit tim duket krejt e pamundur ndjekja e rrugës së mbështetur me forcë nga ana e doktrinës italiane që, në dritën e *iure condendo*, të hiqet dorë nga instrumenti i krimit të organizuar, si një instrument kryesor në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar, e veçanërisht kundër atij me matricë islamike.

Në fakt, rëndësia e kërcënimit që vjen nga terrorizmi islamik është e padiskutueshme dhe rëndësia e të mirave juridike në lojë (jeta e qindra njerëzve) na bën të mendojmë që mund të mos jetë e pashmangshme ndonjë sakrificë të kufizuar nga pikëpamja e garancive, në favor të një mbrojtjeje më efektive të shoqërisë, duke qenë të vetëdijshëm që parimet kushtetuese në fushën e të drejtës penale (parimi i materialitetit; parimi i ligjshmërisë; parimi i sulmit; i përpjestimit mes veprës dhe dënimit dhe personalitetit të përgjegjësive penale) nuk shfaqen kurrë si dogma absolute, por natyrisht u nënshtrohen balancimeve me kundërvlera në rastin në fjalë në konflikt, ashtu siç është mbrojtja e jetës të gjithë qytetarëve.

Megjithatë kjo nuk do të thotë që duhet ta lëmë veten të mposhtemi nga shtypa pro ndëshkimit dhe të themi që e gjitha kjo është “e nevojshme” në luftën kundër terrorizmit, por lipset të gjejmë pika ekuilibri mes nevojave për mbrojtjen e shoqërisë dhe kërkesave për garanci që mund dhe duhet të gjenden brenda një kuadri ligjor që, sado të jetë mbështetur në një logjikë emergjence, lejon ende garancinë e një përgjigjeje gjyqësore ndaj fenomenit të terrorizmit ndërkombëtar me matricë islamike.

Në këtë këndvështrim, krimi i organizuar dhe lloji i krimit i parashikuar nga neni 270 bis i k.p., ashtu siç ndryshuar në vitin 2001 nga ligjvënësi, përbën një pikë referimi të pandarë në kuadrin e një përgjigjeje efektive, me armët që vetë e drejta penale ka, kundër terrorizmit me matricë islamike.

Prandaj duket e udhës të theksojmë se neni i ri 270 bis, ndërsa përcakton dënimin për veprimet e pjesëmarrjes në organizatë me qëllim terrorist, edhe ndërkombëtar, pasqyron globalizimin aktual të krimit të organizuar dhe synon të mbrojë “sigurinë publike botërore” nga rreziqet që paraqesin grupet

terroriste për “stabilitetin socio-politik universal, rendin publik ndërkombëtar dhe interesat supremë të njerëzimit”⁸⁴.

Duke pasur parasysh sa më lart – ndonëse shkurtimisht – duhet të theksohen veçantia e organizatës me qëllime terroriste ndërkombëtare, parashikuar e dënuar nga neni 270 bis i k.p..

Duhet vërejtur në fakt se karakteri “*transnacional*” i llojit të krimit, shtrirja e objektit të mbrojtjes dhe mungesa e përcaktimit ligjor të një “metode terroriste apo subversive” (mbi modelin e përfutur me nenin 416-bis të k.p. për të vepruarin mafioz) ngrenë çështjen e verifikimit të trajtimit të një strukture të organizuar në paradigmen e nenin 270-bis të k.p.

Ky rindërtim provues është i nevojshëm kur struktura e organizatës nuk është identifikuar ende – për një fakt të ditur dhe/ose verifikim gjyqësor – si terroriste apo eversive, dhe aq më shumë kur duke mos kryer më parë akte terroriste, konsiderohet vetëm potencialisht në gjendje të shkaktojë dëme nga të mirës “së sigurisë publike botërore”.

Organizatrat terroriste transnacionale shfaqin sidoqoftë karakteristika më se të ndryshme nga grupet kriminale tradicionale, veçanërisht nga ato të llojit mafioz. Karakteristika që përbëjnë forcën e mirëfilltë të tyre, pasi i bëjnë “të pazbulueshme”, pra më pak të depërtueshme nga hetimet.

Ndërsa organizatat mafioze karakterizohen nga një strukturim i fortë dhe rrënjëzim në territor, “celulat” islamiste nuk janë të strukturuar ngurtë në një organizatë të vetme hierarkike, por janë të lidhura mes tyre si në një konfederatë, e kjo gjë ndër të tjera ndodh në rrugë krejt informale; vërtiten rreth “strukturave të shërbimit” (financiar e logjistik) si Al Quaeda; veprojnë me shumë shpejtësi e lehtësi brenda “një rrjeti” transnacional të terrorit, në kuadrin e të cilit kapërcehen gjithnjë e më shumë edhe identitetet etniko-kombëtare.

Edhe objektivat e çdo grupi mund të dallojnë mes tyre, ndonëse bashkohen të gjithë në një emërues të përbashkët: lufta e shenjtë kundër armiqve dhe jo besimtarëve.

Vështirësitë në veprimin e luftës gjyqësore – që duhet patjetër të veprojnë mes efikasitetit dhe garancive, duke shmangur rrugët e shkurtra apo boshllëqet gjatë marrjes së provave – rrjedhin edhe nga dallimet në interpretim, për shkak të mungesës së jurisprudencës së konsoliduar mbi

⁸⁴ FIANDACA-TESAURO, *L'azione di contrasto al terrorismo internazionale - Le disposizioni sostanziali: linee*, në *Il processo penale tra politiche della sicurezza e nuovi garantismi*, nën kujdesin e G. De Chiara, G. Giappichelli Editore – Torino.

llojin e ri të krimit sipas nenit 270-*bis* të k.p., në lidhje me elementët e nevojshëm për konfigurimin e veprimeve të pjesëmarrjes në një organizatë me qëllime terroriste me matricë islamike.

Meqenëse është e qartë që shpallja e parakohshme e dënueshmërisë nuk mund të reduktohet në persekutim të ideve, si dhe të pozicioneve gjeografike, lipset të përcaktojmë diskriminimin mes anëtarësimit ideologjik ndaj radikalizmit fundamentalist dhe pjesëmarrjes në një organizatë terroriste. Nuk është vetëm një problem prove, por është para së gjithash një problem juridik.

Duket gati një antinomi e pazgjidhshme. Por është e udhës të kujtojmë se disa Autorë, ndonëse kanë parasysh problemet e kushtetueshmërisë së dispozitave me rrezik abstrakt, kanë mbërritur në përfundimin sipas të cilit ekzistenca e tyre në një legjislacion penal është e domosdoshme kur lind me forcë nevoja për të mbrojtur në mënyrë veçanërisht intensive – pra, duke i paraprirë pragut të dënueshmërisë deri në rrezikshmërinë abstrakte – të mira të caktuara dhe, sidomos kur vërtetimi i një rreziku konkret mund të ishte jashtëzakonisht i vështirë pikërisht për shkak të natyrës “së paprekshme” të të mirës së mbrojtur.

Detyrueshmëria e ulur e dispozitës mbi krimin e organizuar, karakteri i saj “transnacional”, që qëndron i hapur ndaj fenomenologjisë së ndryshueshme socio-politike, shtrirja e objektit të mbrojtjes dhe mungesës së përcaktimit ligjor të një “metode terroriste ose subversive” (mbështetur në modelin e përfutur me nenin 416-*bis* të k.p. për të vepruarin mafioz) ngrenë që në fazën e hetimeve paraprake çështjen e verifikimit të trajtimit të strukturës së organizuar që mendohet të jetë me matricë terroriste ose subversive, duke iu referuar paradigmës së nenit 270-*bis* të k.p..

Nevoja për të verifikuar përshtatshmërinë e strukturës së organizuar është shumë më e madhe në rastet kur veprimet e dhunshme janë ende në fazën “e qëllimit” dhe nuk kanë nisur ende të kryhen. Atëherë do të bëhej fjalë për të verifikuar, siç është vërejtur më parë, ekzistencën e një strukture të organizuar që mund të jetë në gjendje t’i shkaktojë dëm të mirës së mbrojtur, ekzistencën e një plani kriminal dhe të përgatitjes së mjeteve të përshtatshme për qëllimin.

Në aspektin interpretues – ndonëse në mungesë të orientimeve jurisprudenciale të konsoliduara në lidhje me nenin e ri 270-*bis* të k.p. – mund të themi se mundësia për ta konsideruar organizatën si një strukturë me qëllime terroriste ndërkombëtare kërkon ekzistencën e më shumë se një personi, të një strukture të organizuar, të një lidhjeje që krijohet mes

anëtarëve, të një plani të dhunshëm (qëllimi i “*kryerjes së akteve të dhunshme*”) dhe i pajisjes me mjete të përshtatshme për qëllimin.

Megjithatë, këto pohime duhet të krahasohen me realitetin e fenomeneve të organizatave terroriste transnacionale me matricë islamike, që shfaqin karakteristika mjaft të ndryshme nga to të grupeve kriminale tradicionale dhe që përbëjnë forcën e vërtetë të tyre, pasi i bëjnë më pak të depërtueshme nga hetimet:

- bëhet fjalë për “celula” jo të strukturuar ngurtë në një organizim të vetëm hierarkik, por që lidhen mes tyre, në mënyrë krejt informale, si të ishin pjesë e një konfederate, duke u vërtitur rreth “strukturave të shërbimit” (financiar dhe logjistik) si Al Qaeda;

- veprojnë në kuadrin e një “rrjeti” transnacional të terrorit, duke ruajtur identitetin e tyre etniko-kombëtar, por duke qëndruar në lidhje, duke bashkëpunuar dhe duke u specializuar (për shembull, në Itali duke u specializuar në përgatitjen e dokumenteve të rremë);

- edhe objektivat e çdo grupi mund të dallojnë mes tyre, ndonëse të gjithë bashkohen nga një emërues i përbashkët: lufta e shenjtë kundër armiqve dhe jo besimtarëve;

- “Plani i dhunshëm” i këtyre organizatave duhet parë në atentatet dhe në aktet e dhunshme që janë kryer në vende të ndryshme, ndërsa anëtarësimi në të i anëtarëve të veçantë, herë pas here, duhet të provohet me hetime specifike.

Karakteristikat shumë të copëzuara dhe sektoriale të veprimeve të pjesëmarrjes në një organizatë, dhe vështirësitë për rrjedhojë për të provuar të gjithë elementët e parashikuar nga neni 270-bis i k.p., sidomos qëllimin terrorist të veprimeve dhe vizionin ndërkombëtar të tyre jo thjesht si anëtarësim ideologjik, na këshillojnë të mos braktisim idenë – si alternativë apo si krim në bashkëpunim me atë të ex neni 270-bis të k.p. – të akuzës së krimit të parashikuar në nenin 416 të k.p. në lidhje me një program apo plan (të vërtetuar) kriminal si “mbështetje logjistike”.

Lidhur me këtë duhet vërejtur se doktrina dhe jurisprudenca kryesuese e konsiderojnë plotësisht të mundshëm bashkëpunimin – duke përjashtuar kështu marrëdhënien e specialitetit ex neni 15 i k.p. – mes krimit të pjesëmarrjes në një organizatë me qëllime terroriste-subversive dhe atij të bandës së armatosur (neni 306 i k.p.) pasi mes këtyre krimeve rrjedh një marrëdhënie mjeti dhe qëllimi dhe jo gjinie dhe lloji. Në të njëjtin përfundim mund të arrihet në rastin e një bashkëpunimi në krim që ka për qëllim trafikun e dokumenteve të rremë, që synon të ofrojë mbështetje

logjistike për organizatën me të madhe me qëllim terrorizmin ndërkombëtar. Me fjalë të tjera, veprimi në organizatë, ex neni 416 mund të shihej në këtë rast si një mënyrë pjesëmarrjeje në organizatë terroriste (krahas veprimeve të tjera, si proselitizmi, rekrutimi, mbështetja financiare, asistenca ligjore, etj.,..).

Në radhe të parë duket qartë se tërësia e celulare të krijuara në Itali dhe në Evropë dhe në Lindjen e Mesme, pasi u rikrijuan duke filluar të paktën nga gjysma e parë e vitit 2002, në bashkëveprim të përhershëm mes tyre dhe pasi dolën në dritë nga hetimet e kryera, përbën një realitet të qëndrueshëm dhe të konsoliduar, një instrument që është i gatshëm të nisë të veprojë në zinxhirin e hallkave të veçanta operative (nga zhvendosja e një militanti në studimin e një objekti, nga një mesazh telefonik i kodifikuar në vendosjen përfundimtare të një lënde shpërthyesë) që është i destinuar të përfundojë me atentatin terrorist të mirëfilltë.

Nëse ose ndoshta mund të thuhet se kur, ku dhe në dëm të cilit objektiv do të ndodhë një gjë e tillë (kundër një Shteti të huaj në një territor të huaj, kundër një përfaqësie të huaj apo një organizmi ndërkombëtar italian në Itali, kundër një objekti italian jashtë vendit apo, sipas rastit, kundër një objekti italian në Itali), do të varet nga rrethanat politike të momentit apo nga mundësi konkrete dhe nga urdhrat e marrë, por është e sigurt që, edhe në bazë të qëllimeve politiko/fetare të luftës kundër gjithë Perëndimit që janë shprehur qartë dhe fare mirë pothuaj çdo ditë, koha e marrjes së vendimit do t'i gjejë celulat të gatshme të realizojnë pjesën e tyre të detyrës.

Në këtë aspekt duket qartë se jo vetëm mbajtja materiale e lëndëve shpërthyesë por zhvendosjet e ushtarakëve, të shumave të parave, të celularëve, të njoftimeve të krijuara sipas kodeve numerike të përcaktuara më parë, shkëmbimi i materialit propagandistik me qëllim rekrutimi, disponibiliteti i banesave dhe sidomos prodhimi i vazhdueshëm i dokumenteve të rremë përbëjnë edhe në kohë pritjeje dhe edhe për shumë kohë, kushte pa të cilat zinxhiri që shpie deri në atentatin terrorist nuk do të vihej dot në lëvizje, lidhen ngushtë e janë funksionale për kryerjen e një veprimi.

Sidomos prodhimi i dokumenteve të rremë “të sigurtë”, ku celulat italiane duket se janë më të zonja, përbën një instrument thelbësor për organizatën pasi përmes tyre anëtarët e saj mund të lëvizin qetësisht nëpër vendet evropiane dhe të Lindjes së Mesme duke mbajtur marrëdhënie me anëtarët (shumë më thelbësore dhe të shpeshta nga vendi në vend se ato që kishin karakterizuar organizatat terroriste tradicional) dhe duke iu përgjigjur në kohën e duhur objektivave.

§ 4.2. Neni 270 sexies i k.p. dhe veprimet me qëllime të terrorizmit ndërkombëtar.

Për sa më sipër, duhet të theksojmë këtu zgjedhjen legislative që u bë të nesërmen e atentateve të korrikut të vitit 2005 në Londër dhe në Egjipt, me nenin 270 sexies të k.p., parashikuar nga ligji nr. 155, dt. 31 korrik 2005.

Pikërisht për të kapërcyer një sërë kontradiktash dhe çorientimesh të jurisprudencës në lidhje me të, për shkak të mungesës së një nocioni të saktë për terrorizmit në legjisllacionin italian, zgjedhja që bëri ligjvënësi ishte përcaktimi i veprimeve me qëllime terroriste, duke sjellë një përkufizim të dyfishtë:

Një pjesë e parë në të cilën jepet një përkufizim i përgjithshëm i veprimeve me qëllim terrorist duke e ndryshuar plotësisht vendimin kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 13 qershor 2002;

Një pjesë e dytë në të cilën nocioni shtrihet sidoqoftë në të gjitha veprimet që konsiderohen sidoqoftë terroriste nga e drejta ndërkombëtare.

Pra në pjesën e parë ligjvënësi sqaron dy kriteret të pacenueshme, me qëllim që të mund të flitet për veprime me qëllime terroriste, madje pa saktësuar as që duhet të bëhet fjalë për veprime “të dhunshme”. Ndërsa ajo që kërkohet është që këto veprime, për nga natyra apo konteksti i tyre, duhet të jenë “të përshtatshme dhe t’i shkaktojnë dëm një vendi apo një organizate ndërkombëtare” dhe se “këto veprime duhet të karakterizohen nga faji specifik”, që mund të shfaqet në forma të tjera alternative:

qëllimi për të frikësuar popullsinë;

qëllimi për të detyruar pushtetet publike apo një organizatë ndërkombëtare për të kryer apo mos kryer çdo veprim;

qëllimi për të destabilizuar apo shkatërruar strukturat politike themelore, kushtetuese, ekonomike dhe sociale të një vendi apo të një organizate ndërkombëtare.

Ndërsa në pjesën e dytë, ligjvënësi ofron një normë mbrojtjeje duke iu referuar të drejtës ndërkombëtare, aty ku përcakton se **duhet të konsiderohen veprime terroriste edhe të gjitha veprimet e përcaktuara si terroriste apo të kryera me qëllime terrorizmi nga marrëveshje apo norma të tjera të të drejtës ndërkombëtare.**

Përkufizimi i qëllimit terrorist i cili është përfshirë në sistemin juridik italian nga neni i ri 270 *sexies* k.p., përkon në thelb me konceptin sociologjik të terrorizmit, të cilit ligjvënësi sigurisht në mungesë të një përkufizimi specifik kish dashur t'i referohej me dispozitën e parashikuar në nenin 270 bis të k.p., kështu që fare mirë mund të përdoret tani për interpretimin e saktë të normës në fjalë.

Nga pikëpamja sociologjike, pa asnjë pretendim për përkufizim shkencor, nënkuptohet zakonisht me terrorizëm çdo akt i dhunshëm, i kryer si kundër personave ashtu dhe kundër sendeve (pra, vetëm si shembull, vrasje, plagosje, sekuestrime apo burgosje personash apo dëmtime ose atentate me lëndë shpërthyesë ose me mjete të tjerë kundër ndërtesave, impianteve, rrugëve të komunikimit), të kryera me metoda terroriste me qëllime ngushtësisht politike.

Metoda e përdorur është terroriste kur nga njëra anë objektivi, i goditur nga akti i dhunës, nuk ka rëndësi në vetvete (pra autori i aktit të dhunshëm nuk është i interesuar të godasë pikërisht atë viktimë, personin e tij apo sendet e tij, për atë që ka bërë apo që nuk ka bërë, rrethanë pra që përbën qëllimin e kryerjes së krimit, shpjegimin e veprimit të vet), por ka rëndësi ose sepse mishëron një simbol për kolektivitetin të cilit i përket (është rasti për shembull i atij që ka role të caktuara, për shembull ushtron veprimtari drejtuese në qeveri apo në administratën e drejtësisë apo të ruajtjes së rendit publik, apo është rasti i ndërtesave që janë seli e detyrave të mësipërme) apo, anasjelltas, sepse është një anëtar çfarëdo i kolektivitetit të mësipërm pa asnjë rol në veçanti, e meqenëse identiteti i tij personal është krejt pa rëndësi, nga ana tjetër autori i aktit të dhunshëm, duke goditur objektivat si më lart të përcaktuar, kërkon të sjellë ngjalljen e një ndjenjë të përhapur paniku apo të një terrori të mirëfilltë në kolektivitet, ndërkohë që objektivat e goditur janë pjesë e këtij kolektiviteti.

Qëllimi i fundit i aktit terrorist është sidoqoftë e gjithnjë “politik”, në kuptimin e ngushtë, pasi konkretizohet në vullnetin për të shkaktuar një ndryshim, pak a shumë të gjerë apo madje të plotë, të përgjithshëm të sistemit juridik efektivisht në fuqi në kuadrin e një komuniteti të caktuar, me mjete të ndryshme nga ato të lejuara nga ai sistem juridik.

Lidhur me këtë Gjykata e Kasacionit ish shprehur duke thënë se “përbën qëllim terrorizmi ngjallja e terrorit në komunitet me veprime kriminale të indiskriminuara, jo kundër personave të veçantë por kundër asaj që ata përfaqësojnë dhe, nëse janë drejtuar kundër personit pavarësisht nga funksioni i tij në shoqëri, synojnë të ngjallin terror për të tronditur besimin

në sistemin e ngritur dhe të dobësojë strukturat e tij” (krs. Kasac.11382 të dt. 5.11.1987).

Meqenëse kuadri ligjor është kështu i ravigjzuar, duket se është e nevojshme të provojmë në radhë të parë se personat në hetim kanë krijuar një organizatë të qëndrueshme dhe të konsoliduar, apo që janë bërë pjesë e një strukture të tillë paraekzistuese, e gatshme të hyjë në veprim kur vendoset të kryhet akti terrorist i mirëfilltë.

Në këtë aspekt duket qartë se jo vetëm mbajtja materiale e lëndëve shpërthyes dhe/ose e armëve, por edhe zhvendosjet e militantëve, të shumave të parave, të celularëve, komunikimet e krijuara sipas kodeve të vendosura numerike, shkëmbimi i materialit propagandues me qëllim rekrutimin, disponibiliteti i banesave e vendstrehimeve dhe sidomos prodhimi i vazhdueshëm i dokumenteve të rremë **përbëjnë kushtet e nevojshme pa të cilat zinxhiri që shpie në atentatin terrorist nuk mund të vihet në lëvizje: janë pra ngushtësisht funksionale për përfundimin e mirë të një veprimi.** Këto veprime, që të provohet qëllimi dhe jo rastësia, janë të mjaftueshme në vetvete për të konsideruar krimin në fjalë.

Le të kujtojmë për shembull se prodhimi i dokumenteve të rremë “të sigurtë”, ku celularat italiane të Jihadizmit terrorist ndërkombëtar duket se janë më të zonja, përbën një instrument thelbësor për organizatën sepse përmes anëtarëve të tij mund të lëvizin qetësisht nëpër vendet e Evropës dhe të Lindjes së Mesme duke mbajtur marrëdhënie me anëtarët dhe duke realizuar në kohën e duhur objektivat ose në vendet kur kryhet stërvitja paraprake për qëllime të kryerjes së atentatit.

§ 4.3. Parimet e përcaktuara nga jurisprudenca italiane më e fundit në lidhje me ekzistencën e krimit të organizuar me qëllime terrorizmi.

U përmend më sipër jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit në lidhje me tiparet e nenit të vjetër 270 bis të k.p. dhe pra të llojit të mësipërm me hyrjen në fuqi të ligjit të dhjetorit 2001, që ish konsideruar e përshtatshme për të kuptuar edhe veprimet e pjesëmarrjes në një organizatë me qëllime terrorizmi ndërkombëtar, pra në ato organizata që drejtonin veprimtaritë e tyre të dhunshme kundër një Shteti të huaj, meqë në këto raste bëhet fjalë për veprimtari që – ndonëse të kryera në territor italian – nuk kishin sidoqoftë për qëllim të përmbysin rendin kushtetues të Shtetit italian (Kas. 1.3.1996, Ferdjani me të cilin Gjykata hodhi poshtë rekursin e prokurorit të Napolit kundër vendimit të Gjykatës së Rishqyrtimit që kish përjashtuar

zbatueshmërinë e nenit 270 bis dhe kish zbatuar nenin 416 të k.p. për një organizatë që vepronte në Itali dhe që kish lidhje me G.I.A. Algjeriane).

E pra, siç ndodhi në vitin 1996, ashtu dhe pas vitit 2001 ishte Autoriteti Gjyqësor i Napolit ai që kërkoi edhe një herë ndërhyrjet e para të Gjykatës së Lartë të Kasacionit në lidhje me organizatën me qëllime të terrorizmit ndërkombëtar (neni i ri 270 bis i k.p.).

Dhe në fakt, vendimet e para të Gjykatës së Kasacionit rezultojnë të jenë dhënë pikërisht në lidhje me çështje të rëndësishme mbi një organizatë terroriste me matricë islamike e quajtur Grupi Salafit për Predikimin dhe Luftimin shumë aktiv në Algjeri dhe që kish lidhje me rrjetin e njohur ndërkombëtar terrorist të quajtur Al Quaeda.

a) Një vendim i parë është ai i depozituar më datë 16 mars 2005, nga Seksioni i Dytë Penal i Gjykatës së Kasacionit (në kuadrin e një çështjeje penale të regjistruar kundrejt 28 personave me kombësi algjeriane të hetuar për krimin e parashikuar në nenin 270 bis dhe të tjera), me të cilin Gjykata e Lartë duke pranuar plotësisht rekursin e sjellë nga Prokurori i Napolit kundër vendimit të Gjykatës së Rishqyrtimit, e anuloi – për mungesë arsytimi – duke e kthyer për rishqyrtim me urdhëresën nr. 284/04 të Gjykatës së Napolit – Seksioni i Rishqyrtimit, depozituar më datë 14 korrik 2004, duke hedhur poshtë apelin e Prokurorit kundër urdhëresës së GJHP pranë Gjykatës së Napolit, që kish hedhur poshtë kërkesën për zbatimin e masave të sigurisë në burg kundrejt njëzet e tetë shtetasve algjerianë, në lidhje me krimin e parashikuar në nenin 270 bis, paragr. 1, 2 e 3 të k.p., pasi janë organizuar mes tyre dhe me persona të tjerë të panjohur, duke realizuar në Itali një rrjet mbështetjeje logjistike të organizatës subversive me matricë profesionale të quajtur G.S.P.C. (Grupi Salafit për Predikimin dhe Luftimin), e lidhur nga pikëpamja funksionale me organizatën terroriste ndërkombëtare të quajtur Al Quaeda, me qëllim kryerjen e akteve të dhunshme kundër Shtetit algjerian dhe akte që kanë për qëllim terrorizmin ndërkombëtar.

Në vendimin e sipërpërmendur – i pari vendim i dhënë në lidhje me këtë krim – Gjykata shprehet se Gjykata e Napolit ka mbërritur në vendimin e kundërshtuar duke lënë pas dore dokumentet e prodhuar në seancë nga prokurori (që sqaronin më mirë vlerën provuese të elementëve të të dhënave që i janë vënë në dispozicion GJHP) dhe duke i ndarë elementët ekzistues në ngarkim të të hetuarve, duke i shqyrtuar më vete, pa prekur, sipas një

mënyre të gabuar vlerësimi, kuadrin e përgjithshëm të akuzës që paraqitet nga prokurori.

Një shqyrtim i tillë i mangët i materialit të të dhënave është sipas Gjykatës jashtëzakonisht i rëndësishëm në rastin kur të hetuarit akuzohen se bëjnë pjesë në një organizatë terroriste-subversive me përmasa transnacionale.

Parimet e përgjithshme të konfirmuar janë si vijon:

1) Nëse do të jetë e nevojshme të vlerësohet për qëllime të krimit siç në nenin 270 bis të k.p., qëndrimi i grupeve ekzistuese në Itali, që – sipas akuzës – bëjnë pjesë në organizata që veprojnë në vende të tjera, është pak të konsiderosh vetëm elementët që kanë të bëjnë me veprimtarinë e kryer në territorin tonë, pa e përfshirë atë në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarisë që lidhet me gjithë organizatën. Në fakt celulës italiane mund t'i kërkohej të kryejë detyra thjesht në mbrojtje të veprimit dhe, edhe pse ka një rol të kufizuar, do të dilte si pjesë përbërëse e një organizate që ka për qëllim të kryejë akte të dhunshme me qëllime terrorizmi.

2) Po kështu, shqyrtimi i përmbajtjes së bisedave të regjistruara nuk duhet të ndjekë këto rrugë interpretimi reduktuese, pasi një fjalë apo një shprehje më vete mund të mos ketë një kuptim të qartë por, nëse përfshihet në një kontekst më të gjerë provues, mund të marrë një kuptim të caktuar.

3) Të pohosh se historia e Algjerisë nuk i përket bagazhit të njohurive të zakonshme mbi të cilat gjyqtari mund të mbështesë vendimin e vet dhe shpallja e mospërdorshmërisë gjyqësore të njoftimeve të dhëna nga shtypi, për të cilat do ish e nevojshme të verifikohet prejardhja dhe vërtetësia, **mbështetet në një metodë të gabuar kulturore dhe juridike të nocionit të një fakti të njohur. Ky i fundit, në shoqërinë e sotme gjithnjë e më të integruar dhe transnacionale, nuk mund të vlerësohet më një mjedis të ngushtë lokal, meqë në këtë mënyrë gjyqtari që gjendet përballë ngjarjeve që përfshijnë vendin tonë dhe vende të tjera, mbërrin pashmangshmërit në një “non liquet” substancial, duke mos dashur të konsiderojë fakte edhe shumë të qarta që, për nga rëndësia që kanë, duhet të konsiderohen si fakte që njihen nga të gjithë.**

b) Vendime të tjera të Gjykatës së Lartë të Kasacionit janë vendimet nr. 24994/24995 të depozituara më 19.7.2006 po nga Seksioni II, dhe që janë marrë nga Gjykata në kuadrin e një çështjeje penale të regjistruar kundrejt subjekteve algjeriane që u konsideruan anëtarë të një celule terroriste e

pranishme në Itali, në zonën mes Napolit, Salernos, Breshias dhe Viçencës e cila kish lidhje me organizatën terroriste të quajtur G.S.P.C.

Bëhet fjalë për dy vendime krejt të ngjashme, pasi janë dhënë në lidhje me pozicione të ndryshme të të hetuarve, me të cilat Gjykata – edhe në dritën e normativës së re të futur në korrik të vitit 2005, me nenin 270 *sexies* të k.p. – vendos “...që për plotësimin e veprimit të pjesëmarrjes në një organizatë me qëllime terrorizmi edhe ndërkombëtar apo përmbysjeje të rendit demokratik, siç në nenin 270 bis të k.p., është e mjaftueshme, qoftë edhe në rastin e një strukture të organizuar në mënyrë primitive, që anëtarësimi ideologjik të mbështetet në qëllime serioze kriminale që synojnë realizimin e qëllimeve të organizatës, dhe duke pasur parasysh natyrën e krimit të rrezikut të prezumuar, nuk është e nevojshme të ketë nisur ekzekutimi konkret i planit kriminal”.

Kuptohet mirë se sa i fortë është parimi i të drejtës i afirmuar nga Gjykata e Lartë që për herë të parë ia mvësh konkretisht krimit të parashikuar nga neni 270 bis të k.p. rolin e instrumentit të luftës dhe njëkohësisht të parandalimit të fenomenit të terrorizmit ndërkombëtar, duke treguar se i ka kuptuar mirë karakteristikat e këtyre organizatave shpesh primitive (dhe të tilla që cilësohen qartë si disa celula apo rrjet mbështetjeje logjistike) dhe nevojën për t’i paraprirë pragut të dënueshmërisë edhe për veprimtaritë e ideimit të një plani kriminal, që konkretisht nuk varet edhe nga ekzekutimi material i planit kriminal.

I të njëjtit nivel me dy vendimet e mëparshme është edhe vendimi i dhënë **nga Seksioni I i Gjykatës së Kasacionit nr. 29602 i depozituar në datë 19.9.2006** po në kuadrin e të njëjtës çështje në lidhje me dy të pandehur që janë dënuar kohët e fundit me 6 vjet burgim për krimin e parashikuar nga neni 270 bis i k.p., nga Gjyqtari i Seancës Paraprake i Gjykatës së Napolit, gjatë një gjykimi të shkurtuar.

Ndërsa konfirmon vendimin e Gjykatës së Rishqyrtimit të Napolit, Gjykata konfirmon se për ekzistencën e krimit siç në nenin 270 bis të k.p., ndonëse ndërtuar si një krim me rrezik të prezumuar, nuk është i nevojshëm anëtarësimi ndaj një ideologjie abstrakte, por është e nevojshme përgatitja e një “plani konkret të veprimeve subversive” ende të porealizuara.

Rrjedh nga kjo që ideja e thjeshtë eversive, e pashoqëruar nga qëllime konkrete dhe akte të dhunshme, nuk mjafton për të realizuar krimin, duke u mbrojtur kështu pikërisht nga rendi kushtetues i Shtetit që, në rrugë kontradiktore, kjo ide kërkon të përmbysë.

Për këtë arsye, prova e pjesëmarrjes në një organizatë terroriste ndërkombëtare nuk mund të rrjedhë vetëm nga anëtarësimi psikologjik ose ideologjik kriminal, por ka nevojë për një kalim konkret në veprim të anëtarëve të grupit, në formë veprimtarie përgatitore në lidhje me ekzekutimin e krimeve ose me marrjen përsipër të një roli konkret në organigramën kriminale (është shprehur kështu së fundi Gjykata e Kasacionit Seksionet e Bashkuara më dt. 20 shtator 2005, Mannino).

Dhe për këtë qëllim gjykata mendon se janë sigurisht tregues të marrjes përsipër të një roli konkret në organigramën e organizatës dhe të përfshirjes në veprimtari subversive (ndonëse kanë mbetur në fazë plani) elementët e përcaktuar nga Gjykata e Rishqyrtimit dhe më saktë:

- biseda të përgjuara në të cilat flitet për përgatitje atentatesh, frekuentim i përhershëm i anëtarëve të organizatës, marrëdhënie e zgjatur në kohë me personin nxitës dhe organizator të celulës, bashkëpunim në veprimtarinë e gjetjes e sigurimit të dokumenteve të rremë për anëtarë të GSPC, përcaktimi i tij ndër persona bashkëkombës si “terrorist”, përpjekje e hapur për t’iu shmangur kontrollit, etj.,..).

Megjithatë, pasi pohoi parimin e të drejtës, Gjykata kaloi në trajtimin e temës së vlerësimit të elementëve të provës që konsiderohen të mjaftueshëm nga Gjykata e Rishqyrtimit të Napolit me qëllimin për të përcaktuar se në celulë ekziston mundësia e organizatës terroriste dhe se ajo ka lidhje me G.S.P.C. duke pohuar kështu parimin sipas të cilit vetëm përfshirja në lista të vendeve të veçanta apo të organizatave ndërkombëtare nuk është e mjaftueshme të provojë natyrën terroriste të një organizate.

Një tjetër vendim i rëndësishëm është vendimi i Gjykatës së Lartë – Seksioni I, i depozituar më dt. 19.09.2006, me nr. 30824, me të cilin Kasacioni trajton si problemin e karakteristikave të krimit të ri të parashikuar nga neni 270 bis i k.p., ashtu dhe në lidhje me provën e ekzistencës së organizatës terroriste, problemin e vlefshmërisë së listave të hartuara nga Bashkimi Evropian.

E pra, për sa i takon krimit të parashikuar nga neni 270 bis i k.p. Gjykata pohon se ndonëse ka konfirmuar natyrën e krimit me rrezik të prezumuar, për krimin siç në nenin 270 bis të k.p., nuk është i mjaftueshëm aderimi i i thjeshtë ndaj një ideologjie abstrakte – sado e urryer dhe e shfaqur brutalisht të jetë ato – por është e nevojshme të përgatitet “një plan konkret veprimesh subversive”, duke mos dalluar në këtë aspekti struktura e tij nga ajo e krimeve të tjera të organizuara. Gjykata ka zbatuar gjithashtu parimet e

pranuara nga Seksionet e Bashkuara në lidhje me pjesëmarrjen në një grup a marrëveshje kriminale për të përcaktuar se ku kemi pjesëmarrje në celulë terroriste kundrejt anëtarësimit të thjeshte psikologjik ose ideologjik ndaj radikalizmit fondamentalist.

Së fundi, vendimi sqaron se listat e organizatave terroriste të hartuara nga Bashkimi Evropian nuk mund të përbëjnë në vetvete një element prove të natyrës terroriste të organizatës, duke u përkthyer ndryshe në një provë të parregullt ligjore.

Vendimi më i fundit është vendimi n.1072 Seanca 11.10.2006 depozituar më dt. 17.1.2007 i dhënë nga Seksioni Penal I i Kasacionit (Ric. Buoyahia e të tjerë n. 19646/06).

Gjykata ka dhënë një interpretim të rëndësishëm të dispozitës së re që përmban neni 270 *sexies* i k.p.. Kjo normë, sipas Gjykatës së Lartë, përmban një përkufizim të terrorizmit “me ndikim të drejtpërdrejtë” mbi rëndësinë e shtrirjen e dispozitës inkriminuese siç në nenin 270 bis të k.p.. Çështja, siç dihet, kish të bënte me referueshmërinë apo jo ndaj normës së sipërpërmendur të veprimeve vetëvrasës të kryera nga kamikazët gjatë një konflikti të armatosur që, ndonëse drejtoheshin kundër objektivave ushtarakë, shkaktonin dëme të rënda ndaj popullsisë civile.

Sipas Gjykatës, përmes formulimit të hapur të normës së re të parashikuar nga neni 270 *sexies* i k.p., i cili për sa i përket përkufizimit të veprimeve terroriste apo të kryera me qëllime terrorizmi, u referohen instrumentave ndërkombëtarë që përbëjnë detyrim për Italinë, është futur një “mekanizëm në gjendje të sigurojë automatikisht përafrimin e legjislacioneve të Shteteve” që bëjnë pjesë në komunitetin ndërkombëtar në përpjekjen për “një veprim të përbashkët ndëshkues” të fenomenit të terrorizmit ndërkombëtar. Për këtë arsye, meqenëse norma e re e kodit duhet të përshtatet me Konventën Ndërkombëtare për ndëshkimin e financimit kundër terrorizmit, bërë në Nju Jork më 8.12.1999 dhe ratifikuar në Itali me ligjin n.7, të dt. 14.1.2003, qëllimin i terrorizmit mund të konsiderohet se ekziston edhe kur veprimet kryhen në konflikte të armatosura – të cilësuar nga e drejta ndërkombëtare edhe nëse kanë të bëjnë me luftëra civile të brendshme – dhe nëse, përveçse kundër civilëve, drejtohen edhe kundër personave që nuk janë përfshirë në konflikte, duek përjashtuar vetëm veprimet e drejtpërdrejta kundër luftëtarëve, të cilat përkundrazi vazhdojnë të rregullohen nga e drejta ndërkombëtare humanitare. Për rrjedhojë, në lidhje me çështjen e të drejtës që e rregullon atë, **Gjykata ka vendosur që**

mund të cilësohen si akt terrorist edhe veprimet që kryhen kundër një objekti ushtarak “kur situatat e veçanta dhe konkrete bëjnë të duken të sigurta dhe të pashmangshme pasojat e rënda në dëm të jetës dhe të integritetit fizik të popullsisë civile, duke kontribuar në përhapjen e frikës dhe panikut në popullsi”.

Një tjetër parim i rëndësishëm i konfirmuar nga ky vendim i Gjykatës së Lartë ka të bëjë me mundësinë për të konsideruar ekzistencën e të ashtuquajturit bashkëpunim të jashtëm edhe në organizatën terroriste, ex neni 270 bis i k.p.. Konfirmohet në fakt në vendimin e sipërpërmendur se veprimtaritë e kryera në Itali në mbështetje të një organizate terroriste që vepron jashtë vendit janë të dënueshme si pjesëmarrje në krimin e organizuar **ex neni 270 bis i k.p. apo bashkëpunim i jashtëm në bazë të nenit 110 të k.p.**, eventualisht nëse ekzistojnë ose jo elementët bazë përkatës që janë treguar sëfundi në vendimin e njohur të Seksioneve të Bashkuara të dt. 12.7.2005, Mannino – Ced.cass. 231673. nga kjo rrjedh që mund t’i referohen krimin të mësipërm edhe veprimet e kryera nga persona që edhe pse vazhdojnë të qëndrojnë jashtë strukturës organizative, do të sillnin “një ndihmë konkrete dhe të vetëdijshme ekziologjikisht e rëndësishme për ruajtjen, përforcimin dhe arritjen e qëllimeve të organizatës kriminale ose të degëzimeve të saj sektoriale”, duke qenë të vetëdijshëm për qëllimet e arritura nga organizata.

Së fundi, Gjykata ka trajtuar temën e vlefshmërisë së listave të hartuara nga organizatat ndërkombëtare ku përfshihen organizatat terroriste.

Lidhur me këtë Gjykata pohon se pozicioni i një organizate në listat e organizmave ndërkombëtarë ka vlerë vetëm administrative, duke u përdorur më shumë nga pikëpamja investigative si një element rivlerësues, por nuk mund të marrë vlerën e provës, në një sistem si i yni që, edhe në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, nuk ka dashur të ndryshojë kundrejt garancive të llojit substancial dhe gjyqësor, po kaq të qenësishme sa parimet kushtetuese.

§ 4.4. Veprimi i financimit të organizatave me qëllim terrorizmi (neni 270 bis k.p.).

Një tjetër risi e sjellë nga norma e re e ndryshuar nga ligji nr. 431, i dhjetorit 2001, është fakti se ai parashikoi si veprim autonom, që ndër të tjera u gjykua si i barazvlefshëm me veprimet e themelimit dhe të nxitjes, me veprimin e “financimit të organizatave që synojnë të kryejnë akte të dhunshme me qëllime terrorizmi”.

Duhet vërejtur para së gjithash se normativa është mbështetur në këtë pikë në legjislacionin e njëkohshëm në lidhje me “masat urgjente për ndëshkimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit”, siç në D.L. 369/2001, konvertuar në ligjin 431/2001.

§ 4.5. Dispozita e re për krimin e dhënies së ndihmës për anëtarët e organizatës – neni 270 ter k.p.

Me ligjin e dhjetorit 2001 u fut gjithashtu edhe parashikimi i krimit siç në nenin 270 ter të k.p. që, përtej rasteve të bashkëpunimit në krim apo të dhënies së ndihmës, inkriminon këdo që ofron strehim, ushqim, mjete transporti, mjete komunikimi një prej personave që marrin pjesë në organizatat e treguara në nenin 270 bis k.p..

Edhe ky lloj i ri inkriminimi duket të frymëzohet më shumë në nevoja simboliko-ndëshkuese, sesa në nevojën për një kodifikim të saktë. Në fakt është e qartë se ky parashikim i ri synon t’u kundërvihet të gjitha mbështetjeve që bazohen në solidaritetin e racës, fesë apo ideologjisë që mund të hasen vazhdimisht në favor të organizatave të inkriminuara nga legjislacioni në fjalë, pikërisht në sajë të natyrës së tyre.

Në mbështetje të sa thamë duhet vërejtur se kjo norma mbështetet në parashikimin e nenit 307 të k.p. në lidhje me “ndihmën që u jepet anëtarëve të një konspiracioni dhe të bandës së armatosur”. Edhe në këtë rast ligjvënësi ka dashur të parashikojë një formë të veçantë ndihme për anëtarët e organizatës, rregulluar nga neni 418 i k.p..

Është po kaq e qartë që ky veprim nuk do të konsiderohet si krim atëherë kur personi që e ka kryer atë duhet të konsiderohet si anëtar i qëndrueshëm i organizatës dhe ndihma është dhënë me vetëdije në këtë kuadër programi më të gjerë për personin veprues, sepse në këtë rast do të ishte një ndihmë që i jepet organizatës në mënyrë të vetëdijshme, me një ndryshim krejt të kuptueshëm në aspektin subjektiv.

Për këtë arsye, me qëllim që të vërtetohet veprimi i dhënies së ndihmës është e nevojshme të ekzistojë një faj i përgjithshëm, i cili qëndron në faktin që dhënia e ndihmës një anëtar pa qenë e nevojshme të bashkëndajë qëllimet, objektivat dhe planet e organizatës në të cilën bën pjesë, është e vetëdijshme.

Për sa u takon dallimeve me krimin e favorizimit (neni 378 i k.p.), rezulton i vlefshëm pohimi në dritën e të cilit “krimet e dhënies së ndihmës ndaj anëtarëve dhe i favorizimit personal, përveçse nga natyra e të mirës

juridike të dëmtuar dallojnë edhe për nga larmia e qëllimeve të ndryshme ashtu dhe të përmbajtjes së ndihmës së dhënë. Parakusht për krimin e parashikuar në nenin 378 të k.p. është që të jetë kryer një krim përpara se t'i jetë dhënë ndihmë autorit të tij; ndërsa, parakushti për krimin e parashikuar në nenin 307 të k.p. është që ndihma t'i jepet autorit të krimit veprimtaria kriminale e të cilit të mos jetë ndërprerë ende. Personi i ndihmuar në krimin sipas nenit 378 të k.p. është një person jo i cilësuar, ndërsa në nenin 307 të k.p. është një anëtar i organizatës ose i bandës së armatosur (Kështu Kasac. 11.7.1987, seksioni I, Benacchio).

§ 4.6. Dispozitat e reja në lidhje me terrorizmin të futura me ligjin nr. 155, dt. 31.7.2005.

Folëm më lart për rolin shumë të rëndësishëm të ligjvënësit në korrik 2005 me futjen e nenit 270 *sexies* të k.p., në të cilin rezultojnë të ndara sipas llojit dhe të shtjelluara veprimet me qëllime terrorizmi. Megjithatë, po me këtë ligj është plotësuar kuadri i dispozitave penale në lidhje me terrorizmin duke parashikuar raste të tjera krimi:

a) Neni 270 quater (rekrutim me qëllime terrorizmi edhe ndërkombëtar)

Kjo normë parashikon në fakt dënimin e burgimit nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet për këdo që, përtej rasteve të parashikuara nga neni 270 bis i k.p., rekruton një apo më shumë persona për kryerjen e akteve të dhunës apo sabotim të shërbimeve publike të qenësishme, me qëllime terrorizmi, edhe nëse drejtohen kundër një Shteti të huaj, një institucioni apo një organizmi ndërkombëtar.

Bëhet fjalë për një normë që synon të ofrojë një mbrojtje të mëtejshme e më të gjerë, duke garantuar një sanksion penal edhe për ata persona që ndonëse nuk rezultojnë të jenë anëtarë të një organizate terroriste (apo për të cilët nuk arrihet të provohet pjesëmarrja në një organizatë me qëllime të terrorizmit ndërkombëtar) kryejnë veprimtari rekrutimi për të kryer më pas akte të dhunshme ose sabotimi.

b) Neni 270 quinquies (stërvitje në veprimtari me qëllime terrorizmi edhe ndërkombëtar)

Një tjetër veprim stërvitjeje që ndëshkohet, po përtej rasteve të parashikuara në nenin 270 bis k.p., me dënimin me burgim nga 5 deri në 10 vjet është ai që ka për qëllim përgatitjen apo përdorimin e materialeve shpërthyesë, armë zjarri ose armë të tjera, lëndësh kimike apo bakteriologjike të dëmshme ose të rrezikshme apo lëndë radioaktive, si dhe

të çdo teknike tjetër apo metode për kryerjen e akteve të dhunshme apo sabotim të shërbimeve publike të qenësishme, me qëllime terrorizmi, edhe nëse drejtohen kundër një Shteti të huaj, një institucioni apo një organizmi ndërkombëtar.

c) Neni 280 bis i k.p. (Akti i terrorizmit me mekanizma vrasës ose shpërthyes)

Përpara ligjit të vitit 2005 dhe më pas atij të dhjetorit 2001, ligjvënësi ka futur me ligjin nr. 34, të dt. 14.2.2003 një tjetër parashikim penal në lidhje me terrorizmin, që ka për qëllim në radhë të parë të sigurojë luftën kundër veprimeve të kryera përmes përdorimit të mekanizmave shpërthyes apo sidoqoftë vdekjeprurës, duke parashikuar një dënim që është nga dy deri në pesë vjet burgim, me përjashtim të shtesave të parashikuara nga rrethanat rënduese të treguara në paragrafët 3 e 4.

Në veçanti, paragrafi i dytë i nenit 280 bis sqaron se çfarë duhet të kuptohet me mekanizma shpërthyes apo sidoqoftë vdekjeprurës, duke specifikuar që bëhet fjalë për armë dhe lëndë që u mvishen atyre siç treguar në nenin 585 të k.p. dhe që janë të përshtatshme të shkaktojnë dëme materiale.

Lidhur me këtë lipset të kujtojmë se ligji i dhjetorit 2001, si më sipër, kish përfutur tashmë nenin 1 të ligjit 110/1975 në lidhje me armët luftarake, duke përfshirë aty edhe lëndë biologjike dhe radioaktive përveç atyre kimike.

§ 4.7. Instrumentet hetimore të ndërfutur nga ligjvënësi italian në lidhje me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Emergjenca ndërkombëtare e diktuar nga ngjarjet tragjike të datës 11 shtator 2001 në Shtetet e Bashkuara dhe më pas të marsit 2004 dhe korrikut 2005 në Spanjë, Britaninë e Madhe dhe në Egjipt, e bënë ligjvënësin italian të adoptojë një sërë instrumentesh të të drejtës penale substanciale dhe procedurale sigurisht më efikase dhe më të përshtatshme në luftën kundër kësaj forme të krimit transnacional.

Në veçanti, përgjigjja u dha përmes dy ndërhyrjeve të ndryshme e të rëndësishme ligjore dhe në veçanti me D.L. n.374 të dt. 18.10.2001, konvertuar më pas në ligjin 238 të dt. 15.12.2001 dhe me ligjin më të vonë nr. 155, dt. 31 korrik 2005.

Lidhur me këtë, duhet thënë menjëherë që zgjedhja e ligjvënësit italian qe të shtrinte sa më shumë të qe e mundur edhe në fenomenin e terrorizmit

instrumentet dhe normat procedurale të ashtuquajtura “speciale” të eksperimentuar dhe përfshira më parë për të luftuar emergjencën mafioze.

Dhe për këtë arsye, edhe për hetimet në lidhje me terrorizmin janë eksperimentuar instrumentet tradicionale të hetimit në lidhje me krimin e organizuar, ndonëse duke qenë të vetëdijshëm se gjendemi përballë dy fenomeneve të ndryshme dhe instrumenteve që shpesh janë të pamjaftueshëm për të luftuar një fenomen që objektivisht ka përfshirje transnacionale dhe duket se është e vështirë të luftohet me veprime të njëkrahshme, nëse nuk do të kishin një bashkëpunim real dhe efikas në veprimtarinë hetimore në nivel ndërkombëtar mes Autoriteteve të Policisë dhe atyre Gjyqësore të vendeve të ndryshme të përfshira.

Dhe në të vërtetë, nga përvojat e pasura duke filluar nga fundi i vitit 2001 deri më sot mund të themi se nuk ekziston një hetim mbi terrorizmin ndërkombëtar i ndërmarrë në Itali, në kuadrin e të cilit të mos ketë rezultuar që në fillim nevoja për t’u marrë vesh me autoritetet e huaja, me qëllim përfundimin e elementëve të njohjes së fenomenit apo sidoqoftë elementë që i shërbejnë vazhdimit të hetimeve.

Përpos sa më sipër shtojmë se në pjesën më të madhe të hetimeve në lidhje me terrorizmin islamik të ndërmarrë në vendin tonë, shpesh e për fat të mirë (duke pasur parasysh se në Itali, ndryshe për shembull nga Spanja e nga Britania e Madhe nuk ka pasur ngjarje tragjike) njoftimi për krimin që sillet në vëmendje të prokurorit vjen nga zhvillimi i elementëve informues mbi subjekte ose grupe subjektsh që vërtiten rreth zonës së ekstremizmit islamik, të dhënë nga policia gjyqësore e specializuar (kryesisht D.I.G.O.S dhe R.O.S.), nga Shërbimet tona të Sigurimit, që nga ana e tyre marrin dhe shkëmbejnë informacione dhe të dhëna me përfaqësuesit e shërbimeve të sigurimit të vendeve të ndryshme evropiane ose ekstraevropiane.

Këto karakteristika, të cilat i njohin mirë ata që merren me këtë fushë, sjellin dhe kanë sjellë sidomos në krye e përpara ndërhyrjeve legislative për të cilat do flasim pak më tej, jo pak probleme për fillimin e veprimtarive hetimore në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar, sidomos në lidhje me vështirësitë që ka në radhë të parë policia gjyqësore e në radhë të dytë prokurori për të shmangur në kërkesat për përgjim telefonik ose në natyrë, sidomos në paraqitjen e të dyshimeve për krim, çdo referim ndaj burimeve të sigurimit apo informative, me qëllim që të shmanget mosmiratimi i autorizimit nga ana e Gjyqtarit, mbështetur me të drejtë mbi dispozitën e nenit 203 të k.p.p..

§ 4.8. Përgjimet telefonike dhe në natyrë si një instrument i privilegjuar në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Neni 3 i ligjit 438/2001 parashikon shprehimisht në lidhje me përgjimet, që edhe në çështjet në lidhje me krime të kryera për qëllime terrorizmi dhe subversioni të rendit kushtetues gjejnë zbatim dispozitat e parashikuara në nenin 13 të D.L. nr. 152, dt. 13 maj 1991, konvertuar me ndryshime nga ligji nr. 203, në dt. 12.7.1991.

Nga kjo rrjedh që edhe në çështjet në lidhje me terrorizmin (ashtu si ato në lidhje me krimin e organizuar) gjen zbatim norma që parashikon, në ndryshim nga sa përcaktuar nga neni 267 i k.p.p., mundësia për të autorizuar operacione përgjimi edhe në prani të **dyshimeve të mjaftueshme për krim** (e jo edhe për dyshime të rënda) madje edhe kur ato nuk janë të domosdoshme, por vetëm të nevojshme për vazhdimësinë e hetimeve.

Po kjo normë, në lidhje me përgjimet në mjedis, parashikon që përgjimi mund të kryhet në një banesë private, edhe kur ka arsye të mendojmë se në vendet e mësipërme po zhvillohet një veprimtari kriminale.

Në paragrafin 2 të nenit 13 parashikohet më në fund se kohëzgjatja e përgjimeve mund mbërrijë deri në 40 ditë, të shtyshme dhe me 20 të tjera me vendim të arsyetuar, nëse vazhdojnë të ekzistojnë kushtet që e kanë shtyrë gjyqtarin të japë autorizimin.

Ky regjim i veçantë në lidhje me përgjimet telefonike dhe në natyrë rezultoi të ishte menjëherë efikas në hetimet në lidhje me grupe apo celula terroriste me matricë islamike. Instrumenti i përgjimeve telefonike dhe në natyrë vazhdon të jetë në fakt instrumenti kryesor hetimore në këtë fushë, ashtu si për krimet e kriminalitetit të organizuar, ndonëse – siç parashikohej – rezultatet pozitive që rrjedhin nga përgjimet nisin të jenë gjithnjë e më modeste dhe hasen vështirësi gjithnjë e më të mëdha në përdorimin e këtij instrumenti hetimor.

Në të vërtetë, në hetimet më të fundit haset gjithnjë e më shumë një vëmendje sistematike e gati maniakale nga ana e personave me kombësi islamike që vërtiten rreth hapësirës së të ashtuquajturit ekstremizëm apo të subversionit (dhe jo vetëm) të përfshirë në hetime në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar, në përdorimin e telefonit apo të instrumenteve të tjerë të komunikimit o edhe në komunikimin në mjedise të mbyllura (makina, banesa, xhami).

Kjo situatë ishte pak a shumë e parashikueshme pas zbulimit të kryer në çështjet e trajtuara nga disa Autoritete italiane dhe kështu, pasi këta të hetuar apo të pandehur e kuptuan mirë se pjesa më e madhe e provave të

mbledhura kundrejt tyre vinte pikërisht nga përgjimet e bisedave të tyre telefonike dhe në mjedis.

Pikërisht për këtë arsye në hetimet më të fundit u kërkua të privilegjoreshin instrumente përgjimi ai ato telematike, duke përcaktuar për shembull atëherë kur është e mundur, adresat e-mail apo në disa raste duke ndërhyrë madje me përgjim edhe në vende publike (p.sh. internet-point ose internet kafë), e-mail apo forma të tjera të komunikimit me internet, si për shembull lidhjet me të ashtuquajturat chat-line ose kontaktet (përmes hapjes dhe shkarkimit të dokumenteve dhe të programeve) me site që në dukje as nuk u përkasin shoqatave, grupeve apo realiteteve me matricë islamike.

Të gjithë kësaj i shtohet problemi serioz i përkthyesve të gjuhës arabe apo i një prej gjuhëve të folura nga të hetuarit e huaj, që duhet të shoqërojnë në këtë veprimtari oficerët e policisë gjyqësore që nga fillimi i operacioneve të dëgjimit të bisedave të përgjuara dhe kanë një rol vendimtar në këto hetime.

Të kesh në dispozicion persona të zotë nga pikëpamja profesionale dhe sidomos të besuar në këtë sektor është e domosdoshme dhe, për fat të keq, të konstatosh që pavarësisht se i gjithë sistemi ynë shfaq mangësi ende sot dhe, ashtu siç shpesh ndodh në vendin tonë, zgjidhjet (sigurisht të pamjaftueshme) për problemin i janë lënë vullnetit të mirë dhe profesionalizmit të operatorëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve që drejtojnë hetimet.

Në fakt deri tani, aty ku ka qenë e mundur – falë edhe bashkëpunimit me disa organizma institucionalë (Ambasada, Universitete, Konsullata) apo shpesh falë aftësisë së organeve të policisë gjyqësore për të gjetur persona të besuar, të aftë të kuptojnë gjuhën arabe (shpesh dialektet e ndryshme të gjuhës arabe që fliten nga personat e përgjuar) – të gjejnë një numër të përshtatshëm interpretësh – përkthyes të gjuhës arabe që përgjithësisht emërohen si ndihmës – konsulentë të prokurorit e që punojnë krah për krah me oficerët e policisë gjyqësore edhe më shumë se tetë orë në ditë, ndërkohë që kjo detyrë nuk përkon me veprimtari të tjera pune.

Pra, do kish qenë dhe do ishte e udhës të mendonim për një sistem përzgjedhës më të përshtatshëm të interpretëve-përkthyesve të gjuhës arabe, përmes formimit të një peme kombëtare të interpretëve-përkthyesve që duhet të kenë pasur përvojë në sektorin e hetimeve në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar, të cilëve duhet t'u sigurohej një formë rekrutimi apo sidoqoftë punësimi me kontratë me kohë të përcaktuar.

§ 4.9. Përgjimet parandaluese: dobi dhe caqe në luftën kundër terrorizmit.

Neni 5 i ligjit 438/2001 rregullon këtë instrument të veçantë parandalues dhe/ose informues në lidhje me krimet e kryera me qëllime terrorizmi apo subversioni të rendit demokratik.

Në të vërtetë, ligjvënësi përfitoi nga rasti për të rishkruar tiparet esenciale të përgjithshme të këtij instituti, parashikuar që me nenin 226 të disp.akt. K.p.p. dhe nga neni 25 ter i ligjit 356/1992 për krimet në lidhje me kriminalitetin e organizuar (dispozita të dyja të shfuqizuara nga dispozita e re me paragrafin 1 e me paragrafin 2 të nenit 5 të përmendur).

Siç dihet, nuk bëhej fjalë për një institut rezidual të sistemit tonë të vjetër procedural, pikërisht sepse sistemi ynë penal shënjohej nga parimi i përgjithshëm sipas të cilit përgjimet mund të autorizohen vetëm në kuadrin e një çështjeje penale dhe duhet të kenë për qëllim përfundimin e elementëve të provës vetëm në lidhje me një krim tashmë të kryer.

Neni 226 disp.akt. K.p.p. ishte pra norma e fundit ende në fuqi e cila lejonte për disa lloje krimi këtë ndërhyrje parandaluese.

Me paragrafin 5 të nenit 4 të ligjit 438/2001, ligjvënësi pra ndërftoi edhe për çështjet *de quibus* institutin e përgjimeve parandaluese me veprim ndëshkues, informues dhe lufte kundër krimeve të mafies që siç thamë ishte parashikuar më parë nga neni 25 ter i D.L. 306/1992.

Nuk ngre asnjë problem paragrafi 3 i nenit 5 të ligjit 438/2001 në të cilin përcaktohet se brenda pesë ditëve, për operacionet e kryera dhe për përmbajtjen e saj çka përgjijet duhet të hartohet një proces verbali përmbledhës i cili duhet të depozitohet pranë zyrës së prokurorit që ka autorizuar veprimtarinë. Prokurori nga ana e tij, pasi verifikon përputhshmërinë e veprimtarive të kryera me autorizim, vendos menjëherë shkatërrimin e suporteve të proces verbaleve.

Sigurisht që norma në fjalë parashikon mundësinë për të autorizuar jo vetëm përgjime paraprake telefonike, por edhe përgjime paraprake të komunikimeve mes personave që janë takuar dhe përgjime bisedash dhe komunikimesh në rrugë telematike.

Del të jetë krejt i tepërt – sidomos pas ndryshimit të ardhur me ligjin e korrikut 2005, që parashikoi sërish për prokurorin të paktën në lidhje me krime të kriminalitetit të organizuar dhe terrorizmit, mundësinë për të autorizuar drejtpërsëdrejti marrjen e të dhënave që kanë të bëjnë me 24 muajt e fundit – parashikimi siç në paragrafin 4 të nenit 5 i cili parashikon

autorizimin për qëllime parandalimi të gjurmimit të komunikimeve dhe të marrjes së të ashtuquajturve tabulatë telefonikë apo të të dhënave telematike.

Paragrafi që krijon më shumë probleme është pikërisht i pesti, në të cilin parashikohet papërdorshmëria absolute e rezultateve të përgjimeve paraprake në procesin penal, por pa prekur këtu qëllimet hetimore.

Parashikohet gjithashtu shprehimisht që *“veprimtaritë e përgjimit paraprak dhe të dhënat e marra në bazë të tyre, nuk mund të përmenden në akte hetimore, dhe as të përbëjnë objekt deponimi, e as të shpërndahen”*.

Në këtë mënyrë përcaktohet një sanksion i saktë dhe absolut procedural: papërdorshmëria që merr edhe një mbrojtje e rreptë penale, aq sa janë futur dy figura të reja krimi që mbrojnë, në alternativë, si aspektin objektiv të të dhënës së marrë, ashtu dhe atë subjektiv në mbrojtje të saj.

Shpjegohen kështu figura inkriminuese e paragrafit 3 *bis* të nenit 5 të sipërpërmendur dhe parashikimi penal në paragrafin 3 *ter* po të këtij neni 5, me të cilin parashikohet madje një krim në mbrojtje të identitetit (e po kështu të integritetit) të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore që kryejnë operacionet.

Është e qartë se një normë si kjo i mbyll rrugën çdo mundësie për rikonvertimin e përfundimeve të këtyre përgjimeve në funksion prove.

Më e fundit, dhe për disa aspekte edhe më e diskutueshme, duket forma e veçantë e përgjimeve paraprake të futura me nenin 4 të ligjit nr.155, dt. 31.7.2005. Bëhet fjalë për një instrument parandalues të besuar, me autorizim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave lëshuar drejtorëve të Shërbimeve të Informacionit dhe Sigurisë, të cilët mund të kërkojnë autorizimin për të kryer përgjime paraprake, atëherë kur gjykohen të domosdoshme për parandalimin e veprimtarive terroriste apo të përmbysjes së rendit kushtetues. Ky autorizim nuk do t'i kërkohej Prokurorit të Rrethit, por Prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Rrethit ku ka lindur nevoja për parandalim.

E pra, është e kotë të themi që ky instrument, sado ta njohim atë, është përdorur shumë rrallë në praktikë, në dallim nga përgjimet paraprake të kërkuara nga organet e policisë gjyqësore që sidomos në fazën menjëherë pas atentateve terroriste të viteve të fundit bëhen herë pas here në lidhje me persona dhe vende të njohur më parë.

§ 4.10. Kontrollet e ndërtesave ose blloqeve të ndërtesave.

Paragrafi i dytë i nenit 3 të ligjit 438/2001 shtrin gjithashtu zbatueshmërinë e normave të parashikuara në nenin 25 bis të D.L. nr.306, 1992, konvertuar në ligjin n.356, dt. 7.8.1992 edhe në çështjet që kanë për objekt krime me qëllime terrorizmi.

E pra, pa ndryshuar sa parashikuar nga neni 27, parag. 2 Ligji n.55, 19.3.1990, oficerët e P.GJ. mund të procedojnë me kontrollet lokale të ndërtesave apo blloqeve të ndërtesave ku kanë arsye të bazuar të mendojnë se gjenden armë, municione apo lëndë shpërthyes apo që është strehuar një person i shpallur në kërkim apo një i arratisur, në lidhje me një prej krimeve të treguara në nenin 51 parag. 3 bis i k.p.p. apo krimeve me qëllime terrorizmi.

Norma në fjalë, përtej asaj që duket, është veçanërisht delikate; në fakt kjo normë sjell një shtrirje të kompetencave të Policisë Gjyqësore, në mënyrë të tillë që në çështje për krime me qëllime terrorizmi dhe subversioni, edhe në mungesë të garancive që vijnë nga ndërhyrja e prokurorit, i japin policisë gjyqësore një kompetencë të pavarur për të ndërmarrë kontrolle, duke krijuar një parashikim që i shtohet parashikimit të nenit 41 të T.U.L.P.S., me qëllim gjetjen e armëve dhe neni 99 i T.U. 309/90 që u njehtë njëjtën kompetencë në anijet luftarake apo në shërbim të policisë mbi mjetet lundruese në lundrim në ujëra territoriale, me qëllim gjetjen e lëndëve narkotike.

§ 4.11. Veprimtaritë e infilttruara të oficerëve të policisë gjyqësore.

Neni 4 i ligjit 438/2001 parashikon një rregullim të veçantë të veprimtarive të ashtuquajtura *undercovered* të policisë gjyqësore në lidhje me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, që kryesisht risillet me rregullimin e veprimtarive të infilttruara sipas **nenit 9 të ligjit të dt. 16 mars 2006, nr. 146 në lidhje me krimin transnacional**, ku u referohet shprehimisht veprimtaritë e infiltrimit në lidhje me terrorizmin.

Duhet vërejtur menjëherë se përpara se të hyjmë në hollësitë e rregullimit ligjor që – të paktën për sa u takon hetimeve në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar me matricë islamike – nuk rezultojnë raste ku është eksperimentuar figura e agjentit të infiltruar. Ky moszbatim u detyrohet sigurisht vështirësive objektive për të gjetur një oficer të policisë gjyqësore i cili është në gjendje të flasë dhe të kuptojë gjuhën arabe dhe që ka të njëjtat tipare somatike të personave të hetuar me të cilët duhet të lidhet. Vetë mundësia e gjetjes së ndihmësve me prejardhje arabe që mund të

bashkëpunojnë me oficerin e policisë gjyqësore të infiltruar ka qenë shumë herë mjaft e vështirë, si për shkak të faktit se janë pak personat e gatshëm ta bëjnë këtë, ashtu dhe sidomos për shkak të besueshmërinë e tyre. Pra ishte dhe do të jetë e nevojshme në të ardhmen që të investojmë në këtë sektor dhe të parashikojmë forma rekrutimi të personave me prejardhje arabe që duhet të përdoren me sukses në operacione infiltrimi.

Sidoqoftë, përtej vështirësive të zbatimit të instrumentit, duhet të analizohen karakteristikat e rregullimit ligjor të futura me ligjin e vitit 2001.

Në fakt, neni 4 i sipërpërmendur, pa ndryshuar sa parashikuar nga neni 51 i k.p., parashikon një shkak padënueshmërie për oficerin e policisë gjyqësore që gjatë operacioneve specifike të policisë, të cilat janë vendosur në bazë të paragrafit 5 po të këtij neni me qëllimin e vetëm për të marrë elementë prove në lidhje me krimet e kryera me qëllime terrorizmi, edhe nëpërmjet një personi të ndërmjetëm blejnë, marrin, zëvendësojnë ose fshehin para, armë, dokumente, lëndë narkotike, të mira apo sende që janë objekte, produkt, përfitim apo mjet për të kryer krimin, apo që pengojnë zbulimin e prejardhjes apo mundësojnë përdorimin e tyre.

Në këtë mënyrë, rregullohet plotësisht rasti specifik i agjentit provokator dhe parashikohet një shkak padënueshmërie për oficerët e policisë gjyqësore që veprojnë me qëllim marrjen e elementëve të provës në lidhje me krimet e kryera me qëllime terrorizmi.

Megjithatë, operativiteti i kësaj dispozite varet nga një sërë kushtesh.

Në radhë të parë, është e nevojshme që të jenë duke u kryer operacione specifike të policisë dhe këto operacione mund të kryhen në bazë të paragrafit të nenit të mësipërm, vetëm nga oficerë të policisë gjyqësore që u përkasin organizmave investigativë të Policisë së Shtetit dhe Armës së Karabinierëve të specializuar në veprimtarinë e luftës kundër terrorizmit dhe eversionit dhe Rojes Financiare kompetente në veprimtarinë e luftës kundër financimit të terrorizmit edhe ndërkombëtar.

Në radhë të dytë, është e domosdoshme të bëhet fjalë për operacione të menduara dhe të vendosura, në bazë të paragrafit 5 të nenit 4 si më sipër, nga organi më i lartë i zyrës të cilës i përket oficeri që merr detyrën.

Gjithashtu, veprimtaritë që mund të kryhen janë të gjitha të treguara sipas llojit me një listë taksative: bëhet fjalë për blerjen, marrjen, zëvendësimin, etj., ashtu siç janë renditur në listë në paragrafin 1.

Së fundi, veprimtaria i infiltruar që, siç thashë më lart mund të marrë nga jashtë tiparet e një veprimi të paligjshëm, në abstraksion përmban një

parashikim të krimit, duhet të ketë për qëllim mbledhjen e provave në lidhje me krimet e kryera me qëllime terrorizmi, përndryshe prokurori nuk do mund të përdorë dispozitën inkriminuese të parashikuar.

Bëhet fjalë për një dispozitë që në njëfarë mënyre risjell figurën e agjentit të infiltruar që është provuar më parë me sukses në lidhje me veprimet në luftë kundër grupeve kriminale që merren me trafikun e lëndëve narkotike dhe rregulluar nga neni 97 i D.P.R. 309/90.

Megjithatë, në dallim të faktit që për këtë normë të fundit, për të cilën parashikohet detyrimi për njoftim të menjëhershëm të Autoritetit Gjyqësor në rast realizimi të blerjes së një lënde narkotike, ligji 438/2001 parashikon vetëm një detyrim njoftimi për prokurorin për nismën e ndërmarrë dhe kryerjen e saj gjatë operacionit dhe menjëherë më pas, një njoftim të organit dhe të subjekteve që kanë marrë pjesë në operacion, si dhe të rezultateve të operacionit.

Në këtë mënyrë del qartë modeli i përzgjedhur nga ligjvënësi i cili është i prirur të transferojë pjesën më të madhe të përgjegjësive, ashtu si dhe nismat në lidhje me veprimtaritë e infiltrimit, nga Autoriteti Gjyqësor në organin më të lartë të policisë që merret me veprimtarinë parandaluese. Në mbështetje të kësaj është e mjaftueshme të përmendim pjesën e dytë të paragrafit 6 të nenit 4 të Ligjit 438/2001, me të cilin parashikohet vetëm që sipas rastit (nëse do të kërkohej ose do të ishte e nevojshme) do të njoftohet Prokurori (që ndër të tjera ka të drejtën të njoftohet paraprakisht për fillimin e veprimtarisë) për emrin e oficerit përgjegjës për operacionin dhe pjesa e fundit e po këtij paragrafi, ku nuk parashikohet asnjë kompetencë interlokutori për prokurorin që mund të ketë marrë njoftim për fillimin apo për rezultatet e operacionit.

Parapëlqimi për një impostim përgjithësues – parandalues shfaqet më tej në pjesën e parë të paragrafit 5 të nenit 4 si më sipër, e cila i jep kompetencë nisme organit më të lartë të zyrës së Policisë që do të kryejë konkretisht veprimtarinë dhe plotësohet në pjesën e dytë të paragrafit 5 i cili parashikon detyrimin për t'i njoftuar menjëherë këtij të fundit përfundimin e veprimtarisë (dhe jo vetëm të rezultateve siç parashikuar për Prokurorin).

Kodifikohet pra me nenin 4 të ligjit 2001/438 një tjetër rast i agjentit provokator, figurë jo krejt pa debate, si në jurisprudencë ashtu dhe në doktrinë e, edhe një herë i lihet profesionalizmit të policisë gjyqësore të specializuar që vepron në luftën kundër terrorizmit, të veprojë me kushtet operative të parashikuara nga neni 4 i ligjit të konvertimit. Nëse një gjë e tillë nuk do ndodhte sepse shkaku justifikues i përgjithshëm për kryerjen e

detyrës mund të veprojë sipas kushteve të sipërthëna, pasojat mund edhe të jenë negative pasi mund të mbërrihet në inkriminimin me akuza shumë të rënda të oficerit të p.gj. që ka vepruar. Në fakt është e parashikueshme që jurisprudenca nuk do të ndryshojë orientimet e veta të mëparshme, edhe me ardhjen e kësaj normative.

Pasi trajtuam, ndonëse tërthorazi, problemet që lidhen me figurën e agjentit provokator, duhet të përmendim parashikimin ligjor që sjell ligji 438/2001 që u jep mundësi oficerëve të p.gj. të kryejnë veprime provokatore “me anë të një tjetër personi”, aty ku me këtë term mendohet të aludohet qartë ndaj mundësisë për të përdorur për këtë lloj veprimesh një person të jashtëm ndaj policisë gjyqësore. Lidhur me këtë folëm më sipër për vështirësitë në kuadrin e hetimeve në lidhje me terrorizmin dhe subversionin ndërkombëtar, në gjetjen dhe zbulimin e personave në gjendje të marrin përsipër një rol kaq delikat dhe të rrezikshëm.

§ 4.12. Shtyrja e ekzekutimit të masave të para-sigurisë dhe të sigurisë (neni 4 parag.3 i Ligjit 438/2001).

Jashtëzakonisht i rëndësishëm është edhe parashikimi siç në paragrafin 3 të nenit 4 të ligjit 438/2001 që shtrin edhe në çështjet që kanë për objekt krime të terrorizmit, mundësinë për të zbatuar nenin 10 të D.L. nr. 419, më dt. 31.12.1991, konvertuar me ndryshime në Ligjin nr. 172, më dt. 18.2.1992. Përmes kësaj norme (parashikuar më parë për çështjet në lidhje me krimet e pastrimit, zhvatjes dhe fajdes) Prokurori ka mundësi të shtyjë, me një vendim, ekzekutimin e urdhrave a masave të arrestit, ndalimit, sekuestrimit dhe zbatimit të një mase sigurie. Edhe në këtë rast, ka pasur një rishikim të rregullimit në kuadrin e ligjit mbi krimin e organizuar transnacional (**neni 9, parag.7 i ligjit n. 146, dt. 16.3.2006**).

Kur kjo do të bëhej e nevojshme për të marrë elementët e provës apo për zbulimin e personave përgjegjës për krime të terrorizmit, përmes nxjerrjes së një vendimi të arsyetuar, apo edhe me një urdhër të dhënë gojarisht, në rast urgjence (por që duhet të miratohet me shkrim brenda 48 orëve të ardhshme), Prokurori mund të vonojë ekzekutimin e këtyre masave apo urdhrave.

Së fundi, në rastin e një urgjence shumë të madhe, vetë policia gjyqësore mund të mos ekzekutojë aktet në kompetencë të vet (apo arrestimin në flagrancë ose sekuestrimin penal) duke njoftuar për këtë me shkrim brenda 48 orëve.

§ 4.13. Takimet hetimore për luftën kundër terrorizmit dhe lejet e qëndrimit për qëllime hetimi.

Siç u tha më në krye, ndërhyrja e dytë e ligjvënësit italian i takon ligjit n.155, dt. 31 korrik 2005 që, përveç se futi me nenin 270 *sexies* të k.p. një nocion të saktë të veprimeve me qëllim terrorist dhe dispozita të reja penale në lidhje me terrorizmin, plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me rregullimin e mjeteve të luftës kundër terrorizmit duke shtuar në legjislacionin penal instrumente të tjerë hetimore dhe parandalues.

Duhet të përmendim për këtë normën e futur me nenin 1 që, duke ndryshuar nenin 18 *bis* të ligjit nr.354, dt. 26 korrik 1975 (ligj mbi legjislacionin e sistemin e burgjeve) ka përcaktuar se gjejnë zbatim edhe për përgjegjësit, të paktën në nivel province, e zyra apo reparteve të Policisë së Shtetit apo të Armës së Karabinierëve kompetentë për zhvillimin e hetimeve në lidhje me terrorizmin, si dhe për oficerët e policisë gjyqësore të caktuar nga përgjegjësit e nivelit qendror dhe, vetëm për aspektet që lidhen me financimin e terrorizmit, personave të Policisë Financiare, të caktuar nga përgjegjësi i nivelit qendror, normat që në fushën e kriminalitetit të organizuar parashikonin mundësinë për të realizuar biseda apo takime hetimore, me qëllim që të përftoheshin nga të burgosurit apo nga të ndaluar informacione të dobishme për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve të kryera për qëllime të terrorizmit, edhe ndërkombëtar, apo përmbysjeje të rendit demokratik.

Është e qartë se ky instrument – ashtu siç ka ndodhur ndër të tjera në lidhje me kriminalitetin e organizuar të llojit mafioz – paraqitet shpesh (por jo gjithmonë) si propedeutik ndaj një veprimtarie të mundshme e të shpresueshme bashkëpunimi nga ana e personave të përfshirë në hetime në fushën e terrorizmit ndërkombëtar, por që sigurisht mund të jetë e frytshme në aspektin informativ edhe me qëllimin e vetëm për të sqaruar pozitat dhe veprimtaritë e personave në një fazë të parë të hetimeve.

Në fakt, autorizimi për një takim investigativ në fazën e hetimeve jepet nga prokurori i cili duhet të gjendet në kushte të tilla saqë mund të gjykojë nëse ekzistojnë apo jo kushtet për forma të mundshme bashkëpunimi. Përndryshe, në rastin e personave të dënuar apo të ndaluar, autorizimi jepet drejtpërsëdrejti nga Ministri i Drejtësisë ose nga një person i autorizuar prej tij.

Një tjetër mundësi për të proceduar me takime investigative parashikohet nga paragrafi 3 i nenit 18 *bis* të ligjit mbi sistemin e burgjeve dhe i takon Prokurorit Kombëtar Antimafie për qëllime të ushtrimit të

funksioneve të nismës dhe të bashkërendimit, parashikuar nga neni 371 vis i k.p.p.

Por kjo mundësi tjetër, duke pasur parasysh kuptimin e përnjimend të normës, duket si e pazbatueshme edhe për krimet në lidhje me terrorizmin, duke pasur parasysh se në legjislacionin tonë mungon një organ kombëtar homolog ndaj Drejtorisë Kombëtare të Antimafies.

Një tjetër instrument i futur nga ligji n.155 i datës 2005, është ai i parashikuar nga neni 2, që, në ndryshim nga normativa në fushën e emigracionit, lejon lëshimin e lejeve të qëndrimit për të huaj, kur gjatë operacioneve të policisë, hetimeve apo një çështjeje në lidhje me krime të kryera për qëllime të terrorizmit, edhe ndërkombëtar, apo të përmbysjes së rendit demokratik, është e nevojshme të garantohet qëndrimi në territorin e Shtetit i të huajit i cili u ka dhënë Autoritetit Gjyqësor apo organeve të policisë bashkëpunim që ka karakteristikat siç në paragrafin 3 të nenit 9 të D.L. n.8/1991 në lidhje me bashkëpunëtorët e drejtësisë. Në një rast të tillë, në të vërtetë Kuestori, në mënyrë të mëvetësishme apo pas një raportimi të personave përgjegjës të paktën në nivel province të Forcave të Policisë apo të Drejtorëve të Shërbimeve Informative dhe të Sigurisë, apo ku kërkohet nga Prokurori i Republikës, i lëshon një të huaji një leje të veçantë qëndrimi, me kohëzgjatje njëvjeçare e cila mund të shtyhet për të njëjtën periudhë kohore.

Por raportimi duhet të përfshijë të gjithë elementët nga të cilët duhet të rezultojë ekzistenca e kushteve të treguara në nenin 9, parag. 3 i D.L. 15.1.1992, si më lart përmendur (pra duhet të bëhet fjalë për deklarata që kanë karakter besueshmërie të mirëfilltë, që sjelle informacione të reja apo plotëson apo duhet të kenë rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e hetimeve apo për qëllime të gjykimit apo për veprimtaritë investigative, etj.) duke iu referuar veçanërisht rëndësisë së ndihmës së dhënë nga i huaji.

Leja e qëndrimit e dhënë sigurisht që mund të ripërtërihet më vonë për arsye të drejtësisë apo të sigurisë publike dhe po sigurisht mund të anulohet në rast veprimesh të papajtueshme me qëllimet e saj, siç raportuar nga Prokurori, nga organet e tjera të parashikuara në paragrafin 1 apo që sidoqoftë vërtetohen nga Kuestori, apo kur nuk ekzistojnë më kushtet që kanë justifikuar lëshimin e saj.

Së fundi, në paragrafin 5 të nenin 2 të ligjit 2005/155 parashikohet madje mundësia për t'i lëshuar madje të huajit, bashkëpunimi i të cilit ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme për parandalimin në territorin e Shtetit të atentateve terroriste kundër jetës apo integritetit të njerëzve apo për një

ulje konkrete të pasojave të dëmshme apo të rrezikshme të këtyre atentateve apo për të identifikuar përgjegjësit e akteve terroriste, kartën e qëndrimit që, siç dihet, presupozon një periudhë më afatgjatë qëndrimi në Shtet dhe u jepet zakonisht shtetasve të Shteteve të tjera evropiane.

§ 5. Kanalet e financimit të terrorizimit ndërkombëtar.

Ndër veprimet e ndjekshme penalisht në lidhje me terrorizimin, ligji 438/2001 ka parashikuar edhe atë të financimit të organizatave terroriste ose subversive. Bëhet fjalë natyrisht për një parashikim tejet të rëndësishëm i cili mban parasysh nevojën për të luftuar terrorizmin edhe përmes zbulimit të personave që sigurojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo para dhe fonde për grupe dhe celula terroriste.

Duhet thënë menjëherë se në përvojën praktike në zbatim të këtij parashikimi nuk ka raste të mirëfillta financimi në kuptimin teknik dhe të vazhduar të terrorizmit, në kuptimin që nuk rezulton të hasen në Itali forma të përdorimit të instrumenteve bankarë veçanërisht të sofistikuar.

Në të vërtetë, duket e udhës të theksojmë se në praktikën hetimore janë shfaqur për më shumë forma të financimit të tërthortë të grupeve terroriste, kundrejt të cilave prova juridike e plotë e përcjelljes (apo madje të dorëzimit) nga një qendër e caktuar interesat financiarë për persona që i përkasin një organizate terroriste kërkon një përpjekje investigative mjaft të lartë.

Gjithashtu, duhet vënë në dukje se në dallim nga sektori i kriminalitetit të llojit mafioz, ku shpesh gjendemi përballë në veprimtari të pastrimit të parave të ardhura nga veprimtari e paligjshme, në rastin e grupeve terroriste jemi shpesh para një veprimtari të riinvestimit të parave që vijnë nga veprimtari të ligjshme (të ardhura nga veprimtari tregtare, mbledhje fondesh në xhami, etj.) për qëllime të paligjshme (jo gjithmonë me dijeninë e plotë të financuesve) për të mbështetur *jihad-in* islamik dhe për të garantuar kështu mbështetjen e celulave terroriste që veprojnë në Evropë dhe në vendet e tjera extraevropiane.

Gjatë hetimeve janë vërejtur transferime për shuma të vogla parash përmes kanaleve alternativë kundrejt atyre bankarë, si për shembull kanali i njohur u përdorur nga extrakomunitarët në Itali i Western Union apo përmes një sistemi shumë më të artizanal, por shumë më të sigurt nga pikëpamja kriminale, që është ai i transferimit të shumave të parave përmes rrjetit ndërkombëtar të tregtarëve të vegjël arabë, të cilëve u kërkohet të transferojnë në të holla shuma, për shembull nga Italia në Francë apo në

Britaninë e Madhe, ku këto shuma do të merren nga persona që qëndrojnë afër apo janë anëtarë të celulave apo grupeve terroriste.

Në hetimet e zhvilluara në territorin napoletan dhe jo vetëm, ky sistem i fundit rezulton të jetë përdorur shumë nga persona me prejardhje islamike, të cilët kanë realizuar në këtë mënyrë një sistem transferimi dhe qarkullimi të parasë nga një vend në një tjetër duke pasur mbulim maksimal dhe pa shumë risqe.

Një tjetër sistem, edhe ai po aq primitiv, i financimit të terrorizmit islamik, siç rezultuar gjatë hetimeve italiane është ai i mbledhjes së fondeve mes anëtarëve të komuniteteve myslimane, gjë e cila mund të ndodhë në mënyrë pak a shumë të fshehtë.

Bëhet fjalë për të ashtuajturin *zakat*, pra për mbledhjen e fondeve në xhami, që zyrtarisht janë të destinuara të përdoren për të ndihmuar vëllezërit më të varfër dhe të sigurojnë shpenzimet për mbajtjen e komuniteteve myslimane fetare.

Natyrisht që bëhet fjalë për një mbledhje absolutisht të ligjshme e cila mbështetet në parime fetare, megjithatë, janë vërtetuar raste në të cilat një pjesë e fondeve të mbledhura nga komunitetet fetare nuk përdoren më pas për qëllimet fillestare, por përkundrazi, për të mbështetur “disa vëllezër luftëtarë apo familje të vëllezërve luftëtarë” në Algjeri, Marok apo edhe në Palestinë. E siç u tha më sipër, kjo gjë nuk ndodh patjetër me dijeninë e plotë nga ana e besimtarëve myslimanë.

Një tjetër sektor të cilit po i kushtohet vëmendje më e madhe, sidomos në vitet e fundit, është ai i kontrollit, për sa është e mundur, të gjithë rrjetit të veprimtarive tregtare apo të shërbimeve të administruara nga persona myslimanë, kundrejt të cilëve ekziston dyshimi se bëhet fjalë për veprimtari maskuese apo sidoqoftë për shoqëri që veprojnë me fonde që vijnë nga persona që qëndrojnë pranë organizatave terroriste që sigurojnë me veprimtaritë e tyre, në dukje të ligjshme, mbështetjen ekonomike ndaj celulave terroriste.

Së fundi, po në kuadrin e hetimeve të zhvilluara nga Seksioni i Antiterrorizmit të Prokurorisë së Napolit, ka rezultuar një fenomen mjaft shqetësues, i cili ndër të tjera u zbulua gjatë hetimeve të Autoriteteve spanjolle pas masakrës së Madridit në vitin 2004, pra lidhja mes personave myslimanë të futur në organizatat kriminale transnacionale që merren me trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe personave myslimanë anëtarë të grupeve terroriste. Në fakt, rezultojnë të provuara kontaktet e disa personave të përfshirë dhe të arrestuar nga hetimet mbi masakrën e Madridit

dhe persona që janë anëtarë të organizatave kamorriste të rajonit të Kampanias (Itali), në kuadrin e një trafiku të lëndëve narkotike mes Spanjës, Hollandës dhe Italisë, në rastet kur trafikantët e drogës myslimanë (më saktë marokenë) përdornin të ardhurat e drogës për të financuar blerjen nga ana e terroristëve të armëve, lëndëve shpërthyes dhe dokumenteve të rreme.

§ 6. Përfundime.

Përvoja gjyqësore e këtyre viteve të fundit tregon se zgjedhja e ligjvënësist italian, me fjalë tjera zgjedhja për të përdorur edhe në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar instrumentet e të drejtës penale (ndonëse si për luftën kundër mafies, duke përdorur instrumente të veçantë dhe të ashtuquajturin sistem të binarit të dyfishtë) është me siguri përvoja që pajtohet më mirë me një Shtet të të Drejtës dhe që parapëlqehet ndaj përdorimit të instrumenteve dhe strukturave me natyrë ushtarake.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë që nuk ekzistojnë më boshllëqe ligjore dhe çështje edhe me natyrë praktike që duhet të zgjidhen menjëherë, me qëllim që të përmirësohet dhe bëhet gjithnjë e më efikase lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Le të mendojmë për shembull nevojën për të siguruar një strukturë koordinuese në nivel kombëtar dhe nevojën për të përgatitur një bankë të dhënash kombëtare në lidhje me terrorizmin.

Duhet theksuar edhe një herë se del të jetë absolutisht e domosdoshme të përmirësojmë dhe perfeksionojmë instrumentin e bashkëpunimit ndërkombëtar si në nivelin e policisë gjyqësore, duke u nisur nga kushti që, në këtë sektor, ashtu si një gjithë sektorët në lidhje me të ashtuquajturit krime transnacionalë, nuk mund të mos mbajmë parasysh lidhjen me policinë dhe autoritetet gjyqësore të vendeve të ndryshme të përfshira, dhe lipset të sigurojmë – që në fazën e parë të hetimeve paraprake – një shkëmbim të shpejtë, të përshtatshëm e konkret të informacioneve dhe akteve, duke kapërcyer mosbesimet dhe vonesat burokratike që sigurisht nuk e lehtësojnë luftën kundër terrorizmin ndërkombëtar.

MICHELE DEL PRETE

Prokuror

Prokuroria pranë Gjykatës së Napolit

Tiranë, Mars 2007

P J E S A E D Y T Ë

LUFTA KUNDËR KRIMIT EKONOMIKO-FINANCIAR NË KUADRIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

2.1. *Lufta financiare kundër pastrimit të parave ndërkombëtar. Roli i Zyrës së Informacionit Financiar.*

§ 1. *Hyrje.*

Cila është marrëdhënia që ekziston mes mbrojtjes së kapitaleve të paligjshme dhe luftës ndërkombëtare kundër pastrimit të parave? Cili është roli që mund të marrë Zyra e Informacionit Financiar (ZIF)? Për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve lipset të mbajmë parasysh dy aspekte paraprake themelore. Në radhë të parë, kapitalet e paligjshme mund të përdoren në masën në të cilën pastrohen. Siç dihet, grumbullimi i kapitalit përfaqëson njëherësh qëllimin dhe mjetin e kriminalitetit të organizuar. Por lipset **që ky kapital të jetë i “shpenzueshëm” në treg**. Dhe që ky kapital të jetë realisht “i shpenzueshëm”, është e nevojshme që në njëfarë kuptimi ai “**të certifikohet**”, apo të njihet nga të gjithë si mjet i zakonshëm pagese për blerjen e të mirave dhe shërbimeve, pa ngjallur dyshime mbi prejardhjen e tij. Pastrimi i parave është tërësia e veprimeve financiare përmes të cilave kapitalet e krijuara në rrugë të paligjshme “vishen” me ligjshmëri.

Pastrimi i parave bëhet kryesisht nëpërmjet një procesi pastrimi përmes disa fazave që ndjekin njëra-tjetrën. Në fazën e parë (*placement*) kush pastron paratë përpiqet të thyejë tërësinë e rregullave për të futur në zonat “e shëndetshme” (ndërmjetës të mbikëqyrur) paratë e pista. Kjo është faza më delikate, sepse ky “i ftuar i huaj”, sapo vendoset në botën e mbrojtur, rrezikon të njihet nga sensorët që gjenden tek ndërmjetësit; në fakt, ata janë të përgatitur të pikasin mospërputhjen në përmasa dhe në modalitete të parave me profilin “e pritshëm” pasuror që duhet të ketë klienti. Kush pastron paratë duhet të fshehtë origjinën e të ardhurave të paligjshme përmes mekanizmave kërcënues, të korrupsionit apo i falsifikimit. Në fazën e dytë (*layering*) kush pastron paratë ndërmerr një proces fshehjeje dhe largimi nga origjina, duke iu përshtatur rregullave të zakonshme financiare, por që nuk është i natyrshëm. Edhe kjo është një fazë delikate sepse parregullsia që bie në sy është mospërputhja me logjikën financiare të veprimeve që kryen ai që

pastron paratë, që nuk kërkon fitim por fshehje. Së fundi, në fazën e tretë (*integration*), synohet të realizohet bashkëjetesa “paqësore” e kapitaleve tashmë “të certifikuar”, pra “të shpenzueshme” me investimet e rregullta. Në këtë fazë mospërputhja është e vështirë të kuptohet. Mund të ekzistojë kundrejt realiteteve territoriale që pritet të jenë ndryshe dhe të rezultojë nga analiza shumë të thella financiare.

Një kapital i paligjshëm ka pra nevojë të pastrohet. Kjo gjë shpjegon përse nga ana tjetër mbrojtja e kapitaleve të paligjshme është e mundur vetëm në masën në të cilën ekziston një luftë efikase kundër pastrimit të parave. Për ta thënë më thjesht, mund të themi se lufta kundër pastrimit të parave ka për qëllim të pengojë “certifikimin” e kapitaleve të paligjshme, apo ta bëjë më të kushtueshëm. Sa më e vogël është “shpenzueshmëria” e kapitaleve të paligjshme aq më e madhe është kostoja e “pastrimit” të tyre. Dhe sa më e vogël është “shpenzueshmëria” e tyre, aq më i madh është çmimi që kriminelët duhet të paguajnë për t’i pastruar ato. Por në çfarë qëndron çmimi i paguar nga kriminelët për “të certifikuar” kapitalet e grumbulluara në rrugë të paligjshme? Ky çmim mund të shprehet në monedhë apo në risk. Në fakt, nëse pastrimi i parave bëhet më i vështirë, nga njëra anë ai që pastron paratë do të kërkojë një shpërblim më të madh, nga ana tjetër, kriminelin do të jetë më i rrezikuar të zbulohet apo mashtrohet. Objektivi kryesor i një **Zyre të Informacionit Financiar** është pra ta bëjë pastrimin e parave sa më të kushtueshëm duke ulur krijimin e kapitaleve të paligjshme dhe duke rritur mundësinë e zbulimit të krimeve, si dhe atë të **uljes në minimum pastrimin e parave të kryer përmes bankave dhe ndërmjetësve të mbikëqyrur**, duke i shtyrë të gjithë ata që pastrojnë paratë gjithnjë e më shumë drejt sistemit financiar.

Ky rol ushtrohet përmes një veprimtarie **zbulimi (intelligence)** financiar. Mund të kuptohet lehtë se si lufta kundër pastrimit të parave nuk mund të luftohet duke monitoruar një për një të gjitha veprimet financiare. Lipset, siç thamë, të gjejmë një sistem **alarming**, që vihet në lëvizje nga subjektet që kryejnë konkretisht ato veprime, apo bankat dhe ndërmjetësit financiarë. Këtyre subjekteve u kërkohet në fakt të bashkëpunojnë me autoritetet, duke vlerësuar veprimet individuale dhe financiare të klientelës, dhe duke shpallur alarmin sa herë që **veprimet** e kërkuara ngjallin dyshim, sepse janë **“anormale”**, apo jo të zakonit kundrejt veprimtarisë që pritet të ketë një klient në një zonë të caktuar territoriale, apo **jo ekonomike**. Në lidhje me fazat teorike të pastrimit, instrumentet që na bëjnë të mundur përcaktimin e profileve të mospërputhjes në fazat e ndryshme të pastrimit të parave, janë: në fazën e parë (*placement*) vetëm raportimi i veprimet të dyshimtë, sepse ndërmjetësi është në gjendje të kuptojë mospërputhjen mes profilit

ekonomik të subjektit dhe veprimi; në fazën e dytë (*layering*) kontributi që jep ndërmjetësi në zbulimin e parregullsive që dalin nga të dhënat e kërkuara jo me emra (*analizë financiare*). Në fazën e tretë (*integration*), zbulimi i mospërputhjes është shumë i vështirë sepse procesi ka mbaruar në thelb. Në teori vetëm një rindërtim i thelluar i realitetit territorial mund të na bëjë të mundur gjetjen e parregullsive të mundshme. Siç do të themi më tej, duke rritur të drejtat për të vepruar kryesisht të ZIF, mund të merren rezultate më të mira si në ndihmë të leximit të veprimeve të raportuara nga vetë sistemi, ashtu dhe për të nxitur raportime *ad hoc* apo të posaçme.

Në vija të trasha, mekanizmi i *alarming* i parashikuar nga sistemi kundër pastrimit të parave mbështetet në kriteret që nuk janë shumë të ndryshëm nga ata që qëndrojnë në themel të formave të “konfiskimit të thjeshtuar”, siç në nenin 12-*sexies* të Dekret Ligjit nr.306, të vitit 1992, i kthyer në Ligjin nr.356 të vitit 1992. Në të dyja rastet, ajo që fiton rëndësi është mosekzistenca e burimeve pasurore. Në rastet kur ligjshmëria e prejardhjes së këtyre burimeve nuk do të provohej në mënyrë të përshtatshme, nga njëra anë bankat dhe ndërmjetësit e tjerë do të kujdesen të raportojnë veprimet që lidhen me to nga njëra anë, dhe nga tjetra, autoritetet gjyqësore, pasi të kenë vërtetuar ekzistencën e këtyre kriterëve të parashikuar nga ligji, vijojnë me marrjen e masave të nevojshme të sekuestrimit dhe konfiskimit.

§ 2. *Roli i ZIF.*

Sipas sa parashikuar nga e drejta e Bashkimit Evropian, në veçanti nga Vendimi GAI i vitit 2000 mbi mënyrat e bashkëpunimit mes ZIF-ve dhe të ashtuquajturës Direktivë III kundër pastrimit të parave të vitit 2005, ZIF përfaqëson një “njësi qendrore kombëtare që, me qëllim që të luftojë pastrimin e parave ka për detyrë të marrë, analizojë dhe përhapë informacione financiare lidhur me të ardhura të dyshimta nga pastrimi i parave”. Në Itali, ZIF është krijuar në vitin 1997, duke i caktuar në një formë të përqendruar dhe vetëm Zyrës Italiane të këmbimeve detyrën për të marr dhe thelluar raportimet e operacioneve të dyshimta (ROD), dhe është njohur zyrtarisht në vitin 2000, përmes kualifikimit të ZIK si ZIF, dhe duke i dhënë kësaj të fundit të tjera kompetenca. Siç do të shohim më në hollësi në vijim, me qëllim që të kryejë funksionet e veta, ZIF merr dhe përpunon ROD, i përcjell këto të fundit pranë autoriteteve hetimore, shkëmben informacione me autoritetet e mbikëqyrjes dhe me ZIF të huaja, harton udhëzime lidhur me zbulimin e operacioneve të dyshimta, ushtron një funksion këshillimi kundrejt Parlamentit dhe Qeverisë, merr të dhëna financiare në formë të grupuar nga ana e bankave dhe ndërmjetësve

financiarë, bashkëpunon me Autoritetet gjyqësore. Me një konfigurim të tillë ZIF ka fituar një rol të rëndësishëm në nivel kombëtar, në gjetjen dhe rikuperimin e të ardhurave nga krimi; dhe nga ana tjetër ajo është një terminal për zbulimin, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave pasurore.

Në aspektin operativ, ZIF mund të ketë një sërë kanalesh informacionesh shumë të gjera. Në radhë të parë, ajo **merr dhe thëllon raportimet mbi operacionet e dyshimta (ROD)**. Siç dihet, ROD kanë për objekt operacione që për nga karakteristikat, përmasat dhe natyrën që na bëjnë të mendojmë se të mirat dhe dobitë që përbëjnë objekt vijnë nga një krim me dashje. U nënshtrohen këtyre raportimeve përveç bankave dhe ndërmjetësve financiarë edhe një kategori e gjerë profesionistësh (si noterë, avokatë, llogaritarë, komercialistë, konsulentë pune) dhe operatorë financiarë (si kazinò, tregtarë ari, shoqëri të transportimit të vlerave, agjentë në veprimtari financiare). **ROD përbëhen nga një pjesë me të dhëna dhe nga një pjesë përshkruese**. Në pjesën e quajtur përshkruese, gjenden zakonisht disa të dhëna pasurore shumë të rëndësishme, si i) marrëdhëniet që subjektet e raportuar kanë tek raportuesit (si llogari rrjedhëse, dosje titujsh, librezat depozitash), ii) transaksionet e kryera në këto marrëdhënie, nga të cilat është e mundur të gjenden marrëdhëniet e tjera pranë raportuesve të tjerë (siç ndodh në rastin e kreditimit të një urdhër-pagese lëshuar mbi një llogari rrjedhëse të regjistruar në emër të subjektit të raportuar pranë një tjetër raportuesi), iii) të mirat apo veprimtaritë e sipërmarrjes, drejtpërsëdrejti ose jo të lidhura me subjektet e raportuar, iv) subjekte të tjerë “të lidhur” me të raportuarin, pasi janë të lidhur me të përmes marrëdhëniesh me karakter familjar, personal ose profesional.

Në radhë të dytë, ROD përbëjnë objekt **thëllimi** nga ana e ZIF. Për këtë qëllim, kjo e fundit ka të drejtë të i) **marrë, pranë raportuesit** që ka hartuar konkretisht ROD, apo pranë të gjithë raportuesve, **çdo informacion të dobishëm** për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, përfshirë ato të regjistruara në arkivat apo në regjistrat unikë, si a) subjekte palë në operacionet e kryera në marrëdhënie që ka i raportuari (si përfitues të urdhër-pagesave apo të çeqeve të lëshuar, apo urdhëruesit e urdhër-pagesave të marra apo të çeqeve të derdhura), b) marrëdhëniet e ndryshme që kanë subjektet “e lidhur”, c) veprimtaritë profesionale apo sipërmarrëse të deklaruara dhe dokumentuara me qëllim që të merren financime; ii) **kërkojë informacione**, përfshirë të dhënat pasurore, **pranë ZIF-ve të huaja**, duke u mbështetur për këtë në *memorandume mirëkuptimi* dypalëshe apo në platforma shkëmbimi shumëpalëshe (si rrjeti *Egmont*, që lidh ZIF e 101 Shteteve, apo rrjeti *Fiunet*, që aktualisht kufizohet me vendet anëtare të BE); iii) **ketë akses** ndaj informacioneve të mbajtura pranë **Centralit të Risqeve** të Bankës së

Italisë (në lidhje me ekspozimin e subjekteve privatë ndaj bankave), **Zyra e Regjistrimit të Tatimpaguesve** (me të cilën është duke u arritur një marrëveshje e posaçme me ZIK), Arkivin e marrëdhënieve me ndërmjetësit (mbi të cilën do të ndalemi në vijim), iv) **paraqesë kërkesa pranë administratës publike**, të ndryshme, që kanë të bëjnë me mbledhjen apo me mbajtjen e mbledhjes dhe administrimit të informacioneve të rëndësishme; v) **shkëmbejë informacione**, pavarësisht nga ruajtja e sekretit, me autoritetet e mbikëqyrjes mbi financën private (Banka e Italisë, Consob, Isvap, Covip).

Në radhë të tretë, të dhëna të tjera mund të nxirren nga arkivat në dispozicion të ZIK për ushtrimin e funksioneve të veta. Për këtë arsye ZIF mund të mbështetet në i) **të dhënat që përmban arkivi i ROD**, mbi të cilat është e mundur të zhvillohet një veprimtari e mirëfilltë *intelligence*, si a) identifikimi i ROD të mëparshme në ngarkim të të raportuarve apo të subjekteve “të lidhur”, b) zbulimi i lidhjeve të mundshme mes ROD, në lidhje me zonën territoriale apo sektorin e sipërmarrjes në fjalë (siç ka ndodhur, për shembull, në lidhje me marrjen e paligjshme të financimeve kombëtare dhe të Bashkimit Evropian); ii) **të dhënave të mbledhura në arkivin e të dhënave të grumbulluara**, që përcillen çdo muaj dhe të grupuara dhe jo me emra nga bankat dhe ndërmjetësit financiarë, në bazë të të cilave mund të pikasen aspekte parregullsie me natyrë financiare, që shërbejnë për të plotësuar informacionet që rezultojnë nga raportimet e operacioneve të dyshuara, apo për të ndërmarrë analiza më të thelluara lidhur me mosraportime të operacioneve të dyshimta; iii) **të regjistrimeve të kryera në regjistrin e ndërmjetësve financiarë**, me të cilat mund të njihemi nëse i raportuari është mbajtes aksionesh apo detyrash në shumë subjekte që veprojnë në tregun financiar, si ndërmjetës financiarë, që veprojnë dhe jo ndaj publikut, bashkëfinancues, ndërmjetës në kredidhënie, agjentë në veprimtari financiare (ndër të cilët kryesojnë nën-agjentët e shërbimit *money transfer*); iv) të informacioneve të disponueshme pranë **arkivit të deklaratave të transportit ndërkufitar** që shoqërojnë para dhe tituj importi më të madh se 12.500 €, apo pranë sistemit informativ të gjykatës, nga të cilat mund të merren të dhëna mbi burimet financiare likuide në dispozicion të subjekteve të raportuar.

Të dhënat pasurore të mbledhura dhe të përpunuara nga ZIF përdoren më pas sipas katër modaliteteve kryesore. Para së gjithash, ato **përcillen** në formën e një relacioni teknik që u bashkëngjitet ROD të veçanta, Drejtorisë së Investigimit Antimafia (**DIA**) dhe Skuadrës Speciale të Policisë Valutore të Rojës së Financës (**NSPV**), që i plotësojnë me informacionet, përfshirë të dhënat pasurore që kanë në dispozicion dhe i përdorin për ushtrimin e

funksioneve të veta. Gjithashtu, këto të dhëna mund të përcillen, pas një vendimi të arsyetuar, edhe pranë **Autoritetit Gjyqësor** (AGJ) në kuadrin e procedimeve penale që ndërmerren në ngarkim të të raportuarve apo të subjekteve “të lidhur” me ta, kundrejt të cilëve ZIF mund t’i kërkohej të bashkëpunojë me funksionarët e vet si konsulent për aspektet financiare. Përsëri, të dhënat pasurore përfaqësojnë bazën për të proceduar me **pezullimin e operacioneve të dyshuara**, për të cilat ZIF mund të procedojë edhe me kërkesë të DIA dhe të NSPV, maksimumi brenda 48 orëve, gjithnjë nëse kjo nuk do të përbënte rrezik për vazhdimin e hetimeve dhe për operativitetin e rrjedhshëm të ndërmjetësve duke njoftuar menjëherë organet hetimore. Së fundi, në bazë të të dhënave pasurore të mbledhura në ushtrim të funksioneve të veta, ZIF mund të **lidhet me ZIF e huaja**, me qëllim që të arrijë apo favorizojë ndërprerjen e operacioneve apo sekuestrimin e të mirave dhe dobive që lidhen me të raportuarin në Shtetin e huaj. Mbi rezultatet e arritura në ushtrimin e këtyre kompetencave dp të flasim më tej.

§ 3. Disa raste të ekzaminuara.

Në rastin e **Capital Leben**, ZIF ka siguruar sekuestrimin jashtë vendit të një shume më të madhe se 20.000.000 USD, të vjedhur në rrugë të paligjshme gjatë ngjarjes **Parmalat**. Në veçanti, i) në kryerjen e hetimeve të ndërmarra kryesisht mbi të dhënat që ka arkivi i të dhënave të grumbulluara, ZIF vërejti një parregullsi financiare që ndodhi në provincën e Parmës, e që konsistoi në vendosjen e një urdhër-pagese prej 20.000.000 USD drejt Litenshtejnit; ii) pasi ZIF komunikoi me bankën që kish kryer operacionin ajo dërgoi një ROD, nga ku rezultoi se urdhër-pagesa ish urdhëruar mbi një llogari rrjedhëse në emër të një shoqërie Parmalat të Maltës, në favor të një shoqërie sigurimi të **Litenshtejnit**, me para që vinin nga kreditimi i një urdhër-pagese të mëparshëm të urdhëruar nga një shoqëri Parmalat e Vendeve të Ulëta; iii) duke u mbështetur në këto informacione, ZIF u lidh me ZIF e Litenshtejnit, që njoftoi se shuma e urdhër-pagesës ishte përdorur, me urdhër të një shoqërie investimesh të Ishujve britanikë, për blerjen e një police sigurimi për jetesën në favor të një avokati banues në Brazil; iv) me kërkesë të ZIF italiane, ZIF e Litenshtejnit kreu “**ngrirjen**” e policës së sigurimit për jetën, që më pas u shoqërua me sekuestrimin gjyqësor të vendosur me kërkesë të një letërporosie të Prokurorisë së Parmës.

Në rastin **Casamonica**, ZIF ndihmoi në **sekuestrimin** në Itali të parave dhe të mirave që i përkisnin një familjeje kriminale për një shumë më të madhe se **100.000.000 €**. Në veçanti, i) në analizën e thelluar të një ROD të përcjellë nga Banka 1, sipas të cilës llogaria rrjedhëse e një **shtëpiakeje**

kishte operacione kreditimi dhe debitimi të hollash dhe çeqesh për shuma në shpërpjestim në krahasim me veprimtarinë e deklaruar, ZIF mësoi faktin se këto operacione ishin kryer për llogari të personave të tretë, sidomos të ndërmarrjeve të mesme që vepronë në tregtinë e automjeteve të luksit; ii) në bazë të ROD të marrë, DIA informoi ZIF se shtëpiakja i përkiste një familjeje të njohur kriminale, e cila ish nën hetim për krime të ndryshme, ndër të cilat edhe për fajde; iii) gjatë kërkimeve të tjera, ZIF mësoi se në Bankën 1 ishin çelur edhe tri llogari rrjedhëse në emër të tre familjarëve të shtëpiakes, në të cilat ishin kredituar një sërë urdhër-pagesash që ishin urdhëruar nga një llogari rrjedhëse e shtëpiakes pranë një Banke 2 me seli në **Montekarlo**; iv) pasi ZIF italiane kontaktoi **ZIF të Montekarlos** kjo e fundit njoftoi se nga llogaria rrjedhëse e shtëpiakes në Bankën 2 ishin urdhëruar urdhër-pagesa të tjera në favor të familjarëve të tjerë të shtëpiakes pranë Bankave 3, 4, 5 dhe 6; v) pasi u pyetën lidhur me këtë pikë Bankat 3, 4, 5 e 6 ato thanë se shumatat e kredituara ishin tërhequr ndërkohë *cash* dhe ndoshta ishin përdorur për blerjen e të mirave me vlerë; vi) në bazë të informacioneve të dhëna nga ZIF, Prokuroria e Romës procedoi me **arrestimin e 12 personave** dhe me sekuestrimin e të mirave dhe dobive që u takonin atyre për më shumë se 100.000.000 €.

Në rastin **Ultimo Imperatore (Perandori i Fundit)**, ZIF ndihmoi Autoritetin Gjyqësor në zbulimin dhe ndëshkimin e një numri të madh lëvizjesh financiare të kryera nga komuniteti i kinezëve në bashkëpunim me shtetas italianë me qëllim pastrimit e të ardhurave nga krimi i falsifikimit. Në veçanti, i) në analizën e thelluar të disa **ROD**. ZIF mësoi se subjekti i raportuar, me shtetësi italiane, ish autorizuar të vepronte në një numër të madh llogarish rrjedhëse, në emër të një **shoqërie dorëzanie**, për të cilën ishte administrator; ii) me qëllim që të verifikohet operativiteti i shoqërisë së dorëzansisë, ZIF u njoh me të **dhënat e grupuara** të dërguara prej saj në bazë të normativës për luftën kundër pastrimit të parave, nga ku rezultuan më shumë se **800 operacione** kreditimi dhe debitimi, për shuma të përgjithshme të barabarta me rreth **20.000.000 €** në kolonën dhënie e marrje, që konsistojnë kryesisht në derdhje *cash* dhe në urdhrin për disa **urdhër-pagesa në favor të personave që përsëriten shpesh e që janë banues në Kinë**; iii) ROD dhe relacionet teknike përkatëse u përcollën më pas, pas një kërkesë të posaçme, pranë **Prokurorisë së Romës**, që kish nisur një hetim penal të pavarur lidhur me faktin në fjalë; iv) hetimet penale shpunë në vërtetimin e një mekanizmi kompleks të pastrimit të parave, sipas të cilit falsifikuesit kinezë i dorëzonin paratë me origjinë të paligjshme në duart e të raportuarit italian, i cili i depozitonte në një prej llogarive rrjedhëse në emër të shoqërisë së dorëzansisë pranë bankës raportuese, dhe më pas, në

bashkëpunim me punonjësit e bankës, kryente me to urdhër-pagesat drejt Kinës. V) në përfundim të hetimeve **u arrestuan 5 italianë dhe 4 kinezë.**

Në rastin **Nazionale Fiduciaria**, ZIF ndihmoi prokurorinë duke hedhur dritë mbi një numër të caktuar veprimesh të paligjshme për shuma jashtëzakonisht të rëndësishme, gjatë vitit 2003, nga përfaqësuesit më të lartë të **Unipol**. Në veçanti, i) nga analiza e **të dhënave të grupuara** të përcjella nga Nazionale Fiduciaria Spa, ZIF mësoi për ekzistencën e dosave operacioneve kreditimi dhe debitimi përmes urdhër-pagesave për shuma shumë të mëdha; ii) pasi iu kërkua Nazionale Fiduciaria-s të jepte informacione lidhur me këtë, ajo bëri me dije se operacionet ishin kryer në dy llogari rrjedhëse, në emër të dy përfaqësuesve, dhe konsistonin për secilin prej tyre **në marrjen e një urdhër-pagese prej rreth 25.000.000 €**, në **blerjen dhe në shitjen e letrave me vlerë të Antonveneto, në urdhërimin e një urdhër-pagese për rreth 28.000.000 €** në favor të llogarive rrjedhëse të po këtyre personave pranë Bankës Popullore të Lodit; iii) pasi u lidh me Bankën Popullore të Lodit, ZIF ish në gjendje të kuptonte përdorimin e mëtejshëm të shumës së krijuar nga operacionet e mësipërme; iv) për operacionet e mësipërme janë duke u kryer verifikime investiguese nga ana e Prokurorisë së Milanos.

Në rastin **Islamic Charity**, ZIF dha ndihmën e saj në kryerjen e një hetimi penal në lidhje me terrorizmin ndërkombëtar. Në veçanti, i) në janar të vitit 2002, ZIF mori një ROD lidhur me një lëvizje jo të zakonit të kryer mbi llogarinë rrjedhëse në emër të një **shoqate islamike bamirësie**, e administruar nga një shtetas **jordanez**, një **kuvaitian** dhe një **izraelit**; ii) nga kërkimet e bëra nga ZIF doli se llogaria rrjedhëse në emër të shoqatës kish marrë një numër të madh urdhër-pagesash, për një shumë mes 5.000 € dhe 10.000 €, për të cilat ishin urdhëruar urdhër-pagesa për një shumë më të madhe në favor të **shoqatave islamike të bamirësisë**, kombëtare dhe të huaja; iii) ROD dhe analizat e bëra lidhur me to iu përcollën më pas Autoritetit Gjyqësor, që kish nisur nga ana e vet një hetim penal mbi këtë fakt; iv) ndërkohë, ZIF mori një kërkesë nga ana e **ZIF izraelite**, lidhur me çdo informacion të dobishëm mbi administratorët e shoqatës islamike të raportuar; v) meqenëse ekzistonte **një hetim penal**, ZIF krijoi lidhje mes Prokurorisë kombëtare dhe ZIF izraelite, që u pasua me një shkëmbim **letërporosish** mes Autoriteteve Gjyqësore dhe izraelite mbi këtë fakt.

§ 4. Rezultatet e arritura.

Duke përdorur instrumentet e mësipërm ZIF arriti në kohë këto rezultate operative. Duke filluar nga data 1997, ZIF mori më shumë se 57.000 ROD, 90% e të cilave u përcollën nga banka. Në nivel territorial, më shumë se 40% e ROD vijnë nga qarqet veri-perëndimore, rreth 17% nga ato verilindore, më shumë se 20% nga ato qendrore, pjesa tjetër, 22%, nga ato jugore dhe ishujt. Më shumë se 55.000 e ROD të marra u analizuan më tej dhe iu përcollën DIA-s dhe NSPV, ndërsa rreth 1.940 u arkivuan. Në bazë të sa u gjet në informacionet e dhëna nga organet investigative duke filluar nga vitit 2001, rreth 9.300 ROD u arkivuan, ndërsa rreth 1.400 iu përcollën Autoritetit Gjyqësor. Në 70 raste ZIF procedoi me pezullimin e operacioneve të dyshuara, që u shoqëruan më pas me urdhra sekuestrimi për një shumë të përgjithshme më të madhe se 100.000.000 €. ZIF mori më shumë se 2.000 kërkesa për informacion nga ana e ZIF të huaja, lidhur me më shumë se 5.500 subjekte; nga ana tjetër, ajo ka nisur 234 kërkesa për informacion pranë ZIF të huaja, lidhur me 565 subjekte. Nga viti 2004, ZIF u ka kërkuar gjithashtu ZIF-ve të tjera të kryejnë bllokime dhe pezullime mbi të mira dhe utilitete që gjenden jashtë Italisë, për të cilat kanë dalë më pas urdhrat e sekuestrimit për shumat 270.000.000 € dhe 28.000 \$. Së fundi, Autoriteti Gjyqësor u ka ngarkuar 50 detyra konsulence përfaqësuesve të ZIF.

§ 5. Ndërrhyrje në zhvillim e sipër dhe çështje aktuale.

Një ndihmë të madhe për veprimtarinë analizuese të kryer nga ZIF do të mundësohet nga **Arkivi i marrëdhënieve me operatorët financiarë**, i cili është krijuar së fundi nga Dekret Ligji nr.223 i vitit 2006⁸⁵, i kthyer në Ligjin nr.248 i vitit 2006 dhe i rregulluar nga Akti i dt.19 janar 2007 i Agjencisë së të Ardhurave⁸⁶ (Zyra e Tatim Taksave), si dhe nga Rregullorja e Agjencisë së të Ardhurave nr.18, dt.4 prill 2007. Njoftimet në Arkiv duhet i) **të kryhen nga** bankat, Postat Italiane Spa, ndërmjetës financiarë, dhe operatorë të tjerë financiarë, ii) në lidhje me një **numër të madh marrëdhëniesh** (si llogari rrjedhëse, llogari depozitë, administrime kolektive), iii) duke treguar **të dhënat identifikuese** të mbajtësit të

⁸⁵ (Dispozita urgjente për rilançimin ekonomik dhe shoqëror, për menaxhimin dhe racionalizimin e shpenzimit publik, si dhe ndërrhyrje në fushën e të ardhurave dhe të luftës kundër evazionit fiskal).

⁸⁶ (Modalitete dhe afate të njoftimit të të dhënave në Zyrën e Regjistrimit të Tatimpaguesve nga ana e operatorëve financiarë siç në nenin 7, parag.i gjashtë, i D.P.R. n.504, dt. 29.09.1973, dhe ndryshimet e mëvonshme).

marrëdhënies (por **jo** edhe të dhënat mbi **shumat e disponueshme** mbi marrëdhëniet, **operacionet** e kryera në to apo përmes tyre, **shumës** së administrimeve pasurore, **subjektet e autorizuar** të veprojnë), iv) sipas **modaliteteve telematike**, v) lidhur me marrëdhëniet ekzistuese në datën 31 dhjetor 2006 apo me ato që janë mbyllur pas datës 1 janar 2005, vi) brenda datës **30 prill 2007**. Të dhënat dhe informacionet e mbledhura përpunohen vetëm në rastet e subjekteve ndaj të cilëve kanë nisur hetime për kryerjen e hetimeve pasurore, pas marrjes së një autorizimi paraprak nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së të Ardhurave apo nga Komandanti i Përgjithshëm i Rojës së Financës. Informacionet do të mund të përdorën gjithashtu nga autoriteti gjyqësor, nga oficerët e policisë gjyqësore, nga ZIK, nga Ministria e Brendshme, nga Shefi i Policisë, nga kuestorët, nga Drejtori i DIA-s dhe nga Komandanti i Skuadrës speciale të Policisë Tatimore të Rojës së Financës. Mes ZIK dhe Agjencisë së të Ardhurave janë vendosur lidhje për të realizuar lidhjen e shpejtë, gjë që parashikohet për qershorin e ardhshëm.

Ndryshime të rëndësishme mund të rrjedhin nga Direktiva 2005/60/KE e quajtur ndryshe **Direktiva III e luftës kundër pastrimit të parave**, që sjell të paktën tre aspekte të rinj: 1) (konfirmimi i) shtrirjes së **rregullimit të luftës kundër pastrimit të parave edhe për qëllime parandalimi të financimit ndaj terrorizmit**; 2) **modulimi i detyrimeve për luftën kundër pastrimit të parave** për shkak të ekspozimit të klientelës ndaj riskut të pastrimit të parave (si, për shembull, për operacionet apo marrëdhëniet e biznesit me “persona politikisht të ekspozuar” banues në një tjetër vend anëtar të BE-së apo në një Shtet të tretë); 3) futja e **nacionit komunitar ZIF**, e ngarkuar të marrë, analizojë dhe komunikojë pranë autoriteteve kompetente informacionet që mund të kenë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, dhe duke i dhënë asaj kompetencën për të pasur akses, drejtpërsëdrejti ose jo, në informacionet financiare, administrative dhe investigative të nevojshme për të përmbushur detyrat e veta në mënyrë të përshtatshme. Në zbatim të këtyre parimeve, është duke u përgatitur në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF), për t’u miratuar më pas nga Këshilli i Ministrave, **një projekt i Dekretit Legjislativ që duhet përfutur**. Nga zbatimi i këtij dekreti pritet të vijnë të reja të rëndësishme, si përjashtimi i kategorive të caktuara të subjekteve nga detyrimet e regjistrimit, rishikimi i mënyrave të identifikimit dhe regjistrimit të klientelës, diversifikimi i mënyrave të raportimit të operacioneve të dyshimta, reformimi i aparateve administrative të përfshira në rregullimin e sektorit dhe në kryerjen e kontrolleve përkatëse.

Lidhur me këtë aspekt të fundit, do të duhet të sigurohemi që projekti i Dekretit Legjislativ për përfundimin e Direktivës III të jetë në përputhje me **projekt ligjin** qeveritar (nr.1.366 të dt. 5 mars 2007) të **reformës së kompetencave të autoriteteve të mbikëqyrjes** në tregjet financiare, që, siç dihet, parashikon **futjen e ZIK** në Bankën e Italisë, duke u kujdesur për t'i siguruar ZIF respektimin e garancive të pavarësisë dhe autonomisë të parashikuara nga dispozitat ndërkombëtare. Në këtë kuptim, projekt ligji duket se sjell përmirësime të ndjeshme për funksionin e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, përmes **fuqizimit të kompetencave që i njihen ZIF-së dhe rivlerësimit e sinergjive kundrejt** funksioneve (sidomos atij të mbikëqyrjes) të ushtruara nga Banka e Italisë. Në këtë kontekst, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është krijuar së fundi dhe sapo ka nisur punën një **Komision studimi për nxjerrjen e Tekstit Unik për luftën kundër pastrimit të parave**. Këtij Komisioni i është besuar detyra e paraqitjes së propozimeve në dritën e zbatimit të autorizimit që përmban ligji komunitar për vitin 2005, për nxjerrjen e një T.U. për luftën kundër pastrimit të parave, që synon të koordinojë dekretin e adoptimit të Direktivës III me normat legjislative në fuqi, “duke sjellë ndryshimet e vetme të nevojshme për të garantuar thejshimin dhe koherencën logjike, sistematike dhe leksikore të normativës”. Për këtë arsye, do të bëhet fjalë për një analizë të kujdesshme të shtrirjes së autorizimit, dhe për të vlerësuar nëse është e mundur të bashkohen punimet e Komisionit në projekt dekretin e hartuar, apo për të adoptuar ndryshimet më të rëndësishme (si parashikimi i krimit të vetëpastrimit të parave, dhe ndryshimi i rregullimit mbi transportin ndërkufitar të vlerave) si dhe për të përgatitur një autorizim të mundshëm *ad hoc*. Mbi çështje që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me pastrimin e parave është duke punuar aktualisht edhe **Komisioni i studimit për racionalizimin e procedurave të konfiskimit dhe të administrimit të të mirave të konfiskuara**, i krijuar pranë Ministrisë së drejtësisë me autorizimin për të dhënë propozime që kanë për qëllim të sigurojnë një efikasitet më të madhe në këtë sektor.

§ 6. Propozimet për reformë.

Në dritën e konsideratave të zhvilluara si më sipër, janë aktualisht në fazë diskutimi disa propozime, të cilat kërkojnë të rrisin efikasitetin e sistemit të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, edhe në lidhje me instrumentet e hetimit pasuror. **Para së gjithash**, në planin ndëshkues, do ishte e udhës që ligjvënësi të fuste parashikimin e veprës penale të të ashtuquajturit **vetëpastrim parash**. Aktualisht, vepra e pastrimit të parave

mund të zbatohet me vështirësi, për shkak të vështirësisë që paraqet në të provuarin, gjatë debatit gjyqësor, e faktit që pastruesi i parave është i tretë kundrejt autorit të krimeve; kjo gjë mund ta bëjë autoritetin gjyqësor ta konsiderojë veprën si një *nënlloj* të bashkëpunimit në krimin e supozuar. Dënueshmëria e vetëpastrimit të parave do të mundësonte ndjekjen e një politike gjyqësore më “agresive” dhe efikase, jo vetëm sepse nuk do ish më e nevojshme të provohej të qenit i tretë për autorin e pastrimit të parave kundrejt autorit të supozuar të krimeve, por edhe sepse do të ish e mundur të rritej në maksimum dobishmëria e sistemit të ROD.

Në radhë të dytë, në planin parandalues, do ish e udhës që përgatitja e fluksit të strukturuar të **feed-back** të informacioneve nga autoritetet investiguese tek ZIF. Aktualisht, **feed-back** ka të bëjë me raportimet e operacioneve të dyshimta që nuk merren përsipër nga autoritetet investiguese, pa treguar arsyet që e bëjnë këtë informacion “të parëndësishëm”. Kjo gjë nuk lejon një perceptim të përfundimeve gjyqësore të raportimeve mbi operacionet e dyshimta, përfundime që shpesh ZIF i njeh vetëm përmes shtypit. Prej disa vitesh, këtij boshllëku legjislativ i përgjigjet pjesërisht një tjetër fluks informacionesh, që vjen nga autoritetet investiguese, që ka për objekt të ashtuquajturat “rezultate të shërbimit”, pra tregon raportimet e operacioneve të dyshimta që kanë pasur një vazhdim gjyqësor. Në këtë kontekst, një strukturim më i mirë e fluksit të informacioneve do t’i jepte mundësi ZIF-it të vlerësonte në mënyrë të pavarur rëndësinë e fluksit të ROD dhe efikasitetin e analizës së kryer nga ajo, si dhe, për rrjedhojë, të orientojë sa më mirë të jetë e mundur punën e raportimeve, edhe duke nxjerrë udhëzime specifike operative, duke përcaktuar treguesit e parregullsisë, përhapjen e operacioneve të shpeshta (të paligjshme).

Në radhë të tretë, po në planin parandalues, do ish e udhës të merreshin masa që synojnë uljen e “**vizibilitetit**” të subjektit raportues, në mënyrë të tillë që nuk lejon të mbërrihet deri tek autori i raportimit. Kjo gjë mund të arrihet **përmes një objektivizimi më të madh** të procedimit të raportimit, që (siç kërkohet ndër të tjera nga GAFI) duhet ndjekur përmes rivlerësimit të mekanizmave të *rating* të dyshueshmërisë së operacioneve dhe vlerësimit të aspekteve të riskut të klientelës. **Në radhë të katërt**, një vëmendje më e madhe duhet t’i kushtohet mundësisë për të futur **kufizime më përcaktuese për përdorimin e cash-it** në pagesat mes privatëve dhe në transaksionet përmes *money-transfer*. Në këtë mënyrë, do ish e mundur të shtrihet më tej sfera e veprimeve të garancive që rrjedhin nga kanalizimi i operacioneve, si dhe, për rrjedhojë, për “të shtrënguar” më tej pastrimin e parave jashtë sistemit financiar të konceptuar më tërësinë e tij.

Në radhë të pestë, masa të përshtatshme duhet të merren me qëllim që **të rriten aftësitë për ndërhyrje të ZIF**. Në këtë kontekst e për këtë arsye do ish e udhës: i) **të rritej mbikëqyrja** mbi subjektet e detyruar, sidomos në lidhje me kontrollet e drejtpërdrejta mbi të raportuarit, duke i bërë më të rënda sanksionet për mosraportim dhe mosbashkëpunim; ii) të shtrihet efikasiteti i masave **të pezullimit nga 48 orë në 72 orë**, për të lehtësuar dhe bërë më vendimtare ndërhyrjen e mëtejshme, që qëndron në sekuestrimin nga ana e A.GJ.⁸⁷; iii) **të racionalizohen dhe bëhen më të shpejta shkëmbimet e informacioneve** mes raportuesve, ZIF, organeve investiguese dhe autoriteteve gjyqësore; iv) **t'i japë ZIF të drejtën për të ndërmarrë kryesisht analiza të thelluara financiare**, edhe pavarësisht nga marrja e ROD, në bazë të “parregullive” individuale të hasura në kryerjen e funksioneve të veta; v) **të sigurojë një bashkëpunim më të ngushtë mes ZIF dhe autoritetit gjyqësor**, përmes thjeshtimit të shkëmbimit të informacioneve, dhe mundësisë “për të përdorur analistë financiarë pranë Prokurorive; vi) **të konfirmojë dhe forcojë të drejtën e ZIF për të dhënë udhëzime mbi ROD**, përveç atyre të dhëna nga i ashtuquajtimi “Dekalog”, edhe në lidhje me situata të veçanta risku për pastrim të parave me karakter rastësor; vii) të ndihmojë në pjesëmarrjen e ZIF, në cilësinë e palës së dëmtuar, në procesin penal për pastrim të parave, me qëllim që të merret në procedim çdo element i mbledhur siç duhet gjatë ushtrimit të detyrës së vet të analizës së ROD.

Së fundi, në këtë kontekst do ish e udhës të sillnim disa mendime edhe në lidhje me racionalizimin e rregullave dhe procedurave të përcaktimit, ndëshkimit (përmes **sekuestrimeve dhe konfiskimeve**) dhe administrimit të të mirave dhe utiliteteve me prejardhje të paligjshme. Aktualisht, siç dihet, këto rregulla dhe procedura rezultojnë se kanë një zbatim kompleks nga pikëpamja funksionale, të vështirë nga pikëpamja procedurale, jo efçente nga pikëpamja financiare e madje me humbje, sepse ndiqen nga forma administrimi të të mirave jo të strukturuara dhe sidomos jo të orientuara ndaj fitimit.

DR. RENATO RIGHETTI

*Përgjegjës i Shërbimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, ZIK**

⁸⁷ Në vendet e tjera evropiane, për shembull, afati i vlefshmërisë prej 48 orësh shpesh kapërcehet, siç është provuar për shembull nga **Finlanda** (5 ditë), **Luksemburgu** (3 muaj), **Austria** (6 muaj). (shih bashkëlidhjen).

* *Z.I.K. – Zyra Italiane e Këmbimeve (UIC)*

BASHKËLIDHJE: PEZULLIM I OPERACIONEVE TË DYSHIMTA NË EVROPË

Fiu	kompetenca e ndërprerjes	kompetenca e ngrirjes
AUSTRI	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 6 muaj • a.gj. duhet njoftuar 	Jo
GJERMANI	jo	Jo
LUKSEMBURG	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 3 muaj • edhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare • edhe me kërkesë të fiu të tjera nëse është e shoqëruar me letërporosi 	Po
BELGIKA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 2 ditë pune • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Jo
ESTONI	<ul style="list-style-type: none"> • 2+12 ditë pune • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Po
REPUBLIKA ÇEKE	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 72 orë • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Po
LITUANIA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 48 orë • edhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Po
BULLGARIA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 3 ditë pune 	Jo
MALTA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 24 orë • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Jo
SUEDIA	jo	Jo
SLLOVAKIA	<ul style="list-style-type: none"> • 48 orë + 24 (nëse rasti u është nënshtruar organeve investiguese) • edhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	Jo
HOLLANDA	jo	
POLONIA	48 orë	po
GREQIA	jo	
HUNGARIA	/	
FINLANDA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 5 ditë pune • edhe me kërkesë të fiu të tjera, nëse është e mundur të niset një çështje për pastrim parash edhe në Finlandë 	po
IRLANDA	Jo	po
DANIMARKA	jo	po
RUMANIA	3 ditë pune (me masë nga fiu) + 4 ditë pune (me masë nga a.gj.)	jo
SLLOVENIA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 72 orë 	jo
LETONIA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 45 ditë, për rastet e pastrimit të parave • maks. 6 muaj për rastet e terrorizmit 	po
SPANJA	jo	jo
MBRETËRIA E BASHKUAR	<ul style="list-style-type: none"> • 7 ditë + 31 ditë (nëse çështja i është nënshtruar organeve investiguese) • edhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare 	jo
FRANCA	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 12 orë (të shtrira me anë të dispozitës së agj.) 	jo
ITALI	<ul style="list-style-type: none"> • maks. 48 orë • edhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare 	jo
PORTUGALI	jo	jo
QIPRO	<ul style="list-style-type: none"> • kohëzgjatje e papërcaktuar • dhe me kërkesë të autoriteteve të tjera kombëtare • edhe me kërkesë të fiu të tjera 	po

2.2. *Krimi i organizuar në fushën ekonomiko-financiare në Shqipëri: analizë e fenomeneve dhe strategjive të luftës.*

§. *Në konstatimet e Këshillit të Evropës për Shqipërinë, në kuadër të projektit “Për forcimin e kapaciteteve në luftë kundër krimit të organizuar në Evropën Juglindore”, ndër të tjera, thuhet: “Kërcënimet kryesore për Shqipërinë janë krimi i organizuar që ka lidhje me drogën, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin ekonomik dhe korrupsionin”.*

Krimi ekonomik në përgjithësi dhe veçanërisht grupet kriminale që kryejnë vepra penale në sferën financiare kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një rrezik serioz për vendin tonë dhe për sigurinë kombëtare. Kapacitetet financiare të këtyre grupeve, shërbejnë jo vetëm për konsolidimin dhe zgjerimin e operacioneve të mëtejshme të tyre, por edhe për të depërtuar në strukturat shtetërore me qëllim që të sigurojnë mbrojtje nga këto struktura e deri për të ndikuar në marrjen e vendimeve në aspektin politik, legjislativ, ekzekutiv, ekonomik apo në fushën e drejtësisë. (Komente)

Edhe më tej, kapaciteti i këtyre grupimeve kriminale, financiar dhe teknik, në disa raste e tejkalon kapacitetin e agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit. Në këto rrethana lufta kundër krimit ekonomik dhe posaçërisht atij të organizuar përbën një sfidë të veçantë për organet e zbatimit të ligjit në vend, sidomos në kuptimin e gjurmimit, të ndjekjes policore, por dhe të hetimeve shumë më komplekse, të cilat diktojnë nevojën e përdorimit më gjerësisht të mjeteve të posaçme hetimore, një bashkëpunim më të ngushtë midis institucioneve në vend dhe atyre ndërkombëtare, sekuestrimin dhe menaxhimin e pasurive të kapura, mbrojtjen e dëshmitarëve si dhe një proces gjyqësor më efikas.

§. *Zbulimi i disa grupeve kriminale. (Komente)*

Në krahasim me atë që ndodh realisht zbulimi është ende larg. Grupe kriminale që kanë kryer e vazhdojnë të kryejnë krime të rënda në ekonomi janë zbuluar pak, ndonëse këto grupe nuk janë të paktë në numër. Si shembull pozitiv këtu mund të përmendet çështja e kontrabandës së cigareve e hetuar nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe më pas nga Prokuroria për Krime të Rënda. Si dhe grupi kriminal i falsifikimit të pasaportave, vizave etj.

(Komente).

Është fakt i pamohueshëm që krijimi i Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe disa ndryshime e plotësime në Kodin Penal e Kodin e Procedurës Penale kanë ndikuar dukshëm në përmirësimin e punës kundër krimit të organizuar dhe atij financiar. Por, ende ka probleme të mëdha dhe kërkohet një punë më e kujdesshme, më cilësore e më sistematike dhe një drejtim e kontroll më efektiv nga prokuroria për rritjen e forcës zbuluese.

Llogaritet që në Shqipëri ka një evazion fiskal që arrin mbi 50 për qind. E konvertuar në shifra kjo do të thotë që nuk arkëtohen çdo vit në arkën e shtetit më shumë se 1,5 miliard Euro. Prapa këtyre shifrave tronditëse për kushtet e Shqipërisë, fshihet jo vetëm krimi ordiner, por edhe ai i organizuar.

Cilat janë atëherë shkaqet që shpien në një evazion fiskal kaq të madh?

Faktorët që ndikojnë në mosarkëtimin e shumave kaq të mëdha në arkën e shtetit janë të shumtë e nga më të ndryshmit.

Renditja e disa shkaqeve dhe mangësitë e punës gjurmuese, hetimore dhe të prokurorisë:

- Një numër i konsiderueshëm i firmave të mëdha në Shqipëri falsifikojnë në mënyrë sistematike bilancet ose punojnë me dy bilance. Bilancet që paraqiten përpara organeve tatimore tregojnë në mënyrë të rreme fitime më të ulëta në krahasim me ato reale.

- Nuk është bërë e nuk bëhet ndjekja në vijimësi e faktit se cilët subjekte i përdorin realisht blloqet e TVSH-së që shesin organet tatimore për firmat private, pasi disa nga firmat blerëse ua shesin këto blloqe firmave të tjera. Këto të fundit falsifikojnë këto dokumente sikur kanë bërë blerje të mallrave të importuara nga jashtë shtetit, kur realisht ato janë prodhuar në vend, mallra këto që në fakt i kanë shitur në shtet, (siç janë produktet bujqësore dhe blektorale me të cilat furnizohet Ministria e Mbrojtjes, konviktet ose shkollat ushtarake, etj.) dhe me anë të këtyre dokumenteve me përmbajtje të rreme rimbursohen padrejtësisht duke përfituar TVSH të papaguar. Raste të tilla përbëjnë vjedhje të pasurisë shtetërore sepse kanë të bëjnë me pakësim të parave nga arka e shtetit në mënyrë të padrejtë. Edhe në këtë aktivitet sistematik të jashtëligjshëm duhet të kërkohet ekzistenca e elementëve të krimit të organizuar.

- Organet tatimore nuk kanë ushtruar e nuk ushtrojnë kontrolle të rrepta për ndjekjen e TVSH-së që nga koha e importimit të mallrave nga jashtë shtetit e deri tek blerësi i fundit, pasi, në këtë drejtim, ka probleme të shumta

e të vazhdueshme. Kjo gjë përbën edhe një drejtim të rëndësishëm të punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe të organit procedues.

- Regjistrimet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe në zyrat tatimore, si për personat juridikë ashtu dhe për ata fizikë, nuk janë bërë duke identifikuar saktësisht personat që regjistrohen. Ka ndodhur, jo rrallë, që regjistrohen shoqëri në emër të personave fiktive si rastet e tri firmave në Durrës dhe në emër të këtyre firmave imagjinare kryhet veprimtari në fushën e doganave e tatimeve me qëllim shmangien e pagesave në arkën e shtetit. (Komente).

- Kopjet e të gjitha licencave që lëshohen nga administrata shtetërore (si nga Ministria e Shëndetësisë e Bujqësisë e Ekonomisë etj., – për stomatologët, farmacistët, mjekët privatë, veterinerët, etj..), po kështu, nuk dërgohen në zyrat përkatëse të tatimeve në mënyrë që të realizohet vjelja korrekte e detyrimeve ndaj Shtetit dhe të mos ushtrojnë aktivitet privat me vite, siç ka ndodhur e vazhdon të ndodhë, pa paguar asnjë detyrim në arkën e Shtetit.

- Artikuj të duhaneve e pijeve alkoolike janë shitur e vazhdojnë të shiten pa pullë fiskale, ndërsa policia tatimore në rastin më të mirë s'ka bërë e nuk bën detyrën. Kontrabanda e mallrave me detyrim të lartë doganor sikurse janë këto mallra, nuk mund të zbulohet vetëm kur kapen anijet. Ndërsa gazetarët brenda ditës gjejnë se në cilat pika doganore hyn një pjesë e këtyre cigareve organet shtetërore heshtin. Pullat tatimore të vendosura në shishet e pijeve alkoolike ripërdoren ose ka raste që falsifikohen.

- Organet doganore vazhdojnë të pranojnë si dokumente që vërtetojnë origjinën e mallit akte të lëshuara nga firma imagjinare sipas sistemit të ashtuquajtur “trekëndësh”, fenomen ky që ka shpënë jo vetëm në shmangien e detyrimeve doganore, por edhe në vjedhje. Të përfshirë në këtë veprimtari janë grupe kriminale të cilat kanë në përbërje edhe punonjës të doganave.

- Policia gjyqësore e tatimeve dhe e doganave nuk aktivizohet në hetimin e këtyre fenomeneve. Fenomeni që ndodh për hetimin e veprave penale të kontrabandës. Vetëm rreth 40 çështje janë hetuar nga policia gjyqësore e doganave për periudhën shtator 2005 – shtator 2006, nga 846 të tilla të hetuara gjithsej. Cilat janë shkaqet ? (shih shkresën që i është drejtuar Drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor dhe analizën që është bërë për këtë qëllim).

- Ka mosnjohje të akteve ligjore e nënligjore në fushën e taksave e tatimeve nga të gjithë ne, si nga oficerët e policisë gjyqësore dhe nga prokurorët e gjyqtarët.

- Për disa nga drejtimet e sipërpërmendura, prokuroritë e rretheve, por dhe Prokuroria për Krime të Rënda mund dhe duhet të regjistrojë çështje penale kryesisht.

- Duhet të rritet numri i objekteve të sekuestruara sipas ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Në radhë të parë duhet të bëhet evidentimi i saktë i të gjithë personave që janë dënuar për krim të organizuar brenda dhe jashtë vendit.

- Zbatimi sa më i gjerë dhe sa më efektiv i ligjit për goditjen dhe parandalimin e krimit të organizuar do të bëjë të mundur dhe zbatimin e ligjeve organike të policisë e prokurorisë ku përcaktohet që një pjesë e parave dhe mjeteve të konfiskuara nga krimi të kalojnë në favor të policisë e të prokurorisë për përmirësimin e kushteve të punës në këto institucione.

Kriminaliteti i organizuar duhet të kërkohet më shumë edhe në fushën e vjedhjeve, mashtrimeve, falimentimeve të provokuara, pastrimit të parave të pista, tenderave etj.. Prokuroria për Krime të Rënda mendoj se duhet të rrisë frymën e bashkëpunimit me prokuroritë e rretheve në mënyrë që të tërheqë për të drejtuar vetë hetimin e veprave penale në këto drejtime kur dalin të dhëna se janë të pranishëm elementët e krimit të organizuar.

Puna me dosjet hetimore të pezulluara për moszbulim autori.

Vjedhjet në KESH janë evidente dhe të njohura nga të gjithë, por askush nuk është vënë përpara përgjegjësisë penale. Përvetësimet e kryera dhe korrupsioni i një numri të madh personash të kësaj koorporate dihen dhe, policia gjyqësore elektrike gati nuk ekziston. Ka të dhëna që blerja e pajisjeve të KESH-it nga jashtë shtetit është bërë nëpërmjet një falsifikimi dokumentesh e kontrabande të sofistikuar që ka çuar në vjedhje të shumave të mëdha. Përpara kësaj situatë mendoj se duhet të veprojnë me forcë jo vetëm prokuroritë e rretheve, por dhe Prokuroria për Krime të Rënda.

Me synim forcimin e luftës kundër krimit ekonomik dhe pakësimin e evazionit fiskal, çojmë se është e domosdoshme të ndryshohen, të plotësohen dhe të hartohen disa ligje, e konkretisht:

- Nevoja për ndryshimin dhe riformulimin e neneve 180 dhe 181 të Kodit Penal. Komente.

- Është e nevojshme që, në zbatim të nenit 45 të Kodit Penal, të hartohet e miratohet një ligj i veçantë ku të përcaktohen veprat penale dhe masat shtrënguese që duhet të zbatohen ndaj personave juridikë. Ky ligj është i domosdoshëm sepse në zbatim të tij do të mund të vihen përpara përgjegjësisë penale shoqëritë private që kryejnë vepra penale ndaj shtetit

ose individëve, përveç personave fizikë që mund të vihen nën akuzë me legjislacionin penal aktual.

- Për policinë tatimore është krijuar një vakum ligjor dhe është e domosdoshme që t'i jepen kësaj policie kompetencat e policisë gjyqësore. Kjo polici është shumë e rëndësishme për hetimin e veprave penale në këtë fushë si organ i specializuar që njeh legjislacionin tatimor.

- Mendojmë se është e domosdoshme të miratohet Kodi Tatimor, i cili duhet të sanksionojë parimet bazë të organizimit dhe të veprimtarisë tatimore, të përcaktojë rregullat e përcaktimit dhe të vjeljes së borxhit tatimor, shkeljet administrative në këtë fushë dhe shkeljet që përbëjnë vepër penale etj.

- Si duhet të ishte vepruar për zbulimin e krimit të organizuar për vjedhjet në Bankën e Kursimeve (Komente).

- Metodika e hetimit të veprës penale të prodhimit industrial të jashtëligjshëm. Marrëdhëniet juridike që cenohen (Komente).

Firmat prodhuese që shmangin tatimet dhe detyrimet doganore. Firmat e ndërtimit dhe falsifikimi sistematik i bilanceve.

Vjedhjet dhe shpërdorimet që realizohen nga përcaktimi i çmimeve fikse prej shoqërive të sigurimit.

Vjedhjet që realizohen nëpërmjet përcaktimit të çmimeve fikse nga kompanitë e telefonisë celulare. Nevoja për përmirësim ligjor në këtë fushë.

Elementë të metodikës së hetimit për zbulimin e krimit në fushën e kthimit dhe kompensimit të pronave, kthimit të padrejtë të pronave e pastaj ndërtimeve dhe marrjes së parave nëpërmjet shitjes së pjesëve të fituara. Shembuj dhe komente.

Nevoja e kryerjes së ekspertimeve komplekse kontabël.

Komente rreth konventave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe për shkëmbimin e informacioneve dhe provave në fushën e doganave.

Komente rreth Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Analizimi dhe përpunimi i të dhënave për mallrat me detyrim të lartë doganor. Ndjekja dhe regjistrimi i çështjeve penale kryesisht (cigaret, pijet e forta alkoolike, kafë, karburantet, etj).

Problemet që ekzistojnë për pullat tatimore. Nuk ka kontabilitet të saktë. Nuk kanë numër serie, nuk kanë të shënuar çmimin dhe ndarja bëhet vetëm në bazë të ngjyrës, gjë që është e papranueshme.

Metodika e hetimit të rimbursimeve të paligjshme, të eksporteve të rreme (shih çështjen e kafes) në fushën e pasurisë së paluajtshme (ku janë marrë e po merren provat në çështjen e ish shefit të policisë ndërtimore dhe në çështjen tjetër që ka Jetnori (shih planin e hetimit). Marrja e provave edhe në arkivin e shtetit, në Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, zyrat noteriale, në duart e të dëmtuarve etj., në komisionet e kthimit të pronave, në zyrat tatimore, në banka etj., dhe krahasimi i të dhënave dhe i përmbajtjes dhe hetim i fakteve që janë të dobishme për hetimin. (shih rastin e “Shpërdhesë”, rastin e anijes që sillte naftë në Vlorë dhe dilte për peshkim, të dhënat në kapitaneritë e porteve dhe në Zyrën e regjistrimit të anijeve ose siç quhet ndryshe Regjistri Detar, etj.,

BILBIL METE
Prokuroria e Përgjithshme, Tiranë

Tiranë, Mars 2007

2.3. *Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Itali.*

§.

Krimi i organizuar i llojit mafioz e ka zanafillën e vet historike në jugun e Italisë, ku problemet ekonomike kanë qenë gjithnjë më të mëdha, për shkak edhe të shifrave të larta të papunësisë që kanë ekzistuar përherë aty.

Në Itali veprojnë në mënyrë të përhershme katër organizata:

- “Koza Nostra” (*Cosa Nostra*), e cila ka lindur në fund të Tetëqindës në Sicili. Ajo i ka rrënjët e saj në fshatra dhe, me kalimin e kohës u shtri edhe në qendrat urbane. Struktura e saj është sigurisht e llojit bosht-piramidë;

- “ndrangeta” (*ndrangheta*) vepron në Kalabri përmes grupeve kriminale të fuqishme me anëtarë që shpesh i përkasin të njëjtës familje. Asnjë nga grupet e përmendura nuk komandon mbi të tjerët, e për këtë arsye mund të themi se ‘ndrangeta’ ka një strukturë kryesisht horizontale;

- “Kamorra” (*Camorra*), e lindur në Kampania në shekullin XVI, në veçanti në qendrën e qytetit të Napolit gjatë sundimit spanjoll, pati deri në fillim të Nëntëqindës një strukturë të llojit bosht. Ndërsa sot ajo përbëhet nga konflikte të kamorrës çdo herë që një grup përpiqet të “komandojë” mbi një grup tjetër;

- “Sakra Korona Unita” (*Sacra Corona Unita*) vepron në Pulje. E krijuar dhe pranuar nga kamorra, aleate e të cilës ka qenë për shumë kohë, me kalimin e viteve ajo ka fituar një pavarësi të vetën. Për këtë arsye edhe kjo organizatë, e përbërë nga më shumë se një familje, çdonjëra prej të cilave kontrollon një pjesë të caktuar të territorit, ka një strukturë të llojit horizontal.

Parakusht për ekzistencën e këtyre organizatave është rregulla bazë e **heshtjes** (*omertà*), pra angazhimi i çdo anëtari për të ndjekur rregullën e heshtjes që, nëse nuk respektohet, mund të ndëshkohet edhe me vdekje, e cila vendoset nga një *Gjykatë e kamorrës*.

Dhuna dhe/ose kërcënimi me frikësim kundrejt viktimave është **metoda** që përdoret nga organizatat e llojit mafioz për të kryer veprimet kriminale.

Organizatat e mësipërme ushtrojnë një **kontroll të hekur mbi territorin** përkatës “në kompetencë të tyre”, ku angazhohen të kryejnë veprimtari të çfarëdolloji.

Me qëllim që të arrijnë qëllimet e tyre grupet e mësipërme priren shpesh **të kushtëzojnë fushatat zgjedhore**, sidomos ato vendore, duke futur në listat e tyre ithtarë apo duke mbështetur kandidatë mbi të cilët investojnë shuma të mëdha parash që fitojnë me sistemin *derë më derë*, përmes forcës së hollë të frikësimit, që vjen nga karizma kriminale e përfaqësuesve të tyre të boshtit. Kjo prirje synon të **infiltrtojë** persona në veprimtarinë e Administratës Publike, me qëllimin e vetëm për të imponuar zgjedhjet dhe për të marrë kontrollin e drejtpërdrejtë dhe/ose të shpallë e fitojë prokurime publike.

Veprimtaritë e paligjshme kryesore, burim fitimesh të jashtëzakonshme për organizatat mafioze që veprojnë në Itali, janë ato të llojit tradicional, pra zhatjet, trafiku i lëndëve narkotike dhe i armëve, mashtrimet para bashkimit Evropian si dhe kontrabanda dhe bastet klandestine.

Të gjitha veprimtaritë ekonomike, edhe ato të përmasave më të vogla, i nënshtrohen **zhatjes**. Grupet kriminale, përmes kontrollit të vazhdueshëm të gjithë territorit, përv caktojnë fare lehtë veprimtaritë prodhuese, duke i detyruar pronarët e tyre të paguajnë një *ryshfet* (bare, restorante, biznese tregtare të çdo lloji).

Dukuria e zhatjes ka të bëjë edhe me sektorin e prokurimeve të punimeve publike dhe me atë të ndërtimit në përgjithësi; sidomos për të parin imponimi i nënprokurimeve dhe i *qeradhënieve* “*në të ftohtë*” a “*në të nxehtë*” në favor të ndërmarrjeve, drejtpërsëdrejti apo jo, të administruara nga grupe kamorriste.

Pikërisht në **sektorin e prokurimeve** vërehet një **përputhje interesash** të kimit të organizuar të llojit mafioz, klasës sipërmarrëse dhe përfaqësuesve të politikës (zakonisht, të administratave vendore pasi janë qendrat më të mëdha të vendimarrjes së shpenzimit publik).

Përmes këtij pikëtakimi, organizatat e llojit mafioz arrijnë objektivin e kontrollit të ekonomisë, nga i cili s’mund të heqin dorë, duke minuar në themel parimin e konkurrencës së lirë, pra të vetë demokracisë.

Në shumë raste, hetimet kanë vërtetuar se shoqëritë e prokuruar, përpara se të nisnin punimet, duke druajtur veprime të dhunshme kundër personit apo kundër mjeteve të kushtueshme që duhen përdorur për kryerjen e punimeve, janë përpjekur vetë të krijojnë lidhje me *personin e kontaktit kamorrist* të zonës në fjalë, për të rënë në ujdi lidhur me zhatjen.

Po kështu ka ndodhur për pronarët e ndërmarrjeve të ngarkuara me kryerjen e furnizimeve dhe të kryerjes së shërbimeve.

E vazhdueshme është vëmendja e shoqërive kriminale kundrejt disa punimeve publike që duhen realizuar në kuadrin e projekteve të rëndësishme, si, për shembull, linja hekurudhore të shpejtësisë së lartë, rikualifikim i lagjeve të degraduara të disa qyteteve italiane, modernizimi i rrjetit rrugor dhe të autostradave.

Eksperienca gjyqësore e këtyre viteve na ka konfirmuar ekzistencën e shoqërive pranë organizatave kriminale, dhe të shpërndarjes në bazë marrëveshjeje në favor të tyre të prokurimeve në lidhje me **punime të mëdha publike**. Ndërsa për **prokurimet për shuma më të vogla** vazhdojnë të mbijetojnë, sidomos në qarqet jugore ku ka një prani të ndjeshme mafioze, format tradicionale të infiltrimit me kushtëzim kriminal, si:

- *tendera me porosi*, në veçanti përmes përgatitjes së skedave përzgjedhëse ad hoc;
- *përrjashtimet me pretekst* të disa shoqërive të themeluara mbi formalizma, interpretime të sforcuara apo arsyetime vetëm sipërfaqësore;
- *shkelje të sekretit të ofertave*;
- *zëvendësim dhe/ose falsifikim i ofertave*;
- *paraqitje e njëkohshme e shumë ofertave*, që duket se vijnë nga subjekte të ndryshëm por, në të vërtetë, i referohen të njëjtës shoqëri apo grupi shoqërisht;
- *përgatitje dokumentacioni të rremë*, që provon ekzistencën e kritereve të kërkuar për pjesëmarrjen në tender;

Me fjalë të tjera, në lidhje me prokurimet publike, sidomos përmes korrupsionit, realizohet një **marrëdhënie perverse** dhe një përputhje interesash mes tre subjekteve protagonistë, pra mes *kamorrës*, shoqërisë dhe shtresës politike dhe/ose administrative.

Sidomos në rajonet jugore ekzistonin (dhe ekzistojnë) **komitete biznesi të mirëfillta** të përbërë nga administratorë, sipërmarrës, titullarë studiosh inxhenjerie, përfaqësues të organizatave kamorriste që kishin (dhe kanë) vendosur një lloj *kontrate* për shërbime përkatëse, që me kalimin e kohës është i destinuar dhe ka për qëllim të marrë fitime të paligjshme të jashtëzakonshme.

Në veçanti, **administratorët publikë** (në ndonjë rast, politikanë të rangut të lartë) i siguronin vetes (dhe i garantojnë vetes), **përmes kriminalitetit të organizuar** një kontroll sistematik të votës mbi në territor të caktuar, duke marrë miratim të jashtëzakonshëm në zgjedhje, ndërsa **përmes shoqërive** i siguronin vetes (dhe i sigurojnë) fluks të

vazhdueshëm financimesh në interes të tyre apo në favor të aparatit politiko-administrativ të cilit i përkasin.

Nga ana e tyre, **organizatat e llojit mafioz** i garantonin vetes (dhe i garantojnë):

- **përmes administratorëve publikë**, mbulimet e nevojshme institucionale,
- **përmes shoqërive**, burime të mëdha ekonomike, si në formë përqindjesh mbi prokurimet dhe krijimin e mëvonshëm të fondeve extra nga ana e vetë shoqërive, si përsa i përket menaxhimit me marrëveshje të prokurimeve;
- kontrollin sistematik të veprimtarive ekonomike në territor, si dhe mundësinë për të ofruar vende pune, pra **një pëlqim të madh në shoqëri**.

Së fundi shoqëritë, në bazë të kësaj marrëveshjeje, përftonin (dhe përftojnë) në mënyrë të qëndrueshme, një kuotë të konsiderueshme të tregut të prokurimeve publike duke ndryshuar mekanizmin e konkurrencës dhe, njëkohësisht, siguronin për veten (dhe sigurojnë) **sigurinë e kantierëve** të shpërndarë në territor, **mungesën e çdo kontradikte** me përfaqësitë e sindikatave dhe, siç thamë, mjete të mbajtjes së kontabilitetit në të zezë dhe disponibilitete shumësh financiare extra kontabël, që u shërben atyre për pagesën e rryshfeteve për administratorët publikë dhe për strukturat përkatëse kamorriste.

Si përfundim, mund të themi se *organizatat e llojit mafioz* kanë përdorur (dhe përdorin) marrëdhënien e mësipërme tripalëshe si mekanizëm kryesor të akumulimit ekonomik dhe të shtrirjes së pushtetit të vet kriminal.

Fajdja synon kryesisht financimin e përkohshëm por dhe mashtrues të sipërmarrësve, që gjenden në një situatë vështirësie ekonomike, edhe për shkak të kostove të larta që rrjedhin nga veprimtari të mëparshme zvatjeje që mund të jenë kryer ndaj tyre. Si përherë, pamundësia për të përballuar pagesën e interesave shumë të lartë të fajdes, i detyron sipërmarrësit t'i cedojnë plotësisht ndërmarrjet e tyre, apo një pjesë të tyre tek përfaqësues të grupeve mafioze që vazhdojnë t'i lënë ata të jenë titullarë.

Pra fajdja është ende sot një mjet që u lejon organizatave kriminale të përftojnë shoqëri të ligjshme, përmes të cilave arrijnë të kryejnë edhe *pastrimin* e të ardhurave të paligjshme dhe reinvestimin e tyre në veprimtari që vetëm në dukje janë të ligjshme.

Të gjitha organizatat e llojit mafioz veprojnë në **trafikun e lëndëve narkotike** të çdo lloji, duke marrë të ardhura të paligjshme të

konsiderueshme. Këto lëndë vijnë nga vende prodhuese të Amerikës Latine, nga Turqia, Azia dhe nga Lindja e Largët.

Është e qartë nevoja që organizatat kanë për të vendosur lidhje me shitës të huaj të lëndëve narkotike dhe me subjekte të vendeve të ndryshme për të organizuar dërgesat e tyre, për të kryer magazinimin e tyre dhe për të garantuar destinacionin përfundimtar.

Ndrangeta ka vendosur kontrollin pothuaj monopolist mbi trafikun e lëndëve narkotike dhe, shumë shpesh, del si garante për organizatat e tjera mafioze për blerjen e këtyre lëndëve nga Amerika e Jugut dhe, në veçanti nga Kolumbia.

Organizatat e llojit mafioz kanë **kapërcyer prej kohësh ambjentet lokale të veprimtarisë së tyre**, duke kryer operacione kriminale të ndryshme në të gjithë territorin kombëtar dhe jahstë tij, duke u shndërruar në **organizata ndërkombëtare** të mirëfillta apo, duke vepruar në bashkëpunim me organizatat e huaja të të njëjtit lloj, duke fituar përmasën e një **konfederate kriminale transnacionale**.

Një prirje e veçantë e organizatave të llojit mafioz është ajo e vendosjes në territore ku ato veprojnë të lidhjeve me drejtues të Instituteve të kredisë, kontabilistë dhe profesionistë të tjerë, në gjendje të kryejnë operacione të fshehjes së kapitaleve të paligjshme dhe, pra të reinvestimit të tyre në veprimtari formalisht të ligjshme, edhe përmes transferimit të tyre jashtë vendit, sidomos në vendet e ashtuquajtura parajsa fiskale, përmes operacioneve tregtare transnacionale.

Në kohët e fundit jemi përpara një dukurie shqetësuese kriminale transnacionale, pra në lidhjen operative mes interesave dhe veprimtarive kriminale. Kjo gjë ka nxjerrë në pah marrëveshjet e arritura mes terrorizmit ndërkombëtar dhe kriminalitetit të organizuar transnacional, sidomos në lidhje me trafiket e paligjshme të lëndëve narkotike dhe të armëve dhe të pastrimit të të ardhurave të paligjshme (ky është shembull i grupeve terroriste të ashtuquajtura .F.A.R.C. që veprojnë në Kolumbi dhe që shesin sasi të mëdha kokainë në këmbim të armëve).

Këto lidhje përbëjnë objektin e dy rekomandimeve të B.E. të vitit 2002 e 2005 ku u kërkohet Shteteve të rrisin bashkëpunimin e brendshëm dhe të realizojnë një strukturë efikase për luftën kundër krimeve transnacionale që mbështesin dhe ndihmojnë veprimtarinë terroriste; të analizojnë dhe shkëmbejnë informacione për të vërtetuar natyrën e lidhjeve mes terrorizmit dhe kriminit ndërkombëtar dhe në veçanti mënyrën se si organizatat terroriste mbështesin veprimtarinë e tyre me kryerjen e krimeve dhe, nëse është e

nevojshme, të zhvillojnë strategji për të mundësuar ndërhyrje që synojnë të zhdukin dhe dobësojnë këto veprimtari.

E njëjta linjë është ndjekur nga disa rezoluta të O.K.B.-së sidomos pas atentateve me matricë fundamentaliste-islamike të Nju Jorkut (shtator 2001), të Madridit (mars 2004) dhe Londrës (korrik 2005).

LUCIO DI PIETRO
Zëvendës Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie

Tiranë, Nëntor 2007

2.4. Krimi i organizuar, ekonomia dhe politika në Shqipëri.

§ 1. Në vend të hyrjes.

Në fund të vitit 1990 Shqipëria përmbysi sistemin monist njëpartiak, diktaturën e proletariatit dhe sistemin e ekonomisë shtetërore të centralizuar dhe përqafoi sistemin pluralist, demokracinë parlamentare dhe sistemin ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut të lirë. Ndryshimet rrënjësore politike, ekonomike dhe sociale që përfshinë të gjitha fushat e jetës nuk qenë të lehta dhe në mjaft raste ndeshën në pengesa të shumta, si pasojë e mungesës së përvojës politike, mangësive kulturore dhe aftësisë së klasës qeverisëse për t'iu përshtatur reformave të shumta dhe të gjithanshme. Që në fillimet e proceseve demokratike klasa drejtuese shqiptare shpalli si leitmotiv të programit politik të saj integrimin e Republikës së Shqipërisë në strukturat euroatlantike (Bashkimin Evropian dhe NATO), duke reflektuar kështu një aspiratë të hershme të popullit shqiptar për të qenë, jo vetëm pjesë e Evropës në pikëpamje gjeografike, por edhe pjesë e qytetarisë, kulturës dhe vlerave evropiane.

Natyrisht, për t'u integruar në organizma të tillë, nuk mjafton vetëm shprehja e një vullneti të mirë politik e shoqëror, qoftë ky edhe plebishitar⁸⁸, pasi këto institucione kanë vënë në themel të organizimit dhe veprimtarisë së tyre parimet e shtetit të së drejtës, përparësisë së ligjit, ndarjes dhe balancimit të pushteteve të qeverisjes, respektimit të të drejtave e lirive themelore të njeriut, një sistem demokratik zgjedhor dhe një pushtet gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm. Shqipëria, pavarësisht ecjes së ngadaltë, gjatë këtyre shtatëmbëdhjetë viteve tranzicion ka arritur suksese të brishta në drejtim të përmbushjes së standardeve për t'u integruar në Bashkim Evropian dhe NATO, duke miratuar ligjin themelor të shtetit (Kushtetutën), në nëntor të vitit 1998; duke nënshkruar, ratifikuar dhe aderuar në instrumente të rëndësishëm ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; Paktet e OKB-së për të drejtat civile, politike, ekonomike e shoqërore, konventat e Këshillit të Evropës dhe të OKB-së që rregullojnë bashkëpunimin ndërshtetëror në luftë kundër krimit të organizuar dhe produkteve të paligjshme që përfitohen nëpërmjet tij etj., si dhe duke kryer

⁸⁸ Sondazhet e shumta që janë bërë nga organizma prestigjioze në opinionin publik shqiptar kanë treguar se mbi 90% e popullsisë dëshirojnë që Shqipëria të aderojë në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

reforma të thella në ekonomi, sistemin fiskal e doganor, administratën shtetërore, ushtri, polici, shërbimin e fshehtë etj.

Republika e Shqipërisë ka sot një kuadër normativ të kënaqshëm i cili rregullon marrëdhëniet shoqërore në shumë fusha të veprimtarisë shtetërore e njerëzore, por me keqardhje konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk zbatohen, duke pasur një impakt negativ tek institucionet evropiane e ato globale, që monitorojnë zbatimin e reformave dhe respektimin e angazhimeve të marra nga shteti ynë, në funksion të anëtarësimit të tij në nismat e mbrojtjes kolektive të Atlantikut të Veriut dhe tregut të përbashkët evropian. Natyrisht që procesi i reformimi të sistemeve jetike për ekzistencën e sistemit demokratik, atij të drejtësisë, përfshi edhe organin e akuzës, atij zgjedhor, përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Evropian, respektimi efektiv i të drejtave të njeriut, ngritja dhe konsolidimi i një administrate publike, ushtrie dhe shërbimesh policore e atyre inteligjente të modeleve evropiane, të përgatitura, të afta dhe profesionale është i gjatë, i vështirë dhe kërkon vullnet të plotë e të qartë politik, bashkëpunim të singertë dhe luajal ndërmjet mazhorancës dhe opozitës, dhe punë, përkushtim dhe profesionalizëm të lartë nga funksionarët shtetërorë dhe aktorët politikë.

§ 2. *Probleme rreth përkufizimit të krimit të organizuar.*

Demokracia shqiptare, ashtu si edhe ajo perëndimore, nuk shpëtoi dot nga një sërë dukurish që, fatkeqësisht, shoqërojnë këtë rend shoqëror, si trafiqet e ndryshme të drogës, të të miturve, prostitucionit, armëve, klandestinëve etj., të cilat në pjesën më të madhe realizohen në bashkëpunim ndërmjet dy a më shumë personave, dhe jo rrallë me ndihmën e shtetasve të huaj kur vepra penale kryhet edhe në territorin e atij shteti. Siç dihet, kriminaliteti është një fenomen kompleks dhe mjaft heterogjen, si për nga format e paraqitjes, ashtu edhe nga shkaqet që e përcaktojnë atë. Sjelljet kriminale janë të shumëllojshme, siç janë të tilla edhe marrëdhëniet shoqërore dhe të mirat materiale të cilat shkelen, mohohen apo cenohen nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Një ndër format më të hasura dhe më të rrezikshme të sjelljes kriminale në shoqërinë e sotme është i ashtuquajturi kriminalitet profesional dhe i organizuar. Ky kriminalitet quhet profesional, pasi atë e kryejnë persona të cilët merren rregullisht me aktivitet kriminal, i cili atyre iu është kthyer në profesion dhe mjeshtëri e përhershme. Nga kjo veprimtari e paligjshme këta persona realizojnë të ardhura e përfitime të konsiderueshme. Marrja me këtë

aktivitet kriminal është orientimi i përhershëm dhe deviza e vetme e tyre. Në kryerjen e veprave penale këta persona tregojnë një zell të madh, përkushtohen në mënyrë të konsiderueshme dhe ndjejnë një kënaqësi të veçantë. Ata përgjatë veprimtarisë së tyre përsosin mënyrat, metodat dhe mjetet e kryerjes së veprave penale, deri në perfeksion duke vështirësuar ndjekjen, zbulimin dhe kapjen e tyre, si dhe dokumentimin e fiksimit e provave dhe gjurmëve të kryerjes së veprës penale. Një pjesë e madhe e kriminelëve profesionistë përfshihen në aktivitete të krimit të organizuar, duke kontribuar me eksperiencën e tyre në kryerjen e veprimeve në forma të veçanta të bashkëpunimit.

Shprehja “*krim i organizuar*”, për shumë njohës apo studiues të ligjit mund të duket se nuk ka nevojë për ndonjë shpjegim të veçantë, sepse kuptimi i saj, në momentin e parë, eventualisht perceptohet dhe duket mjaft i qartë. E megjithatë, edhe në kuptimin terminologjik, nuk është e thjeshtë të arrihet në një përkufizim të saktë dhe koherent për këtë dukuri, si në kuadrin e një shteti të vetëm, ashtu edhe në kuadrin ndërkombëtar. Nga ana tjetër, ky përkufizim merr rëndësi të veçantë për sa i përket saktësisë apo përpikërisë, kur shihet në raport me përkufizimet juridike të veprave të tjera penale të lidhura me momente specifike të organizimit kriminal. Kemi të bëjmë me probleme të ngjashme, të cilat nuk mungojnë edhe në sektorët e tjerë të disiplinuar të sociologjisë dhe shkencave të përafërta.

Nuk ekziston një model unik i krimit të organizuar, por disa modele që mbështeten në strukturimin e tij sipas tipit të kulturës dhe historisë së vendit, në të cilin ai ka hedhur rrënjë. Në përgjithësi, krimi i organizuar paraqet një lloj përkulshmërie, në kuptimin se përshtatet me nevojat e ndryshimit e ekonomisë dhe institucioneve politike e sociale të vendeve ku ai vepron. Kjo nuk përjashton që, në të njëjtën kohë, t'i kushtëzojë dhe nënshtrojë ato deri në fund, bile deri në kufij ekstreme. Mendojmë se duhen adoptuar përkufizime të artikuluar, komplekse, të hapura dhe pluraliste që përpunohen në gjirin e të ashtuquajturave “komisione ndërkombëtare”, ku realitete të ndryshme dhe pikëpamje të kundërta, ballafaqohen në kërkime (jo gjithmonë produktive), për emërues dhe kritere të përbashkëta. Përpunime nga më të fundit (ndoshta edhe më e avancuara) mbeten ato të bëra në Konferencën Ministrore Botërore “Mbi krimin transnacional”, të organizuar në Napoli nga 21 deri në 23 nëntor 1999; ato të pranuar në majin e vitit 1993 nga grupi i punës *ad hoc* “Për krimin e organizuar ndërkombëtar”, që ishte krijuar shtatorin e vitit 1992 nga ministrat e drejtësisë dhe të brendshëm të Komunitetit Evropian, për dhënien e një përkufizimi juridik dhe bashkëpunimin në aspektin represiv dhe më në fund

përkufizimet e dhëna në Konventën e OKB-së, nënshkruar në Konferencat e Vjenës dhe Palermos, në vitin 2000.

Në aktet përfundimtare të këtyre takimeve, vihej në dukje se shprehja “krim i organizuar” për shumë kohë, kishte qenë burim i polemikave dhe kontradiktave, herë - herë të detyrueshme, për të përkufizuar këtë dukuri në rajone të ndryshme të botës. Megjithatë, grupet e punës kishin arritur në një “marrëveshje” mbi karakteristikat e domosdoshme dhe esenciale, për identifikimin e tij, duke arritur në këtë përkufizim: *“Organizimi kriminal është para së gjithash, një bashkësi personash që bashkëpunojnë (në shoqëri) për t’iu dedikuar veprimtarive kriminale në një mënyrë pak a shumë të qëndrueshme. Ata reagojnë në formën e një sipërmarrje, administrojnë pasuri dhe shërbime të paligjshme, por edhe të ligjshme, që megjithatë, janë fituar nëpërmjet mënyrave të paligjshme (vjedhjeve, rrëmbimeve e mashtrimeve).”*

Në doktrinë ndeshen përkufizime të ndryshme të nocionit “krim i organizuar”. Kështu, nga aspekti i trajtimit penalo-juridik të pjesëmarrjes së organizuar të shumë personave në një vepër penale, krimi i organizuar konsiderohet si: *“Kryerja e veprave penale nga ana e organizatës kriminale për të realizuar përfitime ose fuqi (pushtet), me anë të përdorimit të forcës ose me anë të shfrytëzimit të pozicionit të posaçëm në shoqëri, me zvogëlimin e rrezikut nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme ekonomike, politike dhe aktivitete të tjera dhe me një sistem të krijuar më parë të mbrojtjes nga ndjekja e organeve shtetërore të zbatimit të ligjit.”.*

Një përkufizim të ngjashëm të “grupit të organizuar kriminal” na jep edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, në pikën “a”, të nenit 2 të saj, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8920, datë 11.07.2002, që përcakton: *“Grup kriminal i organizuar” nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.”.* I njëjti instrument ndërkombëtar në nenin 2/c bën përkufizimin e një lloji tjetër të veçantë bashkëpunimi të cilësuar, që paraqet rrezikshmëri me të pakët shoqërore, “grupin e strukturuar kriminal”, i cili përcaktohet si: *“... një grup që nuk është formuar në mënyrë të rastësishme për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësimit në të ose të ketë një strukturë të zhvilluar.”.*

Kjo konventë jep edhe përkufizimin e “krimit serioz”, duke quajtur të tillë: “... atë akt që përbën një veprë penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.”.

Sipas konventës një krim ka natyrë ndërkombëtare, kur: 1-kryhet në më shumë se një Shtet; 2-kryhet në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një shtet tjetër; 3-kryhet në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një Shtet dhe 4-kryhet në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.

Ky krim quhet i organizuar pasi kriminelët profesionistë gjatë kryerjes së aktiviteteve kriminale i planifikojnë dhe i bashkërendojnë ato në mënyrë të veçantë. Për këtë qëllim ata mbështeten në shoqëri, shoqata apo persona të tjerë juridikë grupe të themeluara më parë apo të krijuara rishtazi, të cilat nga pikëpamja formale merren me aktivitete të lejuara dhe të ligjshme dhe shpesh janë të regjistruara rregullisht për aktivitetet që kryejnë. Për të realizuar qëllimet e saj, organizata kriminale, nga ana objektive vepron me veprime aktive të kundërligjshme, duke përdorur forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimin dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarive ekonomike, të koncesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike, për të realizuar përfitime ose avantazhe të padrejta për vete a personat e tjerë ose për të ndaluar a penguar ushtrimin e lirë të së drejtës së votës gjatë fushatave zgjedhore, si dhe veprimtarive të tjera të ngjashme me to.

§ 3. Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe zbatimi i saj në Shqipëri.

Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” iu imponon shteteve që e kanë ratifikuar atë, që të bëjnë pjesë të legjislacionit të brendshëm penal dhe t’i përcaktojnë si vepra penale të dënueshme, duke përfshirë parandalimin dhe hetimin e tyre, veprat penale të:

- pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar;
- pastrimin e të ardhurave që rrjedhin nga krimi;
- korrupsionin;
- veprimet që pengojnë zbatimin e drejtësisë;
- veprat penale serioze, që dënohen jo më pak se katër vjet burgim.

Në zbatim të përcaktimeve të formave të organizuara të kryerjes së veprave penale që përcakton kjo konventë, Kodi ynë Penal ka sanksionuar si forma të veçanta bashkëpunimi (neni 28, i ndryshuar):

1. Organizatën kriminale, duke e përcaktuar atë si formën më të lartë të bashkëpunimit, në të cilin bëjnë pjesë të paktën tre anëtarë dhe që ka si karakteristikë të saj shkallën e veçantë të organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë e kohëzgjatjes, që krijohet me synim kryerjen e një a më shumë veprave penale dhe me qëllim realizimin e përfitimeve materiale dhe jomateriale.

2. Organizatën terroriste, duke e përkufizuar atë si një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë dhe që kanë si qëllim kryerjen e veprave me qëllime terroriste, që synojnë kryerjen e veprimeve të dhunshme për qëllime terroriste, si përmbysje të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe të pasigurisë në masë etj.

3. Bandën e armatosur, që e përcakton si formë të veçantë bashkëpunimi që ka si karakteristikë se anëtarët e saj zotërojnë armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, me të cilat synon të kryejë veprat penale që cenojnë pavarësinë dhe rendin kushtetues, marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe veprat penale për qëllime terroriste, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupin e strukturuar kriminal, që e përkufizon si formë të veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë të paktën tre anëtarë, që krijohet për kryerjen e një a më shumë veprave penale, me qëllim realizimin e përfitimeve materiale dhe jomateriale. Sipas Kodit Penal, grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprave penale nuk formohet në rrethana rastësore dhe nuk është e nevojshme të karakterizohet nga anëtarësia e qëndrueshme, ndarja e detyrave, organizimi dhe një strukturim i zhvilluar.

Nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal përcaktojnë si vepra penale të dënueshme krijimin, pjesëmarrjen dhe kryerjen e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar, duke përcaktuar masa dënimi të konsiderueshme, të cilat rriten nëse provohet që organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë apo lëndë shpërthyesë apo kur provohet që të ekzistenca e ndërmarrjeve (shoqërive) të kontrolluara nga pjesëtarët e organizatës, të cilat financohen tërësisht apo pjesërisht me produkte të veprave penale.

Në zbatim të detyrimeve që vendos Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, Kodi Penal shqiptar parashikon si veprë penale të dënueshme:

1. “pastrimin e produkteve të veprës penale” (neni 287) dhe “çeljen e llogarive anonime” (neni 287/a);

2. “korrupsionin aktiv në sektorin privat” (neni 164/a); “korrupsionin pasiv në sektorin privat” (neni 164/b); “korrupsionin aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike” (neni 244); “korrupsionin aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë” (neni 245); “korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” (neni 259); “korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë” (neni 260); “korrupsionin aktiv të dëshmitarit; ekspertit dhe përkthyesit” (neni 312); “korrupsionin aktiv të gjyqtarit; prokurorit etj.” (neni 319) dhe “korrupsionin pasiv të gjyqtarit; prokurorit etj.” (neni 319/a);

3. “vrasja e gjyqtarit; prokurorit etj”; (neni 79/c); “kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit” (neni 316); kanosja e gjyqtarit (neni 317); “kanosja për të mos kallëzuar” (neni 311) dhe “kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë” (neni 312/a).

§ 4. *Krimi i organizuar dhe politika.*

Studimet kriminologjike kanë përcaktuar një lidhje të fortë varësie ndërmjet pasigurisë politike të një vendi dhe lindjes, zhvillimit, konsolidimit e forcimit të krimit të organizuar. Kuptohet që mungesa apo brishtësia e strukturave të një shteti përbën një shtrat të mirë për rritjen e aktivitetit kriminal në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti. Përgjatë këtyre viteve të tranzicionit shteti ynë është përballur jo rrallë me situata të paqëndrueshme politike dhe sociale, të cilat kulmin e arritën në pranverën e vitit 1997 ku thuhetse të gjitha strukturat shtetërore pushuan së ekzistuari dhe për një kohë jo të shkurtër vendi u përfshi nga kaosi dhe pasiguria totale. Të gjitha këto situata politike, të shoqëruara me mungesën e kontrollit të kufijve dhe mosushtrimin e autoritetit të shtetit në të gjithë territorin, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e kriminalitetit të organizuar në Shqipëri dhe bashkëpunimin e tij, sidomos me kriminalitetin e vendeve fqinjë. Kjo situatë dalëngadalë ka filluar të ndryshojë dhe tashmë vendi ynë është një vend relativisht i konsoliduar politikisht, por pasojat e destabilitetit politik do të vuhën nga ekonomia dhe populli për një kohë ende të gjatë.

Një problem tjetër në të cilën është përfshirë një pjesë e klasës politike shqiptare është edhe lidhja e saj me kriminalitetin e organizuar. Hetimi dhe gjykimi i veprave penale që lidhen me krimin e organizuar shqiptar, sidomos jashtë Shqipërisë, ka nxjerrë në pah disa raste edhe emrat politikanësh jo pak të njohur, të cilët në rastin më të mirë iu kanë siguruar mbrojtje e favore kriminelëve, sigurisht kundrejt shpërblimit dhe “mirënjohjes bujare” të tyre, dhe në rastin më të keq përfshirja e tyre në këtë aktivitet kriminal, në rolin e bashkëpunëtorit. Ka qenë pozita e lartë zyrtare dhe politike e ndonjë personi që i ka detyruar në ndonjë rast autoritet gjyqësore të ndonjë vendi evropian që të mos i përgjigjen kërkesës për ndihmë juridike në fushën penale të organeve tona të hetimit dhe gjykimi, duke e argumentuar mosdhënien rrugë të letërporosisë me mosbesimin që kishin ato autoritete se këta persona të implikuar do të viheshin përpara përgjegjësisë penale.

Duke e trajtuar këtë problem në një rrafsh të përgjithshëm konstatohet se trazirat politike, lindja e konflikteve, (që kohët e fundit kanë përfshirë shtete të ndryshme), kanë “ofruar” për krimin e organizuar; kushte të favorshme për përfitime. Në veçanti nënvizohen lëvizje të mëdha dhe të vogla të emigracionit. Grupet etnike minoritare, herë herë edhe pse nuk janë futur mirë në qelizat shoqërore të shtetit që i pranon, krijojnë për elitat kriminale të vendeve të origjinës terrene pjellore për rekrutimin e krahut të punës (besnike dhe të heshtura, solidaritet etnik). Në mënyrë analoge; në nivelin e raporteve ndërmjet vendeve të pasura dhe botës së tretë apo të katërt, disa nga këto organizime kriminale priren të legjitimohen përballë bashkëkombësve të tyre, duke u prezantuar në funksion dhe me një optikë anticolonialiste, si protagoniste esenciale të një zhvillimi ekonomik padrejtësisht të kufizuar dhe të vonuar. Është një strategji e thjeshtë për t'u vënë në jetë dhe, ndonjëherë ia arrijnë të fitojnë, në se kanë ndihmën e disa politikanëve apo funksionarëve në marrëveshje të fshehta me ta.

Krimi i organizuar është i aftë të veprojë dhe të minojë i pashqetësuar, vetë bazat e jetesës shoqërore. Ai futet në pikat më të dobëta të organizimit shtetëror, nëpërmjet korrupsionit të funksionarëve në sektorë dhe nivele të ndryshme, duke përfituar nga të ashtuquajturat zona gri, që kanë të bëjnë me paligjshmërinë që mbizotëron si pasojë e mungesës së kontrollit që ekzistojnë në këto komunitete (duke shfrytëzuar të çarat që vijnë nga plagët e emigracionit, varfërisë, mungesës së zhvillimit). Kjo dukuri ka ngjallur mjaft debate edhe në vendet më të zhvilluara, duke u shndërruar, kështu, në një diskutim të vlefshëm edhe mbi planin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërmjet shteteve të pasura dhe të varfra.

Krimi i organizuar, duke përfituar nga korruptimi i zyrtarëve shtetërorë, në jo pak raste arrin të fitojë tendera, që prokurojnë fonde publike, në sektorë jetikë dhe kyç të shoqërisë, duke sjellë jo vetëm fuqizim të tyre, por edhe një rrezik potencial për interesat shtetërorë e ata publikë që mund të vihen në diskutim apo të cenohen nga ndonjë veprim apo mosveprim kriminal i këtyre personave. Nga rruga e sipërmarrjeve publike, më pas, helmimi arrin në sektorin e administrimit publik dhe institucionet politike, nëpërmjet formave të ndryshme të korrupsionit të mundshëm, në terrene të tilla si, financime për politikanë dhe funksionarë për të nxjerrë përfitime, marrje autorizimesh të ndryshme, shkëmbim votash, shantazhe, oferta mbrojtje etj. Praktika ka vërtetuar skandale nga më të ndryshmet, të cilat e kanë bërë dhe e bëjnë të dukshme prezencën e këtyre lloj raportesh ndërmjet politikës dhe krimit. Është e domosdoshme, megjithatë, të ripërsëritet që ky aspekt shqetësues, vë në rrezik në fund të fundit, një administrim të mirë të demokracisë. Vetëm institucione të konsoliduara dhe në koordinim ndërmjet tyre, me fjalë të tjera një shtet efikas, vetëm norma ligjore të zhdërvjellëta dhe të zbatueshme, mund të garantojnë evitimin e këtyre dukurive negative.

§ 5. *Krimi i organizuar dhe ekonomia.*

Sot krimi i organizuar ka fituar në mënyrë të stabilizuar një dimension transnacional. Një gjë e tillë, nuk do të thotë domosdoshmërisht se të gjitha grupimet e krimit të organizuar veprojnë në këtë shkallë. Normalisht ekzistojnë raporte gjithnjë e më të ngushta dhe të frekuentuara ndërmjet trafikëve dhe veprimtarive kriminale të një vendi dhe atyre të vendeve të tjera, pasi organizimet kriminale synojnë gjithnjë e më me interes drejt tregjeve që janë përtej kufijve. Nga ana tjetër një përfundim i tillë nuk është absolutisht një gjë e re. Të mendojmë që edhe më parë, pa këto mjete komunikacioni që janë sot, ushtrohej kontrabanda pa “respektuar” kufijtë, veprimtari kjo e konsideruar si nga më antikët në botë.

Nuk është vetëm për arsye të tregut që krimi i organizuar ka tejkaluar kufijtë kombëtarë. Një gjë e tillë, së pari bëhet për të garantuar një siguri maksimale, për të evituar masat represive të shteteve të ndryshme, duke stabilizuar bazat e tyre në territoret ku veprimi kontrollues i autoriteteve të policisë dhe financave është më i butë, legjislacioni më i favorshëm apo funksionimi i aparatit gjyqësor më i dobët. Kjo nuk ndalon, përkundrazi, lejon me tërë qetësinë, zhvillimin e afereve në zona ku veçanërisht sigurohen të ardhura dhe fitime maksimale.

Multinacionalet e krimit kërkojnë të çlirojnë në maksimum lirinë e veprimeve, duke pakësuar në minimum efektet e kontroleve nacionale dhe internacionale. Sipërmarrjet legale kërkojnë ose janë të detyruara të nënshkruajnë marrëveshje me qeveritë e vendeve, në të cilat veprojnë duke pranuar detyrime relative (taksa, kontrole, autorizime). Megjithatë përjashtimisht, në aktivitetin e tyre, kryejnë edhe veprime që përbëjnë shkelje të normave ligjore (korrupsion dhe mashtrime). Në të kundërt, për organizimet kriminale ky përjashtim është rregull edhe pse veprimtaritë e paligjshme lidhen (për shkaqe të mbulesës ose të qarkullimit të parave) me veprimtari dhe me investime në ambientet legale.

Revolucioni në transport dhe i komunikimit, depërtueshmëria e kufijve nacionalë, liberalizimi dhe ndërkombëtarizimi i rrjeteve tregtare dhe financiare, krijuan terrenin ideal për internacionalizimin e sipërmarrjeve, edhe të atyre kriminale. Nga njëra anë ishte veçanërisht mekanizmi financiar i këmbimeve, që varet nga valuta të forta dhe mundësia për të transferuar para me rrugë elektronike, që favorizuan lehtësimin dhe shpejtësinë e transaksioneve ekonomike ndërkombëtare, por një gjë e tillë, nga ana tjetër, krijoi vështirësi të dukshme për vende të ndryshme dhe qeveritë e tyre, në drejtim të kontrollit të lëvizjes së kapitalit: fshehjes ose qarkullimit të parave me prejardhje të paligjshme.

Realiteti në fakt është shumë shqetësues. Është një e vërtetë e padiskutueshme që veprimtaritë kriminale, (për më tepër të “ndihmuara”), vonojnë dhe pengojnë në mënyrë të fuqishme zhvillimin ekonomik e civil të vendeve të varfra, por dhe realizojnë goditje pas shpine me dëme të dukshme për vendet industrializuara dhe të avancuara. Sot asnjë shtet nuk mund të mendojë se është i imunizuar nga efektet e kobshme të veprimtarive të këtyre organizimeve kriminale. Nuk mundet më që krimi i organizuar të konsiderohet thjesht një problem i rendit publik, nga momenti që ai kërcënon normalitetin social, pavarësinë, integritetin e institucioneve financiare dhe funksionimin e demokracisë.

Studimi numëron dhe përshkruan kostot për kolektivat që përcaktohen nga ekonomia kriminale:

- efektet negative që rrjedhin nga përdorimi i të ardhurave të paligjshme (mendohet, p.sh. dëmet për shëndetin nga helmimi i drogës);
- humbjet e të ardhurave në favor të shtetit, për shkak të ushtrimit të kontrabandës dhe për financimin e aktiviteteve në kombëtare;
- humbjet e konsumatorit, sepse pasuritë e paligjshme shiten me çmime më të larta nga ato të tregut normal;

- dëmet që vijnë nga penetrimi kriminal në veprimtaritë e ligjshme, me ndikim të pakontrollueshëm mbi dinamikën e tregut, p.sh. mbajtja e ndërmarrjeve jorentabël dhe vendosja e gjobave për bizneset e ligjshme.

Edhe në ato raste, kur nëpërmjet qarkullimit (riciklimit), krimi i organizuar hyn me kapitalet e veta në kuadrin ligjor, ai mbetet përsëri një faktor me forcë të madhe helmuese, pasi ai efektivisht:

- krijon efekte disekuilibri mbi tregun financiar, duke prodhuar inflacion të pakontrolluar;
- indukon gjithë sistemin bankar dhe të bursës për të shkelur rregullat;
- futet në mënyrë masive mbi tregun e investimeve dhe të sipërmarrjeve, pa respektuar parimet e një konkurrence ligjore.

§ 6. Disa mendime për luftën kundër krimin të organizuar.

Kohët e fundit, si pasojë e rritjes së nivelit të punës të organeve të policisë, shërbimit informativ, financave, prokurorisë dhe gjykatave, janë konstatuar një sërë arritjesh në luftën kundër krimin në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti. Janë goditur një sërë organizatash e bandash të ndryshme kriminale, janë zbuluar, arrestuar dhe dënuar individë të ndryshëm që ushtronin trafikun e klandestinëve, të drogës, armëve, prostitucionit, janë shënuar një sërë bashkëpunimesh të frytshme me policinë dhe autoritetet gjyqësore italiane, greke, zvicerane, amerikane etj. Megjithatë, jo rrallë dëgjohen edhe zëra kritikë në drejtim të forcave të rendit, prokurorisë dhe gjykatave. Në se konstatohen veprime të shkëputura që lidhen me neglizhenca, mungesë profesionalizmi dhe më tej akoma, raste të pandershmërisë në kryerjen e detyrës, krahas dënimit të tyre me forcë, duhet të jemi të vëmendshëm që një gjë e tillë të mos kthehet në një pretekst për të eliminuar gjithçka është arritur dhe për t'i delegjitimuar ato.

1. Lufta kundër krimin të organizuar nuk përfundon me inkriminimin e organizatës kriminale. Shumë legjislacione evropiane, përfshi edhe vendin tonë, kanë bërë ndryshime në ligjet e tyre penale materiale dhe procedurale, duke pranuar konceptin e *belum justum*: ashpërsimin e masave të dënimit, zgjerimin e kompetencave të organeve të policisë dhe përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit, përgjimit dhe komunikimeve të të gjitha llojeve etj.

2. Disa nga aspektet themelore, ku organet shtetërore të ngarkuara të ngarkuara posaçërisht, duhet të luftojnë kundër krimin të organizuar kanë të

bëjnë sa me zbulimin dhe goditjen e grupeve kriminale, aq edhe me individualizimin dhe konkretizimin e pasurive të tyre. Arrihet në këto përfundime, sepse sot krimi i organizuar, si në kuadrin nacional ashtu edhe në atë internacional e transnacional, vepron si një sipërmarrje me të gjitha parametrat përkatës, duke shfrytëzuar specialistë të afirmuar, sidomos në fushën financiare. Qëllimi final i këtyre sipërmarrjeve kriminale është rritja e fitimeve, pasurive të luajtshme e të paluajtshme, pasi këto fitime, këto pasuri, janë edhe baza reale e fuqisë së tyre.

3. Me shumë interes në favor të kësaj lufte do të ishte nxjerrja dhe zbatimi i akteve normative të zhdërvjellëta, që do të lejonin sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të tilla me prejardhje të paligjshme. Një gjë e tillë, individëve dhe grupimeve kriminale do t'u shkaktonte goditje vdekjeprurëse në pikat e tyre më të dobëta.

4. Transparenca e bankave, një legjislacion më i ashpër mbi veprimtaritë financiare, mund të kthehen në armë të fuqishme për të goditur krimin e organizuar dhe interesat e tij - paratë. Nga ana tjetër, në se krijohen instrumente më të mira për të zbuluar apo nxjerrë në dritë kapitalet e paligjshme, këto instrumente mund të përdoren edhe për të luftuar evazionin fiskal, ose të tjera çështje të paligjshme. Pikërisht për këtë, rezistencat ndaj një legjislacioni më të rreptë në fushën bankare dhe monetare, mund të jenë të mëdha.

5. Në këtë kuadër janë të gjitha mundësitë për të venë në jetë instrumentet e nevojshëm për të parandaluar shpërndarjen e mëtejshme të veprimtarisë kriminale në fushën ekonomike. P.sh. mund të arrihet të kontrollohet që në një qytet rriten apo jo transaksionet në *cash* (paguhet në *cash* kur nuk dëshirohet të lihen gjurmë të parave). Po ashtu mund të analizohen të dhënat e marra nga dhoma e tregtisë për të parë në se vërehet një rritje e dukshme e shoqërive tregtare të vogla, të cilat mund të jenë një simptomë e vendosjes kriminale nëpërmjet përdorimit dhe akaparimit të shoqërive.

6. Një politikë e dobishme mund të jetë ajo e stimulimit dhe e mospengimit të shpërndarjes së instrumenteve të pagesave nominative, si: çeqe, kartë krediti, urdhërxhirime etj. Në fakt praktika të tilla kanë filluar të aplikohen dhe ato janë për t'u përshëndetur. Në se transaksionet nominative bëhen një rregull, atëherë do të jetë shumë më e thjeshtë të bëhen verifikimet fiskale, në lidhje me paratë që konsumohen.

7. Një tregues i rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar ka të bëjë me rritjen e profesionalizmit të atyre që merren me luftën kundër krimit, të punonjësve të rendit, financave, prokurorisë dhe gjykatave.

Pa dashur të lemë mënjanë arritjet dhe pa dashur të analizojmë në detaje këtë problem, mund të parashtrihen disa konsiderata të përgjithshme. Ka ardhur koha që organet e policisë të mos e matin punën dhe arritjet e tyre vetëm me “zbulime”. Dëgjojmë shpesh të thuhet nëpër mediat e ndryshme apo në konferencat e shtypit, se u kapën apo u zbuluan aq dhe kaq vepra penale, individë apo grupe individësh kriminelë. Deri këtu mirë, por më tej çfarë ndodh? Nuk janë të pakta rastet, që realizohet zbulimi i veprës penale apo autorit të saj dhe nuk shoqërohet një gjë e tillë me zbatimin e respektimin e procedurave përkatëse ligjore, me plotësimin dhe dokumentimin e nevojshëm të praktikës përkatëse që shoqëron këtë zbulim e kështu me radhë. Neglizhenca dhe mungesa e profesionalizmit në këto drejtime, sjell pasoja mjaft negative. Ato krijojnë kushte të favorshme që individët apo e grupet e individëve të prezumuar si autorë të veprave penale, të evitojnë goditjen e ligjit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për organin e akuzës prokurorinë. Nuk janë të pakta edhe këtu rastet e neglizhencave, mangësive profesionale, etj. Vërehen zvarritje në procedime, të cilat sjellin për pasojë kalimin e afateve ligjore që kanë të bëjnë me masat e sigurimit dhe më gjerë. Gjithashtu janë minimale rastet kur organi i akuzës shkon tej konstatimeve dhe zbulimeve të bëra nga ana e organeve të policisë dhe atyre financiare. Mangësi vërehen edhe në punën e gjykatave. Konstatohen edhe këtu zvarritje të dukshme të gjykimeve, mungesë profesionalizmi etj.

8. Bashkëpunimi ndërkombëtar për të bërë të mundur kufizimin e të ashtuquajturave “*parajsa fiskale*”, në ato vende që lejojnë paratë me prejardhje të paligjshme (të pista) të tranzitohen nëpërmjet llogarive sekrete në bankat e tyre lokale. Parajsat fiskale përdoren nga organizimet kriminale, për të bërë të mundur humbjen e gjurmëve të parave të tyre, duke kufizuar kështu mundësitë e hetimeve. Janë bërë propozime kohët e fundit që ndaj vendeve që krijojnë dhe lejojnë brenda tyre parajsa fiskale, të aplikohen sanksione tregtare. Problemi është që sanksione të tilla, për të qenë efektive, do të duhet të mbështeten nga shumë vende.

AMARILDO LAÇI

Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Tiranë

Tiranë, Nëntor 2007

2.5. Ndëshkimi i fenomenit të korrupsionit në Shqipëri pas ndryshimeve të fundit të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale.

§ 1.

Korrupsioni është një fenomen negativ i shoqërisë i cili parandalon rritjen ekonomike, rrezikon stabilitetin financiar dhe dobëson aftësitë e Shtetit për të siguruar të mirat e nevojshme.

Korrupsioni dekurajon bizneset e rregullta, shkatërron klasën e mesme dhe bën të vështirë tërheqjen e investimeve të huaja. Nga ana tjetër korrupsioni deformon karakterin e njeriut, duke dëmtuar integritetin moral të tij. Në qoftë se japim një përkufizim teorik të nocionit “korrupsion” do të kishim:

“Korrupsioni është mitmarrja dhe çdo lloj sjellje tjetër që lidhet me persona të veshur me përgjegjësi në sektorin publik dhe privat, e cila dhuron detyrat që burojnë nga statusi i tyre si zyrtarë publik, nëpunës privat, agjent të pavarur, ose marrëdhënie të tjera të këtij lloji, me qëllim për të përfituar avantazhe të pamërituara të çdo lloji për veten e tyre ose për të tjerët.”

Fushat në cilat ekziston risk i lartë për korrupsion janë shumë, por më kryesoret mund të përmendim:

1. Licencimi, lejet dhe autorizimet për të ushtruar aktivitete të ndryshme.
2. Mbledhja e taksave dhe tatimeve.
3. Shpenzimet publike.
4. Financimi i partive politike.

Ndërsa drejtimet kryesore për forcimin e luftës kundër korrupsionit janë:

1. Forcimi i punës për zbatimin e ligjit.
2. Përsosja e sistemeve dhe mekanizmave ekzistues shtetëror në drejtim të shmangies të elementëve që favorizojnë korrupsionin.
3. Rritja e edukimit dhe e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit.

Duke parë drejtimet e paraqitura më sipër rezulton se drejtimi i tretë realizohet nga struktura të administratës shtetërore dhe nga shoqëria civile. Drejtimi i dytë realizohet nga pushteti ekzekutiv (Këshilli Ministrave) dhe ai legjislativ (Kuvendi). Ndërsa drejtimi i tretë realizohet nga organet e kontrollit financiar, ato ndjekjes penale dhe të drejtësisë.

Forcimi i punës për zbatimin e ligjit është një nga drejtimet kryesore të luftës kundër fenomenit të korrupsionit. Për këtë qëllim në fund të vitit 2004 është miratuar një paketë ligjore për ndryshime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Këto ndryshime prekin kryesisht fenomenin e korrupsionit në drejtim të përcaktimit më të qartë të veprës penale, si dhe në drejtim të përcaktimit të mjeteve dhe metodave speciale të hetimit në ndihmë të mbledhjes së provave dhe arritjes së provueshmërisë së kësaj vepre penale.

Aktualisht në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ekzistojnë njëmbëdhjetë dispozita penale, që parashikojnë fenomenin e korrupsionit si të dënueshëm penalisht. Dispozitat e Kodit Penal që parashikojnë korrupsionin janë:

Neni 259

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga 2 deri 8 vjet dhe me gjobë nga 500.000 deri 3.000.000 lekë.

Neni 260

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë.

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga 4 deri 12 vjet dhe me gjobë nga 1.000.000 deri 5.000.000 lekë.

Neni 244

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo premtimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet dhe me gjobë nga 300.000 deri 1.000.000 lekë.

Neni 245

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë.

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetëror ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga 1 deri 5 vjet dhe me gjobë nga 500.000 deri 2.000.000 lekë.

Neni 245/1

Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtun ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptar ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, përbejnë vepër penale dhe dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet dhe me gjobë nga 300.000 deri 1.000.000 lekë.

Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 500.000 deri 2.000.000 lekë.

Neni 164/a

Korrupsioni aktiv në sektorin privat

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që ushtron funksione drejtuese në shoqëri tregtare ose punon në çdo pozicion në sektorin

privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën ose funksionin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë deri në një milion lekë.

Neni 164/b

Korrupsioni pasiv në sektorin privat

Kërkimi a marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt a i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në tre milion lekë.

Neni 312

Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tretë, dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit, për të siguruar deklarime ose dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrimeve të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohen me burgim deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 500.000 deri 2.000.000 lekë.

Neni 319

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga 1 deri 4 vjet dhe me gjobë nga 400.000 deri në 2.000.000 lekë.

Neni 319/a

Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimit i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim

që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga 3 deri në 10 vjet dhe me gjobë nga 800.000 deri në 4.000.000 lekë.

Neni 328

Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve

Ofrimi ose dhënia e të hollave, bërja e premtimeve për vende pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, me qëllim që të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit, për të votuar pro ose kundër një kandidati apo për të marrë pjesë ose jo në votime, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj.

Pranimi i të hollave, premtimeve dhe favorizimeve të tjera për të kryer veprimet e mësipërme, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Duke vlerësuar dispozitat e Kodit Penal, të paraqitura më sipër, rezulton se të gjitha janë miratuar më ligjin Nr.9275 datë 16.09.2004 (me përjashtim të nenit 328 të Kodit Penal).

Në krahasim me dispozitat e vjetra të Kodit Penal, konstatohet se kemi një rritje të numrit të dispozitave që parashikojnë korrupsion si të dënueshëm penalisht; kemi përdorim të termit “korrupsion”, në vend të mitmarrje dhe mitdhënie që kishim më parë; kemi ndarje më të qartë sipas subjekteve në private dhe shtetërore, po kështu dhe brenda të njëjtit grup subjektësh; parashikohet për herë të parë korrupsioni në sektorin privat; kemi një përshkrim të detajuar të mënyrës së kryerjes së korrupsionit; në përgjithësi parashikohen masa më të rënda dënimi.

Në përgjithësi mund të thuhet se ndryshimet e Kodit Penal, të miratuara në shtator 2004, kanë futur koncepte të reja në lidhje me korrupsionin si vepër penale.

§ 2. *Disa komente në lidhje me subjektet e veprës penale, të parashikuar në dispozitat për korrupsionin.*

Në dispozitat e paraqitura më sipër parashikohen si subjekt i veprës penale persona fizik të cilët kanë status të ndryshëm shoqëror. Duke bërë një grupim të subjekteve mund të themi se subjekt i veprave penale të korrupsionit janë punonjës shtetëror, (nenet 259, 260 dhe 319/a të Kodit Penal); punonjës të sektorit privat (neni 164/b i Kodit Penal); dhe shtetas (nenet 164/a, 244, 245, 245/1, 312, 319 dhe 328 të Kodit Penal).

Punonjësi shtetëror si subjekt i veprës penale të korrupsionit parashikohet në nenet 259, 260 dhe 319/a të Kodit Penal.

Neni 259 i Kodit Penal ka si subjekt të veprës penale “personin që ushtron funksione publike”. Në Kodin Penal nuk ka një përkufizim të konceptit “person që ushtron funksione publike”. Edhe në aktet e tjera ligjore apo nënligjore në fuqi nuk gjejmë një përkufizim të qartë dhe të plotë të këtij koncepti. Funksionet publike kryhen si në sektorin shtetëror, ashtu dhe në sektorin privat. Në këto kushte, për efekt të zbatimit të dispozitave përkatëse të Kodit Penal, mendoj se mund të bëhet ndarja e subjekteve, sipas vendit ku ushtrojnë detyrën e tyre. Pra në rastet kur personi që ushtron funksione publike, ushtron detyrën në një institucion, apo ndërmarrje me kapital shtetëror dhe kur kryen korrupsion do të përgjigjet sipas nenit 259 të Kodit Penal.

Ndërsa në rastet kur personi që ushtron funksione publike, ushtron detyrën në sektorin privat dhe kur kryen korrupsion do të përgjigjet sipas nenit 164/b të Kodit Penal.

Një ndarje e tillë bëhet më e pranueshme po të analizojmë më hollësisht nenet 259 dhe 164/b të Kodit Penal. Neni 259 i Kodit Penal (njëlloj si dhe nenet e tjera ku parashikohet subjekti shtetëror) parashikon ndër të tjera “...personi që ushtron funksion publik për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij...”). Ndërsa në nenin 164/b kemi shprehjen “...personi që ushtron funksion drejtues ose punon në çdo pozicion në sektorin privat, për të kryer ose mos kryer një veprim në kundërshtim me detyrën a funksionin e tij...”).

Nga analiza e dispozitave rezulton se jemi para dy situatave të ndryshme. Neni 259 kërkon që veprimi të lidhet me detyrën a funksionin, ndërsa neni 164/b kërkon që veprimi të jetë në kundërshtim me detyrën a funksionin. Dhe ajo që është kryesorja, neni 164/b përdor shprehjen “në çdo pozicion në sektorin privat”, pra pavarësisht nëse kryen apo jo funksione publike, kur personi punon në sektorin privat dhe kryen korrupsion, do të përgjigjet sipas nenit 164/b të Kodit Penal.

Më e qartë është ndarja e subjekteve sipas neneve të tjera ku parashikohet korrupsioni.

Kështu subjekt i nenit 260 të Kodit Penal janë funksionarët e lartë shtetëror ose të zgjedhurit vendor. Në konceptin funksionar i lartë shtetëror futen dy kategori punonjësish. Në radhë të parë funksionarët politikë, ku përfshihen deputetët, Ministrat, stafet politike të tyre (këshilltarë dhe drejtues kabineti), drejtuesit e institucioneve qendrore të emëruar nga

Kuvendi apo Këshilli Ministrave. Së dyti përfshihen funksionarët e lartë shtetëror që parashikohen në Ligjin “Për shërbimin civil”. Këtu përfshihen sekretarët e përgjithshëm, drejtorët e departamenteve dhe drejtorët e përgjithshëm.

Ndërsa të zgjedhur vendor janë kryetarët e bashkive, komunave, anëtarët e këshillave bashkiake dhe komunale, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga populli.

Neni 319/a ka si subjekt të veprës penale të korrupsionit gjyqtarët, prokurorët, ose funksionarët e organeve të drejtësisë. Në konceptin gjyqtar përfshihen gjyqtarët e të gjitha llojeve, po kështu dhe për prokurorët. Ndërsa është e papërcaktuar qartë se çfarë do kuptojmë me “funksionarë të drejtësisë”. Mendoj se në këtë koncept mund të përfshihen sekretarët gjyqësor, sekretaria e prokurorive, kancelarët, apo dhe përmbaruesit. Megjithatë përderisa nuk ka një përkufizim të qartë të këtij koncepti, vlerësimi se kush do konsiderohet funksionar i organeve të drejtësisë është subjektiv dhe mbetet për t’u bërë rast pas rasti.

Në rastet e korrupsionit aktiv subjekt i veprës penale është çdo shtetas, pavarësisht nga funksioni apo detyra që kryen. Pra kushdo që propozon apo jep mitë, apo favore të tjera të parregullta është subjekt i veprës penale të korrupsionit aktiv. Ndarja në dispozitat përkatëse sipas neneve 164/a, 244, 245, 245/1, 312, 319 dhe 328 të Kodit Penal bëhet në varësi të faktit kush është pozicioni i personit që i propozohet ose jepet mita, apo përfitimi i parregullt. P.sh në rastin kur përfitimi i parregullt i jepet një personi që ushtron funksione publike në sektorin shtetëror do përgjigjet sipas nenit 244 të Kodit Penal. Në rastin kur përfitimi i parregullt i jepet një funksionari të lartë shtetëror apo të zgjedhuri vendor, atëherë do përgjigjet për nenin 245 të Kodit Penal, etj.

Në të gjitha nenet që parashikojnë korrupsionin si vepër penale dallojmë dy koncepte të reja, “korrupsion aktiv” dhe “korrupsion pasiv”. Këto dy koncepte, ashtu si dhe përkufizimi i veprave penale të korrupsionit, janë marrë nga Konventa Penale Kundër Korrupsionit e bërë në Strasburg në vitin 1999. Ndarja e këtyre dy koncepteve bëhet në varësi të faktit se jemi para marrjes së një përfitimi të parregullt nga ai që ushtron detyrën, apo jemi para dhënies së një përfitimi të parregullt nga një shtetas i caktuar. Korrupsion aktiv do të kemi në rastet kur një shtetas i caktuar premton apo jep një përfitim të parregullt një personi që ushtron një funksion të caktuar. Ndërsa korrupsion pasiv do të kemi në rastet kur një person që ushtron një detyrë të caktuar kërkon apo merr një përfitim të parregullt.

Duke analizuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si në rastet e korrupsionit aktiv, ashtu dhe në rastet e korrupsionit pasiv, konstatohet se për të konsideruar veprën penale të konsumuar, nuk është i nevojshëm konstatimi i të gjitha veprimeve të parashikuara në dispozitë njëkohësisht.

Në rastin e korrupsionit aktiv kemi disa situata. Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt apo tërthorazi. Secila prej këtyre situatave në vetvete duhet konsideruar si vepër penale e kryer. Kështu mjafton të jemi vetëm para premimit, vetëm propozimit apo vetëm para dhënies dhe kur plotësohen kushtet e tjera që kërkon dispozita do të kemi veprën penale të konsumuar.

Në rastin e korrupsionit pasiv përsëri kemi disa situata. Kërkimi, marrja, ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për vete apo për të tjerët. Edhe në këtë rast secila prej këtyre situatave në vetvete duhet konsideruar si vepër penale e kryer. Kështu mjafton të jemi vetëm para kërkimit, vetëm para marrjes, vetëm para pranimit dhe kur plotësohen kushtet e tjera që kërkon dispozita do të kemi veprën penale të konsumuar.

Ajo që është e përbashkët në të gjitha rastet e veprave penale të korrupsionit është shprehja “përfitim i parregullt”. Koncepti përfitim i parregullt përfshin përfitime materiale dhe përfitime jomateriale.

Neni 245/1 i Kodit Penal parashikon një situatë të ndryshme nga rastet e tipike të korrupsionit, pra raporti jep-merr ndërmjet dy palëve. Në rastin e nenit 245/1 parashikohet ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, pra korrupsioni i kryer nga ndërmjetësit, ose sekserët siç thuhet në gjuhën popullore.

Në paragrafin e parë parashikohet rasti kur një shtetas i caktuar kërkon që nëpërmjet një personi të tretë të ushtrojë ndikim të paligjshëm tek një person që ushtron funksion publik dhe për këtë i premton, propozon apo jep personit të tretë një përfitim të parregullt. Ndërsa në paragrafin e dytë parashikohet rasti kur një person i caktuar premton se do kryejë, ose kryen ndikim të paligjshëm tek një person që ushtron funksione publike në favor të një personi tjetër, i cili është në marrëdhënie me funksionarin publik për arsye të detyrës së tij.

Ajo që është e përbashkët për të dy paragrafët është se vepra penale konsiderohet e konsumuar edhe pa u ushtruar fare ndikimi i paligjshëm, apo pa ardhur pasoja e dëshiruar. Pra mjafton që personi të marrë përsipër ushtrimin e ndikimit të paligjshëm, apo mjafton që të kërkohet të kryhet ndikimi i paligjshëm, kur ekzistojnë kushtet e tjera të parashikuara në dispozitë dhe do kemi veprën penale të konsumuar.

§ 3. Metodatat speciale të hetimit dhe përdorimi i tyre në hetimin e rasteve të korrupsionit.

Kodi i Procedurës Penale parashikon dhe lejon përdorimin e metodave speciale të hetimit në rastin e hetimit të veprave penale të korrupsionit.

Përgjimi, kushtet dhe mënyra e kryerjes janë parashikuar në nenet 221 deri 226 të Kodit të Procedurës Penale. Duke ju referuar këtyre dispozitave rezulton se përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës lejohet në rastet kur hetohet për korrupsion të parashikuar nga nenet 259, 260 dhe 319/a të Kodit Penal. Ndërsa përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vend ndodhjes lejohen për rastet kur hetohet vepra penale e korrupsionit e parashikuara nga nenet 164/a, 164/b, 244, 245, 245/1, 259, 260 312, 319 dhe 319/a. Megjithatë duke ju referuar përcaktimeve të nenit 221, pika 3, germa “b” dhe “c” të Kodit të Procedurës Penale rezulton se mund të përdoret si përgjimi i bisedave private ashtu dhe përgjimi në ambientet publike në të gjitha rastet kur hetohet për veprat penale të korrupsionit. Kjo pasi pavarësisht se për kë merret leja e përgjimit (kufizimi për veprat që dënohen në maksimum jo më pak se 7 vjet burg) mund të përgjohen njëkohësisht me të dyshuarin kryesor edhe personi që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari (germa “b”), si dhe personi që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin (germa “c”). Në rastin e hetimit të veprave penale të korrupsionit gjithmonë kemi dy palë që transmetojnë komunikime me njëri tjetrin dhe që marrin pjesë në transaksione me njëri tjetrin.

Nga praktika e hetimit të rasteve të korrupsionit në dy vitet e fundit ka rezultuar se shtetas të ndryshëm, apo gazetarë kanë realizuar përgjime të bisedave, jashtë procedimit penal, duke dokumentuar rastet e korrupsionit të nëpunësve publik. Pyetja që shtrohet në këtë rast është se a duhet të vlerësohen si të rregullta këto përgjime dhe a kanë vlerën provës në një procedim penal për korrupsion.

Së pari duhet thënë se këto përgjime janë realizuar nga persona të ndryshëm (gazetarë apo shtetas të ndryshëm) në mënyrë private, pa u regjistruar më parë një procedim penal. Organet e ndjekjes penale, policia gjyqësore dhe prokuroria, nuk kanë dijeni dhe nuk kanë kryer asnjë veprim në lidhje me këto përgjime. Si të tilla ato nuk janë kryer sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale për mënyrën e marrjes së provave.

Por kasetat e përgjimit, në momentin që i vihen në dispozicion organeve të ndjekjes penale janë një dokument, si çdo dokument tjetër që duhet vlerësuar. Pra duhet hetuar në lidhje me vërtetësinë e tij dhe të fakteve dhe rrethanave që paraqiten në të. Në rastin kur provohet nga hetimet e kryera se faktet e paraqitura në përgjimet e kryera nga personat private qëndrojnë, janë të vërteta dhe se këto fakte përbëjnë veprën penale të korrupsionit, atëherë është e domosdoshme ngritja e akuzës ndaj personave që kanë kryer veprën penale dhe dërgimi i tyre para gjykatës.

Edhe praktika gjyqësore e dy viteve të fundit ka ecur në këtë drejtim (rastet e hetuara mbi bazën e materialeve të paraqitura nga një emision investigativ i një televizioni privat). Pra materialet e përgjimit të realizuar nga persona privatë jashtë procedimit penal janë administruara në rrugë procedurale nga prokuroria. Është hetuar rreth vërtetësisë së tyre dhe kur është krijuar bindja se jemi para veprës penale të korrupsionit janë dërguar për gjykim. Në përfundim të gjykimit personat janë shpallur fajtorë dhe dënuar nga gjykata.

Një metodë tjetër që duhet përdorur në rastin e hetimeve për korrupsion është simulimi i aktit korruptiv. Simulimi i aktit korruptiv parashikohet në nenin 294/a të Kodit të Procedurës Penale. Sipas këtij neni oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore, ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për simulimin e një akti korruptiv. Në këtë rast autorizimi jepet nga prokurori që kontrollon hetimet, ose prokurori që ka në juridiksion territorin ku do zhvillohet veprimi. Në rastet kur përdoret metoda speciale e simulimit të aktit korruptiv duhet treguar kujdes i veçantë që të shmangët rasti i provokimit të aktit kriminel. Bazuar në nenin 294/a, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

Në rastin e hetimit të veprave penale të korrupsionit në përgjithësi ndodhemi para një rrethi vicioz. Kjo për faktin se gjithmonë korrupsioni ka dy palë, njëri që jep dhe tjetri që merr, të cilët nuk kanë interes të flasin, sepse dënohen të dy palët. Në kushte të tilla Kodi Penal ka parashikuar në nenin 245/2, “Përrjashtimin nga vuajtja e dënimit”. Sipas këtij neni përjashtohen nga vuajtja e dënimit, ose përfitojnë ulje të tij, sipas rregullave të parashikuara nga neni 28 i Kodit Penal, personat që kanë premtuar ose kanë dhënë shpërblym apo përfitime të tjera, sipas neneve 164/1, 244, 245, 312, 319 dhe 328 të Kodit Penal. Pra përfitojnë personat që kanë kryer korrupsion aktiv, por që të përfitojnë duhet të bëjnë kallëzim penal dhe të japin ndihmesë në procedimin penal të këtyre veprave. Është e rëndësishme

të theksohet se të drejtën për t'i përjashtuar nga dënimi, apo për t'i ulur dënimin e ka vetëm gjykata.

Në mënyrë të përmbledhur, bazuar në kohën që kishim në dispozicion për të diskutuar, këto ishin disa mendime në lidhje me kuptimin e veprave penale të korrupsionit të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

ARBEN KRAJA
*Prokuror në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm
Drejtoria Kundër Krimet të Organizuar*

Tiranë, Mars 2007

2.6. *Prokurimet e veprave publike dhe infiltrimet mafioze: analizë e protokolleve hetimore.*

§ 1.

Hyrja në fuqi e *Kodit të ri të kontratave publike*⁸⁹, me bashkimin në një korpus të vetëm ligjor të rregullimit të kontratave publike “që kanë për objekt marrjen e shërbimeve, produkteve, punimeve dhe veprave (shih nenin 1, parag. 1, Dekreti legjislativ i 12 prillit 2006, nr. 163), duhet të sugjerojë një trajtim të përbashkët të risqeve të infiltrimit mafioz në këtë sektor nevralgjik të ekonomisë kombëtare, si në lidhje me marrjen e produkteve ashtu dhe në lidhje me *prokurimet e shërbimeve* apo të kontratave publike që, në mënyrë më specifike, kanë për objekt, në bazë të nenit 257 të “*Kodi i kontratave publike në lidhje me punimet, shërbimet dhe furnizimet në zbatim të direktivave 2004/17/KE dhe 2004/18/KE*” (ky është emërtimi i dekretit legjislativ të 12 prillit 2006, nr. 163, botuar në G.Z. të 2.05.2006, supl.zakon.n.107/L), ardhja në fuqi e dispozitave të reja përkon me ditën e 60° pas botimit të tij në G.Z. (pra, më 1° korrik 2006). Në lidhje me parag.2 të po këtij neni, janë të vlefshëm duke filluar nga një vit pas ardhjes në fuqi të kodit, “*dispozitat në lidhje me detyrimet e njoftimit për Autoritetet dhe Observatorin, që kanë të bëjnë me shërbime e furnizime*” dhe “*neni 240 në lidhje me marrëveshjen e mirëkuptimit për shërbimet dhe furnizimet*”.

Tema e kësaj trajtесе, që qëndron brenda analizës së teknikave hetimore të luftës kundër infiltrimeve mafioze në sektorin specifik të *prokurimeve të punëve dhe punimeve publike*, do të prekë vetëm një aspekt të fenomenologjisë më të gjerë që lidhet me infiltrimet e krimit të organizuar në qarqet e ekonomisë së ligjshme. Do të qëndrojë jashtë trajtesës sonë gjithë sa ka të bëjë me infiltrimin mafioz, po kaq delikat, në sektorin e *prokurimit të shërbimeve*, rregullimi i të cilit, në përputhje me nevojat për ta thjeshtuar dhe përafruar sipas **direktivave me të fundit komunitare**

⁸⁹ Në bazë të nenit 257 të “*Kodi i kontratave publike në lidhje me punimet, shërbimet dhe furnizimet në zbatim të direktivave 2004/17/KE dhe 2004/18/KE*” (ky është emërtimi i dekretit legjislativ të 12 prillit 2006, nr. 163, botuar në G.Z. të 2.05.2006, supl.zakon.n.107/L), ardhja në fuqi e dispozitave të reja përkon me ditën e 60° pas botimit të tij në G.Z. (pra, më 1° korrik 2006). Në lidhje me parag.2 të po këtij neni, janë të vlefshëm duke filluar nga një vit pas ardhjes në fuqi të kodit, “*dispozitat në lidhje me detyrimet e njoftimit për Autoritetet dhe Observatorin, që kanë të bëjnë me shërbime e furnizime*” dhe “*neni 240 në lidhje me marrëveshjen e mirëkuptimit për shërbimet dhe furnizimet*”.

n.2004/17/KE dhe 2004/18/KE është trajtuar nga rregullimi që sjell përpunimi gati dhjetëvjeçar dhe ndryshimi i gjerë i *Kodit të kontratave publike*, lidhur me fushën e punimeve publike apo, për ta thënë me një shprehje më të gjerë, të punëve publike (shih p.sh. normat në lidhje me projektimin, zbatimin, kolaudimin, rezervat, etj.). Nuk është fjala për një çështje sipërfaqësore; mjafton të mendojmë se sipas vlerësimeve të bëra nga Autoriteti për mbikëqyrjen mbi kontratat publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve (më pas: Autoriteti⁹⁰), vëllimi i përgjithshëm i prokurimeve që i nënshtrohen mbikëqyrjes do të destinohej të arrinte, brenda një kohe shumë të shkurtër, një shifër shtatë herë më të madhe se ajo aktuale. Edhe në planin financiar, raporti mes shumës aktuale të prokurimeve të punimeve mbi të cilën është ushtruar deri tani veprimtari mbikëqyrjeje nga Autoriteti dhe shumës shumë më të madhe ku përfshihen sektorët (e zakonshëm dhe të veçantë) e shërbimeve dhe furnizimeve, duhet të marrë pak a shumë të njëjtat përmasa⁹¹.

Nëse e dhëna sasiore është alarmante në vetvete, edhe në perspektivën e monitorimit të fenomeneve kriminale që lidhen me zgjerimin domethënës të mundësisë së riskut të infiltrimit mafioz, po aq alarmante është e dhëna cilësore⁹². Në fakt, nuk mund të na shpëtojë që **si në planin e mbikëqyrjes**

⁹⁰ Në një studim të pabotuar të kohëve të fundit mbi perspektivat e zhvillimit tekniko-organizativ dhe planifikimin strategjik dhe programimin e veprimtarive të Autoritetit të mbikëqyrjes edhe për qëllime të impostimit, përditësimit dhe funksionimit të sistemit informativ përkatës (“*NGA MBIKËQYRJA MBI PROKURIMET E PUNIMEVE ME MBIKËQYRJE TË KONTRATAVE PUBLIKE TË PUNIMEVE, SHËRBIMEVE DHE FURNIZIMEVE. Cili do ishte zhvillim i Autoritetit për mbikëqyrjen mbi kontratat publike*”, Romë, 26 mars 2007), është vërejtur se, me shtrirjen e veprimtarive të mbikëqyrjes së Autoritetit edhe në sektorin e prokurimeve të shërbimeve dhe furnizimeve, vetë “*Autoriteti duhet të përballojë teorikisht një vëllim prokurimesh të paktën 7 herë më të madh*”. Megjithatë, kjo e dhënë, nuk mban parasysh dy faktorë të tjerë rritës të tillë që i pari qëndron në përmbushjen nga ana e agjencive prokurorese të vogla e të mesme, e detyrimit për nisjen e të dhënave të rëndësishme pranë Observatorit dhe, i dyti, qëndron në paplotësinë aktuale të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mbi prokurimet e punimeve nga ana e Autoritetit.

⁹¹ Sipas vlerësimeve të mësipërme të Autoritetit, “*duhet të kalohet sidoqoftë nga një mbikëqyrje mbi një vëllim prokurimesh të punimeve prej rreth 16 miliardë € në rreth 138 apo 160 miliardë € në varësi të shumës së përgjithshme në fjalë sipas burimeve*” (Ministria e Ekonomisë dhe ISAE, në rastin e parë, dhe Confindustria, në të dytin, në lidhje me vitin 2004: bëhet fjalë për një saktësim që gjendet në shënimin 17 të studimit të mësipërm, shënimi 2) dhe (...), *kur mbikëqyrja do të shtrihet në gjithë fushën e shërbimeve dhe në furnizimet në sektorët e zakonshëm dhe në ata të veçantë, në vëllime (...), ndoshta edhe më të mëdha, të vlerësueshëm në shumën e barazvlefshme me 200 miliardë € në vit.*

⁹² Në analizën e mësipërme të Autoritetit (shih më lart shënimi 2), kompetencat e këtij të fundit janë shtrirë “*nga një mbikëqyrje e kryer mbi prokurime publike lidhur me kategorinë*

me karakter administrativ ashtu dhe në lidhje me kontrollet me karakter penal, do të kërkohen *figura të reja profesionale*, në gjendje të përballojnë *logjikat e ndryshme ekonomiko-financiare, profesionale, projektuale dhe menaxhuese që karakterizojnë sektorët e dhënies së shërbimeve dhe të furnizimit të produkteve kundrejt atij të zbatimit të punëve dhe punimeve*. Në të vërtetë, përtej analogjive sipas të cilave në perspektivën e kontrolleve të nevojshme administrative dhe gjyqësore, të gjithë sektorët e mësipërm (le të mendojmë këtu për shembull për investimet, analizën e kostove/përfitimeve dhe të risqeve, për cilësimin e subjekteve të interesuar, për profilet procedurale të financimit, për shqyrtimin e projekteve, kontrollet e afateve, kostot dhe cilësinë e prodhimit, kolaudimet dhe mirëmbajtjet, logjikat financiare dhe të tregut, etj.), ekzistojnë disa **dallime të mëdha që karakterizojnë sektorët e dhënies së shërbimeve dhe të furnizimit të produkteve kundrejt atij të zbatimit të punimeve**. Në këtë të fundit veprojnë mbi të gjitha profesionistë të nivelit të lartë (p.sh., projektues, drejtues punimesh, përgjegjësi i vetëm i procedimit, etj.), që janë më vete secili përgjegjës, në bazë të normave të sakta ligjore apo nënligjore, për punën e tyre, sidomos kur i përkasin një urdhri profesional. Por kjo gjë nuk ndodh **në sektorin e shërbimeve**, në të cilin kryeson **bashkëpunimi mes subjekteve të ndryshëm** (subjekte që ofrojnë shërbimin, subjekte që e marrin këtë shërbim, bartës interesi, etj.). Gjithashtu lipset të marrim në konsideratë **logjikat e ndryshme të tregut** që i paraprijnë rregullimit të sektorit të furnizimit të produkteve dhe të dhënies së shërbimeve (më dinamik, pasi orientohet drejt bashkëpunimit mes subjekteve të interesuar dhe që lidhet me **ciklin e jetës, përgjithësisht të shkurtër, të shërbimit apo marrjes, po kaq jetëshkurtër, të një produkti**) në krahasim me atë të punimeve (më statik, pasi lidhet me vetë natyrën e dhënies së shërbimit dhe me periudhën, kryesisht të papërcaktuar, të ekzistencës dhe shfrytëzimit të një ndërtimi)⁹³.

Si fund, zgjerimi i kompetencave të Autoritetit të mbikëqyrjes në sektorin e kontratave publike lidhur me shërbime dhe furnizime dhe, sidomos, *ushtrimi konkret* i të drejtave përkatëse do të sjellë pashmangshmërisht krijimin dhe forcimin e vazhdueshëm, edhe në këtë sektor specifik, të kompetencave të nevojshme profesionale nga ana e

e vetme të mallrave të punimeve” në një kontroll mbi *“prokurime shërbimesh dhe furnizimesh në lidhje me 60 kategori mallrash të ndryshme, në sektorë të zakonshëm dhe të veçantë”*.

⁹³ Në këtë ide të fundit, me të cilën jam plotësisht dakord, mbështetet edhe studimi i Autoritetit të mbikëqyrjes së kontratave publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve, cit. më sipër, shënimi 2, fq. 29-31.

organeve të kontrollit administrativ, të tilla që mund të përballojnë raste të abuzimeve të mundshme, të parregullsive dhe shmangieve kundrejt zbatimit të rregullt të **parimeve komunitare të përmendur në nenin 2 të kodit të ri të kontratave publike** (*konkurrenca e lirë, barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi, transparencë, përpjestueshmëria dhe deklarimi*). Në këtë mënyrë, do mund të garantohet më mirë në zhvillimin e marrëdhënies kontraktore, nga faza e financimit deri tek ajo e zbatimit (si në rastin e veprave dhe punimeve publike ashtu dhe të shërbimeve dhe furnizimeve), cilësia e punës së dhënë, në respektim të *parimeve të leverdisë ekonomike* (në përputhje me nevojat shoqërore, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm), *efikasitetin, shpejtësinë dhe përpikmërinë*.

Është e qartë se **shtrirja sasiore dhe cilësore e këtij lloj kontrolli edhe në sektorët e dhënies së shërbimeve dhe të furnizimit të produkteve është e destinuar të pasqyrohet pozitivisht në kontrollet me karakter penal në po këta sektorë**, pavarësisht nga kryerja e kontrolleve të bëra kryesisht apo me autorizim të Autoritetit gjyqësor, nga policia gjyqësore apo, *motu proprio*, nga vetë prokuroria. Ndër të tjera, kontrollet që kanë për qëllim vërtetimin e krimeve – dhe, më konkretisht, ato vepra që kanë të bëjnë me fenomene të infiltrimit mafioz – duhet të përballen me të njëjtat probleme operative të raportuara nga Autoriteti i mbikëqyrjes. Në thelb, edhe kontrollet me karakter penal, ndonëse në planin hetimor dhe procedural mund të përdorë edhe përvojën e fituar nga numri i madh i rasteve që flasin për infiltrimë mafioze në sektorin e punimeve publike, duhet të përballen me një sërë ndryshimesh pavarësisht nga aftësia që ato kanë për të ndikuar ndjeshëm vërtetimin e rrethanave të mundshme, me rëndësi penale, në dritën e sa thamë më lart. Duhet të mendojmë këtu jo vetëm për **kuadrin ligjor të ndryshuar** siç më lart përmendur por edhe për një sërë faktorësh të tjerë (si ata që lidhen me **veçantinë dhe ndryshueshmërinë e fenomeneve socio-ekonomike në dhënien e shërbimeve dhe furnizimin e mallrave**) që e bëjnë edhe më të vështirë marrjen dhe përforcimin procedural të provës së infiltrimëve mafioze, që janë bërë të mundura jo vetëm sipas parashikimit të nenit 416-*bis* të K.p., por edhe përmes kryerjes së krimeve-mjet (si, p.sh. ata të parashikuar nga nenet 317, 318, 319, 321, 323, 328, 353, 476, 477, 478, 479 të k.p.).

§ 2. Mafia dhe prokurimet: një binom në zhvillim të përhershëm, mes përpjekjeve për racionalizim të sistemit normativ dhe mekanizmave të legalizimit të veprimtarive ekonomike që të shpien në krimin e organizuar.

Për të qëndruar brenda kuadrit të temës specifike të kësaj trajtесе, është e udhës të theksojmë se, si pasojë e ndryshimit të legjislacionit në fusha – si ajo e prokurimeve publike – që janë të destinuara të ngjallin interes apo oreks për mafien, *mafiet tradicionale (cosa nostra, 'ndrangheta, camorra)* kanë shfaqur interes të veçantë për të shfrytëzuar hapësirat e rregullimit ligjor apo për të përdorur në interes të vet kanalet e ngushtë të normativës me qëllim që të arrijnë dhe kujdesen për interesat e tyre kriminalë.

Kjo gjë ndodhi pikërisht pas të disatës përpjekje për racionalizim sistematik të fushës së prokurimeve publike që u bë përmes **ligjit-kuadër të datës 11 shkurt 1994** (i ashtuquajtur *ligji Merloni*) dhe variantet e mëvonshme dhe plotësimet normative, por mbi të gjitha pas ardhjes në fuqi të ligjit të 21 dhjetorit 2001, nr.443 (i ashtuquajtur *ligj objektiv*) i cili ka gjetur zbatim përmes dekretit legjislativ nr.190, dt. 20.08.2002⁹⁴.

⁹⁴ Nder **elementët e rinj më të rëndësishëm** të futur në legjislacionin tonë nga dy burime ligjore të sipërpërmendura, është edhe mundësia për t'i besuar një figure të re sipërmarrëse, **kontraktorit të përgjithshëm**, realizimin "*me çfarëdoj mjeti*" të një veprе që u përgjigjet nevojave të treguara nga subjekti tenderues. Normativa në fjalë, rishikuar së fundi nga kodi i ri i kontratave publike (Dekreti legjislativ n.163, i vitit 2006), përcakton, në përputhje me sa parashikuar nga direktiva KEE n.93/37, që kontraktori i përgjithshëm, ndryshe nga prokuruesi i punëve publike, mund të realizojë punën që i është porositur atij duke qenë i lirë të përcaktojë mënyrat e realizimit, në kuptimin që ai mund t'ua besojë realizimin – të plotë apo të pjesshëm – të tretëve, të përzgjedhur dhe të koordinuar prej tij, duke qenë i detyruar t'i ofrojë porositësit të vet shërbimet kolaterale (projektim, marrje të hapësirave, marrëdhënie me të tretët, etj.), të nevojshëm për realizimin e plotë të punimeve. Në përfundim, *general contractor*-it duhet t'i kërkohet sidomos të ketë një *aftësi të madhe organizative*, meqë funksionet që i kërkohet të kryejë qëndrojnë kryesisht në koordinimin e përgjithshëm dhe në veprimtarinë e subjekteve të tjerë (projektues, zbatues, etj.): për këtë, krs. opinionin (e pabotuar) nr.2064/03 të dhëna nga Këshilli i Shtetit, Seksioni Këshillues për Aktet Ligjore, në Mbledhjen e datës 9 qershor 2003, mbi skemën e rregullores që ka për objekt "*Krijimin e sistemit të përzgjedhjes së kontraktorëve të përgjithshëm në bazë të nenit 15, të dekretit legjislativ n.190, të vitit 2002*".

Një tjetër element themelor dhe i ri i futur nga *ligji objektiv* përbëhet nga **privatizimi i marrëdhënieve, si të thuash, në bazë të kontraktorit të përgjithshëm** në kuptimin që marrëdhëniet e këtij të fundit "*me të tretët*", sidoqoftë të përfshirë në realizimin e veprës, "*janë marrëdhënie të të drejtës private, për të cilat nuk mund të zbatohen norma të ligjit kuadër dhe të rregullores përkatëse*", me përjashtim të sa parashikuar nga ligji i delegimit i vitit 2001, nga dekreti legjislativ në zbatim të tij dhe nga plotësimi i rregullores siç në nenin 15 të po këtij dekreti (shih neni 9, parag.6, i dekretit legjislativ n.190, vitit 2002). I njëjti rregullim përса u takonm marrëdhënieve me nënkontraktorët, përcaktohet për rastin kur

Megjithatë, me përjashtim të ndonjë ndreqjeje të vogël të sugjeruar nga zhvillimi i përvojës së fituar nga organizatat kriminale që veprojnë në këtë sektor, asgjë apo puthuaj asgjë nuk ka ndryshuar në lidhje me *format e varësisë kriminale* në administrimin e *prokurimeve publike* si të tilla.

Në vija të trasha, mund të vërejmë se **binomi mafie-prokurime** ka përfaqësuar në këto vite të fundit shumatoren e mënyrës së ndotjes së ekonomisë publike dhe private nga ana e krimit të organizuar, një lloj **sulmi, veçanërisht tinëzar, ndaj rregullave të tregut të lirë dhe nismës së lirë ekonomike private**, si dhe, në rastet e përfshirjes në sistemin e paligjshëm të disa sektorëve që kanë devijuar nga politika kombëtare e vendore, **një faktor të rrezikshëm të vënies në rrezik të vetë bashkëjetesës demokratike**.

Në disa qarqe të Italisë (Sicili, Kalabri, Kampania) veçanërisht të ekspozuara ndaj risqeve të infiltrimit mafioz edhe në sektorin politiko-administrativ, organizatat kriminale të llojit mafioz kanë rritur me shumë sukses mundësitë që prehen në trinomin *politikë-mafie-prokurime*. Siç do ta shohim më tej – dhe, siç dihet për fat të keq – ato nuk kanë arritur të krijojnë kushtet për një destabilizim të thellë dhe të tillë që vështirë se mund të ndreqet jo vetëm të sistemit ekonomik vendor, me pasoja të rënda në nivel kombëtar, por edhe të vetë rendit demokratik të zonave të konsiderueshme të vendit, të cilat i janë nënshtruar, apo kushtëzohen fort, ndaj pushtetit kriminal mafioz.

I ashtuquajhuri ligj Merloni dhe ndryshimet e mëvonshme të sjella në rregullimin bazë të prokurimeve publike i gjegjen nevojës për të përshtatur

realizimi i veprave infrastrukture jepet në formë koncesioni për ndërtimin dhe administrimin në bazë të neneve 6, parag. 1 gërma a), dhe 7 të dekretit legjislativ nr.190, të vitit 1992.

Parag. 3 i nenit 7 të përmendur përmban në fakt disa saktësime të rëndësishme. “Në marrëdhëniet e koncesionarit me të prokuruarit e vet (...) b) procedurat e prokurimit të koncesionarit dhe marrëdhëniet e po këtij të fundit me të kontraktuesit e vet apo me kontraktorin e vet të përgjithshëm, rregullohen vetëm nga:

norma rregulluese të prokurimeve të koncesionarit sipas direktivës 93/37/KEE të Këshillit, të dt. 14 qershor 2003;

norma të përzgjedhjes së kontraktorëve dhe të nënkontraktorëve të vet siç në dekretin e Presidenti të Republikës më 25 janar 2000; nr.34;

verifikime antimafia, që duhen kryer ndaj kontraktorëve apo nënkontraktorëve të punimeve”.

Kjo nuk do të thotë që “*Marrëdhëniet mes koncesionarit dhe të prokuruarit apo kontraktorit të përgjithshëm janë marrëdhënie të të drejtës private të rregulluara nga kontrata dhe nga normat e kodit civil që rregullojnë prokurimin; për këto gjejnë zbatim normat e ligjit kuadër dhe të rregullores”.*

normativën aktuale ndaj direktivave komunitare⁹⁵ në perspektivën e një rimëkëmbjeje moralizuese në sektorin në fjalë, që – deri atëherë – dukej se nuk qëndronte i paprekur as sektori i prokurimeve të shërbimeve, ku shquhen njësoj rreziqe të infiltrimit mafioz.

Duke dashur të mos hyjmë në hollësi, mund të vërejmë në vija të trasha se sistemi i ri normativ i futur nga e drejta komunitare me **direktivat e lartpërmendura 2004/18 dhe 2004/17 KE** përbën një **përpyetje të vlefshme për rregullimin organik të fushës së prokurimeve publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve**, që sigurisht diktohet nga ndërgjegjësimi për rrezikun e infiltrimit të krimit të organizuar në këtë sektor⁹⁶.

Megjithatë, kërkimi i një emëruesi minimal të përbashkët në përcaktimin e strategjisë së luftës në këtë sektor rrezikon të sjellë një **limit të rëndë** për gjithë rregullimin ligjor të prokurimeve publike.

Rreziku kryesor përfaqësohet nga **rreziku i emigracionit të sipërmarrjes mafioze**. Në fakt, ka shumë të ngjarë që sipërmarrjet dhe operatorët ekonomikë, të prekur nga virusi i krimit të organizuar, të jenë të tunduar të zhvendosen, **falë lirisë së vendosjes**, që garantohet në nivel komunitar, në tregun e lirë evropian dhe në Vendet anëtare të Bashkimit (sidomos në ata që janë anëtarësuar së fundi) që, ndonëse në respektim të *standardeve* minimale të përcaktuara nga direktiva në fjalë, ende nuk janë pajisur, ashtu si legjislacioni ynë, me norma të përshtatshme për të luftuar me efikasitet rrezikun e infiltrimit mafioz. Për shembull, parashikimi, mes **shkaqeve të përjashtimit nga prokurimet publike**, për nevojën e një **dënimi përfundimtar** për një sërë krimesh të llojit tipik mafioz apo sidoqoftë që bëjnë pjesë në listën e atyre që zakonisht karakterizojnë infiltrimin e krimit të organizuar edhe në sistemin e prokurimeve publike, përbën një hapësirë të gjerë ligjore që mundëson arritjen e qëllimit të rregullimit të ri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit të rrezikut në fjalë. Sidoqoftë mund të parashikohet fort mirë që sipërmarrjet mafioze dhe ato që në mënyrë të tërthortë apo jo kontrollohen dhe financohen nga krimi i organizuar, me qëllim që të mbrohen nga veprimtari luftuese të organeve të

⁹⁵ Shih., më konkretisht, direktivat n.89/440 KEE, në fushën e dhënies së prokurimit të punëve publike dhe n.93/37 KEE në lidhje me koordinimin e procedurave përkatëse.

⁹⁶ Duhet thënë se, në bazë të pikës 6 të direktivës 2004/18/KE, lejohet – ndër të tjera – zbatimi i *“masave të nevojshme në mbrojtje të rendit, të moralitetit dhe sigurisë publike (...) me kusht që këto masa të jenë në përputhje me traktatin”*. Është e udhës të vërejmë se një referim i tillë *explicit* ndaj mbrojtjes së nevojave të rendit publik, që lidhen me rrezikun e infiltrimit të krimit të organizuar në sistemin e prokurimeve publike, duket se nuk gjendet në Kodin e ri të kontratave publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve.

Shteteve anëtare që ashtu si Italia kanë përgatitur instrumente parandalimi dhe ndëshkimi të krimit ekonomik dhe sipërmarrës, si të thuash të kenë mundësi “*të emigrojnë*” në territorin e Shteteve më “*tolerantë*” dhe të mund të veprojnë kështu pa u ndëshkuar falë lirisë së vendosjes dhe të ndërmarrjes të garantuara nga e drejta komunitare.

I shtojmë kësaj **uljen e pragut të kriterëve të përzgjedhjes cilësore të pjesëmarrjes në prokurimet publike** aq sa të mos përjashtohet operatori ekonomik që është shpallur i falimentuar apo përfundimisht i dënuar për një krim që ndikon në moralitetin e tij profesional apo që ka dhënë deklarata të rreme në lëshimin e informacioneve të detyruara para një autoriteti kompetent në lidhje me gjendjen personale apo aftësitë e veta ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale, përfaqëson **një vulnus të rëndë për gjithë sistemin**⁹⁷.

⁹⁷ **Neni 45** i direktivës 2004/18/KE parashikon **shkaqe të përjashtimit të detyruar** nga pjesëmarrja në një prokurim të punëve publike, furnizimeve dhe shërbimeve dhe **shkaqeve të përjashtimit fakultativ** të operatorëve ekonomikë kandidatë apo ofertues në procedurat që kanë të bëjnë me dhënien e këtyre prokurimeve. Duke saktësuar dhe sqaruar sa pohuar nga parimi në hyrje të direktivës, ky nen përcakton si **shkak të përjashtimit të detyruar** (arg. nga shprehja: “*Përjashtohet...*”), **dënimi** i kandidatit apo ofertuesit, me **vendim përfundimtar**, për të cilin është në dijeni administrata prokuruese, për një prej arsyeve të mëposhtme:

pjesëmarrje në një organizatë kriminale, siç përcaktuar në nenin 2, parag. 1, të veprimit të përbashkët 98/773/GAI të Këshillit;

korruption, siç përcaktuar përkatësisht në nenin 3 të aktit të Këshillit të dt. 26 maj 1997 dhe të nenit 3, parag. 1, të veprimit të përbashkët 98/742/GAI të Këshillit;

mashtrimit, në bazë të nenit 1 të konventës në lidhje me mbrojtjen e interesave financiarë të Komunitetit evropian;

pastrimit të të ardhurave nga veprimtari të paligjshme, siç përcaktuar nga neni 1 i direktivës 91/308/KEE të këshillit të datës 10 qershor 1991 lidhur me parandalimin e përdorimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e të ardhurave nga veprimtari të paligjshme.

Duhet thënë se po neni 45 parashikon jo vetëm që Shtete anëtare mund të saktësojnë “*në përputhje me të drejtën përkatëse kombëtare dhe në respektim të të drejtës komunitare*”, kushtet e përjashtimit të detyruar si më sipër (shih parag. 1, fjalia e dytë), por gjithashtu mund “*të parashikojnë një ndryshim nga detyrimi i parashikuar në paragrafin e parë për nevoja imperative me interes të përgjithshëm*” (shih parag. 1, fjalia e tretë).

Gjithashtu me shumë interes është përcaktim i pjesës së fundit të paragrafit të parë të nenit 45 cit., ku, në vend të kërkesës për administratat prokuruese **mund** t’ua drejtojnë, nëse është e nevojshme, “*kandidatëve dhe ofertuesve për të paraqitur dokumentet siç në paragrafin 3*”, parashikohet mundësia që këto administrata “*t’u drejtohen autoriteteve kompetente për të marrë informacione në lidhje me gjendjen personale të kandidatëve ofertues që i gjykojnë të nevojshme*”. Këto informacione, në rast se kandidatët apo ofertuesit e vendosur në një Shtet anëtar të ndryshëm nga ai i administratës prokuruese, **mund** t’i kërkohen autoritetit kompetent të Shtetit të vendosjes dhe do të kenë të bëjnë me personat juridikë por

Kjo gjë del edhe më qartë nëse mbajmë parasysh se, në Itali, përvoja gjyqësore e viteve të fundit ka treguar hapur se është pikërisht ky terreni e

dhe fizikë, “përfshirë, nëse është e nevojshme, drejtuesit e shoqërive apo çdo person që ushtron të drejtën e përfaqësimit, të vendimmarrjes apo kontrollit të kandidatit apo ofertuesit”.

Shkaqet e përjashtimit fakultativ (“**Mund të përjashtohet...**”: neni 45 parag. 2 i direktivës 2004/18/KE) nga pjesëmarrja në prokurim tregohen në paragrafin e dytë të nenit 45 cit. Ato kanë të bëjnë me “*çdo operator ekonomik*”:

- a) që ndodhet në gjendje **falimentimi, likuidimi, pezullimi aktiviteti, kujdestarie** apo **marrëveshjeje paraprake likuidimi** apo në çdo rrethanë tjetër të ngjashme që rezultojnë nga një procedurë e po kësaj natyre parashikuar nga ligje dhe rregullore kombëtare;
- b) në ngarkim të të cilit është **duke u zhvilluar një çështje** për shpallje falimentimi, kujdestarie, likuidimi, marrëveshjeje paraprake likuidimi apo çdo procedim tjetër i po kësaj natyre parashikuar nga ligje dhe rregullore kombëtare;
- c) ndaj të cilit është shpallur një **dënim me vendim të formës së prerë** në përputhje me dispozitat ligjore të Shtetit, **për një krim që ndikon në moralin e tij profesional**;
- d) që, në ushtrimin e veprimtarisë së tij profesionale, ka kryer një **gabim të rëndë**, i cili është vërtetuar me çdo mjet prove nga administrata prokuruese;
- e) që nuk ka shlyer rregullisht detyrimet në lidhje me **pagesat e kontributeve të sigurimeve dhe të përkujdesjes** sipas legjislacionit të vendit ku është vendosur apo të vendit të administratës prokuruese;
- f) që nuk ka shlyer rregullisht detyrimet në lidhje me **pagesën e tatimeve e taksave** sipas legjislacionit të vendit ku është vendosur apo të vendit të administratës prokuruese;
- g) që është fajtor i rëndë për lëshim **deklaratash të rreme** në dhënie informacionesh që mund të kërkohen (...) apo nuk ka dhënë informacione.

Direktiva 2004/18/KE parashikon gjithashtu norma specifike që synojnë të përcaktojnë **kriteret e vlerësimit dhe verifikimit të aftësisë ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë të interesuar të marrin pjesë në prokurime publike**.

Edhe në lidhje me kriteret e përzgjedhjes dhe zgjedhjes cilësore siç në nenin 54 të direktivës 2004/18/KE, në lidhje me procedurat e prokurimit të enteve të shpërndarjes së ujit dhe të energjisë dhe të enteve që furnizojnë shërbime të transportit dhe shërbimeve postare, është vendosur përdorimi i “*rregullave dhe kriterëve objektive që duhet të bëhen të disponueshme ndaj operatorëve ekonomikë të interesuar*” (neni 54, parag.1). Përsa i takon përzgjedhjes së kandidatëve parashikohet përcaktimi i kriterëve të ngjashme nga ana e enteve prokuruese, si në të ashtuquajturat *procedura të hapura* ashtu dhe në *procedurat e prokurimit të ngushta apo të negociuara* (neni 54, parag.2), për të cilat këto kriteret mund t’i gjegjen nevojës, për entin prokurues, “*për të ulur numrin e kandidatëve në një nivel që përkon me një ekuilibër të drejtë mes karakteristikave specifike të procedurës së prokurimit dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e saj*” (neni 54, parag.3). Kriteret në fjalë (dhe, më konkretisht, ata të treguar në parag.1 e 2 të nenit 54, cit.) “***mund të përfshijnë ata të përjashtimit të renditur në nenin 45 të direktivës 2004/18/KE***” (neni 54, parag.4). Bëhet fjalë për kriteret e përzgjedhjes cilësore që ka të bëjë veçanërisht me ***gjendjen personale të kandidatit apo të ofertuesit***.

zgjedhjes së sipërmarrjes mafioze apo, sidoqoftë, të përlyer në krim apo të lidhur me mafien: ajo në fakt, për të arritur objektivin e infiltrimit në sistemin e prokurimeve publike, nuk ka ngurruar deri tani të përdorë instrumentin e *marshimit* dhe të *falsifikimit*, përveçse atë të të rrugës së paligjshme të *shkeljes sistematike të detyrimeve lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të përkujdesjes dhe moskryerjes së pagesës së tatimeve dhe taksave*⁹⁸, me qëllim që të sigurojë, plotësisht apo pjesërisht, shumën që më pas duhet ta përdorë për *ryshfetin mafioz*⁹⁹.

Si përfundim, pavarësisht nga hapat e bërë përpara nga normativa komunitare në këtë fushë, duhet pranuar se jemi ende larg një modeli

⁹⁸ Në shkelje të sa vendosur nga neni 45, parag.2 gërma e) dhe f) e direktivës 2004/18/KE.

⁹⁹ Konsideratat e mësipërme vlejné edhe për rregullimin e koordinuar të procedurave në lidhje me të ashtuquajturat *prokurime të përjashtuara* si më lart (shih direktivën 2004/17/KE si më lart). Në fakt, po ta shohim mirë, rregullimi i prokurimeve të enteve shpërndarëse të ujit dhe energjisë dhe enteve që ofrojnë shërbime të transportit dhe shërbimeve postare paraqet çuditërisht hapësira ende më të gjera se ato të parashikuara për prokurimet publike për punime, furnizime dhe shërbime siç në direktivën 2004/18/KE. Për t'u mjaftuar me kriteret e përzgjedhjes sasiore të kandidatëve, si në një "*procedurë të hapur*" ashtu dhe në një "*procedurë prokurimi të ngushtë apo të negociuar*", ia vlen të theksojmë se këto kriteret "*mund të përfshijnë ato të përjashtimit* (detyruet apo fakultativë: shënim i redaktorit) *të renditur në nenin 45 të direktivës 2004/18/KE*". Vetëm në rastin kur "*enti prokurues është një administratë prokuruese në bazë të nenit 2, parag.1 gërma a)*" (sipas nenit 2, parag.1, gërma a) i direktivës 2004/17/KE, nënkuptohen si "*administrata prokuruese*": Shteti, ente publike territoriale, organizmat e të drejtës publike, shoqatat e krijuara nga një apo më shumë ente publike territoriale apo nga një apo më shumë organizma të të drejtës publike), këto kriteret përfshijnë edhe ato të përjashtimit (të detyruar), renditur në nenin 45, parag.1, i kësaj direktive 2004/18/KE, si më lart. Lidhur me këtë, përballë konstatimit së tolerancës më të madhe në dukje të normativës komunitare në fushën e prokurimeve në sektorët e "dobisë publike", "*paradoksalisht e orientuar të zgjerojë gjithnjë e më shumë hapësirat e kontrollit paraprak*", T.SOLAZZO, *Unione Europea, Appalti e criminalità organizzata transnazionale, në per Aspera ad Veritatem*, 2003, fq. 197-198, ka vërejtur se zgjidhja ndaj të cilës është orientuar direktiva 2004/17/KE (e quajtur **direktiva "dobia"**) "*duket se është ajo e binarit të dyfishtë*" *sipa stë cilit ndërsa administratave prokuruese u kërkohet të pretendojnë edhe në sektorin e "dobive" të njëjtin profil "moral" të pjesëmarrësit në një tender në sektorin "tradicional", përkundrazi "shoqërive publike" u lihet e drejta e zgjedhjes për të zbatuar apo jo kriteret e përjashtimit siç në nenin 46, parag.1 i propozimit për një direktivë të re "klasike".* Arsyeja për këtë qëndron në faktin që "*ndërsa pranohet që në të gjitha Shtete anëtare të Bashkimit "administratat prokuruese" të kenë akses në elementë të provës të pakundërshtueshë,, si "dëshmitë e penaltetit", lidhur me mosekzistencën e shkaqeve të përjashtimit në dritën e direktivës "klasike", nuk është aq e pranuar në Bashkim mundësia që t'u jepet edhe "shoqërive publike" një akses më i përgjithësuar ndaj këtij lloji informacioni*". Kjo vërejtje është paraqitur kur ende nuk ish nxjerrë direktiva. Neni 46, parag.1 i propozimit për direktivë – të cilës i referohej A. – është shkruar më pas në nenin 45 parag.1 i tekstit përfundimtar të direktivës së miratuar.

normativ me të vërtetë të përshtatshëm për të luftuar me efikasitet rrezikun e infiltrimit mafioz në këtë sektor jetik të ekonomisë publike dhe private.

Madje, edhe pas ardhjen në fuqi të *Kodit të ri të kontratave publike*, **kompleksiteti i vazhdueshëm i sistemit ligjor dhe nënligjor** që rregullon këtë fushë rrezikon të përbëjë – në vetvete – një **tjetër faktor rreziku**, i destinuar të pasqyrohet negativisht në mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit të rrezikut të infiltrimit mafioz, që është më i lartë sa më i ulët është niveli i transparencës dhe thjeshtësisë së sistemit¹⁰⁰.

Në *sektorin e prokurimit publik të punimeve*, përvoja gjyqësore e këtyre viteve të fundit na ka mësuar se në shumë raste, sipërmarrësi fitues i prokurimit, apo sidoqoftë zbatuesi i punëve publike, me qëllim sigurimin e avantazheve si më lart, dikur, *paqen në kantjer*, kërkoi – ai vetë – lidhjen me organizatat mafioze vendase apo me ndërmarrjet që u përkisnin atyre. Ka ndodhur shpesh që ai të ketë përdorur **ndërmjetësimin e subjekteve-zinxhir apo sipërmarrësit bashkëpunëtorë** për të lidhur, duke iu shmangur rrezikut të lidhjeve të drejtpërdrejta me krimin e organizuar, **kontratën e mbrojtjes mafioze**, që gjithnjë e më shpesh një formë *konsensusi in idem placitum* (një pëlqim i heshtur), më shume se fryti i një vullneti i shtrënguar nga *metus*.

Kështu, është e lehtë të parashikosh që, në mungesë të mjeteve të fuqishme dhe të qëllimshme për ta ndrequr këtë e duhen adoptuar jo vetëm në planin normativ, organizatat kriminale mafioze, të shoqëruara nga strategji të *fundosjes* edhe nga shoqëritë e ligjshme, do të ndihmohen në **“kërkimin gjithnjë e më të madh të mekanizmave të legalizimit të veprimtarive ekonomike mafioze”**¹⁰¹ dhe do të orientohen ato vetë drejt **fuqizimit të ndërmarrjes kriminale** përmes investimeve të mëdha e të ndryshme në sektorët (gurore, prodhim konglomeratesh të çimentos dhe bitumit, transportime dhe lëvizje dherash) në të cilët kanë treguar prej kohësh prirjen e tyre sipërmarrëse, duke investuar shumën të mëdha financiare.

Kriminaliteti mafioz ka marrë në fakt kohët e fundit dhe në mënyrë gjithnjë e më të qartë tiparet e një **parazitizmi** si të thuash **sistemik**, i destinuar të fuqizojë një **qark sipërmarrjeje alternativ**, të ushqyer nga masa

¹⁰⁰ Përpara ardhjes në fuqi të kodit të ri të kontratave publike, Komisioni parlamentar antimafia i Legjislaturës XIV, në *Relacionin* e miratuar në mbledhjen e datës 30 korrik 2003 (Rel.Sen.Centaro), doc.XXIII, nr.3, 254 dhe vijues, kish vërejtur se “*vështirësia objektive e sistemit të gjerë ligjor dhe nënligjor në fuqi përbën një detyrim për kërkesat e nevojshme të transparencës dhe thjeshtësisë së sistemit, duke krijuar paqartësi që e bëjnë më të lehtë rrezikun e infiltrimit kriminal*”.

¹⁰¹ Shih *Relazione* dhe lok.cit.në fund.

e stërmadhe e financimeve publike, që u bindet rregullave të të vepruarit mafioz në vend që t'u bindet atyre të konkurrencës së lirë, duke përbërë një rrezik të madh për gjithë ekonominë e vendit.

§ 3. *Disa shënime mbi metodat kryesore të infiltrimit të krimit të organizuar në sistemin e prokurimit të punëve publike*¹⁰².

Nuk ka asnjë dyshim që në qarqet italiane më shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të prekjës nga mafia (Sicilia, Kalabria, Kampania), trysnia e vazhdueshme e ushtruar nga krimi i organizuar, sidomos kundrejt botës së sipërmarrjeve, ka ndihur nga njëra anët përhapjen dhe fuqizimin e klimës së heshtjes dhe, nga ana tjetër, uljen e gjithë përqindjes së ligjshmërisë në shoqërinë civile. Njëkohësisht, është parë një **përafrim gjithnjë e më i madh i dy palëve, në krye kundërshtare, i marrëdhënies mafie-sipërmarrje**. Në fakt, e para, duke përdorur të ardhurat nga pozita që rrjedh nga pushteti i saj, i njohur e pranuar në territor, i kontrollit të territorit, e ka parë **me leverdi të ulë në minimum përdorimin e forcës**, duke filluar të krijojë një politikë të **marrjes së pëlqimit** nga ana e shtresës së sipërmarrësve. Një pjesë e madhe e kësaj të fundit, nga ana e vet, duke parë avantazhet e jashtëzakonshme që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin kriminal mafioz (le të kujtojmë për shembull *neutralizimin me metodën mafioze të konkurrentëve të tjerë në të njëjtin tender prokurimi*, apo *mundësinë për të marrë pjesë në bashkime të përkohshme shoqërisht, që i shkon për shtat organizatës mafioze në fjalë*, për *shfrytëzimin e potencialit mafioz për të mësuar të dhëna sekrete në lidhje me procedurën e prokurimit apo për të ndikuar, në përfitim të vet, mbi zhvillimin e rregullt të saj*, apo për *perpesktivën e përdorimit të aftësisë korruptuese dhe kërcënuese të organizatave kriminale për të kapërcyer vështirësitë në lidhje me realizimin e veprës a punimeve, si dhe të kundërshtimeve që mund të ngrejë drejtoria e punimeve rreth cilësisë së punimeve dhe furnizimeve të parashikuara në Pjesën e Posaçme të kontratës, etj.*), ka përfituar nga rasti për të hyrë në një lloj **marrëveshjeje ekonomike me interesat e krimit të organizuar**.

Në **Sicili metoda e ashtuquajtur metoda e tryezës**, e ideuar dhe për një kohë të gjatë e eksperimentuar me sukses nga sipërmarrësi mafioz Angelo SIINO, që më pas u bë bashkëpunëtor i drejtësisë, ka përfaqësuar formën më

¹⁰² Për një pasqyrim përmbledhës historik të metodave “tradicionale” të infiltrimit mafioz në sistemin e prokurimeve publike, i lejojmë vetes t'i referohemi *Coordinamento investigativo e cooperazione istituzionale: nuove prospettive della lotta alla criminalità organizzata nel settore dei lavori pubblici*, në A.V., *Il coordinamento delle indagini di criminalità organizzata e terrorismo*, Milano, Giuffrè, 2004, 359 – 373.

të përpunuar dhe tinëzare të infiltrimit mafioz në sistemin e prokurimeve publike dhe, dikur, një mundësi strategjike për të kontrolluar dhe menaxhuar pushtetin ekonomik-kriminal jo vetëm në Palermo dhe në provincën përreth, por kryesisht në gjithë zonën e ishullit¹⁰³, duke shfrytëzuar **lidhjet kriminale me botën e politikës dhe të biznesit**. Në të vërtetë, *tryeza*, ndërsa parashikonte **kritere komplekse rotacioni të shoqërive që marrin pjesë në tendera**, përbënte **surrogatin mafioz ndaj nismës së lirë private** dhe, duke shkatërruar çdo formë të konkurrencës së lirë, pohoi edhe një herë **rolin hegjemonist të cosa nostra**, e si pasojë mundësinë për të shfrytëzuar sa më mirë të ish e mundur potencialitetet që ka ky sistem kriminal. Shoqëritë e pranuar në *tryezë*, kur u vinte radha, arrinin të fitonin prokurimin e punimeve duke kapërcyer, **në mungesë të një tenderi real në procedurat e prokurimit** (pothuaj gjithnjë me cene për shkak të **teknikave të sofistikuara të manipulimit të rezultatit**, si p.sh. **përdorimi i metodave të mashtrimit për prezantimin e ofertave apo i pjesëmarrjes së rreme në tender nga ana e grupeve sipërmarrëse mbështetëse**), logjika e konkurrencës së lirë me mundësinë për të përfitur **ulje minimale çmimi** dhe tarifa më shpërblyese mbi të cilat ndikonte ryshfeti që i duhej dhënë organizatës kriminale.

Po kështu, në **Kalabri, teknikat e infiltrimit të përdorura nga krimi i organizuar** vendas janë ndikuar fort nga lloji i veçantë i organizatës së **'ndrangetes (ndrangheta)**, kryesisht lokaliste, e mbështetur në të ashtuquajturit *vendas*, dhe në të ashtuquajturat *'ndrine* që, në nivele të ndryshme, pasqyrojnë kontrollin përkatës të territorit. Ky veprim kontrolli është ushtruar nga anëtarët *vendas*, për më shumë në **pavarësi operative në kuadrin e territorit që i përket sferës së tyre të ndikimit**. Ajo është shfaqur kundrejt një shoqërie fituese të tenderit në **dy modalitete të ndryshme operative**:

- e para, ndryshe *parazitare*, e përfaqësuar nga tërheqja e drejtpërdrejtë e një **ryshfeti** të një shume që është në përpjestim me atë të punimeve të prokuruar;
- e dyta, e realizuar me *forma të tërthorta presioni* kanë për qëllim të sigurojnë **kontraktimin apo nënkontraktimin e punimeve (apo të furnizimeve kryesore në ndërmarrje të vogla dhe të mesme,**

¹⁰³ Në dritën e rezultateve të investigimeve më të fundit, që synojnë të vërtetojnë ekzistencën e mundshme të fenomeneve të infiltrimit mafioz në realizimin e disa ***Vepra të mëdha, që janë duke u realizuar zona të ndryshme nga Sicilia***, mund të themi me të drejtë se metoda e *tryezës* përdoret ende, edhe falë anëtarësimit të shoqërive të rëndësishme në nivel kombëtar.

drejtpërsëdrejti ose jo, të kontrolluara nga ‘ndrangheta; dhe kjo përmes përdorimit – apo pas një mbrojtjeje formale – të formave kontraktore nga më të ndryshmet (*nënkontraktim, qiramarrje “në të nxehtë dhe/ose në të ftohtë”, lëvizje dherash, transport materialesh, furnizime inertesh apo konglomeratesh të çimentos dhe bitumit*).

Në vija të trasha, mund të themi se një realitet territorial si Kalabria, ku prania e kirit të organizuar të llojit mafioz është e shumë, e fuqishme dhe agresive, sipërmarrësit shtyhen natyrshëm të ndjekin ***një strategji bashkëpunimi***.

Interesi i krimit të organizuar është përqendruar natyrshëm në punimet me kosto më të madhe, përmes lidhjes së paligjshme të marrëveshjeve paraprake me ndërmarrjet e tenderuara në fjalë dhe me përdorimin e njëkohshëm të një sipërmarrjeje të vogël që është e lidhur me degët lokale të organizatës mafioze sidomos për zbatimin e punimeve të lëvizjes së dherave, që përgjithësisht paguhen “në total apo forfe” dhe jo “me llogaritje”, e për rrjedhojë është më e vështirë të kryhen kontrollet e nevojshëm. Edhe disa drejtues të entit prokurues janë përfshirë në mënyra të ndryshme në këto marrëveshje të paligjshme. As nuk duhet lënë pas dore efikasiteti i pakët, për të mos thënë mungesa e plotë e kontrolleve serioze mbi prokurimin, me nënkontraktim, të një pjesë të mirë të punimeve në fjalë, realizimi i të cilave është bërë nga shoqëri që nuk ishin deklaruar që në krye nga shoqëria fituese e tenderit. Për shkak të mungesës së kontrolleve të përshtatshme nga ana e A.N.A.S. janë vërtetuar parregullsi të ndryshme gjatë tenderit (ulje të tepruara çmimi, deri në 36% mbi çmimin e përcaktuar si bazë ankandi, projekte të përgjithme të rreme, me të cilët duhet të përkojnë në mënyrë artificiale projektet e zbatimit, ekspertizat apo aktvlerësimet variant të kryera me qëllim që të fryhet kostoja e punimeve të prokuruar).

Në **Kampania** zhvillimi i ***marrëdhënieve mes kamorrës (camorra) dhe sipërmarrjes në sektorin specifik të punimeve publike***, është përcaktuar nga fakti që një numër gjithnjë e më i madh sipërmarrësish u përpoq (me sukses) të kthente në përfitim të vet marrëdhënien me organizatat kamorriste duke rekuperuar koston e humbjes së pësuar për shkak të zhatjes si **mundësi gjithnjë e më e madhe për të fituar**, falë *marrëveshjeve të mira të kamorrës, një klientelë të re apo për të siguruar rekuperimin e të ardhurave të pambledhshme apo, përsëri, paqen me sindikatat së*

bashku me garancinë për zhvillimin e qetë të punimeve nëpër kantiere¹⁰⁴.

Nga një marrëdhënie e pastër nënshtrimi ndaj kamorrës, shumë sipërmarrës kanë kaluar në një marrëdhënie ndërveprimi të ndërsjellë që ka rënduar më shumë gjendjen e “ndotjes”, që shënjohej nga njëpërqindje e lartë paligjshmërie e përhapur në sektorin sipërmarrës të ekonomisë vendase¹⁰⁵.

E gjitha kjo ndihmon për të justifikuar pohimin sipas të cilit “kontrolli me ndërmarrjet e veta të prokurimeve ka qenë për kamorrën thelbi i vërtetë i *sistemit*, mekanizmi qendror i grumbullimit ekonomik dhe shtrirjes së pushtetit të vet kriminal”¹⁰⁶.

Kemi arsye të mendojmë ndër të tjera që kamorra i ka investuar sërish fitimet e veta të grumbulluara përmes përdorimit të këtij *sistemi kriminal* në të njëjtin treg ndërtimi të zonave që janë në kontrollin e saj, në mënyrë të tillë që vendosin sundimin e tyre mbi strukturat ekonomiko-financiare dhe sipërmarrëse të sektorit me mundësinë për të përshpejtuar, edhe në këtë mënyrë, *procesin e vet të ligjërimit social*¹⁰⁷.

¹⁰⁴ Lidhur me këtë pikë, analiza (e pabotuar) e përgatitur nga R.ROBERTI dhe C.LEMBO, në kuadrin e Shërbimit të Prokurimeve të Drejtorisë kombëtare antimafia, mbi temën *Modalità d'infiltrazione della criminalità organizzata nei pubblici applati*, Roma, 2001, fq.11 e vijues.

¹⁰⁵ Në analizën e cituar më lart, shënimi 16, theksohet se “*ndër shkaqet e shumta që e bëjnë jo të vështirë “të fituarit” e sipërmarrësit nga ana e organizatës kriminale duhet treguar situata që priret drejt paligjshmërisë së kategorisë sipërmarrëse: krimet e llojit ekonomik rriten, në trevjeçarin 84-87, hark kohor në të cilin është forcuar marrëdhënia mes sistemit kamorrist Alfieri dhe sipërmarrjeve, me 15% të totalit kundrejt 10% të trevjeçarit të mëparshëm; me një kulm për krimet e falimentimit që rriten po në këtë trevjeçar me 93%; duke ruajtur kështu në vitet e tjera një përqindje të vazhdueshme përshpejtimi, edhe pse pak më të ulët, sipas të dhënave të marra nga INSTAT.*

¹⁰⁶ Krs. studimin e përmendur në shënimin e mëparshëm n.11, fq.14.

¹⁰⁷ Është vërejtur (shih studimin e lartpërmendur, shënimi 16) se “*gjatë këtyre viteve, ende nuk është përcaktuar një kanal ndërkombëtar apo kombëtar i pastrimit të parave i krijuar nga njerëz të kamorrës (as edhe pas bashkëpunimit të disa prej kryetarëve dhe njerëzve më të rëndësishëm të saj), ndërsa këto kanale janë vërtetuar për pothuaj të gjitha organizatat e tjera të mëdha kriminale, dhe do të kuptohet që në zonat e kontrolluara nga kjo organizatë kriminale, fitimet e jashtëzakonshme të organizatës reinvestoheshin pikërisht në tregun e ndërtimit, për të marrë kontrollin e tij gjithnjë e më të gjerë, për të pasur nën kontrollin e vet pjesën më të madhe, për të fshehur sa më shumë praninë e tyre në sektor, në formën e fajdes dhe të ushtrimit abuziv të kredisë për sipërmarrësit.*

Carmine ALFIERI, kreu i kamorrës në vitet 1984 deri në 1992 – flet për “hua” me përqindje bankare të dhëna nga ai në favor të shumë ndërmarrjeve të sektorit, por ishin “hua” që përcaktonte kontrollin nga ana e ALFIERIT mbi veprimtarinë e shoqërive “të

Fuqizimit të këtij sistemi dhe përhapjes së një mendësie të shtrembër sipërmarrjeje, sidomos në sektorin e prodhimit dhe shpërndarjes së inerteve dhe konglomerateve të çimentos dhe bitumit, ndihmoi krijimi andej nga fundi i viteve '80 i konsorciumeve të ndërmarrjeve. Kryesisht bëhej fjalë për grupe ndërmarrjesh, të lidhura dhe/ose të varura nga kamorra, objektivi parësor i të cilave nuk ish ai i shpërndarjes sinergjike e me marrëveshje të aftësive, përgjegjësisë dhe fitimeve të sipërmarrjes, por ai i marrjes përsipër, në përpjestim, mes ndërmarrjeve që bëhen pjesë e konsorciumit, të kostove më të mëdha që rrjedhin nga rritja artificiale – por me marrëveshje – e çmimeve të furnizimit të betonit¹⁰⁸, në mënyrë të tillë që garanton në mënyrë të njëjtë dhe të kontrollueshme pagesën e ryshfetit për kamorrën.

Në këtë mënyrë, jo vetëm u prish rregulli sovran i tregut të lirë, i përbërë nga ekuilibri i kërkesës me ofertën, por u shkaktua dhe një **tjetër efekt i rëndë i shtrembërimit të ekonomisë së ligjshme** që qëndron në shkeljen e dukshme të parimeve kushtetuese në lidhje me lirinë e nismës ekonomike private e cila, sipas normës së nenit 41 të Kushtetutës, “*nuk mund të zhvillohet në kundërshtim me dobinë e shoqërisë apo në mënyrë të tillë që i shkakton dëm sigurisë, lirisë, dinjitetit njerëzor*”¹⁰⁹.

Zhdukja e organizatës kamorriste, të quajtur *Nuova Famiglia (Familja e Re)*, që kryesohej nga Carmine Alfieri, u shoqërua nga shpërbërja e këtij sistemi, që pjesërisht u mbijetoi – ashtu siç duket të tregojnë disa hetime të kohëve të fundit – në marrëveshjen e stisur të rritjes së çmimeve të tregut në lidhje me furnizimet e inerteve dhe konglomeratëve të çimentos dhe bitumit.

Kjo mundësi e re strategjike, e përshtatshme për të fshehur pagesën e ryshfetit kamorrist, e thithur nga **rritja artificiale e çmimit të tregut**, u përhap me shpejtësi në mjediset sipërmarrëse që bashkëpunuan me kamorrën apo që ishin bërë pre e saj dhe, për sa na rezulton, përfaqëson ende sot për pjesën më të madhe të punimeve të kryera në prokurimet publike dhe/ose me nënkontraktim, metodën që ndiqet për gjetjen e fondeve që më pas u duhen kaluar organizatave kriminale.

përfituara”. Është e pamundur të mendojmë në fakt që ato mund të kthenin paratë e marrë nëse do u kërkohej (nëse kishin pasur një situatë të ngjashme mungese likuiditeti, sigurisht që do i ishin drejtuar sistemit bankar), e as nuk do mund të mos praninin ta bënin: vjen nga kjo nënshtrimi dhe kontrolli.

¹⁰⁸ Rritja e çmimit është përgjithësisht më e madhe se 2000 lireta të vjetra për metër kub.

¹⁰⁹ Shih *Relazione annuale del Procuratore nazionale antimafia* (hartuar në bazë të neni 76-ter Ord.giud.), tetor 1999, fq. 17.

§ 4. Zhvillimi i sistemit normativ në lidhje me punët publike dhe instrumentet e rinj dhe modulet e parandalimit të risqeve të infiltrimit mafioz.

Siç e përmendëm, pas ardhjes në fuqi të ligjit n.443 të dt.21 dhjetor 2001, (i ashtuquajtur *ligj objektiv*), që përmban “Autorizimin për Qeverinë në lidhje me infrastrukturën dhe impiantet prodhuese strategjike dhe ndërhyrje të tjera për rilançimin e veprimtarive prodhuese”, periudha e infiltrimit mafioz në sektorin e prokurimeve publike duket se nuk është zbutur.

Me afirmimin e figurës së re sipërmarrëse të *kontraktorit të përgjithshëm*, të cilës i besohet realizimi “*me çdo mjet*” i një veprë që përkon me nevojat e treguara nga subjekti i kontraktuar, situata ka ndryshuar thellësisht¹¹⁰.

Privatizimi i marrëdhënieve si të thuash në bazë të kontraktorit të përgjithshëm¹¹¹ ka sjellë në fakt një *thjeshtim dhe liberalizim të theksuar të procedurave të kontraktimit dhe nënkontraktimit të punimeve tek të tretët* (i kontraktuari, i nënkontraktuari dhe, më në përgjithësi, nënkontraktuesi, furnitori dhe nënfurnitori i mjeteve dhe materialeve), por edhe *shmangia e tyre ndaj disiplinës së evidencës publike*. I njëjti rregullim, për sa u takon marrëdhënieve me nënkontraktuesi, përcaktohet për rastin e financimit të realizimit dhe veprave infrastrukturore në formë koncesioni për ndërtimin dhe administrimin në bazë të neneve 6, parag.1 germa a) dhe 7 të dekretit legjislativ nr.190, të vitit 2002¹¹².

¹¹⁰ Lidhur me këtë pikë, shih shënimin 6.

¹¹¹ Marrëdhëniet e *kontraktorit të përgjithshëm* “me të tretët”, sidoqoftë të përfshirë në realizimin e veprës, “*janë marrëdhënie të të drejtës private, për të cilnë mund të zbatohen normat e ligjit kuadër dhe të rregullores përkatëse*”, me përjashtim të sa parashikuar nga ligji i delegimit i vitit 2001, nga dekreti legjislativ në zbatim dhe plotësim të rregullores siç në nenin 15 të po këtij dekreti: shih neni 9, parag. 6, i dekretit legjislativ n.190, 2002, i cit.

¹¹² Parag.3 i nenit 7 cit. përmban në fakt disa sqarime të rëndësishme. “*Në marrëdhëniet e koncesionarit me të prokuruarit e vet (...) b) procedurat e prokurimit të koncesionarit dhe marrëdhëniet e këtij koncesionari me të prokuruarit e vet apo me kontraktorin e përgjithshëm, rregullohen vetëm nga:*

normat rregulluese të prokurimeve të koncesionarit siç në direktivën 93/37/KEE të Këshillit, dt.14 qershor 2003;

norma e përzgjedhjes të të kontraktuarve dhe nënkontraktuarve siç në dekretin e presidentit të Republikës nr.34, dt.25.01.2000;

verifikime antimafie, që duhen kryer kundrejt të kontraktuarve dhe nënkontraktuarve të punimeve”.

Kjo nuk do të thotë se “Marrëdhëniet mes koncesionarit dhe të kontraktuarit apo kontraktorit të përgjithshëm janë marrëdhënie të të drejtës private të rregulluara nga

Në një përmbledhje të fundit, mund të themi se legjislacioni më i fundit mbi punimet publike dhe realizimin e veprave të mëdha infrastrukturore, që janë të destinuara të rilançojnë ekonominë e vendit, karakterizohet nga *thjeshtimi i procedurave dhe nga prirja e privatizimit të marrëdhënieve mes kontraktorit të përgjithshëm dhe koncesionarit, nga njëra anë, dhe çdo subjekt tjetër i interesuar për realizimin e veprës nga ana tjetër.*

Kësaj i shtojmë se *sistemi i ri i përzgjedhjes së shoqërive*, aktualisht i përqendruar mbi **Shoqëritë Organizma Certifikues (S.O.C.)**, shoqëri kapitali e të drejtës private, të nënshtruara ndaj rregullimit të autorizimeve nga ana e Autoritetit për mbikëqyrjen mbi kontratat publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve¹¹³, deri tani duket se nuk është në gjendje të garantojë transparencën e nevojshme të procedurës së përzgjedhjes. Siç dihet, pas mbylljes së Regjistrimit Kombëtar të Ndërtuesve, **përzgjedhja e shoqërive të interesuara të marrin pjesë në prokurime publike për shuma më të mëdha se 150.000 Euro i është lënë S.O.C., për shkak të marrëveshjes private me ndikime të qarta me karakter publicist**, pas verifikimit të kriterëve të përgjithshme të parashikuar nga nenet 17 e 18 të D.P.R. nr.34, të vitit 2000. megjithatë, në zbatimin konkret të reformës së sistemit përzgjedhës të shoqërive, mbetet ende për të verifikuar nëse – nëse po, në cilën masë – kriteri i vetëm i pavarësisë (së supozuar) të S.O.C. është njësoj objekt i kontrollit (të mundshëm) nga ana e Autoritetit kompetent mbikëqyrës, mund të garantojë transparencën e nevojshme të procedurës së përzgjedhjes. Lidhur me këtë, është rasti të themi se qëllimi i fitimit, i lidhur ngushtë me ushtrimin e funksioneve sipërmarrëse të S.O.C. mund të rezultojë *konkretisht* si jo i huaj për zhvillimin e veprimtarisë përkatëse të kontrollit dhe certifikimit¹¹⁴.

kontrata dhe nga normat e kodit civil rregullues të prokurimit; për këto procedura dhe marrëdhënie nuk zbatohen normat e ligjit kuadër dhe të rregullores”.

¹¹³ Në bazë të nenit 6, parag. 6, germa m) i Dekretit Legjislativ nr.163, dt. 12.04.2006, Autoriteti “mbikëqyr mbi sistemin e përzgjedhjes, me modalitetet e përcaktuara nga rregullorja siç në nenin 5 (bëhet fjalë për rregulloren e destinuar të diktojë, ndër të tjera – në bazë të nenit 5, parag.5, të D.legjislativ të përmendur – “dispozitat zbatuese dhe ekzekutuese” (të Kodit të ri të kontratave publike) edhe në lidhje me “kriteret subjektive, certifikime cilësie, si dhe përzgjedhje të operatorëve ekonomikë”, sipas kriterëve të përcaktuar po nga ky Kod.

¹¹⁴ Nuk duhen lënë pa përmendur edhe shqetësimet që shpreh Prokuri kombëtar antimafie dhe Presidenti i Autoritetit për mbikëqyrjen e punëve publike lidhur me pamjaftueshmërinë e sistemit të kontrolleve të kryera nga S.O.C. dhe papërshtatshmëria e përgjithshme dhe qartësia e vakët e dispozitave sanksionues që qëndrojnë në mbrojtje të vërtetësisë së certifikimeve dhe vërtetimeve të lëshuara prej tyre: Shih intervista të lëshuara nga Prokurori kombëtar antimafie, dr. Piero Luigi Vigna dhe nga Presidenti i Autoritetit të mbikëqyrjes së

Nga ana tjetër, në perspektivën e paqartësive që mund të kihen lidhur me zbatueshmërinë e normave penale për falsifikim aktesh (le të mendojmë këtu **dyshimet e mundshme interpretuese rreth cilësimit juridik të autorit të vërtetimit si punonjës publik apo i ngarkuar me funksion publik** apo mbi natyrën juridike të akteve që bëjnë pjesë në procedurën e përzgjedhjes), sugjerimi për ta bërë eksplicite, në nivel ligjor, natyrën publicistike të veprimtarisë së vërtetimit dhe përzgjedhjes së bërë nga S.O.C. duket se i shkon për shtat ligjvënësit¹¹⁵. Në fakt nga njëra anë ekziston rreziku që të mbetet pa një sanksion të përshtatshëm një numër i madh veprash të paligjshme, që përvoja na ka mësuar se ekzistojnë në këtë fushë¹¹⁶, dhe nga ana tjetër, është konstatimi se mbrojtja e interesave me një natyrë të pastër publicistike, si ato të parashikuara nga neni 97 i Kushtetutës¹¹⁷, u mbetet vërtetimeve dhe certifikimeve, me natyrë jo të qartë juridike, që vijnë nga subjekte të të drejtës private (S.O.C.), edhe kur u nënshtrohen autorizimeve dhe kontroleve me natyrë publikuese nga ana e Autoriteteve mbikëqyrëse të punimeve publike¹¹⁸.

punëve publike, Prof. Francesco GARRI, në *Il Sole – 24 ORE, Ndërtimi dhe Territori, 1-6 tetor 2003*, viti VII, nr.47, fq.1-3.

¹¹⁵ Lidhur me këtë duhet thënë se në bazë të disa të dhënave të sjella nga Komiteti i Koordinimit për Mbikëqyrjen e Lartë të veprave të mëdha, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 26 janar 2007, është miratuar një skemë e dekretit legjislativ që përmban “*dispozita ndreqëse dhe plotësuese të d.legjislativ n.163, të 12 prillit 2006*”, në të cilin, neni 2 nëntitulli “*Mbikëqyrja në fushën e kontratave publike*” është njohur shprehimisht “*natyra publicistike*” e S.O.C. “*në ushtrimin e veprimtarive të certifikimit për zbatuesit e punëve publike*”. Po kjo normë parashikon që certifikimet e lëshuara nga S.O.C. “*përbëjnë një akt publik për qëllime penale*”.

¹¹⁶ Shih artikullin në të përjavshmen *Edilizia e Territorio*, cit, më lart, shënimi 18.

¹¹⁷ Ligji nr.109, i 11.02.1994 (i ashtuquajtur i *ligji Merloni*), shprehimisht i abroguar nga neni 256, parag. 1i D.legjislativ n.163, dt. 12 prill 2006, përmbante në nenin 1, referimin *esplicit* ndaj normës kushtetuese: “*Në zbatim të nenit 97 të Kushtetutës, veprimtaria administrative në lidhje me veprat dhe punët publike dhe duhet të garantojë cilësinë e tyre dhe një njësohen me kriteret e efikasitetit dhe efikasitetit, sipas procedurave që mbështeten në shpejtësinë, transparencën dhe saktësinë, në respektim të të drejtës komunitare dhe të konkurrencës së lirë mes operatorëve*”. Ky referim *esplicit* nuk gjendet në nenin 2 të D.legjislativ n.163, si më lart, ku tregohen “*Parimet*” në të cilët frymëzohet Kodi i ri i kontratave publike. Kjo nuk do të thotë që ky referim duhet të konsiderohet *implicit* në të njëjtin nivel të fjalëpërfjalshëm të dispozitës së lartpërmendur, aty ku afirmohet se “*prokurimi dhe realizimi i veprave dhe punëve publike, shërbimeve dhe furnizimeve (...) duhet të garantojë*” – ndër të tjera – “*respektimin e parimeve të (...) efikasitetit, shpejtësisë dhe saktësisë (...) barazisë së trajtimit, mosdiskriminimit, transparencës, përpjestueshmërisë, si dhe të publicitetit (të shpalljes) (...)*”.

¹¹⁸ Lidhur me këtë pikë, shih analizat e Prokurorit kombëtar antimafie në intervistën e lartpërmendur (shënimi 18), aty ku thekson parregullsinë “*për shkak të faktit që filtri i aksesit ndaj sistemit të punëve publike, ndonëse përbëhet nga certifikime dhe vërtetime të*

Gjithashtu duhet të mbajmë parasysh se sistemi i ri i prokurimit të dhe realizimit të veprave të mëdha publike, i përqendruar në figurën e kontraktorit të përgjithshëm, paraqet aspekte të reja – dhe ndoshta më të rënda se në të shkuarën – vulnerabiliteti kundrejt formave të njohura e të vërtetuara të infiltrimit të krimit të organizuar.

Në fakt mund të parashikohet lehtë se krimi i organizuar i llojit mafioz, tashmë prej kohësh i angazhuar në një veprimtari të ngjeshur fshehjeje në sistemin ekonomik-prodhues, do të përpiqet të depërtojë në sistemin e ri të punimeve publike përmes hapësirave – ende tepër të mëdha – të një legjislacioni që, në këto vite të fundit, është marrë më shumë me realizimin e shpejtë të veprave të mëdha infrastrukturore dhe të impianteve industriale strategjike parësore për zhvillimin e sistemit tonë socio-ekonomik, se me rreziqet që lidhen me këtë proces të modernizimit të vendit¹¹⁹.

As nuk shërben të kundërshtojmë duke thënë se Kodi i ri i kontratave publike, ka përcaktuar (neni 12, parag. 4¹²⁰), se “*nuk ndryshojnë normat në fuqi që parashikojnë kontrolle mbi kontratat publike me qëllim parandalimin e veprave penale*” dhe, në një dispozitë të posaçme përfundimtare (neni 247), ka lënë qartë pa ndryshuar normativën antimafia në fuqi “*në fushën e parandalimit të kriminalitetit të llojit mafioz dhe të komunikimeve dhe informacioneve antimafie*”¹²¹.

bëra nga subjektë privatë, duhet të jetë gjithnjë i orientuar ndaj zbatimit të plotë të parimeve kushtetuese të treguara për administratën publike dhe të ngrihet si objektiv realizimi i interesave parësorë të natyrës publicistike”.

¹¹⁹ Nga ana tjetër, ideja qendrore e ligjit objektiv është më se qartë në punët përkatëse përgatitore (Shih relacionin për projekt-ligjin 374/A.S. të 3 korrikut 2001, fq.2), aty ku afirmohet plotësisht që “*ligjshmëria politike dhe juridike e veprës qëndron në ...vetë veprën, pasi ajo identikohet meobjektivi strategjik*”. Ky formulim, duke sjellë mozbatimin e çdo parashikimi tjetër ligjor (me përjashtim vetëm të parimeve komunitare, kushtetuese dhe të të drejtës penale), “*shkak sistematik i pengesës*” për realizimin e shpejtë të këtij “*objektivi strategjik*”, duket qartë që mbështetet në një pragmatizëm absolut, “*të karakterizuar nga epërsia empirike e qëllimit mbi mjetin*”, me një rrjedhojë të fundit që “*meqë ekziston qëllimi objektiv, mjete duhet (mund) të përshtatet*” (Shih relacionin tjetër, fq.4). Në të vërtetë, ajo që duket se mungon në rregullimin e ri të veprave publike infrastrukturore dhe të impianteve industriale strategjike, është pikërisht rregullimi i përshtatjes së mjeteve, sidomos në perspektivën e parandalimit të rrezikut të infiltrimeve mafioze.

¹²⁰ Rubrika e artikullit ka të bëjë me “*Kontrollet mbi aktet e procedurave të prokurimit*”.

¹²¹ Po kështu, përpara ardhjes në fuqi të Dekretit legjislativ n.163, i vitit 2006, neni 9 i D.legj.n.190, di 20.08.2002 (që përmban norma të zbatimit të ligjit n.443, dt. 21 dhjetor 2001 “*për realizimin e infrastrukturave dhe impianteve prodhuese strategjike dhe me interes kombëtar*”), në rregullimin e marrëdhënieve mes kontraktorit të përgjithshëm dhe të prokuruarve të tretë dhe ndër këta të fund dhe të nënprokuruarit, përmbante një referim të

Në të vërtetë bëhet fjalë për një referim të pastër ndaj përmbajtjes konceptuale por dhe të përgjithshme¹²², që në kuadrin aktual e të rrëmujshtëm ligjor, shërbejnë pak për të krijuar mbrojtje të sigurt dhe efikase kundër rreziqeve të infitimit mafioz në këtë sektor.

Në këtë kuptim, janë emblematike parashikimet e nenit 18 të ligjit n.55¹²³ të 19 marsit 1990, shprehimisht të abroguar, duke filluar nga data e ardhjes në fuqi të Kodit të ri të kontratave publike (1° korrik 2006), nga neni 256,

posaçëm ndaj nenit 18 të ligjit 19 mars 1990, nr.55, duke parashikuar që ai “zbatohet për nënkontraktorët e mësipërm”.

¹²² Eshhtë më se e vështirë ta mbështesim këtë parashikim të përgjithshëm legjislativ vetëm në kontrollet, që dolën se nuk ishin dhe aq efikase, që iu lanë prefekturës (le të mendojmë, p.sh. për kontrollet në kantieret e punimeve nga ana e G.I.A. (Grupi Investigativ Antimafie).

¹²³ Ndër dispozitat që përmban neni 18 i ligjit n.55 të vitit 1990, meritojnë të theksohen këto:

1. ndalimi i nënprokurimit apo prokurimit me porosi të punimeve që kalojnë gjithsej 30% të shumës neto të dhëniës së prokurimit;
2. parashikimi i disa “kushteve të veçanta” të cilave u nënshtrohet prokurimi me nënkontraktim apo porosi:
 - a. përcaktim paraprak i punimeve që konkurrentët mendojnë të nënkontraktin apo japin me akord;
 - b. depozitim i kontratës së nënkontraktimit pranë entit prokurues njëzet ditë përpara datës së fillimit të punimeve;
 - c. përcjellje e njëkohshme e certifikimit që vërteton se nënkontraktori zotëron kualifikimin e nevojshëm;
 - d. fakti se nuk ekziston ndaj prokuruesit të tretë asnjë nga ndalimet e parashikuara në nenin 10 të ligjit n.575 të ligjit të 31 majit 1965 dhe ndryshimet e mëvonshme të tij;
 - e. përcjellje tek enti prokurues i kopjes së faturave dhe dëftesave lidhur me pagesat e bëra në favor të nënkontraktorit apo atij që punon me akord;
 - f. ndalimi për të zbatuar për punimet dhe veprat që janë dhënë me nënkontraktim çmime të përbashkëta me Ulje çmimi më të madh se 20%;
 - g. përcaktim i të gjitha shoqërive të nënkontraktuara në grupet e ekspozuara jashtë kantierit;
 - h. detyrimi për respektimin e dispozitave në lidhje me sigurimet, përkujdesjen dhe aksidentetimin në vendin e punës;
 - i. detyrim nga ana e shoqërisë prokuruese për të treguar ekzistencën apo jo të formave të mundshme të kontrollit apo të lidhjes *ex neni* 2359 të k.c. me shoqërinë që nënkontraktin apo jep punimet me akord;
 - j. ndalim i një nënkontraktimi të mëtejshëm;
 - k. barazim i nënkontraktimit të furnizimeve me instalim dhe me qera në të nxehtë e në të ftohtë për një shumë më të madhe se njëqind mijë Euro dhe 2% të shumës së punëve të prokuruar, nëse përqindja e kostos së haktut të punës së personelit është më e lartë se 50% e shumës së kontratës që duhet prokuruar;
 - l. detyrimi i të kontraktuarit për të njoftuar entin prokurues për të gjithë nënkontraktimet e lidhura për realizimin e prokurimit, emrin e nënkontraktuesit, shumën e kontratës, objektin e punës, shërbimit apo furnizimit të dhëna.

parag.1, i Kodit të ri të kontratave publike, por kryesisht i ka mbijetuar abrogimit formal përmes riprodhimit të konceptit përkatës, me ndonjë shtesë¹²⁴ jo të paktë dhe ndryshim leksikor, në nenin 118 të po këtij Kodi¹²⁵.

¹²⁴ I referohemi në veçanti parag.11, sipas të cilit “Për qëllime të këtij neni **konsiderohet nënkontraktim** çdo kontratë që ka për objekt veprimtari që kryhen kudo e që kërkojnë përdorimin e krahut të punës, si **furnizime me instalim dhe qera në të nxehtë**, nëse secila prej tyre kap shumën më të madhe se 2% të shumës së punës së prokuruar apo të një shume më të madhe se 100.000 euro dhe nëse përqindja e kostos së krahut të punës dhe personelit është më e lartë se 50% e shumës së kontratës që duhet prokuruar. Nënkontraktuesi nuk mund të nënkontrakttojë nga ana e vet punë, me përjashtim të furnizimit me instalim të impianteve dhe strukturave speciale që duhen përcaktuar me rregullore: në këto raste furnitori apo i nënkontraktuari, për instalimin dhe montimin, mund të mbështetet tek shoqëritë e besuara të vetat për të cilat nuk ekziston asnjë prej ndalimeve siç në parag.2, numri 4). Përbën detyrim për prokuruarin të njëftojë entin prokurues, për gjithë të nënkontraktuarit për kryerjen e prokurimit, emrin e të nën.-kontraktuarit, shumën e kontratës, objektin e punës, shërbimin apo furnizimin”. Lidhur me këtë pikë, është rasti të njoftojmë se shtrirja e qartë e konceptit të parë të nenit 21, të ligjit n.646, të vitit 1982 e të ndryshimeve të mëvonshme; që rrjedhin nga dispozita e re (vetëm në dukje interpretuese e nocionit të parë të nënkontraktimit të përfuar nga normativa parashikuese) mund të ketë vlerë në rrafshin hermeneutiko-zbatues, duke filluar nga data 1^o korrik 2006, data e ardhjes në fuqi të D.legjislativ nr.163, të vitit 2006 dhe, në referim ndaj veprave-krim të përmendura këtu, të kryera duke filluar nga kjo datë.

¹²⁵ Për një krahasim të dobishëm mes dy dispozitave, sjellim tekstin e nenit 118 të Dekretit legjislativ nr.163, të vitit 2006:

“Neni 118. Nënkontraktimi dhe veprimtaritë që nuk përbëjnë nënkontraktim.

(neni 25, direktiva 2004/18; neni 37, direktiva 2004/17; neni 18, ligji n.55/1990; neni 16, d.legjislativ n.358, i dt. 24 mars 1992; neni 18, d.legjislativ n.157, i dt.17 mars 1995; neni 21, i d.legjislativ n.158, i 17 mars 1995; 34, ligji n.109/1994).

1. Subjektet e kontraktuar siç në këtë kod janë të detyruar të kryejnë vetë veprat dhe punimet, shërbimet, furnizimet e përfshira në kontratë. Kontrata nuk mund të transferohet, përndryshe do të shfuqizohet, me përjashtim të sa parashikuar në nenin 116.

2. Enti prokurues është i detyruar të tregojë në projekt dhe në njoftimin për tender shërbimet e veçanta dhe, për punimet, kategorinë kryesuese me shumën përkatëse, si dhe kategoritë e tjera, në lidhje me të cilat punimet e tjera të parashikuara në projekt, edhe ato me shumën përkatëse. Të gjitha shërbimet si dhe punimet, cilëso kategori i përkasin ato, janë të nënprokurueshme dhe të kontraktueshme me akord, pa ndryshuar dispozitat në fuqi që parashikojnë rastet e ndalimit dhe dhënies në nënkontraktim. Për punimet, përsa i takon kategorisë kryesuese, me rregulloren përcaktohet kuota pjesë e nënkontraktueshme, në masë të ndryshme në varësi të kategorive, por sidoqoftë jo më e madhe se tridhjetë për qind. Për shërbimet dhe furnizimet, kjo kuotë i referohet shumës së përgjithshme të kontratës. Dhënia me nënkontraktim apo me akord u nënshtrohet këtyre kushteve: 1) që konkurrentët në aktin e ofertës apo i kontraktuari, në rastin e varinateve gjatë realizimit, në aktin e prokurimit, kanë treguar punimet apo pjesë të veprave apo shërbime dhe furnizime apo pjesë të shërbimeve dhe furnizimeve që kërkojnë të nënkontraktojnë apo japin me akord; 2) që i kontraktuari të kujdeset të depozitojë kontratën e nënkontraktimit pranë entit prokurues të paktën njëzet ditë përpara datës së nisjes efektive të realizimit të detyrimit

përkatës; 3) që në kohën e depozitimit të kontratës së nënkontraktimit pranë entit prokurues i kontraktuari do t'i përcjellë gjithashtu vërtetimin se i nënkontraktuari zotëron kriteret e kualifikimit siç parashikuar në këtë kod në lidhje me punën e nënkontraktuar dhe deklaratën e nënkontraktuesit që vërteton se gëzon kriteret e parashikuara në nenin 38; 4) që nuk ekziston kundrejt marrësit të nënkontraktimit apo të akordit, asnjë nga ndalimet e parashikuara në nenin 10 të ligjit n.575, dt. 31 maj 1965, dhe ndryshime të mëvonshme të tij.

3. Në njoftimin për tender enti prokurues tregon se do të kujdeset t'i paguajë drejtpërsëdrejti të nënkontraktuarit apo atij që punon me akord shumë e detyrimit për punë të kryera nga këta të fundit, ose ndryshe, që është krijuar detyrim për të kontraktuarit që brenda njëzet ditësh nga data e çdo pagese të kryer ndaj tyre të dorëzojnë një kopje të faturave e dëftesave përkatëse të pagesave që ata të kontraktuar i kanë paguar të nënkontraktuarit apo atij që punon për ta me akord, duke treguar edhe shumat e mbajtura si garanci. Në rast pagese të drejtpërdrejtë i njoftojnë entit prokurues pjesën e punëve të kryera nga i nënkontraktuari apo nga ai që punon me akord, duke treguar në mënyre specifike shumën përkatëse dhe propozim e arsyetuar për pagesë.

4. I kontraktuari, për punë që i janë dhënë me nënkontraktim, duhet të zbatojë të njëjtat çmime që rezultojnë nga shpallja e fituesit të prokurimit, me një ulje që nuk duhet të jetë më e madhe se njëzet për qind.

5. Për punimet, në tabelat e vendosura brend akantierit duhet të tregohen edhe merat e gjithë shoqërive të nënkontraktuara, si dhe të dhënat sipas parag. 2, nr.3).

6. I kontraktuari është i detyruar të respektojë plotësisht shpërblimin e pagës dhe sipas ligjit të përcaktuar në kontratat kolektive kombëtare dhe territoriale në fuqi për sektorin dhe zonën të të cilën kryhen punimet; është gjithashtu përgjegjës i vetëm i respektimit të normave të lartpërmendura nga ana e të nënkontraktuarve kundrejt vartësve të vet për shërbimet e kryera në kuadrin e nënkontraktimit. I kontraktuari dhe, nëpërmjet tij, të nënkontraktuarit, i përcjellin entit prokurues përpara nisjes së punimeve dokumentacionin e kryerjes së deklaratimit para entit të sigurimeve, përfshirë Arkën e Ndërtimit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe të sigurimeve ndaj aksidenteve në punë, si dhe një kopje të planit siç në parag.7. I kontraktuari dhe, nëpërmjet tij, të nënkontraktuarit përcjellin në mënyrë periodike tek administrata apo enti porositës një kopje të derdhjes së sigurimeve, shoqërore, shëndetësore, si dhe të atyre që u detyrohen organizmave të barazvlefshëm të parashikuar nga kontraktimi kolektiv.

7. Planet e sigurisë siç në nenin 131 vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente të ngarkuara me kontrollin dhe inspektimin e kantierëve. I kontraktuari është i detyruar të kujdeset për koordinimin e të gjithë të nënkontraktuarve që veprojnë në kantier, me qëllim që planet specifike të hartuar nga të nënkontraktuarit të jenë në përputhje mes tyre dhe koherente me planin e paraqitur nga i kontraktuari. Në rast grupimi të përkohshëm apo të një konsorciumi, ky detyrim i takon të prokuruarit. Drejtori teknik i kantierit është përgjegjës për respektimin nga ana e gjithë shoqërive të angazhuara në realizimin e punimeve.

8. I kontraktuari që përdor nënkontraktimin apo akordin duhet të bashkangjisë kopjes autentike të kontratës një deklaratë lidhur me ekzistencën apo jo të formave të mundshme të kontrollit apo lidhjes në bazë të nenit 2359 të kodit civil me titullarin e nënkontraktimit apo të akordit. Po kjo deklaratë duhet të bëhet nga çdonjëri prej subjekteve pjesëmarrës në rastin e grupimit të përkohshëm, shoqëri apo konsorcium. Enti prokurues kujdeset të lëshojë **autorizimin** brenda tridhjetë ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse; ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, atëherë kur ekzistojnë arsye të justifikueshme. Nëse nuk do të jetë

As nuk duhet lënë pa thënë se ndër shkeljet e parashikuara nga neni 18, vetëm ato që kanë të bëjnë me **mosrespektimin e ndalimit të nënkontraktimit apo me porosi jo të autorizuar** rezulton të ndëshkohen penalisht nga neni 21 i ligjit 13 shtator 1982, nr.646, ndryshuar nga neni 8 i ligjit n.55, të vitit 1990¹²⁶. Bëhet fjalë për një shkelje të thjeshtë, për të cilën është e zbatueshme rrethana e rënduar sipas nenit 7 i D.L. nr.152 e vitit 1991. **Pas abrogimit të nenit 18 të ligjit n.55 cit**, dispozita legislative që parashikon **detyrimin për “të kontraktuarin që përdor nënkontraktimin apo porosinë” t’u pajisur - ndër të tjera – me autorizimin e entit prokurues gjendet në nenin 118 të dekretit legjislativ nr.163, të vitit 2006¹²⁷.**

kryer pas këtij afati, atëherë autorizimi konsiderohet i dhënë. Për nënkontraktimet apo akordet për shuma më të vogla se 2 për qind e shumës së punimeve të kontraktuara apo të një shume më të vogël se 100.000 euro, afatet për lëshimin e autorizimit nga ana e entit prokurues zvogëlohen me gjysmën e tyre.

9. Realizimi i punimeve a shërbimeve të prokuruar me nënkontraktim nuk mund të përbëjë objekt të një nënkontraktimi të mëtejshëm.

10. Dispozitat e paragr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 e 9 gjejnë zbatim edhe për grupimet e përkohshëm dhe shoqëritë edhe në formë konsorciumi, kur shoqëritë e bashkuara apo të mbledhura në një konsorcium nuk mendojnë të kryejnë drejtpërsëdrejti shërbimet apo punimet që qëndrojnë jashtë bashkimit, si dhe për shoqatat që marrin pjesë kur i anëtarësuarit nuk mendon të kryejë drejtpërsëdrejti punë të marra me kontraktim; gjejnë zbatim gjithashtu për koncesionet për realizimin e veprave publike dhe financimet me procedurë të negociuar.

11. Për qëllime të këtij neni konsiderohet nënkontraktim çdo kontratë që ka për objekt veprimtari të kryera kudo që kërkojnë përdorimin e krahut të punës, si furnizime me instalim dhe qira në të nxehtë, nëse më vetë ato kapin një shumë më të madhe se 2% të shumës së punimeve të kontraktuara apo për një shumë më të madhe se 100.000 euro dhe nëse përqindja e kostos së krahut të punës dhe e personelit është më e madhe se 50% e shumës së kontratës që duhet nënkontraktuar. I nënkontraktuari nuk mund të nënkontrakttojë nga ana e vet punimet, me përjashtim të furnizimit me instalim apo montim, ai mund të mbështetet në shoqëri të tij të besuara për të cilat nuk ekziston asnjë nga ndalimet e parashikuara nga paragr.2, numri 4). Përbën detyrim për të kontraktuarin njoftimi i entit prokurues për të gjitha nën-kontratat e lidhura për realizimin e prokurimit, emrin e nën-kontraktuesit, shumën e kontratës, objektin e punës, shërbimin apo furnizimin që janë prokuruar.

12. Për qëllime të zbatimit të paragrafëve të mësipërm, kategoritë e mëposhtme të furnizimit apo shërbimeve, për specifika të tyre, nuk konfigurohen si veprimtari që prokurohen me nënkontraktim: a) prokurimi i veprimtarive specifike tek punonjës të pavarur; b) nën-furnizim me katalog i produkteve informatike”.

¹²⁶ Neni 21 parashikon gjithashtu “aftësinë” e pastër të entit prokurues ka “për të kërkuar zgjidhjen e kontratës”.

¹²⁷ Sanksionet për shkeljet e ndalimeve të tjera dhe parashikimet që përmban neni 18 duhen gjetur apo, sidoqoftë, ndërtuar në lidhje me të drejtën administrative dhe të rregullimit privatist të marrëdhënieve mes subjekteve (të të drejtës private) të angazhuar në

Si përfundim, nga një rikonjicion ndonëse përmbledhës i parimeve-bazë që rregullojnë aktualisht dispozitivin e luftës antimafie në fushën e realizimit të veprave të mëdha publike strategjike, del mjaft qartë papërshtatshmëria e përgjithshme e këtij dispozitivi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parashikimit të *normave-pengesë*, që në pjesën më të madhe të tyre qëndrojnë brenda hapësirës së ngushtë ndëshkuese të nenit 21 të ligjit nr.646, të vitit 1982, apo, shumë-shumë, siç do ta shohim, i lihen nismës së lirë të institucioneve vendore dhe subjekteve privatë të interesuar të realizojnë veprën publike.

Për këtë duhet thënë se kohët e fundit po përhapen forma të mbrojtjes alternative që qëndrojnë në lidhjen e *protokolleve të ligjshmërisë* dhe në futjen në njoftimet e shpalljes së tenderave dhe në Pjesët e Posaçme të kontratave, e *klauzolave të pëlqimit*, të diktuara nga qëllimi për të parandaluar rrezikun e infitrimëve mafioze.

Protokollet e ligjshmërisë përfaqësojnë instrumentin përmes të cilit subjektet dhe institucionet e të drejtës publike dhe personat apo entet e të drejtës private lidhin një marrëveshje përmes të cilës marrin, secili sipas kompetencës së vet specifike apo aftësisë institucionale dhe/ose profesionale, angazhimin për të ndërmarrë veprime kundër krimit të organizuar, duke realizuar një sërë ndërhyrjesh të planifikuara, të njëkohshme dhe në ndihmë me ato që janë ekskluzivë e organizmave (si Forcat e Rendit dhe Magjistratura) që institucionalisht duhet të garantojnë kushtet e sigurisë dhe ligjshmërisë për të gjithë shtetasit, në mënyrë të tillë që duhet të realizojnë kushtet më të favorshme për afirmimin e ligjshmërisë në zonat e përfshira në planifikimin sipas marrëveshjes¹²⁸.

Përdorimi i këtij instrumenti teorikisht të përshtatshëm për të përfshirë në zhvillimin socio-ekonomik të një zone të caktuar të gjithë subjektet e

realizimin e veprës, siç duket të sugjerojë edhe parashikimi i rëndësishëm i paragrafit 6 të nenit 176, të Dekretit legjislativ n-163, të vitit 2006 [që ka sjellë një dispozitë të ngjashme të nenit 9 të shfuqizuar të Dekretit legjislativ n.190, të vitit 2002, sipas të cilit “*marrëdhëniet e kontraktorit të përgjithshëm me të tretët janë marrëdhënie të të drejtës private (...)*”].

¹²⁸ Realizimi i këtij objektivi ka pasur sidoqoftë disa vonesa dhe pasiguri jo vetëm për shkak të gjendjes jo të madhe të ecurisë së programimit të negociuar që ka të bëjë me zbatimin e *kontratave të zonës* apo të *pakteve territoriale*, por edhe për shkak të vështirësi për të hedhur, në rrafshin socio-kulturor, një ide të ligjshmërisë të menduar si “*parakusht i nevojshëm*” i zhvillimit ekonomik, më shumë se si e dhënë e destinuar të fitojë “*një rëndësi të veçantë (me karakter të tërthortë) vetëm kur do të bëhen realisht operative shoqëritë, në zonën e konsideruar*”. Lidhur me këtë, krs. *I protocolli di legalità*, në *Documenti* të CNEL, nr.8, dt.25.10.2001, fq. 13-16.

interesuar, institucionet dhe shoqërinë civile, nuk ka sjellë efektin e dëshiruar, jo vetëm për shkak të mungesës së një kornize të posaçme ligjore apo të konventave në gjendje të përcaktojë saktë përmbajtjen, objektivat, modalitetet dhe afatet e zbatimit, por edhe për shkak të prirjes së lindur ndaj zhveshjes së përgjegjësisë nga ana e po këtyre subjekteve të interesuar, që shumë shpesh ka dalë se janë të paaftë të përpunojnë konkretisht një strategji të përbashkët për sigurinë e territorit.

Në mungesë të një parashikimi të qartë ligjor dhe, sidomos, në mungesë të një sistemi efikas sanksionues që do të garantonte zbatimin e plotë të tij, duket se nuk do të kenë fat të mbarë edhe të ashtuquajturit **protokolle mirëkuptimi** të lidhur nga enti prokurues me subjekte të tjerë publikë (p.sh. Autoriteti i Mbikëqyrjes së punimeve publike) apo privatë (p.sh. shoqëri, sipërmarrje ose konsorciume shoqërisht të interesuara të marrin pjesë në njoftime për tender për realizimin e veprave publike), përmes të cilave nënshkruarit e marrëveshjes angazhohen në mënyrë të ndërsjellë të pranojnë **futjen në njoftimet për tender të klauzolave të pëlqimit apo të vetëmbrojtjes**¹²⁹. Në thelb, me nënshkrimin e këtyre *protokolleve* kërkohet të bëhen edhe më të përgjegjshëm pjesëmarrësit në tenderat e prokurimeve në mënyrë të tillë që të shkurajohet mbajtja e qëndrimeve të paligjshme, për shkak të “rëndesës së sanksionit” si pasojë e shkeljes së *klauzolave të pëlqimit*¹³⁰. Ndër to, përveç angazhimit të marrë nga çdo shoqëri ofertuese për të mos nënkontraktuar punime të asnjë lloji tek shoqëri të tjera pjesëmarrëse në tender¹³¹, meriton të themi se deklarata e shoqërisë ofertuese sipas të cilës ajo nuk ka bërë marrëveshje, dhe as mendon të bëjë marrëveshje me pjesëmarrësit e tjerë në tender¹³², dhe mbi të gjitha, angazhimin e marrë nga po kjo shoqëri ofertuese për “*t’i paraqitur*

¹²⁹ Me rëndësi të veçantë është protokollin i mirëkuptimit, i nënshkruar më dt.7 maj 2003 mes Autoritetit të mbikëqyrjes së punimeve publike dhe Bashkisë së Torinos (protokolle mirëkuptimi të të njëjtit nivel me ata të nënshkruar, më 9.09.2003 mes Autoritetit të mbikëqyrjes mbi punimet publike dhe Bashkive të Bergamos, Caccamo-s, Poggiomarino-s, Ottaviano-s, Villabate-s, Caltabianco-s, Ficarazzi-t, Bagheria-s). Hyrja e tij përmban në fakt një referencë ndaj nenit 15 të ligjit n.241 të vitit 1990 që, në kuadrin e përgjithshëm të “*marrëveshjeve mes administratave*”, duke përcaktuar që administratat publike mund të lidhin gjithmonë “*marrëveshje për të rregulluar zhvillimin e veprimtarive me interes të përbashkët*”. Protokollin në fjalë nuk mungon të vërejë që “*funkcioni i mbikëqyrjes së Autoritetit përfshin ndër të tjera, të drejtën për të nxjerrë akte orientuese ndaj administratave të prokuruar, në të cilat po këto administrata – për arsye vetëmbrojtjeje – mund të anëtarësojnë apo të largohen me arsye*”.

¹³⁰ Mbi *klauzolat e pëlqimit*, Këshilli i Autoritetit për mbikëqyrjen e punimeve publike ka adoptuar përcaktimin n.14/2003 të dt.15 tetor 2003.

¹³¹ Shih klauzolën n.4 të Protokollit të mirëkuptimit të përmendur më lart, shënim 41.

¹³² Shih klauzolën n.2 të Protokollit të mirëkuptimit.

*administratës prokuruese çdo kërkesë të paligjshme për para, shërbim apo dobi tjetër që asaj i është bërë përpara tenderit apo gjatë zbatimit të punimeve, edhe përmes agjentëve të saj, përfaqësuesve apo punonjësve dhe, sidoqoftë, çdo ndërhyrje e paligjshme në procedurat e prokurimit apo në fazën e zbatimit të punimeve*¹³³. Ky dispozitiv përfaqëson padyshim një përpjekje të lavdërueshme për të realizuar një ndërgjegjësim më të madh të subjekteve pjesëmarrëse në tenderat publikë, edhe përmes një veprimtarie të ngjeshur dhe të kujdesshme kontrolli të entit prokurues¹³⁴. Duhet të pranojmë se bëhet fjalë gjithsesi për një dispozitiv efikasiteti i të cilit varet shumë nga faktorë që lidhen me një marzh të caktuar pasigurie dhe rastësie¹³⁵.

Lidhur me temën specifike të *protokolleve të ligjshmërisë* nuk mund të mos vërejmë se veprimtaria kundër krimit të organizuar në një sektor kaq delikat të ekonomisë së vendit nuk mund t' lihet një lloj spontanizmi të akteve nënligjore, me një natyrë të paqartë juridike dhe, sidomos, me efikasitet të dyshimtë. Sidoqoftë duhet të kujtomë se Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në **Rekomandimin nr.1 të dt.19 shtator 2001**¹³⁶, në lidhje me ***parimet bazë në luftën kundër krimit të organizuar***, kish përcaktuar se “*Shtetet anëtare duhet të ndihmojnë krijimin e në kulture të sipërmarrjes që mbështetet në përgjegjësinë dhe në tolerancën absolute për veprimet e paligjshme. Ata duhet sidomos të përcaktojnë normat për mbrojtjen e personave që raportojnë akte të mitmarrjes apo veprimtari të mundshme kriminale të kryera për llogari të personave juridikë apo në kuadrin e këtyre*

¹³³ Shih klauzolën n.3 të Protokollit të mirëkuptimit. Duhet vërejtur se klauzola n.1 e këtij Protokollit parashikon mundësinë që komisioni i tenderit të pezullojë procedimin e shpalljes së fituesit përpara se shpallja e fituesit të përkohshëm sa herë që vërehen “*parregullsi në lidhje me ofertat, të konsideruara nga pikëpamja e vlerave në përgjithësi, e shpërndarjes numerike apo grupimit, e prejardhjes territoriale, e modalitetit apo veçantisë me të cilat po këto oferta janë përpiluar dhe paraqitur*”.

¹³⁴ Sipas një rikonjicioni të parë të efekteve të sjella nga Protokollit i mirëkuptimit të nënshkruar më dt. 7 maj 2003 mes Autoritetit të mbikëqyrjes mbi punimet publike dhe Bashkisë së Torinos, ecuria e tenderave ka ndryshuar thellësisht sapo u botuan njoftimet e para që përmbanin *klauzolat e pëlqimit*: numri i ofertave është ulur ndjeshëm (nga rreth gjashtëdhjetë për çdo tender në dhjetë); është zhdukur fenomeni i njësimi të dukshëm dhe të tepruar të uljes së ofertave (dhjetëra oferta që ndryshonin nga njëra tjetra nga të mijëta të përqindjes në po këtë tender); shpallja e fituesve është bërë me një çmim shumë më të ulët.

¹³⁵ Le të mendojmë p.sh. afatet modalitetet e verifikimit të situatave që përcaktojnë, për shoqërinë ofertuese apo fituese, detyrimin për t'i referuar administratës prokuruese “*çdo kërkesë të paligjshme për para, shërbim a punim apo për tjetër dobi*” apo çdo “*ndërhyrje tjetër të paligjshme në procedurat e shpalljes së fituesit të prokurimit apo në fazën e realizimit të punimeve*”.

¹³⁶ Shih pikën 7 të parag. II të Rekomandimit të cit.në tekst.

enteve”. Në perspektivën e treguar në këtë rekomandim duhen parë edhe disa *klauzola të pëlqimit* (si ajo në lidhje me **detyrimin për të denoncuar ndërhyrje të paligjshme**), që janë padyshim të destinuara të promovojnë **një etikë të përgjegjësive së sipërmarrësve**, viktime të veprimeve të paligjshme që kryhen ndaj tyre nga krimi i organizuar. I takon në fakt çdo sipërmarrësi dhe organizmave drejtues të çdo sipërmarrjeje një **detyrë e mirëfilltë morale për të bashkëpunuar me organet e Shtetit të angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit** (edhe në akte private, ndonëse kjo formë e veprës së paligjshme, ndryshe nga vende të tjera evropiane, ende nuk është parashikuar si krim në Itali). Shteti italian duhet të konsiderohet sigurisht se i ka përmbushur normat e rekomandimit për sa i takon përgatitjes së garancive të duhura për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe/ose të bashkëpunëtorëve të drejtësisë që do të bashkëpunonin në procesin penale për vërtetimin e fakteve të korrupsionit dhe të veprimeve të tjera të paligjshme të kryera në një kontekst sipërmarrjeje. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë lidhur me përfitimën e instrumenteve të përshtatshëm – kundrejt kontekstit specifik socio-kriminal kombëtar – për të ndihmuar atë **kulturë të re të sipërmarrjes** për të cilën flet rekomandimi i mësipërm¹³⁷.

Për të sjellë një listë, ndonëse përmbledhëse dhe të përafërt, të **rreziqeve të reja të infiltrimit mafioz në sistemin e rinovuar të punëve publike**, duhet të mbajmë patjetër parasysh jo vetëm aftësitë më të forta e të qëndrueshme të krimit të organizuar në këtë sektor specifik por edhe të mundësive të reja që ofron sistemi që u përpoqëm të përshkruanim më lart në vija të trasha.

Në radhë të parë, duket se nuk është shmangur plotësisht rreziku që organizatat kriminale të llojit mafioz, në vend që të hyjnë në lojë në fazën e realizimit të veprës publike përmes mekanizmave të kolauduar – e pikërisht për të këtë arsye njihen më mirë në rrafshin hetimor – të nënkontraktimit

¹³⁷ Në të vërtetë, duhet mbajtur parasysh edhe që përtej deklaratave të mirëkuptimit të organizmave të sindikatave të sipërmarrësve, shtresa e sipërmarrësve italianë duket se qëndron larg kësaj ideje, duke preferuar të krijojë një lloj etike të asnjësisë, duke autorizuar për çdo veprim lufte në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë kombëtare, organet e Shtetit. Edhe futja e *tutorit apo kujdestarit të kantierit* (që qëndron në një vendosje të Forcave të rendit pranë kantierëve të punës gjatë gjithë periudhës së realizimit të veprës publike), që shpresohet nga sektorë të kualifikuar të sipërmarrjes private (në këtë kuptim, shih propozimin e paraqitur nga A.N.C.E., Shoqata kombëtare e ndërtuesve), ndonëse e pranuar për pjesën më të madhe, duket se ka të njëjtin drejtim. Në fakt, bëhet fjalë për një ndreqje që kërkon të nxisë më tej mosangazhimin e shtresës së sipërmarrësve në luftën kundër krimit të organizuar, në një prej sektorëve më delikatë të bashkëjetesës së lirë, me pasqyrimë të pashmangshme në rrafshin e mbajtjes së sistemit socio-ekonomik të shëndetshëm të vendit.

dhe nënprokurimit të çdo lloji (qira “në të nxehtë” dhe “në të ftohtë”, furnizime materiale për ndërtimin, veprimtari të lëvizjes së dherave, oferta të shërbimeve të tjera plotësuese, si roje e siguri kantieri, ndërmjetësim i paligjshëm i kahut të punës, etj.), të marrin pjesë në **financimin e sipërmarrjeve prokurorese të punimeve**, si në formë *project financing*, ashtu dhe në rastin e prokurimit të *general contractor*. Financimi mund të bëhet ose me dhënie dhe/ose futje në qarkun e shoqërive të shoqërisë të cilës i prokurohen punimet (apo të shoqërive që lidhen me të në një bashkim të përkohshëm shoqërisht) të kapitaleve të mëdha me prejardhje të paligjshme (me rrjedhojë pastrimin e parave apo reinvestimin e tyre ex nenet 648-bis dhe 648-ter të k.p.) apo përmes krijimit, shkrirjes apo përthithjes *ad hoc* të shoqërive apo grupeve të shoqërive, që në dukje janë të rregullta, të administruara nga persona që huazojnë emrin apo që sidoqoftë, kontrollohen drejtpërsëdrejti apo jo nga krimi i organizuara, kapitali i të cilave jepet nga kjo e fundit, plotësisht apo pjesërisht apo, sipas rastit, rritet – po me forma të tërthorta, jo transparente dhe të verifikueshme me vështirësi – në varësi të nevojave sipërmarrëse të momentit¹³⁸. Për sa u takon hetimeve, lipset për këtë arsye të rriten kontrollet në këtë drejtim me qëllim që të shmanget që një shoqëri mafioze të arrijë objektivin e dëshiruar të financimit të tërthortë të realizimit të veprave publike përmes një veprimtarie të njëkohshme të pastrimit të parave. Kjo duket të jetë më e nevojshme nëse mbajmë parasysh se *kontraktori i përgjithshëm* mund t’u prokurojë punimet të tretëve, në pjesën më të madhe të tyre, pa asnjë detyrim me karakter publikues – me përjashtim të detyrimit për të respektuar normativën komunitare – që lidhet me respektimin e parimeve kushtetuese të sanksionuara nga neni 97, parag.

¹³⁸ Me qëllim që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur rreziku i infiltrimit mafioz përmes financimit, me kapitale të paligjshme të shoqërive apo grupeve të shoqërive të interesuara për realizimin e veprave publike, Komiteti i koordinimit për mbikëqyrjen e lartë të veprave të mëdha ka përgatitur, sëbashku me Zyrën Italiane të Këmbimeve, një *protokoll të posaçëm të ligjshmërisë financiare*, i destinuar të bëhet pjesë e kontekstit të *protokolleve më të gjera të mirekuptimit* (shih më lart, fq. 20 e vijuese). Bëhet fjalë për dispozita, me natyrë kompromisi, që synojnë të bëjnë të mundur ***zbulimin e flukseve financiare të destinuar për realizimin e veprave të mëdha publike***. Këto dispozita kanë të bëjnë kryesisht me parandalimin antimafie në sektorin e *veprave të mëdha infrastrukturore strategjike*, të treguara në *ligjin objektiv*, por, me ndonjë rregullim të nevojshëm, mund të shtrihen *tout court* në realizimin e veprave publike të përmasave të mesme e të mëdha. Në thelb, në *protokollin e ri të ligjshmërisë financiare* gjendet një rregullim i gjerë dhe i drejtpërdrejtë për të siguruar një **monitorim të vazhdueshëm të lëvizjes financiare, në hyrje dhe në dalje, lidhur me realizimin e veprës dhe e destinuar të kalojë në llogari të posaçme të dedikuara, të çelura nga shoqëri të angazhuara, me çfarëdo arsye. Në realizimin e kësaj vepre.** Raporti i përgatitur nga Komiteti njihet edhe për parashikimin e një sistemi sanksionues, të natyrës kontraktore-civiliste.

1, Kusht. Pra ai mbërrin të marrë një funksion të asimulueshëm në fakt ndaj funksionit të vet të ndërmjetësit financiar më shumë se funksionin e përnjimend të sipërmarrësit-marrës prokurimi.

Në radhë të dytë, do të jetë e nevojshme të **eksplorojmë me themel gjithë universin e S.O.C.** për të parë nëse, përmes procedurave të parregullta të përzgjedhjes së shoqërive të administruara apo kontrolluara nga organizata kriminale mafioze, mund të hidhen bazat për forma të reja edhe më të rrezikshme të depërtimit të këtyre të fundit në rrethin e sipërmarrjes së lidhur me realizimin e veprave të mëdha publike. Shoqëritë e mëdha apo grupet e shoqërive në nivel kombëtar, që zakonisht marrin prokurime, si të kontraktuar të përgjithshëm, për punime të mëdha publike në të ashtuquajtura *rajone në rrezik* (Sicili, Kalabri, Kampania dhe Pulje), mund të kenë interes të krijojnë apo mbajnë lidhje me shoqëri me rrënjë mafioze, që janë legalizuar me vërtetime të rreme të lëshuara nga S.O.C. që janë dakord me to, të krijuara enkas apo të lidhura po me shoqërinë-mëmë që merr prokurimin e punimeve, përmes mekanizmave kompleks me ndërmjetësim të rremë.

Në radhë të tretë, për sa i takon parandalimit të përgjithshëm të fenomeneve të infiltrimit mafioz, do të jetë e udhës që ligjvënësi, tashmë prej kohësh i vetëdijshëm për shtrembërimet e rënda të ekonomisë së vendit të shkaktuara nga qëndrime jo të rregullta sipërmarrëse, të fusë më në fund, edhe në përbushje të detyrimeve komunitare, krimin e **korrupsionit në akte private**. Edhe kështu mund të ushqehet qarku virtuoz u angazhimeve të njëkohshme dhe plotësuese që sipërmarrja publike është në gjendje të marrë përsipër, në përbushje të të ashtuquajturve *protokolle të ligjshmërisë*, përmes respektimit të të ashtuquajturave *klauzola të pëlqimit* apo të *vetëmbrojtjes*.

Në radhë të katërt, organet e kontrollit parandalues dhe ndëshkues, përfshirë këtu Autoritetin e mbikëqyrjes dhe ato që merren me *mbikëqyrjen e lartë* të punimeve (Komiteti për Mbikëqyrjen e Lartë të Veprave të Mëdha Publike krijuar pranë Ministrisë së Brendshme, Zyra për Mbikëqyrjen e Lartë pra Ministrisë së Infrastrukturave, Drejtoria për Mbikëqyrjen e Lartë dhe Zyra për *auditimin* e brendshëm të ANAS s.p.a.) duhet të kontrollojnë me kujdes maksimal, në nivel procedural, jo vetëm ekzistencën e kushteve të ligjshmërisë së prokurimit, por edhe marrjen efektive të masave të përshtatshme për të realizuar *konkretisht* një veprimtari efikase kundër infiltrimeve të mundshme mafioze. Le të mendojmë për shembull kontrollin e modaliteteve me të cilat kontraktori i përgjithshëm ka kryer *parafinancimin, e plotë apo të pjesshëm, të veprës që duhet realizuar*”

(shih tani nenin 176, parag.2, germa e) D.legjislativ 12 prill 2006¹³⁹, nr.163), apo “*si i ka treguar subjektit të prokuruar **planin e prokurimeve, të shpronësimeve, të furnizimeve të materialit***” (shih nenin 176, parag.2, germa g) D.legjislativ i sipërpërmendur që ka riprodhuar tekstin e nenit të abroguar n.9, parag.2, germa g) Dekreti legjislativ nr.190, i vitit 2002), apo “*lidhjen konkrete të **marrëveshjeve të posaçme me organet kompetente në fushën e sigurisë si dhe të parandalimit dhe ndëshkimit të kriminalitetit***” (shih neni 176, parag.3, germa e) nr.163, vitit 2006 që ka risjellë tekstin e nenit të abroguar nr.19, parag.2, germa e) Dekreti legjislativ nr.190, 2002). Në fakt bëhet fjalë për **përbushjen e detyrimeve verifikimi i të cilave na jep mundësi të kuptojmë në terren angazhimin konkret antimafie të shoqërisë prokurorese të punimeve dhe të marrim, sipas rastit, me shumë shpejtësi, kundërmasat e nevojshme për të gjitha rastet e mosrespektimit.**

Në radhë të pestë, dhe përsëri në kuadrin e politikave të parandalimit të krimit, duhen zbatuar **kontrolle të thelluar në sektorët, si të thuash “tradicionale”, të infiltrimit mafioz** (gurore, procedime industriale të prodhimit, tregtimit dhe transportimit të inerteve dhe konglomerateve të çimentos dhe bitumit, lëvizjes së dherave, qira “në te nxehtë” e “në të ftohtë”), edhe përmes rindërtimit të aspekteve ekonomiko-financiare të shoqërive që veprojnë, ndonjëherë në formë koncesioni (gurore), në këta sektorë.

§ 5. Strategji hetimore të luftës kundër infiltrimit mafioz në sektorin e punëve publike.

Për sa i takon hetimit penal, duhet të vërejmë paraprakisht se përfshirja e plotë në kuadrin e marrëveshjes private të çdo marrëdhënieje që ka të bëjë me opsionet kontraktore të bëra nga kontraktori i përgjithshëm si të thuash “në themel” të prokurimit të parë të veprës, ka bërë që **kriza e modelit hetimor të përdorur tradicionalisht nga prokuroria dhe nga policia gjyqësore**. Ky model, përmes verifikimit të veprimeve të mundshme penale sipas ex neneve 317, 318, 319, 321, 323, 328, 353, 354, 476, 478, 479 të k.p., të kryera nga subjekte që ndonjëherë mbulojnë detyra publike apo kryejnë një shërbim publik, të angazhuar në realizimin e punimeve apo të caktuar të kujdesen për kontrollin e realizimit të rregullt të tyre, kish kryesisht si qëllim të **zbulonte, përmes analizës së efekteve të dukshme,**

¹³⁹ *Parafinancimi* i veprës ish i parashikuar, po në këtë mënyrë, nga neni 9, parag.2, germa e) i D.legjislativ n.190, dt.20.08.2002, abroguar nga neni 256 i D.legjislativ nr.163, i vitit 2006.

shkaqet e kushtëzimeve të mundshme të llojit mafioz dhe reagimin konkret të tyre në një kontekst të caktuar territorial.

E gjitha kjo kërkon një rishikim të protokolleve hetimore si të thuash tradicionale, përmes rivlerësimit dhe thellimit sistematik të protokolleve të reja dhe, ndoshta më shumë premtues, që lidhen ngushtë me teknikat e ndryshme operative dhe/ose procedime (në kuptimin e gjerë), nga parashikimi i prokurimit, nga zbatimi tek kolaudimi i punimeve, përmes të cilave mund të realizohet infiltrimi mafioz me mënyra të ndryshme të sapopërshkruara.

Lidhur me këtë nuk ekzistojnë ende metoda të kolauduara apo modalitete të sakta të zhvillimit të hetimeve, meqë është krejt rastësor – apo më mirë të themi, shumë i ndryshueshëm – *incipiti* i hetimit penal në këtë fushë: nga njoftimi për krim “klasik” – por që tani haset rrallë në praktikë – i përbërë nga një denoncim formal i një tentative për krim (simbolikisht i kërcënuar apo konkretisht i kryer) në dëm të makinerive të pranishme në kantier, me të dhënë për një ofertë anormale të kryer nga shoqëria e prokuruar për punimet; nga verifikimi i një nënkontraktimi apo porosie të paautorizuar nga enti prokurues, tek marrëdhëniet e dyshimta të frekuentimit dhe interesit, që rastësisht kanë dalë gjatë përgjimeve telefonike, mes një përfaqësuesi të njohur të një organizate mafioze dhe drejtuesit të një shoqërie nënkontraktuese të punimeve publike që i janë dhënë një shoqërie tjetër të rëndësishme në nivel kombëtar; e kështu me radhë.

Megjithatë, kur gjendemi përpara dyshimesh apo të dhënash të bazuara fajësie, si në lidhje me krime-mjet (p.sh. nenet 476, 477, 353, 354, k.p.) apo krime-qëllim (p.sh. nenet 648-bis, 648-ter, 416-bis k.p.) që drejtpërsëdrejti apo jo flasin për një infiltrim mafioz¹⁴⁰, ekziston mundësia për të proceduar në mënyrë të rregullt, duke e organizuar veprimtarinë hetimore në bazë të hipotezës (apo të hipotezave) të punës që më shumë i përshtaten natyrës, vështirësisë së mundshme dhe perspektivave konkrete të zhvillimit dhe verifikimit të veprave-krim objekt i njoftimit për krim hipotetik ndonëse në fillesat e veta.

Natyrisht, **thellimi i njohjes së kuadrit ligjor** që rregullon këtë fushë komplekse do të jetë pikënisja dhe referimi i vazhdueshëm i çdo hetimi që kërkon të **depërtojë përmes perdes së ligjshmërisë së dukshme**, që

¹⁴⁰ Le të mendojmë në një hamendje të parë për titullsinë, e qartë dhe e fshehur, e subjektit mafioz të një shoqërie të prokuruar apo, sidoqoftë, zbatuese e punëve publike dhe, në hamendjen e dytë, për financimin me kapitale mafioze të një shoqërie që ka fituar një prokurim publik, apo blerja nga ana e po kësaj shoqërie e makinerive me para që vjen nga fitime të veprimtarive të zhvatjes apo të fajdes apo të trafikut të drogës.

ndonjëherë ngrihet në mënyrë artificiale nga funksionarë publikë jo besnikë apo nga sipërmarrës që bashkëpunojnë apo i nënshtrohen mafieve, pas të cilës mund të fshihen pritshmëritë apo interesat e krimit të organizuar.

Po kështu, hetimi penal do të mbajë parasysh realitetin kompleks të këtij fenomeni, siç më lart përmendur, që të shpie drejt modaliteteve të ndryshme – e tashmë të njohura – të infiltrimit mafioz në sistemin e prokurimeve të punimeve publike.

Për këtë arsye hetimet mund të shtrihen, sipas rastit, nga faza përgatitore e tenderit në procedimin e caktimit të fituesit, nga kryerja e punimeve dhe varianteve përkatëse në fazë realizimi në atë të kolaudimit apo të pagesës së fazave të ecurisë së punimeve.

Kufijtë e kësaj pune dhe, sidomos, numri i madh i *pistave* të mundshme hetimore që kanë për qëllim verifikimin e kësaj tipologjie krimesh, nuk na lejojnë të sjellim një tablo të plotë të teknikave më të mira hetimore të luftës kundër këtyre fenomeneve. Nuk ekzistojnë për këtë as *protokolle hetimore* të kolauduar, të tillë që mund të garantojnë suksesin e hetimeve në këtë fushë kaq komplekse.

Është e tepërt të themi se vështirësitë që do të hasin hetimet do të jenë krejt në përpjestim me nivelin e depërtimit të krimit të organizuar në sistemin e sipërmarrjes që, si për qëllime dhe me mënyra të ndryshme, përbën një prej objektivave kryesorë të veprimtarisë së infiltrimit mafioz.

Duke iu referuar historisë së zhvillimit të *mafieve historike* në këtë sektor specifik, duhet vërejtur se hetimi paraqet përgjithësisht një nivel vështirësie jo të lartë sa herë që ***infiltrimi mafioz*** është realizuar në formën e quajtur ***parazitare***, që qëndron në tërheqjen a marrjen e drejtpërdrejtë nga ana e organizatës kriminale të llojit mafioz, të një *ryshfeti* për një shumë që është në përpjestim me atë të punimeve të prokuruarra, apo në vendosjen me forcë të rojës e sigurisë apo në punësimin (real dhe të rremë) të personelit vartës, që ka lidhje farefisnie, interesi apo solidariteti mafioz me vetë organizatën kriminale. Bëhet fjalë, siç e thamë më lart, për formën e zakonshme të infiltrimit mafioz në të cilën mund të kuptohet qëndrimi pragmatik i viktimës, që mund të përfshihet në figurën e ***sipërmarrësit të varur nga mafia*** (në kuptimin e gjerë). Zakonisht ky i fundit, vetëm që të sigurojë *paqen* në kantier, është ***i shtrënguar*** t'u nënshtrohet pretendimeve kriminale të mafies, që bëhen të ditura me mënyra dhe rituale veçanërisht tinëzare dhe të vështira për tu vërtetuar me prova (le të mendojmë këtu kërkesën për një *“kontribut për familjet e të burgosurve”* apo për një borxh, që shërben për të përballuar shpenzimet e një *“operacioni”* të vështirë, apo

të ofertës për shërbimin e sigurisë për të garantuar një mbikëqyrje të përhershme në kantier me qëllim që të shmangen atentate të mundshme dhe të ngjashme. Në këto raste, kur mungon bashkëpunimi i viktimës, përveç hetime rutinë do të duhet të përqendrohemi edhe e sidomos në hetimet teknike (përgjime telefonike dhe në mjedis kundrejt viktimës dhe rrethit familjar të saj dhe profesional), duke u kujdesur të ruajë, me lëvizjet e duhura, përfitim të çdo burimi të dobishëm prove (le të mendojmë p.sh. në një realitet heshtjeje të provuar, për përgjimet telefonike të vendosura ndaj personave që mund të jenë në dijeni të fakteve dhe/ose atyre në mjedis në automjetet e përdorura nga vetë informatorët për të shkuar në zyrat e prokurorëve apo për t'u larguar pasi të jenë marrë në pyetje; për përgjimet dhe videoregjistrimet në mjedis të vendosura, mbase në raste urgjente, nga prokurori ex neni 267 i k.p.p., në sallat e pritjes të zyrave të policisë gjyqësore apo të vetë prokurorit të mëparshëm, pasi kanë vepruar në mënyrë të tillë që mbahen aty viktimat dhe/ose personat e tjerë në dijeni të fakteve: në fakt pothuaj duke mposhtur çdo qëndresë që sjell heshtjen, – më shume se përpara prokurorëve – mund të flasin për gjëra konfidenciale mes tyre apo mund të lëshojnë deklarata që i shërbejnë zhvillimit të hetimeve). Sidoqoftë bëhet fjalë për module hetimi të eksperimentuar gjatë dhe për fat të keq, në pjesën më të madhe të rasteve, njihen nga personat që duhet t'u nënshtrohen p.sh. përgjimeve. Kur veprimtaria e zhatjes dhe/ose kushtëzimit mafioz është ende në kryerje e sipër dhe ekziston një arsye e bazuar për të gjykuar se viktimat dëshiron sinqerisht të bashkëpunojnë, mund të shërbejë për të instaluar me shumë kujdes aparatura të mbikëqyrjes video në gjendje të dokumentojë kryerjen e mundshme të veprimtarisë kriminale dhe/ose zbulimin e autorëve, apo të infiltrojë, me kujdes edhe më të madh, një apo më shumë agjentë apo oficerë të policisë gjyqësore mes personelit që është çdo ditë i pranishëm në kantier (duke i bërë ata të luajnë, sipas rastit, rolin e rremë të drejtuesit të punimeve, të përgjegjësit të kantierit, mbikëqyrësit, punëtorit) me qëllim që të cilësohen burimet e informacionit drejtpërsëdrejti në vendin dhe menjëherë pasi kryhet vepra, edhe e sidomos në perspektivën për të vijuar me arrestimin në flagrancë të autorëve të krimit (p.sh., tentativë për zhatje apo kryerje të zhatjes, që mund të jetë dhe në rrethana rënduese ex neni 7, i d.l.nr.152 të vitit 1991, konvertuar me ndryshime në ligjin n.203 të vitit 1991).

Por, siç thamë, hetimet do të jenë më të vështira dhe të shtrira atëherë kur infiltrimi mafioz ka sjellë në këtë sektor (prokurime publike të punimeve) një lloj bashkëpunimi aktiv, të karakterizuar nga konvergjenca e interesave, mes organizatës kriminale mafioze dhe sipërmarrësit objekt i

interesit të tij kriminal. Në këtë rast gjendemi përballë figurës së të ashtuquajturit *sipërmarrës që bashkëpunon me krimin*.

Siç kemi pasur rast të vërejmë¹⁴¹, në vazhden e një analize të thelluar socio-kriminologjike të “*fenomenit sipërmarrës në mjedisin mafioz*”¹⁴², duke i kushtuar vëmendje të veçantë atij në Kalabrinë e poshtme të Tirrenit (Piana di Gioia Tauro), marrëdhënia mes mafies dhe sipërmarrjes lokale “nuk duhet kuptuar si marrëdhënie “e njëkahshme”, por si një ndërveprim që zhvillohet në një kuadër detyrimesh dhe mundësish në të cilat ka hapësirë për vlerësime dhe preferenca të sipërmarrësve si dhe për llogaritjen e kostove dhe përfitimeve që lidhen me llojin e marrëdhënies që duhet krijuar¹⁴³. Me fjalë të tjera, mund të ndodhë që në disa realitete territoriale (p.sh. Kalabria, disa zona të Kampanias, si Kazertanos (Casertano) dhe Sicilia) ku sa më e fortë, e përhapur dhe agresive është prania e krimit të organizuar të llojit mafioz, aq më shumë **sipërmarrësit** janë të shtyrë të përftojnë **një strategji bashkëpunimi**. Në fakt, nëse është e vërtetë që për disa sipërmarrës mafia përfaqëson një *detyrim*, është po kaq e vërtetë që për të tjerë mund të jetë një *shans apo mundësi*. Mund të ndodhë që – e ka ndodhur konkretisht (në Kalabri) – që dy situatat e mësipërme bashkëekzistojnë në të njëjtin kontekst territorial. Organizatat mafioze lokale mund të përdorin ndaj shoqërive të angazhuara në realizimin e punimeve publike një strategji të dyfishtë: duke ushtruar, nga njëra anë, presionin mafioz sipas metodës “tradicionale” të kërkesës për një ryshfet (të një shume përgjithësisht të barazvlefshme me 3% të shumës së punimeve të prokuruarra); nga ana tjetër, mund të ofrojë ndihmën e funksionarëve teknikë, drejtues, si për shoqëritë prokurorese ashtu dhe për entet e prokuruarra, duke qenë të vetëdijshëm se bëhet fjalë **për mekanizma të bashkëpunimit të paligjshëm**. Ndihehet me ta jo vetëm gjetja e (përmes **faturimeve të rreme**) e burimeve financiare që duhen përdorur për pagesën e ryshfetit, por edhe për futjen e mëvonshme në punime . përmes **dhënies së lejeve të paligjshme për nënkontraktim** – të shoqërive që janë të lidhura me mafien, që nuk gëzojnë kriteret e parashikuara, krejtësisht në dëm të

¹⁴¹ Shih tekstin tonë *Coordinamento investigativo e cooperazione istituzionale: nuove prospettive della lotta alla criminalità organizzata nel settore dei lavori pubblici* (cit.sipër, në shënimin 14) fq.365-366.

¹⁴² Krs. R.SCIARRONE, *Mafie vecchie, mafie nuove*, Roma, 1998, fq.53, e në vijim, fq.63 e në vijim.

¹⁴³ Kështu R.SCIARRONE, *Il rapporto tra mafia e imprenditorialità in un'area della Calabria, në Quaderni di sociologia*, Vëll. XXXVII, 1q993, fq.68 e në vijim.

shoqërive të tjera, rregullisht të treguara në aktin e pjesëmarrjes në tender, por pa mbështetjen “e nevojshme” të organizata lokale¹⁴⁴.

Interesi i krimit të organizuar është përqendruar natyrshëm në veprat me kosto më të madhe, përmes lidhjes së paligjshme të marrëveshjeve paraprake me shoqëritë të cilave u prokurohen punimet dhe duke **përdorur njëkohësisht një sipërmarrje që lidhet me organizatat lokale sidomos për realizimin e punimeve të lëvizjes së dherave**, të paguar “në total” dhe jo “me llogaritje”, me vështirësinë tjetër që vjen shkak të kryerjes së kontrolleve. Edhe disa drejtues të entit prokurues janë përfshirë për arsye të ndryshme në marrëveshje të tilla të paligjshme. As nuk duhet lënë mënjanë efikasiteti i pakët, për të mos thënë mungesa e plotë, e kontrolleve serioze mbi prokurimin, në rast nënprokurimi, të një pjesë të mirë të këtyre punimeve, zbatimi i të cilave ka ndodhur nën kujdesin e shoqërive që nuk janë shpallur më parë nga shoqëri prokurorese gjatë zhvillimit të tenderit. Në disa raste, **mungesa e kontrolleve të përshtatshme nga ana e A.N.A.S.** ka shpënë në **parregullsi të ndryshme të shënuara gjatë tenderit** (*ulje të tepruara* deri në në 36% të çmimit të caktuar si çmim dysHEME, *projekte të përgjithshme të rreme*, me të cilët duhet të përkohet më pas në mënyrë artificiale projektet e zbatimit, *ekspertiza varianti* të kryera me qëllimin e vetëm për të fryrë kostot e punimeve të prokuruar)¹⁴⁵.

Për sa u takon hetimeve, është e udhës të bëjmë me dije se, përpara fakteve të përshtatshme të justifikojnë, në rrafshin logjiko-financiar apo të paktën në aspektin e dyshimit të bazuar, supozimin e një infiltrimi mafioz, qëndrimi jo bashkëpunues – madje një qëndrim që është hapur i tërhequr dhe heshtjeje – i viktimës nuk duhet t’i bëjë magjistratët dhe jo vetëm të hamendësojmë domosdoshmërisht apo, deri dhe të mendojnë “në një drejtim të vetëm” një përputhje interesash mes organizatës kriminale nën hetim dhe sipërmarrësit të përfshirë: megjithatë, duhet pasur parasysh se, jo rrallë, kalimi nga situata e sipërmarrësit të nënshtruar tek ajo e sipërmarrësit që bashkëpunon me krimin përfaqëson hapat e parë të një procesi zhvillimi – apo, nëse duam, të kthimit prapa – të marrëdhënieve mes mafies dhe sipërmarrjes, siç thamë

¹⁴⁴ Në Relacionin e Komisionit parlamentar antimafie të Legjislaturës XIV, miratuar në mbledhjen e datës 30 korrik 2003 (Rel.Sen.Centaro), doc.XXIII, nr.3, fq. 266, është theksuar me të drejtë se “konteksti hetimor ka hedhur dritë mbi pushtetin konkret të strukturës kriminale ndaj Shoqërisë së madhe prokurorese, e cila, me sa duket me qëllimin që të shmangë probleme me mjedisin përreth, e zëvendësoi drejtuesin teknik që kish denoncuar menjëherë përpjekjet e pataë zhatëse, me një tjetër funksionar, që ndryshe nga ai ish treguar plotësisht i aftë të bëhej pjesë e kontekstit kriminal”.

¹⁴⁵ Shih aktet e çështjes penale n.5726/2001 R.G.N.R. të D.D.A. të Katanzaros (*Operazione Tamburo/Operacioni Daullja*).

fryt i uljes së përgjithshme të nivelit të ligjshmërisë në realitetin specifik territorial në të cilin shpaloset kjo marrëdhënie. Në fakt mund të ndodhë që sipërmarrësi, i cili u nënshtrohet presioneve të ndryshme, për leverdi dhe me idenë se falë *mundësive të mira* të mafies, do të ketë përfitime që nuk do i kish marrë kurrë, arrin të lidhë një lloj *pakti me djallin*, që penalisht ndëshkohet nga *ex neni 110, 416-bis i k.p.* apo madje *ex neni 416-bis i k.p.*

Kjo duhet të mbahet fort mirë parasysh në kryerjen e hetimeve antimafie që do të jenë veçanërisht të kujdesshme të dallojnë ndër sipërmarrësit dhe administratorët dhe drejtuesit e sipërmarrjeve apo të konsorciumeve të sipërmarrjeve, të përfshira në realizimin e punimeve publike, viktimat e vërteta të mafies nga subjektet që për arsye të ndryshme e në shkallë të ndryshme përgjegjësie bashkëpunojnë me të, e madje janë ata vetë autorët apo bashkëpunëtorët e veprimtarisë kriminale të infiltrimit (*ex neni 416-bis apo ex neni 110, 416 bis i k.p.*). Për të kryer veprimtarinë e gjerë investiguese sigurisht që mund të shërbejë kontributi i *bashkëpunëtorëve të drejtësisë*, anëtarë të një organizate kriminale autore e kësaj veprimtarie apo që janë bërë pjesë e realitetit sipërmarrës kriminal si më lart përshkruar.

Edhe më të vështira do të jenë hetimet antimafie në rastet kur në kontekstin mjedisor objekt të hetimeve, dyshohet me të drejtë se ekzistojnë t dhëna konkrete për të menduar se gjendemi përballë një apo më shumë sipërmarrësve apo sipërmarrjesh (shoqëri personash apo kapitalesh, konsorciume sipërmarrjesh, etj.), që janë fshehur me shumë kujdes si titullarë të pronësisë apo mbajtës të kontrollit të shoqërisë, që veprojnë drejtpërsëdrejti si *longae manus* (dora e zgjatur) e mafies, sipas logjikës së sipërmarrjes së mësipërme, *për të rritur kërkimin e mekanizmave të legalizimit të veprimtarive ekonomike* që lidhen me to tërthorazi apo jo. Kjo fenomenologji, që përmbledhtas ka të bëjë me figurën e *sipërmarrësit mafioz* dhe të *mafies sipërmarrëse*, është ajo që shfaq aspektet më të qarta të padepërtueshmërisë pasi karakterizohet nga njëra anë nga një aftësi e theksuar e protagonistëve për të fshehur apo disimuluar matricën e tyre mafioze dhe, nga ana tjetër, nga prania e vazhdueshme e mbështetjes së fuqishme dhe të mbulimit jo vetëm në kuadrin e kësaj shtrese sipërmarrësish, por edhe në atë politiko-administrativ. Ja pra që veprimtaria hetimore që ka ndier rritjen gjithnjë e më të madhe të marrëdhënies mafie-sipërmarrje dhe aftësinë e madhe ndërmjetësuese që kanë fituar mafiet, do të përpiqen të vërtetojnë, me instrumentet tradicionale (vëzhgim, ndjekje dhe kontroll, përgjime telefonike dhe në mjedis, dhe nëse do jetë e nevojshme edhe hetime pasurore dhe bankare të shoqërive, etj.) ekzistencën e rrjeteve të marrëdhënieve dhe organizata kriminale, nga njëra anë, dhe botën e sipërmarrjes, përfaqësuesit e politikës dhe funksionarët publikë të përfshirë

drejtpërsëdrejti apo jo në procedurat vendimmarrëse nga ana tjetër. Në nivel politik dhe burokratiko-administrativ merren në fakt vendime në lidhje me financimin, lokalizimin dhe realizimin e punimeve. Për këtë arsye, në rastet ku rrethanat e faktit e sugjerojnë, mund të supozohet me të drejtë (duke përgatitur instrumente të përshtatshëm hetimorë të provës) një njohje më e thelluar e mekanizmave të pilotimit të procedurave publike (“*të hapura*”, “*të ngushta*” apo “*të negociuara*”, sipas terminologjisë së re të futur, në vitin 2006, nga Kodi i kontratave publike) për prokurimin e punimeve.

Vlen të ndalemi edhe në çështjen e **financimit (të plotë apo të pjesshëm) të veprës nga ana e krimit të organizuar.**

Bëhet fjalë për një rrezik të ri e të rëndë të infiltrimit mafioz që mund të ndodhë edhe *në fund* të vetë realizimit të veprës publike, shumë më parë e pavarësisht nga përdorimi i mëvonshëm e metodave tradicionale të varësisë ndaj krimit.

Financimi mund të bëhet ose me dhënie dhe/ose hedhje në kapitalin e shoqërisë së sipërmarrjes të cilës i prokurohen punimet (apo në shoqëritë që lidhen me të në një bashkim të përkohshëm sipërmarrjesh) të kapitaleve të tjera me prejardhje të paligjshme (që ndiqen nga veprimtaria e pastrimit të parave). Ndryshe, ai mund të kryhet përmes krijimit, shkrirjes apo përthithjes *ad hoc* të sipërmarrjeve apo grupeve të sipërmarrjeve, që në dukje janë të rregullta, të cilat administrohen nga *persona që huazojnë emrin e tyre* apo, sidoqoftë të kontrolluara, drejtpërsëdrejti ose jo nga krimi i organizuar. Për sa u takon hetimeve duhet të rriten më tej kontrollet në këtë drejtim me qëllim që të shmanget fakti që një sipërmarrje mafioze të arrijë objektivin e dëshiruar për të financuar drejtpërsëdrejti realizimin e veprave publike përmes një veprimtarie të njëkohshme të pastrimit të parave. Në këtë mënyrë, ajo merr si fund një funksion që i ngjan atij të ndërmjetësuesit financiar më shumë se funksionit të sipërmarrësit-të prokuruar¹⁴⁶.

Siç e pamë, përzgjedhja e sipërmarrjeve të interesuara për realizimin e punimeve publike përbën kushtin e nevojshëm për pjesëmarrjen në

146 Mbi aktualitetin dhe konkretësinë e rrezikut të infiltrimit në fazën e financimit, të drejtpërdrejtë ose jo, të shoqërive që aspirojnë të luajnë rolin e *general contractor* në procedurat e dhënies dhe/ose realizimit të veprave të mëdha publike nuk është e nevojshme të shpenzohen shumë fjalë: sipas rezultateve të një hetimi të kohëve të fundit, të kryer nga Drejtoria e Rrethit Antimafie, një përfaqësues i rëndësishëm i një familjeje mafioze, me origjinë siciliane por që vepronte në Kanada, kish ngarkuar një të dërguarin e vet, një përfaqësues ligjor të një shoqërie ndërtimesh, të specializuar në realizimin e *Urës së Ngushticës së Mesinës*, gati për t'i dhënë një *general contractor*, shumë prej pesë miliardë euro, që vjen nga fitimet e jashtëzakonshme të trafikut të lëndëve narkotike që menaxhohet nga kjo familje mafioze.

procedurat përkatëse të prokurimit. Sipërmarrja mafioze apo që bashkëpunon me mafien mund të ketë për këtë arsye interes të ruajë kontrollin dhe, nëse është e nevojshme, të ndikojë me metoda të paligjshme mbi rezultatin e procedurës së përzgjedhjes, që u besohet S.O.C. ose, madje, të marrë kontrollin, e drejtpërdrejtë ose jo, të vetë shoqërive certifikuese me qëllim që të menaxhojë drejtpërsëdrejti këto kontrole delikate. Në bazë të kontrolleve të kryera nga Autoriteti i mbikëqyrjes¹⁴⁷, që sistemet që përdoren më shpesh për të marrë pa të drejtë vërtetime të lëshuara nga S.O.C., konsistojnë në këto veprime të paligjshme: 1. falsifikim përmes “ndryshimit të certifikimit të punimeve”, me të cilat mund të fryhen shumat e punimeve të kryera, duke ndryshuar shifrat apo duke shtuar klasifikime të reja; 2. paraqitje *certifikimi të punimeve plotësisht të rreme*, me firma nëpunësish që nuk ekzistojnë aspak apo *nënkontraktive që paraqiten si punë private*; 3. paraqitje *faturash, për marrje me qira pajisjesh, të rreme dhe të pakontabilizuara në bilanc*; 4. *përfshirje në listën e pajisjeve të kantierit të të mirave a pasurive të familjes* (p.sh. makina jashtë serie që paraqiten si automjete shërbimi). Kjo duhet mbajtur parasysh sa herë që hetimi do të haste në fakte të ngjashme, me përfshirjen e personave dhe/ose sipërmarrjeve që lidhen në mënyra të ndryshme me krimin e organizuar.

Për sa u takon *metodave të manipulimit të procedurave publike*, në të cilat marrin pjesë sipërmarrës individë apo shoqëri apo grupe shoqërisht të lidhura apo që mbështeten nga krimi i organizuar, përvoja gjyqësore na jep shembuj të shumtë, që tregojnë për tipologji të ndryshme e të gjera të ndërhyrjes në prokurimet publike nga ana e të ashtuquajturave *mafie historike*. Kushtëzimi dhe kontrolli i procedurave përkatëse, siç thamë, si në fazën e financimit publik të veprës (në formë të tillë që marrin rëndësi marrëdhëniet që mund të ekzistojnë me politikanët e korrumpuar apo që sidoqoftë bashkëpunojnë me mafien), ashtu dhe në fazën e tenderit të prokurimit, si e tillë. Është pikërisht kjo faza ku mund të bëjnë vend, siç na mëson edhe përvoja gjyqësore, teknikat më tinëzore dhe të sofistikuar të manipulimit të paligjshëm të procedurës, të kryera me qëllim eliminimin e çdo forme të konkurrencës së ndershme dhe të lirë dhe mbrojtjen e interesave të mafies dhe të shoqërive që lidhen me të.

Folëm më lart për metodën e *tryezës*, të përdorur deri tani nga *cosa nostra*, siç rezulton nga disa hetime të fundit. *Cosa nostra* kërkon të sigurojë me këtë kontrollin e plotë të prokurimit në çdo fazë, nga financimi i veprës deri në realizimin konkret të saj. Pikërisht në këtë fazë të fundit mafia, pasi ka mbrojtur interesat themelore të organizatës, ish një gjendje të ndihmonte

¹⁴⁷ Mbi këtë pikë, shih më sipër, shënimi 28.

edhe sipërmarrjet mafioze lokale, duke ndihmuar caktimin e nënprokurimeve, qirave “*në të nxehtë a në të ftohtë*” furnizimit të materialeve.

Por edhe atëherë kur kjo metodë nuk përdorej mund – atëherë dhe tani – të përdoren forma të tjera kontrolli të tenderit të prokurimit si:

- ***përgatitja në tenderat prokurues të skedave teknike*** (me bashkëpunimin e funksionarëve të korruptuar, që janë ngarkuar të hartojnë njoftimet për tender), në mënyrë të tillë që e brendashkruajnë numrin e shoqërive të autorizuar të marrin pjesë, apo madje duke shpallur një fitues të vetëm të paracaktuar (i ashtuquajtur ***njoftim për tender me porosi***);
- ***përcaktim paraprak i uljes së çmimeve*** (në mënyrë të tillë që të ulen në minimum);
- ***pjesëmarrje me funksion mbështetës*** nga ana e sipërmarrjeve që paraqesin oferta të fryra nga pikëpamja instrumentale apo që tërhiqen më pas nga tenderi (të ashtuquajtura ***marrëveshje***)¹⁴⁸;

¹⁴⁸ Mbi fenomenin e të ashtuquajturave ***marrëveshje (cordate)***, është vënë re së fundi vëmendja e Shërbimit të Inspektimit të Autoritetit të mbikëqyrjes së kontratave publike të punimeve, shërbimeve dhe furnizimeve (shih shënimin e dt.29 nëntor 2006), që ka vërejtur se ky fenomen sjell një devijim të konkurrencës sa herë që “*shoqëritë, duke orientuar ofertat e tyre (uljet e çmimeve) në bazë të një marrëveshjeje paraprake, kushtëzojnë përfundimin e tenderit, duke përcaktuar faktikisht apriori ofertën e ofertuesit, apo sidoqoftë kuadrin e uljes brenda të cilit do të vendoset ajo*”. Për sa i takon ***shpeshhtësisë me të cilën vërehet ky fenomen***, duhet thënë se rezulton të jetë shumë e ndjeshme në Kampania, dhe sidomos ***në Sicili***, meqë ky qark i fundit ka pasur një ecuri në rritje deri në vitin 2992, për të rënë më pas me shpejtësi nga viti 2002 e tutje. Në studimin e përmendur, Shërbimi i inspektimit të Autoritetit ka vërejtur gjithashtu mesatarja e numrit të pjesëmarrësve në tendera, në Sicili, dhe e 81 shoqërive kundrejt një mesatareje kombëtare të 10 shoqërive. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i ecurisë së fenomenit, në Sicili, ka të bëjë me ***mesataren e uljeve***: deri në vitin 2002, uljet vërtiteshin mbi një vlerë mesatare prej 5% (në periudhën 2000-2002, mbi 1925 tendera me ulje më të ulëta se 5%, 1839 tendera paraqisnin një ndryshim të menjëhershëm, por të njëkohshëm, të qëndrimit të shoqërive pjesëmarrëse në tenderat e qarkun e mësipërm, në kuptimin që mesatarja e uljeve është e njësuar me mesataren kombëtare. Sipas kësaj analize, prania e tre faktorëve të parregullsisë në tenderat e shqyrtuar (ulje të ngjashme, numër i madh i pjesëmarrësve, ndryshim i vazhdueshëm i uljeve të tarifave të shpallura mes vitit 2002 dhe 2003) flet për “*një regji, apo një kushtëzim të fortë në nivel sipëror, më shumë se për një marrëveshje paraprake mes vetë shoqërive pjesëmarrëse në tender*”. As nuk duhet të lëmë pas dore që për një shpjegim më të gjerë të fenomenit të sipërpërkthuar, zhvillimi më i fundit i normativës në nivel qarku në lidhje me këtë fushë. Në fakt, kjo e fundit “*deri në muajin gusht 2002 [...] (për shumën më të vogël se 5 milionë euro) parashikonte që dhënia e prokurimeve të kryhej në lidhje me një ulje mesatare, duke eliminuar krahët (sipas sa përcaktuar nga vetë norma, 25% të ofertave me ulje maksimale dhe 25% të ofertave me ulje minimale)*. Ky sistem penalizonte uljet

- **përrjashtimi nga tenderi me metoda mashtrimi** (shkaktuar me bashkëpunimin e funksionarëve të korruptuar: si p.sh. heqje dokumentesh nga zarfi i ofertës) i sipërmarrjeve që nuk u binden rregullave të vendosura me forcë nga mafia.

Njohja e këtyre mekanizmave mund të orientojë pa humbur kohë drejt hetimeve në drejtimin e duhur, edhe përmes seleksionimit të kujdesshëm dhe marrjes së dokumentacionit që ngjall interes për hetimet (njoftimi për tender, zarfe me ofertat përkatëse, dokumentacion në lidhje me strukturat e shoqërive që marrin pjesë në tender apo të atyre që janë tërhequr prej tij, vërtetime kualifikimi, vërtetime antimafie, etj.).

Por, më shpesh, gjurmët më të rëndësishme që na lejojnë të hamendësojmë apo madje provojmë proceduralisht infiltrimin mafioz në prokurimin e punimeve publike, mund të gjenden në **fazën e të ashtuquajturit kantierizim të veprës**.

Sipas një analize të kohëve të fundit të kryer nga Drejtoria kombëtare antimafie¹⁴⁹, pikërisht në këtë fazë “bëjnë vend format më tinëzare të ndërhyrjes kriminale, në realizimin e punimeve, nga ana e organizatave kriminale të llojit mafioz”¹⁵⁰.

maksimale dhe minimale, kështu që nga pikëpamja strategjike është e leverdisshme të paraqesësh oferta me ulje të tepruara. Nga muaji shtator 2002, normativa e re ka parashikuar dhënien e prokurimit sipas kriterit të çmimit më të ulët pas prerjes së krahëve (10%). Ky mekanizëm i ka shtyrë sigurisht shoqëritë të rrisin uljen e çmimit të prokurimit [...]. Ligji i fundit i qarkut (nëntor 2005) ka ndryshuar së fundi formulën për llogaritjen e limitit të parregullsisë duke futur një sistem të përafërt për llogaritjen e prerjes së krahëve a aksesorëve (nxjerrja e një numri nga 11 deri në 40, që përbën përqindjen e ofertave me ulje më të vogël që duhen përrjashtuar). Nga rezultatet e para të tenderave të jryer duket se uljet e prokurimit prirën drejt një zvogëlimi (pothuaj 10%)”. Si përfundim – sipas Shërbimit të Inspektimit të Autoritetit – “normat që kanë vijuar pas vitit 2002 janë përrjekur për këtë arsye të kundërshtojnë fenomenin e marrëveshjeve (cordate) (me parashikimin e fundit që fut llogaritjen aleatore të krahëve), por të dhënat e marra nga Observatori duket se nuk dëshmojnë që qëllimi është arritur konkretisht, edhe pse pas vitit 2002 është vërejtur një zvogëlim i numrit të tenderave”.

Përsa u takon masave të mundshme që duhen marrë në dritën e legjislacionit në fuqi në këtë fushë, duket me vend referimi ndaj dispozitave që përmban **neni 34, paragrafi 2, i Kodit të ri të kontratave publike**, sipas të cilave “entet prokuruese përrjashtojnë gjithashtu nga tenderi konkurrentët për të cilët vërtetojnë se ofertat përkatëse i takojnë një qendre të vetme vendimmarrëse në bazë të elementëve të qartë”.

¹⁴⁹ Shih Shënimin (e pabotuar) të Prokurorit kombëtar antimafie në datën 12 shkurt 2004, drejtuar njëzet e gjashtë Prokurorëve të Rretheve Antimafie.

¹⁵⁰ “Ky lloj infiltrimi – vëren Prokurori kombëtar antimafie në shkresën e lartpërmendur, shënimi 59 -, realizuar përmes shoqërive apo personave që janë të lidhur me këto të fundit, nuk shfaqet vetëm sipas skemës tradicionale të zhvatjes si të thuash “klasike”, në të cilën

Në bazë të kësaj analize me të cilën jemi të një mendjeje, D.N.A./D.K.A. (Drejtoria Kombëtare Antimafie) ka përgatitur një **Protokoll të përgjithshëm për veprimtarinë hetimore në kantieret e punimeve publike** që përmban përcaktimin e disa sugjerimeve të dobishme operative që duhen ndjekur “*në fazën e parë dhe më delikate të zbulimit dhe marrjes së burimeve të provës, me vëmendje të veçantë në veprimtarinë që duhet kryer, eventualisht përmes policisë gjyqësore të autorizuar posaçërisht ex neni 370 k.p.p., në kantieret e punimeve apo, sidoqoftë, pranë selisë apo zyrave të shoqërive të përfshira drejtpërsëdrejti në realizimin e punimeve objekt i prokurimeve publike*”¹⁵¹.

Në këtë fushë, është tejet e rëndësishme që hetimet e para, ndonëse u besohen, së bashku apo më vete, organizmave të ndryshëm të policisë gjyqësore, me qëllim që ata të procedojnë në mënyrë të koordinuar, për të garantuar përgjigjen me shpejtësi e të nevojshme të marrjes së provave dhe, mbi të gjitha, përditësimi i vazhdueshëm dhe seleksionimi i arsyeshëm i informacioneve që i shërbejnë hetimit, e që janë të destinuara të përbëjnë

është e lehtë të dallohet viktimat, që i nënshtrohet një presioni të fortë kërcënues dhe, për këtë arsye, pak e prirur të bashkëpunojë me hetuesit, por mund të kuptohet vetëm përmes një përmirësimi të kujdesshëm dhe shpesh nga marrëdhënie që shoqëria e kontraktuar ka vendosur në fazën e kantierizimit.

Përvoja në mëson se gjithnjë e më shpesh shoqëritë e prokuruarat për realizimin e veprave të mëdha publike (autostrada, ujësjellës, vepra të rimëkëmbjes së transporti urban dhe të mjedisit që janë bërë të nevojshme pas ngjarjeve katastrofike, si tërmete, përmblytje, etj.) lidhin (apo janë të detyruara të lidhin) “në tryezë” marrëveshje të mirëfillta bashkëpunimi me krimin e organizuar apo bëjnë lirisht (apo janë të detyruara t’i bëjnë) zgjedhje të qarta sipërmarrëse që, duke përfshirë në forma të qarta apo të fshehta në realizimin e punimeve sipërmarrjet e lidhura me krimin e organizuar, synojnë të garantojnë për veten zhvillimin e qetë të punimeve. Në aspektin ekonomik, çmimi i këtij operacioni konsiderohet nga shoqëria e nënshtuar me forcën e kërcënimit të organizatave kriminale si një kosto e vërtetë prodhimi. Është e tepërt të themi se pagesa e kësaj shume, edhe ekuivalente (le të kujtojmë këtu marrëveshjen për rritjen e çmimit për punime dhe furnizime të kryera nën kujdesin e shoqërisë mafioze të lidhur), përgjithësisht luhet nga 3 deri në 5% të shumës së përgjithshme të punimeve të kontraktuara apo të nën-kontraktuara, maskohet shumë shpesh dhe bëhet e padukshme ndaj kontroleve dhe hetimeve të llojit tradicional.

Në fazën e kantierizimit të veprës, mund të verifikohen sidoqoftë veprime që sjellin varësi e nënshttrim, nga ana e grupeve të tjera kriminale, të përjashtuar nga marrëveshjet e bashkëpunimit për arsye nga më të ndryshmet, për shembull, ndihet pak në territor prania e tyre kriminale, ose u përkasin klaneve humbëse apo janë të papërshtatshëm për të siguruar paqen në kantier, meqë bëhet fjalë për grupe të formuara së fundi apo që janë në konkurrencë me grupe të tjera kriminale më të rëndësishme që tashmë kanë dalë garant për zhvillimin e qetë të punimeve.

¹⁵¹ Shih shënimin e përmendur në shënimin e mësipërm.

emëruesin e përbashkët të informacioneve të qarkut të hetimeve që që i takojnë prokurorisë.

Në fazën e të ashtuquajturit *kantierizim* të veprës, një faktor shumë i rëndësishëm për marrjen e rezultateve hetimore të mira mund të qëndrojë një *shpejtësinë dhe njëkohshmërinë e ndërhyrjes së parë në zonat e kantierit*, sidomos kur ato janë të shumta dhe të vendosura në territore të ndryshme, siç ndodh rëndom për veprat e mëdha realizimi i të cilave shtrihet në blloqe të ndryshme, që ndodhen në territorin e qarqeve dhe/ose provincave të ndryshme¹⁵².

Në protokollin hetimor të përgatitur nga D.K.A.¹⁵³ sugjerohet me të drejtë të veprohet me një rikonjicion paraprak – sidoqoftë të koordinuar – të denoncimeve të mundshme për kërcënim apo veprime zhvatjeje dhe formash të tjera presioni apo kushtëzimi të llojit mafiozi (atentat me lëndë shpërthyesë, vënie zjarri apo të një natyre tjetër; kërcënime të hapura apo të fshehta, paralajmërime, telefonata kërcënuese, oferta për shërbime roje e sigurie, kërkesa për punësim të bëra me arrogancë, prepotencë apo mënyra të tjera tipike mafioze, pretekste mosmarrëveshjeje me sindikatat me kërcënim të bllokimit të punimeve në kantier, e të ngjashme) në dëm të shoqërive të angazhuara, me çfarëdolloj arsye e të drejtë kontraktore (kontraktim, nënkontraktim, qira në të nxehtë a në të ftohtë, furnizim materialesh e shërbimesh, etj.), në realizimin e punimeve.

Në fazën që vjen menjëherë më pas, do të jetë e udhës të procedojmë – sipas *protokollit* të mësipërm – me marrjen e informacioneve të tjera të përzgjedhura përmes një rikonjicioni – pothuaj një *“fotografi” që i bëhet gjendjes së punimeve*, me të gjithë implikimet e mundshme penalisht të dënueshme – të çdo shtate të tillë që na bën të besojmë mundësinë e infiltrimeve mafioze. Për këtë qëllim, mund të jetë e dobishme *të verifikojmë*, për shembull, në kantieret ku zhvillohen punimet, *praninë e mundshme fizike të personave* (titullarë shoqërisht, administratorë ose ortakë dhe persona që u huazojnë emrin e tyre, personel drejtues dhe teknik, punëtorë, etj.) *dhe mjete mekanike* (makineri, autokarro, automjete

¹⁵² Është ky rasti i punimeve të zgjerimit dhe modernizimit të autostradës A3 Salerno-Reggio Calabria, mbi të cilët është përqendruar së fundi interesi i hetimeve të disa Prokurorive të rretheve të Jugut.

¹⁵³ Në bazë të nenit 371-bis, paragraf 3 germa c) k.p.p. ndër detyrat e drejtorisë kombëtare antimafie është edhe ajo e përpunimit të të dhënave, njoftimeve dhe informacioneve në lidhje me krimin e organizuar. Protokollet organizative të llojit të cilit i referohet teksti, përfaqësojnë frytin e kësaj veprimtarie, që është e destinuar të merret me ushtrimin e veprimtarisë së koordinimit dhe nxitjes së Prokurorit kombëtar antimafie dhe/ose të rrisë sasinë e informacioneve në zotërim të Drejtorive të rretheve antimafie të interesuara.

shërbimi, etj.) *që na shpien drejt shoqërive dhe përfaqësuesit e të cilave, drejtuesit apo administratorët janë dënuar, të pandehur apo nën hetim për fakte të krimit të organizuar dhe/ose korrupsionit*¹⁵⁴.

Gjithashtu mund të vlerësohet, rast pas rasti, mundësia për të vërtetuar:

- modalitetet e *kontrolleve të përgatitur dhe të realizuar konkretisht nga organet e ndryshme të entit prokurues*, si dhe
- *shkelje të mundshme të normave të vendosura në mbrojtje të sigurisë në punë dhe të zhvillimit të rregullt të marrëdhënies së punës* edhe në lidhje me mbrojtjen e asistencës dhe të sigurimeve të punonjësve,
- *shkelje të detyrimeve tatimore dhe mashtrime tatimore, mashtrime në furnizime publike* (lidhur me këtë, do të jetë e udhës të kryejmë në terren, nëse është e mundur me veprime të befasishme, *marrjen e nevojshme të kampionëve*, që duhen krahasuar me ata që mund të jenë kryer më parë nga shoqëria e kontraktuar apo e nënkontraktuar dhe/ose nga enti prokurues gjatë kontrolleve rutinë mbi cilësinë dhe sasinë, dhe kjo në perspektivën e verifikimeve të mundshme të ekspertizës *ish neni 359 dhe 360 k.p.p.*);
- *falsifikim i akteve publike dhe private* (që kanë të bëjnë me lëshimin e të ashtuquajturave *vërtetime antimafie* apo të vërtetimeve të parashikuara për kualifikimin nga ana e S.O.C.; falsifikim faturash, fletë-dorëzimi, shënime të para, libra kantieri, shkrime të tjera kontabël).

Në këtë këndvështrim, mund të na shërbejë:

- *marrja e dokumentacionit* (përputhja e ofertave të marra, shënime të punonjësve të sipërmarrjes së kontraktuar, të nënkontraktuar, dhe/ose qiramarrëse apo furnizuese) *në lidhje me përcaktimin e çmimeve të përdorura për qira në të nxehtë e/o në të ftohtë të makinerive apo për furnizime inertesh, konglomeratësh të çimentos dhe bitumit dhe në krahasimit me çmimet e përdorura në treg* apo që rezultojnë nga listat e tarifave zyrtare të tregut;

Mund të na shërbejë gjithashtu vërtetimi i elementëve të tjerë si vijon:

- *përqindja e përgjithshme e kostove për qera kundrejt çmimeve të fitimit të kontraktiveve dhe nënkontraktiveve;*

¹⁵⁴ Lidhur me këtë pikë të fundit, konsultimi i mirëmenduar i sistemit informativ SIDDA-SIDNA – e ashtuquajtura *bankë e të dhënave “taktike”* e Drejtorisë kombëtare antimafie – mund të jetë shumë i dobishëm.

- ***Ekzistenca e artificeve të mundshme që kërkojnë të fshehin titullsinë apo kompetencën e vërtetë vendimmarrëse të shoqërive të angazhuara në realizimin e punimeve;***
- ***Marrëdhënie preferenciale mes shoqërive në lidhje me qiratë apo furnizimet dhe në marrëdhënie të ngjashme kontraktore;***
- në rastin e punimeve të realizuara dhe kolauduara, ekzistenca e ***mashttimeve të mundshme apo parregullive të hasura gjatë kolaudimit*** dhe ndërmarrjes së një çështjeje civile apo administrative.

Në kryerjen e procedurës së ndërhyrjes, prokurori procedues, në koordinimin e veprimtarisë së organeve të ndryshme të policisë gjyqësore të autorizuar për kryerjen e akteve specifike, mund të vendosë që, për një ndërhyrje sa më efikase *in loco*, të mbështetet në bashkëpunimin ndërkombëtar të organizmave të tjerë (Inspektoriat i punës, A.S.L. kompetente, Dhoma e Tregtisë), krijuar më parë në formë të rezervuar, në mënyrë të tillë që garanton ***efektin surprizë***. Së fundi, mund të na shërbejë edhe ndërmarrja e gjithë atyre masave të nevojshme (përgjime telefonike dhe në mjedis, veprimtari të mundshme specifike të vëzhgimit, edhe me telekamera fikse apo të lëvizshme, ndjekje dhe kontrolle, etj.) në mbrojtje të marrjes së pastër të burimeve të mundshme të provës¹⁵⁵.

¹⁵⁵ Në *Protokollin e përgjithshëm të ndërhyrjes investiguese në kantieret e punimeve në lidhje me prokurimet publike*, përgatitur nga Shërbimi i Prokurimeve i Drejtorisë kombëtare antimafie, mbi *afatet dhe modalitetet e ndërhyrjes*, sillen – ndër të tjera – sugjerimet e mëposhtme operative:

- a) në rastin e ndërhyrjes në disa kantiere ku shtrihet realizimi i veprave të prokuruarra dhe ende të papërfunduara *njëkohshmëria e ndërhyrjes* është kusht i nevojshëm për të garantuar pastërtinë e marrjes së provave; për këtë qëllim, me fshehtësinë e duhur, do të vendosen marrëveshjet e nevojshme dhe do të merren masat e nevojshme për të garantuar efikasitetin e kontrolleve;
- b) (...)
- c) Aksesi në kantiere do të kryhet mundësisht nga ***skuadra të përziera***, të përbëra nga oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore që u përkasin zyrave të mësipërme të specializuara, që – pas marrëveshjeve të arritura paraprakisht për të cilat duhet vënë në dijeni prokurori që drejton hetimet – do të ndajnë detyrat përkatëse sipas drejtimeve përkatëse e specifike profesionale;
- d) Gjatë ndërhyrjes, oficerët e policisë gjyqësore që veprojnë mund të autorizohen shprehimisht për
- e) kryerjen e këtyre akteve:
 - marrjen, *në vend dhe/ose* pranë zyrave kompetente territoriale të entit prokurues, e informacioneve dhe të dokumentacionit që ka për objekt çdo prokurim apom nënprokurim në lidhje me punimet e realizimit apo në çelje e sipër; identifikimi dhe, nëse është e nevojshme, pyetje të funksionarëve të këtyre enteve prokuruese

me qëllim marrjen e çdo informacioni të dobishëm mbi parregullsi të mundshme të hasura në procedurat e shpalljes së prokuruesit dhe/ose të kryerjen e punimeve; marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për përcaktimin e kufizimit topografik të kantierit apo të parcelës ku kryhen punimet objekt i prokurimit apo nënprokurimit: kjo veprimtari do të bëjë të mundur **brendashkrimin nga ana grafike të zonës në fjalë në një hartë të posaçme topografike, e cila duhet t'i bashkangjitet shënimit ku do të përmbliidhen rezultatet e ndërhyrjes, në mënyrë të tillë që do u jepte hetuesve mundësinë për të pasur një vizion grafik të të tërës, që mund të sugjerojë kryerjen e kontrolleve të tjera më të thelluara** (le të mendojmë këtu, për shembull, marrjen nga ana e të interesuarve të tretë të terreneve që qëndrojnë në kufi të veprës publike që duhet ndërtuar, vlera e të cilëve është e destinuar të rritet, apo kur gjenden para rastit, me rëndësi strategjike në aspektin ekonomiko-industrial të guroreve apo komplekseve për furnizimin e betonit, çimentos dhe konglomeratëve bituminozë, gjatë sistemit rrugor apo të autostradës që duhen realizuar):

- gjetjen e shoqërive që me çfarëdo të drejtë (duhet saktësuar, pas marrjes së dokumentacionit përkatës: kontratë prokurimi, nënprokurimi, qeraje në të nehtë/në të ftohtë, etj.), operojnë në kantierin që i nënshtrohet kontrollit; identifikimin e titullarëve përkatës dhe/ose përfaqësuesve dhe, nëse bëhet fjalë për shoqëri, të ortakëve të tyre; në rastin e *qerave në të ftohtë*, është e udhës të merret dokumentacioni përkatës dhe të kryhen hetimet e nevojshme që synojnë të vërtetojnë për çdo shoqëri qiradhënëse, shumën e përgjithshme të qirave të kryera dhe kuotën përkatëse të prokurimit dhe nënprokurimit të cilit i referohet qeraja; në rastin e shoqërive operuese, me çfarëdo të drejtë, edhe në kantiere të tjera, do të jetë mirë të njihet me një shënim përmbledhës të rezultateve të hetimeve të autorizuar;
- identifikimin e personave të pranishëm, për çfarëdo arsye, në kantier (nëse do jetë e nevojshme, për të konstatuar situatat e dyshimta apo, sidoqoftë, që të bëjnë të ndalesh, do të procedohet me informacionet e nevojshme apo të përpilohen shënime; kujdes i veçantë do i kushtohet identifikimit të drejtorëve të kantierëve, përgjegjësve të kantierëve, brigadierëve që do të pyeten me procesverbal, në vend, mbi fakte që mund të paraqesin interes në dritën e hetimeve si më sipër treguar);
- përcaktimin e gjithë automjeteve dhe makinerive që gjenden në kantier dhe të drejtuesve të tyre, operatorëve dhe pronarëve; në rast parregullsish të mundshme të hasura në aktin e kontrollit (p.sh. automjete dhe/ose makineri që i përkasin shoqërisë së prokuruar për punimet, që drejtohen nga personel që i përket një shoqërie tjetër; persona që janë të ngarkuar me drejtimin e mjeteve mekanike, të marra me qera nga shoqëria e prokuruar apo nënprokuruar, punonjës në varësi të këtyre të fundit; artifice që kërkojnë të fshehin – psh. Përmes “maskimit” të emrave në tabelëzën e ndërmarrjes pronare që qëndron mbi këto makineri, *e të ngjashme*), në varësi të urgjencës së rastit, do të zhvillohen gjithë përhellimet e nevojshme investiguese;
- gjetjen e komplekseve të mundshme të prodhimit të inerteve, të konglomerateve bituminoze dhe të çimentos, të përdorur për furnizimin dhe instalimin e materialeve përkatëse në kantieret e mësipërm (në hartën topografike të lartpërmendur do të tregohen vendet në të cilat ndodhen këto komplekse); përcaktimin e shoqërive furnizuese të materialeve si më sipër.

Natyrisht, me sa thamë deri tani nuk pretendojmë aspak të kemi sjellë gjithë sa ka të bëjë me drejtimit e hetimeve.

Ashtu siç e di mirë çdo hetues i zotë, që ndien sadopak vështirësinë e kësaj fushe, rrugët e hetimeve gjyqësore sidomos në këtë sektor specifik, nuk mund të përcaktohen *apriori* dhe për pjesën më të madhe të tyre i lihen në dorë intuitës dhe ndjeshmërisë investiguese të çdo operatori. Por as njëri as tjetri nuk mund shihen veç njohjes së normativës që rregullon fushën komplekse, as – aq më pak – veç vetëdijes që format e reja të infiltrimit mafioz në këtë sektor nevralgjik të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit synojnë të krijojnë situata djallëzore ***në dukje të ligjshme*** që është detyrë e investigimit penal t’i zbulojë dhe ndjekë.

KËSHILLTAR CORRADO LEMBO
Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie

Romë, Tetor 2007

2.7. Veprimtaria e luftës kundër krimit të organizuar në sektorin e prokurimeve publike: shënime mbi kontrollin administrativ antimafie në prokurimet publike.

§ 1. Hyrje dhe konteksti i përgjithshëm.

§ 1.1.

Përshkrimi i sistemit të monitorimit antimafie mbi Veprat e Mëdha kërkon detyrimisht disa premisa të caktuara dhe disa shpjegime mbi veçantitë e sistemit italian të kontrollit të prokurimeve në lidhje me riskun e depërtimit të krimit të organizuar.

Me termin Vepra të Mëdha kuptohen ndërhyrjet në lidhje me infrastrukturën, publike dhe private, dhe kompleksët prodhues strategjike dhe me interes kombëtar parësor, të cilat duhet të realizohen për modernizimin dhe zhvillimin e vendit.

Zbatimi i shpejtë i një programi rilancimi të politikave të ndërhyrjes që kanë për qëllim që Italia të plotësojë boshllëqet e veta në infrastrukturë, kundrejt e sidomos ndaj partnerëve të tjerë evropianë, është dashur të përballlet me një sërë vështirësish, dhe kjo shpuri nevojshmërisht në zgjedhjen për të adoptuar një instrument të posaçëm në ndryshim të atij të zakonshëm.

Në dritën e kësaj lindi “ligji objektiv”, pasi kështu quhet ligji n.443, i dt. 21 dhjetor 2001. Termi *objektiv* ka të bëjë pikërisht me nevojën për të plotësuar sa më parë boshllëkun e modernitetit që vuan vendi ynë në shumë sektorë strategjikë, duke përfshirë në këtë kuadër jo vetëm lidhjet hekurudhore dhe rrugore, por edhe përshtatjen dhe zhvillimin e gjithë sistemeve të ndryshme të transportit, modernizimin e sistemeve të furnizimit me energji, si dhe ndërhyrjet në sektorin e telekomunikacioneve dhe të furnizimit me ujë.

Siç shihet, Plani i Veprave të Mëdha nuk mjaftohet me një listë të shkurtër përparësish, por trajton në themel çështjen e prapambetjes historike të vendit, duke pasur parasysh se, siç vërejnë edhe disa kërkime në këtë fushë, në klasifikimin e posaçëm që mat pajisjen e infrastrukturave të nevojshme për rritjen e përshtatshme të sistemit ekonomik, Italia qëndron pesë pikë poshtë mesatares evropiane. Trembëdhjetë qarqe italiane kanë një nivel më të ulët se mesatarja. Ndër to Umbria, Kalabria (Calabria), Bazilikata (Basilicata), Trentino Alto Adixhe (Trentino Alto Adige),

Sardenja (Sardegna) dhe Molize (Molise), kanë një nivel që përkon me një të katërtën më i ulët se masatarja evropiane, duke qëndruar kështu në fund të klasifikimit ndërkombëtar.

§ 1.2.

Thamë se ligji objektiv është një ligj i posaçëm. Në relacionin shoqëruës të këtij ligji mund të gjejmë një referim krejt të ri, pasi përdoret parimi i specialitetit. I japim pra fjalën ligjvënësit: “...Si rregull, është special apo i posaçëm një ligj që nuk parashikohet si i përgjithshëm. Ligji special është në veçanti, special: a) në varësi të ngjarjeve të jashtëzakonshme me karakter natyror (për shembull, fatkeqësi natyrore) apo me karakter shoqëror (për shembull, gjendja e jashtëzakonshme); apo në varësi të fushës specifike të zbatimit.

Pikërisht për këto arsye ligji objektiv është një ligj special pasi synon të arrijë një objektiv dhe për rrjedhojë përcaktohet në bazë të fushës së zbatimit. Deri tani (sidomos në historinë më të fundit të Italisë) përdorimi i legjislacionit special është shtyrë nga arsye me karakter shoqëror (për shembull, legjislacioni kundër kriminalitetit të organizuar). Në veçanti këtu propozimi (risia) është (të kthehemi) të përdorim këtë instrument “duke e specializuar” në varësi të infrastrukturave. Duke përcaktuar pra objektiva operative, që përbëhen pikërisht nga infrastruktura specifike. Në këtë kuptim, “thelbi” i ligjit objektiv përbëhet nga infrastruktura, e cila përcaktohet dhe përkufizohet në teknikat specifike të saj, vit pas viti, gjatë ligjit financiar. Duke pasur parasysh këtë objektiv dhe në varësi të tij, instrumenti normativ që ndërfitet është ai i një delegimi, apo autorizimi, që mbështetet në objektiva dhe kritere, ...në respektim të plotë të parimeve të autonomive, të parimeve të mbrojtjes së mjedisit, të të drejtave të shtetasve, efikas në mekanizmin e vet operativ dhe ekonomik...”

Me miratimin e ligjit n.443 të vitit 2001 u ndërfit kështu një rregullim i posaçëm, në thelb një legjislacion, i njëkohshëm me atë të zakonshëm (i zbatueshëm në përgjithësinë e ndërhyrjeve), karakterizuar nga një kuadër objektiv zbatues jashtëzakonisht më të vogël, duke pasur të bëjë **vetëm me**

infrastrukturat strategjike, të përcaktuara me Program¹⁵⁶ të posaçëm të parashikuar nga vetë ligji 443 (neni 1, paragrafi 1).

Ligji 443 përvetëson pra, për të njëjtat arsye që qëndrojnë në zanafillë, një logjikë ndryshuese, në gjendje të kapërcejë vështirësitë kryesore që has realizimi i veprave publike, që qëndrojnë sidomos në ngurtësinë e mekanizmave proceduralë e cila mund të ndikojë në çdo fazë, nga ajo e projektimit deri në atë të zbatimit, dhe nga kufizimi i burimeve financiare që duhen përdorur për investimet në infrastrukturë, shpesh në themel të ndërprerjes me forcë të ciklit të realizimit, gjë që sjell si rrjedhojë një tjetër faktor negativ, “të ashtuquajturat vepra apo punime të papërfunduara”, që ndikon në sistemin e marrëdhënieve të besimit mes institucioneve dhe qytetarëve. Në këto rrethana, për një rilançim më konkret të sektorit të infrastrukturave, del i domosdoshëm adoptimi i formulave të përshtatshme që do të mundësonin përfshirjen e kapitalit privat në realizimin e ndërhyrjeve, si dhe të moduleve proceduralë të thjeshtuar dhe të privilegjuar, në veçanti, për hartimin dhe miratimin e projekteve, për procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor, për sistemet e realizimit, për procedurat e zgjedhjes së kontraktuesit.

§ 1.3.

Për sa u përket **kontrolleve antimafie**, dekreti legjislativ që ka zbatuar ligjin objektiv – bëhet fjalë për dekretin n.190, të dt. 2 gusht 2002 – përmban vetëm disa dispozita specifike.

Një dispozitë e parë përcakton në lidhje me mënyrat e realizimit përmes dhënies në prokurim të veprës tek *general contractor*, detyrimin për subjektin prokurues që të lidhë *kontrata të posaçme me autoritetin e sigurisë*, kompetent në fushën e parandalimit dhe ndëshkimit të kriminalitetit, që kanë për qëllim verifikimin paraprak të programit të zbatimit të punimeve në dritën e monitorimit të mëtejshëm të gjitha fazat e realizimit të veprave dhe të subjekteve që i realizojnë ato.

Një dispozitë e dytë parashikon që kontrollet antimafie ndaj *general contractor* apo kontraktorit të përgjithshëm dhe ndaj subjekteve të tjera që

¹⁵⁶ Programi i parë i Infrastrukturave Strategjike (P.I.S.) është miratuar në dhjetor 2001 nga Komiteti Ndërmintor për programimin ekonomik, organ i bashkërendimit ndërmintor të kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave. Ky Komitet ka kompetenca të gjera në fushën e Veprave të Mëdha dhe marrin pjesë në të edhe kryetarët e Qarqeve dhe të Provincave autonome të Trentos dhe Bolxanos, që preken nga ndërhyrje të veçanta strategjike.

marrin pjesë në realizimin e punimeve, në zbatim të marrëdhënieve kontraktuale që kanë krijuar në rrugë të drejtpërdrejtë apo tërthortë me këtë *general contractor*¹⁵⁷, kryhen sipas mënyrave të parashikuara për punimet publike, me po ato mënyra që përdoren për të vënë në jetë ndërhyrjet e tjera që nuk përfshihen në Programin e Veprave të Mëdha e që duhen konsideruar “të zakonshme”.

Mund të themi pra se ndryshimi i sjellë në ligjin objektiv dhe në dekretin autorizues të zbatimit nuk u shoqërua në sistemin e kontrolleve antimafie, në kuptimin që ky ndryshim ***nuk ndikoi në asnjë mënyrë në këtë sistem.***

Së fundi, një dispozitë e tretë parashikon që me dekret të Ministrisë të Punëve të Brendshme, në marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e infrastrukturave dhe transporteve, përcaktohen procedurat për monitorimin e infrastrukturave dhe të komplekseve industriale për parandalimin dhe ndëshkimin e përpjekjeve për infiltrim mafioz. Në zbatim të këtij parashikimi është marrë dekreti ministror i dt. 14 mars 2003 (për të cilin i referohemi paragrafit **2.1.**).

§ 1.4.

Nga sa thamë në pikën e mësipërme vazhdon të jetë edhe në sektorin e Veprave të Mëdha sistemi i kontrollit antimafie për prokurimet, i cili zbatohet sa herë që bëhet fjalë për një ndërhyrje “të zakonshme”.

Ky sistem ***mbështetet në figurën e prefektit***, të cilit i takon përgjegjësia për kontrollet e kryera mbi subjekte, persona fizikë dhe juridikë, të përfshirë në ciklin e ekzekutimit të punimeve. Kuadri ligjor që rregullon këto ndërhyrje të prefektit sillet nga dekreti i Presidentit të Republikës n.352, dt. 3 qershor 1998. Ky akt parashikon një rregullim të zbatueshëm në bazë të tre grupe të ndryshme:

- a) Bëjnë pjesë në grupin e parë kontratat dhe nënkontratat vlera e përgjithshme e të cilave nuk e kalon pragun prej 154.937,07 euro, për të cilat nuk ekziston asnjë detyrim për dokumentacionin antimafie;
- b) bëjnë pjesë në grupin e dytë kontratat dhe nënkontratat vlera e përgjithshme e të cilave është më e madhe se 154.937,07 euro; për instrumentet kontraktuale që bëjnë pjesë në këtë grup, kontrollet

¹⁵⁷ Dallon një radhë e parë subjektësh, zbatues të nivelit të parë, dhe një radhë e dytë, zbatues të nivelit të dytë, e përbërë nga nënprokurues dhe nënkontraktorë, që kanë një marrëdhënie vetëm të tërthortë me *general contractor*.

antimafie parashikojnë marrjen nga ana e subjektit publik që jep në prokurim punimet (që quhet me termin enti prokurues) të një vërtetimi regjistrimi në Dhomën e Tregtisë i cili vërteton mosekzistencën e shkaqeve penguese të llojit mafioz, ekzistuese apo që varen nga zhvillimi i një çështjeje penale apo me natyrë sigurie (do të shpjegojmë më tej veçantinë e këtij instrumenti, që përfaqësohet nga *masat e sigurisë personale apo pasurore*). Për këtë qëllim Dhomat e Tregtisë mbështeten në një lidhje telematike me sistemin informativ të përdorur nga Prefektura e Romës;

- c) së fundi, bëjnë pjesë në grupin e tretë kontratat vlera e përgjithshme e të cilave është e barabartë apo më e lartë se pragu i zbatimit të rregullimit komunitar në lidhje me prokurimet, apo nëse bëhet fjalë për nën-kontrata (nënkontraktim apo forma të tjera të ngjashme), vlera e të cilave është më e madhe se shuma 154.937,07 euro. Për këto kontrata dhe nën-kontrata kontrolli antimafie nuk përfundon me vërtetimin e shkaqeve penguese të përmendura në pikën b). Në fakt, në këto raste paraprihet më tej pragu i mbrojtjes pasi del e nevojshme të vërtetohet mosekzistenca edhe e *përpyekjeve për infiltrim mafioz* në shoqëritë apo ndërmarrjet e interesuara. Theksohet lidhur me këtë një punë mjaft delikate, pasi ekzistenca e përpyekjeve për infiltrim mund të vërtetohet jo vetëm nga rrethana që paracaktohen nga ligji por edhe nga verifikime që vendosen nga prefekti¹⁵⁸ në lidhje me subjekte që, ndonëse zyrtarisht nuk kanë të bëjnë me ndërmarrjen e shoqërinë, ushtrojnë sidoqoftë *një ndikim përcaktues mbi zgjedhjet dhe orientimet përkatëse*. Për këtë arsye vëmendja përqendrohet më shumë në marrëdhëniet dhe ndikimet konkrete, rregullisht të vërtetuara, sesa mbi aspektet formale të pronësisë së ndërmarrjeve a shoqërive.

¹⁵⁸ Këto verifikime janë kryer duke u mbështetur në të drejtat për të pasur akses dhe kontroll që i janë dhënë Komisarariatit të Lartë për koordinimin e luftës kundër krimit mafioz (organizëm që ka pushuar së qeni në vitin 1992, kompetencat e të cilit në këtë fushë u ishin deleguar në rrugë të përhershme nga Ministria e Brendshme Prefektëve të Republikës).

§ 1.5.

Verifikimet anifimafie dhe, në veçanti, informacionet e lëshuara nga prefekti i vijnë në ndihmë sistemit të parandalimit, sistem që në panoramën juridike evropiane përfaqëson një unicum.

Masat parandaluese apo të sigurisë personale bëjnë vend në sistemin penal në aspektin që, nga pikëpamja funksionale, synojnë të shmangin kryerjen e një krimi nga ana e një subjekti për të cilin rrethana konkrete tregojnë se janë veçanërisht të prirura ndaj krimit. Në të vërtetë, bëhet fjalë për masa *ante-delictum* pikërisht në kuptimin që gjejnë zbatim në mungesë të një krimi të kryer. Ato i shmangen pra qarkut “shkelje e urdhrit-përgjegjësisë-ndëshkimit”, duke iu referuar më shumë një rrethane që të lë arsyeshmërisht të parashikosh që një individ mund të kryejë një krim. Për këtë aspekt përfaqësojnë një institut edhe më të diskutuar. Është vënë në diskutim nëse ato pajtohen apo jo me parimet kushtetuese, duke kritikuar faktin që zbatimi i tyre lidhet jo me kryerjen e një vepre konkrete, përcaktuar në çdo aspekt të vet, sesa, me rrethanën subjektive të rrezikshmërisë kriminale, që rezulton nga tregues të sjelljes. Në veçanti, është pranuar se do të shkeleshin parimet e ligjshmërisë dhe të detyrueshmërisë. Por duhet thënë edhe se normat që përmban ligji n.1423 i vitit 1956 – që përfaqëson deri më tani ligjin bazë të sistemit – kanë kaluar më shumë se një herë nën kontrollin e suksesshëm të Gjykatës Kushtetuese, që në fakt ka konfirmuar legjitimitetin kushtetues në përputhje me kriterin që justifikon ekzistencën e masave paraprake të sigurisë kundër rrezikut të kryerjes së veprave të paligjshme që mund të rrezikojnë zhvillimin e rregullt dhe paqësor të marrëdhënieve shoqërore dhe/ose të vërë në rrezik gëzimin e lirë të të mirave dhe të interesave themelore të njeriut, ndër të cilët qëndrojnë sigurisht e mira e jetës dhe ajo e lirisë në çdo kuptim të vetin.

Në perspektivën konkrete të luftës kundër mafies dhe organizatave të tjera kriminale që shfaqin karakteristika të ngjashme në veprimtarinë e tyre që përkohet me atë të përcaktuar *metoda mafioze*, që qëndrojnë në shfrytëzimin e forcës së kërcënimit dhe të kushtit të nënshtrimit dhe të heshtjes, fiton një rëndësi të veçantë ligji antimafie n.575, i dt. 31 maj 1965, që parashikon zbatimin e masave parandaluese të sigurisë në ngarkim të subjekteve “të dyshuar se i përkasin organizatave mafioze”.

Divergjencia më e madhe e këtij ligji kundrejt ligjit të mësipërm n.1423, të vitit 1956, qëndron në faktin që ndërsa ky i fundit supozon ekzistencën e

rrethanave të caktuara të lidhura, për më shumë, me situata¹⁵⁹ të llojit të sjelljes, për të cilat është e nevojshme që vërtetimi i rrezikshmërisë së subjektit të varet nga përputhja e rrethanave të caktuara, sipas ligjit antimafie n.575, dt. 1965, parakusht për masën e sigurisë është vetëm cilësia e të dyshuarit për anëtarësi në një organizatë të llojit mafioz, në pavarësi të plotë nga rrethanat që përmendëm më lart.

Është e rëndësishme të theksojmë se ligji antimafie n.575, i vitit 1965 parashikon që në ngarkim të subjekteve të dyshuar se kryejnë veprimtari mafioze të procedohet me *hetime pasurore*.

Për sa i takon objektit të këtyre hetimeve, neni 2-bis i ligjit të sipërpërmendur vendos që ato duhet të kenë të bëjnë me nivelin e jetesës, me disponibilitetet financiare dhe, më në përgjithësi, me gjendjen pasurore të subjektit. Veprimtaria hetimore, siç saktëson norma, synon edhe të përcaktojë burimet e të ardhurave të personit të dyshuar.

Duke pasur parasysh qëllimin e saktë të tyre, që është gjetja e arsyeve të grumbullimit pasuror dhe inventarizimi i të gjitha të mirave që i përkasin subjektit, apo mbi të cilat i dyshuari mund t'i disponojë¹⁶⁰ *në mënyrë të tërthortë*, veprimtaria hetimore shfaqet deri diku e ndërlikuar. Në të vërtetë, ajo kërkon në përgjithësi të kryhen përputhje dhe analiza të kujdesshme në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në arkivat noterialë, në kancelaritë e gjykatave, në dhomat e tregtisë, etj., por sidomos në aksesin në banka, shoqëri besimi dhe organizma të tjerë që zhvillojnë veprimtari me karakter financiar.

Në fakt, *hetimet bankare* përbëjnë instrumentin më provues për zbulimin e të ardhurave të përfuara në mënyrë të paligjshme dhe për rindërtimin e veprimtarive dhe të lidhjeve subjektive që kanë shpënë në arritjen dhe fshehjen e fitimeve kriminale.

¹⁵⁹ Neni 1 i ligjit 1423/1956 përcakton që masat e sigurisë personale që zbatohen për: 1. ata që, në bazë të elementëve të faktit, duhet të konsiderohen se merren zakonisht me trafikë të paligjshme; 2. ata që për sjelljen e tyre (vijon shënimi 4) dhe nivelin e jetesës, në bazë të elementëve të faktit, duhet të konsiderohen se jetojnë zakonisht, edhe pjesërisht, me të ardhura nga veprimtari të paligjshme; 3. ata që për sjelljen e tyre, në bazë të elementëve të faktit, duhet të konsiderohen se merren me kryerjen e krimeve që cenojnë apo vënë në rrezik integritetin fizik apo moral të të miturve, shëndetin, sigurinë apo qetësinë publike.

¹⁶⁰ Për këtë arsye, hetimet kryhen edhe ndaj bashkëshortit, fëmijëve, bashkëjetuesve gjatë pesë vjetëve të fundit, si dhe ndaj personave fizikë e juridikë, shoqërive, konsorciumeve apo bashkimeve kapitalin e të cilave rezultojnë se mund ta disponojë, plotësisht apo pjesërisht i dyshuari.

Kapitali i paligjshëm i të dyshuarit, si kur përfaqëson frytin e nxjerrë drejtpërsëdrejti nga zhvillimi i veprimtarive të paligjshme, ashtu dhe kur rrjedh nga riinvestimi i parave të pista, si në rastin e pasurive të paluajshme, i aksioneve në shoqëri, i veprimtarive të ndërmarrjeve të fituara me investimin e mjeteve financiare me prejardhje kriminale, i nënshtrohet *sekuestrimit* dhe, më pas, me zbatimin e një mase sigurie individuale, *konfiskimit*.

Si do të përmendet në paragrafin që vijon, sistemi ligjor antimafie parashikon më pas një sërë rrjedhojash, si ndalime, pezullime, humbje të drejte, që synojnë të pengojnë personin që dyshohet se është anëtar i një organizate mafioze të ketë marrëdhënie me administrata publike nga ku mund të nxjerrë mundësi të tjera përfitimi. Ndër ndalimet e parashikuara, duket me rëndësi të kujtojmë se, sipas nenit 10 të ligjit antimafie n.575, të vitit 1965, personat ndaj të cilëve ushtrohet një masë sigurie, ndër të tjera, nuk mund të lidhin kontrata prokurimi, furnizimi për punime, të mira e shërbime në lidhje me administratën publike dhe nën-kontrata përkatëse.

Personat që kanë për kompetencë dhe detyrë të zhvillojnë hetime pasurore ndaj subjekteve të dyshuar si mafiozë janë prokurori dhe kuestori, të cilët mbështeten në veprimtarinë e Rojës së Financës apo të policisë gjyqësore.

Në mbyllje, përmendet vetëm fakti që mes procedurës së masës së sigurisë dhe procesit penal ekziston një marrëdhënie e *autonomisë së plotë*, edhe në prani të identitetit të fakteve materiale dhe të subjekteve të interesuar. Lidhur me këtë, bëhet fjalë për *binarin e dyfishtë*, pasi është eliminuar çdo lidhje paragjyqeshmërie të ndërsjellë. Nga kjo rrethanë varësie mund të rrjedhin sidoqoftë mbivendosje dhe ndërhyrje, që mund të ndikojnë negativisht mbi efikasitetin e përgjithshëm të sistemit sanksionues.

§ 1.6.

Për sa u takon informacioneve antimafie të prefektit duhet sqaruar se ato përkojnë me **masat me karakter administrativ**, ndërsa masat parandaluese të sigurisë për të cilat folëm deri tani janë kompetencë juridiksionale. Lidhja që krijohet mes njoftimeve dhe informacioneve të prefektit për masat e sigurisë qëndron në faktin që zbatimi i tyre rrjedh nga një metodë që mbështetet tek dyshimi, që rivlerëson me fjalë të tjera dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në rrethana fakti që i nënshtrohen një verifikimi rigoroz, lidhur me rrezikshmërinë e subjektit. Pra, të dyja shohin drejt të ardhmes, në kuptimin që mbështeten nga një gjykim probabilist, që bazohet

mbi atë që përcaktohet një “siguri juridike fillestare” (rrethanat e faktit të lartpërmendura). Gjithashtu, kur jepen informacione negative, përveçse përcaktohet **pamundësia për administratën prokuruese që të lidhë një kontratë** me shoqërinë apo sipërmarrjen të cilës i referohen informacionet, përcaktojnë edhe nisjen e verifikimeve të mëtejshme që mund të përmblihen në raportin për autoritetin gjyqësor për nisjen e veprimtarisë me karakter penal dhe, për këtë, në paraqitjen e propozimit, nga ana e organeve kompetente, para gjykatës për zbatimin e masës së sigurisë.

Nga kjo pikëpamje, duket e ligjshme thënia sipas të cilës tërësia e njoftimeve dhe informacioneve antimafie në sektorin e prokurimeve publike merr pjesë me të gjitha të drejtat në sistemin e parandalimit, në kuptimin që e plotëson dhe integron atë. Në veçanti, aspekti parandalues qëndron në faktin që, përmes njoftimeve dhe informacioneve mbrohet sistemi ekonomik-prodhues nga sulmi i organizatave të llojit mafioz, në mbrojtje të interesave publikë të rëndësishëm, si interesi i mbrojtur nga kushtetuta i asnjansinë dhe ecurinë e mirë të administratës publike, dhe interesi për një menaxhim efikas të fondeve financiare publike.

§ 2. Sistemi i kontrollit antimafie mbi Veprat e Mëdha.

§ 2.1.

Sistemi i monitorimit antimafie për Veprat e Mëdha rregullohet për herë të parë me nxjerrjen e dekretit ministror nr. 190, dt. 14 mars 2003, nxjerrë në zbatim të dekretit legjislativ, të lartpërmendur, neni 14^{is}, paragrafi 5.

Për vështirësinë dhe shtrirjen e veçantë, edhe territoriale, të funksioneve që i jepen sistemit rezultoi menjëherë i nevojshëm strukturimi i tij **në formë rrjeti**, veçanërisht me këto nyje kyç:

- a) në nivel qendror, **Komiteti i Bashkërendimit të Mbikëqyrjes së Lartë të Veprave të Mëdha**. Marrin pjesë në këtë organizëm përfaqësuesit më të lartë të administratave më shumë të interesuara në këtë fushë specifike; bëjnë pjesë në veçanti Ministria e Infrastrukturave, që ka kompetencat kryesore në fushën e punimeve publike; Ministria e ekonomisë dhe financave, për aspektet që lidhen me veprimtarinë e luftës kundër fenomenit të pastrimit të parave (do të flasim më tej për nismat e monitorimit financiar të Veprave të Mëdha); Drejtoria Kombëtare Antimafie, organ që bashkërendon hetimet në çështjet për krime të kryera nga krimi i organizuar; Autoriteti i mbikëqyrjes mbi kontratat e

punimeve publike, shërbimeve dhe furnizimeve, autoritet administrativ i pavarur që kryen në këtë sektor të gjerë funksione të mbikëqyrjes dhe pranë të cilit operon Observatori kombëtar i punimeve publike; Drejtoria Investigative Antimafie, e krijuar për bashkërendimin e veprimtarisë informative dhe investigative në luftën kundër krimit të organizuar. Komiteti e ka selinë e vet pranë Kabinetit të Ministrit të Punëve të Brendshme;

- b) në nivel periferik, prefekturat – zyrat territoriale të Qeverisë, pranë të cilave, dekreti ministror i dt. 14 mars 2003, ka krijuar **Grupet Interforze**. Bëhet fjalë për grupe të vogla të bashkërenduar nga një Nënprefekt dhe përbëhen nga përfaqësues nga forca të policisë, nga një përfaqësues i Qendrës Operative D.I.A., kompetente për territorin, nga funksionarë të administratës periferike të punëve publike dhe të punës dhe nga ajo e sigurimeve shoqërore (këto të fundit, në veçanti, për luftën kundër fenomenit të “punës në të zezë” dhe për sigurinë në vendet e punës, janë dy aspekte që vënë në dukje depërtimin e krimit sidomos në kontekste territoriale *me ligjshmëri të dobët*.

Duhet thënë se Grupet Interforze kanë lidhje të vazhdueshme me Komitetin dhe **krijojnë edhe mes tyre një rrjet**, në kuptimin që shkëmbejnë informacione dhe të dhëna në lidhje me infrastruktura që bëjnë pjesë në kompetencën e tyre territoriale. Kjo gjë mund të ndodhë pothuaj shpesh e mjafton të kujtojmë shtrirjen lineare të lidhjeve hekurudhore të sistemit të Shpejtësisë së Lartë- Aftësisë së Lartë, që duhet konsideruar si një Veprat e Mëdha që kërkon një punë të madhe nga ana e Grupeve Interforze.

G.I., që sigurojnë një kthim të vazhdueshëm të informacioneve në Komitet, përfaqësojnë **partnerin operativ** të Drejtorisë Investigative Antimafie.

Ky modul lidhjeje përsërit në një farë mënyre një formë të mëparshme bashkëpunimi mes prefekturave dhe D.I.A., që u eksperimentua sidomos në disa zona të qendrës dhe veriut dhe jugut të Italisë nga punimet e para TAV (T.SH.L.) (Treno Alta Velocità/Tren me Shpejtësi të Lartë) dhe nga ato që kanë të bëjnë me programin e veprave hidrike të Jugut të Italisë, punime me ndikim të madh që mund të thuhet se u paraprijnë Veprave të Mëdha.

Duhet shtuar edhe se D.I.A. – që ka një mandat të qartë për veprimtarinë antimafie lidhur me prokurimet publike dhe ka zhvilluar për këtë, në vite, njohuritë e saj në këtë sektor – ka realizuar dhe administron në nivel qendror **Observatorin qendror të prokurimeve** (OCAP), sistem telematik që, ndër të tjera, duhet të mbledhë të dhënat dhe informacionet e marra nga Grupet

Interforze në lidhje me *aksesin inspektues pranë kantierëve të Veprave të Mëdha*.

Kjo formë kontrolli, e ndërfutur enkas për kontrollet antimafie të Veprave të Mëdha nga dt. 14 mars 2003, përfaqëson një instrument mjaft të dobishëm dhe ka ndikime mjaft interesante si për menaxhimin administrativ të të dhënave, ashtu dhe në varësi të zhvillimeve me karakter më mirefilltasi investigues.

Ajo që na interesin më shumë në këtë trajtesë është të theksojmë mundësitë që ky instrument aksesit kundrejt kompetencave për të ndërhyrë të prefektit. Në fakt, nuk duhet të harrojmë se Grupet Interforze përfaqësojnë një *longa manus* të prefektit. Në të vërtetë, është prefekti ai që në bazë të propozimeve të arsyeuara të Grupit Interforze, vendos aksesin në kantiere dhe është po ky autoritet ai që vendos zhvillimin që do të kenë rezultatet e arritura nga ky akses.

Mundësia që të zhvillohen drejtime paralele, si me karakter administrativ (siç do të shohim më mirë, prefekti mund t'i kërkojë entit prokurues, pas aksesit, të ndërhyjë për ta përjashtuar një ndërmarrje që “dyshohet të jetë mafioze”) ashtu dhe me karakter investigues, *tregon që sistemi i kontrollit të Veprave të Mëdha priret të jetë gjithnjë e më i bashkuar*.

§ 2.2.

Me veprimtarinë e monitorimit antimafie merret një direktivë e posaçme që përmban udhëzimet, apo një akt të orientimit kryesor ndaj të cilit duhet të njehsohen fazat e ndryshme të verifikimit dhe kontrollet e mëtejshme.

Në këtë dokument të gjerë e të rëndësishëm, që daton qershor 2005, jepen udhëzimet që, në sektorin e kontrolleve antimafie të kryera nga prefekurat, përfaqësojnë një risi të veçantë.

Lipset të sqarojmë se kontrollet në lidhje me prokurimet publike që deri tani kanë pasur të bëjnë me kontrollin e subjekteve, personave fizikë dhe juridikë, të përfshirë në realizimin e veprës, me qëllim që të vërtetohet ekzistenca apo jo e elementëve pengues.

Në këtë direktivë, e cila u drejtohet prefektëve, vendoset theksi edhe në *kontekstin mjedisor* ku parashikohet të realizohet vepra.

Kjo e dhënë duket e rëndësishme sepse cilëson veprimtarinë e prefektëve në nivel *shërbimi informativ (apo intelligence)*, pra analize paraprake të risqeve në lidhje me ndikimin territorial të infrastrukturës së re.

Lind në këtë fazë mundësia që prefekti të luajë një rol vendimtar në *mbrojtje të sistemit ekonomik* lokal që mund të kërcënohet nga manovra depërtuese të krimit të organizuar, që është i interesuar të shfrytëzojë çdo mundësi fitimi.

Theksi duhet vënë pra jo vetëm në zgjedhjen e shoqërive dhe ndërmarrjeve të kontraktuara, por edhe aspektet e projektit të veprës që lidhen veçanërisht me territorin. Aspekte që duken më delikatë në rastet kur infrastruktura e re apo kompleksi i ri prodhues do të ndikonte ndjeshëm sistemin dhe mundësinë për zhvillim të territorit.

Në këtë fazë veprimtaria e monitorimit, duhet të përballet me një element ndotjeje të mundshme që përfaqësohet nga forca e depërtimit dhe e kushtëzimit mafioz që mund të ushtrohet nga grupe kriminale me qëllim *përgjimin e flukseve ekonomike të lidhura me potencialet për shtrirje të ndërhyrjes publike*. Le të kujtojmë, për shembull, realizimin e një strukture të re të rrjetit të transportit (një stacion i ri hekurudhor apo një *hub* i madh aeroportual) dhe krijimin e formave të reja ekonomiko-prodhuese, të lidhura me të ardhurat apo të përcaktuara nga oferta e shërbimeve të kualifikuara për ndërmarrjet.

Kjo fazë monitorimi do të dallohet kështu nga një zërë kontrollesh të kujdesshme e paraprake mbi zonat ku krijohen ndërmarrjet apo qendrat e reja me qëllim që të monitorohen transferimet e pronësisë dhe të kontrollohen subjektet e sapo regjistruar, por edhe për të kryer një sërë verifikimesh mbi veprimtari të ndryshme që mund të shënojnë njëfarë dyshimi më të madh pikërisht në përputhje dhe për shkak të nisjes së punimeve. Po për të sjellë një shembull, mjafton të kujtojmë ndërmarrjet lokale që veprojnë në sektorin e betonit apo që menaxhojnë impiante të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit (gurore). Në përgjithësi, bëhet fjalë për një sektor që, sidomos në rajone që janë pre e presionit të mafies, për arsye të ndryshme, është veçanërisht i ekspozuar ndaj rrezikut të depërtimit dhe të kontrollit nga ana e grupeve kriminale.

Një risi tjetër që u përmend më parë, e ndërfutur në sistemin e kontrollit antimafie të Veprave të Mëdha, përfaqësohet nga mundësia për inspektuar kantieret.

Në fakt, bëhet fjalë për një instrument inspektues që përdoret në veçanti në fazën e realizimit të veprës që paraqet rrezikun e depërtimit mafioz, që

qëndron në forma të ndryshme presioni, përgjithësisht me karakter zhvatjeje, pre e të cilave mund të bëhen ndërmarrjet që operojnë në kantier.

Shkohet nga vendosja me detyrim e “gjobës”, pra nga dhënia e shumave të parave apo të dobive të tjera, që fitohen me kërcënime atentatesh ndaj impianteve apo makinerive, “ofertës për mbrojtje”, realizuar përmes formave që përpiqen të shfaqen si interesim, të cilat synojnë të garantojnë që ndërmarrja realizuese të mos shqetësohet as nga veprime të dhunshme, as nga trazira të ndonjë lloji tjetër (protesta të sindikatës, ndërhyrje të ndërmarrjeve konkurruese, etj.,).

Një formë e veçantë zhvatjeje përfaqësohet nga *shtrëngimi për rekrutim të krahut të punës lokale*, që ndodh në bazë të lidhjeve të sakta të degëzimit mafioz. Punësimi i punëtorëve – elementë që ndër të tjera nuk kontrollohen – merr në këtë rast një rëndësi të veçantë pasi priret të tregojë se çdo veprimtari ekonomike e rëndësishme që kryhet në territor nuk mund t’i shpëtojë një forme “bashkëpjesëmarrjeje” të degëve a grupeve kriminale, në mbështetje të kontrollit të gjerë të ushtruar nga këto të fundit. Kuptohet qartë se sa mund të jetë e kënaqshme për grupet kriminale kjo gjë, sidomos në drejtim të rritjes së pushtetit e prestigjit të tyre.

§ 2.3.

Teknikat e depërtimit të përdorura nga krimi i organizuar nuk janë gjithmonë të njëjtat. Është vërejtur sidomos që janë të ndryshme qëndrimet e organizatave kriminale që veprojnë në tre qarqet kryesore të prekura nga ndotja mafioze – Sicilia, Kalabria dhe Kampania – në lidhje me teknikat e pastrimit dhe investimit të të ardhurave të paligjshme që rrjedhin nga kontrolli i prokurimeve publike. Në Kampania, për shembull, është theksuar prirja për të riinvestuar fitimet po në tregun e ndërtimit, në mënyrë që të mbahen nën kontroll strukturat ekonomiko-financiare të sektorit dhe **të rriten mundësitë për shtrirjen e pushtetit të tyre kriminal.**

Ndodh që kjo gjë të sjellë – por sigurisht jo vetëm në Kampania – leverdinë e ndërsjellë mes sipërmarrjes dhe grupeve kriminale për të lidhur forma aleancash dhe marrëveshjesh me të cilat sipërmarrësi siguron përmes kësaj mbrojtjen kriminale për veten dhe mundësinë për të zgjeruar ndjeshëm biznesin e vet, ndërsa organizata kriminale, falë kësaj marrëdhënieje ndërvepruese, ka më shumë mundësi të fitojë, brenda një kohe të shkurtër e në forma pak a shumë të fshehta një imazh të prezantueshëm, duke përshpejtuar kështu një proces *legalizimi dhe ligjërimi shoqëror.*

Në këto rrethana e në të tjera të ngjashme me to bëhet përpjekja, që shpesh ka sukses, nga ana e kriminalitetit të organizuar, jo vetëm për të tërhequr në sferën e vet të ndikimit sipërmarrjen lokale, por edhe për të kushtëzuar rëndë shoqëri e ndërmarrje të rëndësishme në nivel kombëtar, të cilat janë të shtrënguar të bien në ujdi me klane mbizotëruese. Lipset të themi se ky kontakt, ashti siç ka treguar dhe përvoja gjyqësore, ndonjëherë kërkohet edhe nga vetë sipërmarrësit, që mbështeten në ndërmjetësimin e **subjekteve-zinxhir, në përgjithësi sipërmarrës bashkëpunëtorë**, për të bërë marrëveshje për të pasur mbrojtjen e mafies, me përfitime që janë verifikuar (“qetësi në kantier”, eliminim atentatesh, etj.).

Aksesi mund të shfaqet si një instrument mjaft i dobishëm për të parë se cila është gjendja konkrete që shfaqet në “kantier”, sidomos për të krahasuar nëse ajo që ka deklaruar sipërmarrësi lidhur me ndërmarrjet e nënkontraktuara prej tij – të vetmet të autorizuara të jenë të pranishme, sipas planit të prokurimeve, me punëtorët dhe mjetet e tyre të punës në vendin e kryerjes së punimeve – përkon faktikisht me gjendjen reale apo në se vihen re parregullsi që pak a shumë të bëjnë të dyshosh.

Siç rekomandohet në **Protokollin e përgjithshëm të veprimtarisë investiguese** të përgatitur nga Drejtoria Kombëtare Investigative Antimafie, që përmban sugjerime të dobishme operative të cilat duhen ndjekur në marrjen e burimeve të provës, sidomos në lidhje me veprimtarinë e autorizuar që kryhet në kantiere nga organet e policisë gjyqësore, është shumë e rëndësishme të procedohet në fillim me një lloj **fotografimi të gjendjes së punimeve**. Për këtë qëllim mund të jetë e udhës të kontrollojmë nëse ka apo jo në kantier **persona** (pronarë ndërmarrjesh, administratorë apo ortakë apo persona që huazojnë emrin, personel drejtues dhe teknik, punëtorë, etj.) dhe **mjete mekanike** që kanë të bëjnë me ndërmarrje përfaqësuesit të cilave, drejtuesit apo përgjegjësit kanë qenë të dënuar, të pandehur apo objekt hetimesh për vepra të krimit të organizuar dhe/ose korrupsionit.

Kjo gjë mund të bëjnë të mendojmë për një depërtim mafioz dhe mund të na shtyjë të kryejmë kontrole dhe verifikime të tjera që, së bashku, mund të mbështesin hamendjen investiguese fillestare.

Edhe akseset e kryera nga Grupet Interforze në kantieret e Veprave të Mëdha njësohen me kriteret standard, pothuaj të ngjashëm me ata të trajtuar më lart, që janë diktuar nga Drejtoria Investigative Antimafie.

Para së gjithash, edhe këtu rekomandohet që hyrja në kantier bëhet për të fotografuar gjendjen e punimeve në fjalë, në veçanti, në çdo kantier ku

rezulton të jetë e pranishme shoqëria apo ndërmarrje për të cilën janë rritur dyshimet. Pikërisht për këtë arsye rekomandohet **që aksesit të jetë i njëkohshëm**, kush i nevojshëm që rezultatet e arritura mund të konsiderohen të rëndësishme, sidomos kur ndërmarrja në ndjekje është e pranishme në shumë kantiere të ngritur në zona të ndryshme, siç ndodh shpesh për Veprat e Mëdha, realizimi i të cilave shtrihet në zona që ndodhen në qarqe apo provinca të ndryshme.

Një tjetër element i nevojshëm që hyrja në kantier të ketë rezultate pozitive vjen sigurisht nga **“efekti i befasisë”**. Për këtë qëllim, lidhur me faktin që në hyrjen në kantier merr pjesë personel i jashtëm i forcave të policisë (siç u tha, lidhur me strukturën e tyre, G.I. përbëhen edhe nga drejtues të Inspektoratit të punës dhe të punëve publike), jepet udhëzimi për të treguar çdo kujdes të mundshëm dhe për të ruajtur sekretin mbi informacionet lidhur me kohën e hyrjes në kantier për të shmangur kështu zbulimin, gjë që do të vinte në rrezik rezultatin.

Gjatë hyrjes në kantier mund të jetë e nevojshme të konsultohet banka e të dhënave të OCAP, edhe për të kryer krahasimet që do të plotësonin tërësinë e elementëve dyshues. Mund të jenë të nevojshme edhe thellimet e njëkohshme mbi (nëse ka): a) shkelje të normave të vendosura në mbrojtje të **sigurisë së punimeve** dhe të zhvillimit të rregullt të marrëdhënies së punës; b) **shkelje tatimore dhe mashtrime tatimore**; c) **falsifikim dokumentash publike dhe private**, që kanë të bëjnë për shembull, me njoftime antimafie dhe vërtetime të parashikuar për cilësimin nga ana e SOA¹⁶¹, fatura, fletë-dorëzimi, libra kantieri dhe shkrime të tjera kontabël.

§ 2.4.

Pra hyrja në kantier mund të sjellë shumë rezultate, në kuptimin që mund të sjellë pasoja të ndryshme, duke mos përjashtuar nxjerrjen e akteve të autoritetit gjyqësor, vendime dënimi apo masa sigurie.

Ajo që do doja theksoja lidhur me një rezultat më të mirë që arrihet kur përfshihet drejtpërsëdrejti prefekti, është se nga hyrja në kantier mund të na japë të dhëna që sugjerojnë të ndërhyhet për ndryshimin e dokumentacionit antimafie. Kjo mund të përkojë me një vendim të mëvonshëm të prefektit që, në bazë të rezultateve të marra, **tërheq masën çliruese**, duke vërtetuar se

¹⁶¹ Akronim i Shoqëri Organizëm Vërtetues; bëhet fjalë për shoqëri të të drejtës private, të autorizuara nga Autoriteti për mbikëqyrjen mbi kontratat publike për të vërtetuar ekzistencën e kriterëve të përzgjedhjes që u nevojiten shoqërive për zbatimin e punëve publike.

ekzistojnë arsye që të vendoset nga administrata prokuruese largimi nga kantieri i personi mbi të cilin janë kryer hetime a kërkime.

Pra nis në këtë mënyrë një procedurë që synon të arrijë dëbimin e ndërmarrjes ku ndihet të jetë mafia, me një efekt spastrimi në një fazë të dytë.

Nga ana tjetër, sistemi ligjor antimafie parashikon që në rastin e verifikimeve të bëra *pas* lidhjes së kontratës apo *pas* miratimit të nënkontratës bën të dalin në dritë elementë mafioziteti në lidhje me shoqërinë apo ndërmarrjet e interesuara (edhe pjesërisht) në kryerjen e punimeve, ato mund të ***përrjashtohen nga vazhdimi i punimeve***. Në fakt, parashikohet që enti prokurues mund të përdorë në këto raste ***të drejtën për të revokuar detyrimin kontraktual***, duke i likuiduar palës tjetër të drejtat që i takojnë në bazë të asaj që ndërmarrja ka realizuar dhe brenda limiteve në të cilat i ka shfrytëzuar konkretisht administrata prokuruese (parimi i *utilitier coeptum*).

Në direktivën mbi monitorimin antimafie të Veprave të Mëdha, është dhënë orientimi për të ndërfutur në protokollet e sigurisë parashikimin sipas të cilit enti prokurues angazhohet në çdo rast të ushtrijë të drejtën për të ndërprerë zbatimin e kontratës. Për të arritur këtë objektiv, i cili synon ta bëjë efektiv mekanizmin e përjashtimit të ndërmarrjes që sapo përshkruam më lart, të gjitha kontratat e nënkontratat pajisen me një ***klauzolë pëlqimi***. Në të vërtetë, vendoset që, pas informacioneve të reja e negative të prefektit, enti prokurues ka sidoqoftë të drejtë të ushtrijë aftësinë e vet për të t'u çliruar në mënyrë të njëanshme nga detyrimi kontraktual, duke pasur parasysh se nuk ekziston më ***marrëdhënia e besimit*** me shoqërinë apo ndërmarrjen që pëson tërheqjen nga kontrata.

Në këtë mënyrë forcohet më tej në sistemin e Veprave të Mëdha një instrument mbrojtjeje dhe vetëmbrojtjeje për administratat që rrisin ndjeshëm mundësitë për një ndërhyrje të mëtejshme. Në prokurimet e zakonshme, kjo mundësi kaq e madhe zakonisht nuk parashikohet. Në këto raste, ndërhyrja e prefektit ndaj entit prokurues duket më pak vendimtare dhe më të shumtën e herëve shfaqet si një ushtrim i një forme të ***moral suasion***.

Veprimtaria e prefektit, në kuadrin e kontrolleve antimafie të infrastrukturave dhe vendeve strategjike, i gjegjet më së fundi një nevojë për ***shërbim informativ ekonomik***, në mbrojtje të ligjshmërisë dhe sigurisë së investimeve publike.

Kjo gjë sjell një fazë delikate tranzicioni, ende aktuale, që qëndron në kalimin nga një konceptim pothuaj statik të “veprimtarisë antimafie” në

kontratat publike, pra që lidhet me verifikimin rast pa rasti, që në përgjithësi nis me kërkesë të administratës prokuruese, në një konceptim më të zhvilluar e më vendimtar.

Bëhet fjalë për një perspektivë të ndryshme që ndonëse vepron (pjesërisht) me instrumente ekzistues, implikon qartë *politika*. Në fakt në këtë perspektivë zyra antimafie e prefekturës i nënshtrohet një ndryshimi të importimit të punës, pasi kërkohet një metodë pune e mirëmenduar jo vetëm mbi nevojën për të ruajtur ta pacenuara administratat prokuruese nga “mafia” dhe për të mos lejuar që krimi i organizuar të prekë fondet publike, por edhe për të kuptuar dinamikat e fenomenit të infiltrimit mafioz, sipas një kategorie konceptuale efektivisht më afër metodës së monitorimit që është, pikërisht, një formë kontrolli dinamik.

§ 2.5.

Kjo metodë pune që sapo u përshkrua në fund të paragrafit të mësipërm, e shpie pashmangshmërisht vëmendjen mbi aktorët e krimit ekonomik dhe shtrihet në marrëdhëniet e biznesit që mund të kenë, sado mund të fshihen pas një tisi ligjshmërie, lidhje të qarta me botën e krimit, si kur ato kryhen apo jo nga njerëzit e financës.

Natyrisht sa më shumë futemi në fushën e *korporate crimes* aq më shumë zbehet roli qendror i prefektit, pasi bëhet fjalë për një veprimtari në të cilën kryesojnë mënyra të ndryshme ndërhyrjeje, të cilat orientohen kryesisht drejt hetimit financiar me lidhje të mundshme indo-investiguese me “grupe” të ndryshme hetimore kundër pastrimit të parave të pista në vendet që bëjnë pjesë në GAFI.

E përmendim këtë vetëm për të theksuar se sistemi i kontrollit antimafie mbi Veprat e Mëdha shfaqet shumë më kompleks edhe sepse ushqehet nga nisma që kërkojnë të hedhin dritë mbi mekanizmat e financimit të veprës.

I konceptuar në krye në varësi të realizimit të Urës së Ngushticës – infrastrukturë lidhjeje, edhe hekurudhore, mes pikës së fundit të vendit (Reggio Calabria) dhe Sicilisë (Messina) – monitorimi financiar ngrihet si objektivi i luftës kundër përpjekjes së krimit të organizuar për *t’u infiltruar në kanalet e gjetjes së financimeve të veprës*.

Skema kriminale e ndjekur nga Prokuroria distrektuale Antimafie e Romës, gjatë një hetimi që ka shpënë në arrestimin e personave me origjinë italo-amerikane që janë marrë me pastrimin e parave të pista, na bën të mbajmë parasysh mundësinë se krimi i organizuar, për të arritur kontrollin

mbi veprën që po realizohet, mund të jetë i interesuar të **kapë kërkesën për kapital**, edhe përpara se të ndodhë përcaktimi i fituesit të të prokuruarit.

Në të vërtetë lipset të mbajmë parasysh se për realizimin e një ndërhyrjeje që bën pjesë në programin e Veprave të Mëdha, përveç rasteve të *project financing*, i kërkohet gjithmonë *gjeneral contractor* të parapaguajë një pjesë të mirë të fondeve. Nevoja për të gjetur pjesën e parafinancimit, që më pas rikuperohet në përfundim të ciklit të punimeve, bën që edhe subjektet me asete të mira e me portofole të qëndrueshme, të gjenden në kushtin e varësisë, në masë edhe të konsiderueshme, nga burime financimi të jashtëm.

Rreziku i infiltrimit mafioz nuk qëndron vetëm në mundësinë e përdorimit të qëllimshëm të fazës së gjetjes së financimeve, me qëllim që ta përdorë atë si një kanal për pastrimin e kapitaleve të paligjshme. Ajo çka është më shumë alarmuese është skenari i një **kriminaliteti që bëhet bashkëpjesëmarrës** i një fete të mirë të biznesit të ekonomisë, duke fituar një pozicion **kontrolli parazit** kundrejt shoqërive që bëjnë pjesë në konsorciumin e realizimit të veprës.

Në bashkëpunim me Zyrën Italiane të Këmbimeve – që përfaqëson në fushën financiare *unit* apo zyrën kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave – është përgatitur nga Komiteti i koordinimit për mbikëqyrjen e lartë të Veprave të Mëdha një sistem monitorimi i operacioneve financuese të veprës.

Ky sistem mbështetet në parashikimin që koncesionari i veprës, kontraktori i përgjithshëm dhe të gjithë subjektet e tjera të zinxhirit duhet të çelin **llogari të posaçme**, në të cilat duhet të derdhen *vetëm* fondet financiare të destinuara me ekzekutimin e punimeve, ndërkohë që s'është e mundur të derdhen në këto llogari fonde të tjera. Gjithashtu, është edhe parashikimi tjetër lidhur me detyrimin e lëvizjes së parave vetëm përmes **urdhërpagesave on-line**, duke përjashtuar pothuaj plotësisht (pranohen vetëm transaksionet me shuma të ulëta) përdorimi i parave (cash) si mjet pagese.

Përmes këtyre masave të rëndësishme lehtësohen mundësitë për “të gjetur” transferimet dhe për të identifikuar tregjet e prejardhjes dhe të destinacionit të kapitaleve, në avantazh të plotë të nevojave për **transparencë të flukseve financiare**.

Komiteti i koordinimit është pyetur edhe në lidhje me avantazhin e përdorimit të formave të kontrollit të besueshmërisë financiare të subjekteve realizues të veprave, që bazohen në përdorimin e modeleve të tjera të kontrollit. Për shembull, duke pasur parasysh se ndërmarrjet konkurruese

vlerësohen paraprakisht nga agjenci vlerësimi (*rating*), që më pas japin një gjykim të shkallëzuar të cilësisë që duhet pasur parasysh në një prokurim.

Ndërsa, edhe për sa i takon monitorimit të çdo operacioni që, në hyrje e në dalje, kryhet mbi një *llogari të posaçme*, nuk ka asnjë dyshim që ky lloj kontrolli do të ndihmojë jo vetëm në parandalimin e formave të përdorimit të qëllimshëm të tregjeve financiare, por edhe për të ndalur përpjekjen që paratë që hyjnë në qarkun e Veprave të Mëdha të përfundojë me “territorin ku mblidhet” që është nën kontrollin e organizatave kriminale.

§ 3. *Cases History.*

§ 3.1.

Paraqitja e rasteve praktike kërkon të nxjerrë në pah se si monitorimi i Veprave të Mëdha synon të marrë formën e një punë në rrjet (network) të aktorëve kryesorë të aktorëve antimafie, me qëllim që të sistemi i kontrollit të jetë sa më i gjerë e përfshirës, duke krijuar kështu bashkëpunimin e nevojshëm, dhe të nxisë mekanizmat e shumëfishimit të efekteve.

Le të nisim me rastin e parë të zgjedhur prej nesh.

§. Në këtë rast elementi kryesor përfaqësohet nga disa kontrole të kryera nga *Qendra Operative D.I.A. e Milanos* në lidhje me disa shoqëri që kanë qenë objekt i vëmendjes nga ana e Grupit Interforze të kryeqendrës lombarde. Bëhej fjalë për shoqëri që veprojnë në punimet e realizimit të linjës hekurudhore TAV Bolonjë-Veronë.

C.O. e Milanos vëren praninë e një elementi që tregon infiltrim mafioz, i cili përfaqësohet nga fakti që kuota e mazhorancës së një shoqërie me kapital, një ndërmarrje ndërtimi me seli ligjore në provincën e Astit, doli se ish blerë së fundi nga një person që dyshohej se kush lidhje me një “familje” mafioze nga Agrixhento (Agrigento). Për pasojë, duke iu përmbajtur një skeme pune të koordinuar, C.O. e Milanos i kërkoi zyrës qendore të D.I.A.-s të kryente disa verifikime dhe kontrole të tjera, duke qenë së kjo e fundit përbëhet edhe nga një Obeservatori Qendror i lartpërmendur (OCAP), si dhe *C.O. të Agrigento-s* dhe, përmes kësaj, Grupit Interforze të qytetit sicilian.

Kërkimet e kryera konfirmuan dyshimin e parë. Kuadri i informacioneve, i plotësuar me rezultatet e reja në dispozicion të

Observatorit Qendror, u përcoll: a) tek *C.O. i Torinos*, sepse ish kompetent për territorin e Astit, ku kush selinë ligjore ndërmarrja; *tek Grupi Interforze në Mantova*, sepse rezultoi se ndërmarrja po kryente disa *punime me nën-prokurim* (për rreth një milion e gjysmë euro) për realizimin e një kabine elektrike në territorin e provincës së Mantova-s; *tek Grupi Interforze në Torino*, duke pasur parasysh se edhe në këtë territor rezultoi se ndërmarrja kish marrë disa nën-prokurime të tjera, në kuadrin e punimeve që sidoqoftë nuk bënë pjesë në programin e Veprave të Mëdha.

Grupi Interfoze i Mantovës, veçanërisht i interesuar për pasojat e menjëhershme operative, u udhëzuar të procedonte me urgjencë inspektive në kantieret ku është e pranishme ndërmarrja objekt i verifikimeve.

Me dekret të Prefektit të Mantovës që e pranoi menjëherë këtë propozim, u procedua me hyrjen në kantier që shpuri në konfirmimin e dyshimeve të rënda. U vërejt kështu prania në vendet e punës të personave të dënuar më parë dhe e administratorit të vetëm të vjetër të shoqërisë, i cili ish zëvendësuar nga dikush që kish huazuar emrin pasi ish larguar për “precedentë” mafiozë. Rrethana vërtetoi kështu mundësinë e rotacionit të drejtimit të shoqërisë ish në vetvete një mjet dhe se kontrolli efektiv rezultoi se vazhdonte të ishte i përqendruar në duart e subjektit që vetëm formalisht e zëvendësua, dhe që duhej konsideruar si përfaqësues i një grupi të njohur mafioz të Agrigento-s.

Në këtë pikë, rezultatet e kësaj hyrjeje në kantier iu bënë me dije prefektit të Astit që, edhe pas verifikimeve të kryera nga reparte të specializuara të Rojës së Financës, që konfirmuan përdorimin e emrit të një personi tjetër, dhe varësinë substanciale të shoqërisë nga një qendër interesash mafiozë, procedoi: me revokimin e “vërtetimit antimafie” dhe duke deklaruar se në ndërmarrje ekzistonte një situatë infiltrimi mafioz; më pas, iu kërkua entit prokurues të punimeve për Veprën e Madhe *ta përjashtonte ndërmarrjen* duke revokuar autorizimin për nën-prokurim. Kërkesë kjo e cila u zbatua menjëherë.

Siç u tha, verifikimet kishin nxjerrë në dukje faktin se shoqëria kish fituar disa prokurime edhe jashtë programit të Veprave të Mëdha. Megjithatë, mundësia ekspansive e sistemit bëri që edhe këto situata të kishin të njëjtin rezultat. Në fakt, Komuna e Astit vendosi të anulonte kontratën e prokurimit që kish caktuar ndërmarrjen për realizimin e një strukture rrugore lidhëse, duke e përjashtuar atë nga punimet, dhe po kështu u sollën entet e tjera prokuruese.

Duhet sqaruar se ky bashkëpunim, i mundësuar përmes vënies në rrjet të Grupeve Interforze dhe falë lidhjes së tyre me D.I.A., i jep zgjidhje një mungese jo të pakët të regjimit të informacioneve antimafie. Duke përfituar nga fakti se informacionet në përgjithësi nuk evidentojnë se në kohën kur administratat prokuruese bëjnë kërkesë, ndodh shpesh që ndërmarrja të vazhdojë pa kurrfarë shqetësimi punimet, edhe kur janë vërtetuar elemente që flasin për një situatë varësie nga krimi. Nga ana tjetër, prefekti nuk është i detyruar të marrë, e as nuk i ka mjetet e nevojshme për ta bërë këtë, një kuadër të plotë informacionesh lidhur me të gjitha situatat ndaj të cilave është (apo mund të jetë) e interesuar një shoqëri në ngarkim të të cilës vërtetohen elementë negativë.

Ky boshllëk, që padashur mbështetet nga sistemi i pragut të shumës (le të shihet lidhur me këtë aspekt sa shpjeguar në paragrafin § 1.4), bëri që Komiteti i Koordinimit për Mbikëqyrjen e Lartë të Veprave të Mëdha të kujdesej për një nismë të kohëve të fundit të ndërmarrë nga D.I.A., me të cilën realizohet lidhja telepatike mes prefekturave për qarkullimin e informacioneve antimafie. Ky sistem i ri – i quajtur S.I.D.I.N. (akronim i sistemit të mosmiratimeve) do të krijojë mundësinë që, edhe për prokurime të zakonshme që nuk bëjnë pjesë në ndërhyrjet strategjike, të kemi *një bashkëndarje të mosmiratimeve*, apo masave o akteve që refuzojnë dhënien e vërtetimit antimafie apo që revokojnë një akt të parë të favorshëm, duke bërë të mundur goditjen e rasteve të shmangies dhe të shkeljes së normativës mbi kontrollin.

§. *Rasti i dytë.*

§ 3.2.

Në një tjetër rast që vë në dukje aftësinë e sistemit të monitorimit për të shkaktuar efekte domino, verifikimet nisin nga një rikonjicion i kryer nga **Grupi Interforze i Romës** që po interesohej për një grup shoqërisht me seli në kryeqytet.

Në këto rrethana interesi ish përqendruar në një shoqëri që dyshohej se kish marrëdhënie me një grup kriminal që ish lokalizuar në Catania (Catania).

Observatori qendror i D.I.A. dha tre *impute* të ndryshme: **C.O. i Romës**, q ëu mor me aspektet formale që lidhen me selinë e ndërmarrjes së shoqërisë; **C.O. në Catania**, për zhvillimin e elementëve të dyshimit dhe

përputhjes për sa i takon lidhjes së dyshuar me realitetin mafioz lokal; **C.O. dhe Grupi Interforze në Napoli**, në bazë të rrethanës që u raportua një veprimtari e caktuar ekspansive në drejtim të Napolit, edhe pse në sektorë që s'kanë të bëjnë me Vepra të Mëdha.

Me fjalë të tjera OCAP ka luajtur rolin e drejtuesit kryesor, duke vënë në lëvizje organizmat territorialë me qëllim që të përpunonte më pas një *feedback* informacionesh dhe për t'u dhënë atyre shtysë, udhëzime dhe orientime për veprimet e mëtejshme konkrete (apo ndaj partnerëve të tjerë që i përkasin po këtij rrjeti koordinimi).

Njëkohësisht Observatori, në bazë të përpunimit të të dhënave me bankat e tjera të të dhënave në nivel kombëtar, identifikoi subjektin kryesor, një sipërmarrës i arrestuar më parë për krime të mafies, me të cilin lidheshin shumë interesa të sipërmarrjes.

Në të vërtetë, ashtu siç konfirmuan më tej verifikimet e kryera nga C.O. Catania, shoqëria, në aspektin e kontrollit të subjektit të dyshuar se ka lidhje me mafien, rezultoi se kish aksione mazhorance në shoqëri të tjera ndërtimit dhe në degë të shtrira edhe në sektorin e shpërndarjes së madhe. Në fakt, ndonëse selia ligjore e shoqërisë ishte në Romë, lidhjet e shumta të vërtetuar nga D.I.A. mbështetën tezën që **qendra e interesave** të shoqërisë i kish rrënjët në kryeqendrën e Sicilisë, aty ku kjo shoqëri, duke shfrytëzuar afërsinë dhe mbështetjen ndikuese të personave të lidhur me grupet mafioze lokale, kish marrë prokurime për shuma prej disa miliona euro.

Veprimtaria e C.O. dhe e Grupit Interforze në Napoli shpuri më tej në procedimin me hyrjen inspektuese në kantier, që dha rezultate të tilla që u konsideruan të rëndësishme dhe më zhvillime interesante.

Në veçanti, iu kërkua kuestorit të ndërmerre masa sigurie, edhe me karakter pasuror, prefektit lidhur me dokumentacionin antimafie, dhe autoritetit gjyqësor të ndërmerre hetime të fshehta penale që ende vazhdojnë.

Sistemi i kontrolli tregoi plotësisht aftësinë e vet për të ndërmarrë disa ndërhyrje që, ndonëse të orientuara drejt masave krejt autonome dhe më vete, ravijëzojnë rreth subjektit të hetuar një **rrjet bllokues** që priret ta neutralizojë me masa të ndryshme e të mundshme, por që, në një kohë të parë, ka për qëllim edhe të mbajë nën kontroll veprimtarinë dhe të thellojë profilin kriminal të tij.

§. Rasti i tretë.

§ 3.3.

Rasti i tretë është i veçantë pasi rrjedh nga një hetim penal i kryer nga D.I.A. mbi disa shoqëri të përfshira në realizimin e Autostradës Salerno-Reggio Calabria, infrastrukturë që bën pjesë në programin e Veprave të Mëdha.

Veprimtaria hetimore e autorizuar shpuri në nxjerrjen dhe zbatimin e shumë masave të arrestit dhe, njëkohësisht, i dha udhë një sërë verifikimeve mbi këto shoqëri me qëllim që të përcaktoheshin qartë marrëdhëniet dhe skenarët ku rezultonin të përfshira këto shoqëri.

Për këtë arsye, iu kërkua të vepronin disa Forcave speciale të Policisë – çdo forcë policie është e pajisur me struktura investiguese qendrore të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar të llojit mafioz – për të kryer verifikimet e nevojshme. Kjo gjë mundësoi evidentimin se disa subjekte të përfshirë, drejtpërsëdrejti ose jo, në realizimin e punimeve në autostradë, ishin pjesë e qarkut të krimit të organizuar kalabrez

Vëmendja e investiguesve u ndal veçanërisht në një *grup shoqërisht* në gjendje të kontrollonte, përmes pjesëmarrjes në shoqëri të tjera të vogla e të mesme, një pjesë të mirë të sektorit të ndërtimit. Shoqëria që qëndronte në krye të këtij grupi, rezultoi ndër të tjera se ish edhe titullare e një impianti nxjerrës (një gurorë) dhe, në këtë rrethanë, përfaqësonte furnizuesit e përhershëm dhe ekskluziv të inerteve (beton, konglomeratë bituminozë, etj..) të shoqërive lokale – të prokuruar dhe të nën-prokuruar – që, në lidhje cilësinë kryesore të tyre, përdorin këto materiale.

Strategjia investiguese kërkonte për këtë arsye të ndërhyhej ndryshe në këtë rrethanë, nga njëra anë duke ndërmarrë hetime komplekse, edhe me natyrë pasurore, për të kuptuar gjithë tërësinë e marrëdhënieve mes shoqërive të ndryshme të lidhura mes tyre, e nga ana tjetër, duke ndërhyrë për të spastruar mundësisht efektet negative mbi blerjen e furnizimeve të inerteve që, siç thamë, i nënshtroheshin një lloj *varësie nga grupi*.

Lidhur me planin e parë të ndërhyrjes, D.I.A. u kërkoi degëve të veta kalabreze t'u jepnin shtysë hetimeve mbi strukturat e shoqërisë, sidomos për të hedhur dritë mbi truket juridike që kërkonin të fshihnin përqendrimin e interesave në një qendër të vetme mafioze. Për sa i takon nivelin e dytë të ndërhyrjes, u vu në lëvizje *Grupi Interforze Reggio Calabria* për të proceduar, në bazë të informacioneve të mbledhura, me një rishikim të

përgjithshëm të dokumentacionit antimafie në lidhje me shoqëritë objekt verifikimi.

Ky drejtim i dytë shpuri shumë shpejt në rishikimin e vërtetimeve antimafie ndaj shoqërive që i përkasin një grupi, me nxjerrjen e mëvonshme të masave ndaluese dhe me **revokimin e autorizimit të prokurimeve të dhëna**. Kjo formë ndërhyrjeje u shoqërua edhe kërkesa që iu bë kuestorit për të ndërmarrë procedimin e masës së sigurisë pasurore.

Rasti që u soll më lart është emblematic pasi tregon se si në disa rrethana kontrolli i mafies mund të prekë në mënyrë **sistematike** një sektor të veprimtarisë dhe si i tillë arrihet përmes blerjes, të drejtpërdrejtë ose jo, të shoqërive që veprojnë në këtë sektor, si përmes shtrëngimit konkret të pjesës tjetër të subjekteve sipërmarrës për t'iu drejtuar një mbledhësi të vetëm të ofertës, i cili është në gjendje të gëzojë një rentë parazitare dhe, për këtë arsye, është në gjendje të imponojë rritjen e rremë të çmimeve të furnizimit, që në përgjithësi rriten me 2/3%.

Përvoja hetimore investiguese ka dëshmuar se, sidomos në qarkun e Campania-s, në fund të viteve '80, disa shoqëri, nën presionin e zhvatjes nga ana e *camorra-s*, kanë përdorur disa forma bashkimi për të zbutur kështu efektet e kostos më të lartë të materialeve (që përfaqësonte shumën e një gjobe), *duke shpërndarë në shoqëri*, si të thuash, dëmin ekonomik që rrjedh nga kjo tipologji specifike e zhvatjes

Duhet shtuar edhe se nën kujdesin e Komitetit të koordinimit për Mbikëqyrjen e Lartë të Veprave të Mëdha, në partneritet me Drejtorinë Kombëtare Antimafie, është duke u realizuar një nismë për monitorimin e guroreve në provincën Reggio Calabria dhe në disa provinca të Sicilisë.

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të depërtimit mafioz në këtë sektor, hetimi synon të hedhë dritë mbi titullsinë reale të aktiviteteve të nxjerrjes (gurore), përmes analizës dhe përpunimit të informacioneve të përftuara gjatë hyrjes në kantier nga ana e forcave të policisë.

PREFEKT BRUNO FRATTASI
*Kryetar i Komitetit Koordinues
për Mbikëqyrjen e Lartë të Veprave të Mëdha*

Romë, Tetor 2007

2.8. Sekuestrimi dhe konfiskimi në legjislacionin e luftës kundër pastrimit të parave.

§ 1. Ndëshkimi penal i pastrimit të parave.

Ky nocion, i përfutur në sistemin ligjor italian me ligjin nr. 328/93 (ratifikim dhe zbatim i Konventës së Strasburgut dt. 8.1.1990), përbën bazën e nenit 648 bis K.P. (pastrimi i parave të pista) si dhe të nenit 648 ter K.P. (përdorimi i të hollave, pasurive apo përfitimeve me prejardhje të jashtëligjshme).

Në veçanti:

- me nenin 648 bis K.P. dënohet me “burgim nga 4 deri në 12 vjet dhe me një gjobë prej 2 deri në 30 milionë lireta, kushdo që zëvendëson apo transferon të holla, pasuri apo përfitime të tjera me prejardhje nga krimi jo nga pakujdesia, pra që pengon, me veprime të tjera, identifikimin e prejardhjes së tyre kriminale”;

- me nenin 648 ter K.P., që integron dhe plotëson sjelljet kriminale të parashikuara nga neni 648 bis, sanksionohet me të njëjtat dënime “kushdo që përdor në veprimtari ekonomike apo financiare të holla, pasuri apo përfitime të tjera me prejardhje nga krimi”.

Subjekt aktiv i krimit të pastrimit të parave mund të jetë kushdo që nuk ka bashkëpunuar në realizimin e krimit të hamendësuar; kjo përbën aspektin që e shton vështirësinë në përcaktimin e përgjegjësisë për pastrimin e parave, pasi, duke lëvizur shpesh në lëmi të krimit të organizuar, pra me bashkëpunim, nuk është e lehtë të merret me mend një larës parash jashtë organizatës kriminale. Me fjalë të tjera, një anëtar i organizatës kriminale që ka detyrën e “mbarështimit” të kapitaleve të jashtëligjshme të fituara nga bashkëpunimi (i ashtuquajtur i larës i brendshëm) nuk do jetë përgjegjës për pastrim parash por për bashkëpunim në krim me qëllim, për shembull, trafikimin e lëndëve narkotike, sekuestrimin e personave, fajden, rrëmbimin, shfrytëzimin e prostitucionit, etj., ose më mirë bashkëpunim mafioz, duke përmbushur kushtet paraprake sipas nenit 416 bis K.P..

Pra autori tipik i krimit në fjalë është një subjekt, i cili edhe pse nuk është pjesë organike e shoqatës kriminale, e vë veprën e tij në dispozicion për të mbarështuar më së miri të ardhurat e jashtëligjshme të organizatës (i ashtuquajtur i larës i jashtëm). Shpesh bëhet fjalë për specialistë të vërtetë të sektorit financiar dhe/ose bankar (profesionistë ose shoqëri financiare) në

gjendje për t'i përdorur të gjitha mjetet më moderne dhe të sofistikuara për të zhvendosur paratë “e pista” drejt Vendeve që karakterizohen nga një shkallë e ulët e ligjshmërisë, nga frytshmëria e ulët e kontrolleve dhe mbrojtja e sferës së rezervuar të personave e shoqëruar me një detyrim fiskal të përmbajtur. Vende ku, përfundimisht, është e mundur të sigurohet mbrojtja maksimale për kapitalet e jashtëligjshme.

(Këndeji lind nevoja për një “rregullore bazë të përbashkët” nga ana e të gjitha Vendeve, siç është nuhatur prej kohësh nga bashkësia ndërkombëtare që për argumentin e posaçëm po punon në mënyrë aktive duke u nisur nga tashmë e njohura Konventë e Vjenës deri në propozimin francez, suedez dhe belg për të miratuar parimin e “njohjes së ndërsjellë” që duhet zbatuar edhe për urdhrat paraprakë, në mënyrë që të procedohet me shpejtësi për sekuestrimin sigurues dhe konfiskimin e pasurive në të gjitha Vendet pjesëmarrëse).

Për krimet e këtij lloji, është i nevojshëm vullneti për të zëvendësuar ose ripërdorur të hollat dhe përfitimet e tjera me vetëdijen e prejardhjes së tyre nga një krim, cilado qoftë kjo.

Objekti material i krimit praktikisht ka një shtrirje të pakufi, veprimi i dhënë kriminal mund të ketë të bëjë përveç se me paratë me çdo lloj pasurie apo përfitimi. I vetmi kufizim duket të jetë objektiv në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Si plotësim, neni 648 ter thjesht ka si qëllim sanksionimin e ripërdorimit të parave të pista në veprimtari ekonomike dhe financiare (blerje shoqërishe, blerje titujsh të aksioneve ose obligacioneve, etj.) jashtë rasteve të rregulluara me nenet 648 (strehim parash ose sendesh me prejardhje nga krimi) dhe 648 bis.

Tabloja normative italiane me qëllim kundërshtimin e fenomeneve të grumbullimit dhe përforcimit të përfitimeve të paligjshme paraqet edhe mjete të tjera që na duket me vend t'i cekim shkurtimisht.

Në veçanti i referohemi:

- krimi i strehimit (neni 648 K.P.) që sanksionon me heqje lirie nga 2 deri në 8 vjet dhe me gjobë prej nga 1 deri në 20 milionë lireta këdo që, me qëllim përfitimin për veten ose për të tjerët të një përfitimi të paligjshëm (mashtrim specifik), blen, merr dhe fsheh para ose sende të prejardhura nga çdo lloj krimi. Një normë e tillë ka si qëllim ndalimin e qarkullimit të lirë të sendeve objekt të krimeve kundër pasurisë për të bërë të mundur rikuperimin në favor të personit të lënduar, si dhe të parandalohet vetë porositja e krimeve të tilla duke e bërë të vështirë vendimin në treg të

sendeve që përbëjnë përfitimin. Kjo normë, në nder të parimit të veçantisë, nuk zbatohet në rastet kur ekzistojnë të dhënat përbërëse të krimit specifik sipas nenit 648 bis (pastrimi i parave), ndërsa mbizotëron në lidhje me nenin 648 ter (ripërdorimi i kapitaleve të jashtëligjshme) që vjen si normë përmbyllëse dhe, pra, me karakter dytësor në krahasim me të tjerat;

- nenit 12 të ligjit nr. 197/91 që ka sjellë rishtazi një figurë specifike kriminale që përfaqësohet nga përdorimi i paligjshëm i kartave të kreditit dhe të pagesave të mirëfillta të falsifikuara (burgim deri në 5 vjet dhe gjobë deri në 3 milionë);

- nenit 12 – *quinquies* të ligjit nr. 356/92 (zhvendosje me mashtrim e vlerave) që sanksionon me burgim nga dy deri në gjashtë vjet këdo që u mvesh të tjerëve në mënyrë të rremë titullin apo disponibilitetin e parave, pasurive apo përfitimeve të tjera me qëllim që t’u shpëtojë dispozitave të ligjit për sa i përket ruajtjes së pasurisë apo kontrabandës, apo lehtësimit të porositjes së krimeve sipas neneve 648, 648-bis dhe 648 ter. Kjo normë ka si synim të godasë përdorimin e “dordolecëve”, për këtë arsye thjesht vënia e pasurive dhe përfitimeve në një emër tjetër përbën një krim;

- nenit 379 K.P. (ndihmë reale), normë që, edhe pse dytësore dhe eventuale me qëllim ndëshkimin e qarkullimit të përfitimeve të jashtëligjshme, sanksionon këdo, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nenet 648, 648 bis dhe 648 ter, që ndihmon dikë tjetër për të siguruar të ardhura nga një krim.

§ 2. *Konfiskimi dhe sekuestrimi i pasurive dhe i sendeve që kanë të bëjnë me krimin.*

Procesi penal italian parashikon në kuptim të përgjithshëm Institucionin e sekuestrimit dhe të konfiskimit, të dy me prirjen e “shpronësimit” të sendeve dhe pasurive të lidhura me krimin.

Konfiskimi, përgjithësisht, konsiston në shpronësimin përfundimtar, nga ana e shtetit, të sendeve që kanë të bëjnë me krimin ose që në vetvete janë kriminale; mund të jetë, varet nga sa i rëndë është rasti, i detyrueshëm ose jo (neni 240 K.P.).

Sekuestrimi (neni 321, paragrafi 1 dhe 2 K.P.P. – sekuestrimi parandalues), i jep gjykatësit të drejtën që të vendosë, me një dekret që shpjegon arsyet dhe me kërkesë të prokurorit të çështjes, shpronësimin e sendeve që kanë të bëjnë me krimin, kur ka rrezik që këto të humbasin dhe gjithashtu kur parashikohet konfiskimi.

Një nga normat gjyqësore me rëndësi të madhe me qëllim ndëshkimin e riciklimit është neni 12-*sexies* ligji nr. 356/92 (konfiskimi i pasurive dhe vlerave të pajustificuara), që zbatohet në rast dënimi për një krim të tillë si dhe për krime të tjera të rënda të ngjashme të gjitha të përmendura në të njëjtën normë ligjore si bashkëpunimi mafioz, rrëmbimi, mbajtja peng e personit, fajdja dhe trafiku i narkotikëve. Në fakt me këtë normë vendoset konfiskimi i detyrueshëm i të hollave, pasurive apo të përfitimeve të tjera për të cilat i dënuari nuk mund të justifikojë prejardhjen dhe për të cilat, edhe nëpërmjet një personi të tretë, rezulton se është titullari apo i disponon në përpjesëtim të zhdrejtë në lidhje me të ardhurat e deklaruara për tatimet në burim apo me veprimtarinë ekonomike të zhvilluar.

Efikasiteti i veçantë i kësaj norme qëndron në faktin që sekuestrimi parandalues ex neni 321 K.P.P., në sajë të dispozitave të parashikuara në paragrafin e dytë, lidhur me sa parashikon neni i cituar 12-*sexies*, mund të qëllojë drejtpërdrejt të mirat e “pajustificuara” të të akuzuarit ose, si alternativë, në “përpjesëtim të zhdrejtë” në lidhje me të ardhurat e deklaruara apo me veprimtarinë e ushtruar. Përveç kësaj, në rast dënimi, vendoset konfiskimi i të mirave pasurore së të dënuarit, për të cilat do jetë fort e vështirë të tregojë rrjedhjen e drejtpërdrejtë nga veprimtaria e jashtëligjshme. Është pra vetë pasuria “e pajustificuar dhe në përpjesëtim të zhdrejtë” që konsiderohet si e dyshimtë në tërësi dhe pra e jashtëligjshme.

Një tjetër parashikim i rëndësishëm i konfiskimit të detyrueshëm rregullohet me paragrafin 7 të nenit 416 bis K.P. (bashkëpunim mafioz) për subjektet e dënuara për të njëjtin krim. Edhe në këtë rast objekti i konfiskimit, dhe pra edhe i sekuestrimit, është shumë i gjerë, pasi shtrihet jo vetëm tek sendet që shërbyen ose që ishin menduar për kryerjen e krimit dhe tek sendet që përbëjnë çmimin, produktin dhe përfitimin, por edhe tek sendet që përbëjnë përdorimin.

Në fund duhet të konsiderojmë dispozitën e 1.146/06 që ka ratifikuar dhe ka nisur ekzekutimin në Itali të Konventës së Palermos për krimin transkombëtar. Sipas këtij ligji – si shtojcë e mjeteve të zakonshme të sekuestrimit dhe konfiskimit të parashikuara nga rendi gjyqësor – parashikohet që “Për krimet sipas nenit 3 të këtij ligji, kur konfiskimi i sendeve që përbëjnë produktin, përfitimin ose çmimin e krimit nuk është i mundur, gjykatësi urdhëron konfiskimin e të hollave, pasurive apo sendeve të tjera të disponueshme nga autori i veprës penale, edhe nëpërmjet një personi të tretë fizik a juridik, për një vlerë gjegjëse të produktit, përfitimit a çmimit. Në rastin e fajdeve sidoqoftë urdhërohet konfiskimi i një shume të barabartë me vlerën e interesave apo të avantazheve të tjera a të

shpërblimeve të fajdes. Në raste të tilla, gjykatësi me vendimin e dënimit, përcakton shumat e parave apo cakton pasuritë apo përfitimet e nënshtuara konfiskimit me një vlerë njëjtë me produktin, përfitimin a çmimin e krimit”.

§ 3. *Konfiskimi ndërkombëtar.*

Kjo është tabloja përmbledhëse e normativës italiane në lëmi të konfiskimit penal. Në sistemin tonë juridik është në fuqi edhe institucioni i “konfiskimit ndërkombëtar” rregulluar me ligjin nr. 328 dt. 1993 konform Konventës së Strasburgut të vitit 1990.

Dihet gjerësisht se teknikat e përdorura nga krimi i organizuar për të larë paratë, për të fshehur dhe ripërdorur të ardhurat e jashtëligjshme i kapërcejnë zakonisht kufijtë ndërkombëtarë. Si rrjedhojë, edhe lidhjet në zinxhir të hetimeve duhet të shtrihen në mjedis ndërkombëtar.

Në fakt, në kuadrin e një bashkëpunimi ndërkombëtar të përparuar, kontrollet ekonomike të kryera në vendin ku ka selinë organizata vepruese dhe ku janë vërtetuar krimet prodhuese të pasurisë duhen lidhur ngushtë me një veprimtari përkatëse të hetimit të pasurisë me synim të qartë dhe të kryer në zinxhir nga Autoritetet e Vendit në të cilin të ardhurat janë transferuar dhe ku kanë pësuar shndërrime të mëtejshme.

Parimi që del nga Konventa e Strasburgut është, përmbledhtas, të privilegjuarit, brenda territorit të Shteteve pjesëmarrëse, e hetimeve të pasurive me synim konfiskimin e pasurive të jashtëligjshme në kontekstin e hetimeve penale.

Për këtë qëllim rendi juridik italian me paragrafin 1 bis të nenit 731 K.P.P. (njohja e vendimeve penale të huaja në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare), përfutur me ligjin e cituar nr. 328/93, parashikon që Ministri i Drejtësisë, nëse mendon se sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare duhet të ekzekutohet brenda Shtetit një vendim penal i marrë jashtë shtetit, i kërkon njohjen prokurorit të përgjithshëm pranë gjykatës së apelit që ka kompetencën e duhur, “edhe kur bëhet fjalë për ekzekutimin e një konfiskimi dhe masa përkatëse është marrë nga autoriteti gjyqësor i huaj me një akt të ndryshëm nga vendimi i dënimit”.

Institucioni i konfiskimit ndërkombëtar paraqet një kufizim të vetëm, parashikuar nga paragrafi 1 bis i nenit 733 K.P.P. (kushte paraprake për njohjen) paraqitur nga fakti që “vendimi i huaj nuk mund të njihet për sa i përket ekzekutimit të një konfiskimi nëse ky ka si objekt të mira, konfiskimi

i të cilave nuk do ishte i mundur sipas ligjit italian sikur për të njëjtin fakt të bëhej procedimi brenda Shtetit”.

Orientimi i ligjvënësit italian drejt një raporti të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim sigurimin e pasurive të jashtëligjshme, përftohet edhe nga neni 735 bis (konfiskimi që konsiston në detyrimin e pagesës së një shume të hollash), edhe ky i përftuar me ligjin nr. 328/93, që parashikon zbatimin e dispozitave mbi ekzekutimin e dënimeve në para “në rastin e ekzekutimit të një mase të huaj konfiskimi që konsiston në detyrimin e pagesës së një shume të hollash që i përgjigjet vlerës së çmimit, të produktit apo të përfitimit të një krimi”.

Me rëndësi themelore, gjithnjë në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe duke iu referuar posaçërisht aspektit hetimor, është neni 737-bis K.P.P. (hetime dhe sekuestrim me synim konfiskimin), po i përftuar me ligjin nr. 328/93, që parashikon, në prani të marrëveshjeve ndërkombëtare, që Ministri i Drejtësisë t’i kërkojë një autoriteti të huaj që të procedojë me hetime mbi pasuritë që mund të bëhen objekt i një kërkese të mëvonshme për konfiskim, dhe pra të procedojë me sekuestrimin e tyre.

§ 4. Procedimi administrativ antimafie: sekuestrimi dhe konfiskimi si masa sigurimi të pasurisë.

Përveç normativës penale dhe të procedurës penale, sistemi ynë juridik përmban edhe një mënyrë të të proceduarit, pjesërisht administrative dhe pjesërisht juridiksonale, me qëllim goditjen, përgjithësisht, të subjekteve të konsideruara si të “rrezikshme” për sigurinë publike pasi zakonisht merren me veprimtari kriminale. Mes këtyre natyrisht përfshihen edhe të dyshuarit si pjesëmarrës në organizata mafioze.

Bëhet fjalë për korpusin ligjor që ka të bëjë me të ashtuquajturat masa sigurimi, që mund të jenë personale (ligji n 1423/56) ose të pasurisë.

Masat personale janë:

- lajmërim gojor dhe riatdhesim me fletën e dëbimit në komunën e rezidencës, në kompetencë të Kuestorit;

- mbikëqyrje e posaçme e policisë – e thjeshtë ose me detyrimin dhe ndalimin e qëndrimit në një komunë të dhënë, që zbatohet nga Gjykata me propozim të Kuestorit.

Masat për pasurinë, që zbatohen për subjektet e dyshuara se u përkasin organizatave mafioze (dhe me modifikimet sipas nenit 14 1.55/90 edhe për

të dyshuar për krime në lëmi të narkotizmit dhe ata që mendohet se i nxjerrin mjetet e jetesës nga të ardhura të krimeve të pastrimit të parave, rrëmbimit, mbajtjes peng të personave, fajdes, kontrabandës), janë:

- sekuestrimi i pasurive “jo në përpjesëtim” në krahasim me të ardhurat e deklaruara apo me veprimtarinë ekonomike të zhvilluar dhe, me zbatimin e Mbikëqyrjes së Posaçme të policisë, konfiskimi i pasurive për të cilat i dyshuari nuk ka treguar prejardhjen e ligjshme (të vihet re ngjashmëria me nenin 12 *sexies*).

Procedimi për zbatimin e masave të sigurimit personal dhe për pasurinë zakonisht është autonom.

Megjithatë kur ka nisur procedura penale, neni 23-*bis* i ligjit nr. 646/82 detyron Prokurorin e çështjes që është titullar i procedurës penale që të informojë pa vonesë Prokurorin kompetent për marrjen e masave të sigurisë.

Kjo strategji në proces e njohur si “binar i dyfishtë”, paraqet një avantazh të padyshimtë kur konsiderohet se në rastin e një zgjidhjeje të dyshimeve gjatë procedurës penale, me revokim pasues të sekuestrimit penal të pasurive, nuk bie ajo çka është kryer në bazë të procedurës për masat e sigurisë së pasurisë që do të prodhojë efekte të mëtejshme të konfiskimit në rastin kur nga ana e Gjykatës kompetente do të ishin të parashikuara masat e sigurimit vetjak, për të cilat – theksohet – është e nevojshme që të ekzistojnë “dyshime për përkatësi në organizata mafioze” (ose kushte të tjera paraprake të thëna më lart) dhe vetë personi nuk është në gjendje të tregojë prejardhjen e ligjshme të pasurive të tij.

- pezullimi i përkohshëm i administrimit të pasurive vetjake (nenet 22 e 24 të ligjit nr. 152/75 në lidhje me nenin 2 ter, ligji nr. 575/65) (X).

§ 5. Parandalimi i riciklimit në sistemin financiar.

Sistemi i ngritur kundër pastrimit të parave, edhe për shkak të vështirësive të njohura nga të gjithë për gjetjen e tij, nuk mund të bazohet vetëm mbi zbatimin e ligjeve ndëshkuese por duhet të jetë rezultat i integritimit mes sanksioneve penale dhe administrative.

Në këtë fushë një vend qendror zë ligji nr. 197 i vitit 1991, që sjell “masa urgjente për të kufizuar përdorimin e parave në dorë dhe titujve prurësit në transaksione dhe parandaluar përdorimin e sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave”, i shpallur duke përfutur rekomandimet nga GAFI, dhe duke hershuar përmbytjen e Direktivës 91/308/CEE, përfutur nga Këshilli i Komuniteteve Evropiane më 10 qershor 1991.

Me ligjin nr. 197/1991 është përftuar:

- ndalimi i transferimit të parave në dorë dhe mjeteve të tjera anonime të pagesës për vlera që i kalojnë 20 milionët (neni 1);

- detyrimi për të identifikuar klientelën që kryen veprime për shuma më të mëdha se kjo vlerë, edhe nëse të copëzuara, dhe për të regjistruar të dhënat përkatëse në një arkiv unik informues të ndërtuar në nivel ndërmarrjeje. Të gjithë ndërmjetësit e aftësuar për ta bërë këtë kanë detyrimin e krijimit të arkivit unik informatik; pra parashikohet përcjellja e të dhënave në Z.I.K vetëm për të dhëna të grumbulluara, në mënyrë që të lejojë kryerjen e kërkimeve për të gjetur fenomene eventuale të pastrimit të parave në zona të dhëna territoriale (neni 2);

- detyrimi për të sinjalizuar veprimet e dyshimta, për të cilat do flitet gjerësisht më tej (neni 3), që faktikisht ka shndërruar bashkëpunimin e ndërmjetësve nga pasiv në aktiv.

Tjetër masë e rëndësishme ligjore në fushën e parandalimit të riciklimit, është dekreti legjislativ nr. 125, dt. 30 prill 1997 që, në zbatim të ligjit nr. 52/1996 (ligji komunitar 1994) të përfutimit të Direktivës 91/308/CEE, ka modifikuar disiplinën e lëvizjes ndërkufitare të kapitaleve dhe të monitorimit fiskal të parave, titujve dhe vlerave, parashikuar me nenin 3 të dekretit legjislativ nr. 167/1990, konvertuar me disa modifikime në ligjin nr. 227/1990.

Në thelb dekreti legjislativ nr. 125/1997 parashikon:

- lëvizjen e lirë të parave në dorë dhe titujve prurësit, nga ana e personave rezidentë dhe jo rezidentë, nga dhe drejt vendeve të huaja edhe për shuma mbi 20 milionë, me detyrimin e paraqitjes së një deklarate që i dërgohet Z.I.K., organi i Bankës së Italisë;

- depozitimi i deklaratës, për dërgimin e mëpasshëm tek Z.I.K., pranë doganave kufitare, dhe në çastin e kalimit të kufirit, për Vendet extrakomunitare; në zyrat doganore; komandat e Rojës së Financës, zyrat postare dhe bankat, brenda 48 orësh pas hyrjes ose para daljes, në rastin e vendeve extrakomunitare;

- mbajtjen e dokumentit me vete (në hyrje dhe në dalje për kalimet extrakomunitare, vetëm në dalje për vendet komunitare);

- përjashtimin nga deklarimi për transferimet e mandateve postare apo kambiale apo çeqe, bankare apo qarkulluese, të lëshuara nga ndërmjetës huadhënës apo posta italiane që mbajnë emrin e përfutuesit dhe klauzolën e patransferueshmërisë;

- mundësinë, për Z.I.K., që të përdorë të dhënat e përmbajtura në deklaratë me qëllim kundërvënien pastrimit të parave dhe të detyrimeve të tjera institucionale, si dhe përcjelljen e vetë të dhënave Administratës financiare ose Autoritetit mbikëqyrës sipas nenit 11 të ligjit nr. 197/1991;

- zbatimin e një sanksioni administrativ në të holla nga 200.000 lireta deri në 40% të shumës së transferuar më tepër nga vlera e 20 milionëve, në rastet e mungesës së deklaratës;

- dhënia e një sanksioni penal (burgim nga 6 muaj deri në një vit dhe gjobë nga 1 deri në 10 milionë) në rast të mosdhënies, gjatë deklaratës, të të dhënave të subjektit për llogari të të cilit kryhet transferimi nga dhe drejt një shteti të huaj dhe në rastin kur këto të dhëna janë të rreme.

Një tjetër masë që vlen të përmendet është ligji nr. 310, dt. 10 gusht 1993, që sjell “norma për transparencën në pushimin e pjesëmarrjes dhe në përbërjen e bazës shoqërore të shoqërisë së kapitalit, si dhe të pushimit të ushtrimit tregtar dhe të transferimit të pasurisë së trojeve”.

Kjo masë, në fakt, ka si qëllim të realizojë një transparencë më të madhe në transferimet e pasurisë dhe në asetet e pronësisë së shoqërive, si dhe në pushimin e ushtrimit tregtar dhe në transferimin e pronësisë së trojeve që, sidomos në zonat kufitare me hapësirat urbane, shpesh janë të përshtatshme për veprime të jashtëligjshme.

Në veçanti, transferimi i kuotave të shoqërisë duhet të bëhet me nënshkrim të noterizuar dhe depozitim të mëvonshëm për t’u regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve. Nga ana e noterëve është detyrimi që të depozitohen në regjistrin e ndërmarrjeve aktet e transferimit të ndërmarrjeve tregtare dhe t’i përcjellin një kopje kuesturës kompetente për territorin; gjithnjë nga ana e noterit i përcillen së njëjtës zyrë të dhënat thelbësore në lidhje me shitblerjen e trojeve, duke shënuar palët kontraktuese, burimin objekt transferimi si dhe çmimin e vendosur në kontratë. Në fund Autoriteti komunal që lëshon autorizimin për ushtrimin e veprimtarisë tregtare apo që merr masa për të kaluar në emrin e blerësit autorizimin që më parë i ishte dhënë shitësit, ka detyrimin të përcjellë të dhënat e masës së marrë Kuesturës kompetente për territorin.

Në fund, dekreti nr. 69, dt. 4 gusht 2000 me të cilin ngrihet pranë Ministrisë së Thesarit regjistri (i informatizuar) i raporteve të llogarive dhe depozitave sipas nenit 20, paragrafi 4, i ligjit nr. 413, dt. 30 dhjetor 1991. Në zbatim të këtij ligji tani është bërë e mundur që subjekte të mirëpërcaktuara si A.GJ, Z.I.K dhe Forcat e Policisë mund të kërkojnë, duke iu referuar personave fizikë apo juridikë, ekzistencën eventuale të

raporteve të llogarive dhe depozitave në emër të tyre apo në bashkëzotërim apo në lidhje me të cilat ata veprojnë në emër dhe për llogari të.

§ 6. Raportimi i operacioneve të dyshimta.

Për sa u përket dispozitave të ligjit nr. 197/91 një kapitull më vete e zë disiplina e të ashtuquajturave “raportime të operacioneve bankare të dyshimta”, e ripërtërirë me Dekretin legjislativ nr. 153/1997 edhe ky i nxjerrë për të zbatuar Direktivën 91/308/CEE në lëmi të riciklimit.

Më hollësisht neni 3 i ligjit 197/91 përshkruan në ngarkim të ndërmjetësve financiarë të aftësuar për ta bërë këtë, detyrimin për të raportuar pa vonesë “çdo operacion i cili, për nga karakteristikat, entiteti, natyra apo çdo rrethanë tjetër, duke pasur parasysh edhe kapacitetin ekonomik të veprimtarisë së kryer nga subjekti që i referohet”, të bën të mendosh se të hollat, pasuria dhe përfitimet objekt i operacionit mund ta kenë prejardhjen nga krimi jo nga pakujdesia.

Në veçanti, ndërmjetësve u është vënë një detyrim autonom dhe parësor që konsiston përmbledhtas në:

- mbledhjen sistematike të lajmeve;
- në një screening paraprak të tyre;

- në raportimin pranë Autoritetit administrativ – Zyra Italiane e Këmbimit – të lëvizjeve të dyshimta duke ndërfutur parimin e “bashkëpunimit aktiv” nga ana e vetë ndërmjetësve.

Nga ana e saj Zyra Italiane e Këmbimit:

- Shqyrton sinjalizimet duke mbajtur parasysh edhe arsyet e mundshme ekonomike;

- Përfton të dhëna të mëtejshme dhe informacione nga ndërmjetësit;

- përdor rezultatet e analizave të flukseve financiare;

- shkëmben informacione me autoritetet e mbikëqyrjes dhe autoritetet e huaja homologe;

- i përcjell, në përfundim të këtyre përthellimeve, sinjalizimet e përfutuara bashkë me një relacion teknik, Skuadrës së Posaçme të Policisë Valutore të Rojës së Financës dhe Drejtorisë Hetimore Antimafie, kompetentë në kryerjen e kontroleve eventuale me karakter hetues.

Në një kuadër të tillë, vihet në pah një risi tjetër domethënëse në nenin 3 të ligjit nr. 197/1991, modifikuar me dekretin legjislativ 153/1997, që vendos se D.I.A dhe Skuadra e Posaçme e Policisë Valutore e Rojes së Financës, do jenë organet e ngarkuara me zhvillimet hetimore në lidhje me çdo sinjalizim, duke vendosur edhe që, në rastin kur këto sinjalizime kanë të bëjnë me krimin e organizuar, këta vetë informojnë Prokurorin Kombëtar Antimafie.

Pra ligjvënësi italian – edhe si rrjedhojë e asaj çka vendoset në Konventën e Strasburgut mbi temën e shtrirjes së krimit të mundshëm të riciklimit dhe të gjitha krimeve jo nga pakujdesia – ka dashur në këtë mënyrë t'i kushtojë një “vëmendje” të veçantë kundërvënies së pastrimit të parave të lidhur me veprimtarinë mafioze.

Në skenarin e ri të “trajtimit” të raportimit të operacioneve të dyshimta nën profilin e analizës financiare dhe të hetimeve, është ndërfutur gjithashtu një proces i feedback që, nëse përdoret si një tjetër mjet studimi dhe orientimi, mund të prodhojë edhe në kohë jo të gjata një shtysë të rëndësishme për mbarë sistemin e “sinjalizimeve”.

Në fakt, paragrafi i pestë i tekstit të ri të nenit 3, vendos që D.I.A dhe Skuadra e Posaçme e Policisë Valutore, nëse në dritën e elementeve të përfuara gjatë hetimeve policore nuk gjejnë në raportimin e marrë elemente përthellimi duhet të informojnë edhe Zyrën Italiane të Këmbimit e cila, më pas, njofton ndërmjetësin që pati sjellë raportimin.

Përveç kësaj, gjithnjë në bazë të paragrafit të pestë, organet hetimore informojnë Z.I.K. për çdo rrethanë që rezulton nga veprimtaria e hetimit dhe njohja e të cilës mund të përdoret për të parandaluar përdorimin e sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave.

Një tjetër element i rëndësishëm është përdorimi i sekretit profesional për të ruajtur edhe në lidhje me administratën publike, të gjitha informacionet e zotëruara nga Z.I.K. dhe nga organet e tjera të mbikëqyrjes dhe kontrollit që kanë të bëjnë me zbatimin e normativës kundër pastrimit të parave.

Por sistemi i mbrojtjes nuk ka karakter absolutizmi pasi paragrafi i dytë i nenit 3-bis vendos se identiteti i personit fizik dhe/ose juridik mund të zbulohet vetëm kur Autoriteti Gjyqësor, me dekret të motivuar, e quan të domosdoshëm për qëllimin e vërtetimit të krimit për të cilin po kryhen veprimet.

Megjithatë legjislatori ka pasur kujdesin të parashikojë se fshehtësia mbi identitetin ruhet edhe në rastin e veprimeve të posaçme të policisë gjyqësore

si sekuestrimet e akteve apo dokumenteve që për nga natyra e tyre mund të kryhen me nismën e policisë gjyqësore duke vendosur në lidhje me këtë – neni 3-bis, paragrafi 3 – detyrimin e marrjes së masave të nevojshme për të garantuar fshehtësinë.

Një element tjetër mbi të cilin është e udhës të ndalemi ka të bëjë me “pezullimin e operacionit financiar të dyshimtë”, që legjislatori, me modifikimin e bërë normës sipas nenit 3, paragrafi i gjashtë, i ka besuar Z.I.K., edhe me propozim të D.I.A. dhe/ose të Skuadrës së posaçme të Policisë valutore.

Kjo e drejtë, e dhënë organit të kontrollit, mund të ushtrohet, në prani të treguesve të dyshimit dhe maksimumi për 48 orë, me kusht që pezullimi të mos krijojë paragjykim:

- për rrjedhën e hetimeve;
- për operativitetin në veprim të ndërmjetësve.

Një aspekt që duket e udhës të vihet në dukje është ai që ka të bëjë me parashikimin normativ në bazë të të cilit raportimi i bërë nga ndërmjetësit në bazë të ligjit 197/1991 nuk përbën shkelje të detyrimit të fshehtësisë dhe nuk sjell përgjegjësi të asnjë lloji.

Me rëndësi të madhe duket dekreti legjislativ i kohëve të fundit i 25 shtatorit 1999, nr. 374 i cili me qëllim integrimin e zbatimit të direktivës 91/308/CEE në lidhje me parandalimin e përdorimit të sistemit financiar me qëllim riciklimin e të ardhurave nga veprimtari të jashtëligjshme, vendos të shtrijë në gjithçka apo pjesërisht zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 197/91, për ato veprimtari që janë veçanërisht të ndjeshme ndaj përdorimit me qëllim pastrimin e parave për shkak se realizojnë grumbullimin apo transferimin e shumave të mëdha ekonomike po financiare apo rezultojnë se janë të ekspozuara ndaj infiltrimit të krimit të organizuar.

Në veçanti dekreti i cituar shtrin fushën e zbatimit të dispozitave kundër riciklimit në veprimtaritë e mëposhtme, ushtrimi i të cilave mbetet i nënshtruar zotërimit të licencave, autorizimeve, regjistrimeve në regjistra apo dhoma të ndryshme, ose një deklaratë paraprake të fillimit të veprimtarisë:

- mbledhje e huasë për llogari së të tretëve;
- ruajtje dhe transportim parash dhe sendesh pa përdorimin e rojeve të posaçme;
- agjenci biznesi e ndërmjetësimit imobiliar;

- tregti e sendeve të antikuariatit;
- galeri arti ose shtëpi ankandi;
- tregtimi, përfshi importin dhe eksportin, e arit me qëllime industriale apo të investimit;
- prodhimi, ndërmjetësimi dhe tregtimi, përfshi importin dhe eksportin, i sendeve të çmuara;
- administrimi i shtëpive të lojërave të fatit;
- prodhimi i sendeve të çmuara nga ana e ndërmarrjeve të artizanatit;
- ndërmjetësimi i huasë;
- agjenci e veprimtarisë bankare sipas nenit 106 të dekretit legjislativ nr. 385 dt. 1 shtator 1943.

Subjekteve të cituara dekreti (neni 4) u njuh detyrime të përcaktuara të identifikimit, regjistrimit dhe raportimit të operacioneve të dyshimta duke parashikuar:

- në rast shkeljeje (neni 6) të detyrimeve të identifikimit dhe regjistrimit sanksionet sipas nenit 2, paragrafi 1, ligji nr. 197/91;
- në rastin e shkeljes së detyrimeve të raportimit sanksionet sipas nenit 5, paragrafi 5, ligji nr. 197/91.

Në “Udhëzime operative për identifikimin e operacioneve të dyshimta”, përditësuar kohët e fundit, Guvernatori i Bankës së Italisë kujton njohjen e klientelës si një çast themelor të itinerarit logjik që çon në vlerësimin e operacionit me qëllim kalimin e raportimit të operacionit të dyshimtë (përveç se të profilit të rrezikut dhe të mundësive të zhvillimit të marrëdhënies, dhe tregon mjetet – në veçanti Arkivin Unik Informues, parashikuar nga normativa kundër pastrimit të parave – për të përmirësuar këtë njohje.

§ 7. *Hetimet ekonomike dhe të pronësisë: modeli hetimor.*

Dispozitat në fuqi për t’iu kundërvënë krimit të organizuar në rrafshin ekonomik-financiar, lejojnë përdorimin e disa mundësive hetimore komplekse dhe të ndryshme sipas rastit.

Në lidhje me këtë, edhe pse marrim parasysh vështirësinë e kryerjes së hetimeve me formula të ngurta dhe stereotipe, meqë nuk mund të lihen mënjandë ndryshoret e rastit të çështjes konkrete, megjithatë mund të jepen,

sa për të orientuar, disa udhëzime, të nxjerra nga përvoja operative, mbi metodologjitë hetimore të konsideruara si ato më të vlefshmet në veprimin e kundërshtimit të krimit të organizuar.

Në mënyrë të veçantë është vënë re frytshmëria e përdorimit sinergjik të moduleve të ndryshme operative, me qëllim shfrytëzimin e plotë të bashkëplotësimit që krijohet mes tablosë ligjore me karakter ndëshkimor dhe asaj me karakter parandalues dhe përfutimit të maksimumit të mundshëm nga veprimi kundërshtues, përmes sulmit të qendrave jetësore të organizatës kriminale si në një rrafsh “ushtarak” ashtu edhe në frontin ekonomik financiar.

Siç dihet, një mjet i vlefshëm hetimor janë masat e sigurimit, për të cilat do të flitet me hollësi më vonë (ligji nr. 575/65, me modifikimin e bërë me ligjin nr. 646/82) që lejon fillimin e hetimeve dhe kontrolleve bankare dhe pasurore duke u nisur nga presupozimi i ekzistencës së shenjave të përkatësisë në organizata kriminale. Efikasiteti i këtij ligji rrjedh kryesisht nga mundësia për t’ia nënshtruar veprimtarinë e këtyre subjekteve kontrolleve të posaçme dhe të shumëllojshme, edhe nëse këto veprimtari rezultojnë të jenë të zotëruara përmes një personi të tretë ose ndonjë shoqërie fantazëm.

Siç e ka vënë në dukje përvoja, tipologjia hetimore e përmendur e domosdoshme për shkatërrimin e potencialitetit ekonomik-financiar të ortakërive të llojit mafioz dhe për identifikimin e investimeve të tyre në treg, nuk mund të lërë mënjanë – për arsye të një efikasiteti më të lartë – veprimtarinë paralele të policisë gjyqësore, që ka si qëllim gjetjen e provave në lidhje me krimet e kryera.

Një veprimtari e vlefshme hetimore antimafie duhet pra që të shprehë një përmbajtje të lartë tekniko-cilësore, duke shfrytëzuar së pari, siç patëm mundësinë të sqarojmë, mundësitë e shumta të ofruara nga legjislatori (operacione nën mbulesë, përgjime në mjedis, bashkëbisedime hetimore, kontrolle bankare, dëgjimi i bashkëpunëtorëve të drejtësisë) në përpjekjen për të krijuar një tablo provuese në gjendje për të përballuar fazën e mëtejshme të shqyrtimit me anë të debatit.

Për këtë çdo hetim duhet të zhvillohet sipas një “sistemi binar”, duke u munduar të shfrytëzojë në maksimum bashkëplotësinë që ekziston mes tablosë ligjore me karakter ndëshkues dhe asaj me karakter parandalues.

Kjo përqaasje lejon që në përfundim të hetimeve paraprake dhe pasi të jetë rindërtuar tabloja e interesave ekonomike dhe e disponimit financiar që

çon tek ortakëria nën hetim, të goditen me efikasitet pasuritë e grumbulluara në mënyrë të jashtëligjshme përmes:

- sekuestrimit penal parandalues *ex neni* 321 K.P.P. për konfiskimin eventual të detyrueshëm në rast dënimi, në bazë të nenit 12 *sexies* të ligjit nr. 501/94, të parave, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe/ose të përfitimeve të tjera prejardhjen e të cilave i akuzuari nuk mund ta justifikojë dhe për të cilat rezulton se është titullari ose se i disponon qoftë edhe nëpërmjet një personi të tretë fizik apo juridik, të mira këto në përpjesëtim të zhdrejtë me të ardhurat e tij apo me veprimtarinë e tij ekonomike.

- fillimit të njëkohshëm të një procedure me qëllim zbatimin e masave të përshtatshme të sigurisë me karakter personal dhe të pasurisë (sekuestrim dhe konfiskim i mëvonshëm) për të gjitha ato subjekte që rezultojnë se janë pjesë e së njëjtës ortakëri mafioze objekt hetimi, edhe vetëm mbi bazën e shenjave provuese në bazë të nenit 2 ter, paragrafi 2 dhe 3 të ligjit nr. 575/65.

Vlefshmëria e një impostimi të tillë konfirmohet, mes të tjerave, nga paragrafi i fundit i nenit 2 ter të ligjit nr. 575/65, që sanksionon bashkëplotësinë mes masave të sekuestrimit me karakter sigurimi dhe konfiskimit dhe atyre gjegjëse me natyrë penale.

§ 8. Hetimet ekonomike dhe të pronës.

§ 8.1. Hyrje

Veprimtaria kundër krimit të organizuar presupozon përdorimin e koordinuar të një sërë mjetesh hetimore të parashikuara nga masa normative të shumta, njohja e të cilave është e domosdoshme për të ndërhyrë në mënyrë domethënëse mbi këtë fenomen.

Më poshtë do të tregohen, në mënyrë organike, kushtet paraprake, karakteristikat, subjektet e përligjura dhe mënyrat e aktualizimit të hetimeve duke pasur si qëllim veçanërisht rindërtimin e pasurive të grumbulluara në mënyrë të jashtëligjshme nga organizatat kriminale dhe gjetjen e kanaleve të riciklimit dhe të ripërdorimit në veprimtari ekonomike të përdorura prej tyre.

Krahas procedurave të përgjithshme – që tregojnë në mënyrë të plotë subjektet e përligjura për të vepruar në këtë sektor, kushtet paraprake për përdorimin e disa fuqive hetimore të parashikuara, si dhe rrugët autorizuese për t'u ndjekur dhe përmbushjet e detyrimeve që lidhen me to – jepen

udhëzime metodologjike në lidhje me mënyrat konkrete të zhvillimit, duke pasur parasysh se këto duhen marrë si sugjerime orientuese dhe jo si absolute. Në fakt vetëm analiza e situatave të veçanta të ndeshura “në lëmë”, me një veprimtari të përshtatshme paralele të *intelligence-s*, lejojnë zgjedhjen dhe përshtatjen, brenda mandatit dhe përgjegjësi, të mënyrave hetimore më të volitshme për rastin konkret.

Kjo pasi shumëllojshmëria e formave në të cilat mund të shfaqen veprimtaritë e jashtëligjshme të krimit të organizuar, për shembull, për t’u infiltruar në pëlhurën ekonomike dhe shoqërore “të shëndoshë”, si edhe evolucioni i vazhdueshëm i metodave të përdorura nga organizatat kriminale që të mund të përfitojnë sidoqoftë nga të mirat e lidhura me disponibilitetin e pasurisë së grumbulluar në mënyrë të jashtëligjshme, e bëjnë sidoqoftë të vështirë hetimin brenda formulave të ngurta dhe stereotipeve.

Kur flasim për hetime në sektorin ekonomik të pasurive, nënkuptojmë si përfundim të hetimit që ka si qëllim sekuestrimin penal të të mirave të luajtshme dhe të paluajtshme të grumbulluara në mënyrë të jashtëligjshme si fryt i krimit, ashtu edhe hetimin mbi pasurinë dhe nivelin e jetesës, brenda një procedimi të posaçëm administrativ me qëllim zbatimin e masave të ruajtjes së pasurisë (sekuestrim dhe konfiskim) dhe personale (vëzhgim i posaçëm, vendqëndrim i detyruar).

Në këtë lëmë, sistemi i masave parandaluese përbën një veçanti frytdhënëse të legjislacionit tonë në kundërshtim me krimin mafioz që integron, ecjen e procesit penal duke hershuar prapun e dënueshmërisë në çastin në të cilin nuk është mbërritur akoma siguria e provuar mbi prejardhjen specifike të jashtëligjshme të të mirës apo pasurisë, duke pasur si kusht paraprak rrezikshmërinë shoqërore (marrë si përkatësi apo përngjijtje me organizata kriminale të rëndësishme).

Rrezikshmëria duhet të rezultojë nga elemente faktike (jo nga hamendësime të pastra, dyshime apo deduktime): denoncime të kohëve të fundit për krime të rënda, nivel jetese në përpjesëtim të zhdrejtë me të ardhurat e deklaruara, shoqërim me ish të dënuar, fakte fajësuese rezultat i procedimit penal në vazhdim ose të përcaktuara më parë; sidomos kur janë të aftë të përballojnë një masë sigurie; elemente të deduktueshme edhe nga vendime të pushimit të çështjes, por që të jenë konkrete.

Rrezikshmëria shoqërore duhet të jetë aktuale. Ky aktualitet nuk bie kurrë për subjekte për të cilat është e mundur të pohohet vazhdimësia e përkatësisë së tyre në një bandë mafioze.

Subjekte të masave parandaluese janë:

- personat që zakonisht merren me trafik kriminal (neni 1, nr. 1, ligji nr. 1423/1956);

- personat që për shkak të sjelljes dhe nivelit të jetesës duhet të mendohen se jetojnë normalisht, edhe pjesërisht, me të ardhura nga veprimtari kriminale (neni 1, nr. 2, ligji nr. 1423/1956);

- personat që kryejnë krime të cilat fyejnë ose vënë në rrezik integritetin fizik apo moral të të miturve, shëndetësinë, sigurinë, apo qetësinë publike (neni 1, nr. 3, ligji nr. 1423/1956);

- të dyshuarit si pjesëmarrës në organizata mafioze dhe të barazvlefshme (neni 1, ligji nr. 575/65);

- të dyshuarit si pjesëmarrës në organizata që merren me trafikim të narkotikëve (neni 74 i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309 dt. 9 tetor 1990);

- personat të cilët për shkak të sjelljes dhe nivelit të jetesës duhet të mendohen, mbi bazën e elementeve faktike, se jetojnë normalisht, edhe pjesërisht, me të ardhura nga veprimtari kriminale, kur veprimtaria nga mendohet se vijnë të ardhurat është një prej atyre që parashikojnë nenet 629, 630, 644, 648-bis dhe 648 ter K.P. (rrëmbimi, mbajtja peng e personit, fajdet, pastrimi i parave të pista, përdorimi i të hollave, pasurive apo përfitimeve me prejardhje të jashtëligjshme) ose ajo e kontrabandës.

Masat e parandalimit vetjak janë:

- njoftimi me gojë (njoftimi për të pasur një sjellje sipas ligjit) (neni 4, ligji nr. 1423/1956);

- vëzhgimi i posaçëm nga forcat e sigurisë publike (neni 3, paragrafi 1, ligji nr. 1423/1956, me ndalimin e qëndrimit në një komunë të ndryshme nga ajo e rezidencës apo e vendbanimit (neni 3, paragrafi 2) apo me detyrimin e qëndrimit në vendin e rezidencës apo të vendbanimit (neni 3, paragrafi 2).

Me lajmërimin gojor kuestori mund t'u imponojë personave që rezultojnë përfundimisht të dënuar për krime jo nga pakujdesia ndalimin e zotërimit dhe të përdorimit të çdo aparature të komunikimit radiotransmetues, radarë dhe kuadër shikues për natën, veshje dhe pajime për mbrojtje balistike individuale, makina të blinduara apo të modifikuara me qëllim shtimin e fuqisë apo aftësisë sulmuese, ose sidoqoftë në mënyrë të tillë që t'i shpëtojnë kontrollit të policisë, si dhe programe informatike dhe mjete të tjera shifrimi apo kriptimi të bashkëbisedimeve dhe mesazheve (kjo masë është futur kohët e fundit me nenin 15 të ligjit nr. 128/2001).

Shkelja e masave të parandalimit vetjak dënohet penalisht.

Mjetet, aparaturat dhe programet e zotëruara apo të përdorura konfiskohen dhe u jepen forcave të policisë, nëse bëjnë kërkesë, për t'u përdorur në detyrat e institucionit.

§ 8.2. Hetimet ekonomike dhe pasurore të parashikuara nga normativa antimafie: neni 2 bis Ligji nr. 575 dt. 31.05.1965.

§ 8.2.1. Hetime të mëtejshme ose verifikime ex neni 3-quater ligji nr. 575/65.

Një tjetër lloj hetimi, gjithnjë në lidhje me veprimtaritë ekonomike “në rrezik”, është ai që pason kryerjen e kontrolleve të pasurisë sipas nenit të cituar 2-bis apo të hetimeve që kryhen për të verifikuar rreziqet e infiltrimit nga ana e krimit mafioz, kur ndeshet prania e të dhënave të mjaftueshme që të bëjnë të mendosh se ushtrimi i disa veprimtarive ekonomiko-sipërmarrëse të dhëna:

- i nënshtrohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, kushteve të kanosjes dhe/ose të nënshtimit parashikuar me nenin 416-bis K.P.;

Sidoqoftë, mund të lehtësojë veprimtarinë e personave ndaj të cilëve është propozuar apo zbatuar masa e parandalimit e vëzhgimit të posaçëm dhe e detyrimit të qëndrimit në një vend, pra bëhet fjalë për persona që i nënshtrohen procedimit penal për njërin nga krimet e parashikuara nga nenet 416-bis, 629, 630, 644, 648-bis dhe 648-ter të kodit penal dhe nuk ekzistojnë kushtet për zbatimin e masave të cituara të parandalimit vetjak.

Në prani të këtyre rrethanave, Prokurori i Republikës dhe Kuestori mund t'i kërkojnë Gjykatës kompetente që të vendosë:

- kryerjen e hetimeve dhe verifikimeve të mëtejshme mbi veprimtaritë ekonomike

të përmendura edhe nëpërmjet Rojës së Financës apo Policisë Gjyqësore;

- detyrimin, për ata që kanë pronësinë ose përdorimin, me çdo lloj titulli, së të mirave apo të përfitimeve të tjera me vlerë jo të përpjesëtuar me të ardhurat vetjake apo me kapacitetet ekonomike vetjake, që të justifikojnë prejardhjen e ligjshme, për marrjen eventuale të masës së heqjes së përkohshme të së drejtës së administrimit të pasurive.

Në ekzekutimin e këtyre kontrolleve, meqë këto përputhen me kontekste në të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme për pjesëmarrjen në shoqëri të llojit mafioz të nevojshme për zbatimin e masave të parandalimit, nuk do të jetë e mundur të përdoren fuqitë e posaçme që parashikohen nga neni 2-bis i ligjit nr. 575/65, duke iu referuar veçanërisht paragrafit të gjashtë të tij, por vetëm ato të dhëna nga ligji në rrugë të zakonshme. Megjithëse mbetet ky kufizim i krijuar nga normativa, edhe në këtë veprimtari specifike mund të përshtaten, nëse do të mendohen si të zbatueshme dhe të volitshme në lidhje me rastin konkret, metodologjitë operative të shtjelluara në pikën (2) të shkronjës a).

§ 8.2.2. Verifikimi i pozicionit fiskal.

Neni 25 i ligjit nr. 646 dt. 13 shtator 1982 i lejon Skuadrës së Policisë Tatimore të Rojës së Financës, kompetente në lidhje me vendbanimin e zakonshëm të subjektit, që të mund të fillojë verifikimin e pozicionit fiskal të subjekteve të dhëna, edhe duke pasur si qëllim kontrollin e shkeljeve valutore dhe të shoqërive.

Kushtet paraprake. Për të kryer verifikimin e pozicionit fiskal, në ngarkim të subjektit pritës, është e nevojshme që të jetë lëshuar një vendim dënimi, edhe jo i formës së prerë, për krimin sipas nenit 416-bis, ose të jetë vendosur, me një masë edhe jo të formës së prerë, një masë parandaluese në bazë të ligjit nr. 575/65, pasi i dyshuar si pjesëmarrës në organizata mafioze ose të barazvlefshme.

Verifikimi mund të kryhet edhe mbi:

- bashkëshortin, fëmijët dhe ata që kanë bashkëjetuar me subjektin në fjalë në pesë vitet e fundit;

- persona fizikë apo juridikë, shoqëri, ortakëri dhe ente, pasuritë e të cilëve subjekti rezulton se i zotëron krejtësisht apo pjesërisht, drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt;

- ndërmarrjet, shoqatat, shoqëritë e ortakëritë në të cilat i interesuari është administrator apo ku përcakton, me çdo lloj mënyre, zgjedhjet e drejtimet.

Subjektet e përligjura. Kontrolli i pozicionit fiskal mund të kryhet nga Skuadrat e policisë tatimore të Rojës së Financës kompetente në lidhje me vendbanimin e zakonshëm të subjektit.

Nisja apo jo e kontrollit të pozicionit fiskal lihet në vetëgjykimin e Komandantëve të Skuadrave të policisë tatimore mbi bazën e një analize të kujdesshme dhe të thellë të elementeve në dispozicion (rezultati i kontrolleve të mëparshme mbi pasurinë, ndikimi i masës së konfiskimit mbi pasurinë e subjektit, rezultate të tjera të arritura në kamatëvonesat e procedimit parandalues, përmasa e vendimit të dënimit, dokumentet e mbledhura gjatë gjyqit, etj.) në mënyrë që të vlerësohet dobia efektive – nën profilin e përfuturit të kuotave së të ardhurave të jashtëligjshme, apo të vërtetimit të mundshëm të shkeljeve valutore dhe të shoqërisë – dhe raporti pasues kosto/përfitime.

Mënyrat e ekzekutimit. Me qëllim lejimin e aktivizimit të procedurës së kontrollit, paragrafi 3 i nenit 25 parashikon që Kancelaria e Gjykatës duhet t'i përcjellë Skuadrës kompetente të policisë tatimore një kopje të vendimit të dënimit apo të masës së zbatimit të masës parandaluese.

Komunikimi i menjëhershëm nga ana e kancelarive të Gjykatave është, pra, vendimtar për t'u njohur me masat e marra nga juridiksioni dhe për të filluar, nëse duhet, veprimtarinë e kontrollit.

Për zhvillimin e veprimtarisë në fjalë policisë tatimore i njihen fuqitë:

- E parashikuara nga ligjet e përgjithshme në fushën e tatimeve dhe nga ligjet e veçanta të tatimeve;

- sipas nenit 2-bis, paragrafi 6, ligji nr. 575/65 që lejonë t'i kërkohen çdo zyre të administratës publike, çdo enti huadhënës, si dhe ndërmarrjeve, shoqërive dhe enteve të çdo lloji, informacione dhe kopje të dokumentacionit që mendohet se është i dobishëm për qëllimin e hetimeve, si dhe mund të kryhet sekuestrimi i këtij dokumentacioni sipas mënyrave të përshkruara në nenet 253, 254 dhe 255 K.P.P.;

- e dhëna pjesëmarrësve në Skuadrën Speciale të Policisë Valutore të Rojës së Financës nga kombinimi i vendosur me nenet 6 të ligjit nr. 159 dt. 30 prill 1976 dhe 25, 26 e 28 të Dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 148 dt. 31 mars 1988 – Teksti Unik i dispozitave të ligjit në fushë valutore.

Rëndësi të veçantë marrin në këtë fushë të drejtat e:

- inspektimit pranë ndërmarrjeve të kredive dhe instituteve të kredive të posaçme, si dhe pranë subjekteve të tjera, ku mendohet se ekziston dokumentacion i rëndësishëm, në vende të ndryshme nga banesat private [neni 25, paragrafi 1, pika c];

- kërkesës pranë ndërmarrjeve dhe instituteve të kredive për të treguar regjistrat e kontabilitetit, dokumentet dhe letërkëmbimin dhe marrjes së kopjes [neni 28, paragrafi 1, pika a];

- sekuestrimit të valutës së huaj, vlera të luajtshme italiane dhe të huaja, lireta dhe ar i papunuar, kur përbëjnë objekt shkelje të normave valutore [neni 28, paragrafi 1, pika c].

Në bazë të nenit 26 të ligjit nr. 646/82, Skuadrat e policisë tatimore që kanë kryer kontrollin e pozicionit fiskal duhet t'i komunikojnë Prokurorit të Republikës dhe Kuestorit të gjitha elementet e mbledhura me rastin e kontrolleve, *ex neni 25* dhe, sidoqoftë, ndryshimet e pasurisë mbi 20 milionë të tre viteve të fundit, si në lidhje me ortakët ashtu edhe me përfutesit.

Po këto të dhëna duhet t'i përcillen Ministrisë së Brendshme – Departamenti i Sigurisë Publike, për futjen e tyre në Qendrën e Përpunimit të të Dhënave Interforce.

§ 8.2.3. Detyrimi i njoftimit për subjektet e dënuar apo që u janë nënshtruar masave të sigurisë.

Neni 30 i ligjit nr. 646 dt. 13 shtator 1982 u imponon disa subjekteve detyrimin për t'i njoftuar Skuadrës së policisë tatimore të vendit ku banojnë zakonisht të gjitha ndryshimet për sa i përket entitetit dhe përbërjes së pasurisë, që kanë të bëjnë me elemente me vlerë jo më të vogël se 20 milionë lireta.

Brenda 31 janarit të çdo viti vetë personat duhet të komunikojnë ndryshimet e ndodhura në vitin paraardhës, kur kanë të bëjnë me elemente me vlerë jo më të vogël se 20 milionë lireta.

Përfundohen ato të mira a pasuri që do të përdoren për plotësimin e nevojave të përditshme.

Shkelja e detyrimeve të përshkruara të komunikimit dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet dhe me një gjobë nga 20 milionë në 40 milionë. Dënimi pasohet nga konfiskimi i pasurive të blera me çdo lloj titulli, ose gjegjësi i pasurive të tjetërsuara me çdo lloj titulli.

Kushte paraprake. Në mënyrë që të veprojnë detyrimi i komunikimit në fjalë është e nevojshme që në ngarkim të subjekteve të interesuara të jetë dhënë një dënim me vendim të formës së prerë për krimin e bashkëpunimit mafioz ose një masë e formës së prerë për një masë parandalimi në zbatim të ligjit

nr. 575/65, pasi të fajësuar si pjesëmarrës në shoqëri mafioze ose të barazvlefshme.

Detyrimi vlen për dhjetë vjet, duke nisur nga data e dekretit apo nga vendimi për dënimin e formës së prerë dhe duhet të zbatohet brenda tridhjetë ditësh nga ngjarja që ka përcaktuar ndryshimin në entitetin dhe përbërjen e pasurisë që ka të bëjë me elemente me vlerë jo më të vogël se 20 milionë lireta.

Detyrimet e komunikimit rreshtin së qeni kur masa parandaluese revokohet si pasojë e rekursit në Apel ose në Kasacion.

Subjektet e përligjura. Kontrollin e dispozitës normative në fjalë e kryejnë Skuadrat e policisë tatimore kompetente, në lidhje me vendbanimin e zakonshëm të subjekteve të interesuara.

Mënyrat e ekzekutimit. Me qëllim që të sigurohen për zbatimin e këtij detyrimi, Skuadrat e policisë tatimore të Rojës së Financës do të kujdesen, pasi të kenë marrë komunikimin në zbatim të nenit 25, paragrafi 3, të ligjit nr. 646/82, të ndjekin zhvillimin e kontekstit:

- Duke marrë pranë kancelarive të Gjykatave një kopje të vendimit të formës së prerë të dënimit apo të dekreteve që zbatojnë masat e parandalimit në formën e prerë;

- Duke krijuar, për secilin nga subjektet e interesuar, një dosje të posaçme në të cilën të shënohen komunikimet e mbërritura dhe rezultatet e kontrolleve mbi ndryshimet e pasurisë objekt i raportimit;

- Duke nisur, në mënyrë periodike, kontrolle me qëllim verifikimin e ndonjë lëshimi dhe duke marrë masat e duhura në rast të ndonjë shkeljeje të vërtetuar.

§ 8.2.4. Detyrimi i njoftimit ex neni 3 quinquies ligji nr. 575/65.

Një hipotezë e mëtejshme e detyrimit të komunikimit disiplinuar nga legjislacioni antimafie parashikohet në rastin e revokimit të masës së heqjes së përkohshme të së drejtës së administrimit të pasurisë (neni 3-Quarter).

Në një rast të tillë, Gjykata mund të vendosë detyrimin për atë që ka pronën, përdorimin apo administrimin e pasurisë, apo të një pjese të saj, që t'i komunikojë Kuestorit dhe Skuadrës së Policisë Tatimore në vendin e banesës së zakonshme, ose në vendin ku ndodhen pasuritë nëse bëhet fjalë për persona me banim jashtë shtetit, për një periudhë jo më të shkurtër se tre vjet:

- aktet e zotërimit, të blerjes apo të pagesave të kryera;
- aktet e pagesave të marra;
- detyrat profesionale, të administrimit apo të mbarështimit në besim që janë marrë;
- aktet e tjera apo kontratat e kërkuara nga Gjykata, me një vlerë jo më pak se 50 milionë lireta apo me një vlerë më të lartë të vendosur nga gjykata në lidhje me pronën dhe të ardhurat e personit.

Shkelja e këtij detyrimi, që duhet përmbushur brenda dhjetë ditësh nga kryerja e aktit dhe sidoqoftë brenda 31 janarit të çdo viti për aktet që kryhen vitin paraardhës, sjell burgimin me nga një deri në katër vjet dhe konfiskimin e detyrueshëm të pasurive objekt të operacioneve të padeklaruara.

§ 8.3. Hetimet “kundër pastrimit të parave” në bazë të ligjit nr. 197/91.

Në kërkimin e zgjidhjeve të mundshme për t’u përshtatur për ta bërë gjithnjë e më të mprehtë veprimin e kundërshtimit të pastrimit të parave, përfshirja e sistemit bankar dhe, më në përgjithësi përfshirja e ndërmjetësimit financiar, është gjetur si një vijë e domosdoshme strategjike për t’u ndjekur, meqë kjo, pasi përbën një pikë kalimi të detyrueshme për futjen e kapitaleve të jashtëligjshme në tregun e ligjshëm, mund të luajë një rol parandalues, shumë të frytshëm, sa një funksion i pazëvendësueshëm bashkëpunues me autoritetet gjyqësore dhe policore në ndëshkimin e fenomenit të sipërpërmendur. Me nxjerrjen e Dekretligjit nr. 143 dt. 3 maj 1991 që ka të bëjë me masa urgjente për të kufizuar përdorimin e parave në dorë dhe të kambialeve në dorë prurësit në transaksionet financiare me qëllim pastrimin e parave, të kthyer në ligjin nr. 197 dt. 5 korrik 1991, legjislatori italian ka pasur qëllimin të realizojë përfshirjen e drejtpërdrejtë të sistemit bankar dhe parabankar për kontrollin e lëvizjeve financiare, në përputhje të plotë me sugjerimet e Komitetit të Bazilesë dhe me porositë e Gafi-t.

Struktura normative e ligjit, në veçanti, cakton një sërë rregullash me karakter parandalues dhe disa masa të natyrës ndëshkimore të ndërtuar, thelbësisht, mbi tre mekanizma themelorë:

- kanalizimi i transaksioneve më domethënëse përmes sistemit të ndërmjetësve financiarë;

- mbledhja dhe mbarështimi i të dhënave që kanë të bëjnë me operacione më të mëdha se një prag minimal i paracaktuar përmes një arkivi të posaçëm unik informatik,

- detyrimi i raportimit të operacioneve që duken si të dyshimta.

§ 8.3.1. Detyrimi i identifikimit dhe regjistrimit.

Detyrimi i regjistrimit dhe identifikimit të klientelës nga ana e subjekteve të veçanta që veprojnë në sistemin financiar – për kryerjen e kësaj detyre është parashikuar krijimi i arkivit të vetëm informatik në gjendje që të memorizojë dhe të ruajë informacionet përkatëse – ka si qëllim përgatitjen e një aparati të kontrollit të flukseve financiare, të aftë për të kryer një veprë parandaluese frytdhënëse dhe për të mbështetur veprimtaritë hetimore.

Këto detyrime janë parashikuar nga neni 2 i ligjit të kujtuar nr. 197/1991 me të cilin është zëvendësuar përbërja e nenit 13 të Dekretligjit nr. 625 dt. 15 dhjetor 1979 mbi “Masa urgjente për mbrojtjen e rendit demokratik dhe të sigurisë publike”, të konvertuar, me modifikime, nga ligji nr. 15/1980, siç është zëvendësuar nga neni 30, paragrafi i parë, i ligjit nr. 55/1990 në lidhje me “Dispozita të reja për parandalimin e kriminalitetit të llojit mafioz dhe të formave të tjera të rënda të rrezikshmërisë shoqërore”.

Me anë të një normative dytësore, të nxjerrë më vonë, janë vendosur mënyrat e aktualizimit të dispozitave të cituara, të integruara nga ndërhyrjet interpretuese të Ministrit të Thesarit në lidhje me kërkesën për sqarim dhe me disa kërkesa specifike të bëra për dispozitat, me qëllim lejitimin e një zbatimi të njëtrajtshëm të normativës së sipërpërmendur nga ana e të interesuarve në ushtrimin e veprimtarive të tyre institucionale.

§ 8.3.2. Raportimi i operacioneve të dyshimta.

Raportimet e operacioneve të dyshimta paraqesin, pa dyshim, boshtin e parandalimit të sistemit financiar me qëllim pastrimin e parave dhe përthellimet e parashikuara garantojnë një karakter të duhur sistematik të veprimtarisë së kontrollit të vendosur me ligj.

Në bazën e përvojave të pjekura gjatë vënies në jetë të procedurave të ndryshme normative dhe operative gjatë gjashtë viteve kur ligji nr. 197/1991 ishte në fuqi, me Dekretligjin nr. 153/1997 është ristrukturuar regjimi i raportimeve. Disiplina e re i beson Zyrës Italiane të Këmbimit një rol qendror në fushë të luftës ndaj pastrimit të parave, me detyrën për të marrë

sinjalizime, për t'i analizuar dhe përthelluar nën një profil tekniko-financiar dhe për t'i përcjellë, pasi t'i ketë pasuruar, njëkohësisht tek Drejtoria Hetimore Antimafie dhe tek Skuadra Speciale e Policisë Valutore e Rojës së Financës që më pas informojnë Prokurorin Kombëtar të Antimafies, në rastet e krimit të organizuar.

Në ekzekutimin e përthellimeve të mëtejshme hetimore, këto organe hetimore veprojnë në bazën e një “marrëveshjeje” që parashikon që Drejtoria Investigative Antimafie, në përputhje me barrën e ngarkuar nga ligji themelues, duhet të kujdeset të përthellojë sinjalizimet të cilat rezultojnë të lidhura me fenomene organizative të llojit mafioz; ndërsa në rastet e tjera procedon vetëm Skuadra Speciale e Policisë Valutore pjesëmarrësit e së cilës, në kryerjen e funksionit të tyre, ushtrojnë edhe fuqitë që u jep normativa në fushë valutore (nenet 25, 26 dhe 28 të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 148/1988), shprehimisht të rimarra në pikën e mëparshme 2, pika c. (3). Këto fuqi, për efekt të modifikimeve të sjella nga dekreti legjislativ nr. 153/1997, shtrihen edhe tek oficerët e policisë tatimore të Skuadrave rajonale dhe provinciale të Policisë Tatimore, të cilëve Skuadra Speciale mund t'u besojë kryerjen e detyrave të parashikuara me ligj.

Veprimtaria e përthellimit e kryer nga këto Skuadra, e zhvilluar paraprakisht në një mjedis të policisë administrative, përdor metodologjitë e përshkruara në pikën 2 pika a (3) dhe ka si qëllim të vërtetojë se operacioni financiar i sinjalizuar në këtë rast përbën krim sipas neneve 648 bis dhe 648 ter K.P.. Pasi përftohet një tablo të dhënash që përbën atë që quhet *notitia criminis*, hetimi do të vazhdojë nën drejtimin e A.GJ. kompetent, duke përdorur edhe të gjitha mjetet hetimore të parashikuara nga kodi i procedurës penale dhe ligjet e posaçme.

Prokurori Kombëtar i Antimafies, ku është e nevojshme, do të ushtrojë koordinimin e parashikuar për hetimet në lidhje me krimin e organizuar.

Krijimi i Bashkimit Monetar Evropian mund të ketë ndërlikime të ndryshme mbi dinamikën e flukseve monetare dhe financiare të lidhura me zhvillimin e veprimtarive ekonomike të jashtëligjshme dhe kriminale. Këto ndërlikime ngrenë probleme të reja të politikës ekonomike, para se të jenë probleme të politikës kriminale.

Drejtoria Kombëtare e Antimafies ka nisur, me Universitetin Ekonomik “Bocconi” të Milanos, një hulumtim mbi efektet e pritshme që hyrja në fuqi e monedhës së vetme – qoftë në fazën e kthimit të monedhave kombëtare po ashtu edhe në atë të mëvonshme të qarkullimit komunitar dhe

extrakomunitar të euros – do të ketë mbi strategjitë kriminale të pastrimit të parave, duke mbajtur parasysh edhe përqindjen e ndryshme të vigjilencës ekzistuese, megjithë njehsimin e standardeve komunitare, mes njëmbëdhjetë Vendeve të BEM, në veçanti për shkak të dallimeve të disiplinës në fushë fiskale dhe të sekretit bankar.

Duket i nevojshëm zhvillimi i modeleve të analizës që të lejojnë gjetjen e kushteve në të cilat – në sektorin monetar, bankar, financiar dhe informatik – BEM do mund të rriste mundësitë e pastrimit të parave dhe pra aftësitë e organizatave kriminale për të ndotur tregjet dhe ekonominë e ligjshme.

Një nga efektet që duhet të prodhojë BEM, përmes kanaleve të ndryshme, është reduktimi i kostove të transaksioneve, që përbëjnë një pengesë (edhe pse relative) për zhvillimin e ekonomisë së jashtëligjshme. Nëse reduktimi i kostove të transaksioneve duhet uruar pra për zhvillimin e ekonomisë së ligjshme, duhet të kemi parasysh se ky, në mungesë të masave të përshtatshme, do të favorizonte edhe ekonominë e jashtëligjshme.

Nga kjo rrjedh për Shtetet anëtare një rend i dyfishtë i objektivave të domosdoshëm:

a) të gjenden ato kanale të posaçme transmetimi, përkatësisht nga njëra anë monetare, nga ana tjetër bankare dhe financiare, që me BEM do mund të reduktonin kostot e transaksioneve për ekonominë e jashtëligjshme;

b) të vihen në jetë ndërhyrjet e duhura të rregullimit dhe vigjilencës mbi sistemin e pagesave, nga njëra anë, dhe mbi industrinë bankare nga ana tjetër, për të gjetur zgjidhje të barazpeshuara në dialektikën mes mbrojtjes së sistemit nga ndotja e ekonomisë kriminale dhe shtysës ndaj frytshmërisë dhe zhvillimit të tregjeve të ligjshme.

Në rrafshin monetar, Euro do të bëhet një monedhë e rëndësishme rezervë në shkëmbimet ndërkombëtare, si të ligjshme ashtu edhe të jashtëligjshme.

Ekziston rreziku konkret që, pasi të jenë zhdukur monedhat kombëtare, çelja e hapësirës monetare të përbashkët të bëhet ajo vetë një shumëfishues i rasteve të riciklimit. Afërmendsh, do të jetë qarkullimi extrakomunitar i Euros që do tërheqë më tepër ata që pastrojnë paratë, edhe pse tani për tani nuk parashikohet që Euro të bëhet konkurrues i dollarit apo jenit, apo nëse do arrijë deri aty sa t'i zëvendësojë këto monedha në tregun e jashtëligjshëm.

Rreth pasojave që mund të rrjedhin në rastin në të cilin Euro mund të bëhet monedha që do vendosë rregullin në shkëmbimin me qëllim pastrimin e parave të krijuara nga tregjet e jashtëligjshme, analistët parashikojnë që:

- sa më energjike do jenë mjetet normative në kundërshtim me veprimtaritë e jashtëligjshme dhe kriminale që prodhojnë të ardhura, aq më shumë do të rritet presioni në tregjet në të cilat shkëmbehen veprimtaritë e mirëbesimit (monetare, bankare dhe financiare);

- Sa më shumë që teknikat e pastrimit të parave do të parashikojnë përdorim të parave në dorë, aq më shumë ky presion do të ketë të bëjë me kërkesën për Euro, sidomos të prerjeve të mëdha.

Në prani të monedhës së vetme, dhe të tregjeve bankare e financiare gjithnjë e më të integruara, nuk duket megjithatë se mund të mbivlerësohet efikasiteti i ndërhyrjeve kundër pastrimit të parave, me natyrë monetare, si kufizimet e emetimit të Euros në prerje të mëdha. Kërkesa e riciklimit thjesht mund të interesohet nga një efekt i zëvendësimit – që nga faza e *change over* e monedhave kombëtare – duke parapëlqyer në këtë mënyrë teknika të demaskimit dhe pastrimit të konsideruara më të sigurta, përmes kanaleve bankare dhe financiare.

Në “Udhëzime operative për gjetjen e operacioneve të dyshimta”, të përditësuar kohët e fundit nga Guvernatori i Bankës së Italisë, mes treguesve të anomalisë në lidhje me veprimet me para në dorë, tregohet këmbimi i kartëmonedhave me prerje të ndryshme dhe/ose të valutave të tjera, sidomos nëse kryhet pa kaluar përmes llogarisë rrjedhëse, në veçanti:

- këmbimi i kartëmonedhave në shuma domethënëse në një herë të vetme ose në një periudhë të shkurtër kohe, sidomos nëse prerja është e madhe;

Këmbimi i kartëmonedhave në lireta apo në valutë komunitare me valutë të Vendeve jo komunitare kryer në periudhën e tranzicionit të futjes së euros, sidomos nëse bëhet shpesh dhe për shuma domethënëse;

- këmbimi i kartëmonedhave në lireta ose valutë komunitare në Euro i kryer në periudhën e tranzicionit të futjes së euros, sidomos nëse bëhet shpesh dhe për shuma domethënëse;

§ 8.3.3. *Koordinimi hetimor.*

Centralizimi i raportimeve të operacioneve të dyshimta pranë Zyrës Italiane të Këmbimeve ka sjellë sigurisht përmirësime për sa i përket bashkëpunimit, si mes ndërmjetësve sinjalizues dhe organit pritës të sinjalizimeve – tani jo më një organ policie por një organ financiar – ashtu edhe mes këtij të fundit dhe dy organizmave hetimorë (Dia dhe Skuadra e Policisë Valutore) të vënë në krye të përthellimeve.

Në fakt me bindjen se pastrimi i parave është para së gjithash një problem financiar, dekretligji vo nr. 153/1997 ka impostuar nga e para sistemin duke dalluar përbërësen e analizës financiare nga përbërësja hetimore. (Është menduar se me një përqsje aseptike të analizës financiare është e mundur të gjenden rrugë për të mbërritur në zbulimin e disa formave të pastrimit të parave që hetimi hulumtues tradicional nuk mund t’i nxjerrë në pah).

Pastaj, për sa i përket sinjalizimeve që rezultojnë se kanë të bëjnë me fenomene të organizuara të llojit mafioz, për të cilat është vendosur me ligj detyrimi për organet hetimore që të informojnë Prokurorin Kombëtar Antimafie – i ngarkuar me koordinimin për sa i përket krimit të organizuar – pa dyshim, falë procedurës së parashikuar nga “protokolli i marrëveshjes” tashmi cituar, Drejtoria Investigative Antimafie – edhe falë përgjegjësive të posaçme që ligji i vesh në këtë fushë – merr kështu një rol të dorës së parë në krahasim me Skuadrën Valutore.

Në fakt, pas përcjelljes së njëkohshme të sinjalizimeve nga ana e Zyrës Italiane të Këmbimeve të dy organizmave hetimorë, DIA vepron në mënyrë autonome, duke komunikuar qëllimin për të proceduar në përthellimin e sinjalizimeve që i interesojnë. Në këtë rast Skuadra Valutore nuk ndërmerr ndonjë veprim të mëtëjshëm dhe kufizohet me informimin e Skuadrës p.t. kompetente për territorin pasi i intereson për qëllime institucionale.

Nëse ndodh që në llogari të subjekteve të sinjalizuara ka një veprimtari në vazhdim të policisë gjyqësore nga ana e Skuadrës Valutore ose nga ana e ndonjë komande të Rojës së Financës, përthellimet këta i bëjnë në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë Antimafie të Rretheve që janë kompetente për territorin.

ALBERTO CISTERNA
*Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafie*

Romë, Tetor 2007

2.9. *Bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar: kërkimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi.*

§ 1. *Nuk është e lehtë të sjellësh një përmbledhje mbi temën e trajtesës sime.*

Bëhet fjalë për një çështje jashtëzakonisht komplekse dhe të gjerë që, për shkak të ndërëgjegjësimit për aftësinë destabilizuese të fenomeneve kriminale transnacionale, sidomos në vitet e fundit ka qenë teatër zhvillimesh të vrullshme dhe, hera herës, përshpejtimesh absolutisht të papritura nëse shihen në dritën e perspektivës tradicionale të mbrojtjes më fanatike të prerogativave të sovranitetit kombëtar në fushën e drejtësisë penale dhe ndonjëherë të largësisë së madhe të sistemeve dhe kulturave kombëtare.

Secili nga kapitujt e mundshëm në të cilin duhet shtrirë një pasqyrim i pastër i problemeve, do të meritonte një trajtesë specifike.

Objekti i trajtesës sonë ka në vetvete mundësi për të folur gjatë për çdonjërin nga elementët që e përbëjnë atë, jo më pak në numër se gjymtyrët e shumta të atij anëtarit të famshëm të grupit të Katër Fantastikëve vetitë e jashtëzakonshme së të cilit çdo i apasionuar i kësaj historie i kujton fare mirë.

Duke mos pasur mundësi të rrezikojmë të zgjatemi, në kundërshtim me nevojën për të sjellë një prezantim të përmbledhur dhe organik të sistemit, mendoj se do ish më e udhës që në këtë takim të mjaftohesha duke sjellë disa pika themelore për analizën.

E para ndër to ka një ngarkesë të pastër objektive, që sidoqoftë nuk e bën më pak të rëndësishme.

Në fakt, të mbash parasysh që përtej çdo faktori vështirësie, e drejta ndërkombëtare penale karakterizohet nga aftësia për t'u dhënë shtysë proceseve të përafritimit ligjor dhe përputhjes së politikave kombëtare absolutisht të fortë dhe të qëndrueshme në kohë ndaj çdo përpjekjeje për zhvleftësim nihilist.

Madje edhe të gjithë ata që, nga njëra anë apo nga tjetra, flasin e mendojnë se nuk mund të shmangët një përplasje të qytetërimeve mes Perëndimit dhe botës islamike, nuk mund të mos mendojnë që e drejta ndërkombëtare penale vazhdon të luajë një rol të jashtëzakonshëm dialogues

në marrëdhëniet me Shtetet me mazhorancë myslimane, që duket qartë jo vetëm në marrëdhëniet me ata që, më vete (si në rastin e Turqisë) apo për shkak të ndikimit të ndikimeve të mëparshme koloniale kanë ndërmarrë dhe forcuar procese shekullorizimi të institucioneve politike dhe gjyqësore, por edhe në marrëdhëniet me ta, ku jemi ende larg përfytyrimit të një dallimi mes të drejtës dhe fesë.

Në të vërtetë edhe këta të fundit tërhiqen në vorbullën e proceseve ligjore të ndërmarrë nga një lloj ligji të ri fryt i shtrirjes së konventave ndërkombëtare humanitare dhe i politikave ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe zhvillimin.

Natyrisht, druaj se nuk do na mjaftonte koha dhe mundësia për të thelluar më tej këto mendime që kanë si pikënisje konstatimin objektiv që asnjë nga vendet myslimane apo me mazhorancë myslimane nuk është përpjekur as të mos pranojë të drejtën ndërkombëtare publike, duke menduar të vendosin me forcë marrëdhëniet e tyre me Shtetet e tjera mbi parimet fetare të *Sharia-s* në vend të përshtatjes progresive të institucioneve të veta ndaj evolucionit së të drejtës ndërkombëtare.

Por ndoshta na volet të sjellim një shembull.

Sot një Shtet si republika islamike e Iranit, që ka aderuar si në një konventë të rëndësishme si ajo e Vjenës, e vitit 1998 mbi luftën kundër trafikut të lëndëve narkotike, ashtu dhe në një tjetër konventë të mëpasshme të OKB-së mbi krimin e organizuar transnacional, përshkohet nga procese të rishikimit dhe përshtatjes së legjislacioneve që deri pak kohë më parë veç mund të përfytyrohej.

Tashmë diskutohet hapur, për shembull, për mundësinë e futjes së normave në lidhje me operacionet e infiltrimit, absolutisht të ngjashme, për analogjinë e metodës kulturore dhe të zgjidhjeve pozitive, me rregullimet në fuqi në vendet evropiane, duke parashikuar shprehimisht mundësinë e operacioneve në nivel ndërkufitar dhe bashkëpunim e drejtpërdrejtë me autoritetet e policisë dhe ato gjyqësore të vendeve të tjera.

Traktatet dypalëshe të ndihmës së ndërsjellë juridike dhe të ekstradimit janë lidhur edhe me vendet jo myslimane, duke kapërcyer pengesën që vjen nga parimi i *sharias* për parëndësinë e juridiksioneve që nuk kanë një legjitimitet fetar.

Problemi i identifikimit të bazave të pranueshme ligjore të shkëmbimit të shërbimeve tipike e të sistemit të ndihmës së ndërsjellë, i penguar nga mospranimi tradicional për t'u dhënë legjitimitet veprimeve dhe kërkesave të juridiksioneve që nuk pranohen nga *sharia*, ka gjetur zgjidhje duke u

mbështetur në parimin e nevojës të Kuranit, e në vetvete nuk është shumë i ndryshëm nga parimi e realizmit politik që qëndron në themel së të drejtës ndërkombëtare, të përgjithshme dhe të konventave.

Por le t'i kthehemi një perspektive analitike më të zakonitë se ajo që sjellin përshtypjet e një përvoje kaq të veçantë dhe të respektojmë angazhimin e marrë përsipër paraprakisht për të kufizuar fushën e analizës dhe krahasimit të mundshëm brenda caqesh të arsyeshme.

Është e udhës të përcaktojmë pra një metodë rikonjicioni të problemeve që është po aq e nevojshme sa dhe të qenit në njëfarë mënyre arbitrare në gjykimin tonë.

Për këtë qëllim janë të nevojshëm edhe disa elementë përshkrues të përgjithshëm.

Para së gjithash, çështja e paracaktuar (“bashkëpunimi gjyqësor”) e përjashton automatikisht nga fushëveshtrimi ynë sektorin e bashkëpunimit të policisë.

Kjo është diçka e mirë dhe me vend për të brendashkruar trajtesën tonë, por duke bërë disa saktësime:

1) Në përgjithësi, dallimi mes bashkëpunimit të policisë dhe bashkëpunimit gjyqësor nuk është i qartë në të gjitha vendet, e do të mjaftonte të mendonim që në jo pak sisteme të *common law* organet e policisë luajnë në fazën e hetimeve paraprake të njëjtin rol që në pjesën më të madhe të vendeve të *civil law* luhet nga autoriteti gjyqësor;

2) kufijtë mes njërës dhe tjetrit lloj bashkëpunimi bëhen të paqartë nga integrimi gjithnjë e më i madh i rregullave së të drejtës ndërkombëtare në lidhje me veprimtari që, ndonëse e kanë zanafillën e tyre në sistemin e bashkëpunimit të policisë, tashmë tërhiqen në sferën e zbatimit të traktateve të ndihmës gjyqësore, sidomos për shkak të nevojës për të forcuar më tej garancitë e të drejtave të njeriut që lidhen ngushtë me zbatimin e tyre: le të kujtojmë këtu rregullimin e veprimtarive të infiltrimit dhe të dorëzimeve të mbikëqyrura që për bashkëpunimin praktik të tyre kërkojnë një veprimtari të përbashkët të autoriteteve gjyqësore (rasti i Turqisë);

3) mes dy sistemeve ekzistojnë lidhje të ngushta, jo vetëm sepse një bashkëpunim i mirë mes policisë është shenjë e zhvillimit më të mirë të ndihmës gjyqësore, por edhe sepse dy kanalet mund të mbivendosen dhe madje të shkëmbehen mes tyre, duke arritur të merren njësoj informacionet përmes njërës apo tjetrit kanal, ndërkohë që përvoja na tregon se përdorimi i

tepruar i mjetit të letërporosisë mund të zëvendësohet më thjesht nga krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë mes forcave të policisë;

4) së fundi, shpesh, njëra apo tjetra formë e bashkëpunimit gjejnë rregullim brenda po këtyre burimeve së të drejtës ndërkombëtare (p.sh. Konventa OKB 2000, Konventa mbi luftën kundër pastrimit të parave, 1990, por duhet të kujtojmë edhe zgjedhjen e trajtimit të përbashkët që sjell Traktati Themelues në Kreun IV të Titullit VI të tij, kushtuar politikave të Bashkimit Evropian që kanë për qëllim krijimin e një hapësire të drejtësisë, lirisë dhe sigurisë); kjo në vetvete të jep idenë e një sistemi unitar, të përbashkët dhe të faktit që zgjedhja ime më shërben të mbaj jashtë fushëvestrimit time sektorin e bashkëpunimit të policisë kundrejt nevojës së qartë për t'u përqendruar në objektivat e ndërhyrjes sime.

Në radhë të dytë, nuk do të flasim për mjete ndërkombëtare që kanë të bëjnë në mënyrë specifike me fushën e kriminologjisë, të ndryshme nga sa përshkruhet në përkufizimin tradicional të krimit të organizuar, por marrja në konsideratë e tyre do të na shërbente për shkak të lidhjeve të ngushta mes fenomeneve kriminale në fjalë: nga konventat në lidhje me terrorizmin dhe ato në lidhje me korrupsionin (instrument kryesor i kriminalitetit të organizuar, siç shprehet edhe Konventa OKB e 12 dhjetorit 2000, që parashikon në nenin 8 një detyrim të përgjithshëm të përndjekjes së praktikave të korrupsionit).

Lipset të mbajmë parasysh në mënyrë sistematike që një pasqyrim realist i sistemit duhet të mos lërë mënjanë jo vetëm të dhënat formale së të drejtës ndërkombëtare, por edhe ato përvoja që, nga ana tjetër, kanë luajtur historikisht një rol themelor në proceset e krijimit të legjislacionit, pasi nuk janë të pakta risitë pozitive që vijnë si rezultat i njohjes së praktikave që po përdoren aktualisht dhe të mundësisë që një rregullim formal i tyre do të shërbente për sigurimin e stabilitetit, përhapjen e mëtejshme të tyre dhe për një zbatim të njehsuar.

Marrja parasysh e shembujve të bashkëpunimit është sidoqoftë shpesh një aspekt thelbësor për përshkrimin e sistemit të bashkëpunimit.

Për shembull, konkretisht, analiza e këtyre shembujve na jep gjithashtu mundësi të vërejmë që klauzola e dënueshmërisë së dyfishtë që rëndon ende formalisht në ndihmën juridike evropiane dhe vlerësimi i të cilës priret natyrisht të bëhet më i rreptë pasi bëhet fjalë për masa shtrënguese, tashmë prej kohësh ka një rëndësi të kufizuar në marrëdhëniet mes shteteve anëtare të B.E.-së, duke konstatuar se shtetet anëtare ka kohë që nuk e zbatojnë atë në rastet e kërkesave të paraqitura nga shtete të tjera anëtare, ndonëse në

lidhje me kontrole dhe sekuestri, për kriterin e padeklaruar, por të dallueshëm qartë që “kontrollat dhe sekuestrimet janë thelbësore në luftën kundër krimit të organizuar”.

Le të mendojmë për instrumentin e shkëmbimit spontan të informacioneve (rëndësia e të cilit vlerësohet më shumë në dritën e rregullave tona të brendshme në lidhje me përdorshmërinë e akteve të marra pas një letërporosie nëse mbajmë parasysh se është përjashtuar zbatueshmëria e sanksioneve siç në nenin 729 të k.p.p. para përfundimeve të provës të marra në aktet e procedimit, në vijim të përcjelljes spontane të kopjeve të akteve të një procedure që po realizohet me një vend tjetër, pas një kërkesë spontane të bërë nga autoriteti gjyqësor i huaj): ky instrument, që rezulton nga kodifikimi i praktikave në fuqi, sot, ndonëse vazhdon të jetë formalisht në fuqi, nga këndvështrimi i Italisë, vetëm në kuadrin e Konventës mbi luftën kundër pastrimit të parave, të vitit 1990 dhe në marrëdhëniet me Zvicrën në bazë të Marrëveshjes dypalëshe të vitit 1998.

Por le t'i kthehemi sërish të parit ndër rathët bashkëqendrorë që përcaktojnë bashkëpunimin e mundshëm në luftën kundër krimit të organizuar: rrethi i përcaktuar nga rregullat e bashkëpunimit të përpunuara brenda Kornizës së Bashkimit Evropian.

Natyrisht, rëndësia e në perspektive të tillë reflektimi është edhe më e dukshme në çastin historik në të cilin përcaktohen profilet kushtetuese të procesit të integritit evropian.

Ndoshta breza të tërë studiuesish së të drejtës kushtetuese do të vazhdojnë të angazhohen në përpjekjen për të përcaktuar natyrën dhe efektet e një procesi kushtetues që sinjerisht duket se s'mund të mjaftohet me skemat e çdo përvoje të mëparshme historike dhe juridike.

Duke ua lënë ekspertëve të kësaj fushe të merren me këtë, më duket e mjaftueshme për momentin të mjaftohemi duke pranuar se vetë ideja e një Kushtetute evropiane sanksionon përfundimisht nevojën për t'i dhënë jetë një sferë të përbashkët të veprimit publik përreth të cilës duhet organizuar gërshetimi i funksioneve komunitare dhe i kompetencave që i mbeten shtetit, e nevojshme për t'u dhënë përgjigje problemeve të përbashkëta, për të cilët, tashmë prej kohësh Shtetet, nuk mund të japin më përgjigje më vete.

Në fushën politike dhe gjeografike të prekur drejtpërsëdrejti nga ajo që po ndodh në laboratorin më interesant institucional të botës, realiteti po kërkon me forcë jo vetëm dhe jo aq një mënyrë të ndryshme të funksionimit të organizmave ndërkombëtarë ekzistues apo një zgjerim të hapësirave të bashkëpunimit juridik mes çdo Shteti, sesa lindjen e organizatave të reja

politike, të përcaktuara nga paradoksi i dukshëm për të cilin nuk është territori, pra hapësira ajo që përcakton përmbajtjen e të drejtës, por është e drejta ajo që e përcakton politikisht territorin, edhe në lidhje me tema si ajo e drejtësisë penale dhe e sigurisë që janë karakterizuar gjithnjë nga një mbrojtje fanatike e prerogativave kombëtare.

Lidhja e fundit mes hapësirës dhe të drejtës në themel të idesë tradicionale të territorit si hapësirë zotërimi e vetme e Shteteve-komb, nga ana tjetër, është një krizë për shkak të proceseve të globalizimit – në aspektet e shumta të tij ekonomike, sociale, teknologjike dhe politike – dhe, për sa na takon drejtpërsëdrejti, nga procese të grupimit në nivel transnacional të kriminalitetit që e bëjnë të dukshme krizën e aftësisë së veprimtarisë parandaluese dhe ndëshkuese të çdo Shteti.

Faktet tregojnë se vetë ideja e bashkëpunimit horizontal mes shteteve është shumë e pamjaftueshme kundrejt rëndësisë dhe urgjencës që ngrenë sfidat që sjell dimensionin transnacional i kërcënimit të sigurisë dhe lirisë së shtetasve.

Nëse tashmë është i qartë vjetrimi i instrumenteve të bashkëpunimit tradicional (letërporosi, ekstradim), deri dhe format më të reja dhe moderne të bashkëpunimit që mbështeten në parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore do të rezultojnë shumë shpejt të pamjaftueshme.

Shumë shpejt do të dalë e qartë nevoja për të kaluar në forma të guximshme të bashkëpunimit vertikal që do të shpien në braktisjen e shtyllave të mirëfillta të çdo sistemi kombëtar.

Vetë parashikimi, ndonëse i kujdesshëm, që përmban projekt Kushtetuta evropiane lidhur me mundësinë e krijimit me ligj të një zyre të vetme evropiane të prokurorisë shërben për të treguar qartë se nga një moment i caktuar e më tej i procesit të ndërtimit evropian, nuk do të jetë më vetëm përafrimi i mundimshëm i ligjeve kombëtare ai që do t'i prijë realizimit të idesë xhiskardiane të hapësirës gjyqësore evropiane, por do të jetë integrimi i strukturave dhe i aparateve ai që do të vendosë rregulla të reja juridike që kanë prirje të jenë të njesuara, edhe të nivelit e rëndësisë kushtetuese, në çdo sistem (ashtu siç ka ndodhur nga ana tjetër në sektorët që i janë nënshtruar kahera rregullimit komunitar).

Natyrisht, vetëdijes së skenarëve që për shumë janë ende larg duhet t'i gjegjet një vlerësim i matur dhe realist i gjendjes aktuale dhe i perspektivave më konkrete dhe të menjëhershme të zhvillimit.

Do të propozoja të niseshim nga një datë e saktë: viti 1997, vit i adoptimit të Planit të veprimit kundër krimit të organizuar (akt i Këshillit të Evropës i dt. 28 prill 1997).

Me këtë zgjedhje nuk dua aspak të zbeh rëndësinë e zërave pozitivë, që në të vërtetë janë të shumta në numër, të bilancit të “shtyllës së tretë” të Mastridit¹⁶².

Besoj megjithatë që është objektiv dhe i përbashkët gjykimi i përhapur sipas të cilit vetëm me Planin e veprimit të përbashkët të vitit 1997 u realizua një kthesë e mirëfilltë në politikat evropiane të luftës kundër krimit të organizuar, duke gjetur shprehje nevoja, deri në atë kohë e mbytur, për të përcaktuar një strategji gjithëpërfshirëse, që do të shërbente si kornizë, por do të thosha edhe si bashkuese, e instrumenteve të ndryshëm të adoptuar dhe, njëkohësisht, të atyre që do të vinin më tej.

Vetëm gjashtë vjet më vonë dhe përpara rezultateve të arritura, duket gati e çuditshme të kujtojmë se ajo përpjekje e parë e përpunimit strategjik të Bashkimit Evropian u shpreh me një instrument që, ashtu siç me vend pamë, ishte një “jo instrument” nga pikëpamja juridike.

Plani i veprimit i përbashkët nuk bënte pjesë në asnjë prej kategorive të akteve të përnjimendta të parashikuara në atë kohë nga neni K3 i Traktatit (konventa, veprime të përbashkëta dhe pozicione të përbashkëta) dhe as në tipologjinë e gjerë të akteve të cilave u është referuar gjatë gjithë kohës Këshilli kur është gjendur në vështirësi politike për të adoptuar instrumente detyrues.

Megjithatë, Plani i veprimit i përbashkët i vitit 1997 e fitoi ligjshmërinë e tij në bazë të autorizimit zbatues që Këshilli i Evropës i dha Këshillit të Ministrave dhe në saje të besueshmërisë për rrjedhojë të angazhimit, mirëfilltazi politik, për të forcuar kufijtë e ngushtë të ofruar nga neni i vjetër K1 i Traktatit lidhur me mundësinë e bashkëpunimit të Shteteve anëtare në fushën penale.

Edhe pse një rikonjicion i shpejtë dhe përmbledhës i përmbajtjes thelbësore të Planit të vitit 1997 shërben për të vënë në dukje se të githa hapat e bërë nga ajo kohë e më tutje në kuadrin evropian lidhur me rrugën e një bashkëpunimi që frymëzohet në një parim efektiviteti apo vlefshmërie

¹⁶² E kam fjalën për Konventën themeluese të Europol-it dhe protokollin përkatës mbi kompetencën e Gjykatës së Drejtësisë, për Konventën mbi mbrojtjen e interesave financiarë të Komuniteteve evropiane dhe protokolleve përkatëse, për Konventat në fushën e doganave.

gjenin një parashikim të parë apo të mëtejshëm në këtë dokument, që ish në radhë të parë politik e më pas juridik.

Për këtë qëllim do të mjaftonte të përmendnim këtu:

- 1) krijimin e Grupit shumëdisiplinor dhe veprimtarinë e tij në kuadrin e procedurave të vlerësimit të ndërsjellë të masave zbatuese të marra në planin kombëtar të angazhimeve të marra në nivel ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar;
- 2) krijimin e rrjetit gjyqësor evropian;
- 3) Konventën e re për ndihmën juridike në fushën penale të dt. 29 maj 2000;
- 4) Rekomandimet dhe veprimet e përbashkëta në lidhje me politikën në fushën e luftës kundër korrupsionit apo pastrimit të parave dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi apo rekomandimi i “shembujve të përvojës së mirë” të bashkëpunimit gjyqësor;
- 5) E jo të fundit për nga rëndësia, për shfaqjen e rolit programues të bashkimit Evropian si i tillë në përcaktimin e politikave të bashkëpunimit në kuadrin extra-evropian, me Shtetet e tjera, organizata dhe organizma ndërkombëtarë të përfshirë në luftën kundër krimit të organizuar: prania e Bashkimit evropian në tryezën e negociatave të përgatitur nga Kombet e Bashkuara në dritën e Konventës së Palermos të datës 12 dhjetor 2000 mbi krimin e organizuar transnacional përbën një zhvillim koherent për të, njësoj si më e fundit Marrëveshje e Bashkimit **Evropian** me Shtetet e **Bashkuara** të Amerikës (Këshilli i BE i dt. 6 qershor 2003) mbi ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë juridike

Vetë lindja e Eurojust-it bën pjesë në këtë perspektivë zhvillimi të bashkëpunimit evropian.

Por le t'i kthehemi Planit të veprimit të vitit 1997, me qëllim që të përpiqemi të shprehim shkurtimisht limitet më të dukshme.

Në fakt, pas adoptimit të një linje të përbashkët strategjike, vazhdoi të ekzistonte vështirësia për të kapërcyer limitet që kanë të bëjnë me dobësinë tradicionale të instrumenteve evropiane të përdorshëm, në radhë të parë për shkak të vonesave në veprimin e përshtatjes së sistemeve të veçantë kombëtarë.

Mjafton të mendojnë për fatin e Konventës mbi ndihmën juridike, të majit 2000: deri më sot, jo të gjitha shtetet e kanë ratifikuar, e ndër to edhe

Italia, që duket sikur tani kërkon të grupojë në këtë fushë shembuj negativë si kurrë më parë; bëhet fjalë për vonesa të papajtueshme me nevojat e koherencës dhe rregullsisë në politikat e bashkëpunimit kundër krimit dhe burim i vështirësive të mëdha praktike në bashkëpunimin mes Shteteve: le të sjellim dy shembuj të rëndësishëm:

- 1) mungesa e gjatë në kohë e një rregullimi zbatues të normave në fushën e skuadrave të përbashkëta hetimore, pavarësisht nga një vendim kuadër i posaçëm i datës 13 qershor 2002 vendoste adoptimin brenda datës 1^o janar 2003;
- 2) mungesa e një rregullimi zbatues i gjithë rregullave komplekse të përcaktuara për kryerjen e përgjimeve të bisedave telefonike apo telematike në Shtete të tjera apo kapja e të cilave do të përfshinte sidoqoftë territorin e Shteteve të tjera: disnivelet ligjore të shkaktuara nga mosadoptimi i rregullave të diktuar nga konventa e majit 2000 rrezikojnë të krijojnë një pengesë serioze për kryerjen e hetimeve transnacionale: krs. dokumentin La Greca dhe artikullin Secchi.

Të njëjtin fat ka pasur deri tani Protokollin shtesë i vitit 2001, ndërkohë që urgjenca dhe nevoja për ta pasur, ndonëse në nivel abstrakt, shihen si thelbësore për hetimet në fushën financiare. Jo vetëm nuk diskutohet ratifikimi i instrumentit, por jemi ende larg nga bërja efektive për qëllime të brendshme të ligjit të vitit 1991 që parashikon krijimin e regjistrimit të llogarive bankare që protokollin i konsideron si parakusht të qenësishëm për një bashkëpunim kundër krimit.

Por ndërgjegjësimi se ekzistojnë kufizime apo limite të mëdha për një zhvillim të masave evropiane që në fazën e vet të zbatimit të praktikë i besohen nismës ligjore të çdo Shteti, nuk i heq asgjë rëndësisë së rrugës metodologjike të eksperimentuar për herë të parë në vitin 1997;

- 1) analizë e përgjithshme e faktorëve të riskut që lidhen me veprimtarinë e grupeve kriminale të organizuara në mënyrë të qëndrueshme;
- 2) përkufizimin e objektivave parësorë;
- 3) tregimi i procedurave të përshtatshme për realizimin e tyre;
- 4) përcaktim i afateve për realizimin e objektivave;
- 5) monitorim i vazhdueshëm i proceseve të zbatimit.

Rruga e ndërmarrë në atë kohë dha fryte plotësisht pozitive, gjeti konfirmim dhe një organizim më të mirë në punën e GDM, përmes dokumentit të mëvonshëm të quajtur me guxim *Strategjia e Bashkimit Evropian për fillimin e mijëvjeçarit të ri për parandalimin dhe kontrollin e kriminalitetit të organizuar*, me të cilin u kërkuar integrimi i metodës së Planit të parë të veprimit përmes udhëzimeve më të qarta të përparësive të objektivave që duhen arritur dhe të ndarjes së përgjegjësive politike që kanë të bëjnë me moszbatimin apo zbatimin me vonesë të tij.

Leximi i tekstit të botuar më pas në Raportin e ri (2 qershor 2003) mbi gjendjen e zbatimit të 39 Rekomandimeve në të cilat shtrihet *Strategjia e Bashkimit Evropian për parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar në fillim të Mijëvjeçarit të Ri*, është jashtëzakonisht i dobishëm për të përcaktuar, hap pas hapi, sektor për sektor, përparimet e shënuara, pengesat që ngrihen para zhvillimeve të reja, zgjidhjeve të mundshme për probleme ende të pazgjidhura.

Kjo gjë më lehtëson nga kryerja e një analize të hollësishme të kësaj çështjeje, por ndoshta ka vend për disa mendime përmbledhëse.

Përcaktimi i objektivave të qartë dhe të përbashkët në kuadrin e një strategjie globale të luftës kundër krimit të organizuar, me shtrirje të gjerë, na vjen në ndihmë për të përcaktuar me shumë qartësi kufizimet më të rënda të politikave evropiane të luftës kundër kriminalitetit të organizuar.

Këto kufizime mund t'i shquajmë shumë qartë nëse mbajmë parasysh dy objektiva thelbësorë të politikave evropiane që, me pak fjalë, përcaktohen në përfundimin nr.6 të Këshillit të Evropës në Tamperrë, më dt. 15 e 16 tetor 1999: *të garantojë që kriminelët të mos kenë mundësi të fshihen e as të fshihin të ardhurat nga krimet e tyre brenda Bashkimit*.

Jo rastësisht, këtyre dy objektivave u gjegjen para së gjithash dy hapa të rëndësishëm të bërë në rrugën e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore.

Do të flasim më tej për urdhrin e arrestit, si për aktualitetin dhe delikatesën e veçantë të skenarit në cilin po maturohet përshtatja e legjislacionit tonë në një vendim tashmë të marrë në gjitha Shtetet anëtare të Bashkimit që kanë aderuar në Vendimin kuadër, duke i paraprirë menjëherë në mënyrë të tillë që teksti ligjor duket se frymëzohet në arsyetime që nuk pajtohen me kuptimin e përkatësisë në një komunitet së të drejtës siç është Bashkimi Evropian.

Objektivit të dytë themelor të politikave evropiane, që e treguam përmbledhtazi me shprehjen që përmban përfundimi nr.6, i lartpërmendur, i

takimit të Tamperrës (*të garantojë që kriminelët të mos kenë mundësi të fshihen e as të fshehin të ardhurat nga krimet e tyre brenda Bashkimit*) i gjegjet mundësia për të gjetur konfirmim sa thamë më lart lidhur me riskun e enfatizimit të përparimeve të shënuara nga bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në përgjithësi, përdorimi i sekuestrimit dhe i konfiskimit në marrëdhëniet juridiksionale përbën një kriter kyç për matjen e vlefshmërisë së bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër fenomeneve kriminale që gjithnjë e më shumë priren të vendosin, fshehin, riinvestojnë dhe sidoqoftë ruajnë të ardhurat e paligjshme në juridiksione të ndryshme nga ato në të cilat krimet konsumohen dhe vërtetohen dhe që, ngrenë natyrshëm problemin e shtrirjes në nivel ndërkombëtar të zinxhirit të hallkave të kontrollit të pasurisë në varësi të veprimtarisë parandaluese e të sigurisë reale dhe hetimore.

Natyrisht, nuk ekziston asnjë dokument ndërkombëtar që nuk thekson rëndësinë strategjike të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër fenomenit të pastrimit të parave, që, i parë në këndvështrimin ekonomik, mund të quhet fare mirë si “vetë zemra e kriminalitetit të organizuar”¹⁶³.

Megjithatë, nëse krahasojmë përmasat e supozuara financiare të tregjeve kriminale¹⁶⁴ me ato të rezultateve të veprimtarisë ndëshkuese sidomos në lidhje me kërkimit, ngrirjen dhe konfiskimin përfundimtar së të ardhurave nga krimi rezultati rrezikon të jetë jo aq i kënaqshëm: ka shumë të ngjarë që në perspektivën e legjislacioneve të veçanta kombëtare, nëse shqyrtojmë bilancin e veçantë të sistemit të ndihmës gjyqësore ndërkombëtare.

Disa kohë më parë, duke dashur të kuptoja se çfarë fshihej pas formulës që përmban raporti i grupit shumëdisiplinor të krijuar pranë Komisionit evropian në përfundim të ciklit të parë të vlerësimeve të sistemeve të ndihmës gjyqësore të Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, sipas të cilit kërkesat për konfiskim ndodhin “relativisht rrallë” në sistemin e bashkëpunimit evropian, pashë se pranë Ministrisë së drejtësisë që, në periudhën mes 31 maj 1999 dhe 16 shtator 2001, ishin marrë nga Italia vetëm dy kërkesa për ekzekutim të masave të konfiskimit të nxjerra nga autoritete të huaja (në një rast, gjerman, dhe në tjetrin, zviceran) dhe ishin dërguar jashtë Italisë tre akte të ngjashme (dy drejt Zvicrës dhe një tjetër drejt Francës).

¹⁶³ Kështu, shprehimisht, në përfundimin nr.51 të takimit të Tamperrës, dt. 15 e 16 tetor 1999.

¹⁶⁴ Fondi Monetar Ndërkombëtar, për shembull, vlerëson se flukset monetare me prejardhje të paligjshme luhaten mes 590 dhe 1.500 miliardë dollarë, pra is të thuash mes 2% dhe 5% të produktit të brendshëm bruto botëror (*Financial Times*, 24 shtator 2000).

Duhet theksuar menjëherë që bëhej fjalë për të dhëna numerike pa asnjë forcë absolute provuese.

Ato ishin fryt i një kërkimi lidhur me një periudhë kohore mjaft të kufizuar dhe të përcaktuar me arbitraritet objektiv, aq sa kërkimi ka një dimension të vetin përafrimi sa të rëndësishëm aq dhe të pashmangshëm.

Megjithatë, ndonëse me këto rezerva, këto të dhëna numerike – që besoj se asgjë s'na bën të besojmë se kanë ndryshuar në një kohë të mëvonshme – flasin objektivisht qartë.

Shpjegimi i këtij bilanci zhgënjyes, por që po ta shohim mirë aspak i papritur, është shumë i mundshëm:

- 1) duke zgjedhur zgjidhjen paradoksale sipas të cilës pranojmë që realiteti procedural do të tregonte se – të paktën për sa i takon Italisë – nuk ekzistojnë realitete të rëndësishme kriminale me përmasa transnacionale apo që organizata krininale të këtij lloji nuk duan t'i zhvendosin të ardhurat e krimeve të tyre nga territori i një Shteti tjetër;
- 2) apo, duke rrezikuar gjithnjë e më pak, duke pranuar thjesht faktin që juridiksionet kombëtare kanë një aftësi jo të madhe për të zbuluar fitimet kriminale dhe pasuritë që sidoqoftë lidhen me krimin që me siguri zhvendosen përmes kufijve kombëtarë apo sidoqoftë duke ndryshuar ndërhyrjet e sigurisë në akuza të mirëfillta.

Besoj në fakt se të pranosh shpërpjestimin e dukshëm mes pasurisë dhe kompleksitetit të aparatit ligjor, edhe së të drejtës ndërkombëtare, që mund të përdoret në mënyrë abstrakte në luftën kundër pastrimit të parave dhe rezultatet e arritura, edhe në çdo vend, në veprimtarinë delikate të parandalimit dhe ndëshkimit të kapitaleve financiare të paligjshme dhe të përdorimit të tyre për qëllime të depërtimit në ekonominë e ligjshme, do të thotë të jesh realist.

Pasuria e përpunimit ligjor duket sikur nuk është në përpjestim të drejtë me dimensionin efektiv të rezultateve të arritura konkretisht.

Në këto fusha, aty ku luhet loja vendimtare në luftën kundër krimit të organizuar, jehona e lajmeve të atyre pas sukseseve zakonisht shuhet në heshtjen e zhurmshme të dështimeve të shumta.

Natyrisht, në bilancin negativ të sapo përmendur, ndikojnë fort edhe vështirësitë dhe pengesat që ende hasen në terrenin e efikasitetit të instrumenteve investigues dhe në përafrimin e sistemeve të të drejtës penale, përveç se në shpejtësinë e mekanizmave të bashkëpunimit gjyqësor.

Shumë është bërë në rrafshin ndërkombëtar dhe evropian (nga Konventa e Strasburgut, e vitit 1990 deri tek Vendimi kuadër për ngrirjen e pasurive për qëllime konfiskimi apo të provës, nga implementimi i Rekomandimeve të *Financial Action Task Force* deri në Protokollin e Parë shtesë të Konventës mbi ndihmën juridike mes Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian) dhe shumë të tjera mund dhe duhet të bëhen efektive (duke filluar nga Vendimi kuadër ende në diskutim mbi ekzekutimin e urdhrave të konfiskimit dhe nga zbatimi i Protokollit shtesë të dt. 16 tetor 2001 i destinuar të plotësojë më tej parashikimet e Konventës së re mbi ndihmën juridike pikërisht në lidhje me temat e aksesit ndaj informacioneve bankare dhe të kontrollit të veprimeve përkatëse dhe, në përgjithësi, në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimit financiar, që besoj se tani për tani nuk është ratifikuar nga asnjë prej Shteteve anëtare).

Por sidoqoftë, duket jo shumë e gjetur të mendojmë se fati i bashkëpunimit evropian dhe ndërkombëtar në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave varet vetëm nga perfeksionimi i instrumentave ligjorë me të cilët mund të pajiset Bashkimi Evropian.

Ka arsye më të thella të krizës së efikasitetit në sistemin e ndëshkimit penal të pastrimit të parave.

Lipset në veçanti të pranojmë se disponibiliteti i strukturave investiguese dhe gjyqësore të çdo Shteti për t'u angazhuar konkretisht, edhe për qëllime të drejtësisë kombëtare, në kërkimin dhe në luftën kundër pastrimit të parave, ka gabime dhe nuk meriton besim.

Nga ky këndvështrim, janë ende të mëdha pengesat kulturore dhe boshllëqet organizative që i kundërvihen përkthimit të vërtetë në praktikë të idesë që programet e hetimeve pasurore specifike, të qëllimshme dhe të lidhura me njëra-tjetrën duhet të përfaqësojnë një kusht të natyrshëm për çdo hetim të rëndësishëm në lidhje me krimin e organizuar (apo me “*criminalité grave*”, sipas formulës më të gjerë të pranuar në hyrjen e Konventës së Strasburgut, të vitit 1990).

Nëse, në vija të përgjithshme, është vendimtare nisma politike e çdo Shteti dhe e çdo Qeverie në rregullimin e veprimtarëve të monitorimit dhe mbrojtjes së transparencës së tregjeve financiare dhe sipërmarrëse, në planin e ndëshkimit, jo më pak i rëndësishëm është *pengesa (deficit)*, më shumë kulturor se organizative, që bie ndesh me bashkimin e përpjekjeve të strukturave investiguese dhe gjyqësore drejt objektivit për të orientuar hetimet dhe përgjigjen gjyqësore edhe drejt anëtarëve dhe lidhjeve të

organizatave kriminale që drejtojnë proceset e grumbullimit të kapitaleve dhe të riinvestimit të fitimeve të paligjshme.

Bëhet fjalë për një faktor thelbësor për të kuptuar vështirësitë dhe limitet e sistemit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

Por, duke kapërcyer pasojat e një shkurajimi të parë, lipset ta hedhim shikimin drejt arsyeve të vështirësive dhe perspektivave të punës që mund t'i kthejnë sidoqoftë vlerë veprimtarisë së kërkimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi.

§ 2. Evolucion i burimeve të konventave.

Në rrafshin e të drejtës së konventave ndërkombëtare, kuadri referues është më i gjerë se kurrë: nga instrumentet e parë dhe të përgjithshëm të sjellë nga Konventat evropiane të vitit 1957 (në fushën e sekuestrimeve të bëra në kohën e arrestimit për qëllime ekstradimi) dhe të vitit 1959 (në fushën e ndihmës juridike në fushën penale) kemi mbërritur dalëngadalë në krijimin e një sistemi gjithnjë e më organik e më kompleks.

Implementimi i tërësisë së instrumenteve ligjorë është zhvilluar veçanërisht si në kuadrin e bashkëpunimit rajonal që dallon për një homogjenitet më të madh politik të legjislacioneve (në radhë të parë, Bashkimi Evropian, por edhe, gjithnjë e më shumë, Këshilli i Evropës), ashtu dhe në lidhje me zona specifike kriminologjike, të përcaktuara sipas rëndësisë politike që u jepet atyre nga komuniteti ndërkombëtar (merren parasysh citimet e Konventës së Vjenës, të vitit 1998 në lidhje me trafikun e lëndëve narkotike, të Konventës së Palermos mbi krimin e organizuar transnacional, të Konventës penale mbi korrupsionin, e Këshillit të Evropës në vitin 1999, e Konventës së OSBE në vitin 1997 mbi korrupsionin dhe transaksionet tregtare ndërkombëtare).

Pra nuk është e mundur të rrekemi të risjellim përmbledhtazi gjithë përmbajtjen komplekse të gjithë fazave, të shumta e jo gjithmonë koherente, të zhvillimit të burimeve të konventave shumëpalëshe, por megjithatë, mund të jetë me interes të vërejmë zhvillimin e rregullimit së të drejtës ndërkombëtare në fushën e hetimeve ekonomike dhe të sekuestrimit të pasurive instrument apo të ardhura të krimit ka fituar ritme shumë më të shpejta në krahasim me çështjen e konfiskimit dhe, të përdorimit të fundit të pasurive të bllokuara për qëllime sigurie.

Thelbi i vështirësive për të vepruar në këtë terren kaq të vështirë qëndron në fakt nga përkufizimi i *standardit* provues të kërkuar për qëllime

të akuzës, i tillë që në burimet ndërkombëtare, përtej formulave që i ftojnë Shtetet kontraktuese të mbajnë parasysh mundësinë për ta afruar pragun provues minimal, duke e mprehtësuar peshën tradicionale provuese që rëndon mbi akuzën, kryeson konsiderata realiste e ndryshimeve legislative kombëtare¹⁶⁵.

Ndodh kështu në Konventën e Vjenës kundër trafikut të lëndëve narkotike dhe psikotrope, që ish konventa e parë që trajtoi hapur në nivel shumëpalësh çështjen se çfarë ndodh me të ardhurat dhe mjetet e krimit, çështjen se çfarë ndodh me pasuritë e sekuestruara gjente zgjidhje mjaft të kujdesshme përmes përcaktimit të kriterit, që në fund të fundit nuk sjell një risi juridike, sipas të cilit masat që synojnë konfiskimin “*përcaktohen dhe ekzekutohen në përputhje me të drejtën e brendshme të çdo Pale dhe sipas dispozitave të këtij legjislacioni*” (neni 5, § 7)¹⁶⁶, duke mos cenuar në asnjë rast të drejtat e të tretëve në mirëbesim (neni 5., § 8).

Dispozita të ngjashme gjenden në nenin 12, § 7, të Konventës së OKB-së mbi krimin e organizuar transnacional dhe në Konventën e Strasburgut mbi pastrimin e parave të vitit 1990 (edhe në këtë rast, parashikimi tradicional sipas të cilit procedurat e konfiskimit rregullohen nga *lex loci* shoqërohet me atë që e detyron Shtetin e kërkuar të verifikojë faktet, gjë që qëndron në themel të vendimit gjyqësor të Shtetit tjetër).

Në përgjithësi, në lidhje me konfiskimin vështirësitë e përafrimit janë të tilla që e bëjnë tejet të vështirë ecjen përpara të të drejtës ndërkombëtare penale.

E dëshmon këtë edhe fati që kanë pasur disa instrumente më të hershëm të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në Marrëveshjen e ndihmës së ndërsjellë në fushën penale mes Italisë dhe Shteteve të Bashkuara të vitit 1982, për shembull, perspektivat e punës që erdhën me marrëveshjen dypalëshe të sapopërmendur¹⁶⁷ përmblihdeshin

¹⁶⁵ Lidhur me këtë çështje, shih G.DI CHIARA, *Modelli e standard probatori in tema di confisca dei proventi di reato nello “spazio giudiziario europeo”: problemi e prospettive*, në *Foro it.*, 2002, II, parag. 263, e në vijim.

¹⁶⁶ Për rrjedhojë nuk na çudit fakti që ratifikimi i konventës së mësipërme ndodhi në Itali (ligji n.328, dt. 5.11.1990) pa pasur nevojë për ndonjë përshtatje të normave të brendshme në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin dhe të atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale mes autoriteteve të huaja.

¹⁶⁷ Mbi këtë model marrëveshjeje të bashkëpunimit ndërkombëtar, shih G.TURONE, *Ndihma gjyqësore mes Italisë dhe Shteteve të Bashkuara në lidhje me konfiskimin*, në *Ind.Pen.* 1987, dhe në vijim; po kjo revistë jepte njëkohësisht informacione për një transfertë në SHBA të Gjykatës së Napolit, Seksioni për ekzekutimin e masave të sigurisë (*këtu*, 618 e vijues),

në përkufizimin e marrëveshjes (neni 18) sipas të cilit “*në bazë të procedurave gjyqësore të parashikuara nga ligjet e Shtetit të kërkuar, ky i fundit do të ketë të drejtë të urdhërojë konfiskimin në favor të Shtetit kërkuar të pasurive të sekuestruara në zbatim të § 2 të këtij neni*”.

Shkëmbimi i ratifikimeve të Marrëveshjes u shoqërua nga ai i shënimeve përmes të cilave dy Shtetet njihnin mundësinë për ta kushtëzuar efikasitetin e dispozitave në lidhje me konfiskimin, me futjen e normave të nevojshme kombëtare zbatuese.

Ndonëse Shtetet anëtare u angazhuan njëkohësisht të përshpejtonin përshtatjen e brendshme dhe të njoftonin njëri-tjetrin për realizimin e kushtit të mësipërm, është fakt që, pavarësisht nga zhvillimet normative të shënuara në njërin apo tjetrin sistem. Mekanizmi i dyfishtë e njoftimit nga i cili varej operativiteti i rregullimit të konventës nuk ka vepruar kurrë, ndërkohë që në pritje që të ndodhte u zëvendësua nga kërkimi i një marrëveshjeje të re në lidhje me *confiscation* që ka vite që duket sikur është një hap larg objektivit, por që ende s’mund ta arrijë atë.

Më 6 qershor 2003, siç thamë, SH.B.A. dhe Bashkimi Evropian kanë lidhur një marrëveshje mbi ndihmën e ndërsjellë juridike që dikton parashikime të reja dhe novatore në lidhje me verifikimet bankare dhe me skuadrat hetimore të përbashkëta, por në të nuk thuhet asgjë domethënëse në lidhje me konfiskimin.

Sidoqoftë, ndërkaq SH.B.A. kanë ndryshuar thellësisht legjislacionin e tyre të brendshëm dhe, bashkë me të, edhe kuadrin e mundësive të konfiskimit të pasurive që gjenden aty e që jepen nga autoritetet gjyqësore të shteteve të tjera.

Që me *Money Laundering Act* të vitit 1986 u fut në fakt mundësia për të sekuestruar dhe konfiskuar fitimet e një krimi lidhur me trafiket e drogës të kryera në dëm të një shteti të huaj, përmes një procedimi të posaçëm *in rem*, pra në bazë të vendimeve të një gjykate të marra në bazë të bindjes për të provuar lidhjen e pasurisë me një vepër krimi, por pavarësisht nga përgjegjësia e mbajtësit dhe nga dënimi i autorit të krimit.

Megjithatë, përtej kësaj mundësie ligjet federale mbi *civil forfeitures* nuk ishin të zbatueshme dhe gjendeshim shpesh përballë kërkesës për

lidhur me verifikime interesante (sa dhe të parakohshme) të zbatueshmërisë në praktikë të perspektivave të reja të bashkëpunimit në nivel jashtë-procedural të konfiskimit parandalues.

ndihmë juridike të Shteteve të tjera, *escamotage*-in për vendosur një procedurë të të drejtës së brendshme që ka për qëllim po rezultatit që synon të arrihet me letërporosi dhe ku bashkoheshin elementët e faktit që qëndrojnë në themel të vendimit të gjyqtarit të huaj.

Gjendja ka ndryshuar ndjeshëm me miratimin e *Civil Asset Forfeitures Reform Act*, të dt. 23 mars 2000.

Një nga qëllimet e reformës ka qenë pikërisht ai i dhënies së bazave ligjore të brendshme për bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin.

Për këtë arsye, tani parashikohet që nëse një person akuzohet në një Shtet të huaj për kryerje veprash që do të justifikonin sekuestrimin dhe konfiskimin në SH.B.A., Ministria e Drejtësisë së Shteteve të bashkuara mund të kërkojë para një gjyqtari federal apo para një gjyqtari të rrethit në të cilin ndodhet pasuria e dyshuar, një urdhër sekuestroje konservative që do të ruante disponibilitetin mbi të për 30 ditë, me përjashtim të rastit kur ka shtyrje të mëtejshme të justifikuar nga nevoja për të marrë jashtë vendit provat e përshtatshme për të mbështetur një vendim konfiskimi sipas ligjeve të brendshme.

Është e udhës që t'i jepnim fund kësaj trajtесе për një vend extra-evropian, por do ish me interes të vazhdonim debatin me analizën e perspektivave të ofruara nga përvoja amerikano-veriore, si për disa pika interesante e specifike të kësaj teme, p.sh. të nocionit të të tretit në mirëbesim¹⁶⁸ apo të administrimit të pasurive të sekuestruara, ashtu dhe

¹⁶⁸ Rezulton të pranohet, në një afat të arsyeshëm (i caktuar gjatë njoftimit të sekuestrimit, apo në mungesë të tij, për 30 ditë nga shpallja përfundimtare e njoftimit të sekuestrimit), ankimi i të tretit që gëzon të drejta mbi pasurinë e sekuestruar në një procedurë jo gjyqësore. Por ankimi nuk duhet të jetë *frivolous* dhe duhet bërë me betim, në mënyrë që ky person mund të dënohet penalisht në rast shpifjeje.

Për sa i takon përpjekjes për të dhënë përkufizimin e *innocente owner*, konsiderohet i tillë ai që nuk mban parasysh veprimet që shpënë në sekuestrim, apo, edhe pse në dijeni të tyre, nuk mund ta shmangte, në mënyrë të arsyeshme, përdorimin e paligjshëm të pasurisë, duke sjellë një kriter të dyfishtë kontrolli për prezumimin e arsyeshmërisë, duke pasur parasysh nga njëra anë detyrimin për të njoftuar menjëherë të dhënat lidhur me nëndorësinë pranë një agjencie ligjore kompetente dhe, nga ana tjetër, për të provuar se ka revokuar apo është përpjekur të revokojë lejen për përdorim të paligjshëm të pronësisë apo të veprimeve të tjera të arsyeshme duke u këshilluar me agjenci të ligjit, por sidoqoftë pa bërë hapa të tillë që nuk do ta shtynin, arsyeshmërisht, të tretin të konsiderohej apo të konsideronte persona të tjerë si persona që nuk kanë lidhje me riskun fizik.

Nocionit të mirëbesimit i referohemi vetëm për të vendosur për fatin e të drejtave të fituara pas veprimit që ka shpënë në sekuestrim, në çdo rast duke kërkuar provën që nuk do

sepse, në përgjithësi, sistemi i *civil forfeitures* paraqet shumë interes për perspektivën e politikës kriminale të Shteteve të tjera, duke përfaqësuar një model interesant ndëshkues që shkëputet nga garancitë tradicionale të drejtës penale (ndonëse të gjitha konventat e mëtejshme ndërkombëtare që e kanë përfutuar nuk janë ratifikuar ende nga Italia (nga Konventa Map e d.29 maj 2000 deri tek Konventa e Palermos mbi krimin e organizuar transnacional të vitit 2000 dhe Protokollin i Dytë shtesë i Konventës evropiane mbi ndihmën gjyqësore të vitit 2001), ka një fushë veprimi absolutisht më të gjerë e të rëndësishme.

Përvoja e marrëdhënieve të bashkëpunimit sheh në fakt të zhvillohen gjithnjë e më shumë jo vetëm shkëmbimi spontan i informacioneve, por edhe adoptimi i instrumenteve të rinj dhe, ndryshe, *extra ordinem*, që priren të racionalizojnë dhe nxisin ato kanale të shkëmbimit të informacioneve, si në rastin e protokolleve të bashkëpunimit të lidhur nga drejtoria kombëtare e antimafias me autoritetet qendrore të shumë Shteteve extra-evropiane, për të cilët, nëse do të kemi kohë e nëse do të keni dëshirë, mund të themi diçka më tej, ndonëse jam i sigurt se do të ketë folur për këtë Vigna.

Pas kësaj hyrjeje që hedh dritë mbi kufijtë dhe sa ka të bëjë me fushën dhe metodën e hulumtimit, mund t'i kthehemi thelbit të çështjes, që përsëri do të na duhet ta trajtojmë në mënyrë të kufizuar.

Në përgjithësi, besoj se është e udhës t'i referohemi një imazhi që i shërben një këndvështrimi të plotë të gjithë sistemit: duke dashur të kemi një pamje të funksionimit të mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar, provoni të përfytyroni disa rrathë bashkëqendrorë që në mënyrë progresive shtrihen në hapësirë.

Secili prej këtyre rrathëve i përkon një fushe specifike të bashkëpunimit, intensiteti i të cilit zvogëlohet dora dorës që largohet nga qendra, por shtrirja e tij në hapësirë është, dora dorës, gjithnjë e më e madhe.

Konkretisht, rrethi bashkëqendror më afër qendrës është ai i kufizuar nga konturet politike të Bashkimit Evropian, brenda të cilit bashkëpunimi mbështetet në rregulla mjaft të forta dhe ku zhvillohet pjesa më e madhe e letërporosive (deri tre vjet më parë llogaritej që më shumë se 70 për qind e letërporosive nga e drejt Italisë kish të bënte me Shtete të tjera anëtare të BE-së, pasi kësaj përqindjeje i shtohet edhe ajo lidhur me shkëmbimet e ndihmës me vende në atë kohë candidate dhe tani anëtare të Bashkimit).

mbante parasysh rrezikun e sekuestrimit dhe nuk do kish një motiv të arsyeshëm për të dyshuar mbi të.

Një sistem mjaft homogjen, për sa mund të përdoret kjo fjalë tekta flasim për gjëra që ndikohen ende fort nga tradita juridike dhe institucionale, por forca shtytëse e të cilit është e destinuar të jetë gjithnjë e më e madhe, me përjashtim të rastit kur mbajmë parasysh se nuk janë pak elementët e krizës së efektivitetit të politikave të bashkëpunimit ndërqeveritar të përpunuara në vitet e fundit.

Përtej këtij rrethi të parë, ka një tjetër rreth, më i gjerë, i cili kufizohet nga fushëveprimi i Këshillit të Evropës.

Bëhet fjalë për një hapësirë bashkëpunimi më pak i ngjeshur se ai i Bashkimit, që tashmë shtrihet drejt parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe integritit të strukturave ndëshkuese, por shumë më i gjerë dhe, pavarësisht nga kjo, mjaft i gjallë dhe i rëndësishëm.

Shtrirja e tij (tashmë bëjnë pjesë në të 47 Shtete, përfshirë Armeninë dhe Azerbajxhanin) bën që të jetë një organizëm mirëfilltazi panevropian, në gjendje të zhvillojë një kuadër rregullash që burojnë nga marrëveshje në fuqi për një numër të madh Shtetesh dhe që luan një rol tërheqës edhe përtej kufijve të vet.

Disa prej konventave të veta kanë marrë në fakt aderimin edhe të Shteteve jo anëtare (është ky rasti i Konventës së Strasburgut mbi pastrimin e parave, në të cilën kanë aderuar, për shembull, edhe Kanadaja dhe Meksika). Të tjera, për nga rëndësia që kanë, ndihmojnë të sjellin një lloj modeli universal për zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare të konventave, si në rastin e CEAG të vitit 1959 dhe të protokolleve të mëtejshëm shtesë, e fundit ndër të cilat është adoptuar në tetor të vitit 2001.

Natyrisht, mes dy rrathëve bashkëqendrorë ekzistojnë lidhje të forta.

Nëse nga njëra anë CEAG është ende teksti themelor i të drejtës ndërkombëtare në fushën e ndihmës gjyqësore aq sa deri brenda Bashkimit Evropian risitë ligjore konceptohen si instrumente plotësues të Konventës mëmë të Këshillit të Evropës (si nga ana tjetër duhet thënë në lidhje me marrëdhëniet mes konventave për ekstradimit lidhur nga Shtetet BE në vitin 1995 dhe në vitin 1997 kundrejt Konventës së Përgjithshme mbi ekstradimit, e Këshillit të Evropës), nga ana tjetër, përparimi i instrumenteve të Bashkimit evropian janë shndërruar në një model referues të zhvillimit të konventës mëmë, siç është e udhës të pranohet nëse krahasohen, për shembull, përmbajtjet thelbësore të konventës BE të majit 2000 me ato të protokollit të dytë shtesë të CEAG bërë nga Këshilli i Evropës në tetor 2001.

Rrethi i madh bashkëqendror, i tretë dhe i fundit, e sjellin konventat e Kombeve të bashkuara që – duke filluar nga ato në lidhje me sigurinë e transportit civil, terrorizmin, trafikun e lëndëve narkotike, deri në Konventën e Palermos mbi krimin e organizuar të vitit 2000 dhe mbi protokollet shtesë në lidhje me trafikun e armëve dhe të personave – shërben për të përmbledhur karakterin e përgjithshëm të Shteteve e natyrisht, gjerësisë së sferës së bashkëpunimit i përkon patjetër një forcë më e vogël e formave të veta.

Sigurisht, sistemi i rrathëve bashkëqendrorë i sapopërkruar u referohet burimeve shumëpalëshe ndaj të cilave Italia është e interesuar, duke na u dashur ta zhvendosim vëmendjen tonë në sisteme të tjera rajonale të bashkëpunimit.

Nga pikëpamja e Italisë, bëhet fjalë për burime që për vetë natyrën e tyre si burime marrëveshesh janë të destinuara të përcaktojnë emërues të përbashkët për marrëdhëniet e bashkëpunimit me tërësinë e Shteteve, nuk ushtrojnë një shtysë shumë të madhe ndaj zhvillimit të legjislacionit të brendshëm, por sjellin një fakt mundësinë për të ndërmarrë procese racionalizimi të legjislacionit me institute specifike dhe të rëndësishëm të së drejtës së brendshme: së fundi, Senati ka miratuar në komisionin përkatës dekretin legjislativ ratifikues të Konventës së Palermos, duke përfituar nga rasti për të sjellë dy risi të rëndësishme:

- 1) në lidhje me operacionet e infiltrimit, përmes futjes së një rregullimi unitar që mund të shërbejë për të eliminuar pasojat jo të njëjta që rrjedhin nga mbivendosja e normave të mëparshme të diktuar në lidhje me sektorë të veçantë;
- 2) dhe në lidhje me rregullimin e konfiskimit të detyruar dhe në bazë vlere, në këtë rast, edhe përmes zgjedhjes për të rregulluar në mënyrë të njehsuar një fushë që është zhvilluar në mënyrë jo organike. Në veçanti, konfiskimi për një vlerë të barazvlefshme, duhet të ketë karakter të përgjithshëm në dritën e parashikimeve të konventës së Strasburgut mbi pastrimin e parave të vitit 1990, rezulton të jetë shtrirë në të gjitha rastet e konfiskimit të detyruar, duke u aplikuar, nëse nuk është e mundur të zbulohet dhe mësohen gjërat që përbëjnë produktin, fitimi apo çmimi i krimit, për të gjitha të mirat dhe utilitetet e tjera që disponon fajtori, edhe përmes një personi të tretë, deri në një vlerë të barazvlefshme të produktit, deri tek fitimi apo tek çmimi i krimit që nuk është e mundur të konfiskohet.

Nëse reforma e vitit 2000 kërkon tani të provohet që e mira është e konfiskueshme *by preponderance of the evidence* në rastet kur në fillim mjaftonte *a probable cause*)¹⁶⁹.

Problematika e perspektivave të bashkëpunimit që kanë për qëllim heqjen përfundimtare të disponibilitetit së të mirave që lidhen me krimin, sidoqoftë nuk mund të fshehin rëndësinë e përparimeve të arritura. Momenti kyç qëndron pikërisht në Konventën e Strasburgut të viti 1990.

§ 3. *Konventa mbi pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi.*

Me përjashtim të konsideratës së disa fushave të tjera të bashkëpunimit dypalësh (si ato të përcaktuara nga marrëveshjet e lidhura mes Italisë dhe Australisë më 28 tetor 1988 të ndihmës së ndërsjellë në fushën penale¹⁷⁰ dhe mes Italisë dhe Mbretërisë së Bashkuar më 16 maj 1990 në lidhje me

¹⁶⁹ Krahas sistemit të *civil forfeitures*, legjislacioni i SH.B.A. njeh sistemin e *criminal forfeiture* të futur në fillim të viteve '60 nga legjislacioni federal në lidhje me krimin e organizuar, meqë konceptohet si dënim, strukturohet në forma shumë më të garantuara, duke kërkuar që akuza duhet të provojë fajësinë e të pandehurit në lidhje me krime të rënda federale dhe që të mirat lidhen me krimin.

Instituti i *criminal forfeiture* lind me qëllimin e deklaruar të mbrojtjes së ekonomisë së ligjshme nga risku i infiltrimëve kriminale.

Ligji themelues ndalonte pikërisht: a) përdorimi apo investimi i forndeve që rrjedhin nga *racket* i një veprimtarie sipërmarrjeje; b) marrja e kontrollit të një shoqërie përmes veprimtarisë së grupeve kriminale të organizuara; c) administrim biznesi të një shoqërie me metoda tipike të një veprimtarie *racket*; konspirimi për kryerje të një prej krimeve të mësipërme.

Krimi i përfaqësuar nga përdorimi i metodës së *racket* në drejtimin e shoqërisë ka shërbyer më pas si levë për të zgjeruar kufijtë e zbatimit të ligjit antiracket dhe me ndërjyrje të mëvonshme ligjore është njohur dora dorës zbatueshmëria për një numër të caktuar krimesh që nisin nga krimet që lidhen me lëndët narkotike, me pastrimin e parave, deri tek trafiku i materiali pornografik e krimet bankare. I shtohet kësaj fakti që jurisprudenca bankare e ka shtrirë rëndësinë e vet në një tjetër grup krimesh, nga mashtrimi postar deri tek ai fiskal, në mënyrë të tillë që përfundimisht sistemi ka ndryshuar ndjeshëm fizionominë e tij të parë dhe sot përdoret edhe për të luftuar kriminalitetin në politikë ndonëse në mungesë të çdo lidhjeje me krimin e organizuar.

Për një analizë më të thelluar të modelit kompleks amerikano-verior, të pasur me referenca doktrimore dhe jurisprudenciale të marra nga përvoja, krs. A.M.MAUGERI, *cit.*, 51-52 dhe 247 e në vijim.

¹⁷⁰ Marrëveshja italo-australiane e vitit 1988 i kushton kësaj fushe specifike disa dispozita të veçanta në lidhje me zbatueshmërinë ekskluzive të të drejtës së Shtetit të kërkuar me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kufizimeve të konfiskimit, të mbrojtjes së të drejtave të të tretëve dhe të detyrimit të adoptimit, në rast urgjence, të masave të sigurisë në gjendje “të ruajë gjendjen ekzistuese si dhe të mbrojnë interesat dhe provat në rrezik”.

ndihmën e ndërsjellë në fushën e trafikut të lëndëve narkotike dhe të sekuestrimit dhe konfiskimit së të ardhurave nga to¹⁷¹), dimensionin sektorial dhe sidoqoftë i mbyllur i precedentëve të të drejtës ndërkombëtare të konventave ndihmon për të shpjeguar gjerësinë e pritshmërive që mbështeten në zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, firmosur në 8 nëntor 1990, në hyrje të të cilës objektivi kryesor i “*priver le délinquant des produits dy crime*” tregohet si qëllimi dhe njëkohësisht si metoda më moderne dhe efikase e luftës kundër kriminalitetit të organizuar.

Në dritën e këtij objektivi kaq të qartë sa dhe tmerrësisht angazhues, në vitin 1990 për herë të parë vjen përkufizimi i një tërësie rregullash instrumentale për ndërtimin e një sistemi të bashkëpunimit ndërkombëtar që mbështetet në një parim të kërkimit të efektivitetit të veprimtarisë së ndëshkimit penal dhe të hapur ndaj anëtarësimit edhe të Shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës.

Por rëndësia e Konventës në fjalë duket edhe e sidomos duke vërejtur risinë e nocionit të sekuestros të pranuar nga Shtetet kontraktuese, që në dritën e perspektivës së konfiskimit shtrihet në të ardhurat nga krimi dhe nuk kufizohet më me sende që i përkasin krimin, siç parashikohet nga Konventa evropiane mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale, e vitit 1959 (neni 3, i C.E.A.G. përshkruan letërporosinë si të drejtpërdrejtë, përveç se në njoftime, në “*kryerjen e akteve përgatitore*” dhe në “*përcjelljen e provës së krimin*”).

Nuk bëhet fjalë për një risi absolute – meqë, në lidhje me trafikun e lëndëve narkotike, që në Konventën e Vienës të vitit 1988 ish futur një nocion i ngjashëm i të mirës që i nënshtrohet sekuestrimit jashtë vendit - por zgjerimi i fushës së zbatimit që jashtëzakonisht i madh dhe tregon qartë vlerën e këtij hapi kaq zhvillues.

Në Konventën e vitit 1990 shfaqet pra një sistem bashkëpunimi që nuk kufizohet me kërkimin e mjeteve të krimin, por që shtrihet në të ardhurat e

¹⁷¹ Marrëveshja italo-britanike, e njëkohshme me fazën përfundimtare të negociatave të Strasburgut që kishin për qëllim lidhjen e Konventës mbi pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi (me ligjin nr.147, 22.02.1994) mbi kushtin e përpjekjes për të përshtatur legjislacionin e brendshëm të bërë për të zbatuar marrëveshjen shumëpalëshe të 8.11.1990, dikton dispozita të zgjeruara lidhur me nocionin e të ardhurave nga krimi (shprehimisht referuar neni 2 ndaj çdo të mirë që është fryt i një veprimtarie kriminale dhe ka të njëjtën vlerë), të kushteve të zbatueshmërisë për krime të ndryshme nga ato të lëndëve narkotike (neni 5, § 1, gërma b), të sekuestrimit të përkohshëm (neni 10), të ekzekutimit të konfiskimit penal dhe, nga ana britanike, edhe të akt-akuzës të nxjerrë në kuadrin e procedurave të parandalimit të krimin, parashikuar nga e drejta italiane (neni 11).

krimeve që janë kryesisht në gjendje të sjellin fitime dhe procese të një grumbullimi të mëtejshëm parash të paligjshme.

Një sistem që mbështetet në idenë që priret drejt detyrueshmërisë së dhënies së ndihmës, jo vetëm gjyqësore, por edhe administrative dhe të policisë, mbi uljen e rëndësisë së klauzolës së inkriminimit të dyfishtë (nuk është e referueshme për të hedhur poshtë ndihmën në hetime që nuk shpiten në ekzekutimin e akteve shtrënguese), mbi nxitjen e shkëmbimit spontan të informacioneve që i jep jetë koordinimit investigues që mund të bëhet në këtë fushë.

Konventa e Strasburgut përbën ende sot bazë më të gjerë e të fuqishme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e hetimeve ekonomike, të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Ajo është bërthama rreth të cilës është organizuar kërkimi i mëtejshëm i instrumenteve të rinj dhe efikasë.

Vetëm në kuadrin e Bashkimit Evropian, në vitet pas Planit të Veprimit kundër krimit të organizuar adoptuar nga Këshilli i Evropës në Amsterdam më dt. 16-17 qershor 1997 (dhe, në veçanti, në rekomandimin nr.26, germa b, në lidhje me fuqizimin e kërkimit dhe të sekuestrimit të të mirave të ardhura nga krimi), u vijua gjatë viteve të fundit me miratimin e:

- Ndërhyrjes së përbashkët të datës 3 dhjetor 1998 mbi pastrimin e parave dhe gjetjen, zbulimin, ngrirjen apo sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi;
- Vendimit kuadër të Këshillit të dt. 26 qershor 2001 në lidhje me po këtë fushë¹⁷²;
- Konventës mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale të 29 majit 2000;
- Dispozitave specifike në lidhje me verifikimet e pasurisë në fushën e hetimeve financiare dhe bankare që përmban Protokollin shtesë i

¹⁷² Ky instrument parashikon:

- a) detyrimin e Shteteve për të hequr rezervat e sjella për Konventën e Strasburgut në vitin 1990 në lidhje me strukturën e krimit të pastrimit të parave që lidhet me krime “të rënda” (neni 6, i Konv.) dhe i kuadrit zbatues të konfiskimit, kur krimi është i dënueshëm me burgim më të madh se një vit (neni 2 Konv.);
- b) detyrimi për të adoptuar *standards* që janë kryesisht të njëjtë të rregullimit të niveleve të sanksioneve të veprës së pastrimit të parave;
- c) detyrimi për të futur në vija të përgjithshme figurën e konfiskimit të vlerës, të paktën në rastet kur të ardhurat nga krimi nuk mund të zbulohen.

Konventës së Bashkimit Evropian për ndihmën gjyqësore në fushën penale të dt.22 maj 2000 adoptuar nga Këshilli i Evropës më 16 nëntor 2001¹⁷³;

- Së fundi, e Vendimit kuadër të dt.22 korrik 2003 lidhur me ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave të bllokimit të të mirave dhe të sekuestrimit për efekt prove.

d) ¹⁷³ detyrimi për të futur në vija të përgjithshme figurën e kofiskimit të vlerës, të paktën në rastet kur të ardhurat nga krimi nuk mund të zbulohen.

¹⁷³ Protokollin (duhet të ish ratifikuar nga të gjitha vendet anëtare shumë më shpejt, sipas marrëveshjeve politike të bëra), synon të përmirësojë format dhe modalitetet e bashkëpunimit gjyqësor evropian në sektorin specifik të krimit ekonomik dhe financiar.

Nuk është e mundur t'i bëjmë ballë detyrës së një paraqitjeje të plotë të përmbajtjes së këtij instrumenti të ri, të rëndësishëm që ka për qëllim të plotësojë dhe përmirësojë kuadrin ligjor që rregullon bashkëpunimin mes Shteteve anëtare me qëllimin specifik të lehtësimit të mbledhjes së provave në procedimet penale lidhur me forma të rënda të krimit të organizuar dhe financiar.

Për qëllime që na interesojnë drejtpërsëdrejti duket se mjafton të theksojmë disa të reja pozitive, duke lënë mënjatë kufizimet që kanë të bëjnë me vështirësinë që hasin negociatat për projektin e parë francez (p.sh., pazbatueshmëria e rezervave të deklaratave të paraqitura duke iu referuar Konventës së përgjithshme të vitit 1959):

- pakundërshtueshmëria e sekretit bankar apo e klauzolave të tjera të diktuar në mbrojtje të konfidencialitetit të veprimtarive bankare;
- pamundësia për të hedhur poshtë zbatimin e kërkesave për ndihmë në dritën e natyrës fiskale të krimit;
- mbi të gjitha, për lidhjen e drejtpërdrejtë me temën, marrja përsipër e detyrimit për të adoptuar masa që mundësojnë gjetjen e llogarive bankare që ka një person (si mbajtës apo kujdestar) dhe dhënien e çdo informacioni të disponueshëm.

Edhe mbi këtë pikë të fundit, teksti nuk është saktësisht ai që kish propozuar projekti francez, meqë ai synonte të angazhonte shtetet me një lloj regjistri qendror ku për qëllime informacioni mund të hyhet lirisht nga autoritete gjyqësore të gjithë vendeve anëtare.

Kundërshtia e disa delegacioneve shpuri në një rezultat të ndryshëm dhe më të kufizuar, siç tregon edhe fakti që ka parashikuar që ekzekutimi i kërkesave për informacion mbi llogaritë dhe veprimet bankare mund të varet sipas shteteve anëtare nga vetë kushtet që rregullojnë ekzekutimin e kërkesave për kontroll dhe sekuestrim (kështu, në mënyrë abstrakte, të inkriminimit të dyfishtë, të mbrojtjes së interesave thelbësorë të Shtetit të kërkuar, etj..). Nuk është ajo sinonin delegacionet më të ndjeshme ndaj arsyeve të bashkëpunimit dhe integritetit të strukturave të drejtësisë, por bëhet fjalë për një instrument të rëndësishëm, siç tregojnë gjithë vështirësitë që relacionet e GDP lejojnë të bëhet mbi gjendjen e bashkëpunimit të brendshëm të Bashkimit Evropian në lidhje me kërkesat e paraqitura për informacione të përgjithshme.

Rëndësia e kësaj del në pah duke patur parasysh se mundësitë e sekuestrimit dhe kofiskimit zakonisht qëndrojnë jo shumë larg kanaleve të ndihmës gjyqësore, duke përkulur dështimi i këtyre pritshmërive me zhdukjen e *paper trail*, pra të gjurmës së provave që, dokument pas dokumenti, bën të mundur gjetjen e të mirave që në dukje janë të ligjshme e që ndodhen në territorin e një Shteti tjetër por që lidhen me krimin e kryer në kufijtë e një tjetri.

Do të kemi mundësi të flasim më tej për perspektivën e instrumentit të fundit, por jo pa vërejtur se pjesa më e madhe e këtyre masave – analiza e përmbajtjes së secilës prej tyre do të kërkonte vëmendje të madhe në sintezën që duhet ruajtur – nuk ka ende zbatim në praktikë, duke konfirmuar kështu nevojën për kapërcimin e *impasse* të përcaktuar për çështjet e shtyllës së tretë aktuale të përshtatshëm të instrumenteve evropiane sot të disponueshëm (konventa, vendime kuadër dhe pozicione të përbashkëta) për të sjellë efekte juridike të drejtpërdrejta në legjislacionet kombëtare.

Edhe pse Konventa ka qenë përgjithësisht e kujdesshme në shtrirjen e kompetencave të Bashkimit, nuk ka qenë e tillë në rastin e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme. Ekziston një vetëdije më e madhe për rolin që Bashkimi duhet të luajë për çështjet si bashkëpunimi gjyqësor dhe i policisë, mbrojtjen e interesave financiarë të Bashkimit, mbrojtjen e kufijve, emigracionin dhe politikën e strehimit. Kemi mbërritur kështu tek në një ndryshim vërtet novatore.

Edhe në perspektivën më specifike të luftës kundër krimit të organizuar.

Në perspektivën që sjell Projekti i Kushtetutës, edhe në këtë fushë do të vlejë kategoritë ekskluzive të ligjit dhe të ligjit kuadër.

Nga ana tjetër, pa këto instrumente do ish shumë e gjatë dhe e mundimshme dhe faktikisht e papërshtueshme rruga e vështirë që na ndan nga zbatimi efektiv i parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve dhe dekreteve gjyqësore siç në parag.1 i nenit III-171 si themel i bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, por edhe në perspektivat e nevojshme të përafritimit të normativave substanciale dhe procedurale.

Të dyja perspektivat janë thelbësore.

Në fakt, nëse është e vërtetë që një rrugë e integritit ligjor nuk mund të shkojë realisht përtej një pike të caktuar, për pengesën e pakapërcyeshme që përfaqëson ndryshueshmëria e traditave dhe përvojave të çdo vendi, është po aq e vërtetë që, po kaq reale, zbatimi i parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore nuk mund të zhvillohet vetëm në drejtimin e përkufizimit të normave procedurale të nevojshme për të siguruar zbatimin në territorin e një shteti anëtar të vendimeve gjyqësore të marra nga autoritete të një tjetër shteti anëtar.

Një perspektivë më e kufizuar e integritit të legjislacionit është thelbësore për funksionimin e një sistemi të bashkëpunimit që mbështetet në parimin e njohjes së ndërsjellë, meqë vetëm zgjerimi i grupit të rregullave të drejtës substanciale dhe procedurale të përbashkëta bën të mundur

përdorimin e besimit konkret drejt të sistemeve të tjera juridike që qëndron në bazë të parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore.

Lidhja e instrumenteve mes përafrimit të normativave kombëtare dhe njohjes së ndërsjellë të vendimeve njihet shprehimisht në nenin III-171 në lidhje me nevojën për norma minimale, që duhen përcaktuar me ligjin kuadër, lidhur me pranueshmërinë e ndërsjellë të provave, të të drejtave të njeriut në çështje penale dhe të viktimave të krimit.

Por kjo lidhje është e dukshme edhe në parashikimin tjetër (neni III-172) që me ligjin kuadër të Bashkimit mund të përcaktojë kriteret ligjore minimale për përkufizimin e krimeve dhe të sanksioneve të rëndësishme për ndëshkimin e formave të krimit veçanërisht të rënda që shfaqin një dimension transnacional që rrjedh nga natyra apo nga pasojat konkrete të këtyre krimeve apo nga një nevojë e veçantë për t'i luftuar nga baza të përbashkëta.

Cilat janë sferat e kriminalitetit që priren të shfaqin këtë dimension u tha në Projekt përmes një renditjeje të hollësishme të fushave, në çdonjërin prej të cilave është e lehtë të dallosh një lloj prirjeje të brendshme për të nxjerrë në pah kriteret e rëndësisë dhe të karakterit transnacional të rrezikut të krimit me të cilët lidhet objektivi i integritetit të legjislacionit.

Lindin këtu problemet e para që rrezikojnë të kushtëzojnë perspektivat e përafrimit të legjislacioneve kombëtare.

Para së gjithash, duhet vërejtur se “sferat e kriminalitetit” potencialisht transnacionale përcaktohen sipas kategorive kriminologjike më shumë se juridike.

Por bëhet fjalë për një zgjedhje ndoshta të pashmangshme, nëse konsiderojmë se mungesa e bazave të forta juridike të kategorive të parashikuara në Projekt-Kushtetutën, në planin politik, nga garancitë më të mëdha të ofruara nga çdo Shtet nga adoptimi i metodës së renditjes së çështjeve për të cilat me ligjin kuadër mund të përcaktohen parashikimet ligjore minimale të përbashkëta.

Çështjet e renditura më vete duket se përfshijnë në këtë rrafsh gjithë fushëveprimet e mundshme të krimit të organizuar dhe, në veçanti, të atij mafioz, meqë renditja e tyre përkon me atë të tregjeve të paligjshme që tradicionalisht janë në kontrollin e krimit të organizuar të llojit mafioz apo, si në rastin e korrupsionit, të atij që është deri tani instrumenti kryesor me të cilin kriminaliteti mafioz ndjek qëllimet e veta të infiltrimit në ekonominë e ligjshme dhe të kërkimit të vendosur për të mos u dënuar.

Kështu pra politikat e përafrimit që kanë për qëllim përcaktimin e bazave ligjore minimale lidhur me sfera të veçanta të kriminalitetit të rëndë janë të destinuara të sjellin efekte të rëndësishme edhe në luftën kundër krimit mafioz, pikërisht duke pasur parasysh rolin që organizatat e llojit mafioz (dhe mendoj jo vetëm dhe jo aq ato me origjinë italiane, por edhe e sidomos grupet kriminale me origjinë extraevropiane, atyre që mund të asimilohen si forma organizimi dhe metoda operative) zhvillojnë një kontroll të sektorëve të trafikut të lëndëve narkotike, të armëve, të qenieve njerëzore, të shfrytëzimit seksual të grave apo të ekzistencës sistematike të pritshmërive të tyre për fitim dhe për të mos u dënuar në qarqet e pastrimit të parave dhe të korrupsionit.

Jo më pak, renditja është edhe më e rëndësishme, meqë shtrihet deri aty sa përfshin fenomenin e krimit të organizuar të konsideruar në vetvete.

Një objekt i pavarur i veprimeve të përafrimit ligjor, përtej ekzistencës së bazave juridike të përbashkëta në lidhje me çdo parashikim konkret të krimit të fenomenit.

Me fjalë të tjera, shprehja “krim i organizuar” e përdorur në nenin III-172, më shumë se një lloj klauzole përmbyllëse të listës së fushave të kriminalitetit me prirje ndërkuftare mbi të cilat duhet përqendruar përpjekja për përafrimin e legjisllacioneve kombëtare, tregon një perspektivë të saktë pune, që s’mund të ndahet nga nevoja për të inkriminuar veprimin e thjeshtë të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale.

Për fat jemi mjaft larg kuptimit të plotë politik dhe për këtë arsye pothuaj të papërdorshme në një këndvështrim juridik të shprehjes së njëjtë të përdorur nga neni 31 i Traktatit të Amsterdimit.

Nga kjo rrjedh nevoja për të përcaktuar parashikimet minimale të një nocioni të kriminalitetit të organizuar që mund të dallohet lehtë dhe konkretisht, para së gjithash në perspektivën e njohjes së ndërsjellë të vendimeve, por edhe gjatë kanaleve të bashkëpunimit gjyqësor dhe të policisë.

Në përpjekjen për të tipizuar një përkufizim ligjor të përbashkët lipset të shohim përtej modeleve ekzistuese në këtë fushë, si në nivel evropian (përmes Veprimit të përbashkët mbi dënueshmërinë e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale në Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të marrë më 29 dhjetor 1998) ashtu dhe në perspektivën më të gjerë të marrëveshjes që sjellin Kombet e Bashkuara me Konventën e dhjetorit 2000 mbi krimin e organizuar transnacional.

Në fakt, të dy modelet ofrojnë hapësira të ngushta për një punë konkrete dhe largpamëse të përafrimit të legjislacionit, meqë u tregojnë Shteteve anëtare nevojën për të inkriminuar, edhe vetëm në alternativë, veprime që përkojnë si me modelin italian të pjesëmarrjes në një organizatë mafioze, ashtu dhe me figurën e *conspiracy* që e ka kaq për zemër e drejta anglosaksone.

Në perspektivën e ruajtjes së linjës përshkruese alternativë dhe për këtë arsye të marrëveshjes, distancat legjislative kombëtare do të ishin të destinuara të qëndronin shumë më të hapura, me vështirësinë për të vepruar për rrjedhje si në terrenin e bashkëpunimit gjyqësor ashtu dhe mbi të gjitha në atë të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore.

Ndërsa nevoja jetike është të shpihen sistemet kombëtare drejt një nocioni të përbashkët të pjesëmarrjes në një grup të organizuar të dënueshëm penalisht që, po duke u mbështetur në natyrën e qëllimshme të veprimit dhe të vetëdijes së njëhershme të qëllimit dhe të veprimeve të përgjithshme kriminale të një grupi të organizuar apo të qëllimit të tij për të kryer krime të rënda, mundëson inkriminimin si të pjesëmarrjes aktive në veprimet kriminale të grupit kriminal ashtu dhe të pjesëmarrjes në lidhje me veprime të tjera që, ndonëse kriminale në vetvete, ndihmojnë sidoqoftë në arritjen e qëllimeve të organizatës.

Referimi ndaj veprimeve të paligjshme në vetvete, por funksionale për qëllimet e përgjithshme të organizatës, është pasqyrimi më i dukshëm i përvojës legjislative italiane në lidhje me organizatën mafioze, që karakterizohet nga metodologjia kriminale më shumë se nga qëllimet specifike të ndjekura, që madje nuk duhet nevojshëmrisht të jenë të paligjshme, pasi organizata mund të synojë të realizojë qëllime të ligjshme në vetvete, si marrja e prokurimeve de koncesioneve publike dhe, në përgjithësi, kontrolli i veprimtarive ekonomike të ligjshme; qëllime pra që në një rrafsh abstrakt janë të ligjshme, por që bëhen të rëndësishme për qëllime inkriminimi nëse përndiqen duke shfrytëzuar aftësinë kërcënuese të organizatës kriminale.

Bëhet fjalë për një aspekt thelbësor të politikave të ardhshme të përafrimit ligjor që duhet realizuar në nivel evropian, pikërisht me qëllimin për të goditur hallkat jetike të grupeve kriminale, pra grupet strukturore më të sofistikuara dhe të afta të rigjenerohen, rreth të cilëve zhvillohen marrëdhëniet e paligjshme me botën e ekonomisë dhe të administratës publike të cilave kriminaliteti mafioz u beson pjesën më të madhe të pritshmërive të veta për t'u integruar në shoqëri dhe për t'i shpëtuar dënimit.

Mund t'i referohemi Konventës së OKB-së në mënyrë më specifike për të përcaktuar llojet e kriterëve të përkufizimit të krimit të organizuar lidhur me tiparin e tij të strukturës së organizuar në mënyrë të qëndrueshme.

Në çdo rast, do të thosha që do të jetë themelore që ligji i ardhshëm kuadër sjell një bazë ligjore minimale për të përcaktuar përkufizimin e krimit të organizuar dhe të pjesëmarrjes së dënueshme për të, pavarësisht nga kryerja në një Shtet të vetëm të krimeve-qëllim, me kusht që në këtë territor të jetë realizuar të paktën një pjesë e veprimit kriminal apo një veprimtari lehtësimi dhe ndihme.

Me fjalë të tjera, përkufizimi i krimit të organizuar i pranuar në Projekt-Kushtetutë duhet të gjejë në ligjin kuadër të mëvonshëm një specifikim që e bën jo të rëndësishëm faktin që organizata e rrënjosur në territorin e një Shteti ndjek qëllimet e veta të paligjshme në territorin e Shteteve të tjera anëtare.

Vënia në praktikë e një Rekomandimi specifik lidhur me këtë pikë – që përkon me një udhëzim problematik që përmban Plani i veprimit i vitit 1997 – është tashmë duke u shqyrtuar nga GDM.

Ndoshta nisma e ndërmarrë në këtë gjashtëmuor të kryesisë italiane, do të kërkojë një fazë paraprake studimi dhe analize të problemeve komplekse në lidhje me ndërtimin e modeleve penalistë të njehsuar.

Por kërkesa për një përafrim specifik ligjor që sapo ka marrë formë është jo vetëm mjaft konkrete, por shumë urgjente e s'mund të shtyhet më tej.

Përvoja e tregon qartë.

Në veçanti, përvoja tregon ekzistencën e organizatave transnacionale komplekse dhe të degëzuara në gjendje, përmes vendosjes së sofistikuar të anëtarëve të tyre dhe strategjive të mira tregtare për të shfrytëzuar dallimet e mëdha mes legjislacioneve të ndryshme kombëtare dhe vështirësia për të kaluar në sferën e njërit apo tjetrit legjislacion kombëtar krimet e veçanta.

Kontrabanda e cigareve, për shembull, kontrollohet nga organizata që, ndonëse vijnë nga kontekste të caktuara kombëtare apo të lidhura nga pikëpamja operative me organizata mafioze që kanë hedhur rrënjë në territorin e një Shteti tjetër, priren të transferojnë në Shtete të tjera të Bashkimit qendrat e veta vendimmarrëse dhe të kryejnë transaksione të paligjshme “jashtë vendit me jashtë vendit” që kanë për qëllim zënien e tregjeve të rregulluar nga normativa të sektorit më pak të ngurta se ajo italiane.

Por shembujt mund të jenë më shumë se kaq, duke vërejtur dinamikat komplekse dhe alarmuese të zhvillimit të krimit të organizuar të llojit mafioz të lindur në vende extra-evropiane dhe që më pas është shtrirë në territorin e Shteteve të Bashkimit Evropian.

Të njohësh si krim faktin që një person i pranishëm në territorin e çdo Shteti anëtar merr pjesë në një organizatë kriminale, pavarësisht nga vendi i Bashkimit në të cilin organizata është përqendruar apo zhvillon veprimtaritë e saj kriminale, duket si fund që përkon me idenë, nga e cila s'mund të hiqet dorë, e përgjegjësisimit të përbashkët të Shteteve anëtare të Bashkimit në luftën kundër krimit të organizuar transnacional.

Nga ana tjetër, një zgjedhje e tillë e këtij propozimi është krejt në përputhje me nocionin e transnacionalitetit të pranuar në nenin III-172, ku ajo aktualisht i referohet kriterëve përmbledhës të “karakterit” të krimeve apo të “implikimeve” të tyre apo, përsëri, një “nevoje të veçantë” për të zhvilluar një veprim ndëshkues “mbi baza të përbashkëta”.

“Implikimet” që mund të nxjerrin në dritë prirjen transnacionale të një krimi mund t’u referohen jo vetëm elementëve të natyrës procedurale (si rrethanë që ekzistojnë procedime në më shumë se një Shtet anëtar apo që në territorin e dy apo më shumë Shteteve anëtare gjenden fajtorët ose viktimat e krimit ose provat që duhen mbledhur), por edhe elementët që ndihmojnë në përkufizimin e krimit dhe të elementëve përbërës të tij.

Por tani është e udhës t’i kthehemi kuadrit referues të sjellë nga Konventa e Strasburgut të vitit 1990, duke i dhënë përparësi përcaktimit të kufizimeve specifike të procesit të përshtatjes së legjislacionit të ndërmarrë nga Italia dhe të disa prej pikave më të rëndësishme interpretuese.

Vijon: disa probleme interpretimi lidhur me ligjin nr.328, të datës 9 gusht 1993. – Në perspektivën italiane, ratifikimit të Konventës të vitit 1990 i përkoi në fakt një përpjekje për përshtatjen e legjislacionit të brendshëm në lidhje me verifikimet e pasurisë, sekuestrimit dhe konfiskimit të të mirave instrument apo të ardhura të krimit që duhen kryer jashtë Italisë apo me kërkesë të autoriteteve të vendeve të tjera (ligji n.328, i dt.9 gusht 1993) që deri tani ka rezultate të pjesshme dhe përgjithësisht jo të arrira.

Përtej drujtjes së madhe për rrugën e ndjekur për këtë temë kaq delikate të hyrjes në sistemin tonë të institutit të konfiskimit të vlerave – pranuar vetëm për qëllimet e ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të paraqitura nga Shtete të tjera dhe vetëm më pas parashikuar në lidhje me sferat e kufizuara të kriminologjisë – risitë e kodit që lidhen me ratifikimin e kësaj Konvente, nëse mund ta themi kështu, kanë ndihmuar ta bëjnë edhe më të ngurtë

sistemin procedural për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar siç rezulton nga kodifikimi i vitit 1988.

Në veçanti, as nuk rezulton të jenë më të theksuar karakteri i politizimit të plotë dhe rigjiditeti objektiv funksional i një procedimi të ndërtuar sipas tipareve hibride (si ata tipikë të procedurës së njohjes së vendimeve të huaja apo të ekzekutimit jashtë vendit të vendimeve italiane, por për të cilin gjejnë zbatim normat procedurale të diktuar për letërporositë) e që përfshin edhe veprimtaritë e kërkimit të pasurisë që duhet sekuestruar dhe konfiskuar që nga ana tjetër Konventa lejon të bëhet edhe sipas rregullave të më të brishtit bashkëpunim të policisë.

Neni 745, parag.2-bis, k.p.p., parashikon në fakt që Ministri ka “aftësinë, në rastet e parashikuara nga marrëveshje ndërkombëtare, të kërkojë kryerjen e hetimeve për identifikimin e pasurive që gjenden jashtë vendit dhe që mund të bëhen objekt i konfiskimit, si dhe të kërkojë sekuestrimin e tyre”.

Norma, ndërsa ia lë vendimin për të filluar kërkimet dhe sekuestrimin të drejtës së autoritetit politik, tregon objektivisht këmbënguljen e ligjvënësit italian për të ndjekur me besim zhvillimet pozitive të sistemit të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Mund të jetë e udhës të ndalemi shkurtimisht në analizën e sistemit ligjor në të cilin kjo dispozitë bëhet pjesë dhe të përcaktojmë kështu konturet efektive të rregullimit kombëtar në këtë fushë.

Në kohën e futjes së dispozitës së re të kodit, shembujt e bashkëpunimit kishin përjetuar prej kohësh zhvillimin e lidhjeve të drejtpërdrejta mes magjistratëve.

E megjithatë, pikërisht në këtë sektor nevrologjik si ai i përballuar nga Konventa mbi pastrimin e parave, vazhdimisht i përshkruar nga kërkesa për të vepruar shpejt në hetime vendimtare për luftën kundër formave më të rënda të krimit, ligjvënësi duket se kushtëzon çdo veprimtari kërkimi dhe sekuestrimi jashtë vendit të pasurive që i nënshtrohen konfiskimit ndaj të drejtës së vetëgjyqimit të Ministrit. Madje ndërton një kuadër procedurash mjaft kompleks që duket gati i papërshtatshëm, nga pikëpamja kushtetuese, ndaj qëllimeve që ndjek hapur¹⁷⁴.

¹⁷⁴ Mbi temën specifike dhe mbi perspektivat e reformës së kodit për veprimtaritë procedurale që përkohjnë me kërkesën dhe ofertën për bashkëpunim mes shteteve që ka për qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin, lejomëni që për të dhëna të tjera të doktrinës dhe jurisprudencës, t’i referohem G.MELILLO, *Accertamenti patrimoniali, sequestro e confisca*

Për ligjvënësin e vitit 1993 duket se kanë rëndësi më shumë shqetësimet për të përditësime sistematike sesa nevoja për t'i bërë funksionale mekanizmat proceduralë.

Konventa që duhej ratifikuar kish të bënte me gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, të ardhura apo instrument i krimit, pra veprimtari juridiksionale të ndryshme që nuk është e lehtë të shpihen drejt një modeli unitar rregullues, meqë ligjvënësi i vitit 1988, duke diktuar rregullimin e ri të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja kish futur edhe çështjen e bashkëpunimit për qëllime të konfiskimit, në Titullin e posaçëm të Librit XI kushtuar njohjes së vendimeve të huaja dhe ekzekutimit jashtë vendit të vendimeve italiane.

Kjo zgjedhje diktohej vetëm nga kriteret juridiko-formale: konfiskimi, në legjislacionin tonë vendoset, zakonisht, me një vendim¹⁷⁵, kështu që bëhet fjalë për ekzekutimin jashtë vendit të vendimeve italiane dhe të ekzekutimit në Itali të vendimeve të huaja.

Në këtë dritë, sekuestrimit i kushtohet një vëmendje mjaft e kufizuar, duke parashikuar vetëm mundësinë, në rrugë pasive, për të siguruar me masë sigurie efektet e një konfiskimi të vendosur nga gjyqtari i huaj dhe për të cilin është kërkuar njohja (neni 737, k.p.p.) dhe, në rrugë aktive, për të kërkuar marrjen e masave të ngjashme të përkohshme në kohën e kërkesës për ekzekutimin e konfiskimit (neni 745, parag.2, k.p.p.).

Të vërejmë se, teknikisht, kërkesa për ndihmë gjyqësore që ka për objekt sekuestrimin e një pasurie që duhet konfiskuar nuk është sipas kodit tonë një letërporosi në kuptimin e ngushtë.

Është një formë ndihme e veçantë, e rregulluar nga norma që përmban një titull i posaçëm, IV i librit XI.

Si në planin aktiv ashtu dhe në atë pasiv ajo rregullohet përmes normave *ad hoc* që, për një pjesë të mirë të tyre marrin zgjidhje duke treguar mundësinë për ta lidhur kërkesën për ekzekutim me një akt konfiskimi të dhënë edhe një sekuestrim që do ta paraprinte atë dhe do garantonte efektet e tij.

nel sistema della cooperazione giudiziaria internazionale: problemi e prospettive del modello applicativo italiano, në *Documenti Giustizia*, 2000, 1177 e në vijim.

¹⁷⁵ Si rregull, meqë jurisprudenca nuk kundërshton më tashmë në kuptimin që mund të kryhet edhe me një urdhëresë, nëse bëhet fjalë për konfiskim të detyrueshëm, mund të bëhet madje dhe me një dekret, nëse bëhet fjalë për forma të konfiskimit që pajtohen me shuarjen e krimit (neni 240, parag.2, nr.2 i k.p.), por edhe, sipas lulëzimit të fundëm të vijave të mëparshme të interpretimit, edhe në rastet fakultative (Kas.I seksioni, 25.09.2000, *TODESCO* e të tjerë, në *Cassazione penale*, 2002).

Ligjvënësi i vitit 1993 zgjedh të veprojë po në këtë drejtim, por është i detyruar të diktojë norma të reja në lidhje me sekuestrimin dhe hetimet pasurore.

Në planin pasiv, futet një nen i ri i kodit, 737-bis, me të cilin përcakton një procedurë *ad hoc* që mbështetet kryesisht në atë të letërporosive nga jashtë dhe që u referohet zyrtarisht normave të diktuarra për këto të fundit për qëllime ekzekutimi.

Në planin aktiv, fut një parag.2-bis të nenit 745 me të cilin i jepen ministrin të drejtë e sipërpërmendura.

Pavarësisht nga mos-homogjeniteti i dukshëm i një sistemi të tillë, meqë nga njëra anë është fryt i kombinimit artificial i skemës procedurale të njohjes së vendimeve dhe, nga ana tjetër, është sidoqoftë e mundur të kërkojë një lexim të rregullimit të veprimtarive jashtë vendit që kanë për qëllim kërkimin dhe dhënien e masës së sigurisë për të mira që kanë të bëjnë me kryerjen e krimit në përputhje me kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare.

Para së gjithash, lidhur me normën që rregullon rastin kur është ministria që vepron.

Nga kjo pikëpamje, për efekt të rregullit të përgjithshëm të epërsisë së normave të të drejtës ndërkombëtare, lipset para së gjithash t'u referohemi konventave ndërkombëtare që rregullojnë ndihmën gjyqësore në fushën penale.

Zbatueshmëria e normave të të drejtës ndërkombëtare në fakt nuk mund të kushtëzohet apo madje të mohohet për shkak të zgjedhjeve të ligjvënësit kombëtar dhe, si në këtë rast, si rrjedhojë e adoptimit të kategorive të përfshirjes formale të risive të bashkëpunimit që u nënshtrohen interpretimeve në kundërshtim me angazhimet e marra në rrafshin ndërkombëtar.

Pasojat e para të këtij rendi argumentues mund të shihen në rrafshin e marrëdhënieve mes shteteve, duke u ndalur veçanërisht në kushtet e zbatimit të normave në lidhje me komunikimin e drejtpërdrejtë mes autoriteteve gjyqësore.

Me fjalë të tjera, zgjedhja e ligjvënësit kombëtar për ta kushtëzuar çdo veprimtari jashtë vendit në lidhje me verifikimet e pasurisë dhe sekuestrimin për qëllime konfiskimi me nismë të Ministrin nuk mund të ketë epërsi mbi normat e konventave që pranojnë komunikimin e drejtpërdrejtë (për të qëndruar në sektorin e burimeve shumëpalëshe operative: neni 15, § 3 e 4, i

C.E.A.G., neni 24, § 2, i Konventës së Strasburgut mbi pastrimin e parave, neni 53 i Marrëveshjes Shengen)¹⁷⁶.

Në rastet e mësipërme, nisma që kish për qëllim kërkimin e gjurmëve dhe të të ardhurave të krimit mund të realizohet sipas rregullave të përcjelljes së drejtpërdrejtë të kërkesave për ndihmë gjyqësore.

Vetëm përtej fushës së zbatimit kështu të përcaktuar, do të gjejë zbatim dispozita e kodit që kërkon miratimin paraprak të kërkesës nga ministria.

Për sa u takon përmbajtjes dhe kufizimeve të kompetencës administrative në fjalë duket se nuk mund të flitet lehtë për një aftësi vetëgjyqëse të ushtrueshme pa asnjë kufizim specifik, duke pasur për analogji parasysh parashikimet e nenit 727 k.p.p..

Sfera e vetëgjykimit që i jepet autoritetit politik në fakt mund të shtrihet përtej caqeve të përcaktuara në nocionin e rrezikut të cenimit të sigurisë së brendshme dhe të interesave të tjerë thelbësorë të Shtetit, që për analogji i referohen ex nenit 727 parag.2 i k.p.p. (edhe në saje të nevojave specifike të mbrojtjes së parimit të efektivitetit të funksionit juridiksional penal¹⁷⁷).

§ 4. Kërkesa italiane për bashkëpunim për qëllime sekuestrimi.

Nëse oferta italiane për bashkëpunim për qëllime sekuestrimi dhe konfiskimi ndalet nga vështirësia që paraqesin procedurat e të drejtës së brendshme, kërkesa jonë për bashkëpunim ndërkombëtar po për këto qëllime ndikohet nga natyra dhe burokracia e përgjithshme e instituteve të brendshme të sekuestrimit dhe konfiskimit.

¹⁷⁶ Zona e bashkëpunimit të përcaktuar nga parimi i komunikimit të drejtpërdrejtë është natyrisht i destinuar të shtrihet, në saje të efektit detyrues të parashikimeve që përmban Konventa e re mbi ndihmën gjyqësore në fushën penale adoptuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian i dt.29 maj 2000, nga risitë që i takojnë Protokollit të Dytë shtesë të Konventës Evropiane për ndihmë gjyqësore, e vitit 1959 (që u hap për firmë nga Këshilli i Evropës më dt.8 nëntor 2001), si dhe, sëfundi, në një dimension ndërsubjektiv mjaft të shtrirë, nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi krimin e organizuar transnacional të shpënë për firmë në Palermo më 12 dhjetor 2000.

¹⁷⁷ G.DIOTALLEVI, *Rapporti giurisdizionali con autorità straniere*, në *Codice di procedura penale. Esposizione di dottrina e giurisprudenza* nën kujdesin e G.LATTANZI dhe E.LUPO, Giuffrè. 1998, vëll.VI, 528, kujton se projekti paraprak i kodit të procedurës penale parashikonte, në lidhje me disiplinën e përgjithshme të parag.2 të nenit 745, lidhur me kërkesën për sekuestrim dhe që transformimi i detyrës përkatëse në aftësi përkoji me një përcaktim të qartë të hartuar nga komisioni parlamentar që duhet të analizonte skemën e aktit të ushtrimit të autorizimit legjislativ.

Një pikë e parë që ka nevojë për interpretim përkon me verifikimin e mundësive, në dritën e normave të sjella nga konventat në fuqi, për të vepruar me një masë sigurie apo heqje të drejte në kuadrin ndërkombëtar të mbështetur në një dekret sekuestrimi apo konfiskimi të nxjerrë nga gjykata të cilës i kërkohet zbatimi i masave të sigurisë pasurore në bazë të ligjit antimafia.

Me vendimin e dt. 13 nëntor 2003, Gjykata e Kasacionit franceze ka njohur mundësinë e ekzekutimit në territorin francez të urdhrit të konfiskimit të marrë nga gjyqtari italian në bazë të nenit 2-ter 1.575/1965 dhe mod.vijues, kërkesë në bazë të Konventës mbi pastrimin e parave, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi bërë në Strasburg më 8 nëntor 1990.

Tema e të vepruarit në nivel ndërkombëtar, si titull i kërkesës për ndihmë gjyqësore që mbështetet në Konventën në fjalë, me akte sekuestrimi dhe konfiskimi të marrë në kuadrin e një procedimi parandalues ish trajtuar dhe më parë nga doktrina duke rivlerësuar të dhënat ligjore të përcaktuara në perspektivën specifike të përafrimit të sistemeve kombëtarë.

Në veçanti, teza që pranon mundësinë për të kërkuar ekzekutimin jashtë vendit të konfiskimit preventiv është mbështetur hapur¹⁷⁸, duke vërejtur që neni 14, § 2 i konventës së mësipërme të Këshillit të Evropës mbi pastrimin e parave parashikon shprehimisht detyrueshmërinë për Shtetin e kërkuar për verifikime që faktikisht i përmban vetëm “një vendim dënimi”, por edhe sidoqoftë, “një vendim gjyqësor i Palës kërkuese”.

E me të vërtetë, në raportin shpjegues gjenden fjali që duket se mbështesin më tej këtë tezë, meqë në të kujdesemi të përcaktojmë natyrën e aktit në dritën e zbatimit të të cilit mund të kërkohet bashkëpunimi i Shteteve të tjera jo më në lidhje me ekzistencën e një çështjeje penale, por në praninë e një objekti të përcaktuar si mjet apo e ardhur nga krimi (në raportin shpjegues citohen hapur aktet in rem tipike të legjislacioni të SH.B.A.-së).

Në veçanti, raporti shpjegues sqaron se:

- 1) është i parëndësishëm fakti që konfiskimi nuk konsiderohet si sanksion penal, pasi mund të cilësohet edhe si masë sigurie apo si “e

¹⁷⁸ G.TURONE, *Tecniche di contrasto del riciclaggio*, në *Cassazione penale* 1993, 2973. Në të njëjtin kuptim, A.M.MAUGERI, *Le moderne sanzioni patrimoniali fra funzionalità e garatismo*, Giuffrè, 2001 e vijues dhe G.DEAMICIS, *Le rogatorie in materia di indagini bancarie e finanziarie*, në *Rogatorie penali e cooperazione giudiziaria internazionale*, në kujdesin e G.LA GRECA dhe M.R.MARCHETTI, Giapicchelli, 2003, fq.213 e vijuese.

një tjetër lloji”, me kusht që “të ketë lidhje” me një veprimtari kriminale;

- 2) është i parëndësishëm fakti që konfiskimi mund të vendoset nga një gjyqtar që nuk është ai penal, me kusht që të bëhet fjalë për një gjyqtar;
- 3) në përgjithësi, natyra penale e procedimit gjyqësor që, pavarësisht nga rregullat procedurale të zbatueshme, mund të përbëjë themelin zbatues të një titulli konfiskimi që mund të jepet në bazë të Konventës varet nga lidhja që ka me pasuri që janë mjet apo të ardhura të krimit (nga kjo, në veçanti, rrjedh referimi i qartë ndaj procedimeve *in rem*, në të cilët konfiskimi lejohet edhe kundrejt subjekteve jo fajtorë).

Duke rivlerësuar këto përcaktime pozitive, në perspektivën hermeneutike të sipërpërmendur, thamë se ajo që ka rëndësi është se ndërhyrja ablativ mbështetet nga “një kuadër i mjaftueshëm provash” që ka të bëjë me lidhjen që rrjedh nga krimi, e tillë që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se “e mira apo pasuria objekt i aktit është një hallkë e ekonomisë kriminale të konsoliduar” dhe, për këtë qëllim, të respektojë kushtet e domosdoshme provuese të caktuara nga Konventa gjatë rregullimit të arsyeve të hedhjes poshtë të kërkesës për ndihmë (neni 18, § 4).

Duke qenë e tillë panorama e përgjithshme e burimeve të të drejtës ndërkombëtare penale të rëndësishme, çështja që shkoi për shqyrtim para Gjykatës së kasacionit franceze mund të gjejë një paraqitje të përmbledhur.

Gjithçka nisi me kërkesën e Gjykatës së Milanos për të ekzekutuar në Francë një vendim sekuestrimi të pasurive të paluajtshme të nxjerrë në kuadrin e një procedimi preventiv të nisur në bazë të ligjit antimafia kundrejt një personi të dënuar me vendim të shkallës së parë në një çështje të njëkohshme penale të nisur në lidhje me krimin e bashkëpunimit në krim me qëllim trafik droge¹⁷⁹.

Kërkesa përkatëse u paraqit duke kërkuar zbatimin si të Konventës së Strasburgut, të vitit 1990 ashtu dhe të Konventës së Vjenës të vitit 1988 mbi luftën kundër trafikut të lëndëve narkotike dhe psikotrope (për rrjedhojë, miratimi i mëtejshëm i autoritetit francez që u bazua në njohjen e përputhjes së materialit të provës të përdorur për qëllime të marrjes së masës së sigurisë nxjerrë në fazën paraprake me qëllimin për të provuar origjinën kriminale të parave të investuara në territorin francez, përtej çdo vështirësie që lidhet në

¹⁷⁹ Gjykata e Milanos, dekreti i dt.13 mars 1998, Crisafullio e tjetër.

mënyrë abstrakte me problemin e natyrës juridiko-formale të titullit të titullit që qëndron në bazë të kërkesës për ndihmë juridike).

Më pas, iu përcoll autoriteteve franceze kërkesa për ekzekutimin e dekretit të konfiskimit të nxjerrë nga gjyqtarët milanezë (dhe konfirmuar nga Gjykata e Kasacionit me vendim të dt. 19 mars 2001), duke kërkuar këtë herë vetëm zbatimin e Konventës së Strasburgut më 8 nëntor 1990.

Edhe kjo kërkesë u pranua nga gjyqtari i faktit francez (vendimi i Gjykatës së Apelit të Aix-en-Provence më dt. 19 dhjetor 2002), me një vendim ndoshta edhe një herë të ndikuar nga forca e veçantë e tërësisë së provave, që shkonte paralelisht me çështjen penale për pjesën më të madhe, që qëndron në themel të masës së sigurisë, por edhe që udhëhiqet nga fakti se verifikimi i njëkohshëm, përfundimtar i përgjegjësisë penale për trafiket e lëndës narkotike për të ardhurat që sipas të dhënave rezultonte disponibilitet i pasurisë së paluajtshme të sekuestruar mund të sillte një lloj kushti substancial barazvlefshmërie mes dekretit të konfiskimit të gjyqtarit paraprak dhe konfiskimit që, sipas të drejtës franceze, mund të jepet vetëm nga gjyqtari penal.

Me vendimin e mësipërm të datës 13 nëntor 2003, Gjykata e Kasacionit francez, ndërsa nuk ndan të njëjtin mendim me Prokurorin e Përgjithshëm, e hodhi poshtë rekursin e paraqitur nga mbrojtja dhe i dha formë përfundimtare vendimit të kundërshtuar.

Në arsyetimin përmbledhës (më shumë se bindës) të këtij vendimi mbështetet me forcë në natyrën detyruese të ndihmës që duhet dhënë nga Shteti francez, në bazë të neneve 12 e 14 të Konventës mbi pastrimin e parave, me qëllim ekzekutimin e konfiskimit të të mirave që vijnë nga trafiket e lëndëve narkotike dhe nga veprimet e mëpasshme të reinvestimit spekulativ të tyre.

Pa u lënë shumë hapësirë çështjeve delikate që lidhen me natyrën e veçantë të aktit të konfiskimit (dhe procedimin përkatës të parashikuar nga ligji italian), gjykata i dha zgjidhje problemit të njohjes së nevojshme të respektimit të kushteve të vëna nga ligji francez për të urdhëruar konfiskimin e pasurive më prejardhje nga krimi duke përjashtuar çdo dëmtim të rendit publik të brendshëm, në bazë të kriterit thelbësor që edhe ligji francez parashikon heqjen e të drejtës mbi të ardhurat e trafikut të lëndëve narkotike dhe të veprimtarive të mëvonshme të pastrimit të parave (“...*les conditions prévues pour cette exécution par la loi du 13 mai 1996* – në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe trafikut të lëndëve narkotike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me sekuestrimin dhe

konfiskimin e produkteve të krimit, me përshtatjen e legjislacionit francez ndaj detyrimeve të vëna nga Konventa e Strasburgut e vitit 1990, në fuqi për Francën nga 1 shkurt 1997 – *...sont réunies: qu'ils relèvent ainsi que la décision de confiscation est définitive et exécutoire et que le bien confisqué est susceptible de l'être dans les circonstances analogues selon la loi française, en ses articles 131-21 et 324-7 du Code pénal; qu'ils ajoutent enfin que l'exécution de la décision précitée ne peut porter atteinte à l'ordre public dès lors que la requête tend à la confiscation d'un immeuble acquis par le blanchiment de sommes issues d'une organisation criminelle*).

Rëndësia e precedentit të krijuar në këtë mënyrë mund të shërbejë sigurisht për të konfirmuar rëndësinë e çështjeve që mund të dalin nga teksti i konventës për të lëvizur më tej limitet tradicionale të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër pastrimit të parave, duke nxjerrë një pohim domethënës me një rëndësi thelbësore për dallimet juridiksionale që nuk ndikojnë në çështjen e verifikimit pozitiv juridiksional që vjen nga pasuria që i duhet nënshtruar heqjes së të drejtës për veprime kriminale.

Megjithatë, duket e tepërt të nxjerrim argumente mbështetëse të pashmangshmërisë së “suksesit të mrekullueshëm” të masave tona të sigurisë pasurore në sistemin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në të vërtetë, perspektivat për zgjidhje të problemit të përcaktimit të një themeli të qëndrueshëm të të drejtës ndërkombëtare penale për një ekzekutim të pretenduar jashtë vendit të masës së sigurisë apo të heqjes së të drejtës të marrë nga gjykata të cilës i kërkohet të zbatojë disa masa të sigurisë pasurore, duket se ruajnë tipare jo pak të rëndësishme të paqartësisë dhe kundërshtueshmërisë.

Përtej përpjekjeve interpretuese që flasin sërish për pritshmëritë e përafrimit të maturuara në punët përgatitore të Konventës dhe të shfaqjes së parë e konkrete të gatishmërisë së Shteteve për të shoqëruar zbatimin praktik, mbeten në fakt të dhëna pozitive që flasin për të kundërtën.

Zgjedhja e kësaj zgjidhjeje më të sigurt pozitive që jep më shumë siguri për këtë interpretim duket se pengohet, veçanërisht e para së gjithash, nga e dhëna e mirëfilltë që sjell neni 1 germa d) e Konventës së Strasburgut, sipas të cilit konfiskimi është, shprehimisht, sanksioni apo masa (që qëndron në heqjen përfundimtare të një të mire) “*e urdhëruar nga një autoritet gjyqësor pas një çështjeje për një apo më shumë krime*”; me këtë përkufizim të fundit nga i cili rezultuar e vështirë të njohësh, përfshirë procedimin që ka për qëllim zbatimin e masave të sigurisë, ndoshta (sipas rregullave autonome të konjencionit dhe vlerësimit të provave) edhe në mungesë të një verifikimi

paraprak të përgjegjësive penale në lidhje me kryerjen e krimeve me të cilët në bazë të të dhënave e dyshimeve lidhet ngjarja e pasurimit të pajustificuar (aspekt ky që priret ta ndryshojë edhe raporti shpjegues).

Por edhe dispozita të tjera të konventës duket se janë të zbatueshme keq në rastet në fjalë.

Referimi ka të bëjë sidomos me rregullimin e arsyeve të hedhjes poshtë. Si për ekzekutimin e sekuestrimit që në pritje të konfiskimit të mëvonshëm vazhdon të jetë në sistemin e konventës mbi pastrimin e parave pengesa lidhur me klauzolën e inkriminimit të dyfishtë, duke kërkuar normalisht që fakti të cilit i referohet kërkesa të konsiderohet krim në legjislacionin e kërkuar për ndihmë, ajo që sigurisht sjell probleme delikate për shkak të natyrës së procedimit paraprak dhe të kriterëve që marrjes së masave të sigurisë dhe të heqjes së të drejtës (duke filluar nga rasti në të cilin vepra, në bazë të të dhënave, lidhet me pasurimin e pajustificuar dhe përfaqësohet nga veprimi i pjesëmarrjes në një organizatë kriminale të llojit mafioz dhe jo nga krime specifike të qëllimshme që përkojnë me figura krimi në legjislacionet e tjera kombëtare).

Shprehimisht, në bazë të parag.4 të nenit 18 të Konventës së Strasburgut, bashkëpunimi për qëllime konfiskimi mund të mos pranohet nëse “ligji i palës së kërkuar nuk parashikon konfiskimin për llojin e krimit të cilit i referohet” (germa *a*).

Është e vërtetë që germa tjetër *d*) e po këtij neni tregon si arsye të kërkesës që i nënshtrohet bashkëpunimit jo vetëm “një vendim të mëparshëm dënimi”, por edhe “një vendim me natyrë gjyqësore”, duke sjellë kështu formulimin e nenit 14 që, siç e pamë, duket se i hap udhë rrugës së ekzekutimit të konfiskimeve të të urdhëruara jashtë procedimit penal, por leximin e përbashkët të rregullimit të arsyeve të hedhjes poshtë që ndiqet nga verifikimi i kryerjes së një krimi, ajo që, siç dihet, nëse shpesh, në fakt, mbështet ushtrimin e veprimit të parandalimit (pra të sigurisë dhe marrjen e masave pasurore përkatëse, megjithatë, në të drejtë, përbën një kusht të pacenueshëm për të).

Ndonëse në rrugë përjashtimore, kësaj i shtojmë faktin se masat e parandalimit antimafia janë njohur qartë në nivel ndërkombëtar, pra që në planin sistematik, duket se ka nevojë për një konfirmim të brishtësisë së bazave ligjore të të drejtës ndërkombëtare të gjetura përmes interpretimeve të shtrira apo sidoqoftë në bazë të të dhënave pozitive kontradiktore.

Më saktë, Marrëveshja e datës 16 maj 1990 mes Italisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me ndihmën e ndërsjellë për luftën kundër trafikut të

lëndëve narkotike apo psikotrope dhe të sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi (për të cilën nuk njihen ende shembuj të zbatimit në praktikë, ajo që konfirmon kushtin e krizës së efektivitetit të dimensionit operativ të gjithë sistemit të ndëshkimit të kapitaleve financiare të paligjshme, në kurriz të prodhimit të një të drejte ndërkombëtare penale tashmë më të pasur dhe të përpunuar, përveç krijimit të normave të brendshme), parashikon që edhe dekretet e dhëna në procedimin paraprak italian mund të mbështeten në ekzekutimin në territorin britanik.

Natyrisht, në një marrëveshje dypalëshe është më e lehtë të procedosh me një pasqyrim të saktë të karakteristikave ligjore kombëtare dhe të mbërrihet në konsideratën e qartë të ndryshimeve që ky rregullim ka.

Por në përgjithësi është e udhës të mbajmë në konsideratë se problemi i përkthimit të instituteve juridike që kanë tipare origjinale në skemat lehtësisht të përdorshme në qarkun e bashkëpunimit ndërkombëtar nuk është ekskluzivë e sistemit tonë.

Në këtë perspektivë më të gjerë është e lehtë të konstatoosh se objektivat e përafrimit të juridiksioneve kombëtare që deklarohet se ndiqen nga Konventa vazhdojnë të jenë larg nga realizimi konkret i tyre edhe duke vërejtur shembujt e zbatimit nga pikëpamja e sistemeve të tjera juridike, siç dëshmohet edhe nga fakti që ekzekutimi jashtë vendit i urdhrave të konfiskimit të dhënë në legjislacionin e SH.B.A.-së sipas rregullave të procedimit *in rem* bie ndesh zakonisht me prirjen e ndjeshme të Shteteve të cilëve u kërkohet ndihmë që ta kundërshtojnë arsyen tradicionale të mospranimit me afirmimin e nevojshëm e paraprak të një dënimi penal të subjektit për të cilin mendohet se disponon pasurinë me prejardhje të paligjshme¹⁸⁰.

Janë vështirësi që lidhen mirëfilltazi me dallimet shumë më mëdha të konceptimit të sistemeve të ndryshme të sekuestrimit dhe konfiskimit, që mund të kapërcehen vetëm përmes gërryerjes progresive të aspekteve të ndryshme të legjislacioneve kombëtare.

Për shembull, jurisprudenca e Mbretërisë së Bashkuar ka pranuar mundësinë për të nxjerrë një *restraint order* në bazë të një akti civil *in*

¹⁸⁰ Për këtë regjistrim objektiv të qëndrimeve konkrete të sistemeve të ndryshme kombëtare, krs. *Financial Action Task Force on Money Laundering annexes of the annual report 1996-1997*, qershor 1997, FAFTAX97.PM5 në <http://ëëë.ustreas.gov/fincen/fatfax97.pdf>.

rem¹⁸¹, por kjo ka ndodhur sepse, ndërkaq, pas futjes së *designated Countries and Territories Order 1990* dhe të *Amendment Order 1993*, u bë i mundur përdorimi i *Drug Trafficking Act* i vitit 1986 me qëllim q'është sigurohej konfiskimi e vendosur në një vend të huaj për të ardhura nga trafiqe lëndësh narkotike (pagesa apo shpërblime të tjera të marra në lidhje me vepra të tilla krimi).

Ndër të tjetra, shpesh është e nevojshme të pranojmë se problemi ka një dimension të fortë pragmatik.

Shumë varet nga ngjashmëritë mes sistemeve të ndryshme kombëtare që mund të shquhen në përvojën konkrete të zbatimit, nga besimi tek juridiksioni i vendit kërkues, nga efikasiteti i instrumenteve të lehtësimit të shkëmbimit të informacioneve (e jo të fundit për nga rëndësia, të shkëmbimit të informacioneve ndërmjet magjistratëve ndërlihdhës); së fundi, por mbi të gjitha, nga prirja për t'i dhënë përgjigje kërkesës për një vlerësim substancial të tipareve të veprës të cilës i referohet kërkesa specifike për ndihmë.

Rruga procedurale në lidhje me çështjen Crisafulli, është një shembull mjaft i mirë për këtë.

Por, duke mos ia zbehur aspak rezultatit pozitiv kësaj përvoje në zbatim, duket e vështirë t'i vidhemi përshtypjes që bazat ligjore ndërkombëtare të përdorshme për parashikimin ndërkombëtar të masave paraprake, janë përgjithësisht të dobëta dhe të paqarta, përveç se në rastin e një konfiskimi parandalues që nuk paraprihet nga një verifikim i përgjegjësishë penale, apo madje, ashtu si natyrisht është më se e mundshme, shoqërohet nga një rezultat përfundimtar negativ i verifikimit të përgjegjësishë penale, gjithashtu në lidhje me rastet e konfiskimit të gjithë kapitaleve pasurore krijimi i të cilëve do të rezultonte i pajustificuar.

Sidoqoftë, duket shumë e guximshme të mbështesim mundësinë e hyrjes në skenë të bashkëpunimit ndërkombëtar të sekuestrimeve dhe konfiskimeve që kanë për objekt grumbullime të tëra pasurish krijimi i të cilave vlerësohet si i pajustificuar, por në lidhje me të cilët zbutet ligjërisht,

¹⁸¹ *Court of Appeal*, 21 qershor-5 korrik 1995, Evans, Otton and Pill L.JJ. në *The Laë Reports* 1996, 272 e në vijim (rasti i përmendur edhe nga A.M.MAUGERI, *cit.*, 609). Në këtë rast bëhej fjalë për të ekzekutuar urdhrin e dhënë nga gjyqtari i SH.B.A.-së për bllokimin e një llogari bankare të një banke londineze që disponohej nga të afërm të trafikantit të drogës, kundrejt të cilit nuk ishte proceduar në SH.B.A. pasi po ky person ishte rezident në Kolumbi, shtet me të cilin SH.B.A. nuk kanë marrëveshje ekstradimi.

deri sa zhduket, lidhja që rrjedh nga e mira (a pasuria) nga kryerja paraprake e krimeve të caktuara.

Konventa e Strasburgut kërkon në fakt provën e lidhjes shkakësore mes krimit dhe të ardhurave që i duhen nënshtruar sekuestrimit dhe konfiskimit, përveç pranueshmërisë së konfiskimit të vlerës¹⁸².

Për këtë arsye ndoshta pësjtelohet që në krye çdo zhvillim i mundshëm në nivel ndërkombëtar i institutit të konfiskimit ex neni 12-*sexies* dekret ligji 306/1992, konfigurimi i të cilit shënjohe nga kriza e lidhjes tradicionale që rrjedh nga objekti i konfiskimit nga krimi i kryer, që është theksuar sërish së fundi nga Seksionet e Bashkuara.

Në përfundim, nuk duket e tepruar të shtojmë se pranojmë një të dhënë objektive: përballë sfidave aktuale të krimit transnacional, sistemi italian i goditjes së pasurive kriminale ndërtohet rreth figurave që karakterizohen që në krye nga një paaftësi për t'u imponuar në qarkun e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Edhe marrja në konsideratë e kësaj do na bënte të mendonim për një rishikim të çështjes¹⁸³ sipas modeleve të reja teorike, që e mbështesin fort efektin e heqjes së të drejtës me përfundimin e procesit penal¹⁸⁴ dhe me favorizimin e proceseve të përafrimit të legjislacionit të cilit i kërkohet të garantojë fluiditetin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar.

§ 5. Vendimi Kuadër mbi ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave të bllokimit dhe sekuestrimit të pasurive për qëllime konfiskimi dhe prove.

Për të folur për këtë na vijnë në ndihmë edhe perspektivat e bashkëpunimit në Bashkimin Evropian në bazë të Vendimit kuadër në zbatim të urdhrave të bllokimit të pasurive për qëllime konfiskimi dhe prove, i miratuar nga Këshilli i Ministrave të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme të Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (GAI) më 22 korrik 2003.

Për qëllime që na interesojnë tani, lipset të themi se instrumenti i ri është i destinuar të zbatohet për akte sekuestrimi apo bllokimi të nxjerrë për

¹⁸² E kujton me vend këtë A.M.MAUGERI, *cit.*, 604, që duket sikur mbron në vija të trasha interpretimin në favor të ekzekutimit jashtë vendit të konfiskimit preventiv.

¹⁸³ Bëhet fjalë, siç vëren bukur A.M.MAUGERI, *cit.*, 604 për një arsye të pashmangshme për të rishikuar sistemin italian të parandalimit pasuror.

¹⁸⁴ Krs. perspektivën reformuese të përpunuar nga A.GIALANELLA në *Parametri di mafia. La prova, il sequestro, la confisca, le garanzie.*, E.S.I., 1998.

qëllime prove apo konfiskimi të mëvonshëm “në kuadrin e një çështjeje penale”, ajo në vetvete duket, edhe formalisht, se i pret rrugën ekzekutimit jashtë vendit të sekuestrove preventivë.

Në radhë të dytë, duhet të vërejmë se nocioni i pasurisë që mund të bëhet objekt i masave të sigurisë të ekzekutueshme në format e parashikuara nga Vendimi kuadër i cili kufizohet me gjërat që përbëjnë objektin, instrumentin apo produktin e krimit, duke përjashtuar të ardhurat nga riinvestimi i tyre, ajo që sidoqoftë duket se i referohet mundësisë për të rishikuar sistemin e sanksioneve pasurore në dritën e mundësive që sjellin instrumentet e rinj.

Në përgjithësi, kjo nismë e Bashkimit Evropian, që vjen nga një propozim i përbashkët i Francës, Suedisë dhe Belgjikës, nisi nga deklarata e ndërgjegjësimit për vonesat dhe mangësitë e veprimit ndëshkues dhe, mbi këtë bazë, nga ideja, e shprehur hap pas hapi në Vendimin kuadër si më lart, për të nxitur zhvillimin e sistemit të bashkëpunimit në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin drejt parimeve të njohjes së ndërsjellë të vendimeve.

Në formulimin e vendimit kuadër është pranuar propozimi i parë për të dalluar qartë kriteret e ekzekutimit të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Privilegjohet objektivisht nevoja praktike për të ekzekutuar menjëherë sekuestrimin, duke kërkuar një kontroll të thjeshtë të rregullsisë formale të kërkesës dhe të mosekzistencës së shkaqeve të veçanta të imunitetit (pranohet vetëm që për arsye hetimore dhe procedurale është e mundur të justifikojmë një shtyrje të ekzekutimit).

Meqë bëhet fjalë për sekuestrim që ka për qëllim krijimin e një efekti përfundimtar të heqjes së të drejtës, ekzekutimi i konfiskimit varet nga verifikimi i ekzistencës së këtyre kriterëve të kërkuar për sjelljen e efektit sipas të drejtës së brendshme të shtetit ekzekutues dhe, në përgjithësi, të vendimit të tij për të mos iu referuar shkaqeve të hedhjes poshtë, siç parashikuar nga neni 18 i Konventës së Strasburgut të vitit 1990.

Ky sistem është shënuar në praktikë nga një dallim i qartë mes nivelit të kushteve të kërkuara për ekzekutimin e sekuestrimit dhe atij që shërben për njohjen e konfiskimit.

Në këtë rast të fundit, meqë kërkohet të kapërcehet një kontroll që nuk ndryshon aspak nga ai i që ka parashikuar gjithmonë sistemi tradicional i bashkëpunimit që mbështetet te kërkesa, mbërrimë ta ulim ndjeshëm dobinë e njohjes së ndërsjellë, funksionimi në praktikë i të cilës arrin të jetë

i barazvlefshëm me funksionimin e vjetër, të Tetëqindës, tipik të letërporosisë.

Ky rrezik, në vija të përgjithshme, ishte mjaft i qartë në nivelin politik evropian – i shprehur si i tillë në Njoftimin e fundit të Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin evropian mbi njohjen e ndërsjellë të vendimeve penale përfundimtare¹⁸⁵ – por tregon sigurisht që, edhe në perspektivën më të vogël të konfiskimit, nuk është e mundur t'i shmangesh, pasi duhet pritur adoptimi dhe zbatimi në të ardhmen i këtij propozimi të Vendimit kuadër për ekzekutimin e urdhrave të konfiskimit¹⁸⁶, apo nisja e periudhës së përafrimit të legjislacionit të parashikuar, përreth instrumentit më të rëndësishëm të ligjit kuadër, në Projektin e Kushtetutës Evropiane.

Në çdo rast, një procedurë kaq e ndryshme ekzekutimi e njërit apo tjetrit lloj akti del të jetë më e kritikueshme nëse merren parasysh risqet lidhur me mundësinë e ekzekutimit të sekuestrimeve që synojnë më moskrijim të ardhurash më pas, sepse nga njëra anë nuk mund të zhvillohet asnjë kontroll në fazën e përkohshme dhe nga ana tjetër, në mungesë të një vendimi kuadër edhe në këtë fushë, që është ende në fazë negocimi, duhen respektuar parametrat më të ngurtë të konventave në fuqi në lidhje me ndihmën gjyqësore për qëllim konfiskimi¹⁸⁷.

¹⁸⁵ Krs. Materiali i mbledhur në *Il riconoscimento reciproco delle sentenze penali në Bashkimin Evropian*, nën kujdesin e G. DI LELLO, GUE/NGL, 2001.

¹⁸⁶ Me nismë të Kryesisë daneze, më 19 dhjetor 2002, Këshilli i drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme mërriti në marrëveshjen e parë politike mbi një propozim të Vendimit kuadër për ekzekutimin në territorin e Bashkimit Evropian të urdhrave të konfiskimit, duke deklaruar qëllimin e zgjerimit të mundësive të bashkëpunimit mes Shteteve anëtare sipas skemës së njohjes së ndërsjellë.

¹⁸⁷ Gjatë negociatave dolën dy propozime të ndryshme ndërmjetësimi, njëri italian dhe tjetri holandez, të dyja që kishin për qëllim përafrimin e kriterëve që përkrijnë me kontrollin e kërkesave për ekzekutim të sekuestrimit dhe konfiskimit.

Sipas propozimit italian, do ish më mirë të parashikohej një mundësi për kontroll homogjen të themelit të njërit apo tjetrit akt lidhur me kriterin e shfaqjes së jashtëzakonshme të rreziqeve për mbrojtjen e interesave thelbësorë të shtetit ekzekutues

Ndërsa teza e delegacionit holandez kërkonte të lejohej kontrolli i themelit të kërkesës për ekzekutim të një urdhër sekuestrimi, sipas kriterit të mbrojtjes së parimeve themelore të shtetit ekzekutues, por pa shtrënguar në asnjë mënyrë hapësirën e arsyeve të mundshme të mospranimit në fazën ekzekutive përfundimtare.

Në përfundim, nëse propozimi holandez kish si qëllim objektiv të pengonte çdo përparim të ndjeshëm të niveleve të bashkëpunimit të mundshëm, teza e delegacionit italian, në mënyrë abstrakte, kish meritën se propozonte uljen e niveleve dhe disniveleve të grancive të efektshmërisë së bashkëpunimit ndërkombëtar mes fazës së masave të sigurisë dhe asaj të mëvonshme të konfiskimit, me qëllim që ky objektiv të ndiqej, jo më përmes një shtrëngimi të nevojshëm të vetëgjykitimit që lidhet me numrin e arsyeve për mospranim që sot mund të

Ndoshta, në këto nisma të ndryshme pasqyrohet kompleksiteti i ndryshëm i çështjeve përkatëse, por ndoshta është e mundur të dallohet në zgjedhjet e bëra edhe një tjetër pasqyrim më i përgjithshëm i prirjes politike për të privilegjuar aspektet simbolike të veprimtarisë ndëshkuese dhe, në këtë këndvështrim, për të enfatizuar rëndësinë e ndërhyrjes së sigurisë kundrejt mbrojtjes së nevojave procedurale që lidhen me krijimin e vendimit përfundimtar mbi pasurinë e sekuestruar.

Pavarësisht nga kjo vendimi kuadër mbi ekzekutimin e urdhrave të bllokimit dhe sekuestrimit përbën një risi që vështirë se mund të mohohet.

Ai ndihmon në rritjen e ndikimit ndërkombëtar mbi ligjet procedurale kombëtare, duke e bërë më urgjente përshtatjen e tyre ndaj modelit të bashkëpunimit që, ndonëse para vështirësive dhe pengesave të çfarëdo lloji, tashmë po merr formë në kuadrin evropian.

Nuk kemi kohë për të bërë një rikonjicion të hollësishëm të përmbajtjes së Vendimit kuadër.

Ndoshta do të mjaftonte të vërenim se:

- 1) për qëllime të ekzekutimit, nuk kërkohet kriteri i inkriminimit të dyfishtë, nëse urdhri i sekuestrimit dhe bllokimit nxirret në çështje që kanë të bëjnë me krime që u referohen 32 kategorive me prirje kryesisht ndërkufitare dhe me një aftësi të ndryshme përshkrimi

kundërshtojnë ekzekutimin e urdhrave përfundimtarë, duke e kushtëzuar edhe ekzekutimin e masave të sigurisë ndaj mosekzistencës së rreziqeve thelbësore të Shtetit, ndonëse duke zbutur aftësinë e mundshme zbatuese të klauzolës tradicionale ligjore duke iu referuar karakterit të jashtëzakonshëm të refuzimeve të arsyetuara në këtë mënyrë.

Në vlerësimin e domethënies së propozimit italian duhet mbajtur gjithashtu parasysh se kontrolli që synon mbrojtjen e të ashtuquajturve interesa thelbësorë të Shtetit, si rregull, do ish i mundur vetëm në kuadrin politiko-administrativ, gjë që del në kundërshti me objektivin e përgjithshëm të depolitizimit të çështjes që natyrisht karakterizon idenë e bashkëpunimit të Traktatit të Amsterdimit dhe të gjithë dokumentave të tjerë evropianë të mëvonshëm: të thjeshtohet, të përshpejtohet, të lehtësohet bashkëpunimi mes qeverive dhe autoriteteve gjyqësore.

Na duhet të kujtojmë këtu se në relacionin e lartpërmendur përfundimtar të Grupit Shumëdisiplinor “Krimi i organizuar”, në analizën e të dhënave e informacioneve të mbledhura lidhur me arsyet e mospranimit të ekzekutimit të kërkesave për ndihmë juridike që kanë për objekt sekuestrime dhe konfiskime, vërehet se *“dylvefshmëria mes vlerësimit politik dhe analizës nga ana e A.G.J. është analizuar në shumë vlerësime pasi është shkak për vonesa në ekzekutim dhe burim pështjellimi në dhënien e kompetencave”*.

Sidoqoftë, propozimet e kundërta alternativë deri tani janë hedhur poshtë dhe ka kryesuar ideja për të ecur drejt njohjes së ndërsjellë të qëllimit të sekuestrimit dhe, anasjelltas, për të mos sjellë asnjë risi thelbësore në rregullimin e kushteve të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare.

objektiv (janë sidoqoftë po ato të renditura në Vendimin kuadër të urdhrin të arrestit evropian);

- 2) arsyet e mospranimit mbështeten ende në parametra mjaft të ngurtë (parregullsi formale të vërtetimit të përcjelljes, ekzistenca e shkaqeve të imunitetit apo privilegjit, shkelje e parimit të *ne bis in idem* menjëherë i provueshëm);
- 3) ekzekutimi është plotësisht i depolitizuar, duke parashikuar përcjelljen e kërkesës për ekzekutim drejtpërsëdrejti tek a.gj. që ka nxjerrë aktin tek ai që duhet ta ekzekutojë atë;
- 4) ekzekutimi bëhet sipas formaliteteve dhe procedurave të treguara nga Shteti që nxjerr urdhrin për të garantuar vlefshmërinë e provës, me përjashtim të rastit kur këto formalitete dhe procedura bien në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit të Shtetit ekzekutues.

Prirja për të braktisur parimin e *lex fori*, ndiqet nga rregulli sipas të cilit (neni 11), nëse palëve të interesuara (përshirë të tretët në mirëbesim) duhet t'u jepen mjete kundërshtimi (ankimimi) – pa asnjë efekt pezullues – që mund të ekzekutohen si në Shtetin që e nxjerr aktin ashtu dhe në atë ekzekutues, arsyet e themelit mbi të cilat mbështetet akti i sekuestrimit apo i bllokimit mund të kundërshtohen vetëm përmes një veprimi përpara një autoriteti gjyqësor të Shtetit që nxjerr aktin.

Në lidhje me një mekanizëm procedural të tillë, është pra e pamundur të mbështetet akuzueshmëria juridiko-formale e aktit përpara autoritetit të shtetit ekzekutues.

Kompetenca juridiksionale që gjen zbatim është drejtpërsëdrejti ajo e Shtetit që kërkon ndihmë për qëllime ekzekutive.

Nga parimi i njohjes së ndërsjellë rrjedh rotacioni i pashmangshëm i sistemit të garancive mbi boshtin e treguar nga legjislacioni i Shtetit kërkues.

Risia e efekteve të ndërtimit ligjor të një instituti që frymëzohet në parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore mbi format e garancisë mund të ndihmojë në futjen e një teme të fundit analize, rregullimi i të cilës është ndikuar fort së fundi nga një vendim mjaft i rëndësishëm i Seksioneve të Bashkuara penale, të cilave iu kërkua të gjykonin mbi pranueshmërinë e një kërkesë për rishqyrtim të propozimit kundër një

kërkese për ekzekutim jashtë vendit të një sekuestrimi për qëllime prove paraqitur sipas rregullave tradicionale të ndihmës gjyqësore¹⁸⁸.

Vendimi i Seksioneve të Bashkuara erdhi si pasojë e vendimeve që kundërshtonin orientimin tradicional, theksuar sërish së fundi nga S.C.¹⁸⁹, sipas të cilit, kundër sekuestrimit të kërkuar para një autoriteti gjyqësor të huaj, nuk do pranoheshin ndreqje të ndryshme nga ato të parashikuara nga legjislacioni i Shtetit të cilit i kërkohet ndihmë, dhe i takonte vetëm atij të ta konsideronte të vlefshëm aktin.

Ky opinion me rrënjë të forta mbështetet në thënien sipas të cilës meqë në bazë të një norme të drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të njohur, ushtrimi i juridiksionit, si shprehje e sovranitetit kombëtar, nuk mund të kapërcejë kufijtë territorialë të çdo Shteti, një akt juridiksional nuk mund të merret ndryshe veç nga autoriteti gjyqësor i po këtij Shteti në territorin e të cilit kërkohet të jetë i vlefshëm, në mënyrë të tillë që për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit referenca e vetme është ligji i Shtetit ekzekutues.

Me fjalë të tjera, meqë autoritetit të huaj i duhet të verifikojë, të paktën që akti i kërkuar përputhet me rregullat e brendshme të legjislacionit të vet, akti i sekuestrimit konsiderohej në rrafshin juridik se i takonte vetëm autoritetit të huaj që e kish marrë dhe, si i tillë, ish i kundërshtueshëm sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin e Shtetit të kërkuar.

Përtej regjimit të kundërshtimeve të këtij legjislacioni të fundit, u prania vetëm mundësia për t'i kërkuar autoritetit gjyqësor italian kthimi i pasurisë (të mirës), që ndoshta mund të pasohet nga një sigurim ekzekutimi ndaj hedhjes poshtë të kërkesës, ajo që, natyrisht, supozon në vetvete që pasuria e sekuestruar është transferuar materialisht në Itali.

Ky rregullim ish tronditur nga disa vendime¹⁹⁰ që kishin pohuar se “kompetenca për të vendosur si mbi nevojën e sekuestrimit të kërkuar dhe ekzekutuar jashtë vendit, ashtu dhe për ruajtjen e tij për qëllime të procedimit penal, nuk mund të jetë veç i Shtetit kërkues, pasi vetëm ai ka mundësinë të përcaktojë, në bazë të krimit për të cilin procedon dhe të elementëve të tjerë në zotërim të tij, nëse sekuestrimi i ekzekutuar nga autoriteti gjyqësor i huaj shërben, apo jo, për procedimin dhe bën pjesë një

¹⁸⁸ Seksionet e Bashkuara penale, 16 prill 2003 (dep.15 maj 2003), Monnier, n.2003/21420.

¹⁸⁹ Seksioni IV, 12.12.2001 CASTELLUCCI, në *Guida al diritto*, 2002, fash.8, 103, e vijues, me koment të E.CALVANESE Për pohime të mëparshme, shih Sez.VI, 19.11.1993, PALAMARA, në *C.e.d. Cass.* n.198237).

¹⁹⁰ Sez.I, 23.10.1997, RUSSO, në *C.e.d. Cass.* nr.209890; Id., 20.09.2002, Monnier, *C.e.d. Cass.*nr.222864.

prej atyre rasteve në të cilat, sipas legjislacionit italian, lejohet sekuestrimi e një sendi të caktuar. Me të vetmin kufizim sipas të cilit gjyqtari italian nuk mund të njohë rregullsinë e akteve ekzekutuese të sekuestrimit të kryera nga autoriteti gjyqësor i huaj apo nga organet e p.gj. të autorizuar prej tij, sepse, meqë sekuestrimi i ekzekutuar sipas legjislacionit të Shtetit të kërkuar, vetëm gjyqtari i këtij vendi është kompetent për të shqyrtuar dhe zgjidhur çdo çështje që ka të bëjë me rregullsinë e procedimit marrës, që ka ndodhur sipas ligjit të vet”.

Përpara kësaj dileme, Seksionet e Bashkuara pohuan parimin sipas të cilit “kërkesa për ndihmë gjyqësore ndërkombëtare për ekzekutimin e një sekuestrimi për qëllime prove jashtë vendit është e kundërshtueshme më vete me kërkesë për rishqyrtim, sepse prezumon një akt sekuestrimi të pavarur, ndonëse ndonjëherë vetëm implicit, të marrë nga autoriteti gjyqësor italian”.

Në arsyetimin e vendimit Seksionet e Bashkuara pohuan se sidoqoftë do ish e mundur të dallohet në letërporosinë me qëllim sekuestrimi një fazë vendimmarrëse, që i takon vetëm autoritetit gjyqësor italian, dhe një fazë ekzekutive, e cila do i takonte vetëm e vetëm autoritetit të huaj dhe, si e tillë, do të rregullohej nga e drejta e Shtetit të kërkuar.

Lidhur me kriterin e kësaj ndarjeje strukturore, mes vendimit dhe ekzekutimit të sekuestrimit, është pohuar pamundësia që mund të rrjedhë prej saj një privim e instrumenteve të mbrojtjes që kanë për qëllim kontrollin e ekzistencës së kushteve ligjore të përcaktuara në dritën e vendosjes së një detyrimi për padisponueshmëri paraprake të kërkesës për ndihmë gjyqësore.

Me fjalë të tjera, thonë Seksionet e Bashkuara, nga ruajtja e opsionit tradicional hermeneutik rrjedh një boshllëk i patolerueshëm i garancive mbrojtëse, që lidhet me mungesën e zgjidhjeve kanonike të të drejtës së brendshme në mbrojtje të nevojës për të verifikuar që në krye ekzistencën e kushteve ligjëruese të marrjes së aktit të sekuestrimit.

U mendua se ky boshllëk mund të mbushej duke pranuar rishqyrtimin kundër letërporosive (*rectius*, sekuestrim implicit në letërporosinë që ka për qëllim të sigurojë sekuestrimin jashtë vendit), aq sa duhet parë si alternativë vetëm përdorimi i sigurimit të kushtetueshmërisë së rregullës legjislative siç interpretuar deri tani (ex nenet 3 e 24 Kusht.).

Megjithatë, për të mbrojtur këtë tezë të kontrollit të dyfishtë gjyqësor, Gjykatës së Kasacionit i është dashur të përdorë një rindërtim të strukturës

së kësaj veprë, duke pohuar se kërkesa për sekuestrim jashtë vendit do të supozonte sidoqoftë një dekret sekuestrimi të a.gj.italian që, nëse nuk do ish marrë më vete, duhet të konsiderohet sidoqoftë implicit në letërporosi, pasi nuk mund të mendohet ndryshe një ndarje konceptuale mes një juridiksioni mbi sekuestrimin (burim ekskluziv i detyrimit të padisponueshmërisë në territorin italian të pasurisë që do ish kriteri implicit por i nevojshëm i aktit shtrëngues të mëvonshëm të huaj) dhe një juridiksioni mbi ekzekutimin, i cili i besohet vetëm legjislacionit të cilit i kërkohet ndihma.

Për sa i takon këtij arsytimi le t'i largohemi modelit konceptual mbi të cilin tradicionalisht mbështetet sistemi i ndihmës gjyqësore ndërkombëtare, bazuar mbi letërporosinë dhe mbi idenë për të autorizuar një tjetër Shtet të kryejë veprimtari juridiksionale që, pasi kryhen, sipas rregullave formale dhe procedurale të legjislacionit të cilit i kërkohet bashkëpunimi, është e udhës të vërejmë se i takojnë vetëm Shtetit të cilit i kërkohet ndihma, ashtu si asonanca më e madhe ndaj modelit teorik të njohjes së ndërsjellë i takon sot vetëm Vendimit kuadër të sipërpërmendur.

Por e mbi të gjitha mund të jetë interesante të vërejmë disa aspekte specifike problematike.

Vetë ideja mjaft novatore për një akt sekuestrimi “implicit”, të cilit i kërkohet të justifikojë përdorimin e disa ndreqjeve procedurale të brendshme, duhet të përballet me disa të dhëna të të drejtës ndërkombëtare penale.

Analiza e burimeve ndërkombëtare tregon në fakt që për të ekzekutuar një letërporosi që ka për objekt një sekuestrim, vetëm në disa mjedise të veçanta bashkëpunimi, që mbështeten në marrëveshje dypalëshe, kërkohet – kur është e qartë se bëhet fjalë për të garantuar seriozitetin e kërkesës për ndihmë gjyqësore – marrja paraprake e një akti sekuestrimi nga ana e autoritetit që paraqet letërporosinë apo bashkëngjitja e dokumenteve të barazvlefshëm për të provuar qëndrueshmërinë e arsyeve paraprake që qëndrojnë në bazë të kërkesës për ndihmë, por sidoqoftë pa rrezikuar që kjo të cenojë në njëfarë mënyre prerogativat e autoritetit të cilit i dërgohet letërporosia në lidhje me vlerësimin e kriterëve të të drejtës së brendshme për marrjen e aktit të sekuestrimit.

Përtej rasteve në të cilat është legjislacioni i brendshëm i Shtetit të cilit i kërkohet ai që kërkon bashkëlidhjen e aktit të sekuestrimit që mund të jetë marrë në Shtetin që paraqet letërporosinë (si, për shembull, parashikojnë *Udhëzimet për Autoritetet Gjyqësore dhe Prokurorinë* e Mbretërisë së Bashkuar), ekzistojnë në fakt, disa marrëveshje ndërkombëtare (marrëveshja

dypalëshe me Kanadanë)¹⁹¹ na kufizon të parashikojmë detyrimin e bashkëlidhjes së letërporosisë së një deklarate të autoritetit kompetent në shtetin që dërgon letërporosinë i cili do të vërtetonte sekuestrimin “*mund të merret nëpërmjet masave shtrënguese nëse të mirat do të gjendeshin në territorin e Shtetit kërkues*”.

Por bëhet fjalë për raste të jashtëzakonshme, që tregojnë qartë se rregulla ndërkombëtare e përgjithshme e konsideron të mjaftueshëm aktin e thjeshtë të shtysës së juridiksionit të Shtetit të kërkuar, për sferën juridiksionale të cilës i përket njohja e kritereve të marrjes së aktit të sekuestrimit.

Thelbi i çështjes në fjalë përkon sidoqoftë me verifikimin e ekzistencës konkrete të boshllëkut të mbrojtjes për rrjedhojë, sipas arsytimit të sjellë nga Seksionet e Bashkuara, për të ruajtur opsionin interpretues më tradicional.

Për këtë qëllim, duhet të mbajmë parasysh se, përtej instrumentave të mbrojtjes që sjell legjislacioni të cilit i kërkohet ndihmë (që janë shpesh të shumtë dhe depërtues, mjafton të mendojmë për sistemin e ankimeve të rregulluar nga legjislacioni zviceran, i cili është thjeshtuar vetëm në lidhje me pastrimin e parave duke përqendruar rekursat para gjyqtarëve federalë, por që nga ana tjetër shtrihet në disa shkallë), kuadri mbrojtës i interesave individualë ka një shtrirje komplekse që vjen nga kombinimi i këtyre zgjidhjeve a ndreqjeve me instrumente të tjerë të mbrojtjes, po kësaj here të të drejtës së brendshme.

Përtej mundësisë për të propozuar një sigurim ekzekutimi, ne mund të ndërmarrim nga njëra anë procedurën e kontrollit gjyqësor mbi refuzimin e mundshëm nga ana e prokurorit të kërkesës për kthimin e pasurisë së sekuestruar dhe, nga ana tjetër, mekanizmi i kontrollit që gjen zbatim në perspektivën e përdorimit të provës së marrë sipas rregullave procedurale të Shtetit të cilit i paraqitet letërporosia në bazë dhe për efekt të nenit 729 k.p.p.

Me të drejtë, është vënë re se gjykimi i përshtatshmërisë së kuadrit të garancive duhet dhënë duke mbajtur parasysh kuadrin e referimeve ligjore dhe të gjitha fazat e procedurës, i tillë që humbja e fazës së rishqyrtimit mund të njihet si e kryer nga përdorimi i instrumenteve të kontrollit të rregulluar nga *lex loci*.¹⁹²

¹⁹¹ Për këto të dhëna, shih E.CALVANESE, *La cooperazione giudiziaria in materia di sequestro*, në *Cassazione penale* (në botim e sipër).

¹⁹² G.DIOTALLEVI, *L'Impugnabilità con istanza del riesame davanti al giudice italiano di una richiesta di sequestro probatorio all'estero. Spunti di riflessione dopo la sentenza delle Sezioni Unite*, në *Cassazione penale* (në botim e sipër).

Po ta shohim më me kujdes, një boshllëk i mbrojtjes në rregullimin e kodit në lidhje me letërporositë ekziston vërtet, por nuk ka të bëjë me letërporositë me jashtë, por procedimi i ekzekutimit të letërporosive nga jashtë dhe, në mënyrë paradoksale, vendimi i Gjykatës që sapo kritikua ndihmon për ta justifikuar atë, aty ku gjen argument nga teza tradicionale sipas të cilës kundrejt veprimtarisë së marrjes së provës së kryer në territorin italian me kërkesë të një autoriteti të huaj do mund të përdorej vetëm instrumenti i sigurimit të ekzekutimit, për të marrë një tjetër konfirmim të pranueshmërisë së nevojshme të rishqyrtimit për kërkesa sekuestrimi jashtë vendit.

Mungesa e një parashikimi të qartë të subjektit të interesuar nga kryerja e akteve të letërporosisë ndër subjektet marrës të njoftimit të thirrjes për në seancën e thirrur për të njohur pranueshmërinë e letërporosisë është rrënja specifike ligjore e këndvështrimit tradicional jurisprudencial të gjykimit të *exequatur* që zhvillohet përpara Gjykatës së Apelit si gjykim pa debat, për të kundërshtuar përfundimin negativ pa të cilin nuk do mund të propozohej sigurimi i ekzekutimit¹⁹³.

Bëhet fjalë për një ngjyrim tradicional të procedurës së *exequatur* ndërkohë që vështirësia për ta justifikuar – ndonëse provohet të kufizohet rëndësia e gjithë procedurës së pranueshmërisë së letërporosisë nga jashtë në planin ekskluziv të marrëdhënieve mes Shteteve¹⁹⁴ – është theksuar fort nga doktrina¹⁹⁵, që ka paditur natyrën e dukshme të funksionit të garancisë që në mënyrë abstrakte u referohet moduleve “paternaliste” të trajtimit të çështjes

¹⁹³ Mbi gjithë rregullimin që sjell kodi në lidhje me letërporositë, lejomëni t'i referohem G.MELILLO, *Ruoli e forme della garanzia giurisprudenziale*, në *Rogatorie penali e cooperazione*, cit., 265 e në vijim.

¹⁹⁴ Për këtë rast, P.LASZLOCZKY, *La cooperazione internazionale negli atti d'istruzione penali*, Cedam, 96.

¹⁹⁵ Mbi këtë temë specifike, krs.: G.CAPALDO, Sub. *Neni 724*, në *Commento al nuovo codice di procedura penale*, nën kujdesin e M.CHIAVARIO, Utet, vëll. VI, fq. 779-780; C.VALENTINI REUTER, *Il controllo dell'autorità giudiziaria italiana sugli atti istruttori effettuati in esecuzione di rogatorie internazionali: un'eterna attesa nel deserto dei tartari*, në *Giur.It.*, 1995, II, p.143 e vijues; G.CATELANI, *I rapporti internazionali in materia penale*, Giuffrè, 195, fq.311; C.VALENTINI, *L'acquisizione della prova fra limiti territoriali e cooperazione con autorità straniere*, Cedam, 1998, fq.143 e në vijim; A.GIOVENE, zëri *Rogatoria*, në *Digesto penale*, vëll. XII, fq.579; J.P.PIERINI, *Assistenza giudiziaria a favore di autorità straniere e diritto di difesa: è vera incompatibilità?* në *Cass.pen.*2002, fq.1113 e në vijim.

Në bazë të kodit të shfuqizuar, problemi i kushtetueshmërisë së mungesës së parashikimit të njoftimit të të interesuarit dhe mbrojtësit të tij u ngrit nga G.D.PISAPIA. *Compendio di procedura penale*, Cedam, V botimi, 1987, fq.626.

procedurale që parashikojnë vetëm pjesëmarrjen e organit të akuzës¹⁹⁶ dhe mungesën e themelit kushtetues, në dritën e parimit të nenit 24 të një interpretimi të rregullimit të kodit që mohon të drejtën e pjesëmarrjes së mbrojtjes në seancën që ka për qëllim shqyrtimin e ekzistencës së kritereve të bashkëpunimit gjyqësor të kërkuar konkretisht dhe, edhe të kritereve ligjore të pranueshmërisë së veprimtarive të letërporosisë, si të tilla të destinuara të bëhen pjesë në një procedim të huaj në të cilin i interesuari mund të jetë drejtpërsëdrejti i përfshirë dhe, sidoqoftë, në vetvete në gjendje të ndikojë drejtpërsëdrejti dhe menjëherë në po këtë sferë juridike individuale dhe, brenda saj, edhe në rregullimin e pasurive (të mirave) që mbrohen nga kushtetuta.

Për këtë qëllim është theksuar edhe mungesa e çdo referimi në punët përgatitore të kodit të procedurës penale për të dhënë shpjegime për përjashtimin e mbrojtjes nga seanca e dhomës në fjalë¹⁹⁷.

Madje, duke i dhënë rëndësi aspektit ekzegjetik apo interpretues të referencës së shprehur në debatit parlamentar ndaj profilit të veçantë të mundësisë për të parashikuar pjesëmarrjen në seancë të një përfaqësuesi të Shtetit të huaj, që më pas u përjashtua për shkak të shqetësimit se po futej kështu një rregull “i tillë që mund të vinte në rrezik ekuilibrat e debatit”¹⁹⁸, merret konfirmimi jo i drejtpërdrejtë se ideja e plotësisë së debatit duhet të jetë e pranishme në mendjen e ligjvënësit, aq sa ta shtyjë atë të mbajë parasysh mundësinë e mosbalancimit të marrëdhënieve procedurale për shkak të ndërhyrjes së një figure tjetër procedurale të cilës i kërkohet të përfaqësojë interesat që bien ndesh me ato të subjektit, titullar i sferës juridike që preket nga ekzekutimi i veprimtarive procedurale të kërkuara.

Gjithashtu u vërejt se si mundësia që të marrë pjesë edhe mbrojtja në seancë logjikisht duket se është diçka që parashikon rregullimi i kodit për objektin e kontrollit juridiksional të pranueshmërisë së letërporosisë, në rastet kur parashikohet që pëlqimi i të pandehurit (pa prekur aspak atë çka parashikojnë modalitetet përkatëse të shprehjes dhe përmbledhjes) shërben për të kapërcyer arsyet e mospranimit të ekzekutimit të parashikuara në germa b) dhe c) të parag. të pestë të nenit 724 k.p.p.¹⁹⁹, e duke parë²⁰⁰

¹⁹⁶ C.VALENTINI, *L'acquisizione della prova*, cit, fq.144.

¹⁹⁷ G.CAPALDO, *Sub.art. 724, cit*, fq.779; C.VALENTINI, *L'acquisizione della prova*, cit.fq.143-144.

¹⁹⁸ Kshtu *Parere della Commissione Parlamentare*, sub neni 714, në A.GAITO (nën kujdesin e, *Il nuovo codice di procedura penale*, vëll.VI, Cedam, 1990, fq.1521.

¹⁹⁹ G.CAPALDO, *Sub.neni 724, cit*, fq. 1521.

²⁰⁰ C.VALENTINI, *L'acquisizione della prova*, cit. fq.145-146.

gjithashtu se efektiviteti i po këtij funksioni verifikimi i këtyre arsyeve (e sidomos i ekzistencës së arsyeve të diskriminimit të urryer, të parashikuara nga dispozita e dytë ndër ato të sipërpërmendura) kërkon në mënyrë të arsyeshme bashkëpunimin e të interesuarit.

Rrjedh nga kjo një përpjekje e madhe për të zbutur me interpretim boshllëkun e mbrojtjes që krijohet për shkak të faktit që legjislacioni nuk përmend të pandehuri dhe as mbrojtësit të tij në radhën e personave që marrin njoftimin për seancën e dhomës, rëndësia e të cilit mund të kuptohet edhe përmes vlerësimit të efektit të përgjithshëm të zvogëlimit të mëtejshëm të garancive të mbrojtjes që rrjedh njëherësh nga njëra anë nga mohimi i zakonshëm i kundërshtueshmërisë së vendimmarrjes përfundimtare të procedurës përpara gjykatës së apelit dhe, nga ana tjetër, nga ngushtësia e marzheve të mbrojtjes që pranohen rregullisht përmes ndreqjeve a mjeteve të lejuar për akte të veçanta ekzekutimi)²⁰¹.

Thamë pra që boshllëku do ishte “i justifikueshëm vetëm nëse do të vërehej se vjen nga mundësia që kërkesa për bashkëpunim mund t’i referohet një procedimi që ende nuk ka një të pandehur”²⁰², pasi përndryshe do ish e pamundur të përdornim zbatimin analogjik të rregullimit të përgjithshëm të procedimit në dhomë për të realizuar integrimin e debatit²⁰³.

Por mangësisë së doktrinës drejt një interpretimi të nenit 724, parag.3, k.p.p. “që i referohet debatit”²⁰⁴ iu kundërvu një qëndrim i vazhdueshëm i jurisprudence, edhe i ligjshëm, që zhvleftësonte hapur kërkesat për vlefshmëri të mbrojtjes të të pandehurit të përfshirë në procedurën e ekzekutimit të një letërporosie pasive, pasi konsiderohej se binin ndesh qartë me pritshmëritë e të gjithëve për një bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar që

²⁰¹ Jurisprudencia e ligjshmërisë, edhe së fundi, ka theksuar se sigurimi i ekzekutimit ndaj akteve ekzekutivë mund të shërbejë për të vendosur, si në aktin *exequatur*, vetëm çështjet që kanë të bëjnë me ekzistencën dhe vlefshmërinë e titullit të ekzekutimit, ashtu dhe në rastin e mungesës së nënshkrimit (Kas., 14 prill 1999, Acampora, në *Cass.pen.2000*, fq.2356 e në vijim, me shënimin e R.FOIS, *Ancora una pronuncia sulla non impugnabilità dell’ordinanza di exequatur della Corte d’appello che dichiarata esecutiva una rogatoria internazionale e sui limiti di operatività dell’incidente d’esecuzione*). Po në këtë kuptim, Cass., 27.10.1994, menegatti, *këtu*, 1996, fq.1571.

²⁰² Shprehimisht, G.CATELANI, *I rapporti internazionali*, cit. fq.311.

²⁰³ G.CATELANI, *vep.loc.cit.* Në po këtë kuptim, C.VALENTINI, *L’acquisizione della prova*, cit., fq.144, si dhe G.DIOTALLEVI, Sub.neni 724, në G.LATTANZI-E.LUPO (nën kujdesin e), *Codice di procedura penale. Rassegna di giurisprudenza e di dottrina*, Giuffrè, 1999, fq.425, i cili pranon praninë në procedurën e dhomës të avokatit mbrojtës të të pandehurit sa herë që letërporosia ka të bëjë me veprimtari të provës lidhur me të pandehurin apo që, sidoqoftë, parashikojnë pjesëmarrjen e mbrojtjes.

²⁰⁴ Shprehja e sjellë është e C.VALENTINI, *L’acquisizione della prova*, cit.fq.146.

mbështetet në rregulla procedurale që sigurojnë efikasitetin dhe shpejtësinë e tij.

Përsëri sëfundi, Gjykata e Kasacionit ka marrë parasysh pabazueshmërinë e qartë të çështjeve të kushtetueshmërisë së rregullimit në fjalë që u ngritën gjatë rekursit të bërë nga mbrojtja e të pandehurit kundrejt urdhëresës për hedhje poshtë të sigurimit të ekzekutimit, me qëllim që të kundërshtohet shkëlja e të drejtës së mbrojtjes si rrjedhojë e mosnjohimit të seancës së dhomës kushtuar njohjes së pranueshmërisë së kërkesës për ndihmë gjyqësore²⁰⁵.

Dobësia e arsytimeve të vendimit të S.C. mbi temën që po trajtohet doli qartë duke marrë parasysh aftësinë e pakët provuese që arsyeshmërisht i lihet një konfirmimi të rregullës së epërsisë së të drejtës ndërkombëtare dhe vlerave të nivelit mbikombëtar që vjen nga përcaktimi i thjeshtë i një nevoje jo të përgjithshme për të rakorduar “normën e shprehur të nenit 24, parag.2, Kusht., ... me një tjetër normë të shprehur nga neni 10, parag.1, Kusht., ... dhe me normën e shprehur nga neni 11” si dhe, në çdo rast, me qëllimin që të përshpejtohet procesi në të cilin synonte legjislacioni ndërkombëtar mbi letërporositë, pa përcaktuar sidoqoftë burimet dhe konturet e sakta të një parimi specifik të të drejtës ndërkombëtare që konkretisht dhe në mënyrë të pandreqshme bie në kundërshtim me kërkesat për garanci që vijnë nga mungesa e çdo lloj mundësie, edhe të mëvonshme, deduktimi të mbrojtjes mbi çështjet që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e letërporosisë²⁰⁶.

Në të vërtetë, në planin e legjislacionit ndërkombëtar nuk është lehtësisht e kundërshtueshme ekzistenca, ndonëse brenda kufijve të përcaktuar me marrëveshje, e një detyrimi të Shtetit italian për të siguruar, sipas efektshmërisë, bashkëpunimin gjyqësor të kërkuar nga Shtete të tjerë, dhe, (natyrisht, në kushte reciprociteti) për të mos adoptuar apo ruajtur legjislacione procedurale të brendshme që, duke i lejuar të interesuarit të

²⁰⁵ Kas.25.02.1000, Acampora, në *Cass.pen.2002*, fq.1109, me shënim të J.P.PIERINI, *vep.lok.cit.*, Po kështu, ish shprehur Kas., 14 prill 1999, Acampora, në *Cass.pen.2000*, fq.2356, me shënim lidhur me këtë pikë të R.FOIS, *Ancora una pronuncia*, cit., duke saktësuar se me sigurimin e ekzekutimit mund të vihet në diskutim vetëm kompetenca territoriale e gjyqtarit të ekzekutimit që, në bazë të nenit 665, k.p.p., duhet parë vetëm tek ai që ka marrë aktin e kundërshtuar.

²⁰⁶ J.P.PIERINI, *Assistenza giudiziaria*, cit., fq.1116, që vëren gjithashtu që mundësia e një kontrolli mbrojtës të mëvonshëm nuk është logjikisht e përjashtuar as në dritën e parashikimeve më të fundit të Konventës së Bashkimit Evropian të dt. 29 maj 2000 (neni 4, § 2) në lidhje me detyrimin e Shtetit të kërkuar për të ekzekutuar kërkesat për ndihmë brenda një kohe sa më të shkurtër dhe duke mbajtur parasysh, për sa është e mundur, afatet procedurale dhe arsyet e tjera të shpejtësisë të treguara nga autoriteti kërkuar.

njihet paraprakisht me letërporosinë, të rrezikojë mundësitë reale për një ekzekutim të suksesshëm.

Kjo hapësirë konceptuale është përcaktuar, konkretisht, në lidhje me kërkesat që kanë për qëllim ekzekutimin me ndihmën e autoritetit italian të “akteve të befashme”, pra të gjithë atyre kërkesave të marrjes së provës (kontrolle, sekuestreimeve, përgjime bisedash, etj.,) që do të përfundonin duke mos pasur asnjë vlefshmëri nëse të interesuarit do t’i jepej (mundësia) për t’u njohur paraprakisht me to²⁰⁷.

Por nevoja të tjera, të ngjashme efektshmërie të bashkëpunimit ndërkombëtar duhen parë në rastet në të cilat del sidoqoftë rëndësia e pritshmërive që mund të plotësohen ligjshmërisht nga autoriteti dërgues i letërporosisë në ruajtje të konfidencialitetit të çështjes penale nga ku lindin nevojat për bashkëpunim ndërkombëtar dhe, në adoptimin e procedurave ekzekutive të kërkesës për ndihmë gjyqësore të tilla që shmangin çdo rrezik për qëllimet e hetimit pas ardhjes së ligjshme në dijeni nga ana e subjekteve të interesuar për faktin se janë duke u kryer veprimtari hetimore.

Le të mendojmë për letërporosinë që ka për qëllim të sigurojë dëgjimin e një dëshmitari, verifikime bankare apo sidoqoftë dokumentesh të veprimtarive ndoshta të paligjshme të një subjekti, marrjen e të dhënave të jashtme të bisedave telefonike apo, meqë mundësitë për të vepruar janë të shumta, çdo verifikim tjetër hetimor apo kërkimor të provës zhvillimi i të cilës është i mundur, sipas ligjit italian, pa pjesëmarrjen e të pandehurit dhe me garancinë e ruajtjes së sekretit që diktohet në vija të përgjithshme (neni 329, parag.1, k.p.p.) në mbrojtje të interesit kolektiv për kryerjen e suksesshme të veprimtarisë kërkimore dhe sigurimit të provës së një krimi.

Në raste të tilla autoriteti i huaj mund të parashtojë zyrtarisht nevojën për të ekzekutuar letërporosinë në mënyrë të tillë që të shmanget jo thjesht rrezikun që i pandehuri apo të subjektet e tjerë të mësojnë para kohe për ekzistencën e veprimtarive specifike të marrjes së provës, por gjithashtu rreziku i risqeve të mundshme e të pandreqshme për hetimet që po kryhen paralelisht sipas ligjit të Shtetit kërkues dhe të zhvillimeve të tyre të mëtejshme.

Meqë bëhet fjalë për kërkesa që në vetvete nuk bien në kundërshtim me legjislacionin juridik të Shtetit, meqë kanë për qëllim arritjen e utiliteteve që përkrijnë plotësisht me ato të siguruara nga statuti i përgjithshëm i veprimtarive të hetimeve paraprake të prokurorit italian (me përjashtim të

²⁰⁷ C.VALENTINI, *L’acquisizione della prova*, cit., fq.145-147; J.P.PIERINI, *Assistenza giudiziaria*, cit., fq.1116.

rastit kur do vërtetohej ndikimi që mund të kenë ndryshime të mundshme të rendit të sistemit që kanë të bëjnë me një afirmim të mundshëm parlamentar të këndvështrimeve ekstremiste të nevojave për një përshtatje legjislative që vijnë nga parimi sipas të cilit kryeradha e dytë e nenit të ri 111 Kusht., në lidhje me të drejtën e personit të akuzuar se është në dijeni të informacionit konfidencial mbi akuzën dhe arsyet e saj “brenda një kohe sa më të shkurtër”), i njëjti parim i efektshmërisë së bashkëpunimit që duhet të japë Shteti italian që është renditur më parë në planin e legjislacionit ndërkombëtar, sipas rregullimit procedural aktualisht në fuqi, shërben për të justifikuar, edhe në rastet e prezumuara si më lart, mosnjohimin e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij për seancën siç në nenin 724, parag.3, k.p.p. që, siç pamë, rrjedh arsyeshmërisht sa nga “aktet e befasishme” ashtu dhe nga konsiderata e thjeshtë e natyrës së objektit të letërporosisë.

Por si kur mbahet parasysh natyra e qenësishme e veprimtarive të marrjes që duhen kryer, ashtu dhe kur deduktohen në letërporosi kërkesa të tjera procedurale që kërkojnë ruajtje të fshehtësisë së veprimtarive që kryhen, vlera e mbrojtjes që legjislacioni ndërkombëtar u njeh arsyeve të efektshmërisë së bashkëpunimit mund të bëhet i pajtueshëm me nevojën për të mos sakrifikuar përtej një mase arsyeshmërisht të nevojshme kërkesat për mbrojtje të mbrojtjes, që gjë na bën të mendojmë se, në përputhje me objektin e kësaj mbrojtjeje ndërkombëtar, bën pjesë në legjislacionin procedural të brendshëm vetëm parashikimi i formave të debatit apo kontrollit të mbrojtjes që pretendojnë t’i paraprijnë ekzekutimit të letërporosisë dhe, në përgjithësi, fakti që nuk ekzistojnë më arsye për të ruajtur fshehtësinë e procedimit të autoritetit dërgues të letërporosisë.

Lidhur me problemet e sjella si më lart, aktualisht asnjë pengesë e të drejtës ndërkombëtare nuk vjen me qëllimin – i realizueshëm vetëm nëpërmjet veprimtarisë ligjvënëse që bëhet urgjente për shkak të mprehtësisë, që duhet parë edhe në lidhje me përmasat që kanë fituar sot bashkëpunimi modern risqet e cenimit të parimit të parashikuar nga neni 24 i Kusht. – për të parashikuar forma të përshtatshme (edhe në lidhje me nevojën për të mos e ngadalësuar bashkëpunimin ndërkombëtar përtej një mase të arsyeshme) të shtyrjes së kontrollit të mbrojtjes, duke ndryshuar sipas nevojës afatet dhe mënyrat e garancive të mbrojtëse²⁰⁸ në lidhje me

²⁰⁸ C.VALENTINI, *L’acquisizione della prova*, cit.fq.145-147; J.P.PIERINI, *Assistenza giudiziaria*, cit., fq.1116. Në veçanti, C.VALENTINI propozon, në një perspektivë *de iure condendo*, për t’i njohur personit të përfshirë për çfarëdo arsye nga letërporosia ndërkombëtare që ka për qëllim kryerjen e akteve të ashtuquajtura “të befasishme” aftësinë për të kërkuar ndërhyrjen e mëvonshme të gjyqtarit në funksion të kontrollit të pranueshmërisë së formave të ndihmës gjyqësore që përkthehen në një ndërhyrje në sferën

natyrën dhe kompleksitetin e hetimeve të autoritetit të huaj, përveçse me vlerën që përfaqëson në vetvete shpejtësia me të cilën bashkëpunohet.

GIOVANNI MELILLO
Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria Kombëtare Antimafi

Tiranë, Nëntor 2007

e lirive të njeriut që gjejnë mbrojtje në Kushtetutë; kontrolli i kritereve të bashkëpunimit që për këtë qëllim do të realizohet duhet të gjejë vend në një fazë pas ekzekutimit të aktit të letërporosisë që, për natyrën e vet, nuk është i pajtueshëm me ardhjen e parakohshme në dijeni nga ana e të interesuarit, por përpara nxjerrjes së urdhrit për përcjelljen tek autoriteti dërgues i letërporosisë të dokumentacionit të përfundimit të veprimtarisë së marrjes së provës të kryera ndërkohë (fq.147).

2.10. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme në Shqipëri, në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

§ 1. Kuptimi i sekuestros sipas K.p.p.

Sic dihet sekuestrimi është një institut i cili nuk funksionon vetëm në fushën e së drejtës civile, por edhe në atë të së drejtës penale. Duke pasur këtë marrëdhënie të dyfishtë ky institut ka krijuar gjithmonë dhe vazhdon të krijojë paqartësi pikërisht për shkak të karakterit të ndryshëm të funksioneve, organeve dhe procedurave që duhen ndjekur për kryerjen e një sekuestrimi, sipas faktit nëse ai përbën një sekuestrim civil apo penal.

Në parim, sekuestrimi është një kufizim i përkohshëm i të drejtave pasurore të një personi mbi një pasuri të caktuar të tij, i cili kryhet sipas një procedure të caktuar të përcaktuar posaçërisht në ligj. Ai shfaqet si një marrje sendesh apo shumash në para nga një organ shtetëror që çon në pamundësinë e pronarit të tyre apo personave të paautorizuar prej organit shtetëror përkatës për t'i disponuar.

Në Kodin Penal shqiptar janë parashikuar disa lloje sekuestrimesh, të cilat dallohen mes tyre, së pari për nga qëllimi që këto masa ndjekin:

- *Sekuestrimi për qëllime prove.* Ky lloj sekuestrimi i parashikuar nga nenet 208 deri më 220 të K.P.Penale shërben si mjet që mund të përdoret nga ana e Prokurorisë gjatë fazës së hetimit paraprak për kërkimin e provës;
- *Sekuestrimi si një masë sigurimi.* Ky lloj sekuestrimi parashikohet nga nenet 270 deri 276 të K.P.P., dhe përfshin sekuestron konservative (nenet 270-273 të K. Pr. Penale) dhe sekuestron preventive (nenet 274-276 të K.Pr.Penale);
- Por përveç parashikimeve në K.P.P., në ndihmë të organeve të ndjekjes penale është parashikuar edhe një lloj i ri sekuestrimi nga “Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”. Ky lloj sekuestrimi ka një natyrë të veçantë dhe përbën një risi në sistemin tonë penal. Pavarësisht se ai dallohet për nga regjimi i tij nga sekuestrat e parashikuara në KPP, duhet thënë se nga dy grupet e sekuestrove, ai ka ngjashmëri më tepër me sekuestron si masë sigurimi.

Pra, siç shihet instituti i sekuestrimit, në fushën e së drejtës penale, paraqitet në dy forma themelore të tij në vartësi të qëllimit që ndjek. Megjithatë e

përbashkëta mes tyre është se në çdo rast sekuestrimi përfaqëson një masë që vendoset mbi pasuri të caktuara që shkakton pamundësinë e personit për t'i gëzuar dhe për t'i disponuar këto sende për një periudhë të caktuar kohe. Si të tilla, ato nuk përfaqësojnë heqje definitive së të drejtës së pronësisë mbi pasuritë mbi të cilat ato vendosen.

§ 2. Sekuestrimi për qëllime prove.

Sekuetrimi i parashikuar posaçërisht nga nenet 208-220 të K.P.Penale është nje mjet i kërkimit të provës. Ai shërben për marrjen dhe ruajtjen e sendeve të caktuara me qëllim që përmes tyre organi i akuzës të realizojë procesin e vërtetimit të fakteve, objekt akuze. Organet e autorizuar nga K.p.p. për të vendosur këtë masë janë Gjykata ose Prokurori kundrejt një vendimi të arsyetuar. Por kur ka rrezik që gjurmët që përmbajnë sende të caktuara mund të ndryshojnë ose të humbasin dhe, kur nuk ka asnjë mundësi praktike për të pritur marrjen e një vendimi nga Prokurori, pa u prishur këto gjurmë, sekuestrimi mund të vendoset edhe nga një Oficer i Policisë Gjyqësore. Por në këto raste ai duhet të vërë në dijeni prokurorin për sekuestrimin e vendosur jo më vonë se 48 orët e ardhshme, i cili ose vleftëson sekuestron e vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore ose vendos heqjen e menjëhershme të kësaj mase, në vartësi të faktit nëse masa e vendosur përputhet ose jo me nevojat për marrjen e një prove.

Ky është rregulli i përgjithshëm që ndiqet për sekuestrimin për nevoja të marrjes së provës. Për shkak të sensibilitetit që kanë disa lloj të drejtash, siç është ruajtja e privacisë, Kodi ka parashikuar rregulla specifike për sekuestrimin e korrespondencës (neni 209) sekuestrimin pranë bankave (neni 210) apo sekuestrimin në zyrën e mbrojtësit. Kështu, në rastin e sekuestrimeve të korrespondencës, Policia Gjyqësore nuk gëzon asnjë kompetencë për të vendosur këtë masë, qoftë edhe në kushtet e emergjencës, e cila vetëm mund të pezullojë dërgimin e korrespondencës deri në marrjen e një vendimi nga ana e Prokurorit për vendosjen e sekuestrimit të saj ose heqjen e pezullimit të dërgimit sipas destinacionit që ka.

Kurse sekuestrimi pranë bankave kryhet vetëm nga Gjykata. Vetëm si përjashtim dhe vetëm kur ka arsye urgjence ky sekuestrim mund të kryhet edhe nga prokurori. Pra siç shihet, sekuestrimi pranë bankave nuk mund të kryhet nga Policia Gjyqësore në asnjë rast. Po kështu, Policisë Gjyqësore nuk i njihen të drejta sekuestrimi edhe në rastet e nevojës për sekuestrim të sendeve që ndodhen në zyrën e mbrojtësit. Sekuestrimi, në një rast të tillë,

bëhet personalisht nga gjyqtari, kurse gjatë hetimeve bëhet nga prokurori në bazë të një vendimi të lëshuar nga ana e Gjykatës.

§ 3. Sekuestrimi si masë sigurimi.

Sekuestrimi si masë sigurimi i parashikuar nga K.p.p. ndjek një qëllim tjetër nga ai i sekuestros për marrjen e provës. Në këtë kuptim, kjo sekuestro nuk synon të vendoset mbi sende apo pasuri që në vetvete përmbajnë gjurmë apo prova të nevojshme për vërtetimin e fakteve para Gjykatës. Për këtë arsye sendet apo pasuria objekt i kësaj lloji sekuestroje nuk kanë lidhje me veprën penale dhe nuk shërbejnë për të provuar fakte apo rrethana që lidhen me të. Brenda këtij grupi sekuestrimi për nevoja sigurimi, dallojmë dy lloji sekuestrosh: sekuestro konservative dhe sekuestro preventive.

A. Sekuestro konservative shërben si një masë me anë të së cilës sigurohet që pronari apo disponuesi i një pasurie, përkohësisht, nuk do të mund të ushtrojë të drejtat e tij të pronësisë mbi pasurinë e sekuestruar, me qëllim që përmes pasurisë objekt sekuestroje të mund të shlyhen të gjitha detyrimet e mundshme që do të ketë autori i veprës penale të kryer prej tij. Duke pasur këtë synim sekuestroja konservative shërben vetëm si mjet ‘konservues’ i pasurisë deri në shlyerjen e detyrimeve nga autori i veprës penale. Për më tepër ai mund të vendoset vetëm kur ka arsye të bazuara për të menduar se autori i veprës penale nuk garanton se do të paguajë dënimin me gjobë, shpenzimet e procedimit dhe të çdo detyrimi tjetër të mundshëm ndaj pasurisë së shtetit.

B. Sekuestro preventive shërben nga ana tjetër si një masë sigurimi që vendoset mbi sende të cilat, për nga natyra e tyre, mund të përdoren nga autori dhe për pasojë disponimi i tyre i lirë mund të lehtësojë kryerjen e veprave penale.

Sendet që mund të jenë objekt i sekuestros preventive kanë pikërisht këtë lidhje me veprën penale, pra ato janë të tilla që mund të përdoren për kryerjen e veprës penale. Pra nuk është fjala për një lidhje me karakter provueshmërie si në rastin e sekuestros për marrjen e provës, edhe pse mund të ndodhë që objektet nën sekuestro preventive mund të shërbejnë edhe si prova. Me fjalë të tjera, nëse një objekt është nën sekuestro preventive kjo nuk pengon aspak që ai të konsiderohet provë materiale e veprës penale, edhe pse nuk i është nënshtruar një sekuestroje me qëllim marrjen e provës. Nga ana tjetër, nëse një send është nën sekuestron si mjet për kërkimin e provës, nuk del e nevojshme vendosja edhe e një sekuestroje të dytë si masë sigurimi me karakter preventiv. Pra sekuestro preventive mund që të gjejë

zbatim vetëm në ato raste kur nuk është vendosur sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës, për mungesë të supozimeve se sendet në fjalë mund t'i shërbejnë të provuarit,

Sekuestrimi parandalues - parashikuar në Ligjin nr.9284, date 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".

Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar (ligji Nr.9284, datë 30.09.2004) ka sjellë një pasurim të kuptimit të institutit të sekuestrimit që parashikon KPP si dhe të regjimit të administrimit të pasurive të sekuestruara.

Sipas këtij ligji, sekuestrimi parandalues synon të privojë pronarin apo administratorin e një pasurie për të cilat ka të dhëna se mund të jenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të personit ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një grup veprash penale. Është fjala për një grup veprash penale të rënda të cilat janë tipike për aktivitetin kriminal të krimit të organizuar.

Natyra juridike e kësaj lloji sekuestroje është paksa e veçantë nga natyra e llojeve të tjera të sekuestrimeve që parashikon K.p.p.. Ky tip sekuestrimi duket si një masë që ka natyrën e një sekuestroje konservative por me disa ndryshime që qëndrojnë kryesisht në qëllimet që merr në konsiderate gjykata për të vendosur këtë masë si dhe në standardet që ajo aplikon për vendosjen e kësaj mase.

Kështu, ashtu si edhe në rastin e sekuestros konservative, siç dhe e përmendëm më sipër, edhe në rastin e sekuestros parandaluese sipas Ligjit 9284, kjo masë ka si qëllim ruajtjen apo konservimin e pasurisë së personit që dyshohet se ka kryer veprën penale me qëllim që ajo të mos fshihet, të transferohet apo të humbasë.

Por megjithatë, ndërsa me anë të sekuestros konservative synohet të sigurohet pagimi i detyrimeve që mund të lindin nga vepra penale, me sekuestrimin sipas ligjit 9284, synohet të sigurohet parandalimi i krimit të organizuar. Në këtë drejtim, pra të qëllimit për të parandaluar, sekuestro parandaluese ngjason në fakt me sekuestron preventive në kuptimin se ato kanë efekte të përafërta, siç janë parandalimi i pasojave të një vepre penale, apo pengimi i kryerjes së veprave të tjera penale.

Por pavarësisht nga ngjashmëritë me sekuestron preventive apo konservative, sekuestro parandaluese e parashikuar nga Ligji 9284 ka disa karakteristika të veçanta që lidhen kryesisht me standartet e shqyrtimit të saj.

Së pari, për të aplikuar sekuestron parandaluese barra e provës për të vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë i takon autorit të veprës penale, nga fusha e aplikimit.

Së dyti, sekuestrimi sipas ligjit 9284, në parim mund të zbatohet pavarësisht nëse është nisur ose jo një procedim penal ndaj personit mbajtës të pasurisë, edhe pse kërkohet prania e një dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e një kategorie të caktuar veprash penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 9284.

Së treti, ky sekuestrim zbatohet jo vetëm ndaj personave ndaj të cilëve mund të rëndojë dyshimi i arsyeshëm, por edhe ndaj bashkëshortit, fëmijëve, personave në gjini ose krushqi të afërt me ta apo edhe ndaj personave fizikë ose juridikë për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë e tyre zotërohen direkt apo indirekt, drejtpërdrejt apo tërthorazi nga personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale të përmendura më sipër.

Së fundi, sekuestrimi i vendosur sipas ligjit nr. 9284, i nënshtrohet disa afateve të përcaktuara në ligj të cilat janë specifike vetëm për këtë lloj sekuestrimi.

§ 4. Konfiskimi.

Konfiskimi parashikohet si në K.p.p., ashtu edhe në Ligjin 9284. Në të dy rastet ajo përfaqëson një masë të urdhëruar nga gjykata. Por këto konfiskime paraqesin karakteristika të cilat i bëjnë ato të dallohen cilësisht mes tyre.

1. Në rastin e konfiskimit të parashikuar nga K.p.p. kjo masë merret në përfundim të një vendimi dënimi. Kurse konfiskimi i parashikuar nga Ligji 9284 edhe pse është një masë e cila vendoset me kërkesën e prokurorit, merret jashtë një procedimi penal. Në këtë kuptim, ai mund të merret pavarësisht nga fakti nëse organi i Prokurorisë ka nisur ose jo një procedim penal.

Konfiskimi i parashikuar në nenin 36 K.p. është konceptuar si një lloj dënimi. Si i tillë ai është një konfiskim i tipit *ad Personam*, në kuptimin që vendosja e tij bëhet sipas standardit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm që është edhe standardi për të provuar fajësinë e të pandehurit. Kurse konfiskimi i parashikuar në Ligjin 9284 është një konfiskim i tipit *in Rem*. Pra, për vendosjen e tij zbatohet standardi që vepron në gjykimet civile, ai i së vërtetës më të mundshme (*balance of probabilities*). Me këtë rast dua të theksoj dyshimet e mia për kategorizimin e konfiskimit si masë dënimi. Së pari, në të gjitha kushtet për konfiskimin e detyrueshëm del qarte se ky

konfiskim apo privim i pronësisë nuk ka karakter ndëshkues, siç mund të ishte rasti i caktimit të një gjobe, por lidhet direkt apo indirekt me kundërligjshmërinë e pasurisë së konfiskuar. Së dyti, ky lloj konfiskimi vendoset edhe pse Gjykata mund të mos japë vendim dënimi, siç është rasti që parashikon germa «d» e nenit 36 të K.P..

2. Konfiskimi i parashikuar në nenin 36 të K.P. është një konfiskim i detyrueshëm. Kjo do të thotë se ky konfiskim nuk paraprihet domosdoshmërisht nga një vendim sekuestrimi i marrë paraprakisht në bazë të kërkesës së bërë nga Prokurori. Kurse konfiskimi i parashikuar në Ligjin 9284 paraprihet gjithmonë nga një proces sekuestrimi, pra mund të vendoset nga Gjykata vetëm pasi ndaj pasurisë është vendosur më parë një masë sekuestrore, në bazë të kërkesës së prokurorit dhe sipas kushteve të përcaktuara për këtë qëllim në këtë ligj.

Në fakt jo të gjitha vendet mbajnë të njëjtin qëndrim lidhur me konfiskimin parandalues. Disa e zbatojnë këtë lloj konfiskimi si një procedurë që ndiqet pas një vendimi dënimi. Ndërsa disa të tjera e zbatojnë këtë lloj konfiskimi pavarësisht nga procedimi penal, si një procedurë paralele me gjykimin penal. Tendenca është përkrahja gjithmonë e më shumë e procedurës së konfiskimit *in Rem*, pra duke zbatuar standardet civile të të provuarit. Kjo, pasi kjo procedurë rezulton më tërheqëse dhe lehtëson ndjeshëm luftën kundër krimit të organizuar. Megjithatë kjo procedurë ende mbetet e diskutueshme në lidhje me rreziqet që e shoqërojnë atë në drejtim të respektimit të të drejtave themelore të individëve. Ajo shpesh është kritikuar pasi lejon privimin nga e drejta e pronësisë edhe të personave të tretë, thjesht duke u bazuar në lidhje objektive që mund të rezultojnë mes pasurisë dhe aktiviteteve kriminale, pa pasur prova të plota fajësie të bashkëpunimit. Për shkak të standardit më të ulët së të provuarit, shumë prej garancive që karakterizojnë procesin penal, mungojnë në procedurat e konfiskimit *in Rem* të pasurive me origjinë kriminale.

Nga analiza e konfiskimit të detyrueshëm të parashikuar nga neni 36 I KP vëmë re se ky lloj konfiskimi është konceptuar jo vetëm si një konfiskim i bazuar tek paligjshmëria e pasurisë por edhe si një konfiskim i bazuar tek vlera apo kundërvlera e pasurisë në raport me produktet e veprës penale. Kjo do të thotë se konfiskimi i detyrueshëm sipas K.p.p. mund të shtrihet edhe mbi pasuri të ligjshme të autorit të veprës penale, deri në masën që ato mbulojnë vlerën e produkteve të veprës penale.

I diskutueshëm është parashikimi i konfiskimit të një pasurie të premtuar si shpërblim për kryerjen e një veprë penale. Në këtë rast mund të ndodhë që premtimi për shpërblim të jetë një mashtrim. Mundet që autorit të veprës penale t'i jetë premtuar një banesë e cila në fakt nuk ekziston. Pavarësisht nga kjo, sipas nenit 36, germa «c» të K.P., gjykata detyrohet të vendosë konfiskimin e shpërblimeve të premtuara, edhe pse ato nuk ekzistojnë materialisht, dhe për më tepër nuk formojnë produkte të veprës penale.

Në nenin 36 të K.P. nuk përcaktohet detyrimi i Gjykatës për të zbatuar kushtet e konfiskimit sipas renditjes së bërë në këtë nen. Kjo mangësi në praktikë nuk ka krijuar ndonjë problem deri tani. Por ajo mund të lërë shteg për abuzime, pasi mund të ndodhë që gjykata të vendosë konfiskimin e pasurisë së ligjshme në formën e kundërvlerës së produkteve të veprës penale, duke lënë pa konfiskuar vetë produktet e veprës penale. Kuptohet që sekuestrimi i kësaj pasurie të ligjshme duhet t'i nënshtrohet konfiskimit vetëm atëherë kur nuk mundet të bëhet konfiskimi i produkteve të veprës penale.

Nga kjo analizë e shkurtër e konfiskimit të detyrueshëm të parashikuar në nenin 36 të K.P. del qartë vështirësia që mund të hasin organet e ndjekjes penale për të arritur në një konfiskim të produkteve të veprave penale kur është fjala për krime të kryera nga organizata kriminale të specializuara në pastrim parash, trafikim lëndësh narkotike, qeniesh njerëzore, etj.,. Përballë tyre qëndrojnë nga njëra anë format dhe metodat e sofistikuara që këto organizata përdorin në veprimtarinë e tyre për fshehjen e lidhjeve mes veprimtarisë kriminale dhe origjinës së produkteve të krimit nga ana tjetër qëndron kërkesa apo standardi i lartë i të provuarit të këtyre lidhjeve jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për të arritur në një konfiskim të mundshëm të tyre. Në fakt vështirësia lidhur me standardin e të provuarit lidhet sidomos me formulimin jo shumë të saktë të vetë nenit 36 të K.P. duke e konceptuar konfiskimin e detyrueshëm si një masë dënimi. Kjo e bën të pamundur për Gjykatën të aplikojë një standard më të ulët dhe nuk i jep mundësi asaj të kalojë barrën e të provuarit të mungesës së lidhjeve mes pasurisë objekt konfiskimi dhe veprës penale për të cilën ai është deklaruar fajtor.

Prandaj ky lloj konfiskimi, i parashikuar në nenin 36 të K.Penal, është një instrument ligjor i pamjaftueshëm në fushën e luftës kundër krimit të organizuar.

Për këtë vjen në ndihmë konfiskimi, i parashikuar në ligjin nr. 9284, i cili përbën pikërisht atë që më sipër e quajtmë konfiskim *in rem*, sipas të

cilit pasuria apo sendet mund të konfiskohen, nëse provohet sipas kriterëve civile së të provuarit që këto pasuri kanë një origjinë të paligjshme dhe kriminale. Zbatimi i kriterëve civile të të provuarit në këtë lloj konfiskimi parandalues, pra ndërrimi i barrës së provës, e bën sistemin më eficient. Ky ndërrim i barrës së të provuarit mund të konsiderohet edhe si një kosto efektive, pasi pronari i një prone, në parim, mund të tregojë më lehtë se autoritetet origjinën jo kriminale të pasurisë.

§ 5. *Kuadri ndërkombëtar.*

Aktualisht, masat parandaluese po gjejnë gjithnjë e më shumë vend si në planin praktik ashtu dhe në debatin teorik, në fushën e strategjive moderne të luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë kuadër, në planin ndërkombëtar një vëmendje gjithmonë e më e madhe po u kushtohet masave për identifikimin, zbulimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe më pas konfiskimin e produkteve të veprave penale të gamës së krimit të organizuar si një rrugë tepër efikase për të ulur fuqinë ekonomike të tij. Përpjekjet po përqendrohen sidomos në përafrimin e legjislacioneve me qëllim krijimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm për të operuar në nivel ndërkombëtar pasi është e qartë se diferencat midis legjislacioneve të ndryshme do të përbënin pengesa serioze për një luftë të efektshme kundër krimit të organizuar dhe atij transnacional.

Në këtë drejtim përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar mund t'i përmbledhim si më poshtë:

Së pari, duhet përmendur Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope të vitit 1988, e cila parashikon detyrimin e Shteteve për adoptimin e masave për të mundësuar konfiskimin e fitimeve që rrjedhin nga veprat penale në fushën e lëndëve narkotike ose të pasurive vlera e të cilave përkon me vlerën e këtyre fitimeve.

Së dyti, Konventa e Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit”, e vitit 1990.

Edhe kjo Konventë, parashikon që çdo Shtet palë merr përsipër të përshtatë masat ligjore dhe masat e tjera që rezultojnë të nevojshme për t'i lejuar asaj konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale.

Së treti, Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokollet shtesë të saj.

Në bazë të kësaj konvente, Shtetet palë duhet të marrin masa në sistemet e tyre ligjore që do të mundësonin konfiskimin e të ardhurave nga krimi për

veprat penale të parashikuara në Konventë apo të pasurisë vlera e të cilave përkon me vlerën e të ardhurave nga krimi.

Përveç kësaj, Konventa ka parashikuar edhe mundësinë e lehtësimit të procesit së të provuarit të origjinës së pasurisë, duke kërkuar që kjo të demonstron nga autori i veprës penale (barra e provës). Kjo konventë, në nenet 13 – 14 të saj, parashikon edhe rregullime të tjera në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, në lidhje me konfiskimin, apo në lidhje me disponimin e të ardhurave nga krimi ose të pasurive të konfiskuara.

Së katërti, Konventa e Këshillit të Europës “Për Pastrimin, Kërkimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit”, e vitit 2005.

Kjo konventë mbulon në të njëjtën kohë si kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, ashtu edhe financimin e terrorizmit. Edhe në këtë Konventë janë parashikuar masat ligjore që duhen marrë në plan kombëtar që të mund të lejojnë konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve apo pasurive që vijnë nga krimi. Sipas Konventës, Shtetet palë, duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme legjislative që do të mundësonin e ngrirjen ose sekuestrimin e pasurive që i nënshtrohen konfiskimit. Përveç këtyre, në këtë Konventë është parashikuar edhe detyrimi që Shtetet duhet të marrin masat ligjore të nevojshme në lidhje me teknikat e hetimit apo edhe me bashkëpunimin ndërkombëtar të shteteve palë me qëllim realizimin e qëllimeve që përcjell kjo konventë.

Aktet e mësipërme ndërkombëtare janë adoptuar edhe nga Shteti shqiptar. Konfiskimi, sekuestrimi i parashikuar në Ligjin nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”, janë një përfaqje e legjislacionit Shqiptar me kërkesat e akteve ndërkombëtare dhe me vullnetin e të gjitha Shteteve palë në këto akte, për të luftuar krimin e organizuar dhe për të konfiskuar të gjithë instrumentet apo pasuritë që rrjedhin prej tij.

§ 6. Ligji 9284. Problematika.

Siç mund të kuptohet edhe nga përshkrimi që bën më sipër lidhur me llojet e sekuestrimit dhe konfiskimit që veprojnë në fushën e ëe drejtës penale, sekuestrimi dhe konfiskimi sipas Ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, përfaqëson një risi në sistemin tonë. Prandaj ishte e pritshme që aplikimi i tij do të shoqërohej edhe me paqartësi dhe keqinterpretime. Ky faktor u bë edhe më ndikues në kushtet kur edhe vetë Ligji në vetvete u vu re se ishte ndërtuar në disa aspekte të tij, në mënyrë jo shumë të qartë që linte natyrshëm mundësi për

këto keqinterpretime. Paqartësitë kishin të bënin kryesisht me Gjykatën që duhej të merrte në shqyrtim dhe të vendoste lidhur me kërkesat për sekuestrim dhe konfiskimin e pasurive në kuadër të këtij Ligji. Po kështu, ishin të paqarta edhe nocionet e sekuestros paraprake në raport me vetë sekuestron, barrën e provës, në kuptim të këtij Ligji. Për këto dhe të tjera probleme interpretimi, ky Ligj u bë objekt shqyrtimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas vendimit përkatës (nr.1, datë 25.01.2007) të Kolegjeve të Bashkuara praktika gjyqësore u udhëzua si më poshtë:

1. Gjykata kompetente për marrjen në shqyrtim të kërkesave për sekuestrim si dhe për marrjen e vendimit të konfiskimit të pasurisë në kuadër të Ligjit 9284, do të jetë Gjykata e Krimeve të Rënda. Në shkallë të parë gjykimi do të bëhet me një gjyqtar, kurse në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda trupi gjykues do të përbëhet nga tre gjyqtarë.

Megjithatë, në këtë drejtim ka mbetur disi e paqartë se si duhet të veprohet kur është fjala për një dyshim të arsyeshëm për veprat penale të parashikuara nga nenet 230/c dhe 230/ç të Kodit Penal, të parashikuara nga neni 3 i Ligjit 9284. Pasi, sipas arsytimit të Kolegjeve të Bashkuara, kompetenca e Gjykatës së Krimeve të Rënda për shqyrtimin e sekuestreimeve dhe konfiskimeve sipas Ligjit 9284, lidhet me kompetencën që ka kjo Gjykatë mbi veprat penale që parashikohen në nenin 3 të Ligjit. Por siç dihet, në nenin 75/a të K.P.P. këto dy vepra penale nuk janë përfshirë në kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Si të tilla, ndjekja penale për to nuk zhvillohet nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda. Kështu që mbetet e paqartë se cila Prokurori duhet të paraqesë në Gjykatën e Krimeve të Rënda kërkesën për sekuestrim kur dyshimi i arsyeshëm lidhet pikërisht me këto dy vepra penale.

2. Procedurat përkatëse të sekuestrimit dhe më pas të konfiskimit të pasurisë në kuadër të Ligjit 9284 kanë karakter autonom në raport me procedurën e shqyrtimit nga Gjykata të akuzave penale, edhe pse si rregull nisja e tyre nënkupton se paralelisht me to ka nisur ose do të nisë një procedim penal.

3. Në procedimin për caktimin e masës së sekuestros apo të konfiskimit sipas këtij Ligji, barra e provës për të vërtetuar praninë e një 'dyshimi të arsyeshëm' për kryerjen e një vepre penale nga ato që përcakton Ligji, i përket Prokurorisë. Kurse për të vërtetuar origjinën e ligjshme të pasurisë objekt sekuestrimi apo konfiskimi, barra e provës i përket personit të cilit i sekuestrohet apo konfiskohet kjo pasuri.

4. Sekuestrimi dhe konfiskimi mbi një pasuri të ligjshme e cila është përzier me pasuri të paligjshme, duhet të shtrihet deri në atë masë që pasuria e ligjshme mbetet e pajustificuar për nga shtimi i vlerës së saj.

5. Sekuestrimi dhe konfiskimi nuk mund të vendoset vetëm mbi bazën e një mospërputhjeje mes të ardhurave të ligjshme dhe pasurisë së krijuar. Përveç kësaj kërkohet të ekzistojë edhe një lidhje shkakësore mes pasurisë së pajustificuar për nga origjina e ligjshme e saj dhe veprimtarisë kriminale për të cilën mbajtësi i pasurisë dyshohet se ka kryer.

Për këtë konkluzion të fundit të arritur nga Gjykata e Lartë personalisht kam rezervat e mia. Është e vërtetë se mungesa e ligjshmërisë së origjinës së një pasurie objekt sekuestrimi mund të ndodhë që të rezultojë se nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë me atë aktivitet kriminal të dyshuar, mbi bazën e të cilit kanë nisur procedurat e sekuestrimit apo konfiskimit sipas Ligjit. P.sh. le të themi se autori për momentin dyshohet se ka nisur aktivitetin kriminal në vitin 2002 dhe gjatë procesit hetimor mbi origjinën e pasurisë së tij, me qëllim vendosjen e sekuestrimit, del se në fakt pasuria është blerë prej tij ose është vendosur në kontrollin e tij në vitin 2000, pra përpara kohës kur ai dyshohet për momentin se ka nisur aktivitetin kriminal. Kjo sipas një logjike metafizike çon në përfundimin se pasuria e vitit 2000 nuk ka lidhje me veprimtarinë kriminale pasi kjo veprimtari dyshohet se ka nisur në vitin 2002. Megjithatë, mendoj se ardhja në dijeni e Prokurorisë në këtë mënyrë, incidentale, gjatë procesit të hetimit mbi origjinën e pasurisë, për mungesën e origjinës së ligjshme të pasurisë së krijuar në vitin 2000, mendoj se nuk mund të legjitimojë mbajtjen e një pasurie origjina e së cilës është krejt e pajustificuar. Sigurisht që në mungesë të një dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e një aktiviteti kriminal nga ana e mbajtësit të pasurisë, nisja e një procedure hetimore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë duhet vlerësuar si e paligjshme. Por kur kjo procedurë ka nisur në prani të këtij dyshimi të arsyeshëm, fillimisht i vlefshëm për një kohë të caktuar, shtrirja e tij duhet të zgjerohet në kohë, duke u bërë automatikisht i vlefshëm edhe për pasuritë e tjera, kur gjatë procesit hetimor del se origjina e krijimit të tyre është e pajustificuar. Gjithsesi, ky mbetet vetëm një qëndrim personal pasi qëndrimi që duhet mbajtur në praktikë është ai që kanë përcaktuar Kolegjet e Bashkuara.

Nga analiza e llojit të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas ligjit 9284, del se ai është një sekuestrim apo konfiskim i bazuar vetëm mbi pasurinë. Me fjalë të tjera, nëse ekzistojnë prova që një person i dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar ka në zotërim pasuri që janë me origjinë të paligjshme dhe për arsye të ndryshme objektive nuk mund të bëhet konfiskimi i tyre, ky

Ligj nuk parashikon mundësinë e konfiskimit të vlerës apo kundërvlerës së tyre. Mendoj se kjo përbën një pikë të dobët të Ligjit pasi sekuestrimi apo konfiskimi e kufizon shtrirjen e tij vetëm mbi pasuritë dhe jo edhe mbi kundërvlerën e tyre.

Dua të theksoj gjithashtu se duhet pasur parasysh se sekuestrimi dhe konfiskimi sipas Ligjit 9284, nuk është konceptuar si një masë dënimi, siç është rasti me konfiskimin e parashikuar nga neni 36 i K.P.. Prandaj edhe zbatimi i tij i shtrin efektet edhe kur dyshimi i arsyeshëm është për vepra penale të kryera para daljes së këtij Ligji. Me fjalë të tjera, për zbatimin e tij nuk ka rëndësi kur dyshohet se ka ndodhur vepra penale. Mjafton që dyshimi i arsyeshëm të jetë për ato vepra penale që parashikohen shprehimisht nga neni 3 i tij.

§ 7. Vështirësitë në drejtim të hetimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar legjislacioni ynë i brendshëm shfaqet me disa anomali apo mangësi të cilat sjellin vështirësi praktike për realizimin e masave të sekuestros dhe konfiskimit.

Në fakt, kuadri ligjor që siguron kryerjen e hetimeve mbi gjetjen dhe zbulimin e pasurive që ndodhen jashtë shtetit në kuadër të një procedimi penal që zhvillohet në Shqipëri është i plotë, pasi kjo rregullohet si nga K.P.P., ashtu edhe nga Konventa për «Ndihmë dhe bashkëpunim të ndërsjellë në fushën gjyqësore».

Po kështu, edhe kuadri ligjor që siguron një hetim jashtë për sa i përket rastit të vendosjes së masës së sekuestros apo konfiskimit si një masë me karakter parandalues, parashikuar nga Ligji 9284 duket se është i mjaftueshëm. Është e vërtetë se në këtë Ligj nuk parashikohet shprehimisht një procedurë specifike për rastet kur hetimi kërkon të shtrijë sferën e kërkimeve edhe mbi pasuri të ndodhura jashtë vendit. Por nga një analizë e kujdesshme e nenit 4 të Ligjit del se kjo procedurë hetimore shtrihet edhe për këto raste. Konkretisht, në këtë nen thuhet se hetimet mbështeten në rregullat e Kodit të Procedurës civile. Duke iu referuar K.p.c., del se në nenin 219 të tij rregullohet procedura e hetimeve për veprime gjyqësore civile jashtë vendit. Pra hetimet jashtë vendit lidhur me pasuritë në fjalë janë plotësisht të mundshme në përputhje me këtë nen të K.p.c..

Por kur pas këtyre hetimeve, si në kuadër të një procedimi penal apo në kuadër të Ligjit 9284, vendoset një masë sekuestro apo konfiskimi, shfaqen probleme të ekzekutimit të tyre.

Konkretisht, kur sekuestrimi vendoset gjatë fazës së hetimeve paraprake si një mjet për kërkimin e provës apo si një masë sigurimi me karakter preventiv apo konservativ, K.p.p. nuk parashikon asnjë mundësi që këto vendime të autoriteteve shqiptare të drejtësisë të mund të njihen, pra të ekzekutohen edhe jashtë shtetit. Këto masa nuk mund të kërkohen të vendosen nga autoriteti gjyqësor i huaj në kuadër të një letërporosie, pasi sipas nenit 505 të K.p.p., letërporositë lidhen vetëm me njoftimet dhe marrjen e provave, por jo edhe për vendosjen e masave kufizuese mbi të drejtat e pronësisë për pasuri të ndodhura jashtë shtetit.

Po kështu, edhe kur është fjala për vendimet penale shqiptare që caktojnë konfiskime si masë dënimi, sipas nenit 36 të Kodit Penal, në parashikimet e bëra në K.p.p., në nenet 519 e vijues, duket se janë lënë jashtë parashikimit rastet e ekzekutimit të masave të konfiskimit të pasurisë që mund të përmbajë një vendim penal. Ndërsa në rastin e kundërt, pra kur është fjala për njohjen e vendimeve penale të huaja që parashikojnë masën e konfiskimit, çuditërisht, në nenin 518 të K.p.p. ky parashikim nuk mungon.

Kur është fjala për ekzekutimin e vendimeve të huaja të sekuestrimit apo konfiskimit, të cilat nuk kanë karakterin e një mase dënimi por janë vendosur si masa parandaluese, në kuadër të detyrimeve që parashikon Konventa «për pastrimin e parave» legjisllacioni shqiptar është i përshtatshëm për aplikim. Kjo pasi sipas Ligjit 9284, dhe Vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të përmendur më sipër, është e qartë se kompetente në këtë drejtim do të ishte Gjykata e Krimeve të Rënda. Procedura që do të ndiqej në këto raste do të ishte ajo e parashikuar nga neni 393 i K.p.c., meqenëse siç thamë Ligji 9284 parashikon zbatimin e një procedure civile në këtë drejtim.

Por vështirësia shfaqet për rastet e njohjes së vendimeve të konfiskimit të vendosur nga Gjykata shqiptare në bazë të Ligjit 9284 mbi pasuritë jashtë shtetit. Kjo pasi në K.p.c. nuk rezulton të ketë një procedurë përkatëse se si duhet të veprojë Gjykata në këto raste. Konkretisht, në nenin 393 të tij, parashikohet vetëm procedura e njohjes së vendimeve civile të huaja, por jo edhe procedura e njohjes së vendimeve penale shqiptare jashtë shtetit. Në këtë rast nuk mund të thuhet se nga ana e Gjykatës që ka marrë masën mund të zbatohet drejtpërdrejt. Konventa kundër Financimit të Terrorizmit, apo Konventa kundër Krimit të Organizuar Transnacional, pasi këto konventa vendosin vetëm detyrime për Shtetet palë për të përshtatur legjisllacionin e tyre të brendshëm, për të bërë të mundur bashkëpunimin ndërkombëtar në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive. Pa bërë këtë përshtatje konkrete në legjisllacionin e brendshëm, pra pa parashikuar në këtë

legjislacion edhe procedurën e njohjes së vendimeve civile shqiptare jashtë shtetit, Konventa mendoj se nuk mund të pritët që Gjykatat tona të zbatojnë Konventën drejtpërdrejt.

Ndërsa në rastet kur kemi të bëjmë me konfiskime të bëra me vendim gjyqësor shqiptar apo të huaj të cilat kanë karakterin e një mase dënimi, pra janë konfiskime sipas kuptimit të nenit 36 të Kodit Penal, procedura e ekzekutimit të tyre është e qartë. Ajo që mund të bëhej pengesë në bashkëpunimin në këtë drejtim është parashikimi i detyrimit në K.p.p. se pasuria e konfiskuar në ekzekutim të një vendimi penal të huaj mund t'i dorëzohet shtetit që ka dhënë vendimin e konfiskimit vetëm nëse ky shtet do të vepronte njësoj në të njëjtat rrethana. Ky parashikim nënkupton se sipas legjislacionit penal shqiptar për dorëzimin e pasurisë së konfiskuar në Shqipëri për llogari të një vendimi penal të huaj kërkohet prania e një marrëveshjeje bashkëpunimi në këtë drejtim me shtetin përkatës ku të parashikohen shprehimisht termat e reciprocitetit. Mesa jam në dijeni këto marrëveshje bashkëpunimi të paktën me vendet fqinjë nuk ekzistojnë. Kjo ka çuar në një bashkëpunim jo shumë efikas në këtë drejtim.

Një problem tjetër që mund të sjellë vështirësi në bashkëpunimin ndërkombëtar në të ardhmen është edhe fakti se në legjislacionin tonë të brendshëm, konkretisht në Ligjin 9284, sekuestrimi dhe konfiskimi i nuk është konceptuar si një sekuestrim apo konfiskim edhe mbi vlerën e pasurisë së ligjshme që i korrespondon vlerës së produkteve të veprës penale. Në këto kushte vendimet Gjyqësore të Huaja që do të përmbajnë konfiskime të konvertuara në vlerë, do të mund të ekzekutohen veçse në kushte kur konfiskimi do të kishte cilësinë e një konfiskimi të dhënë vetëm pas marrjes së një vendimi penal dënimi, siç është rasti i konfiskimeve të parashikuara nga neni 36, germa «ç» e Kodit Penal. Që njohja e një vendimi të huaj konfiskimi në vlerë të realizohej edhe në kushtet e Konventës «Për pastrimin e parave» duhej patjetër që kjo mundësi të parashikohej në legjislacionin tonë, pikërisht në Ligjin 9284 që mbulon rastet e Konventës në fjalë, gjë që siç thashë nuk është parashikuar.

§ 8. Probleme të zbatimit të Konventës për Luftën Kundër Financimit të Terrorizmit, e vitit 1999.

Së fundi dua të evidentoj disa konsiderata personale lidhur me praktikën e zbatimit të Konventës «Për luftën Kundër Terrorizmit».

Ratifikimi i kësaj Konvente nga vendi ynë përmban në vetvete një angazhim të rëndësishëm të vendit tonë ndaj komunitetit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit. Por nga ana tjetër, kam përshtypjen se në praktikë aplikimi i saj po krijon një lloj precedenti i cili duket se afirmon pikëpamjen se për të luftuar terrorizmin mund të justifikohen të gjitha llojet e mjeteve dhe kufizimeve të lirive dhe të drejtave të individit. Në fakt, kjo pikëpamje jo vetëm që mendoj se është e gabuar por për më tepër nuk më rezulton se përbën edhe frymën e kësaj Konvente. Nga një analizë e shpejtë e saj del se në të parashikohen detyrimet e Shteteve palë (neni 4) që të parashikojnë në legjisllacionin e vendeve të tyre, si vepra penale disa akte të parashikuara shprehimisht në Konventë. Po kështu, parashikohet detyrimi që Shtetet të marrin juridiksion për ndjekjen penale të këtyre veprave penale edhe kur ajo ndodh jashtë territorit të tij, por gjithmonë kur vepra penale në fjalë ka cenuar direkt apo indirekt interesat e atij Shteti. Vetëm mbi këtë bazë në nenin 8 përcaktohet se Shtetet kanë juridiksion për të vendosur edhe për sekuestrimin e pasurive të cilat janë destinuar për terrorizëm, në përputhje me legjisllacionin e vendit të tyre. Kjo do të thotë se ngrirja apo sekuestrimi i pasurive në kuadër të Konventës «Kundër Terrorizmit» nuk parashikohet dhe, për pasojë, as nuk ka se pse duhet të interpretohet si një masë e jashtëzakonshme, që nuk respekton asnjë normë dhe standard të kufizimit të lirive dhe të drejtave të individit përmes një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Megjithatë, në praktikën e punës vihet re se Konventa është kuptuar pikërisht kështu, pra si një mundësi që një organ i administratës shtetërore të mund të sekuestrojë një pasuri të caktuar, jashtë kriterëve ligjore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë në rastet kur ajo lidhet me një veprimtari kriminale, pra kur nuk është një sekuestrim me karakter administrativ. Mjafton të shihen mjaft vendime sekuestrimi të Ministrit të Financave të cilat bëhen duke përdorur si bazë ligjore pikërisht këtë Konventë, edhe pse sekuestrimet sipas kësaj Konvente duhej të ishin kompetencë e organit të Prokurorisë, pasi siç mund të kuptohet nga përmbajtja e Konventës, ato lidhen me një dyshim për kryerjen e një prej veprave penale që parashikohen në Konventë. Në mungesë të asaj vepre penale, sigurisht edhe masa e sekuestrimit duhet të bjerë. Ky realitet ka sjellë në praktikë raste të çuditshme kur edhe pse një personi mund t'i jetë pushuar nga ana e Prokurorisë akuza për një nga veprat penale të

Konventës, pasuria e tij vazhdon edhe më pas të jetë në gjendje të sekuestrojë, mbi bazën e urdhrit të Ministrit të Financave.

Rasti i përplasjes së ligjshmërisë së sekuestreimeve në kuadër të Ligjit për Terrorizmin.

a. Kushtetueshmëria e sekuestrimit, jashtë një procesi gjyqësor.

b. Mungesa e efikasitetit të hetimit nga FIU/ZIF në kushtet kur ky organ kufizohet vetëm me gjetjen e pasurive të personit në listë, pa u interesuar për lidhjet e kësaj pasurie me veprën penale. Kjo bën që autori në listë, në një të ardhme, të hiqet nga lista për mungesë të përgjegjësisë penale.

ARTUR SELMANI
Prokuror
Prokuroria e Përgjithshme

Tiranë, Nëntor 2007

P J E S A E T R E T Ë

ASPEKTE PROCEDURALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR: PROCESI PENAL, VLERËSIMI I PROVËS DHE RELACIONI PËRFUNDIMTAR I PROKURORIT

3.1. *Administrimi i procesit penal në Shqipëri.*

§.

Procesi penal ndaj një shtetasi që dyshohet e më pas akuzohet për kryerjen e një vepre penale konsiston në një sërë veprimesh procedurale të rregulluara në mënyrë të posaçme nga ligji procedural penal. Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë veprimet procedurale në funksion të administrimit të procesit penal parashikohen të kryhen nga:

- Oficerët e policisë gjyqësore me iniciativë, në zbatim të neneve 293 e vijues të K.Pr.Penale

- Oficerët e policisë gjyqësore në zbatim të kompetencave të deleguara me vendim të prokurorit të çështjes

- Prokurorit të sektorit që ndjek çështjen si gjatë hetimeve paraprake ashtu edhe në seancat gjyqësore

- Mbrojtjes së të pandehurit në lidhje me pretendimet për marrjen e provave apo në qëndrimet që mbahen prej saj në debatin gjyqësor mbi provat e lejuara të merren për shqyrtim

- Gjykatës kompetente gjatë fazës së gjykimit të çështjes.

Në thelb, një administrim sa më i mirë i të gjithë procesit penal përbëhet nga një administrim i mirë i të gjitha fazave të procesit penal i cili, konsiston në fazën e hetimeve paraprake:

I. në kryerjen e saktë dhe të detajuar të veprimeve hetimore që kryen policia gjyqësore në kohën e ndodhjes së ngjarjes, në fiksimin e marrjen e provave materiale apo në vjeljen e të dhënave që shërbejnë më pas për identifikimin e autorëve apo për saktësimin e mekanizmit të ngjarjes.

II. në veprimet hetimore që prokurori delegon të kryhen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe që në thelb përcaktojnë strategjinë hetimore për zbulimin e mekanizmit të veprës e të autorit të saj si edhe shërbejnë për grumbullimin e provave që shërbejnë për të provuar akuzën.

III. në strategjinë që përdor prokurori i seancës në procesin gjyqësor për marrjen e provave për vërtetimin e akuzës për radhën e marrjes së tyre si edhe për analizën që i bëhet çdo provë gjatë debatit gjyqësor.

IV. në kërkimet e mbrojtjes për marrjen e provave të paraqitura prej saj dhe në pretendimet që ajo ngre në lidhje me papërdorshmërinë e provave të caktuara apo për përcaktimin e vlerës provuese të çdo prove që i nënshtrohet debatit gjyqësor.

V. në disponimet e sakta të gjykatës për marrjen e provave të caktuara nga palët duke përcaktuara se cilat prej tyre janë të nevojshme për procesin penal dhe cilat duhet të anashkalohehen dhe të mos i nënshtrohen procesit për mungesë lidhjeje me të.

Duke mos dashur të përsërisim dispozitat procedurale që rregullojnë veprimet procedurale për menaxhimin e procesit penal e çmoj të vlefshme të ndalem në ato momente që lidhen me këtë proces që kanë paraqitur diskutime në praktikën e gjykatave tona dhe për të cilat vazhdon të jetë i hapur diskutimi mes juristëve.

Problematika e teknikave të menaxhimit të procesit gjyqësor do të trajtohet në këtë temë në këndvështrim të një gjyqtari dhe të detyrave që i dalin këtij organi për disponim në lidhje me rastet që i paraqiten atij.

Problemet thelbësore që hasen në praktiken tonë gjyqësore janë të lidhura kryesisht me pavlefshmërinë e akteve procedurale të hartuara gjatë fazës së hetimeve paraprake në kuptim të nenit 129 të K.Pr.Penale si dhe me papërdorshmërinë e provave të marra gjatë kësaj faze për shkak të shkeljes së ndalimeve që parashikon ligji në kuptim të nenit 151/4 I K.Pr.Penale.

§ 1. Pavlefshmëria e akteve dhe papërdorshmëria e provave.

§ 1.1.

Pavlefshmëria e akteve procedurale parashikohet në nenet 128 e vijues të K.Pr.Penale. Pavlefshmëria absolute e akteve procedurale parashikohet në nenin 128 të K.Pr.Penale. Sipas përcaktimit që bën paragrafi i dytë i këtij neni një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm. Në këtë kuptim gjykata i konstaton edhe kryesisht aktet absolutisht të pavlefshëm. Ajo nuk lidhet me kërkimin e palëve për konstatimin e kësaj pavlefshmërie dhe e merr në konsideratë atë në çdo fazë të procesit. Në zbatim të nenit 131 të K.Pr.Penale pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasshme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm, aq më tepër bëhen të pavlefshme aktet e mëpasshme që varen nga një akt që konstatohet i pavlefshëm. Gjykata në rastet e pavlefshmërisë absolute kur konstaton pavlefshmërinë e akteve të mëpasshme nuk mund të urdhërojë ribërjen e tyre për sa kohë që ato varen nga një akt i cili nuk mund të bëhet i vlefshëm, ajo mund ta bëjë këtë vetëm në rastet kur deklarohen pavlefshmërinë e akteve mbi kërkesën e palëve. Ajo duhet të zgjidhë kryesisht pasojat e pavlefshmërisë së konstatuar në çdo fazë të procesit në të cilën ndodhet.

Ligji përcakton në nenin 128 aktet të cilat, ai i cilëson si absolutisht të pavlefshme për pasojë çdo akt i pretenduar si i pavlefshëm për shkak të shkeljeve të ligjit jashtë rasteve që parashikon kjo dispozitë do të konsiderohet si akt relativisht i pavlefshëm. Neni 129 i K.Pr.Penale parashikon se të gjitha pavlefshmëritë e ndryshme nga neni 128 i K.Pr.Penale mund të deklarohen si të tilla vetëm me kërkesën e palëve, e cila duhet të paraqitet deri para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor i çështjes, duke i dhënë kësaj kërkesë natyrën e kërkesave paraprake.

Në rastet kur gjykata deklarohen pavlefshmërinë e një akti ajo urdhëron përsëritjen e tij në rast se:

- a) është e nevojshme
- b) është e mundshme.

Duhet të ekzistojnë të dyja këto rrethana së bashku që akti të ribëhet. Nevoja e ribërjes së aktit është një element që çmohet nga vetë gjykata pasi të ketë dëgjuar edhe mendimin e palëve. Mundësia e ribërjes së aktit është kriter objektiv i cili varet nga natyra e aktit, nga pasojat që ai ka sjellë, nga koha e bërjes së tij, nga personat që e kanë hartuar atë.

Përgjithësisht aktet procedurale që mund të ribëhen janë ato që konsiderohen të pavlefshme për mungesa të formës dhe që nuk kanë shkaktuar pavlefshmërinë e akteve të tjerë të mëpasshme, rrethanë e cila do ta bënte shumë të vështirë ribërjen e tij.

Në praktikën e gjykatave ndeshet shpesh pretendimi për pavlefshmëri të akteve procedurale të cilat, janë marrë duke mos u respektuar rregullat procedurale. Për këtë motiv detyrohem të nënvizojmë qëndrimin se akte të pavlefshme janë ato të cilët ligji shprehimisht i parashikon si të tilla. Në këtë kuptim shkelja e rregullave do të sjellë pavlefshmëri të aktit kur kjo pasojë është e parashikuar shprehimisht në ligj. Neni 129 i K.Pr.Penale e përcakton këtë rregull kur shprehet se *"pavlefshmëritë e ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 128 mund të deklarohen me kërkesën e palëve"*. Në interpretim të kësaj dispozite, çdo pavlefshmëri që është parashikuar në kod përveç asaj që është e parashikuar në nenin 128 është relative, pra organi që procedon nuk ka diskrecion të përcaktojë pasojën e pavlefshmërisë së një akti pasi atë e ka zgjidhur vetë ligji, por ai vetëm do të verifikojë në se ekzistojnë kushtet e ligjit për ekzistencën e saj.

§ 1.2.

Neni 151/4 i K.Pr. penale parashikon kriterin e provës së papërdorshme.

Sipas kësaj dispozite "provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procedimit".

Gjykata gjendet vazhdimisht në proces me pretendimet e palëve kryesisht të mbrojtjes për papërdorshmërinë e provave. Konstatohet në praktikë se papërdorshmëria pretendohet zakonisht për çdo shkelje të rregullave për marrjen e provës. Sipas përkufizimit të mësipërm prova do të konsiderohet e papërdorshme jo vetëm kur është shkelur ligji në marrjen e saj, por kur kjo shkelje lidhet me një urdhërim ndalues të tij. Vetë papërdorshmëria si institut që përjashton përdorimin e provës nga procesi i të provuarit ka për qëllim të shmangë shkelje flagrante të ligjit të konsideruara të rënda për liritë e të drejtat e individit. Liritë e marra në mbrojtje në këto raste janë më të rëndësishme për t'u respektuar sesa të mirat që mund të rrjedhin për shoqërinë nga shkelja e tyre. Provat që konsiderohen të papërdorshme janë marre në shkelje të dispozitave ndaluese të ligjit për pasojë ato nuk mund të rimerren edhe sikur të ekzistojë mundësia.

Ligji nuk parashikon se çfarë ndodh me provat e tjera të mëpasshme kur ato varen prej asaj që konsiderohet e papërdorshme. Mendoj që zgjidhja duhet të jetë e njëjtë me pasojat që krijon akti i pavlefshëm dhe ato duhet të konsiderohen të papërdorshme gjithashtu.

Pretendimi për papërdorshmëri të provës mund të ngrihet në çdo gjendje e shkallë procedimi. Në praktikë gjykatat përgjithësisht nuk shprehen me vendim në momentin që ngrihet kjo papërdorshmëri nga palët por, ajo shprehet në lidhje me këtë fakt në vendimin përfundimtar kur bën analizën e fakteve që kanë rezultuar nga gjykimi duke e konsideruar vlerësimin e papërdorshmërisë si një pjesë të procesit të çmuarjes së provave. Mendoj që gjykata duhet të shprehet e të zgjidhë çështjen nëse prova do të konsiderohet e papërdorshme në momentin që palët ia bëjnë asaj prezent këtë pretendim apo ajo vetë e konstaton.

Në nenin 151/2 parashikohet se "në gjykim, provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos me urdhër duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të paligjshme". Në kuptim të kësaj dispozite gjykata është e detyruar të përjashtojë nga shqyrtimi gjyqësor një provë që është e ndaluar nga ligji. Këtë urdhër ajo duhet ta marrë gjatë gjykimit të çështjes në varësi të momentit se kur bëhet prezent pretendimi për papërdorshmëri. Një parashikim të njëjtë bën edhe neni 223/4 kur i jep të drejtë gjykatës të heqë regjistrimet dhe procesverbalet e përgjimit, përdorimi i të cilave nuk lejohet para se të ketë përfunduar shqyrtimi i çështjes, gjithsesi e lë këtë detyrë jo me vendimin përfundimtar.

Disponimi i gjykatës në këtë moment do të shmangte çdo mundësi për të krijuar një bindje të brendshme të ndikuar edhe nga prova që nuk mund të përdoren por, do të qartësonte edhe palët për strategjinë e tyre të paraqitjes së pretendimeve e të mbrojtjes, duke garantuar një proces të rregullt e barazi të armëve.

§ 2. Sigurimi i provës.

§ 2.1. Rastet kur gjykata procedon me marrjen paraprakisht të provës.

Në zbatim të sistemit procedural të aplikuar në thelb të Kodit tonë të procedurës penale provat merren ose verifikohen në shqyrtimin gjyqësor.

Neni 151/1 i K.Pr.Penale parashikon se "*gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon sipas rregullave të caktuara në këtë Kod*", ndërsa neni 151/2 i K.Pr.penale parashikon se "*në gjykim, provat*

merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos me urdhër duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme ... "

Duke qenë se në këto dispozita lejohet marrja e provave si nga organi që procedon në fazën e hetimeve paraprake, ashtu edhe nga gjykata gjatë gjykimit të çështjes, mund të lindë diskutimi për faktin se, nëse të gjitha llojet e provave që parashikon K.Pr.Penale mund të merren edhe nga organi që procedon në fazën e hetimeve, atëherë procesi i të provuarit mund të zhvendoset në këtë fazë. Disponimi që bën neni 380 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se "*për të marre një vendim gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor*", i jep kuptim sistemit të pranuar ne procedurën tonë penale se prova krijohet në gjykim. Kjo do të thotë se edhe sikur ajo të jetë marrë në fazën e hetimeve paraprake, ajo i nënshtrohet debatit gjyqësor të palëve, gjatë të cilit verifikohet mënyra e marrjes së saj dhe përcaktohet vlera e saj provuese për faktin konkret.

Gjithashtu, për një kategori të caktuar provash, ligji ka parashikuar se mund të merren vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjykata. Kjo kategori provash nuk mund të merret nga prokuroria gjatë fazës së hetimeve paraprake por, vetëm mund të konstatohet prej tyre burimi i provës nga i cili, do të rrjedhë prova e formuar në debatin gjyqësor.

Pikërisht për këtë lloj provash të cilat mund të merren vetëm nga gjykata në mënyrë që të jenë të përdorshme, dhe për të mbrojtur të drejtën e të pandehurit që të ndikojë në marrjen e provave që në hetime paraprake, ka lindur nevoja e shqyrtimit të tyre në një kohë të mëparshme nga ajo në të cilën do të zhvillohet gjykimi i çështjes. Kjo nevojë është e lidhur me faktin se mosmarrja e tyre paraprakisht rrezikon seriozisht marrjen apo vërtetësinë e tyre në procesin gjyqësor. Në kuptim të kësaj, Kodi i Pr.penale rregullon marrjen paraprakisht të provës në nenet 316-322 të tij.

Neni 316 I K.Pr.penale rregullon:

- kohën se kur kërkohet sigurimi i provës duke përcaktuar se ajo gjendet në fazën e hetimeve paraprake;

- subjektet që legjitimohen ta kërkojnë atë, që janë prokurori dhe i pandehuri, personi i dëmtuar nga vepra penale nëpërmjet ankimit të vendimit të prokurorit që refuzon sigurimin e provës, i dëmtuari akuzues, (rregullim i nenit 318 të K.Pr.penale);

- llojet e provave të cilat mund të merren paraprakisht që janë:

a) dëshmia

- b) pyetja e të pandehurit
- c) ballafaqimi
- d) ekspertimi apo eksperimenti gjyqësor
- e) njohja

- rastet në të cilat prova mund të merret paraprakisht, që janë:

a) në marrjen e dëshmisë, ballafaqimit, pyetjes së të pandehurit kur ekzistojnë rrethana që të bëjnë të mendosh se personi nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze. Në praktikën e gjykatave tona është pranuar se pengesa sëmundjeje duhet të jetë serioze, e tillë që objektivisht ekziston mundësia që personi të mos jetojë deri në fazën e shqyrtimit gjyqësor ose të jetë në pamundësi fizike për të dëshmuar për shkak të problemeve të mundshme që mund të lidhen me gjendjen e tij mendore. Si pengesë tjetër serioze është pranuar praktikisht edhe fakti që personi i cili, kërkohet të pyetet jeton jashtë shtetit ose ekziston mundësia që ai të largohet duke e bërë të vështirë e të diskutueshëm faktin e prezencës së tij në gjykimin e çështjes.

b) në marrjen e dëshmisë, pyetjen e të pandehurit dhe ballafaqimin kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosjeje ose premtimi për dhënie parash ose përfitimesh të tjera me qëllim mosbërjen e dëshmisë ose bërjen e një dëshmie të rreme. Në praktikë është shtruar vazhdimisht problemi i provueshmërisë së ekzistencës së rrethanave që dëmtojnë dëshminë e kërkuar për t'u marrë. Mendoj që niveli i provueshmërisë në këto raste nuk duhet të jetë domosdoshmërisht i lartë. Këto rrethana ligji nuk kërkon që të provohen objektivisht që ekzistojnë, por mjafton që të ekzistojë një arsye e pranueshme për ekzistencën e tyre. Në këto kushte ekzistenca e tyre mbetet në fazën e një dyshimi, i cili është i mjaftueshëm për të vënë në lëvizje gjykatën. Në këtë linjë shkon edhe përcaktimi i bërë në nenin 362/4 i K.Pr.Penale sipas të cilit, gjykata mund zhvleftësojë një dëshmi të marrë në proces kur asaj i rezulton se dëshmitari ka qenë nën presion ose nën premtim për dhënien e një dëshmie të pavërtetë. Edhe në këtë rast ligji nuk kërkon domosdoshmërisht që ekzistenca e rrethanës ndikuese të provohet se ekziston, por përdor termin "rezulton" për shkak të faktit se është shumë e vështirë që rrethana të tilla të provohen plotësisht në proces.

c) në kryerjen e një ekspertimi apo eksperimenti, kur ai lidhet me persona apo vende e sende për të cilat ka arsye të bazuara se mund të pësojnë ndryshime të pashmangshme. Është pranuar se këto raste i referohen kryesisht eksperimenteve apo ekspertimeve që lidhen me vendin e ngjarjes apo me gjendjen psikike të personave e cila, është e ndryshueshme

(rasti i ekzaminimit të gjendjes së shkaktuar prej dehjes patologjike apo ekzaminimi i përdoruesve të drogës menjëherë pas arrestimit me sasira të vogla narkotikësh).

d) në rastin e paraqitjes për njohje ligji nuk vendos kritere të përcaktuar se kur mund të kërkohet të sigurohet kjo provë por, e lë në diskrecion të gjykatës të çmojë nëse ekzistojnë këto "arsye të veçanta" që të çojnë në sigurimin e saj. Këto arsye mund t'i referohen si personit që do të kryejë njohjen dhe mund të lidhen me kujtesën e tij me probleme të perceptimit apo me shikimin e dëgjimin e tij, por mund t'i referohen edhe personave të cilët, do t'i nënshtrohen njohjes, të cilët potencialisht mund të largohen apo mund të ndryshojnë. Në të njëjtën mënyrë mund të arsyetohet edhe kur kërkohet të kryhet njohja e sendeve.

Në këndvështrim të llojit të provave të lejuara që të sigurohen para shqyrtimit gjyqësor, konstatohet se prej tyre vetëm dëshmia është prova e cila nuk mund të merret nga organi i prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake, pasi kjo provë krijohet vetëm kur ajo merret nga një trup gjykues. Ndërkohë, që neni 167/5 i K.pr.penale parashikon mundësinë që pyetja e të pandehurit mund të bëhet nga organi procedues në fazën e hetimeve paraprake, neni 169 1 K.pr.Penale parashikon të drejtën e organit procedues të kryejë ballafaqimin, neni 171 1 K.pr.penale parashikon mundësinë që njohja të kryhet nga organi procedues, neni 177 parashikon mundësinë që eksperimenti të kryhet nga organi procedues dhe neni 179/2 I K.pr.penale parashikon mundësinë që ekspertimi të kryhet nga organi procedues. Në këto kushte lind pyetja se përse organi procedues, prokuroria, duhet të kërkojë të marrë në gjykatë një provë të cilën ligji ia lejon ta marrë vetë. Mendoj se ky organ mund ta bëjë këtë për një administrim sa më të mirë të procesit hetimor dhe për garantim të së drejtave të të pandehurit si edhe për të respektuar një standard më të lartë të këtyre të drejtave, i cili është i tillë në gjykatë. Por ky institut mendoj se është ngritur jo vetëm për të ndihmuar punën e organit e akuzës në procesin penal por, edhe për të mbrojtur të drejtat e liritë e të pandehurit dhe për t'i siguruar atij një proces të rregullt ligjor i mbështetur në parimin e barazisë së anëve. Të gjitha këto raste i vijnë në ndihmë mbrojtjes e të pandehurit kur kërkesa për marrjen e një prove të tillë atij i mohohet nga organi procedues që është prokuroria. Në këto kushte ai mund t'i drejtohet gjykatës, e cila qëndron mbi palët dhe të kërkojë sigurimin e provës, në zbatim të dispozitës së mësipërme.

§ 2.2. Gjykata kompetente për marrjen e provës.

Në kuptim të nenit 317, 318 e 319 të K.Pr.penale gjykata vihet në lëvizje për sigurimin e provës nëpërmjet një kërkesë të paraqitur prej subjekteve të procesit penal.

Në shqyrtim të elementëve të kësaj kërkesë shqyrtimi, i cili bëhet brenda 2 ditëve, sipas nenit 319 të K.Pr.penale, gjykata vendos a) mospranimin e kërkesës kur ajo është në shkelje të kërkesave që lidhen me formën e saj (neni 317 i K.Pr.Penale); b) shtyrjen e afatit të marrjes së provës së kërkuar nga i pandehuri kur zbatimi vendimit do t'i sillte dëm marrjes së provës (neni 319 /2 i K.pr.penale); c) pranimin ose rrëzimin e kërkesës për sigurimin e provës (neni 320/1 i K.Pr.Penale) Vendimi që pranon kërkesën përcakton:

- 1) objektin e provës brenda kufijve të kërkesës
- 2) personat e interesuar për marrjen e provës sipas kërkesës
- 3) datën e seancës e cila nuk mund të kalojë një afat më të gjatë se dhjetë ditë nga dita e dhënies së vendimit (neni 320/2 i K.pr.penale).

Praktika gjyqësore shqiptare, duke e konsideruar me të drejtë këtë kërkesë si një kërkesë të paraqitur prej palëve gjatë hetimit paraprak e ka shqyrtuar atë me një gjyqtar të vetëm, në kuptim të nenit 13/2, gërma *a*) të K.pr.penale, i cili ka qenë gjyqtari që ka shqyrtuar çdo kërkesë në këtë fazë që lidhet me procedimin konkret në zbatim të nenit 278 të K.Pr.Penale.

I njëjti gjyqtar ka marrë pjesë më pas dhe ka kryesuar trupin gjykues që ka marrë provën në zbatim të vendimit që ka disponuar për marrjen e saj.

Duke qenë se mungon një rregullim explicit i ligjit në lidhje me këtë çështje, nga gjykatat më të larta pjesëmarrja në gjykimin e çështjes në themel të gjyqtarëve anëtarë të trupit gjykues që ka marrë pjesë në sigurimin e provës është konsideruar si rast që ka shkaktuar papajtueshmëri të këtij gjyqtari me të qenit e tij gjyqtar në çështjen konkrete. Për pasojë, në zbatim të nenit 15/2 e nenit 428 të K.Pr.penale, vendimet e dhëna nga këta trupa gjykues janë cenuar. Me një vendim të Gjykatës Kushtetuese është pranuar se pjesëmarrja e gjyqtarëve anëtarë të trupit gjykues që ka bërë sigurimin e provës në gjykimin e çështjes nuk përbën rast papajtueshmërie për gjykimin e çështjes.

Duke e konsideruar seancën e sigurimit të provës si një pjesë të procesit gjyqësor e cila, zhvillohet në kohë përpara tij POI', në cilën zbatohen të gjitha rregullat që vlejné për marrjen e provës gjatë procesit gjyqësor, mendoj që është e diskutueshme pjesëmarrja në trupin gjykues që merr

provën të gjyqtarit që ka pranuar kërkesën për marrjen paraprakisht të saj. Neni 15/2 i K.Pr.penale parashikon se gjyqtari që ka vleftësuar një kërkesë të prokurorit gjatë hetimeve paraprake nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Në kuptim të nenit 380 të K.pr.penale sipas të cilit gjykata vendos mbi provat e marra ose të verifikuara në shqyrtimin gjyqësor, mund të interpretojmë se prova e marrë në seancën e sigurimit të provës është një provë e marrë në shqyrtimin gjyqësor përderisa ajo merret nga gjykata në zbatim të rregullave për marrjen e provave prej saj. Në këtë kuptim, kjo provë është marrë nga një trup gjykues në të cilin ka marrë pjesë një gjyqtar që nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes për shkak të papajtueshmërisë tij, për pasojë prova është marrë nga një trup gjykues që nuk ka numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për gjykimin e çështjes. Në kuptim të nenit 128/1, gërma *a*) e K.Pr.Penale kjo do të çonte në pavlefshmërinë absolute të procesverbalit të sigurimit të provës.

Duke mbetur një qëndrim personal dhe jo i praktikës gjyqësore, qëndrimi i mësipërm, mendoj që do të ishte e drejtë t'i nënshtrohej një diskutimi më të gjerë për të arritur në një konkluzion që, gjithsesi do të konsiderohej më i plotë.

§ 2.3. Ankimi i vendimit në gjykatën e apelit.

Neni 320/2 i K.Pr.Penale parashikon të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës për pranimin apo rrëzimin e kërkesës për sigurimin e provës. Ky ankim mund të bëhet brenda 5 ditëve dhe gjykata e apelit është e detyruar të shqyrtojë çështjen brenda 10 ditëve nga depozitimi i akteve.

Problemi i ngritur në praktikë qëndron në faktin se çfarë ndodh me procesin për sigurimin e provës kur ankohet vendimi që pranon marrjen paraprakisht të saj. Ka praktika që kanë pezulluar marrjen e provës deri në pritje të dhënies së vendimit nga Gjykata e Apelit. Në komentarin e procedurës penale* hidhet ideja se ligji nuk është i qartë në lidhje me këtë problem duke e interpretuar të drejtën e ankimit që parashikon kjo dispozitë vetëm ndaj vendimit që refuzon marrjen e provës. Mendoj që ky interpretim është disi i zgjeruar dhe shkon përtej asaj që vetë kjo dispozitë ka në përmbajtjen e saj.

Sipas mendimit tim, ankimi mund të ushtrohet në të dyja rastet, pra edhe kur vendimi ka pranuar sigurimin e provës por, ky ankim nuk duhet të pezullojë ekzekutimin e këtij vendimi. Në këtë arsyetim shkon së pari fakti që vetë ligji nuk është shprehur taksativisht për pezullimin e ekzekutimit të vendimit dhe, së dyti për vetë natyrën e pasojave që prodhon ky vendim. Në

kushtet kur ky vendim jepet për nevoja emergjente të marrjes së provës në të cilat, elementi kohë është determinant, ligji nuk mund të rregullojë situatën mbështetur në një parim të ndryshëm që do sillte krejtësisht pasojën e kundërt me atë për të cilën është krijuar ky institut.

Në vazhdim të këtij arsyetimi seanca për sigurimin e provës do të vazhdojë të zhvillohet sipas disponimit që ka bërë gjykata që ka pranuar marrjen saj dhe në rast se gjykata e apelit do të çmojë të cënueshëm vendimin e ankimuar atëherë, ky fakt do të ndikojë edhe në vlerën e provës së marrë. Në rastin e një vendimi gjyqësor të ndryshuar apo të prishur nga gjykata e apelit gjithsesi do të gjendeshim para një vendimi gjyqësor të pavlefshëm në kuptim të pasojave ligjore që ai ka tentuar të prodhojë. Në këtë kuptim, duke zbatuar rregullin e vendosur në nenin 131/1 i K.pr.penale edhe procesverbali për sigurimin e provës do të konsiderohej si i tillë. E drejta që u njihet palëve shprehimisht nga neni 129/2 i K.Pr.Penale për të kërkuar pavlefshmërinë e akteve të kryera për sigurimin e provës para se të filloje shqyrtimi gjyqësor mendoj që është një nga pasojat e cenimit të vendimit të gjykatës.

§ 2.4. Pjesëmarrja e mbrojtësit të të pandehurit në seancën për sigurimin e provës.

Në kuptim të nenit 321 të K.Pr.Penale pjesëmarrja e të pandehurit në seancën për marrjen e provës nuk është e parashikuar si një e drejtë e të pandehurit përveç rastit kur prova lidhet me pyetjen e një personi. Kjo dispozitë parashikon se i pandehuri nuk merr pjesë në këtë seancë përveç se me autorizim të gjykatës, për pasojë zhvillimi i seancës realizohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit (neni 320/1).

Në rastin e marrjes së dëshmisë dhe të pyetjes së një personi tjetër që mund të jetë një i pandehur në një procedim tjetër, i pandehuri ka të drejtë të marrë pjesë në seancë sipas nenit 320/2 i K.Pr.penale. Në këtë seancë i pandehuri mund të zgjedhë të mbrohet personalisht pa kërkuar një mbrojtje ligjore me një avokat. Mendoj që kjo seancë duhet të zhvillohet në këto kushte pavarësisht se në të nuk merr pjesë një mbrojtës ligjor për të pandehurin. Dispozitat që rregullojnë të drejtën e të pandehurit për t'u mbrojtur me një mbrojtës të kualifikuar ligjor, e konsiderojnë këtë një të drejtë të tij të cilën shteti është i detyruar ta respektojë dhe jo një detyrim apriori të organit që procedon. Neni 49/1 i K.pr.penale parashikon se "*i pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të ndihmohet*

nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon". Në zbatim të këtij parimi të procesit penal i cili është në nivelin e garancive që ofron K.E.D.NJ, zhvillohet edhe seanca për sigurimin e provës në prezencë të të pandehurit i cili nuk kërkon të ndihmohet nga mbrojtësi.

Përcaktimi i bërë në nenin 322/1 i K.Pr.Penale, sipas të cilit "provat e marra sipas rregullave të këtij kreu mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor vetëm ndaj të pandehurve, mbrojtësit e të cilëve kanë asistuar në marrjen e tyre" rregullon pasojën e mungesës së mbrojtësit në rastet kur prezenca e tyre është e domosdoshme duke qenë se të pandehurit nuk mund të marrin pjesë (neni 321/1), si edhe për provat mbi faktet që kanë të bëjnë me persona që nuk përfaqësohen nga mbrojtësit në seancë, siç ndodh kur nga dhënia e një dëshmie mund të rezultojnë të dhëna edhe për persona të tjerë të cilët nuk janë konsideruar ende se duhet të procedohen për këto fakte dhe që, për pasojë, nuk përfaqësohen në seancë.

Në një rast, gjykata e apelit për krime të rënda ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm duke e konsideruar të papërdorshme dëshminë e marrë pa praninë e mbrojtësit të të pandehurit prezent.

§ 3. Marrja e dëshmisë si provë në procesin penal.

§ 3.1. Dëshmia indirekte.

Dëshmia është një nga provat më të ndeshura në procesin penal dhe shërben për vërtetimin e rrethanave të faktit kriminal, të motivit të kryerjes së tij si edhe për provimin e fajësisë së të pandehurit.

Në kuptim të nenit 153 të K.pr.penale dëshmitari pyetet për faktet që janë objekt i të provuarit. Përgjithësisht përveç vetëm rasti kur ai pyetet për fakte që nuk janë objekt prove, por shërbejnë për të vlerësuar besueshmërinë e tij. Të dhënat që dëshmitari jep mbi faktet objekt prove duhet të jenë vënë në dijeni të tij nëpërmjet perceptimit të drejtpërdrejtë të dëshmitarit. Ai mund të dëshmojë para gjykatës vetëm për fakte të cilat ai i njeh për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë të tij me rrethanën. Në kuptim të nenit 153/3 dëshmitari ndalohet të dëshmojë para gjykatës për çka flitet në publik, pra për atë që ai ka mësuar për shkak të qenies e jetesës së tij në një komunitet të caktuar dhe ndalohet gjithashtu të japë vlerësime personale për faktet.

Në rastet kur dëshmitari dëshmon mbi një fakt të caktuar të cilin nuk e ka perceptuar drejtpërdrejt, por e ka mësuar nga një burim tjetër, ndodhemi para rasteve të dëshmisë indirekte.

Në mënyrë që dëshmia indirekte të jetë një provë e përdorshme në proces dëshmitari duhet të tregojë personin ose burimin nga e ka dijeninë për faktet. Në rast se dëshmitari refuzon ose nuk është në gjendje të bëjë këtë, dëshmia e tij nuk mund të përdoret.

Në kuptim të nenit 154 të K.pr.penale gjykata, në rastet kur individualizohet personi që ka shërbyer si burim informacioni qoftë me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, urdhëron thirrjen e tij për të dëshmuar. Në varësi të faktit se cila nga palët ka kërkuar pyetjen e dëshmitarit që bën dëshmi indirekte, asaj pale duhet t'i përkasë edhe detyrimi për të saktësuar vendndodhjen e dëshmitarit që do të thirret nga gjykata edhe në rastet kur ajo disponon kryesisht për këtë thirrje.

Moskryerja e veprimeve të mësipërme nga gjykata e bën dëshminë të papërdorshme për atë pjesë të fakteve që ai i ka mësuar nga personat e tjerë.

Kjo dëshmi mund të marrë vlerën e provës në rast se personi që kërkohet të pyetet a) ka vdekur, b) është i sëmurë rëndë, c) ose nuk gjendet.

Mendoj që në të tre këto raste, kur këta persona kanë bërë deklaramë në fazën e hetimeve paraprake, gjykata, me kërkesë të palëve mund të përdorë leximet e lejueshme të akteve që përmbajnë deklaramet e tyre në kuptim të nenit 369 të K. pr. penale.

Pavarësisht se dëshmia indirekte mund të përdoret në këto tre raste edhe pa lexuar aktet me deklaramet e tyre, mendoj që përmbajtja e akteve do të shërbejë jo për të bërë të përdorshme dëshminë por, për të çmuar vlerën provuese të saj.

§ 3.2. Referimi si burim i dëshmisë indirekte tek i pandehuri.

Mund të ndodhë që dëshmitari, në kushtet e dhënies së një dëshmie indirekte të referojë tek i pandehuri si burim i informacionit të tij. Qëndrimet e hasura në këtë rast janë dy.

I pari qëndrim i juristëve e konsideron këtë dëshmi të papërdorshme pasi në zbatim të nenit 154/1, personi që ka shërbyer si burim duhet të thirret për të dëshmuar prej gjykatës. Në kushtet kur i pandehuri nuk mund të pyetet më cilësinë e dëshmitarit, dëshmia që referon tek ai nuk mund të përdoret.

Qëndrimi tjetër (me të cilin bashkohem personalisht) është ai që i pandehuri mund të pyetet për të deklaruar mbi faktet që dëshmon dëshmitari. Natyrisht që i pandehuri nuk mund të pyetet me cilësinë e dëshmitarit dhe nuk ka detyrim për të dëshmuar. Ai do të pyetet nga gjykata

dhe do të japë deklaramë në qoftë se jep pëlqimin për këtë në zbatim të dispozitave që rregullojnë pyetjen e të pandehurit (neni 166-167 të K.Pr.Penale). Në rast se i pandehuri refuzon të përgjigjet, atëherë, dëshmia indirekte nuk mund të përdoret në respektim të nenit 154/2 të K.Pr.Penale, meqenëse të vetmet raste kur ajo mund të përdoret edhe pa u pyetur personi burim janë ato të parashikuara në këtë paragraf.

§ 3.3. Pyetja e dëshmitarëve në zbatim të rregullave të posaçme të parashikuara nga ligji nr.9110 dt.24.07.2003 dhe të nenit 3611, a të k.Pr.Penale.

Neni 8 i ligjit nr.9110 dt.24.07.2003 parashikon të drejtën e gjykatës për krime të rënda që në rastet që ajo e çmon të nevojshme të realizojë pyetjen e dëshmitarëve, ballafaqimet ose të kryejë leximet e lejueshme në zbatim të rregullave të posaçme që parashikon kjo dispozitë dhe legjislacioni për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Këto rregulla procedurale të ndryshme nga rregullimet klasike që parashikohen për pyetjen e dëshmitarëve janë format e reja të procedimit në procese penale për shkak të rëndësisë së tyre dhe natyrës së veprave penale që gjykohen me qëllimin e vetëm luftën dhe ndëshkimin e krimit të organizuar.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të cituar më lart K.pr.Penale është ndryshuar me ligjin nr.9276 dt.16.09.2004, sipas të cilit është shtuar në kapitullin e marrjes së provave neni 361/a i cili rregullon pyetjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Në këndvështrim të këtyre dispozitave të para së bashku, këto rregulla konsistojnë në:

1. në kuptim të nenit 8 të ligjit nr.9110 dt.24.07.2003 zbatimi i rregullave të posaçme të pyetjes nga gjykata e krimeve të rënda, mund të aplikohet edhe ndaj personave që nuk janë të përfshirë në rrethin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë apo dëshmitarëve të mbrojtur, të trajtuar nga ligji nr.9205 dt.15.03.2004 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë". Sipas këtyre rregullave dëshmitari mund të pyetet ose të kryhet ballafaqimi midis dy dëshmitarëve, duke:

a) u kryer pyetja dhe ballafaqimi në prezencë të mbrojtësit dhe të pandehurit, por pa kontakt vizual. Kjo do të thotë që i pandehuri e mbrojtësi të njohin identitetin e dëshmitarit, të dëgjojnë zërin e tij, por të mos kenë mundësi të perceptojnë vizualisht pamjen e tij fizike.

b) pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit. Në këto raste dëshmitari shfaqet fizikisht para tyre, ata kanë mundësi ta shohin e ta dëgjojnë por, identiteti i tij mbetet anonim. Në këto raste identiteti është i njohur për gjykatën por ai nuk i komunikohet të pandehurit.

c) duke u aplikuar të dy rregullat e mësipërme njëherësh. Pra dëshmitari pyetet në mungesë të kontaktit vizual dhe në mungesë të komunikimit e identitetit të tij tek i pandehuri.

Në mungesë të një mbrojtjeje të posaçme për dëshmitarin aplikimi i të dy rregullave njëherësh do të ishte versioni më i drejtë, duke konsideruar faktin që vendi ynë është me një popullsi të vogël dhe shumë lehtë do të zbulohet identiteti i dëshmitarit që gjykata do të tentonte të mbante të fshehur duke aplikuar vetëm njërin nga rregullat.

2. Në rastin kur gjykata merr në pyetje persona që trajtohen nga ligji "Për mbrojtjen e dëshmitarëve e bashkëpunëtorëve të drejtësisë" do të zbatohen rregullat e nenit 361/a i K.pr.penale.

Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë" përcakton rrethin e personave që do të trajtohen si të tillë.

Sipas nenit 2/1 të ligjit, dëshmitar i drejtësisë konsiderohet personi ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, për shkak se në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar bën njoftime, dëshmon për fakte e rrethana që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale që parashikon ligji dhe që për shkak të këtyre njoftimeve ose dëshmive, ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.

Sipas nenit 2/2 të ligjit bashkëpunëtor i drejtësisë, konsiderohet personi që është i pandehur në një procedim penal ose vuan dënimin, ndaj të cilit zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes, për shkak të bashkëpunimit, njoftimeve dhe deklarimeve të bëra në procedime penale, për vepra penale të parashikuara në këtë ligj dhe që për këto arsye ndodhet në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.

Sipas nenit 2/3 të ligjit, persona të afërm konsiderohen ato që ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve familjare, të gjinisë a krushqisë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë dhe që, si rregull, banojnë ose bashkëjetojnë në mënyrë të qëndrueshme me të/ta.

Sipas nenit 2/4 të ligjit, persona të lidhur konsiderohen ata persona që për shkak të natyrës së marrëdhënieve konkrete që kanë me dëshmitarin ose

bashkëpunëtorin e drejtësisë, ndodhen në gjendje të rrezikut aktual, konkret dhe serioz.

Në zbatim të nenit 361/a/1 të K.Pr Penale, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve, mund të vendosë që pyetja e dëshmitarëve ose bashkëpunëtorëve të drejtësisë të zhvillohet nën masa të veçanta sigurie të cilat përcaktohen prej saj.

Ligji nuk përcakton se cilat mund të jenë këto masa të veçanta duke e lënë në diskrecion të gjykatës përcaktimin e tyre por, nga qëllimi i ligjit gjykata është e detyruar që masat të jenë në funksion të mbrojtjes së dëshmitarit në masën që do të çmohet e nevojshme prej saj në varësi të rrethanave. Një alternativë e këtyre masave mund të jetë pyetja e dëshmitarit ose bashkëpunëtorit të drejtësisë pa praninë e publikut dhe medias duke aplikuar rregullimin që bën neni 340/1 &c i K.Pr.Penale.

Neni 361/a&2 i K.pr.penale parashikon mënyrën e pyetjes së dëshmitarit për të cilin është vendosur ndryshimi i identitetit në zbatim të nenit 10/ <; të ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë". Në këto raste gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët. Këto masa lidhen me ndryshimin e pamjes e deformimin e zërit të dëshmitarit të cilët duhet të kryhen nga persona të specializuar. Në këto raste kontakti vizual i dëshmitarit me të pandehurin ndodh por nën një identitet të ndryshuar dhe në një portret e zë maksimalisht të ndryshuar. Këto masa duhet të ekzistojnë dhe të shoqërojnë jo vetëm procesin e marrjes në pyetje por edhe atë para tij e pas tij, për sa kohë që personi mund të ketë kontakte me të pandehurin apo me persona të tjerë të interesuar.

Neni 361/a&2 parashikon gjithashtu se në rast se njohja e identitetit të personit që e ka ndryshuar atë është e domosdoshme ose që është e nevojshme këqyrja e tij, në (çdo rast është gjykata që do të vendosë nëse ekziston kjo nevojë), gjykata urdhëron paraqitjen e tij për përmbushjen e këtij veprimi. Në këto raste gjykata urdhëron që të merren masa që të pengohet pamja e dallueshme e fytyrës së personit. Pra në këto raste personi nuk shfaqet para gjykatës i maskuar, por kontakti vizual mes tij dhe të pandehurit apo personave të tjerë në sallë, pengohet nëpërmjet vendosjes së pengesave që nuk lejojnë shikimin e fytyrës së dëshmitarit.

§ 3.4. Pyetja në distancë e dëshmitarëve duke përsorur mjetet audio-vizive.

Procedura jonë penale parashikon edhe rastin e pyetjes në distancë të dëshmitarit. Kjo pyetje mund të realizohet si për dëshmitarin e zakonshëm, ashtu edhe për dëshmitarin e mbrojtur apo bashkëpunëtorin e drejtësisë, rregullime të përcaktuara në nenet 361/7 e 361/a&1.

Sipas këtyre dispozitave dëshmitari mund të pyetet në distancë kur ai ndodhet si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Gjatë pyetjes në distancë të dëshmitarit që ndodhet brenda vendit zbatohen rregullat e përcaktuara në K.Pr.Penale për pyetjen e dëshmitarit si edhe për zbatimin e masave të mbrojtjes (parashikim i nenit 361/a) kur ai është në rrethin e personave që trajtohen nga ligji "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

Për pyetjen në distancë të dëshmitarit që ndodhet jashtë vendit në pyetjen e tij përveç rregullave të përmendura më lart e të parashikuara nga legjislacioni ynë do të zbatohen edhe rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare. Aktet ndërkombëtare aplikohen që në fillim të procedurës që kërkon realizimin e pyetjes së dëshmitarit e më pas edhe mënyrën e pyetjes së tij.

Akte ndërkombëtare që trajtojnë posaçërisht mbrojtjen e dëshmitarëve dhe mënyrën e vjeljes së informacionit prej tyre, nuk janë hartuar por, ato bëjnë pjesë në aktet ndërkombëtare të fushës penale si element të rregullave të shpalluara prej tyre. Këto akte konsistojnë në:

Në nenin 24 e 25 të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", ratifikuar me ligjin nr.8920 dt.11.07.2002 u rekomandohet shteteve palë, për të marrë masat e duhura, që t'u sigurohet një mbrojtje efektive nga reprezaljet dhe kërcënimet e mundshme kundër viktimave ose bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të cilët dëshmojnë për veprat penale të krimit të organizuar, si dhe sipas rastit për mbrojtjen e familjarëve apo njerëzve të afërm të tyre.

Sipas neneve 23 e 24 të "Protokollit të dytë shtesë të Konventës Evropiane të Këshillit të Evropës, "Për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale", ratifikuar me ligjin nr.8883 dt.18.04.2002, palët nënshkruese të këtyre akteve mund të lidhin marrëveshje e të bien dakord për masat e mbrojtjes së dëshmitarit të rrezikuar ose në nevojë për mbrojtje, si dhe për masat provizore të mbrojtjes, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

Sipas neneve 9 e 10 të Protokollit të dytë shtesë të kësaj konvente palët nënshkruese, mund të bien dakord edhe për zhvillimin e procesit me video konferencë, me kusht që përdorimi i video konferencës nuk bie ndesh me parimet e ligjit të brendshëm.

Në të dyja rastet, pra edhe kur dëshmitari ndodhet brenda vendit edhe jashtë tij, pranë tij qëndron një person i autorizuar nga gjykata. Ky person bën verifikimin e identitetit të personit dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit të pyetjes. Ai ndihmon dëshmitarin në problemet që mund të ketë për shkak të dëgjimit apo kuptimit të pyetjeve. Për veprimet e kryera prej tij ai mban një procesverbal.

Në çdo rast që të kryhet një pyetje në distancë duhet që gjykata të disponojë mjetet teknike për ta kryer atë. Në praktikën tonë gjyqësore numërohet vetëm një rast i vetëm i pyetjes së dëshmitarit në distancë nëpërmjet komunikimit audio-viziv, për pasojë këto rregullime mbeten ende në një fazë të trajtimit teorik të tyre për sa kohë që praktika nuk na ka ofruar ende probleme ligjore për zgjidhje. Me sa duket deri në këto momente vështirësia thelbësore qëndron tek pamundësia e kryerjes teknikisht të një komunikimi audio viziv, për sa kohe që nuk është përcaktuar ligjërisht se cili do të jetë enti që do të realizojë teknikisht lidhjen apo si do të operojë gjykata me të.

§ 3.5. Pyetja me cilësinë e dëshmitarit të agjentit të infiltruar.

Sipas parashikimeve të nenit 294/b&4 të K.pr.penale mund të pyetet me cilësinë e dëshmitarit edhe punonjësi i policisë i infiltruar në përbërjen e një grupi kriminal. Neni 294/b parashikon se cilat janë të drejtat e detyrat e këtij punonjësi policie duke përcaktuar se ai mbledh të dhëna që shërbejnë për zhvillimin e hetimeve, të cilat më pas dërgojnë organet proceduese në goditjen e aktivitetit kriminal e ndëshkimin e tij sipas ligjit. Si rregull të dhënat që jep punonjësi i infiltruar duhet të shërbejnë për mbledhjen e provave që provojnë ekzistencën e organizatës kriminale, por ligjvënësi e ka parë të arsyeshme që ai të dëshmojë para gjykatës për faktet për të cilat ai është vënë në dijeni si pasojë e aktivitetit të tij. Kodi i procedurës penale nuk parashikon rregulla të posaçme për marrjen në pyetje të këtij dëshmitari dhe e trajton atë si dëshmitarët e zakonshëm.

Duke pasur parasysh faktin që punonjësi i infiltruar vepron me një identitet të rremë dhe se duhet që atij t'i sigurohet një mbrojtje, gjatë pyetjes së tij dhe ai nuk mund të trajtohet si dëshmitarët e zakonshëm. Në këndvështrim të faktit që në këto raste, infiltrimi i punonjësit të policisë

bëhet me qëllim zbulimin e krimeve të rënda, pra vepra që do të gjykohen nga gjykatat e krimeve të rënda, mund të zbatohen në pyetjen e tij rregullimet e veçanta që bën neni 8 i ligjit 9110 dt.24.07.2003, duke mos i komunikuar të pandehurit as identitetin dhe as duke bërë të mundur pamjen fizike të dëshmitarit.

§ 4. Përgjimet si mjet për kërkimin e provës.

§ 4.1.

Përgjimet janë të parashikuara në K.pr.penale si një nga mjetet për kërkimin e provës në nenet 221-226 të tij. Në përmbajtje përgjimi është ndërhyrje e fshehtë në bisedat direkte ose të telekomunikacionit në të cilat marrin pjesë një ose më shumë të dyshuar, me qëllim kapjen, dëgjimin e regjistrimin e përmbajtjeve të komunikimeve. Gama e përgjimeve dhe rastet kur lejohen ato si edhe mënyra e kryerjes së tyre ka qenë në një proces të vazhdueshëm ndryshimesh të cilat kanë ecur në të njëjtën linjë me ndryshimet në legjislacion, me qëllim bërjen sa më efikase të luftës kundër krimit të organizuar.

Sipas nenit 221 të K.pr.penale të ndryshuar përgjimet kategorizohen në:

1. përgjimet e komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji; 2. përgjimi i fshehtë me mjete teknike në vende private; 3. përgjimi me audio e video në vende private; 4. regjistrimi i numrave hyrës dhe dalës.

Kjo kategori përgjimesh lejohet vetëm kur procedohet për a) krime që kryhen me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet; b) për kundravajtjet penale të fyerjes e të kanosjes të kryera me mjete komunikimi.

Për një kategori më të lehtë veprash penale për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum se dy vjet, lejohet përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende publike si edhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes.

Përgjimi sipas përcaktimit të këtij neni mund të urdhërohet kundër: personit të dyshuar për kryerjen e një krimi; personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime me të dyshuarin, që mund të jetë një person jashtë sferës së personave të dyshuar por që vihet nën përgjim për shkak të lidhjes së tij me të dyshuarin; personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin, transaksione që mund të jenë të ligjshëm ose jo; personit, nga

vëzhgimi i të cilit mund të identifikohet gjeneralitet e të dyshuarit ose vendndodhja e tij.

Pavarësisht nga fakti se cili person apo cili numër është objekt përgjimi, rezultatet e tij, kur ai është kryer në parashikim të dispozitave që rregullojnë përgjimin janë të përdorshëm për të gjithë komunikuesit.

Përgjimi i konsideruar edhe nga ligjvënësi si një shkelje e së drejtës për jetën private e familjare të individit (parashikim i nenit 8 të K.E.D.Nj) është pranuar si një ndërhyrje e autoritetit publik në ushtrimin e kësaj të drejtë në shkallën dhe masën e parashikuar nga ligji kur kjo çmohet e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e vendit apo parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e të drejtave e lirive të të tjerëve. Për këtë shkak, për të siguruar garantimin e parimit të proporcionalitetit është parashikuar kontrolli gjyqësor mbi përgjimet.

Si rregull, përgjimet autorizohen me vendim të motivuar të gjykatës kur kërkesa e paraqitur prej prokurorit ose të dëmtuarit akuzues plotëson tri kushtet:

a) përgjimi të kryhet për rastet e lejuara me ligj (kriteret e nenit 221).

b) përgjimi të jetë i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara. Ky kusht lidhet me faktin që përgjimi autorizohet për një procedim të nisur, pra kur ekzistojnë kushtet e tjera që kanë lejuar fillimin e ndjekjes penale dhe kur ky veprim çmohet si i domosdoshëm për vazhdimin e hetimit për shkak të natyrës së çështjes, rrethanave konkrete.

c) përgjimi lejohet kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Në lidhje me këtë kërkesë të dispozitës janë hasur probleme në praktikën e gjykatave tona. Në kuptim të kësaj dispozite organi i prokurorisë, në momentin që paraqet kërkesën për autorizimin e përgjimit duhet të disponojë prova të mjaftueshme për të provuar akuzën. Duke qenë se termi i përdorur në dispozitë tejkalon standardin e arsyeshëm për të vazhduar kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore të cilat, nuk do të kishin kuptim të vazhdonin për një çështje nëse akuza do të provohej mjaftueshëm, mendoj që minimalisht akuza duhet të jetë e ngritur mbi akte që e provojnë të paktën akuzën e nivelit të një dyshimi të arsyeshëm. Në këtë kuptim, përgjimi nuk mund të jetë veprimi hetimor i parë që kryhet nga organi i prokurorisë por, ai duhet të ketë të dhëna serioze që tregojnë se ekzistojnë realisht kushtet për autorizimin e përgjimit dhe çështja të mos ketë nisur mbi hamendësime apo rrethana të supozuara.

Për shkak të moszbatimit të këtij kriteri në praktikë është hasur problemi i caktimit të masave të sigurimit duke u mbështetur dyshimin e arsyeshëm të

bazuar vetëm në rezultatet e përgjimit, ndërkohë që me vendim të gjykatës është autorizuar depozitimi i akteve deri në përfundim të hetimeve. Në caktimin e masave të sigurimit në këto raste gjykata, pasi lexonte dhe njihej me aktet e përgjimit, ia kthente ato prokurorit dhe vendoste masën e sigurimit duke krijuar dyshimin mbi to pa i dhënë mundësi mbrojtjes e të pandehurit për t'u njohur me to në respektim të vendimit për depozitimin e tyre.

Gjykata e Lartë, në çështje të kësaj natyre të marra për shqyrtim ka konkluduar se këto akte duhet të vihen në dispozicion të të pandehurit dhe të mbrojtjes në kohën që prokurori kërkon të mbështesë mbi to dyshimin e arsyeshëm të nevojshëm për caktimin e masave të sigurimit. Në lidhje me vendimin e gjykatës që ka shtyrë depozitimin e këtyre akteve, mendoj që disponimi që gjykata bën në këtë rast duke autorizuar prokurorin që të shtyjë depozitimin e akteve, është në mbrojtje të fshehtësisë së hetimeve paraprake, por në momentin që vetë organi i akuzës kërkon të ndërmarrë masa për cenimin e lirisë së individit, ai nuk mund të pengohet të depozitojë këto akte duke abstraguuar fshehtësinë dhe duke i dhënë epërsi provimit të dyshimit të arsyeshëm.

Gjykata, në vendimin që autorizon përgjimin, përcakton:

a) mënyrën e kryerjes së përgjimit duke përcaktuar se cila nga format e përgjimit autorizohet të kryhet

b) kohëzgjatjen e veprimeve e cila, nuk mund të jetë më shumë se 15 dite (afat i zgjatshëm me kërkesë të prokurorit)

c) personin ose numrin e telefonit objekt përgjimi (kur ka përgjim të komunikimeve telefonike)

d) veprime të nevojshme për t'u kryer nga oficeri i policisë gjyqësore, në kryerjen e përgjimeve të fshehta fotografike ose me video, ose biseda në vende private.

Në përjashtim nga rregulli i përgjithshëm përgjimi mund të autorizohet nga prokurori në rastet kur:

1. përgjimi do të kryhet në vende publike;
2. konsiston në regjistrimin e numrave hyrës e dalës;
3. kryhet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes;
4. kur njëri nga personat që do të përgjohen është në marrëveshje me oficerin e policisë gjyqësore;
5. kur nevoja e kryerjes së përgjimit është emergjente pasi nga vonesa mund t'i vijë dëm hetimit. Në këto raste vendimi i motivuar i njoftohet gjykatës jo më vonë se 24 orë, e cila brenda 48 orëve nga vendimi i prokurorit bën vleftësimin e

përgjimit. Në rast se gjykata nuk bën vleftësimin në afat rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren. Mendoj që kërkesa e prokurorit për vleftësimin e përgjimit të autorizuar prej tij duhet të shoqërohet me procesverbalin që pasqyron veprimet e përgjimit dhe në cilin është e transkriptuar edhe përmbajtja e regjistrimit. Në këto kushte, kur gjykata vleftëson një përgjim të autorizuar nga prokurori duke administruar edhe rezultatit e përgjimit bëhet plotësisht i kontrollueshëm veprimi i organit të akuzës dhe i vihet fre abuzimit në kohë me vendimin që autorizon përgjimin.

§ 4.2. Urdhërimet e gjykatës për transkriptimin e rezultateve të përgjimit.

Në nenin 223/2 të K.Pr.penale parashikohet se *"komunikimet e përgjuara regjistrohen dhe për veprimet e tyre mbahet procesverbal. Në procesverbal transkriptohet përmbajtja e komunikimeve të përgjuara"*. Në paragrafin vijues parashikohet se procesverbalet i dorëzohen prokurorit. Në kuptim të këtyre dy rregullimeve mund të konkludojmë se veprimet për regjistrimin e përgjimeve dhe transkriptimin e komunikimeve kryhen nga oficerët e policisë gjyqësore të cilët mbulojnë sektorin përkatës.

Sipas paragrafit 3 të nenit 223, të gjitha aktet që kanë autorizuar, vleftësuar, lejuar e zgjatur përgjimin së bashku me procesverbalet e transkriptuara dhe vetë regjistrimet, depozitohen në sekretari duke lajmëruar mbrojtësit se kanë të drejtë të njihen me to.

Për shkak të cenimit të lirisë personale të individit nga ky veprim procedural, debati mbi përdorshmërinë ose jo të rezultateve të përgjimit është i vendosur që në fazën e hetimeve paraprake duke bërë pjesë të tij edhe gjykatën.

Në rast se mbrojtësit do të çmojnë se përgjimi është kryer tej rasteve të lejuara me ligj apo nuk janë respektuar rregullat e vendosura për kryerjen e tij, ata mund të kërkojnë nga gjykata që të konsiderojë rezultatit e përgjimit të papërdorshëm. Gjykata në këto raste, në zbatim të nenit 223/4 të K.pr.Penale, pasi dëgjon palët kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore që lejojnë përgjimin dhe mënyrën e realizimit të tij. Në rast se ajo konstaton se ka shkelje të tyre ajo vendos për heqjen e regjistrimeve dhe të procesverbaleve, përdorimi i të cilave ndalohet. Duke disponuar në këtë mënyrë gjykata urdhëron edhe transkriptimin e regjistrimeve që duhet të merren, të cilat futen në fashikullin e gjykimit.

Zbatimi i urdhërimeve të gjykatës, të parashikuara në nenin 223/4,5 është i detyrueshëm kur ajo vihet në lëvizje për këto disponime me kërkesë

të palëve që në fazën e hetimeve paraprake. Pra, në qoftë se pretendohet papërdorshmëri e përgjimeve gjykata merr në shqyrtim pretendimin që në këtë fazë dhe disponon duke zgjidhur këtë problem e duke përcaktuar rezultatet që mund të përdoren e ato që ndalohen të përdoren. Në këto raste ajo disponon edhe për asgjësimin e regjistrimeve që ndalohet të përdoren në zbatim të nenit 226/3 të K.Pr.Penale.

Në rast se mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve nuk paraqesin kundërshti në këtë fazë të procesit, ligji nuk e lidh mosushtrimin e kësaj të drejte me pasojën e humbjes së saj. Mbrojtja ka të drejtë të paraqesë një pretendim të tillë në çdo gjendje e shkallë të procedimit, në zbatim të nenit 151/4 të K.pr.penale, për sa kohë që këto pretendime kanë karakterin e vlerësimit si të papërdorshëm të rezultatit të përgjimit.

Në rast se ndodh një pretendim i tillë në procesin gjyqësor gjykata është e detyruar njësoj të shqyrtojë këtë pretendim dhe të disponojë në lidhje me papërdorshmërinë ose jo të rezultateve.

Gjykata mund të gjendet shpesh në këtë situatë gjatë gjykimit të çështjes për sa kohë që në shumicën e rasteve autorizohet depozitimi i akteve të përgjimit për shkak të mosdëmtimit të hetimeve dhe mbrojtja njihet me to vetëm në fund të hetimeve paraprake.

Në kuptim të nenit 226/1 të K.Pr.Penale, i cili parashikon se "rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni", mendoj që përcaktimi "kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni, ka nevojë për interpretim". Është i qartë rasti i kryerjes së përgjimit tej rasteve të parashikuara në ligj, por mbetet i diskutueshëm përcaktimi i dispozitave të këtij seksioni, shkëlja e të cilave shkakton papërdorshmëri. Personalisht mendoj se dispozitat duhet të lidhen me kryerjen e përgjimit në kuptim të nocionit të papërdorshmërisë që parashikon neni 151/4, i cili e lidh atë me marrjen e provës. Pra, në rast se janë shkelur dispozitat që rregullojnë marrjen e rezultatit të përgjimit, atëherë ai duhet të konsiderohet i papërdorshëm.

§ 4.3. Marrja e provave të mbledhura nga personi që kryen veprim të simuluar dhe nga agjenti i infiltruar.

Veprimtaria e këtyre dy subjekteve të futur rishtas në procesin penal shqiptar rregullohet nga nenet 294/a e 294/b të K.Pr.Penale. Në të dyja rastet, qoftë personi që kryen një veprim të simuluar, qoftë agjenti i infiltruar e shoqërojnë aktivitetin e tyre me kryerjen e përgjimeve të

komunikimeve me personat e dyshuar apo me ata me të cilët ata kryejnë transaksionin. Autorizimi për kryerjen e këtyre përgjimeve dhe për vetë veprimtarinë e këtyre subjekteve jepet nga prokurori. Veprimet e tyre si rregull, duhet të jenë të regjistruara për shkak të përgjimit në audio të bisedave dhe, kur është teknikisht e mundur, edhe për shkak të përgjimit në video të tyre.

Në ndryshim nga përgjimi i autorizuar nga gjykata, rezultatet e përgjimeve të kryera nga personi që kryen veprimin simulues dhe agjenti i infiltruar nuk bëhen të ditura për mbrojtësit apo për përfaqësuesit e palëve. Ato i dorëzohen prokurorit sipas përcaktimit të nenit 294/a&2 në rastin e veprimeve simuluese dhe nga neni 294/b&1 për agjentin.

Me rezultatet e përgjimit të kryera gjatë kësaj veprimtarie, mbrojtësit njihen në përfundim të hetimeve paraprake përderisa, nuk parashikohet ndryshe në dispozita. Për këtë shkak, mbrojtësve dhe të pandehurve u lind e drejta të njihen drejtpërdrejt me regjistrimet, qoftë audio, qoftë video gjatë procesit të gjykimit të çështjes.

Në seancë gjyqësore gjatë dëgjimit apo shikimit të regjistrimeve të kryera nga agjenti i infiltruar apo nga personi që bën veprimin e simuluar, gjykata duhet të pasqyrojë në procesverbalin gjyqësor në mënyrë të përmbledhur atë çka rezulton nga shqyrtimi i këtyre provave. Gjithashtu, pasi të dëgjojë palët ajo duhet të urdhërojë edhe transkriptimin e komunikimeve të regjistruara në rast se ato do të rezultojnë të ndryshme nga ajo çka është pasqyruar në procesverbalet e hartuara nga oficerët e policisë gjyqësore për këtë, ose në rast se do të kenë nevojë për ndryshime për shkak të pretendimeve të mbrojtjes.

Konkluzionet e palëve në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në të cilin është debatuar mbi të gjitha provat e marra për shqyrtim, përbëjnë në thelb një version të analizës së fakteve që kanë rezultuar në gjykim të interpretuara secila nga pozicioni i secilës prej palëve. Këto konkluzione ndihmojnë gjykatën në marrjen e një vendimi përfundimtar pasi ajo njihet në përfundim të gjykimit me pritshmërinë e secilës palë në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Trajtimi i provave në këndvështrime të ndryshme ndihmon në gjetjen e interpretimit të sakte të tyre në harmoni me njëra-tjetrën. Nëpërmjet konkluzioneve të prokurorit dhe të mbrojtjes gjykata rivihet në vëmendje si të vlerave provuese të provës, ashtu edhe të pretendimit të kundërt me të duke u detyruar të arsyetojë ajo vetë mbi këto prova e të çmojë e përcaktojë vlerën provuese të secilës prej tyre, pavarësisht pretendimit të palëve.

Përfundimisht, mund të themi se i gjithë procesi gjyqësor është një bashkëpunim mes subjekteve të tij, i cili për sa kohë që funksionon mirë në të gjitha hallkat do të shpjerë në një vendim të marrë drejt e të mbështetur në ligj.

INA RAMA
Gjyqtare e Gjykatës së Krimeve të Rënda, Tiranë

Tiranë, Mars 2007

3.2. *Krimi i organizuar dhe legjislacioni shpërblyes në Itali.*

PËRMBLEDHJE: 1. E drejta penale shpërblyese mes lidhjeve dogmatike dhe kërkesave të politikës kriminale. – 2. Masa shpërblyese dhe Shteti i të drejtës: legjislacioni i “viteve të plumbit”. – 3. Legjislacioni “promovues” në fushën penale, normativa shpërblyese dhe detyrimet kushtetuese. – 4. Dispozitat e tjera “shpërblyese” në lidhje me krimet e kriminalitetit të organizuar: a) nenet 73, paragraf.7, dhe 74 paragraf.7, D.P.R. 9 tetor 1990, nr.309. – 5. Vijon: b) Rrethana lehtësuese e posaçme e bashkëpunimit *ex neni* 8, d.l. 13 maj 1991, nr.152, i kthyer me ndryshime në ligjin n.203, dt. 12 korrik 1991. – 6. Rrethana të tjera lehtësuese “shpërblyese” të parashikuara kundrejt atyre që bashkëpunojnë me drejtësinë dhe ndikimet përkatëse në planin procedural dhe të burgimit.

§ 1. *E drejta penale shpërblyese mes detyrimeve dogmatike dhe kërkesave të politikës kriminale.*

Një monitorim kritik – sado nevojshmërisht përmbledhës – i instituteve kryesore që i referohen të ashtuquajturës *të drejtë penale shpërblyese* apo, ndryshe, *drejtësisë penale shpërblyese* (për ta thënë me një shprehje më të gjerë ku gjejnë vend edhe aspektet procedurale dhe të burgimit të *shpërblyeshmërisë*) shpie pashmangshmërisht në një marrje pozicioni ndaj vetë kuptimit të kategorisë së diskutueshme dogmatike që do të jetë objekt i kësaj trajtese.

Padyshim që nocioni – antinomik për shumë aspekte – i *të drejtës penale shpërblyese*, më shumë se një tërësi institutesh që kanë bërë vend përmes përvojës juridike, të sjell ndërmend idenë e një *strategjie* që, duke qenë në kontradiktë të pastër ideologjike me vetë thelbin e *të drejtës penale primitive a të hershme*, synon përpunimin e *teknikave të veçanta të luftës*, që preken nga një dukurologji e gjerë veprash krimi, që në një moment të caktuar historik fitoi – apo mendohet se ka fituar – rëndësinë e një *emergjence të mirëfilltë kriminale*. Bëhet fjalë për dukuri kriminale, që i referohen për më shumë kriminalitetit të organizuar dhe, për këtë arsye, të përshtatshme në vetvete për të kërcënuar rendin demokratik kushtetues (le të mendojmë për kërcënimin terrorist) apo rendin publik dhe vetë integritetin dhe besueshmërinë e institucioneve politike dhe ekonomike (le të mendojmë për format e ndryshme të të vepruarit mafioz, për krimet që kanë të bëjnë me trafikun e lëndëve narkotike dhe me zhvatjet për rrjedhojë që pjell në sistemin e ekonomisë ligjore) apo dinjitetin e njeriut në thelbin e brendshëm të tij (le të mendojmë për trafikun e qenieve njerëzore dhe pedopornografinë të menaxhuara nga organizata kriminale pa skrupuj). Madje është pikërisht

karakteri i emergjencës së këtyre dukurive, që ndonjëherë ecën me cikle apo me luhatje (si terrorizmi), që e bën të jetë e veçantë, pra si përjashtues a të veçantë ndaj ligjeve penale që, duke ndërfutur parashikime të rasteve specifike shpërblyese, kërkojnë të sigurojnë funksionalitet dhe efikasitet të aparatit ndëshkues.

Megjithatë, është detyrë e dogmatikës së të drejtës penale – që i konsideron normat juridike të vlefshme objekt të privilegjuar e nga i cili s’mund të hiqet dorë, të punës së juristit, një pikënisje të përpunimit të koncepteve të saj, pasi janë “dogma” të mirëfillta – të vërtetojë përjashtues sistematike dhe përshtatshmërinë e punës së kryer nga ligjvënësi në këtë fushë. I takon pra interpretuesit përmes procesit të pareshtur të abstragimit dhe përgjithësimit të dispozitave ligjore, të zbërthejë konceptet dogmatike që do shpinin drejt një uniteti sistematik dhe të verifikojë që ligjvënësi, me normativën shpërblyese të emergjencës, i ka vënë vetes një qëllim që përkon me misionin e vet të të drejtës penale. Veprimtaria hermeneutike do të marrë përsipër të vërtetojë që, në procedimin e përgatitjes së të drejtës penale, sidomos në perspektivën e përfarimit të masave në fjalë me nevojën për të garantuar të drejtat themelore të njeriut.

E pra, do të jetë pikërisht dogmatika juridike ajo që do të formojë letrën lakmuese për të verifikuar karakterin logjiko-sistematik të *hipotezave të të drejtës penale shpërblyese*, dora dorës që ato bëhen pjesë e legjislatcionit tonë, kundrejt parashikimeve tradicionale në gjurmën e të cilave shfaqen *prima facie* të modeluara.

Në këtë kuptim mund të pohojmë se dogmatika juspenaliste vazhdon të ruajë, sidomos në një periudhë krize të shpallur të ligjshmërisë dhe humbjes së pikave referuese aksiologjike të gjithë sistemit penal, funksionin e vet garantues²⁰⁹, që synon mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në mbrojtje të shoqërisë. Kjo do të thotë se rindërtimi i instituteve nuk mund të jetë i ndarë, nga njëra anë, nga rregullimi aktual i legjislatcionit kushtetues dhe, nga referimi ndaj parimeve të Shtetit social të të drejtës, dhe as nuk mund të lërë pas dore nga ana tjetër, edhe në dritën e shkeljeve më të rënda të të mirave-vlerë kryesore me rëndësi kushtetuese (rend publik, mbrojtje e nismës ekonomike private dhe solidaritet social, kundrejt autonomisë dhe dinjitetit të njeriut), parimet bazë të mbarë sistemit penal. Lidhur me këtë pikë të fundit marrin rëndësi parimet kushtetuese të Shtetit të të drejtës përmes të cilëve, edhe falë ndihmës së sjellë nga dogmatika juridike, u bë i mundur ndërtimi i një

²⁰⁹ Për funksionin e garancisë së dogmatikës juridike, shih S.MOCCIA, *La perenne emergenza*, Napoli, 2000, rishtypja 1°, 19 e në vijim.

sistemi penal teleologjikisht i orientuar ndaj mbrojtjes së të mirave-vlerave që mbështeten në këto parime ligjore, të një niveli të lartë; në planin substancial: ligjshmëria, vendosmëria dhe detyrueshmëria e veprës penale (nenet 25, par.2 dhe 13 i Kushtetutës), proporcionalitet dhe arsyeshmëri e normës inkriminuese (neni 3 i Kusht.), subsidiaritet (nenet 2, 3, 13, 25 par. 2 dhe 3 i Kusht.) dhe personaliteti i veprës penale (neni 27 par. 1 i Kusht.), cenueshmëri (nenet 13, 25 par. 2 e 3, 27 par. 3 i Kusht.), materialitet (nenet 19 e 25 par. 2 i Kusht.), mbrojtje e dinjitetit të njeriut (neni 2, 3 par. 1, 27 par. 1 e 3, 32 par. 2, 41 par. 2, Kusht.), prezumim i pafajësisë (neni 27 par. 2 Kusht.), detyrim i arsytimit (neni 111 Kusht.), detyrueshmëri e veprimet penal (neni 112 Kusht)²¹⁰.

Në këtë dritë, e destinuar të orientojë punën e vështirë të interpretuesit, lipset të mbajë parasysh një tjetër konsideratë të rëndësishme: tashmë prej kohësh është në krizë koncepti Listian, sipas të cilit e drejta penale përbën një “limit të pakapërcyeshëm të politikës kriminale”, në kuptimin që i pari përfaqëson një “pengesë të pakapërcyeshme garantiste” kundrejt nevojave, ndonëse të ligjshme, të eficientës që e dyta, herë pas here, kërkon t’i japë përgjigje. Madje në doktrinë ka pasur edhe nga ata që janë shtyrë nga qëllimi për të zgjeruar fushën e garancive, si formale dhe substanciale, janë përpjekur të përmbysin konceptin Listian, duke thënë se një sistem modern penal nuk mund të mos kushtëzohet nga pritshmëria e ligjshme për të garantuar një bashkëjetesë paqësore mes anëtarëve të shoqërisë, që respekton të drejtat e individit, në një kuadër përgjigjesh normative koherente dhe eficiente, që përcaktohen nga politika kriminale²¹¹.

Për këtë arsye mund të pohojmë me të drejtë se nën shtysën e politikës kriminale dhe të nevojave të ligjshme të mbrojtjes që ajo përfaqëson, kategoritë dogmatike të përpunuara nga doktrina e krimit në lidhje me elementët themelorë dhe plotësues të veprës penale (vepra tipike, antijuridikësia, fajësia, rrethanat, kushtet objektive të dënueshmërisë, etj...), edhe duke mos ndryshuar identitetin sistematiko-konceptor që i karakterizon, kanë fituar një funksion si të thuash dinamik, në përputhje me misionin politiko-kriminal për të cilën këmbëngul prej kohësh doktrina moderne e të drejtës penale. Në thelb, sipas këtij konceptimi *teleologjik* të sistematikës juridike, që kërkon të gjejë në rrafshin hermeneutik zgjidhje sistematike dhe fusha veprimi të kategorive të veçanta të përpunuara nga doktrina e krimit, vetë përpunimi i këtyre kategorive duhet të rezultojë i

²¹⁰ Pasqyra e përpiktë e parimeve ligjore themelore të sistemit penal është marrë edhe në lidhje me normat kushtetuese, nga S.MOCCIA, *op.cit.*, 15.

²¹¹ Lidhur me këtë pikë, krs. S.MOCCIA, *op.cit.*, 14 e *passim*.

përshtatshëm ndaj *qëllimeve* të përcaktuara nga politika kriminale. Këto ide që, në gjurmët e shkencës penalistike gjermane²¹² i referohen kryesisht nevojës për të lidhur teorinë e përgjithshme të krimit me qëllimet që synon të arrijë dënimi, është pranuar prej kohësh në Itali nga doktrina më e mirë²¹³. BRICOLA, në veçanti, ndërta sjell mendimin e shprehur qartë nga RADBRUCH²¹⁴, i cili e vinte theksin mbi nevojën për një lidhje me të ngushtë dhe metodike mes analizës së tipareve të krimit dhe ‘*qëllimit*’ të sanksioneve penale, kish vërejtur me vend se “pësha e të dhënës teknologjike duhet të jetë më e madhe në një sistem si i yni që fiton një pozicion të qartë (neni 27, parag.3, Kusht.) mbi qëllimin e dënimit”²¹⁵. Sipas mendimit tonë bëhet fjalë për një aspekt jashtëzakonisht të rëndësishëm, që u referohet në mënyrë specifike masave penale shpërblyese që do të jenë objekt i trajtesës sonë, meqë këto masa, duke u konkretizuar sidomos në elementë rrethanash krejt të veçantë kundrejt sistematikës tradicionale të doktrinë së krimit, janë të destinuara të ndikojnë ndjeshëm në llogaritjen e masës së dënimit. Ndryshimi i idesë së shpërblimit, që dikur lidhej ngushtë me teorinë e dënimit dhe me rivlerësimin e njëkohshëm të funksionit përkatës të parandalimit, të përgjithshëm e të posaçëm, ka vendosur në qendër të debatit penalist problemin e rithemelimit politiko-kriminal të dënimit mbi baza që janë të përshtatshme për t’u lënë më shumë hapësirë konsideratave me karakter parandalues. Lidhur me këtë, është vërejtur me kujdes se në një perspektivë të tillë të re, “mund të shpjegohet se përse legjislacioni heq dorë nga zbatueshmëria e sanksionit, edhe në ato raste kur, me të drejtë, nuk është e mundur të përjashtohet qortueshmëria e veprimit kundrejt konceptit klasik: si për shembull, në të ashtuquajturin gjendje të nevojës në krimet kundër administratës së drejtësisë”²¹⁶. Një rol vendimtar në rithemelimin e teorisë së dënimit luajti kategoria dogmatike e fajësisë që, në përpunimin e vet më të fundit doktrinor, dhe po në kuadrin e një “teleologjike” sistematike të krimit, që bën kujdes të verifikojë përshtatshmërinë e qëllimeve të politikës kriminale, duket se është e orientuar të rivlerësojë aspektet juspenalistike të parandalimit të përgjithshëm dhe të posaçëm. Pra në këtë këndvështrim, fajësia ka sqaruar

²¹² SCHMIDHÄUSER, *Strafrecht, All.Teil*, Tübingen, 1970, 110, cit. nga F.BRICOLA, *Teoria generale del reato*, në *Novissimo Dig.It.* (ekstrat), Torino, 1974, 25.

²¹³ Shih p.sh. F.BRICOLA, *op. e loc.cit.*; C.FIORE – S.FIORE, *Dir.Pen., Parte gen.*, Vëllimi i, botimi 2°, Torino, 2004, 153 dhe në vijim dhe shënimi 59, në fq. 154, për referime të tjera doktrinore.

²¹⁴ *Zur Systematik der Verbrechenlehre (Festgabe für Frank)*, 1930, rist.anast., I, 163, cit. nga F.BRICOLA, *op.e loc.ult.cit.*, shënimi 4.

²¹⁵ F.BRICOLA, *op.cit.*, 25, shënimi 6.

²¹⁶ C.FIORE – S.FIORE, *Dir.pen.*, cit.156.

gjithnjë e më shumë rolin e vet dhe funksionin specifik në doktrinën e krimit. Në fakt, ajo nuk përbën më të thjeshtin *pendant* logjiko-juridik të parimit shpërblyes (tashmë të kapërcyer) (*nulla poena sine culpa*), por fiton një funksion të dyfishtë, mjaft të rëndësishëm si garanci: “nga njëra anë pra si parim dhe limit garantist – për shembull për përjashtimin e çdo rëndësia që mund të kenë rastet e përgjegjësive objektive – nga ana tjetër si kategori dogmatike që u referohet qëllimeve të parandalimit (sidomos parandalimi i posaçëm) që dënimi përndjek konkretisht”²¹⁷. Doktrinës nuk i ka shpëtuar korolarit që rrjedh nga rishikimi, në një këndvështrim sistematiko-teleologjik, i kategorisë dogmatike të fajësisë, në pjesën ku theksohet funksioni i saj si rregull interpretimi referuese në lidhje me nevojën politiko-kriminale për të siguruar arritjen e qëllimeve të parandalimit të dënimit, të përgjithshëm dhe të posaçëm. Në fakt, nëse në një këndvështrim shpërblyes të teorisë së dënimit, do t’i lihej fajësisë vetëm detyra për të ndihmuar ndjeshëm në llogaritjen konkrete të dënimit, shkallëzimi i gjykimit të qortueshmërisë që fajësia ka në vetvete do të ndikonte në masën konkrete të dënimit që duhet dhënë, duke u shtrirë nga limiti maksimal tek ai minimal. Ndërsa nëse do të niseshim nga parakushti që nuk është e nevojshme që masa e dënimit duhet të përkohet patjetër me fajësinë, në kuptimin që ajo nuk përfaqëson më – ose vetëm – sanksionin, si shpërblim, që i takon përmasës së qortimit që legjisllacioni parashikon ndaj personit që ka shkelur normën penale, mund të thuhet fare mire që sanksioni penal “mund [...] të mbetet nën masën e fajësisë, nëse kjo shërben për arsye të parandalimit”²¹⁸. Me fjalë të tjera, nga marrja parasysh e detyrave të reja politiko-kriminale të fajësisë rrjedh “njohja e faktit, tashmë të përgjithësuar, që fajësisë i takon si detyrë vetëm të përcaktojë kufirin *maksimal* të dënimit; ndërsa nën këtë limit apo kufi, vetëm arsye të parandalimit (të përgjithshëm apo të posaçëm) mund të ndërhyjnë për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit”²¹⁹.

²¹⁷ *Aut., loc. e op.ult.cit.*

²¹⁸ Në këtë kuptim, ROXIN, *Kriminalpolitik und Strafrechtssystem*, Parathënie e botimit në italisht (*Politika kriminale e sistemit të të drejtës penale. Ese të teorisë së krimit*), nën kujdesin e S.MOCCIA, Napoli, 1998, 24.

²¹⁹ Kështu C.FIORE – S.FIORE, *Dir.Pen.*, cit., 156, të cilëve u referohemi për të pasur një ide të përgjithshme mbi orientimet më të fundit kulturore të doktrinës penaliste mbi marrëdhëniet mes politikës kriminale dhe të drejtës penale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë tematikës që ka të bëjë me themelin dhe limitet e të ashtuquajturit “parim të fajësisë”, i riparë në dritën e “aftësisë më të madhe dhe të përpunuar për të nxjerrë nga krahasimi me legjisllacionin kushtetues një mjet që reflekton gjithnjë e më shumë mbi dogmatikën e krimit dhe mbi premisat e përgjegjësive penale” (lidhur me këtë pikë, shih *Aut., e op.ult.cit.*, 51 – 57).

Tashmë prej kohësh, duke u nisur nga një analizë e instituteve të ndërfutura nga e ashtuquajtura *e drejtë penale shpërblyese*, ka lindur dhe është fuqizuar ideja që “[...] – në kuadrin e përjashtimit apo të uljes së dënueshmërisë – çdo “mundësi politiko-kriminale mund të shërbejë si kriter ligjërues, duke mbetur jashtë vetëm ato që do të sillnin dallime në trajtim sipas kritereve të shpallura nga Kushtetuta”²²⁰. Përveç të tjerash kjo nuk do të thotë që çdo zgjidhje *shpërblyese* që edhe pse në kurriz të kërkesave të ligjshme për shpërblim, do të privilegjonte momentin e përgjithshëm dhe/ose të posaçëm-parandalues të funksionit të dënimit duhet të konsiderohet e ligjshme nga legjislacioni. Në mbështetje të vëmendjes sonë mbi çështjet e interpretimit që lidhen me dukurinë e të ashtuquajturve *bashkëpunëtorë të drejtësisë*, që përfaqëson një ndër aspektet teoriko-praktike më të rëndësishme për këtë çështje, duhet të pranojmë se “në sistemin e të drejtës penale substanciale, “shpërblimi” për bashkëpunimin gjyqësor ka futur elementë mosvazhdimësie në krahasim me logjikën “rehabilituese” të dispozitave të ndryshme “shpërblyese” (lehtësuese apo shkaqe mosdënueshmërie që janë shfaqur ndërkohë)²²¹, që gjenden sidoqoftë në tekstin e parë të kodit Rocco”²²². Në të vërtetë, siç është vërejtur²²³, “[...] pë funksionin e mbrojtjes së po kësaj të mire, e cila mbrohet nga norma inkriminuese, trajtimi “shpërblyes” për sjellje “rehabilituese” është adoptuar gjithnjë dhe është konsideruar koherent me parimet themelore të një sistemi penal të orientuar ndaj ndaj mbrojtjes së të mirave juridike”.

“Në rastin e bashkëpunimit gjyqësor, logjika “riaftësuese” përdoret atëherë kur janë në lojë interesa që lidhen me të njëjtin gjykim (rishikim) apo bëhet fjalë për të penguar pasoja të mëtejshme të veprimtarisë kriminale në fjalë, edhe ato objekt i të njëjtit proces. Në fakt edhe deklaratat gjatë gjykimit mund të shërbejnë për rezultate “reintegruese”, si pengesa për kryerjen e ngjarjes, apo çlirimi i pengut, apo shpërbërja e një organizate kriminale. Brenda këtyre caqeve adoptimi i teknikave shpërblyese kundrejt bashkëpunimit gjyqësor “ndreqës” mund të pretendojë po këtë ligjërim të

²²⁰ I tillë është pozicioni i shprehur në një analizë jo të kohëve të fundit, por ende të vlefshme, të instituteve të para të të drejtës penale shpërblyese që dolën në “vitet e plumbit”, nga D.PULITANO, *Teknika shpërblyese mes të drejtës dhe procesit penal*, Relacion, pjesërisht i ripërpunuar nga A., i mbajtur në Konferencën e studimeve “Enrico De Nicola” mbi *Legjislacionin penal* (Courmayeur, 18-20 prill 1986), në *Riv.it.dir.e proc.pen.*, 1986, 1017.

²²¹ Shih për shembull, 376, 386, 525, 308-309, k.p..

²²² *Aut. e op.ult.cit.*, 1006.

²²³ *Aut.e op.ult.cit.*, 1006.

parimit, dhe ngre të njëjtat probleme konformiteti dhe mundësie politike, që vlejné për çdo institut shpërblyes (dhe jo).

Përtej këtyre rasteve specifike [...] qëndrimet e mundshme të bashkëpunimit gjyqësor [...] mbështeten në një plan “vërtet eksentrik në krahasim me planin e dëmit kriminal”²²⁴. Sipas PULITANÒ-s, institutet e të drejtës penale substanciale që marrin bashkëpunimi gjyqësor me objekt parashikimet shpërblyese “duket se karakterizohen nga një lloj këmbimi i marrëdhënies së zakonshme mes të drejtës dhe procesit penal: norma penale substanciale (siç është për nga përkufizimi një rrethanë lehtësuese) duhet “t’i shërbejë” zbatimit të të drejtës substanciale”²²⁵. I shtohen kësaj shqetësimet e drejta të doktrinës²²⁶ si në lidhje me shtimin e mundshëm të rasteve të gabimeve gjyqësore (pasoje e drejtpërdrejtë kjo e bashkëpunimeve të rreme dhe të qëllimshme pasi nxiten nga ideja utilitariste e një shpërblimi dhe për këtë arsye objektivisht “të dyshimta”), ashtu dhe në lidhje me një pasojë të parashikueshme autoritare të debatit gjyqësor, e gjitha në avantazh të prokurorit, i cili nxitet (edhe e sidomos nga legjislacioni shpërblyes) të kërkojë dhe punojë për të pasur bashkëpunimin e të pandehurit.

Por përtej këtyre problemeve të hasura e të rënda duhet pranuar se, përgjithësisht, teknikat normative shpërblyese, të cilat janë ndërfutur dhe zbatuar në Itali që nga koha kur u shfaq më rëndë dhe më fort kriminaliteti i organizuar, terrorist, mafioz dhe/ose i përbashkët, me përmasa kryesisht transnacionale, kanë dhënë rezultate të mira deri tani, edhe jo shumë të mira në planin e luftës së të ardhurave nga krimi i organizuar.

Megjithatë, për të qëndruar në terrenin e politikës kriminale, jemi thellësisht të bindur që, në një Shtet social të të drejtës si i yni, askush nuk mund të mohojë se ligjvënësi, përballë situatave të “emergjencës” kriminale veçanërisht të rëndë, edhe në aspektin e vështirësive të hasura në veprimin ndëshkues, mund të jetë me të drejtë pro zgjidhjeve ligjore që nxisin, me teknika *shpërblyese*, bashkëpunimin gjyqësor. Madje, rëndësia e skajshme dhe karakteri i jashtëzakonshëm i dukurive kriminale që synohet të luftohen përmes kësaj mundësie, mund të luajë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e ligjshmërisë, edhe kushtetuese (ex neni 3, Kusht., në aspektin e barazisë

²²⁴ Lidhur me këtë pikë, shih T.PADOVANI, *La soave inquisizione*, Riv.it.dir.e proc.pen. 1981, 532.

²²⁵ D.PULITANÒ, *op.cit.*, 1007.

²²⁶ Lidhur me këtë shih O.DOMINIONI, M.LAUDI, BONETTO, *Përvoja konkrete e legjislacionit mbi “të penduarit”*: përballje opinionesh, në *Legislazione penale commentata*, 1983, 605. Shih edhe D.PULITANÒ, *op.cit.*, 1020.

/arsyeshmërisë/proporcionalitetit), të vetë masave shpërblyese. Në fakt, këto të fundit, duke qenë detyrimisht të destinuara të kenë një zbatim jo të njehsuar (si në lidhje me periudhën përkatëse të operativitetit, ashtu dhe në lidhje me nevojat të veçanta të politikës kriminale që kanë sugjeruar futjen e tyre), do të konsiderohen të ligjshme në kuptimin se ato janë në gjendje të luftojnë *situata e mësipërme të emergjencës*.

Në një Shtet demokratik të drejtës, i takon vetëm ligjvënësit të mbrojtë, ndonëse përballë një diskrecionalitet të gjerë politik që e dallon këtë veprim, parim e barazisë/arsyeshmërisë/proporcionalitetit të diktuar nga Kushtetuta (neni 3). Kjo normë kushtetuese mund të anashkalohet vetëm në rastet kur trajtimi penal i diferencuar, i ndërfutur me normat penale shpërblyese, do të sillte favorizime të tepruara dhe të pajustificuara. Ja pra se si respektimi i parimit në fjalë, që përfaqëson një limit të brendshëm të pakapërcyeshëm të diskrecionalitetit legjislativ, do të ndodhë jo vetëm në lidhje me mbajtjen e përgjithshme të arsyeshme dhe të koherencën e brendshme të sistemit ndëshkues në të cilin janë futur këto masa, por edhe e sidomos në dritën e nevojave politike kriminale që shprehimisht – apo edhe në mënyrë implicite – qëndrojnë në themel të futjes së tyre në legjislacionin juridik penal.

Nga ana tjetër, lipset të pranojmë se, siç u tha më lart, një katalog i gjerë masash dhe teknikash shpërblyese, si kur lidhen më ngushtë me veprën-krim ashtu dhe me sjelljen në gjykim të subjektit që shpreson të përfitojë shpërblimin, është që në këtë moment pjesë, sidoqoftë implicit, në sistemin tonë të dhënies së dënimeve²²⁷.

Tani bëhet fjalë për të verifikuar nëse dhe në cilën masë rastet e veçanta të shpërblimit përjasen me parashikimet penale të kodit të cilat mbështesin idenë e shpërblimit apo nëse ato përbëjnë një *korpus* ligjor më vete në gjendje të plotësojë një trajtim të diferencuar për lloje krimi dhe/ose lloje autori.

Një analizë e tillë na bën të mbërrijmë në një tjetër verifikim interesant. Në fakt, bëhet fjalë për të zbuluar përmes interpretimit të legjislacionit shpërblyes dhe rregullimin dogmatik të tij, nëse bëjnë vend në të mbeturina antihistorike dhe me një kushtetueshmëri të dyshimtë për shumë aspekte të

²²⁷ Lidhur me këtë pikë, shih reflektimet e qarta dhe të arsyeshme të D.PULITANÒ, *op.cit.*, 1041, i cili vëren në përfundim: “sa më pak ta sforcuojmë rëndësinë e shpërblimit, sidoqoftë implicite në strukturën e sistemit të dhënies së dënimeve, si një instrument presioni hetimor, aq më shumë (e me më pak risqe) mund ta rivlerësojmë atë; pra sa më shumë do të repseктоhej logjika e brendshme e llogaritjes së dënimit, si vlerësim dhe përgjigje *ish post* ndaj veprimeve të pavarura të të pandehurit”.

një të drejte penale të autorit, aty ku padyshim “Karta jonë kushtetuese na angazhon për një të drejtë penale të faktit”, ashtu siç na tregon qartë vetë neni 25, parag.2 i Kushtetutës²²⁸.

§ 2. Masa shpërblyese dhe shteti i të drejtës: legjislacioni i “viteve të plumbit”.

Pas kësaj hyrjeje metodologjike, do ta kemi më të lehtë të orientohemi në analizën kritike të instituteve me karakter shpërblyes, që janë futur në vitet e fundit në legjislacionin tonë penal, duke përdorur në interpretimin e të dhënës legjislative dogmatikën juridiko-penale në perspektivën e lartpërmendur. Duke ndjekur këtë rrugë do të bëjmë kujdes për të parë nëse zgjedhjet politike të bëra nga ligjvënësi penal në këtë fushë delikate rezultojnë apo jo në përputhje me parimet dhe garancitë e shtetit të së drejtës, të mishëruara nga normat kushtetuese, lidhur me strukturën dhe përmbajtjet e veprave të krimit dhe të elementëve (themelorë dhe rrethanorë) që përbëjnë kornizën juridike të tyre (sidomos tipikësia, **kundërligjshmëria** dhe fajësia, të parë edhe në perspektivën e funksionit që i jepet dënimit nga ligjvënësi kushtetues).

E thamë më parë se pjesa më e madhe e të drejtës sonë shpërblyese, që është ngritur në një sistem të mirëfilltë për referimin substancial të normave përkatëse ndaj parimeve rregulluese të përbashkëta, përbëhet nga dispozita legjislative që kanë futur shkaqe të reja mosdënueshmërie dhe figura të reja krimi që në rrafshin dogmatik qëndrojnë brenda kategorive tradicionale të përpunuara nga doktrina penaliste²²⁹.

Në veçanti, për sa u takon rrethanave lehtësuese të futura nga normativa shpërblyese, ato nuk ndikojnë aspak mbi profilet e veçantisës së faktit për të cilin, njësoj si çdo rrethanë tjetër, përbëjnë vetëm një aksesori krejt të rastësishëm (*accidentalialia delicti*), i destinuar të luajë një rol të rëndësishëm, në sajë të mekanizmit të veçantë të shpërblyeshmërisë, në përcaktimin konkret të dënimit.

²²⁸ S.MOCCIA, *La perenne emergenza*, cit., 182-183.

²²⁹ Në lidhje me dhënien e shpërblyesimit në rast bashkëpunimi me drejtësisë, D.PULITANÒ, *vep.,cit.*, 1008, vëren se “kategoria e të drejtës penale substancialë, ku gjen vend problemi i sjelljes së të pandehurit gjatë gjykimit, është ai i veprimit pas kryerjes së kiritimit” (shih p.sh.133, 62, nr. 6, 376 k.p.).

Të gjitha dispozitat me karakter shpërblyes objekt i trajtesës sonë, që mjaftohet vetëm me çështjen e krimeve të kriminalitetit të organizuar²³⁰, përfshin kryesisht, një sërë ndërhyrjesh legjislative arketipi i të cilave duhet gjetur në legjislacionin shpërblyes që përmban i ashtuquajturin *dekret Cossiga* (dekretligji n.625, i 15.12.1979, i konvertuar me ndryshime në ligjin n.15, dt. 6 shkurt 1980). Bëhet fjalë për një akt të nxjerrë në periudhën kur “sulmi në zemër të Shtetit”, i kryer me fuqinë e madhe të “partisë së armatosur”, pas sekuestrimit të deputetit Aldo Moro dhe vrasjes së truprojeve të tij (16 mars 1978) dhe më pas, vrasjes së *liderit* demokristian (9 maj 1978), kish mbërritur në shprehjen më të madhe të egërsisë mizore dhe të përqeshjes së ligjit për mosdënim²³¹.

Ndonëse normativa shpërblyese antiterrorizëm shkon larg objektit të trajtesës sonë, nuk mund të mos vërejmë se ajo ka sjellë për herë të parë teknikën ligjore, me një tipar të fortë praktik, që shkon në një kah krejt të kundërt me theksimin e pastër të veprimtarisë ndëshkuese ndaj fenomenit të terrorizmit, sipas linjës strategjike të ligjit nr.152, të dt. 22 mars 1975. Një shtysë ndëshkuese më të rreptë e ndoshta më simbolike, realizohet përmes parashikimit të figura të reja të krimit (neni 289-bis k.p. “*Sekuestrimi i personit me qëllim terrorizmin apo subversionin*”²³² nenet 270-bis k.p., “*Organizata me qëllime terroriste apo përmbysjeje të rendit demokratik*”²³³), dhe 280 k.p., “*Atentat për qëllime terroriste apo*

²³⁰ Duhet thënë ndër të tjera se teknika e *shpërblyeshmërisë*, që synon të favorizojë bashkëpunimin procedural pra gjatë gjykimit nga ana e të pandehurit, është përfutur sëfundi nga ligjvënësi për të luftuar me më shumë efikasitet edhe fenomene të mikro-kriminalitetit, si vjedhja, në rrethana të thjeshta apo të rënduara. Neni 3 i ligjit të dt.26 mars 2001, nr.128 (e ashtuquajtura “paketë e sigurisë”) ka ndërftuar në kodin penal nenin 625-bis që parashikon rrethana të reja lehtësuese, me efekt të posaçëm (për rrjedhojë me mundësinë për të ulur dënimin nga një e treta në gjysmë), “në rastet e parashikuara nga nenet 624, 624-bis, dhe 625”, “nëse fajtori, përpara gjykimit, ka mundësuar zbulimin e bashkëfajtorëve apo të atyre që kanë blerë, marrë apo fshetur sendin e vjedhur apo që kanë ndërhyrë sidoqoftë që ai të blihet, merret apo fshihet”. Për një analizë më të gjerë të kësaj rrethane lehtësuese, shih A.GARGANI, *Le modifichie al codice penale introdotte dal c.d. “pacchetto sicurezza”*, në *Studium iuris*, 2002, 12.13.

²³¹ Për një analizë efikase historiko-juridike të përgjigjes institucionale ndaj terrorizmit “të kuq” dhe “të zi”, në “vitet e plumbit”, shih edhe për referime të tjera bibliografike, M.LAUDI, *Terrorismo (dir.interno)*, në *Enc.dir.*, Milano, 1992, XLIV, 355 e vijuese.

²³² Ndërfutur nga neni 2 i dekretligjit n.59, të dt. 21 mars 1978, kthyer me ndryshime në ligjin nr.191, të dt. 18 maj 1978.

²³³ Kjo dispozitë, e ndërftuar nga neni 2 i ligjit nr.625, dt. 15.12.1979, është amenduar më vonë, në rubrikë (tani “*Associazioni con finalità di terrorismo anche internazionale o di eversione dell’ordine democratico*”) dhe në tekst, nga neni 1 i dekretligjit n.374, të dt. 18 tetor 2001, kthyer me ndryshime në ligjin nr.438, dt. 16.12.2001.

subversioni”²³⁴), u shoqërua këtë herë me futjen novatore të dy masave të veçanta shpërblyese, që qëndrojnë përkatësisht në parashikimin:

a) e një *shkak* të veçantë mosdënueshmërie, që u referohet vetëm krimeve të kryer për qëllime terrorizmi²³⁵, për të gjithë ata që – jashtë rasteve siç në paragrafin e fundit të nenit 56 të k.p. (pengesë e qëllimshme e ngjarjes, në tentativë për krim) – do kishin penguar ngjarjen dhe do kishin dhënë elementë prove përcaktues për riundërtimin e saktë të faktit dhe gjetjen e bashkëpunëtorëve të mundshëm;

b) e një *rrethanë lehtësuese të veçantë*, edhe ajo u referohet vetëm krimeve të kryera me të njëjtat qëllime, në favor të bashkëpunëtorit që “duke mos qenë dakord me të tjerët, përpiqet të shmangë faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasoja të tjera, apo ndihmon konkretisht autoritetin e policisë dhe autoritetin gjyqësor në mbledhjen e provave vendimtare për zbulimin apo kapjen e bashkëpunëtorëve”²³⁶.

Ndër dy dispozitat shpërblyese, sipas një gjykimi të njëzëshëm të operatorëve të të drejtës, e dyta ka rezultuar të ketë një efikasitet të jashtëzakonshëm kundër krimit të organizuar të llojit terrorist dhe subversiv, meqë, duke ndihmuar fenomenin e “shkëputjes” dhe të të ashtuquajturit “pendim”, u ka hapur udhën rezultateve investiguese të papërfytyrueshme, duke u dhënë mundësi hetuesve të rrëzojnë murin e heshtjes që karakterizonte veprimtarinë e grupeve terroriste dhe subversive. Në këtë mënyrë u bë i mundur infiltrimi brenda strukturës terroriste përmes një njohjeje të thellë, të fituar në sajë të ndihmës së bashkëpunimit të “të penduarve”, të strukturave të organizatës, të përbërjes së tyre, të metodave dhe strategjive të luftës që karakterizojnë veprimtarinë e tyre.

Deri atëherë doktrina²³⁷ nuk kish lënë pa vërejtur, duke iu referuar në mënyrë specifike *rrethanës lehtësuese shpërblyese* të lartpërmendur, karakterin e pastër novator të parashikimit ligjor që krijonte lidhje me “efektin lehtësues në rastin titpik të bashkëpunimit në gjykim (“...ndihmon [...] në përmbledhjen e provave vendimtare për zbulimin apo kapjen e konkurrentëve”). Në të vërtetë bëhet fjalë për një model të ri të shpërblyeshmërisë që do të përdoret gjerësisht nga ligjvënësi edhe në kuadrin e strategjive të luftës kundër fenomeneve të krimit (të organizuara

²³⁴ Shih nenin 3 të dekretligjit nr.625, të vitit 1979, cituar.

²³⁵ Shih neni 5, i dekretligjit n.625, i vitit 1979, siç përmendur.

²³⁶ Shih neni 4 i dekretligjit n.625, i vitit 1979, siç përmendur.

²³⁷ M.LAUDI, *vep.cit.*, 362.

dhe jo²³⁸), jo vetëm të llojit terrorist, kundrejt të cilëve instrumentet e zakonshëm të të drejtës penale substanciale dhe procedurale kishin (dhe kanë) rezultuar krejt të pavlefshëm. Risia që karakterizon normativën shpërblyese për krimet e terrorizmit dhe subversionit të rendit kushtetues qëndronte në faktin që duke u shkëputur nga modelet tradicionale të kodit (shih për shembull nenet 56, parag.i fundit, 62, nr.6, 630, parag.i katërt, i k.p.) që mbështeten në reintegrimin e të mirës juridike të cenuar dhe në ndreqjen e dëmit), i kushtoi një rëndësi të madhe shpërblyese (duke parashikuar mundësinë për të zëvendësuar për të pandehurin “që e meritonte” dënimin me burgim të përjetshëm me burgimin nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet, si dhe për të gjitha krimet e dënuar me burgim, me ulje të dënimit nga një e treta me gjysmën) me *distancimin* nga bashkëfajtorët. Ky kush paraprak duhet të shoqërohej nga ana e fajtorit me një sjellje të përshtatshme e tillë që do të shmangte faktin që veprimtaria kriminale të kishte pasoja të mëtejshme, apo që të sillte një *ndihmë konkrete* ndaj autoritetit gjyqësor dhe të policisë në përmbledhjen e *provave vendimtare* për zbulimin dhe kapjen e bashkepunetoreve

Legjislacioni i mëvonshëm antiterrorizëm, nga ligji n.304 i dt.29 maj 1982, deri në ligjin n.34 të 18 shkurtit 1987, mori përsipër të përgatisë modelin e mësipërm shpërblyes, që rezultoi të ishte një instrument i mirë në luftën kundër krimin të organizuar terrorist dhe subversiv. Kështu, krahas teknikave të parashikimit shpërblyes, apo ndryshe tradicionale (të llojit rehabilitues /ndreqës/eliminues/lehtësues, në lidhje me “pasoja të dëmshme apo të rrezikshme të krimin”, morën formë në një gamë të gjerë rrethanash, situatash që rezultonin nga përvoja procedurale e asaj kohe: pa e prekur *distancimin* (kusht i domosdoshëm për dhënien e çdo përfitimi shpërblyes që, në kushte të rrethana të caktuara, mund të integronte deri dhe një shkak për padënueshmëri²³⁹), e për qëllime të dhënies së rrethanave lehtësuese

²³⁸ Shih për shembull, dispozitën shpërblyese siç në nenin 625-bis të k.p., si më lart përmendur.

²³⁹ Në fakt, në bazë të nenit 1 të ligjit n.304, dt. 28 maj 1982, nuk ishin të dënueshëm “ata që, pasi kanë kryer për qëllime terroriste apo subversioni të rendit kushtetues, një apo më shumë ndër krimet e parashikuar nga nenet 270, 270 bis, 304, 305, 306 të kodit penale dhe, përveç sa parashikuar nga parag.i tretë i këtij neni dhe nga parag.i dytë i nenit 5, duke mos bashkëpunuar në kryerjen e asnjë krimi në lidhje me marrëveshjen, me organizatën apo me bandën, përpara vendimit përfundimtar të dënimit për këto krime:

- a) shpërndajnë apo sidoqoftë përcaktojnë zgjidhjen e organizatës apo të bandës;
- b) heqin dorë nga marrëveshja, tërhiqen nga organizata apo nga banda apo dorëzohen pa bërë qëndresë apo duke braktisur armët dhe japin në çdo rast çdo informacion mbi strukturën dhe organizimin e organizatës apo të bandës.

shpërblyese iu dha rëndësi faktit që i pandehuri, përpara vendimit përfundimtar të dënimit:

1. duhet të ketë “rrefyer plotësisht të gjitha krimet e kryera” (neni 2 i ligjit n.304, i vitit 1982, cituar);
apo që, përveç kësaj,
2. ka ndihmuar “autoritetin në mbledhjen e provave vendimtare për gjetjen apo kapjen e një apo më shumë autorëve të krimeve terroriste”, apo edhe,
3. do ketë dhënë “sidoqoftë elementë të provës të rëndësishëm për rindërtimin e saktë të faktit dhe zbulimin e autorëve” (neni 31, citimi i fundit).

Përfitime të tjera shpërblyese, në ndryshim nga rregullimi i përgjithshëm i kodit penal u futën me ligjin n.304, të vitit 1982, në favor të subjekteve që do kishin qëndrime distancimi (*ex neni 2*)²⁴⁰ apo bashkëpunimi (*ex neni 3*),

Nuk janë njësoj të dënueshëm ata që pengojnë sidoqoftë që të përmbillet kryerja e krimeve për të cilët organizata apo banda janë krijuar.

Nuk janë gjithashtu të dënueshëm:

- a) nëse ekzistojnë kushtet e parashikuara në parag.I, ata që kanë kryer krime në lidhje me armë, municione apo lëndë shpërthyesë, me përjashtim të rasteve të importimit, eksportimit, grabitjes dhe dhunës, krimet e parashikuar në kreun II, III dhe IV të titullit VII të librit II të kodit penal, krimet siç në nenet 303, 414 të kodit penal, si dhe krimi siç në nenin 648 të kodit penal që ka për objekt armë, municione, lëndë shpërthyesë, dokumente;
- b) ata që kanë kryer një prej krimeve të parashikuar në nenet 307, 378 e 379 të kodit penal kundrejt personit të pandehur për një prej krimeve të treguar në parag.e parë, nëse japin informacion të plotë mbi favorizimin e kryer.

Padënueshmeria deklarohet me vendim të gjyqtarit në debat gjyqësor, pas një verifikimi të qartësisë dhe aktualitetit të veprimit të parashikuar në paragrafin e parë e të dytë.

Kundrejt atij që, pasi ka kryer një prej krimeve të parashikuar në paragrafin e parë dhe të tretë, përpara se të ish nxjerrë në ngarkim të tij një urdhër apo mandat kapjeje apo përpara se të ketë nisur një çështje gjyqësore, do të paraqitej spontanisht para autoritetit të policisë apo autoritetit gjyqësor dhe do të kishte një prej sjelljeve të parashikuara nga paragrafi i parë dhe i dytë, urdhri apo mandati i kapjes nuk duhet të nxirret, por mund të vendosen detyrime apo ndalime të parashikuar nga ligji dhe që konsiderohen të nevojshëm për të siguruar kontrollin e veprimit, disponibilitetin ndaj kërkesave të autoritetit gjyqësor dhe pranisë në debat. Nëse është shkelur qoftë edhe një prej detyrimeve apo ndalimeve, prokurori apo gjyqtari nxjerr urdhrin apo mandatin e kapjes.

Nuk gjejnë zbatim nenet 308 e 309 të kodit penal”.

²⁴⁰ Termit *distancim*, në përdorimin e zakonshëm, iu dha një kuptim i ndërmjetëm mes pozicionit të ashtuquajturve *terroristë të penduar* dhe atyre të ashtuquajtur *të padorëzueshëm*, në kuptimin që ai përcaktonte “zgjedhjen e bërë nga ata persona që, të pandehur apo të dënuar për krime të terrorizmit, kishin shfaqur distancimin e tyre nga lufta

si në lidhje me regjimin e “ekzistencës së disa dënimeve” (në ndryshim nga neni 80 i kodit penal: shih nenin 4), si në lidhje me “tentativë për atentat dhe tentativë për krim” (me parashikimin e shkaqeve të posaçme të padënueshmërisë: shih nenin 5), si në lidhje me regjimin e zakonshëm të pezullimit me **kusht** të dënimit (me shtim të limiteve të dhëna: shih nenin 7).

Por efektet e shpërblyeshmërisë shtriheshin edhe në planin procedural përmes një zgjerimi të mundësisë për të dhënë “lirinë e përkohshme” (në rastet e veprimeve të bashkëpunimit “me rëndësi të jashtëzakonshme”, të tilla që do mundësonin dhënien e rrethanës lehtësuese të posaçme siç në nenin 3 të ligjit n.304 të përmendur: shih neni 6) dhe, në fazën e ekzekutive, përmes një zbatimi më të gjerë të institutit të “lirisë me kusht” (në ndryshim nga dispozitat e nenit 176 të k.p.: shih nenin 8), kundrejt të dënuarit “të distancuar” apo “bashkëpunëtor” që do të kish shprehur shenja të qarta pendimi.

Ai që mbyll në lidhje me shpërblyeshmërinë periudhën e viteve të *plumbit*, është ligji n.34, i dt.18 shkurt 1987, për “veprimet e distancimit”; ky ligj solli mundësinë “e ndryshimit dhe uljes së dënimit” (neni 2), edhe “në rastin e dënimit përfundimtar” (neni 3), me pasqyrime të mëtejshme shpërblyese, në rrafshin procedural dhe ekzekutiv, në lidhje me “lirinë e përkohshme” (neni 6) dhe “bashkimin” e dënimeve (në ndryshim nga rregullimi i diktuar nga neni 80, i k.p.: shih neni 7).

Megjithatë, ligjvënësi i viteve '82 e '87 ish mjaft i vetëdijshëm për karakterin *përrjashimor* të rregullimit shpërblyes, ndërkohë që aspekti i jashtëzakonshëm i tij kundrejt instituteve të të drejtës penale dhe procedurale dhe, mbi të gjitha, kundrejt normave të zakonshme të llogaritjes së dënimit duket mjaft qartë në zbatimin praktik, aq sa në një pjesë të mirë të opinionit publik, përballë dënimeve të ulëta që u jepen terroristëve të *penduar* apo të *distancuar* që kanë kryer krime shumë të rënda, mori udhë bindja e *padrejtësisë* substanciale të masave shpërblyese të futura nga

e armatosur, duke mos e shoqëruar – ndër të tjera – me qëndrime bashkëpunimi me magjistraturën dhe organet e policisë” (kështu M.LAUDI, *vep.cit.*, 336). Një përkufizim i qartë ligjor i “veprimeve të distancimit” ish futur nga neni 1, i ligjit n.34 të dt. 18 shkurt 1987, sipas të cilit “për efekte të këtij ligji konsiderohet sjellje apo veprim distancimi nga terrorizmi sjellja e atij që i pandehur apo i dënuar për krime që kanë qëllime terrorizmi apo subversioni të rendit kushtetues, ka braktisur përfundimisht organizatën apo lëvizjen terroriste apo subversive të cilës i përkiste, duke pasur njëherësh këto veprime: pranon veprimtarinë e kryera konkretisht, sjellje që nuk pajtohen objektivisht dhe qartë me vazhdimësinë e lidhjes me organizatën, mohim të dhunës si metodë e luftës politike”.

ligjvënësi në vitet e plumbit²⁴¹. Nga ana tjetër, *përjashtimësia e legjislacionit* – që “kish sjellë padyshim detyrime ndaj modeleve të zakonshëm të ndërhyrjes”²⁴² – balancohej në njëfarë mënyre nga *karakteri i tij i përkohshmërisë* (shih nenin 12, ligji nr.304 të vitit 1982 dhe nenin 8 ligji nr.4 i vitit 1987) dhe i vetë *revokueshmërisë apo humbjes së përfitimeve*, ndonëse të dhënë me të drejtë, në rastin e deklaratave të rreme të bashkëpunimit (shih nenin 9 ligji n.304, i vitit 1992, për “revokimin e lirit me kusht” apo të njohjes së shkaqeve të veçanta apo të dhënies së rrethanave lehtësuese shpërblyese si më sipër treguar, “për shkak të deklaratave të rreme apo jo të plota” (shih nenin 10, ligji n.2304, i vitit 1992).

§ 3. *Legjislacioni “promovues” në fushën penale, normativa shpërblyese dhe detyrimet kushtetuese.*

Në këtë kuadër ligjor, i cili karakterizohet nga një klimë e veçantë kulturore, u “ndryshoi” ndjeshëm ideja e një “roli promovues të të drejtës”²⁴³, që, për realizimin e “rolit shoqëror të të drejtës”, e braktis përdorimin e sanksionit negativ që synon të pengojë akte të padëshirueshme nga pikëpamja shoqërore dhe privilegjon teknikën e “sanksionit pozitiv” që kërkon nga ana e vet “të promovojë kryerjen e akteve të dëshirueshme nga pikëpamja shoqërore”²⁴⁴. Edhe në këtë perspektivë që rivlerëson rolin, si të thuash, promovues të normativës shpërblyese, në kuptimin që përmes veprimeve stimuluese ajo kërkon të promovojë një qëndrim të veçantë të personave që do kishin këtë shpërblim, kontrollin e ligjshmërisë së normave promovuese/shpërblyese jo vetëm që s’mund të lihet pas dore, por përkundrazi, bëhet një nga momentet kyç të analizës ligjore, pasi mundëson një kontroll të dyfishtë, themelor: nga njëra anë, hetimi mbi vetë *ratio-n* kushtetuese të normës *promovuese*, përmes kontrollit në lidhje me ekzistencën e një të mire/interesi me rëndësi kushtetuese për mbrojtjen e të cilës kujdeset dispozita shpërblyese²⁴⁵; nga ana tjetër, verifikimi i aspekteve

²⁴¹ Shih lidhur me këtë pikë, M.LAUDI, *vep.cit.fq.365*.

²⁴² *Aut. dhe vep.cit.sipër*, 369.

²⁴³ N.BOBBIO, *Dalla struttura alla funzione. Nuovi studi di teoria del diritto*, Milano, 1977. ID., *La funzione promozionale del diritto rivisitata*, në *Sociologia Dir.*, 1984. Për një analizë të thellë të ligjeve proporcionale në jurisprudencën kushtetuese, shih F.RIGANO, *Le leggi promozionali nella giurisprudenza costituzionale*, në *Giur.It.*, 1999, 2223 e vijuese.

²⁴⁴ Krs. F.RIGANO, *vep.cit.* 2223, i cili (shih shënimin 3) citon mendimin e N.BOBBIO, *Dalla struttura*, cit.7.

²⁴⁵ Lidhur me këtë, doktrina flet për kontroll të “shkakut të ligjit shpërblyes”: krs. F. RIGANO, *op.,cit.* 226.

të mëtejshme të kontrollit të ligjshmërisë kushtetuese në dritën e parimeve të ligjshmërisë, arsyeshmërisë, barazisë, rolit riedukues të dënimit, kundrejt pavarësisë dhe dinjitetit të njeriut.

Në të vërtetë, analiza e jurisprudencës kushtetuese në këtë fushë, për shkak të varfërisë së burimeve të jurisprudencës, nuk na jep mundësi të bëjmë një verifikim të plotë.

Megjithatë, në bazë të rëndësisë së pakundërshtueshme që shfaq legjislacioni shpërblyes, në përgjithësinë e rasteve të shqyrtuara nga doktrina dhe nga jurisprudenca, një aspekt që sjell ndryshim ndaj rregullimit të përgjithshëm të të drejtës së përbashkët, kontrolli i ligjshmërisë kushtetuese ka të bëjë në radhë të parë me përdorimin e mirë të vetëgjykimit politik që i lihet ligjvënësit (dhe, nga ana tjetër, të qenit jo arbitrar, në aspektin e arsyeshmërisë, të zgjedhjeve legjislative në normativën shpërblyese) dhe, në radhë të dytë, aspektin e mundësisë për të pasur akses të njëjtë, në rrethana të ngjashme, ndaj përfitimit shpërblyes. Bëjnë pjesë në kuadrin e parë vendimet e Gjykatës kushtetuese që kanë pohuar ndër të tjera që “nevoja për të luftuar krimin e organizuar, agresiv dhe të përhapur, justifikon gjerësisht në rrafshin e zgjedhjeve diskrecionale të ligjvënësit penal, sidomos në lidhje me trajtimin që u duhet rezervuar të ashtuquajturve *bashkëpunëtorë të drejtësisë*, epërsinë që u jepet funksioneve të dënimit që mund të nxirren nga neni 27 i Kushtetutës, “qëllimeve të parandalimit të përgjithshëm dhe të sigurisë së shoqërisë, duke u dhënë përfitime të caktuara të burgosurve që bashkëpunojnë me drejtësinë”²⁴⁶. Në të dytin, vendimet e marra në lidhje me rritjen e mundësisë për t’u dhënë përfitime të qëndrimit në burg bashkëpunëtorëve të drejtësisë: në mungesë të lidhjeve të vërtetuara të përfituesit me krimin e organizuar, këto përfitime duhet të jepen edhe në rast bashkëpunimi të lehtësuar apo, madje, të parëndësishëm nga pikëpamja objektive (për sa u takon rezultateve të hetimeve dhe/ose gjyqësore të arritura)²⁴⁷.

²⁴⁶ Shih Gjykata kusht., vendimi n.306, i dt. 8 korrik 1993, në *Giur.Cost.*, 1993, 2467 e vijuese. Po në këtë drejtim është e orientuar jurisprudenca e Këshillit (shih vendimin n.188, të dt. 12 prill 1990, në *Giur.It.*, 1990, I, 1, 1668 e vijuese; dhuh edhe vendimin n.235 të 4 korrikut 1996 në *Giur.Cost.*, 1996, 2128 e vijuese; vendimin e dt.30 korrik 1997, *këtu*, 1997, 2685) lidhur me ligjshmërinë e konsideruar kushtetuese të normave që parashikojnë dhënien e lejeve shpërblyese për të burgosurit, që justifikohet nga mundësia për të favorizuar rehabilitimin në shoqëri të përfituesit (në respektim të nenit 27 të Kusht.), nga njëra anë, dhe për të rivlerësuar nga tjetra, përmes shfrytëzimit të përfitimit, “funksionin pedagogjik shtytës” të sjelljes së rregullt në burg.

²⁴⁷ Shih Gjykata kusht., vendimi i dt. 8 korrik 1993, cit.më sipër.

Është me interes të vërejmë se doktrina²⁴⁸, në mungesë të referimeve më të gjera jurisprudenciale lidhur me kontrollin e ligjshmërisë kushtetuese të të ashtuquajturave *norma promovuese* (shpërblyese) në fushën penale, ka marrë shkas nga analiza e disa dispozitave të kësaj natyre, në lidhje me tatimet²⁴⁹, për të përpunuar norma të tjera interpretuese për sa i takon gjykimit të respektimit të parimit të barazisë (neni 3 Kusht.) që mund të gjejnë fare mirë zbatim edhe në fushën e të drejtës penale shpërblyese.

Para së gjithash, “edhe në fushën e normativës promovuese, barazia e trajtimit nuk kërcënohet nga “pabarazi të pastra e të pashmangshme të faktit”, si për shembull nga rëndësia e ndryshme që kanë në territor personat që do të marrin përfitimet²⁵⁰; ashtu siç është e kritikueshme diferenca në trajtimin që sjellin ligjet e mëvonshme²⁵¹.

Ashtu si çdokush e sheh, bëhet fjalë për kritere që kanë të bëjnë me një aspekt të gjykimit kushtetues të barazisë/arsyeshmërisë (neni 3 i Kusht.) që mund të shtrihet fare mirë në normativën shpërblyese mbi bashkëpunëtorët e drejtësisë, si në lidhje me kriminalitetin terrorist dhe subversiv (në aspektin e përkohshmërisë së rregullimit përkatës), ashtu dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë *tout court* (veçanërisht në lidhje me prejardhjen e tyre mjaft të njohur dhe kryesuese të të ashtuquajturave *zona në rrezik*, si Kampania, Kalabria, Sicilia dhe Pulje.

I shtohen kësaj aspektet e tjera të kontrollit të *ex neni 3 i Kusht.*, veçanërisht në lidhje me normat e barazisë/proporcionalitetit që sjell norma kushtetuese. Norma shpërblyese në fakt, duke supozuar proporcionalitetin e shpërblimit të premtuar në këmbim të qëndrimit që pritet të ketë, duhet të garantojë në çdo rast lirinë e zgjedhjes së përfituesit të mundshëm. Në mungesë të këtij kushti, shpërblimi i premtuar nga ligji duhet të konsiderohet në aspektin racional si diçka që nuk gëzon kriterin e

²⁴⁸ F.RIGANO, *vep.cit.*, 2229.

²⁴⁹ Bëhej fjalë për kontrollin e ligjshmërisë nga gjykata kushtetuese, në perspektivën e përdorimit të ligjshëm të vetëgjykimit a diskrecionalitetit legjislativ, mbi normat që përcaktojnë përjashtimin e deduktueshmërisë së financimeve liberale për qëllime të kërkimit shkencor, dhe të arsimit universitar, nga të ardhura të ndryshme nga ato të shoqërisë. Ky përjashtim, që mbështetet në prezumimin e interesit më të madh të sipërmarrësve ndaj veprimtarive shkencore dhe kulturore, ish konsideruar “i arsyeshëm” nga Gjykata kushtetuese (shih vendimin n.108, të dt. 28 prill 1983, në *Giur.It.*, 1983, I, 1, 1760 e vijuese).

²⁵⁰ Krs. Gjykata Kusht., vendimi n.195, i dt.27 maj 1993, në *Giur.It.*, 1994, I, 97 e vijuese.

²⁵¹ Krs. për shembull, Gjykata Kusht. Urdhri n.303, i dt. 30 korrik 1997, në *Giur.Cost.*, 1997, 2706 e vijuese, në lidhje me rregullimin e pozicioneve të kontributit, cit.nga F.RIGANO, *vep.cit.*, 2229, shënimi 90.

nevojshëm kushtetues të “proporcionalitetit”. Kjo gjë nuk mund të mos konsiderohet shpërblimi që, për *faktin që është jashtëzakonisht i pëlqyeshëm*, nuk mund të mos refuzohet pa mohuar thelbin e brendshëm racional të natyrës njerëzore. Nëse ligji do të siguronte, për shembull, imunitetin e plotë të të pandehurit që bashkëpunon me drejtësinë, “do ishim përballë një alternative pak a shumë të detyruar, për të bërë një “jo zgjedhje”²⁵².

Po kështu, kontrolli i kushtetueshmërisë mund dhe duhet të ketë të bëjë edhe me sakrifikimin e mundshëm të pasurive a të mirave/interesave me rëndësi kushtetuese që mund të orientojnë zgjedhjen drejt formës së shpërblimit. Le të mendojmë për shembull, të drejtën e mbrojtjes që në njëfarë mënyre mund të rrezikojë nga zgjedhja për të bashkëpunuar me drejtësinë për të shfrytëzuar përfitimet shpërblyese. E pra në këtë rast, bëhet fjalë për të bërë balancimin e duhur të interesave në fjalë, me rëndësi kushtetuese. Në këtë rast, vënia në rrezik e të drejtës së mbrojtjes nuk mund të jetë e plotë, në kuptimin që, me përjashtim të të drejtës së heshtjes i pandehuri që do ish në një kundërshti të pastër logjike me vetë nocionin e bashkëpunimit me drejtësinë, duhet të sigurohet sidoqoftë shfrytëzueshmëria nga ana e bashkëpunëtorit, e garancive të tjera procedurale që kërkojnë të ofrojnë mbrojtje për pashkelshmërinë e mbrojtjes “në çdo fazë e shkallë të çështjes” (neni 24 i Kusht.).

Duke analizuar problemet e kontrollit të kushtetueshmërisë së dispozitave penale, doktrina ka prekur së fundi problemin e limiteve kohore të normës shpërblyese. Për këtë, është vërejtur se²⁵³ në bazë të natyrës ndryshuese të shpërblimit kundrejt rregullimit sanksionues të përgjithshëm, ndryshimi mund të gjejë justifikim në rrafshin kushtetues (në aspektin e rregullës së barazisë/arsyeshmërisë/proporcionalitetit *ex neni 3 i Kusht.*) vetëm në rastet

²⁵² *Aut.op.cit. dhe lok.fundit cit.*, ku vërehet se “për këtë aspekt Gjykata kushtetuese nuk ka mundur kurrë të merret apo, më mirë, e ka trajtuar rrallë apo në mënër rastësore. Vetëm në ndonjë rast Gjykata arrin të kontrollojë proporcionalitetin e shpërblimit kur gjykon mbi ligjshmërinë e kufizimit të atributit të saj, siç ka ndidhur për shembull me vendimin n.133, të dt. 30 korrik 1980 [në *Giur.It.*, 1981, I, 1, 682 e vijues] që mohon paligjshmërinë e përjashtimit të pezullimit të kondicionelit të dënimit në rastin e recidivës së shumëfishmë; apo kur pohon se përfitimi i faljes së shpenzimeve gjyqësore nuk mund të kushtëzohet nga sjellja pas burgimit, sepse kështu “stimulimi mund të rezultojë në njëfarë mënyre i lehtësuar” [shih vendimin n.271, të dt.17 korrik 1998, në *Gazz.Uff.*, n.29, I, Serie speciale, 1998]; ashtu si kur [...] Gjykata i nënshtonin gjykimit të vet ligjshmërinë e shpenzimeve të cilave u nënshtrohet dhënia e përfitimit, duket se jurisprudenca kompenson këtu mungesën e kontrollit mbi proporcionalitetin e shpërblimit me kontrollin mbi respektimin e pavarësisë së vendimit të të interesuarit”.

²⁵³ *Aut.e vep.cit.,fundit*, 2230.

kur norma shpërblyese është kalimtare dhe e përkohshme. “Sidomos në jurisprudencën mbi legjislacionin që ka të bëjë me përfitimet për bashkëpunëtorët e drejtësisë del bindja se ndryshimi i zbatimit rigoroz të sanksioneve penale garantohej në njëfarë mënyre nga urgjenca për të mbrojtur sigurinë publike, në një moment veçanërisht kritik”²⁵⁴. Kjo do të thotë që gjykimi i kushtetueshmërisë së normës shpërblyese është domosdoshmërisht i shprehur *rebus sic stantibus*, në kuptimin që është i lindur në të një tipar përkohshmërie, detyrimisht i lidhur me vlerësimin e rrezikut të cenimit të të mirave/interesave me rëndësi kushtetuese, që shfaqet në rrethanën e veçantë historiko-politike në të cilën norma shpërblyese, duke rënë ndesh plotësisht apo pjesërisht me të mirat/interesat e mësipërm, është e destinuar të veprojë²⁵⁵.

²⁵⁴ *Aut, e vep.cit.fundit*, 2230.

²⁵⁵ Krs. *Aut.vep.e lol.fundit*, aty ku, sidoqoftë flitet për vështirësinë për t’i lënë kontrollit a gjykimit të Gjyqtarit kushtetues pezullimin e rolit promovues të ligjit shpërblyes. RIGANO, në përfundim të analizës së tij, në bazë të të dhënave që përmban jurisprudenca kushtetuese në këtë fushë, përpunon një lloj *identikiti* kushtetues të normës promovuese/shpërblyese: 1, ajo, në radhë të parë duhet të shohë drejt së ardhmes, në kuptimin që “duhet të ketë të bëjë me rrethana që vijnë pas ardhjes në fuqi të normës”; 2. në radhë të dytë, në lidhje me natyrën e saj ndryshuese të rregullimeve të përgjithshme, ligji shpërblyes “duhet të qëndrojë në realizimin e një të mire kushtetuese”; 3. në radhë të tretë, modalitetet e dhënies së përfitimit shpërblyes “duhet të respektojnë të drejtën e personit që i jepen për të hequr dorë, pa pësuar asnjë dënim”; 4. në radhë të katërt, në respektim të lirisë së zgjedhjes së përfituesit të mundshëm, shpërblimi i premtuar duhet të jetë në përpjestim me sakrificën që i kërkohet atij; 5. së fundi, norma promovuese/shpërblyese duhet të jetë kryesisht e përkohshme, “e tillë që duhet të kushtëzojë [...] të qenit në fuqi të saj me ekzistencën e efekteve stimuluese”. Për analizën e aspekteve të tjera të pakushtetueshmërisë së normativë shpërblyese antiterrorizëm shih P.P.RIVELLO, *Un significativo intervento della Corte Costituzionale in tema di raccordi fra la normativa sui “pentiti” e quella dei dissociati*”, në *Legislazione penale*, 1990, 733 e vijues, veçanërisht në lidhje me çështjen e kushtetueshmërisë së neneve 7 e 8 parag. 2 ligji n.34, i dt. 18 shkurt 1987, ngritur në lidhje me nenin 3 të Kusht. Sipas Gjyqtarit që heq dorë (Ass.App.Roma, 29 dhjetor 1988, në *Legislazione penale*, 1989, 214, nr.137), nga zbatimi i normave të denoncuara për paligjshmëri kushtetuese sillnin një pabarazi në trajtimin e masës së dënimit mes “atyre që ishin distancuar vetëm së fundi, kundrejt atyre që, në mënyrë konkrete dhe jo me deklarata të hapura, kishin shfaqur që në krye pendimin e tyre. Gjykata kushtetuese, teksa është dakord me këto vërejtje, deklaroi paligjshmërinë kushtetuese, sipas sa më sipër, të dispozitave të neneve 7 e 8, parag.2, ligji n.34, i dt. 18 shkurt 1987. Në veçanti, sipas Gjykatës, mosreferimi “në kuadrin e bashkimit të posaçëm të masës së dënimit siç në nenin 7, ligji n.34/87, të vendimeve të dënimit në rrethana lehtësuese në bazë të neneve 2 dhe 31, 304/82, që eventualisht gjenden në dy apo më shumë vendime dënimi në rrethana lehtësuese në bazë të neneve 2 e 31, 34/87, gjen zgjidhje në një trajtim më të rëndë pikërisht për situata që zakonisht konsiderohen nga vetë ligjvënësi si situata që meritojnë të vlerësohen nga pikëpamja e interesave të shoqërisë, siç janë pikërisht situatat që kanë të bëjnë me dhënien e uljes së dënimit parashikuar nga nenet 2 e 31, 304/82”).

§ 4. Dispozitat e tjera “shpërblyese” në lidhje me krimet e kriminalitetit të organizuar: a) nenet 73, parag.7, dhe 74 parag.7, D.P.R. 9 tetor 1990, nr.309.

Thamë se dispozitat e tjera me karakter shpërblyes të ndërfutura në legjislacionin tonë penal pas legjislacionit të parë organik shpërblyes të viteve '80, në një masë pak a shumë të theksuar u mbështetën në këtë arketip ligjor dhe në njëfarë mënyre, u ndikuan të gjitha nga debati kulturor që lidhet me problematikën e gjerë kushtetuese dhe penale për të cilën folëm pak më lart.

Për këtë arsye, në kuadrin e kësaj kornize juridike duhet të analizojmë dispozitat penale që, në lidhje specifike ndaj krimeve të kriminalitetit të organizuar, e kanë zgjeruar dalëngadalë hapësirën e shpërblyeshmërisë. Ky zgjerim ka ndodhur me më shumë vetëdije dogmatike dhe me ndihmën e përvojës së madhe të fituar sidomos në terrenin e luftës kundër krimit të organizuar transnacional, që me kalimin e viteve është kthyer në një nevojë të re të krimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Siç dihet, përpara ardhjes në fuqi të tekstit të ri unik në lidhje me krimet që kanë të bëjnë me lëndët narkotike dhe psikotrope, qëndrimi i mbajtur nga *reo post crimen patratum* kish rëndësi juridike vetëm në bazë dhe për efekt të paragrafit të dytë të nenit 133 të k.p., apo të nenit 61 nr.6 të k.p..

Pas ardhjes në fuqi të neneve 73, parag.7, e 74, të D.P.R. më datë 9 tetor 1990, nr.309 janë futur në legjislacionin tonë dy rrethana specifike lehtësuese, me efekt të posaçëm (me karakter promovues/shpërblyes), në lidhje me çdonjërin nga normat përkatëse inkriminuese, me parashikimin e qartë të uljes “nga gjysma në dy të tretat” së dënimit të dhënë në favor të:

- a) *“përpiqet të shmangë faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasoja të mëtejshme, edhe duke ndihmuar autoritetin e policisë apo autoritetin gjyqësor në marrjen e burimeve të rëndësishme për kryerjen e krimeve”*; apo të
- b) *“përpiqet me efikasitet që të sigurojë provat e krimit apo për t'i marrë organizatës burime të rëndësishme për kryerjen e krimeve”*.

Ndër dy normat shpërblyese si më sipër renditur, vetëm e dyta ka të bëjë me një rast konkret që lidhet me krime të kriminalitetit të organizuar (“bashkëpunim në krim që ka për qëllim trafikun e lëndëve narkotike apo psikotrope”). Megjithatë, në interpretimin përkatës, duket se s'mund të mos ndalemi në analizën hermeneutike të të dytës, si për të kuptuar më mirë elementët e përbashkët dhe dallues, ashtu dhe sepse ulja e dënimit e parashikuar nga neni 73 parag.7 i D.P.R. cit. – që rregullon një krim-qëllim

tipik të organizatës *ex neni 74 cit.* – bën pjesë me të drejtë e plotësisht në strategjinë e përgjithshme promovuese / shpërblyese të përcaktuar nga ligjvënësi me normativën në fjalë. Nga ana tjetër, në rrafshin e mirëfilltë praktik, është rasti për të vërejtur këtu që vetë mekanizmi shpërblyes i parashikuar nga neni 74, parag.7, cit., në pjesën më të madhe të rasteve mund të rezultojë zhgënjyes, në mungesë të një parashikimi të ngjashëm dhe paralel të masave shpërblyese për krimet-qëllim, që lidhen ngushtë me qëllimet e organizatës, edhe ato të dënuar me dënime shumë të rënda.

Edhe sipas jurisprudencës së ligjshmërisë²⁵⁶, këto rrethana lehtësuese përbëjnë shtrirjen e normave shpërblyese në lidhje me krimet e drogës, norma që diktohen për krime të kryera me qëllime terrorizmi apo subversioni, të cilat gjenin zbatim edhe për krimin e sekuestrimit të personit me qëllim zhvatjeje, siç në nenin 630 të k.p..

Themeli logjiko-juridik apo, për ta thënë ndryshe me terminologjinë e doktrinës konstitucionaliste, *shkaku* i dispozitave të mësipërme shpërblyese, më shumë – dhe përveç – se tek kërkesa për shpërblim dhe parandalim (të përgjithshëm dhe të posaçëm), sipas Gjykatës së Kasacionit²⁵⁷ duhet të kërkohej në “nevojën” që ka ligjvënësi penal “përballë rritjes së fenomeneve veçanërisht alarmuese, si përhapja kapilare e rrjetit të shitësve të drogës në territor”, “për të parashikuar në legjislacion instrumente vetëmbrojtës të përshtatshëm e të tillë që do i bënin mekanizmat ndëshkues më pak të vështirë, më të shpejtë e më të suksesshëm”.

Edhe një herë doktrina i përfshiu rastet e shpërblimit të futura me D.P.R. nr.309, të vitit 1990 në kategorinë e pendimit pas kryerjes së krimit, që, pas rishikimit dogmatik që sjell legjislacioni antiterrorizëm, orientohet gjatë dy linjave kryesore të prirjes që pasqyrojnë dy nevoja të ndryshme ligjore: e para, pasi synon të favorizojë qëndrime të fajtorit që përpiqen “*të shmangin faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasojë të mëtejshme*”, lidhet sidoqoftë me mbrojtjen e të mirës juridike që mbrohet nga normat substanciale në këtë fushë; ndërsa e dyta, për trajtimin e favorshëm që u bëhet atyre që bashkëpunojnë “konkretisht” apo “në mënyrë efikase” me drejtësinë, orientohet drejt promovimit të veprimtarisë së investigimit dhe ndëshkimit të krimeve²⁵⁸.

²⁵⁶ Shih për të gjitha Kas. 27 maj 1992, në *cass.pen.*, 1993, 1231 e vijuese, me një shënim të gjerë shpjegues nga S.PALLA.

²⁵⁷ Shih vendimin e cit., më sipër, në shënimin paraardhës.

²⁵⁸ Lidhur me këtë pikë, krs. G.FLORA, *La fattispecie di ravvedimento postdelittuoso*, në AA.VV., *La nuova normativa sugli stupefacenti*, Milano 1991, 17, që, në kuadrin e “rastit të pendimit pas kryerjes së krimit” futur nga normat penale të tesktit unik mbi lëndët

Në një shikim të parë e të përgjithshëm të normativës shpërblyese në fjalë, nuk mund të mos ndalemi – ashtu si dhe doktrina dhe jurisprudenca është ndalur – në problemin e pajtueshmërisë së dispozitave përkatëse, edhe për shkak të përqindjes së ulët të saktësisë dhe vendosmërisë që e i dallon ato, me norma kushtetuese të konkretësisë/cenueshmërisë (le të mendojmë për efikasitetin shpërblyes që ka qoftë edhe “një përpjekje e thjeshtë” për të arritur disa rezultate të sigurta, pa asnjë saktësim lidhur me përshtatshmërinë objektive të këtij qëndrimi kundrejt qëllimit) apo vendosmërisë (përveç paqartësisë së vetë termit “me u përpjek”, “që mund të lërë shkas për interpretim si në këndvështrimin subjektivo-simptomatologjik ashtu dhe objektivo-shkakësor”²⁵⁹, le të kujtojmë këtu përdorimin e paqartë të shprehjeve ndajfoljore si “konkretisht” apo “me efikasitet” apo përdorimin e mbiemra “rilevantë apo të rëndësishëm” ose “vendimtare apo përcaktuese” që referohen përkatësisht në nenin 73, parag.7, D.P.R. nr.309, i vitit 1990 dhe në nenin 74, parag.7 të po këtij D.P.R. për “burimet” që fajtoribashkëpunëtor duhet të marrë “për kryerjen e krimeve” – neni 73 cit. – apo “organizatës” – neni 74 cit. -, që të mund të përfitojë masën shpërblyese).

Pra edhe një herë, interpretimi dhe renditja e mëvonshme dogmatike e parimeve juridike që duhet të rregullojnë zbatimin e normativës shpërblyese në fjalë, duhet të matet me parimet kushtetuese që rregullojnë fushën penale. Ashtu siç do ta shohim shumë shpejt, do të jenë pikërisht këto kritere dhe parime ato që do na japin mundësi të kemi një orientim të sigurt për t’u dhënë zgjidhje disa çështjeve të interpretimit që, në jurisprudencën e ligjshmërisë nuk kanë gjetur gjithmonë zgjidhje të qarta dhe konvergjente.

Një rregull i parë e themelor të cilit i referohet kushtetuta, i lidhur ngushtë me parimin e arsyeshmërisë/proporcionalitetit të normës penale (neni 3 i Kusht.), do të tregojë si të thuash drejtimin kryesor, boshtin tërheqës që duhet të ndjekë busulla interpretuese. Në fakt nuk duhet harruar që ulja e dënimit të parashikuar nga dy dispozitat e mësipërme shpërblyese, përfshirë mes gjysmës dhe dy të tretave të “dënimeve të parashikuara nga paragrafët 1 dhe 6” është e një mase të tillë që – mund të themi *e jashtëzakonshme* apo *përrjashtimore* – saqë mund të gjejë justifikim dhe të ligjërohet në rrafshin kushtetues (*ex neni 3 Kusht.*), në dritën e “shkakut” të ligjit, vetëm në rastet kur veprimet si të thuash *të shpërblyera* nga ky ligj do

narkotike, bën dallim mes “pendimit në kuptimin substancial”, që duhet përfshirë në perspektivën e “mbrojtjes, qoftë edhe si të thuash në *extremis* të të mirës juridike” dhe “bashkëpunimin në gjykim” që synon, më konkretisht, në “lehtësimin e veprimtarive të ndëshkimit të krimeve”.

²⁵⁹ *Aut. dhe vep.cit. së fundi*, 19.

të rezultonin në interpretimin/zbatimin konkret të tyre, të përshtatshme dhe efikase ndaj qëllimit që kërkon të arrijë ligji shpërblyese.

Ky kriter, që padyshim priret të rivlerësojë aspektet *sasiore* – dhe, për këtë arsye, *objektive* – të veprimeve a sjelljes shpërblyese, duhet të lidhet siç duhet me rregullën kushtetuese të barazisë (*tout court*) që e detyron ligjvënësin t'i rezervojë një trajtim parësor (në lidhje me dispozitat shpërblyese, në kuptimin e zbatueshmërisë praktike të tyre) për të gjithë ata që do të gjendeshin në të njëjtën situatë faktike (pa prekur këtu mundësinë për të shkallëzuar në përpjestim zbatimin e tyre, e duke pasur parasysh masën e ndryshme objektive të *rezultateve* të bashkëpunimit).

E pra, në dritën e parimeve të përmendura të Kartës sonë themelore, mund të gjejmë një zgjidhje të saktë disa probleme interpretimi, në lidhje me të cilët, si në doktrinë ashtu dhe në jurisprudencë, janë vërejtur kundërshtime, probleme dhe marrje pozicioni, që jo gjithnjë përkojnë me atë çka dikton kushtetuta. Emblematic është çorientimi hermeneutik në lidhje me përkufizimin e rëndësisë interpretuese të shprehjeve të paqarta ligjore që, si në nenin 73 (“përpiqet”, “edhe”, “duke ndihmuar konkretisht”, “burime”, rilevante”, “për kryerjen e krimeve”), ashtu dhe në nenin 74 si më lart (“në mënyrë efikase”, “përpjekur”, “për të siguruar provat e krimit”, “apo për t'i marrë organizatës burime të ndjeshme e vendimtare”, “për kryerjen e krimeve”), tregojnë mënyrat e shfaqjes dhe, në njëfarë mase të përgjithshme, masën e kontributit të kërkuar për bashkëpunimin.

Për shembull, nëse është shumë e qartë që koncepti i “përpjekjes” në paradigmen ligjore shpërblyese të neneve 73 e 74 të mësipërm nuk ka të bëjë patjetër me shprehjen ndajfoljore “*spontanisht*” (që përkundrazi e gjejmë në pjesën e dytë të nenit 62, nr. 6, të k.p., krahas shprehjes ndajfoljore “*në mënyrë efikase*”²⁶⁰), nuk mund të konsiderohet po kaq

²⁶⁰ Për një lexim subjektiv të rrethanës së uljes së posaçme të dënimit siç në nenin 73, parag.7, D.P.R., cit. shih së fundi, Kas., 7 prill 2005, n.22588, Volti dhe të tjera, në *C.E.D. Cass.*, n.232095, sipas të cilit nuk ekzistojnë kriteret për dhënien e rrethanës lehtësuese në fjalë, “për mungesë të kriterëve të spontanitetit dhe efikasitetit përcaktues, në veprimin e atij që pasi kapet nga Forcat e policisë në flagrancë substanciale të marrjes së një sasive lënde narkotike, vendos të rrëfejë marrjet e mëparshme të sasive të tjera dhe të tregojë vendin e fshehtë ku mbahet pjesa tjetër e lëndës”. *Contra*, shih kas. 22 nëntor 1996, Torri, në *C.E.D. Cass.*, nr.207264, sipas të cilit konkretësia e ndihmës në bashkëpunim matet edhe, e sidomos, me varfërimin e tregut, kështu që nuk është i nevojshëm një akt i mirëfilltë pendimi apo rrëfimi spontan.

paqësor rindërtimi i tij në këndvështrimin e pastër subjektiv²⁶¹, që duket se ka të bëjë me krahasimin mes shprehjes, të zgjedhuar në kohën e tashme, të përdorur në nenin 73 (“përpiqet të shmangë...”) dhe shprehjes, së përdorur në kohën e shkuar, por që dallon për nga kriteri i *efikasitetit*, që përmban neni 74 (“...është përpjekur në mënyrë efikase...”).

Në të vërtetë, një interpretim subjektiv i rastit të shpërblimit siç parashikuar në nenin 73 cit., mund të gjejë ligjërimin e vet kushtetues në parimin e personalizimit të veprës penale (neni 27 parag.1 Kusht.), me rivlerësimin për rrjedhojë të fajësisë së veprimit (në varësi të rrethanës), që është i dënueshëm në mënyrë jashtëzakonisht lehtësuese. As nuk duhet të harrojmë se, e parë brenda trafikut të sasive të vogla, “është përpjekur” sidoqoftë me rezultate po kaq të vogla në rrafshin e bashkëpunimit, mund të sjellë një dëmtim të parimit të barazisë: në fakt pa të drejtë, rrethana lehtësuese shpërblyese do të njëhej (*ex nenet 3 e 27 Kusht.*) vetëm për ata që janë bërë përgjegjës për krimin apo për krimet më të rënda ndër ato të parashikuara nga neni 73, paragrafët 1 e 6, ndërsa do të përjashtohet në rastin kur do jepej një ndihmë bashkëpunimi e kufizuar, që do vinte si pasojë e vetë pozicionit dytësor të bashkëpunëtorit²⁶².

Përveçse, përjashtimi i hamendësuar i rrethanës lehtësuese në rastet e bashkëpunimit në një masë të vogël duket se nuk autorizohet aspak nga kjo dispozitë, që ndërsa krijon lidhje mes uljes së dënimit si shpërblim dhe “dënimeve të parashikuara nga paragrafët 1 deri në 6” të po këtij neni 73, u referohet edhe tipologjive të krimit që shfaqin një shkallëzim të shtrirë të rëndësisë, deri në parashikimin e “fakteve jo shumë të rënda” (“për mjetet, modalitetet apo rrethanat e veprimit apo për cilësinë e sasinë e lëndëve”), siç në paragrafin e pestë të këtij neni. Rrjedh nga kjo që ulja e dënimit si shpërblim në nenin 73 parag.7 mund të jepet edhe kur veprimi apo sjellja e bashkëpunimit u referohet krimeve që, nga pikëpamja e “sasive të lëndëve” *objekt* i trafikut të paligjshëm, nuk do të paraqiste – *objektivisht*, pikërisht – tiparet e një vepre shumë të rëndë. Megjithatë, për të ligjëruar (*ex neni 3 Kusht.*) një ulje kaq të madhe të dënimit si shpërblim, bashkëpunimi duhet që domosdoshmërisht, edhe nëse nuk do zbuloheshin “burime” kriminale “të rëndësishme” (në kuptimin “të mëdha”) (në lidhje me sasitë e lëndëve narkotike “që i merren” qarkullimit të parave të krimit në tregun e paligjshëm, si dhe faktorëve të tjerë të pasurimit të paligjshëm, si kapitale të

²⁶¹ Ndërsa duket se orientohet drejt një interpretimi subjektiv i rrethanës lehtësuese siç në nenin 73, parag.7, cit., D.POTETTI, *L'art. 73 comma 7, D.P.R. nr.309, del 1990. Questioni ed incertezze interpretative*, në *Cass.pen.2002*, 3880 e vijues.

²⁶² Lidhur me këtë, krs. Kas., 1 shkurt 1996, Bragagna, *C.E.D., Cass.*, nr.204108.

investuara apo që duhen investuar në blerjen e lëndëve narkotike apo edhe të “burimeve njerëzore” të përdorura në trafikun e paligjshëm), duhet të ekzistojnë të paktën rezultate “konkrete” dhe “të dobishme” në perspektivën investiguese dhe të gjyqimit në të cilin gjen vend ulja e dënimit si shpërblim. Në këtë kuptim, mund të jemi dakord me opinionin që e cilëson këtë rrethanë lehtësuese si “një rrethanë lehtësuese rezultati”²⁶³.

Në këtë pikë, na duhet të bëjmë një tjetër saktësim.

Një rindërtim në këndvështrimin subjektiv/simptomatologjik i uljes së posaçme të dënimit që do i jepte shprehjes “përpiqet” detyrën për të rivlerësuar vetëm “mundësitë për bashkëpunim” të një bashkëpunëtori, përkon me *ratio-n* e dispozitës shpërblyese që privilegjon jo aq pendimin e brendshëm të të pandehurit bashkëpunëtor, se sa *rezultatet* që ai, me përpjekjen konkrete të vet, është në gjendje të arrijë apo të bëjë të arrihet nga hetuesit apo nga vetë autoriteti gjyqësor. Por ekziston një tjetër rrezik. Në fakt, gjyqtarit i lihet detyra e vështirë për të llogaritur, në bazë të parametrave delikate subjektivë (që mbështeten në shtrirjen, plotësinë apo jo dhe, për rrjedhojë, në dobinë e gjyqimit), masën e ndihmës së bashkëpunimit të dhënë. E pra, për shkak të pasigurisë së pashmangshme të verifikimit të kriterëve të mësipërme të faktit që justifikojnë këtë të drejtë vetëgjykimore (*ex nenet 132 e 133 të k.p.*), edhe në lidhje me uljen e dënimit që duhet bërë si efekt i rrethanës së posaçme lehtësuese, mund të përcaktohen kushtet për mosnjohjen e rrethanës lehtësuese, meqë “dyshimi mbi ekzistencën e rrethanës lehtësuese kthehet në dëm të fajtorit”²⁶⁴.

Për këtë arsye, duket krejt me vend referimi i doktrinës ndaj normave të materialitetit/cenueshmërisë, që ka të bëjë me qëllimin për të shmangur rrezikun që “rrethana superlehtësuese” të njihet “më shumë në bazë të vlerës simptomatike të sjelljes” (me rivlerësimin për pasojë të aspekteve që i referohen brendësisë së padukshme të sjelljes dhe, një konceptimi të kapërcyer tashmë të të *drejtës penale të sjelljes së brendshme*), “sesa në bazë të përshtatshmërisë objektive penguese të tij”²⁶⁵. Në dritën e këtyre normave kushtetuese, “pendimi pas kryerjes së krimit” përshkruar në nenet 73, parag.7 e 74, parag.7, D.P.R. cit duhet të konsistojë domosdoshmërisht jo më në një sjellje a veprim të pakapshëm nga pikëpamja konceptore, por në një veprim a sjellje që, “në shtrirjen objektive të tij” duket se në aspektin

²⁶³ G.AMATO, *Precisazioni sull'attenuante della “collaborazione” in materia di droga*, në *Cass.pen.*, 2005, 2362.

²⁶⁴ Lidhur me këtë pikë, shih edhe për disa referime interesante jurisprudenciale, D.POTETTI, *vep.cit.*3878.

²⁶⁵ G.FLORA, *vep.cit.*,19.

konceptor gëzon një kuptim të qartë pozitiv dhe, në aspektin faktik, “një përshtatshmëri konkrete penguese apo lehtësuese në rrafshin e dëmit të pësuar apo cenimit”²⁶⁶.

Ja pra që ndër interpretimet e mundshme të normës shpërblyese, duhet të zgjidhet ajo që, në respektim të normave të mësipërme kushtetuese, do të rivlerësonte nga njëra anë përshtatshmërinë dhe konkretësinë e ndihmës së dhënë drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga bashkëpunëtori për autoritetin gjyqësor apo të policisë, kundrejt qëllimeve investiguese-gjyqësuese-ndëshkuese që vetë norma ndjek (të shmangë faktin që veprimtaria kriminale – dhe jo thjesht krimi i kryer tashmë – të ketë pasoja të mëtejshme; të marrë burime të rëndësishme (apo relevante) që shërbejnë për kryerjen e krimeve, për sa i takon uljes së dënimit si shpërblim që parashikon neni 73, parag.7, cit.; të sigurojë provat e krimit, t’i marrë organizatës burime që do të ishin përcaktuese për kryerjen e krimeve, për sa i takon rrethanës së posaçme lehtësuese të parashikuar në nenin 74, parag.7, D.P.R. cit.).

Lidhur me përshtatshmërinë e ndihmës së bashkëpunimit kundrejt qëllimeve të treguara më lart, është me interes të vërejmë se ajo kërkohet njëherësh nga jurisprudenca²⁶⁷. Por i kundërt është kriteri i vlerësimit të përshtatshmërisë. Teza që mbështetet më fort priret për një vlerësim *ex post*²⁶⁸, mbi rëndësinë që ajo “është një pasojë e pashmangshme kur zgjidhet të vlerësohet bashkëpunimi në nivel të pastër objektiv”²⁶⁹. I shtojmë kësaj

²⁶⁶ *Aut, vep.e lok.cit.*

²⁶⁷ Shih për shembull, Kas.30 mars 1994, BOZZI, në *Cass.pen.*, 1996, 657, n.376, që, ndërsa ndalet në kuptimin e ndajfoljes “edhe”, pohon se norma nuk i jep rëndësi juridike çdo lloji bashkëpunimi, por vetë, atij që rezulton se është *i përshtatshëm* për marrjen e burimeve të rëndësishme që shërbejnë për kryerjen e krimeve (të tjera), edhe nëse nuk kanë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me atë për të cilin po procedohet. Rrjedh nga kjo që e drejta për dhënien e uljes së dënimit nuk do të anulohet në rastin kur bashkëpunëtori do të jepte informacione, konkrete, për të shmangur kryerjen e krimeve të tjera, të ndryshme nga ai i kryer tashmë, që përbën objektin e çështjes në të cilën janë marrë deklaratat e bashkëpunimit.

²⁶⁸ Kas., 15 prill 1993, LA TORRE ed altri, në *C.E.D. Cass.*, nr.194893; Kas., 5 dhjetor 1996, Bernardini, *Cass.pen.*, 1997, 1890, nr.1138.

²⁶⁹ D.POTETTI, *vep.cit.*, 3882. Nga ana tjetër priret drejt një vlerësimi *ex ante*: G.FLORA, *La fattispecie di ravvedimento postdelittuoso*, cit., 21, sipas të cilit “pavarësisht nga njëfarë paqartësie në “përpyekjen”, shprehja legislative mund të kuptohet fare mirë në kuptimin e të kërkuarit që sjellja a veprimet të jenë të përshtatshme, sipas një gjykimi të vërtetësisë që duhet bërë *ex ante*, për arritjen e rezultatit të treguar në normë. Kështu, për shembull, për qëllime të njohjes së rrethanës lehtësuese siç në nenin 73, parag.7, pjesa e parë, nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm fakti që “shpërndarësi” do mjaftohej thjesht ta ftonte përdorësin e drogës të mos e merrte dozën e sapodorëzuar duke i treguar se ajo përmban një përqendrim të lartë të principit aktiv. Dhe përsëri, për qëllime të rrethanës lehtësuese siç

faktin që një gjykim përshtatshmërie *ex ante*, i cili për vetë natyrën e vet mbështetet në një procedim abstragimi konceptor, do të humbte karakterin e konkretësisë që, edhe nga pikëpamja kuptimore, referohet nga germa e dispozitës legjislative shpërblyese (“...edhe konkretisht”)²⁷⁰.

Ndër të tjera, e gjitha kjo nuk autorizon në asnjë mënyrë afirmimin sipas të cilit ulja e posaçme e dënimit në fjalë “do ish një lloj rrethane e mirëfilltë lehtësuese”, pasi masa e shpërblimit mund të jepet “vetëm” “për ata që gjenden në një pozicion disi të rëndësishëm brenda strukturës kriminale”, dhe për këtë arsye në gjendje të japë “një ndihmë të vlerësueshme për çështjen e drejtësisë”²⁷¹.

në pjesën e dytë të nenit 73, parag.7, nuk do të jetë ende e mjaftueshme që shpërndarësi “me pakicë” t’i japë autoritetit informacione mbi vendet e furnizimit të tij dhe mbi personat që e frekuentojnë atë, por që janë krejt të papërshtatshme për të përcaktuar me saktësinë e nevojshme si vendet ashtu dhe personat”.

²⁷⁰ Për një analizë të plotë kritike të arsyeve mbi të cilat mbështetet teza (e shprehur nga GJ.H.P. të Gjykatës së Pizës, më 18 nëntor 1991, Mori, *Cass.pen.*,1992, 1938, nr.1054) në favor të vlerësimit *ex ante* të përshtatshmërisë së bashkëpunimit për të arritur efektin shpërblyes të përcaktuar nga ligji, shih D.POTETTI, *vep.cit.*, 3882. Autoriteti vëren se kjo tezë mbështetet në rëndësinë që nuk do mund të konceptohej që “gjykimi mbi ekzistencën e rrethanës lehtësuese mund të pezullohet deri në vërtetimin konkret të efikasitetit të vet, dhe në praktikë, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit mbi fakte të penguar apo të vërtetuara përmes bashkëpunimit”. Në të vërtetë, sipas Autoritetit të cituar, ky kundërshtim duket se nuk godet në shenjë, “Në fakt – vëren Autoriteti -, një pezullim i çështjes penale të këtij niveli nuk është i nevojshëm (kështu që kundërshtimi humb themeltesinë e vet), meqë, në bazë të nenit 2 të k.p., gjyqtari penal zgjidh çdo çështje nga e cila varet vendimi (me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe), pra gjyqtari procedues mund të vlerësojë lirisht dhe në rrugë dytësore e rastësore (qoftë edhe *ex post*) masën e bashkëpunimit të dhënë, edhe pse, siç dihet (neni 2 parag.2) vendimi i gjyqtarit penale që zgjidh çështjen e dorës së dytë penale nuk ka vlerë detyruese në asnjë proces tjetër”.

²⁷¹ Krs. Ks,11 dhjetor 1996, CONTE, në *Cass.pen.*1997, 1893, nr.1139, sipas të cilës bashkëpunëtorët që nuk kanë “mall për të këmbyer”, sepse janë më pak të futur në mjediset e krimit, nuk do kishin mundësi të gëzonin uljen e dënimit si shpërblim por, nëse do të ekzistonin kriteret, disa rrethana të tjera lehtësuese që mundësojnë përshtatjen e dënimit ndaj rëndësisë së faktit. Lidhur me këtë, shih D.POTETTI, *vep.e lok.cit.fundit*, G.AMATO, *Puntualizzazioni giurisprudenziali sulla “collaborazione” dell’imputato in materia di sostanze stupefacenti*, në *Cass.pen.*1997, 1894-1895 dhe ID., *Precisazioni sull’attenuante della “collaborazione” in materia di droga*, këtu, 2005, 2362, ku, ndonëse pranohet fakti që rrethana lehtësuese në fjalë është “një rrethanë lehtësuese rezultati”, vërehet se “për të mos ua njohur shpërblimin në mënyrë të paarsyeshme vetëm atij që është i përfshirë në një trafik të madh lëndësh narkotike, pra në gjendje të ndihmojë në marrjen e burimeve objektivisht “të mëdha”, mbiemri “rilevante apo të rëndësishme” më shumë se në kuptimin “të konsiderueshme” duhet interpretuar më shumë si “fitime”, që mundëson trajtimin e barabartë të të gjithë atyre që gjenden sidoqoftë në të njëjtën shkallë proporcionale të shpërblimit në lidhje me masën e ndihmës konkrete të dhënë”.

Një interpretim i tillë do e linte të hapur çështjen në shpërpjestim të qartë të masës së dënimit (e rëndësishme nga pikëpamja kushtetuese *ex neni* 3 i Kusht., në aspektin e arsyeshmërisë/barazisë kundrejt situatave të tjera të ngjashme të rregulluara nga ligji) të dispozitës shpërblyese kundrejt një përpjekjeje të thjeshtë, qoftë edhe kur nuk e ka kriterin e spontanitetit, siç në nenin 62 nr.2, pjesa e fundit, k.p.. Nga ana tjetër, një zgjidhje hermeneutike e orientuar nga Kushtetuta për mbrojtjen e parimit të barazisë/arsyeshmërisë duhet të shpjerë drejt interpretimit të mbiemrit “rilevantë apo të rëndësishëm” në një këndvështrim si të thuash *cilësor*, duke mos i dhënë kuptimin “të mëdha”, apo “të konsiderueshme” nga pikëpamja sasiore, por duke i mveshur kuptimin “të dobishme apo që shërbejnë”. Në këtë mënyrë, ulja e dënimit si shpërblim mund të pranohej, qoftë edhe përballë shkallëzimeve të ndryshme të trajtimit të masës së dënimit²⁷², për të gjithë ata që kanë bërë gjithë sa kishin në dorë “për të shmangur faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasoja të mëtejshme”, duke dhënë në këtë mënyrë atë ndihmë konkrete për autoritetin e policisë apo autoritetin gjyqësor që, në bazë të nenit 73 parag.7, D.P.R. nr.309 i vitit 1990, duhet të qëndrojë në marrjen e burimeve *rilevante* për kryerjen e krimeve.

Në mbështetje të një interpretimi në këndvështrimin e cilësisë së shprehjes “rilevante”, të përdorur nga ligjvënësi në nenin 73, parag.7, cit., vjen edhe krahasimi me terminologjinë e përdorur në nenin 74, parag.7, i këtij D.P.R. për të përcaktuar rrethanën e ngjashme lehtësuese shpërblyese që u lihet “atyre që janë përpjekur me efikasitet të sigurojnë provat e krimit apo t’i marrin organizatës burime *përcaktuese* për kryerjen e krimeve”²⁷³. Në të vërtetë, natyra *përcaktuese apo vendimtare* e burimeve që bashkëpunëtori ndihmon t’i merren organizatës kriminale nuk kërkon detyrimisht që këto burime të jenë edhe *të mëdha* nga pikëpamja sasiore. Dhe në fakt, meqë termi *burime* mund t’u referohet jo vetëm burimeve materiale (lëndë narkotike, mjete financiare, burime logjistike, etj.), por edhe burimeve njerëzore, padyshim që përcaktueshmëria e burimeve që i merren organizatës mund të varet në disa raste edhe (apo vetëm) nga ndërprerja e qarkut të shpërndarjes së drogës apo nga neutralizimi, edhe i përkohshëm por domethënës, i një hallke jetike (unipersonale) të organizatës shpërndarëse, edhe pse nuk zbulohen njëkohësisht burimet materiale që nga pikëpamja sasiore janë *të mëdha*, sipas shembullit të sjellë pak më lart.

²⁷² Krs. Kas., 1 dhjetor 2000, Serenato, në *Cass.pen.2002*, 2495, që përmban referime të tjera.

²⁷³ Në këtë kuptim, shih G.AMATO, *Precisazioni* cit., 2362.

Në përcaktimin e rrezes së zbatimit të nenit 74, parag.7, D.P.R. nr.309, i vitit 1990, jurisprudenca ka sqaruar gjithashtu se “duke pasur parasysh formulimin më vete të normës, nuk kërkohet që veprimet apo sjellja të treguara në të, të kryhen së bashku, por është e nevojshme që, të paktën, njëra ose tjetra të kenë sjellë efektin e treguar përkatësisht (sigurimi i provave të krimit të organizuar që ka për qëllim trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike apo marrjen ndaj organizatës të burimeve përcaktuese për kryerjen e krimeve”). Nga ana tjetër, s’ka dyshim që ndër dy rrethanat lehtësuese të parashikuar përkatësisht nga nenet 73, parag.7 dhe 74, parag. 7, cit., ekziston një marrëdhënie nga *minus* në *majus*, në kuptimin që për të konfiguruar të dytën nuk mjafton që i pandehuri bashkëpunëtor të jetë përpjekur të shmangë faktin që veprimtaria e shpërndarjes së drogës të ketë sjellë pasoja të mëtejshme, edhe përmes një veprimtaria ndihmëse që do ketë bërë të mundur sekuestrimin e “burimeve rilevante”, por lipset diçka më shumë: në lidhje me rëndësinë më të madhe të krimit (që ka të bëjë me një vepër bashkëpunimi në krim dhe jo me një veprim që ka të bëjë me kuadrin e një trafiku të vetëm të paligjshëm të lëndëve narkotike, mund të silltet n ndihmë *ex neni* 110 i k.p.), është e nevojshme që sjellja bashkëpunuese të jetë e përshtatshme, konkretisht dhe në mënyrë efikase, të ndërpresë veprimtarinë e organizatës në tërësinë e vet. Kjo sjellje mund të realizohet në modalitetin e dyfishtë, alternativ apo të përbashkët që konsiston, siç thamë, ose në përpjekjen efikase për të siguruar provat jo të krimeve-qëllim që bënin pjesë në planin kriminal të organizatës, por “të krimit” (të bashkëpunimit) ku gjen vend rrethana lehtësuese, apo në ndihmën e dhënë për t’i marrë, po organizatës, burime përcaktuese o vendimtare për kryerjen e krimeve²⁷⁴.

Për sa i takon kuadrin të ndryshëm operativ të dy rrethanave lehtësuese shpërblyese, parashikuar në nenet 73, parag.7, e 74, parag.7, i D.P.R. n.309, i vitit 1990, kundrejt rrethanës lehtësuese të përbashkët të parashikuar nga neni 62, nr.6, i k.p., ai është sqaruar me shumë qartësi nga Gjykata e Kasacionit: ndërsa rrethana lehtësuese e përbashkët postulon një nismë “spontane” të fajtorit, që synon të eliminojë pasojat e dëmshme apo të rrezikshme të krimit të kryer prej tij, e gjitha kjo nuk kërkohet aspak nga normativa e mësipërme shpërblyese. Dy rrethanat lehtësuese të posaçme si më lart, kërkojnë në fakt që veprimi i fajtorit që ka për qëllim të brendashkruajë pasojat e krimit apo të bashkëpunojë me drejtësinë “është fryt i një procesi të brendshëm e të vërtetë vuajtjeje (dhe jo i një llogaritjeje

²⁷⁴ Krs.lidhur me këtë pikë, Kas., 25 maj 2006 (dep.më 9 gusht 2006), Pugioni, në *C.E.D. Cass.*, n.234920.

të thjeshtë utilitariste), e as që veprimi që do sillte rrethanën lehtësuese të ketë për objekt krimin “e vet”, ndonëse mund të përfshirë fare mirë edhe “veprimtarinë kriminale” të të tjerëve”²⁷⁵.

Jurisprudenca e ligjshmërisë ka saktësuar gjithashtu se rrethana lehtësuese e parashikuar në nenin 73, parag. 7, cit. “qëndron si rrethanë lehtësuese e posaçme” kundrejt rrethanës “së zakonshme”, “prandaj kjo e fundit mund të gjejë zbatim në rastet ku mbështetet mbi atë veprim bashkëpunues që ka shpënë në njohjen e rrethanës lehtësuese të parashikuar nga para.7, i nenit të mësipërm 73”. Gjykata e kasacionit ka vërejtur gjithashtu që vetë elementët nuk mund të vlerësohen në mënyrë të përsëritur për arritjen e një uljeje të dyfishtë të dënimit. Nga ana tjetër, nuk ka dyshim që në bazë të parimit të përgjithshëm të specialitetit, rrethana lehtësuese e posaçme apo speciale kryeson ndaj asaj të përgjithshme, edhe sipas parashikimit të shprehur të nenit 68 të k.p. që rregullon rastin e “rrethanës komplekse”, në të cilën një rrethanë rënduese përfshin në vetvete një tjetër rrethanë rënduese, apo një rrethanë lehtësuese përfshin në vetvete një tjetër rrethanë lehtësuese. Në këto raste, “rrethana juridikisht më e rëndësishme – pra që do të sillte shtimin apo uljen më të madhe të dënimit – konsiderohet si specifike, pra gjen zbatim dhe vlerësohet vetëm ajo”²⁷⁶. Ndër të tjera, për një saktësi më të madhe interpretuese, është vërejtur se rrethana lehtësuese e posaçme siç në nenin 73, parag. 7, D.P.R. nr.309, i vitit 1990 ka një përmbajtje dispozitash më të gjerë se ajo e parashikuar nga neni 62, nr.6, i k.p.. Në fakt, ajo nuk lidhet me krimin, por me “veprimtarinë kriminale”, që është shprehje sigurisht më e gjerë dhe mund të përfshijë faktin e kundërshtuar pa u ezauruar në të; prandaj duke iu referuar “pasojave të mëtejshme” të “veprimtarisë kriminale”, ajo nuk mjaftohet vetëm me referimin ndaj “pasojave të dëmshme apo të rrezikshme të krimin” (të cilave u referohet neni 62, nr.6, pjesa e dytë, e k.p.), por u referohet edhe ngjarjeve të mëtejshme e të ndryshme, “siç provohet si nga përgjithësia e formulës së

²⁷⁵ Kështu Kas.cit. i fundit.

²⁷⁶ Krs.Kas., 3 qershor 1994, Campostrini, *Cass.pen.*, 1996, 2787; Kas., 24 shtator 1992, D’Onofrio, *këtu*, 1994, 439; Kas., 27 maj 1992, Dudine, *C.E.D., Cass.*, n.191979. Lidhur me këtë pikë, shih edhe Kas., 27 prill 1999, Cantini, *Cass.pen.*, 2000, 3452, që, ndërsa konfirmon natyrën e rrethanës lehtësuese të posaçme të veprimit të përshkruar në nenin 73 të D.P.R. 9 tetor 1990, nr.309, ndaj asaj të parashikuar në nenin 62 nr.6, k.p., ka saktësuar se, për ta konfiguruar, pra që të përkojë me *ratio* të parandalimit të dëmit që i bëhet shoqërisë nga shpërndarja e drogës, është i nevojshëm një bashkëpunim i suksesshëm, që do shmangte kryerjen e krimeve të tjera apo që do mundësonte lehtësimin e pasojave të krimin apo do të pengonte pasoja të tjera. Për këtë arsye, **nuk mjafton vetëm të tregohet vendi ku fshihet droga** në banesën e vet, pasi ky informacion përbën veç një të dhënë q ëi jepet policisë që sidoqoftë do arrinte ta merrte pasi të kryente kontrollin e kësaj banese.

përdorur, si nga dhënia si shembull e disa ndihmave, si ndihmë për veprimtarinë hetimore dhe zbulimin e burimeve rrelevante” (“[...] edhe duke ndihmuar konkretisht autoritetin e policisë apo autoritetin gjyqësor në marrjen e burimeve rrelevante për kryerjen e krimeve”), që sigurisht nuk i referohen shmangies së dëmit kriminal të krimit të kryer”. Nga ana tjetër, rrethana lehtësuese e zakonshme, për qëllime sanksionuese, merr në konsideratë në mënyrë të favorshme sjelljen e veprimet ndreqëse të fajtorit që përpiqet “duke shpresuar të zbusë dëmin apo rrezikun, pjesë e krimit për të cilin akuzohen subjektet pasive, ndërsa rrethana rënduese e posaçme ka të bëjë me zhvillimin përkeqësues të këtij dëmi apo dëmeve të tjera të ndryshme nga dëmi kriminal i konsoliduar”. Rrjedh nga kjo që ndër dy normat ekziston “një marrëdhënie *specialiteti të ndërsjellë*, ndërkohë që kryeson norma që, herë pas here, duhet të cilësohet e posaçme apo speciale në llojin konkret të veprës që i nënshtrohet shqyrtimit të gjyqtarit”²⁷⁷. Në çdo rast, duket se s’mund të mohoet *natyra subjektive* e dy rrethanave lehtësuese në fjalë, në bazë të nenit 70, parag.i parë n.2, k.p., me pasojë mosnjoftueshmërinë e tyre tek personat që kanë bashkëpunuar në kryerjen e të njëjtit krim, në bazë të nenit 118 të k.p.²⁷⁸.

Siç duket qartë, edhe rrethanat lehtësuese të posaçme, të të drejtës *shpërblyese*, që shqyrtoam deri tani sjellin në vija të trasha strukturën, kuadrin operativ dhe, deri diku kërkesat justifikuese²⁷⁹ (*mutatis mutandis*) edhe në rrafshin kushtetues, të rrethanës lehtësuese “të zakonshme” si më

²⁷⁷ Në këtë kuptim, shih Kas., 7 mars 1994, Sut., Cass., pen., 1996, 316.

²⁷⁸ *Natya subjektive* e rrethanës lehtësuese të nenit 62 nr.6 të k.p. afirmohet në bazë të themelit të vet psikologjik specifik, nga doktrina kryesuese dhe nga jurisprudenca e ligjshmërisë: shih, p.sh. G.FIANDACA – E.MUSCO, *Diritto penale*, p.gj., 326; M.ROMANO, *Commentario sistematico del codice penale*, I, Milano, 1995, 638; F.MANTOVANI, *Diritto penale, parte generale*, Padova, 1992, 417; C.FIORE – S.FIORE, *Diritto penale, parte generale*, II, 34; Kas., 12 maj 1997, p.gj. Cereda, *C.E.D. Cass.*, n.207756. Në kuptimin e kundërt, mbi faktin që ajo i referohet rëndësisë së krimit, shih A.PAGLIARO, *Principi di diritto penale, parte generale*, Milano 1990, 482. Shprehet me dyshim, T.PADOVANI, *Circostanze del reato*, në *Digesto disc.pen.*, Torino, 1988, II, 222, që vëren se “sipas orientimit kryesues, rrethana që tregon pendimin e fajtorit, do kish natyrë subjektive; por ideja, ndoshta me të drejtë, kundërshtohet nga ata që theksojnë ndikimin që ajo ka mbi rëndësinë e dëmit të shkaktuar”.

²⁷⁹ Këto kërkesa identifikohen me *ratio* të normativës shpërblyese në mbrojtje të të mirave, me rëndësi kushtetuese, si vetë vetëmbrojtja e legjislacionit kundrejt zgjerimit të fenomeneve që përbëjnë shqetësim të veçantë për shoqërinë, në gjendje të kërcënojë rëndë jo vetëm shëndetin publik, por edhe, përmes futjes në qarqet e paligjshme të disponibiliteteve të mëdha financiare me prejardhje nga trafiket e drogës, ekonominë e tregut të lirë.

sipër. Edhe sëfundi, Gjykata e kasacionit²⁸⁰, duke u nisur nga e njëjta linjë interpretimi, ka saktësuar se rrethanat lehtësuese të posaçme në fjalë, që kërkojnë të shpërblejnë dhe stimulojnë pendimin e përgjegjësit pas kryerjes së krimit, përbëjnë “instrumentin kundër trafikantëve të lëndëve narkotike, përmes të cilëve kërkohet të nxitet distancimi dhe bashkëpunimi që konsiderohen thelbësore që të minuar në themel kompaktësinë dhe heshtjen që karakterizojnë të gjitha organizatat kriminale, edhe ato më pak të sofistikuara dhe të shtrira. *Ratio* e rrethanës lehtësuese (por ndoshta do ish më mirë të flisnim për *qëllimin* e rrethanës lehtësuese) – sipas kësaj jurisprudence – ka karakter të mirëfilltë investigues, meqë “shpërblimi” që qëndron në një “hedhje poshtë” të trajtimit sanksionues (ulje e dënimit nga gjysma në dy të tretat), është i lidhur ngushtë me rezultatin e hetimeve, konkret dhe të prekshëm, në veprimtarinë e luftës kundër trafikëve të paligjshme të drogës, që lidhet me sjelljen bashkëpunuese të fajtorit.

Në këtë jurisprudence, shfaqen shprehje dhe formula interpretuese që duket se i bëjnë jehonë jurisprudence së ngjashme të mëparshme në lidhje me rrethanat lehtësuese shpërblyese të futura nga legjislacioni antiterrorizëm. Për shembull, në përcaktimin e “emëruesve minimalë të përbashkët” të dy rrethanave lehtësuese shpërblyese të parashikuara nga normativa antidrogë, thekson tre aspekte themelore: I. nevojën që fajtori, më shumë se – dhe përveç – ndreq pasojat e dëmshme të krimit, vepron konkretisht, me sjelljen e tij *post delictum*, një *zgjedhje të mirëfilltë në terren*, krejt të ngjashme me atë të bërë në kryerjen (apo në bashkëpunimin me të tjerë për ta kryer) e krimit; II. Nevoja që fakti, “për natyrën e vet apo për modalitete specifike të kryerjes, është në gjendje të sjellë pasoja “të mëtejshme”, pra që shkojnë përtej efektit tipik të saj, dhe që ende nuk kanë përfunduar²⁸¹; III. “veprimtaria ndreqëse e subjektit duhet të jetë e tillë që mund të prodhojë efekte relevante”²⁸².

Në bazë të këtyre sqarimeve dhe saktësimeve, të zhvilluara në një rrafsh interpretues dhe dogmatik në përputhje me orientimet e sjella nga Kushtetuta, mund të zgjidhen lehtë disa çështje të nivelit praktik që kanë përbërë objekt reflektimi në doktrinë dhe në jurisprudence. Për t’u mjaftuar me analizën e çështjeve më të rëndësishme e që gjejnë më shpesh zbatim²⁸³,

²⁸⁰ Kas.,30 janar 2007, nr.3429, A.A.M. që gjehet në *Diritto penale e processo*, 2007, nr.3, 294.

²⁸¹ Lidhur me këtë pikë, Shih Kas., 5 prill 1986, 2590, Moliterni.

²⁸² Këshu Kas., 27 maj 1992, cit.

²⁸³ Për një pasqyrim të përpiktë të “situatave të ndryshme që praktika gjyqësore lejon të vlerësohet”, shih G.AMATO, *Precisazioni* cit,m 2362-2363, me referime të shumta jurisprudenciale.

lipset të mbajmë parasysh rastet në të cilat ndihma në bashkëpunimin e dhënë nga kush kërkon rrethanat e posaçme lehtësuese në fjalë ka qëndruar në veprimet ndihmëse për rrjedhojë:

- a) rrëfim i thjeshtë, i pashoqëruar nga informacione të mëtejshme të dobishme (për shembull, për të mundësuar sekuestrimin e lëndëve narkotike që ende nuk janë gjetur nga policia gjyqësore apo të përshtatshme për të identifikuar bashkëfajtorët);
- b) pranim dhe deklarata të pjesshme apo të përgjithshme;
- c) pranim dhe deklarata të përshtatshme për të forcuar një kuadër provash të ravijëzuar mjaftueshëm në bazë të elementëve të përfutur.

E pra, duket qartë se në rastet e sapopërmendura duhet përjashtuar efekti shpërblyes *ex D.P.R.* nr.309, i vitit 1990. Në të vërtetë, në lidhje me rastin e rrëfimit të thjeshtë pa informacione të tjera të dobishme, mungon kriteri i *efikasitetit* dhe *konkretësisë* në lidhje me rrethanën e mëtejshme të marrjes së “*burimeve rilevante*” (*ex neni 73, paragrafi 7, cit.*) apo “*përcaktuese*” (*ex neni 74, paragrafi 7, cit.*), në kuptimin të *dobishme*, për qëllime të ndërprerjes së qarkut kriminal²⁸⁴ dhe/ose të sigurimit të provave të krimit²⁸⁵.

²⁸⁴ Mbi “interpretimin e qarkut të shpërndarjes së lëndëve narkotike” si efekt i mirëfilltë i pranimit të fajit apo veprime të tjera bashkëpunuese të të pandehurit që gjenden sidomos në Seksionet e Bashkuara të dt.28 tetor 1998, Barbagallo dhe të tjerë, në *Cass.pen.*, 1999, 3079; *këtu*, 2000, 330. Po kështu, sipas Kas., 27 maj 1992, cit.sipër, shënimi 48, “që të kemi një rrethanë lehtësuese *de qua*, është e nevojshme që agjenti të bëjë gjithë sa mund të bëjë për të ndërprerë qarkun e shpërndarjes së drogës, duke treguar vendin e fshehjes së një sasive të konsiderueshme të saj, ku ka akses jo vetëm ai, por edhe persona të tjerë, apo duke treguar emrat e furnitorëve apo blerësve të tij, apo duke dhënë çdo informacion që do shfaqte interes jo të vogël për qëllime të ndëshkimit të veprimtarisë kriminale, si në sektorin e veçantë – pak a shumë të gjerë – ku ai është futur”.

²⁸⁵ Lidhur me këtë pikë, krs. *ex pluribus*, Kas. 24 shtator 2003, Grado e të tjerë, në *Guida dir.*, 2004, n.5, 94. Më së fundi, mbi rrethanën lehtësuese të bashkëpunimit *ex neni 73, paragrafi 7, D.P.R. cit.*, shih Kas. 3 maj 2005, n.28548. Godena e të tjerë, në *C.E.D. Cass.*, n.232435, sipas të cilëve “duhet që kontributi i dhënë nga bashkëpunëtori do të rezultonte konkretisht i dobishëm, pra i tillë që do të përcaktonte në mënyrë të drejtpërdrejtë një përfundim të favorshëm për hetimet dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale lidhur me të”.

Po kështu, në rastin e pranimeve të pjesshme²⁸⁶ apo të përgjithshme²⁸⁷, bashkëpunimi nuk mund të konsiderohet konkret dhe efikas, pra dhe *i dobishëm*, si në planin substancial ashtu dhe mbi atë procedural të sigurimit të provave të krimeve të kryera, për shkak të paplotësisë së vet. Në të njëjtën mënyrë duhet të vlerësohen deklaratat e përgjithshme që, edhe pse jepen në një kontekst plotësie të dukshme, nuk rezultojnë *ab initio* të përshtatshme për të siguruar rezultate konkrete gjatë hetimeve²⁸⁸.

Në të njëjtin përfundim duhet të mbërrijmë kur pranimet e fajit apo deklaratat e lëshuara në një rrethanë bashkëpunimi, do të rezultojnë thjesht si përforcuese të një kuadri provash të plotë nga pikëpamja substancial, në dritën e rezultateve investiguese dhe procedurale të mbledhura nga autoriteti procedues: le të mendojmë këtu për bashkëpunëtorin që u ka dhënë hetuesve emrin e një shpërndarësi që ata e dinin më parë²⁸⁹, apo për rastin kur i

²⁸⁶ Në kuptimin që bashkëpunimi duhet të qëndrojë në një ndihmë “të plotë”, të karakterizuar nga plotësia, të paktën për sa rezulton në dijeni të bashkëpunëtorit, krs. Kas., 13 prill 1999, Lorenzimi, në *Cass.pen.*, 2000, 519. Më së fundi, jurisprudencia (Kas., 30 nëntor 2005, nr.47245, Barbieri, në *C.E.D. Cassl.*, n.233014) ka afirmuar se ulja e dënimit të parashikuar nga neni 73, D.P.R. cit, referuar për një pjesë të fajtorit për të shmangur faktin që krimi të ketë pasojë të mëtejshme, “supozon ekzistencën e një kontributi konkret dhe përcaktues në neutralizimin e dëmeve apo krimeve të reja, apo të një bashkëpunimi me autoritetin që mundëson gjetjen e furnitorëve apo të marrjes së burimeve të konsiderueshme nga trafiku i lëndëve narkotike, në mënyrë që rezultati të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e bashkëpunimit, duke mos bërë pjesë qëndrime që pjesërisht fshehin informacione”. Në thelb, sipas orientimit të vazhdueshëm të jurisprudencës së ligjshmërisë, kontributi bashkëpunues duhet të jetë i qartë, në kuptimin që veprimtaria e deklaruar dhe objektive e bashkëpunimit nuk duhet shoqëruar apo të pasohet nga sjellje që pjesërisht lënë pa thënë apo fshehin qëllimisht të dhëna, kështu që kjo ndihmë do të rezultonte qëllimisht e paplotë (kështu, ndër shumë vendime, Kas., 8 mars 1994, Otalvaro, *C.E.D.Cass.*, n.198515).

²⁸⁷ Lidhur me këtë, krs. Kas., 10 qershor 1999, Morroquin, në *C.E.D., Cass.*, n.215207, lidhur me një rast në të cilin është konsideruar përgjithësia, pra parëndësia e informacioneve të dhëna nga i pandehuri (që ish mjaftuar të jepte dy numra telefoni të kartave me parapagim në zotërim të subjekteve të tjerë të përfshirë në një trafik droge) në mënyrë të tillë që hetimet nuk kanë sjellë rezultate të dobishme për shkak të përgjithësisë së këtyre informacioneve.

²⁸⁸ Për shembull, është mohuar rregullisht nga Gjykata e kasacionit (shih vendimin n.20237, dt. 26 janar 2006, në të cilin droga që i është sekuestruar të pandehurit nuk është gjetur për meritë dhe iniciativë të këtij të fundit”, sa herë që “ndihma e dhënë nga i pandehuri në hetime nuk ka fituar tiparet e kërkuara nga norma (konkretisht, është vënë re se ndihma ka pasur të bëjë me dhënien e emrit të personit që kish dërguar nga Brazili pakon ku gjendej drogën dhe ky informacion nuk ka dhënë asnjë përfitim për qëllime të gjetjes konkrete të përgjegjësve të tjerë kundrejt një trafiku të paligjshëm të njëfarë rëndësie, duke patur parasysh sasinë e përgjithshme dhe sa e pastër është lënda narkotike).

²⁸⁹ Kësaj situatë provuese i referohet Kas. 28 janar 2004, Esentato e të tjerë, në *Cass.pen.*, 2005, 2359 (me shënim të G.AMATO, *Precisazioni* cit.), që saktëso se për qëllime të njohjes

pandehuri është mjaftuar të konfirmojë rrethanat e faktit të referuara nga një tjetër deklarues²⁹⁰, apo për rastin kur bashkëpunëtori ka akuzuar si bashkëfajtorë të tjerë bashkëpunëtorë, të cilët janë identifikuar më parë nga hetuesit që, kanë mbledhur në ngarkim të tyre elementë të rëndësishëm prove²⁹¹.

Si përfundim, mund të bashkëndajmë idenë e shprehur nga doktrina sipas të cilës *ndihma që i jepet autoritetit për marrjen e burimeve relevante* për kryerjen e krimeve të treguara nga neni 73, parag.7, pjesa e dytë, cit., duhet kuptuar se, në respektim të parimeve kushtetuese të lartpërmendura, “bashkëpunimi duhet të ndihmojë mundësisht në parandalimin e krimeve në lidhje me lëndët narkotike, edhe kur nuk përbëjnë zhvillimin e mundshëm të asaj që është kryer apo për të cilën akuzohet, duke favorizuar në këtë mënyrë daljen nga qarku kriminal të personave që merren me kryerjen e krimit të drogës apo të sendeve marrja e të cilave do ta bënte të paktën më të vështirë kryerjen e këtyre krimeve”²⁹².

së rrethanës lehtësuese siç në nenin 73, parag. 7, D.P.R., 9 tetor 1990, n.309, “nuk mjafton të tregohet thjesht emri i ndonjë bashkëpunëtori, por lipset që ndihma të konkretizohet të paktën në një rezultat të dobishëm, në kuptimin që bashkëpunimi i pfruar, në limitet e pozicionit të fajtorit, të shpjerë në marrjen e burimeve dhe të shmangë kryerjen e krimeve të tjera”. Në rastin konkret të marrë në shqyrtim nga Gjykata, e vetmja ndihmë që ofrohet nga i pandehuri qëndronte në dhënien e emrit të një shpërndarësi, që ndër të tjera dihej nga hetuesit.

²⁹⁰ Po në këtë kuptim, në lidhje me rastin kur i pandehuri ish mjaftuar “të konfirmonte” fakte të treguara nga një tjetër bashkëpunëtor, shih Kas., 4 tetor 1999, në *Cass.pen.*, 2000, 3453, me referime të tjera jurisprudenciale, dhe Kas., 27 prill 1999, Zappa, *këtu*, 2000, 519.

²⁹¹ Për parëndësinë, në kuptimin që s’janë të dobishme, e deklaratave të bashkëpunimit që qëndrojnë në tregimin e thjeshtë të sasive të lëndëve narkotike që forcat e rendit do i kishin gjetur dhe sekuestruar sidoqoftë, shih Kas., 27 prill 1999, Cantini, në *Cass.pen.*, 2000, 3452).

²⁹² G.FLORA, *La fattispecie di ravvedimento postdelittuoso* cit., 21-22, që (fq.22) thotë se “në fund të fundit, në nocionin “burime” duhen të përfshihen [...] edhe ato ... njerëzore dhe mbiemri “rilevantë”, që të mos rezultojë krejt i papërcaktuar, duhet parë në kuptimin “jo krejt të vogla”, “të përshtatshme të paktën për të lehtësuar”.”.

§ 5. *Vijon: b) Rrethana lehtësuese e posaçme e bashkëpunimit ex neni 8, d.l. 13 maj 1991, nr.152, i kthyer me ndryshime në ligjin n.203, dt. 12 korrik 1991.*

Thamë më lart se normativa shpërblyese në lidhje me terrorizmin dhe luftën kundër trafikut të lëndëve narkotike, ndonëse në rrafshin e të drejtës penale substanciale bën pjesë në kategorinë dogmatike të *pendimit pas kryerjes së krimit*, mund të duket “eksentrike”²⁹³ në shumë aspekte kundrejt instituteve tradicionale që i gjegjen asaj në kodin penal, sidomos nëse shihet në *ration*-n në të cilën ajo mbështetet. Megjithatë, ndonëse me limite sistematike që rrjedhin nga situata të veçanta të emergjencës kriminale që kanë sugjeruar futjen e saj, mund të vërejmë – të paktën kështu besojmë – se interpretimi, pra zbatimi i kësaj normative, edhe pse shfaq disa aspekte problematike në lidhje me pajtueshmërinë e sistemit të vlerave/parimeve/interesave me rëndësi kushtetuese, nuk i shmanget një “leximi” të orientuar nga pikëpamja kushtetuese, i tillë që e bën të pajtueshme me gjithë sistemin e legjislacionit pjesë e të cilit është bërë.

Duke filluar ng ardhja në fuqi e dekretligjit n.8, të datës 15 janar 1991, konvertuar në ligjin n.82, të dt.15 mars 1991, u përrua një stinë e re për *shpërblyeshmërinë*, duke futur në faza të njëpasnjëshme, disa ndryshime të rëndësishme të sistemit tonë penal, gjyqësor dhe të burgut.

Në fakt në një fazë të parë, u fut me këtë ligj një rregullim organik i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë (që më pas u përmirësuar me ligjin n.45, dt.13 shkurt 2001). Ky *corpus* i ri legjislativ është futur në mënyrë të veçantë një kompleks normativ në lidhje me sekuestrimin e personit me qëllim zhatjeje. Përmbahen në të ndër të tjera *norma të reja penguese* kundër këtij lloji krimi²⁹⁴ – që në atë kohë ish

²⁹³ Këmbëngul veçanërisht në tezën sipas të cilës “Normativa shpërblyese në lidhje me krimin e organizuar përfaqëson hallkën e fundit të një zinxhiri “të emërgjencës” që, duke filluar nga fundi i viteve Shtatëdhjetë, i ka dhënë jetë një sistemi shpërblyes eksentrik ndaj atij të kodit”, S.MOCCIA, *La perenne emergenza*, cit.179 e *passim*.

²⁹⁴ Ndër këto, përveç disa masave me karakter civilist, duhet të kujtojmë (si “nuliteti” apo pavlefshmëria e kontratave të sigurimit” që kanë për objekt, në çdo formë, rrezikun e sekuestrimit të personit me qëllim zhatjeje: shih neni 2 i d.l. n.8, 1991 cit.) dhe dispozitat procedurale (si “sekuestrimi i të mirave të përdorura për të arritur çmimin e shpengimit” *ex neni 1, d.l. cit.*, pagesa e kontrolluar të shpengimit, a autorizuar nga gjyqtari me kërkesë të prokurorit apo vonesën, e vendosur me vendim të prokurorit, e ekzekutimit të sekuestrimit apo arrestimit, e ndalimit apo të një mase tjetër sigurie që duhet kryer ndaj personit të dyshuar), edhe norma të të drejtës substanciale si parashikimi, si vepër më vete penale, e mosdenoncimit të akteve apo fakteve që kanë të bëjnë me krimin, edhe në të mbetur në tentativë, e sekuestrimit të personit me qëllim zhatjeje apo të rrethanave në lidhje me

shumë i përhapur, dhe një “rrethanë lehtësuese e posaçme në rast bashkëpunimi” (neni 6, i d.l. n.8, cit., ndryshuar në rubrikë nga neni 20, parag.1, germa e) ligji 13 shkurt 2001, n.45)m në rastet e sekuestrimit të personi për qëllime terrorizmi apo subversioni (neni 289-bis k.p.) apo të sekuestrimit të personit *ex* neni 630 k.p., përcaktuar në favor të bashkëpunëtorit për krim, edhe në lidhje me kohëzgjatjen e sekuestrimit dhe paprekshmërisë së personit të sekuestruar”. Për këtë, duhet thënë se edhe kjo rrethanë e posaçme e parashikuar në shtesë të rrethanave lehtësuese, edhe ato të posaçme, që rregullohen përkatësisht nga parag.4 i nenit 289-bis, dhe nga parag.4° dhe 5° të nenit 630 k.p., qëndron në brazdën e asaj *shpërblyeshmërie penale* që synon, mbi të gjitha, të forcojë më tej mbrojtjen e të mirave juridike të rrezikuara nga veprimi i paligjshme i parashikuar nga vepra e posaçme inkriminuese, që ka të bëjë me cenimin apo vënien në rrezik të këtyre të mirave.

Në një fazë të dytë, me nenin 8 të d.l. n.152, dt. 13 maj 1991, kthyer në ligjin n.203, të dt. 12 korrik 1991, është futur një parashikim i ri shpërblyes, në formën e rrethanës lehtësuese të posaçme, “për krime siç në nenin 416-bis të kodit penal dhe për ato të kryera duke u mbështetur në kushtet e parashikuara nga neni i mësipërm apo me qëllim që të lehtësohet veprimtaria e organizatave të llojit mafioz”. Në sajë të kësaj dispozite, një ulje e konsiderueshme e dënimit (“dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me atë të burgimit nga dymbëdhjetë deri në njëzet vjet dhe dënimet e tjera ulen nga një e treta në gjysëm”) i lihet “të pandehurit që, duke u distancuar nga të tjerët, përpiqet të shmangë faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasoja të mëtejshme edhe duke ndihmuar konkretisht autoritetin e policisë apo autoritetin gjyqësor në mbledhjen e elementëve përcaktues për rindërtimin e fakteve dhe për zbulimin apo kapjen e autorëve të krimit”. Kjo normë përcakton gjithashtu se në rastin e zbatueshmërisë së rrethanës lehtësuese, “nuk gjejnë zbatim dispozitat e nenit 7” të dekretligjit cit²⁹⁵. Heqja e rregullimit të posaçëm të ekzistencës së rrethanave heterogjene që futet nga neni 7, cit., sjell për rrjedhojë një nënvizim të

kërkesën apo pagesën e çmimit të lirit të personi të sekuestruar, apo të rrethanave të tjera të dobishme për gjetjen apo kapjen e fajtorëve apo për lirimin e të sekuestruarit.

²⁹⁵ Neni 7, i d.l. nr.152, i vitit 1991, rregullon rrethanë rënduese të posaçme që i përkon (në dy format e përdorimit të metodës mafioze dhe të “qëllimit për të lehtësuar veprimtarinë e organizatave” të parashikuara nga neni 416-bis të k.p.) dhe mundësinë e ekzistencës së njëkohshme të kësaj rrethane rënduese me rrethanat lehtësuese, të ndryshme nga ato të parashikuara nga nenet 98 e 114 të kodit penal, duke përcaktuar që këto rrethana lehtësuese “nuk mund të konsiderohen të barazvlefshme apo kryesuese ndaj saj dhe uljet e dënimit bëhen mbi masën e dënimit që rezulton nga shtimi për rrjedhojë i rrethanës së mësipërme rënduese”.

efekteve shpërblyese që lidhen me zbatimin e rrethanës lehtësuese të posaçme që për këtë arsye, do mund të konsiderohet kryesuese ndaj çdo rrethane tjetër rënduese, të zakonshme apo të posaçme.

Në një fazë të tretë, pas masakrave ku humbën jetën Giovanni Falcone dhe Paolo Borsellino, përfitime të reja dhe më të konsiderueshme janë parashikuar në favor të bashkëpunëtorëve të drejtësisë në lidhje me krimin e organizuar, sidomos në fazën e ekzekutimit penal, me futjen e një rregullimi ndryshues absolutisht në favor sidomos të masave në alternativë të asaj të burgimit.

Kritikat më të mëdha që bëhen nga doktrina më e mirë ndaj këtij lloji të strategjisë legjislativë, që mbështetet në njohjen e rrethanës lehtësuese të posaçme të bashkëpunimit *ex neni* 8, i dekretligjit n.152, të viti 1991, cit., mund të përmbledhen si vijon²⁹⁶:

a) ***në planin substancial*** dispozitat e reja shpërblyese do të rezultojnë larg idesë së mbrojtjes së të mirave juridike dhe, meqë premtojnë një përfitim që nuk lidhen me *faktin*, penalisht të rëndësishme, i cili është kryer më parë nga fajtori, do ishin shprehje e “kritereve autoritare të të drejtës penale të autorit, të atij që jep dënime penale në bazë të një gjykimi mbi personalitetin e thjeshtë të subjekti”²⁹⁷; për këtë arsye, ato do qëndronin “jashtë ligjshmërisë së sistemit” meqë do ishin shprehje e “zgjedhjeve legjislativë që lënë në hije plotësisht kërkesat e faktit, edhe në nivel vërtetimi gjyqësor”²⁹⁸;

b) ***në planin e proceseve gjyqësore dhe të vuajtjes së dënimit*** normativa legjislativë në shqyrtim, fryt i një “zgjedhjeje hetimore të dukshme, (ku vihet re një zvogëlim i theksuar i rëndësisë së zbatimit të parimeve të prezantimit verbal të debatit akuzë/mbrojtje), do të shndërronin jo vetëm të pandehurin, por edhe të dënuarin, në “një negociator të fakteve gjyqësore, për të cilat merr premtime dhe shpërblime: një “shitje e mëshirës apo faljes”²⁹⁹ në kuptimin e vërtetë të fjalës, e cila mund të çojë në “mundësinë e kthimit pothuajse të plotë të lirisë, duke i dhënë kështu jetë një lloj shtrëngimi shqetësues ndaj bashkëpunimit”³⁰⁰; sipas këtij opinioni, “kjo lloj normative është shprehje e një marrëdhënieje kontraktore midis Shtetit dhe individit në çështje penale, që jo rastësisht, mbetet jashtë traditës së shtetit të

²⁹⁶ Mendojmë se është e udhës, ndonëse fare shkurt, të sjellim një përmbledhje të kritikave që bëhen ndaj normativë së lartpërmendur shpërblyese, të cilat bëhen me shumë finesë dhe argumentim të mprehtë e të qartë nga S.MOCCIA, *La perenne emergenza*, cit., 175.193.

²⁹⁷ Në këtë kuptim, *Aut.dhe vep.cit.fundit*, 184.

²⁹⁸ *Aut. dhe vep. cit. fundit*, 185.

²⁹⁹ *Aut. dhe vep. cit. fundit*, f.177

³⁰⁰ *Aut. dhe vep. cit. fundit*, f.181

të drejtës për shkak të mospajtueshmërisë së saj me vlerat që ky i fundit përmbledh, e në mënyrë të veçantë me të drejtën penale të faktit³⁰¹; nga ana tjetër, gjatë zhvendosjes së “vendit në të cilin vendoset fati i të pandehurit nga procesi gjyqësor në fazën që e paraprin atë, apo në fazën e ekzekutimit të dënimit³⁰², do të krijohej, nga njëra anë, një model procesi gjyqësor “i llojit policor” me përhapjen paralele të një *forma mentis* që çon në padënueshmëri të mundshme³⁰³, dhe nga ana tjetër, në mosrespektimin e qëllimeve të dënimit të parashikuara nga Kushtetuta jonë (neni 27, paragrafi 3, Kusht.). Dhe në të vërtetë, neni 58-ter i legjislacionit mbi vuajtjen e dënimit, modifikuar në nenin 1 paragrafi 1 i ligjit nr. 203 viti 1991, ndërsa lejon një zbatim të gjërë të benefiteve të vuajtjes së dënimit për bashkëpunëtorët e drejtësisë³⁰⁴, vetëm për faktin se këta janë bindur të japin

³⁰¹ Shprehur kështu, *Aut. dhe vep. cit. fundit, f.182*

³⁰² *Aut. dhe vep. cit. fundit, f.1178-179*

³⁰³ *Aut. dhe vep. cit. fundit, f.179*

³⁰⁴ Neni 58-ter i Legj. për vuajtjen e dënimit, në tekst rezultoi i modifikuar nga ligji nr. 45 datë 13 shkurt 2001, riprodhon pak a shumë të plotë, paradigmen ligjore të rrethanave lehtësuese të posaçme të parashikuara nga neni 8, dekret-ligji nr. 152, viti 1991 cit. duhet theksuar gjithashtu që, nga krahasimi i dy normativave shpërblyese, del se në dispozitat e vuajtjes së dënimit: 1. nuk citohet “distancimi”, I cili parashikohet në nenin 8 cit. (“...duke u distancuar nga të tjerët”); 2. ndaj personave që, edhe pas dënimit, kanë bashkëpunuar me drejtësinë në një nga mënyrat e përshkuara nga vetë neni 58-bis, me qëllim lejimin e benefiteve të punës në ambiente të tjera (ish neni 21, legjisl. i vuajtjes së dënimit), të lejeve dhënë më qëllim shpërblyes (ish neni 30-ter, paragrafi 4, Legjisl. Vuajtjes dënimit), të gjendjes gjysëm të lirë (ish neni 50, paragrafi 2, Legjisl. Vuajtjes dënimit) nuk vlejné kufizimet e dënimit të parashikuara për “ persona të dënuara për ndonjë nga krimet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 4-bis” (që përcaktohen, pas ndryshimeve në nenin 4-bis Legjisl. Vuajtjes dënimit në ligjet nr. 279 datë 23 dhjetor 2002 dhe nr. 38 datë 6 shkurt 2006, në veprat e mëposhtme penale: “krime të kryera për qëllime terrorizmi edhe ndërkombëtar, apo të prishjes së rendit demokratik përmes kryerjes së akteve të dhunës, krim i parashikuara në nenin 416-bis të kodit penal, krim i kryer sipas kushteve të parashikuara në të njëjtin nen apo me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së bahkëpunimit, të parashikuara në të, krime të parashikuara në nenet 600, 601, 602 dhe 630 të kodit penal, 291-quarter të tekstit themelor të dispozitave legjislativë mbi çështjet doganore, parashikuara në dekretin e presidentit të Republikës nr. 43 datë 23 janar 1973 dhe nga neni 74 i tekstit themelor të ligjeve mbi lëndët narkotike dhe psikotrope, parandalimi, kurimi dhe rehabilitimi i gjendjeve të varësisë nga këto substanca, parashikuara nga dekreti i Presidentit të Republikës nr. 309 datë 9 tetor 1990; po ashtu edhe veprat penale të parashikuara e dënuara nga nenet e mëposhtme: “neni 575, 600-bis, paragrafi i parë, 600-ter, paragrafi i parë dhe i dytë, 600-pestë, 609-bis, 609-ter, 609-katër, 609-octies, 628, paragrafi I tretë, dhe 629, paragrafi I dytë, të kodit penal, neni 291-ter të tekstit themelor të sipërpërmendur sipas dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309 datë 9 tetor 1990, bashkë me mundësinë e fakteve rënduese sipas nenit 80, paragrafi 2, të të njëjtit tekst themelor, neni 416 të kodit penal, realizuar me qëllim kryerjen e veprave penale sipas Librit II, titulli XII, kapitulli III, pjesa I, në të njëjtin kod, nga nenet 609-bis, 609-ter, 609-quarter, 609-octies të kodit penal

deklarata me qëllim bashkëpunimi, pavarësisht nga çfarëdo lloj pendese ose, të paktën, për shkak të një futjeje serioze në rrugën e integritit shoqëror, do të çonte në “mosplotësimin e qartë të kërkesave edukuese të dënimit”.

Aq më pak, nga ana tjetër, sipas kësaj rryme të besueshme mendimi, duhet lënë pas dore *vulnus-i* i rëndë që do të rridhte nga parimi i barazisë (neni 3, Kusht), gjithmonë nëse, "pas shkëputjes së mekanizmave shpërblyese nga realizimi i funksioneve të dënimit, shtrohet problemi i trajtimit të autorëve të veprave penale me të njëjtën rëndësi, të cilët mbeten jashtë kontekstit të krimit të organizuar e të cilët, duke mos pasur asgjë për të rrëfyer veç krimeve të tyre, pikërisht pse nuk kanë qenë mafiozë apo kamorristë, nuk do të mund të gëzojnë të njëjtat benefite, në rastin që do të pendohen"³⁰⁵.

Mund të biem dakord për sa i përket pohimit sipas të cilit, deklaratimet me qëllime kritike, nganjëherë të justifikuar nga *përdorimi i pavend* i bashkëpunëtorëve të drejtësisë në fazën e hetimeve paraprake dhe, mbi të gjitha, në atë të gjyqimit (të paktën deri në ndryshimet e fundit të kodit të procedurës penale të diktuar nga normat e reja mbi një *procesi gjyqësor të drejtë*), paraqesin aspekte të një besueshmërie të palëkundshme, sidomos për sa i përket domosdoshmërisë së një ballafaqimi të vazhdueshëm të legjislationit shpërblyes me parimet kushtetuese, me vëmendje të veçantë – duhet pranuar – ndaj parimeve të ligjshmërisë, materialitet-ofensivës, barazi-arsyeshmërisë, riedukim të dënimit.

E megjithatë, përpara se të nxjerrim jashtë sistemit tonë penal, substancial, gjyqësor dhe të vuajtjes së dënimit këto dispozita shpërblyese, për shkak të mosrespektimit të kushtetutës, duhet bërë edhe një përpjekje tjetër për interpretimin e tyre, duke verifikuar nëse ato lejojnë leximin e tyre sipas parimeve të mësipërme kushtetuese.

Në planin e racionalitetit logjik dhe faktik të zgjidhjeve legislative (në kuptimin e arsytimit të saj mjaft të ndërlikuar, e cila lidhet edhe me

dhe ng neni 12, paragrafët 3, 3-bis e 3-ter të tekstit themeltar të dispozitave mbi çështjet e emigracionit dhe normat mbi gjendjen e të huajve, parashikuar në dekretin legjislativ nr. 286 datë 25 korrik 1998 (bëhet fjalë, ndër të tjera, për vepra penale për të cilër ndalohet sidoqoftë në mënyrë absolute lejimi I benefiteve gjatë vuajtjes së dënimit mbi caktimin e punës në ambiente të jashtme, të lejeve shpërblyese dhe të masave të tjera veç burgosjes, me përjashtim të lirimimit të parakohshëm, kur, për veprat penale të grupit të parë, nuk “janë përfutuar elementë të tillë që të mund të përjashtohet ekzistenca e lidhjeve aktuale me krimin e organizuar, me terrorizmin apo atë të prishjes së rendit”, apo, për veprat penale të grupit të dytë, kur “ka elementë të tillë që provojnë ekzistencën e lidhjeve me krimin e organizuar, me terrorizmin apo rendprishjen”).

³⁰⁵ *Aut. dhe vep. cit. fundit, f.188.*

përshtatshmërinë dhe efikasitetin potencial me qëllim shtypjen e dukurive të krimit të organizuar të tipit mafioz, marrë veçanërisht në konsideratë nga legjislacioni shpërblyes), mjafton të përmenden konsideratat e mësipërme në lidhje me zgjidhjet e ngjashme legjislative të ndërmarra në çështje të terrorizmit. Këtu do të mjaftonte të vihej re, në lidhje me përshtatshmërinë e normave të mësipërme shpërblyese, që kanë lidhje qoftë me çështje të rrëmbimit të personave me qëllime përfitimi, qoftë me atë të “luftës” kundër kriminalitetit mafioz, që ato kanë qenë të përshtatshme për qëllimin të cilin ligjvënësi i kishte vënë vetes: me gjithë kufizimet e tyre, legjislacioni shpërblyes dhe normat e tjera pengesë në çështjet e rrëmbimit të personave kanë lejuar asgjësimin pothuajse të plotë të dukurisë³⁰⁶, ndërsa legjislacioni shpërblyes mbi bashkëpunëtorët e drejtësisë ka dhënë mundësinë të kryhet një kthesë në luftën kundër krimit të organizuar, të paktën në planin e luftës kundër të ashtuquajturit *krahut ushtarak* të organizatave mafioze.

Me gjithë kufizimet që lindin natyrshëm në të njëjtit legjislacion penal, çdo herë që ai pretendon të rregullojë dukuri të tilla komplekse si *mafia* (në kuptim figurativ), nuk ka dyshim që legjislacioni shpërblyes mbi bashkëpunëtorët e drejtësisë projektohet në mbrojtjen e të mirave/interesave me rëndësi kushtetuese (mendoni për rendin publik të brendshëm, mbi të cilin mbështetet gjithë sistemi juridik, për dinjitetin e njeriut, për lirinë individuale dhe të shoqërisë, për shprehjen e lirë të mendimit, për mbrojtjen e punës, për ushtrimin e lirë të së drejtës së votës, etj) që *mafia* ka për qëllim të marrë nëpër këmbë dhe të kushtëzojë, duke përdorur forcën frikësuese të lidhjes në organizata dhe të gjendjes së shtypjes e të heshtjes së qëllimshme që rrjedh prej saj. E njëjta doktrinë që ka shprehur kritika të ashpra dhe rezerva ndaj legjislacionit shpërblyes, nuk ka përjashtuar faktin që, nga përdorimi i tij “mund të vijnë efekte të qarta substanciale deri edhe në çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pasurisë juridike, në kuptimin e shkatërrimit të mundshëm të organizatës kriminale dhe të pamundësisë nga ana e të dënuarit të hyjë përsëri brenda saj”³⁰⁷.

³⁰⁶ U referohemi kryesisht rrëmbimit të organizuar të personave që drejtohen drejtpërdrejt nga krimi i organizuar i llojit mafioz dhe, pikërisht, nga *‘ndrangheta*. Aktualisht kjo dukuri paraqitet me karakteristika të ndryshme (c.d. *sequestrim i rrufeshëm*), krejt të ndryshme nga ato që, mes viteve ’70 dhe fundit të viteve ’80, kishin shënuar në mënyrë të trishtë format kryesore të manifestimeve (robërim i gjatë e, nganjëherë, vrasje e pengjeve, traktativa me ndërmjetës, pagesë e shumave të mëdha si shpërblim, pamundësi absolute për të hyrë në organizatat kriminale që drejtonin rrëmbimin).

³⁰⁷ Kështu S.MOCCIA, *La perenne emergenza* cit., f. 186, I cili sidoqoftë vë re që “ duhet theksuar mirë fakti që rëndësia e sjelljes me qëllim bashkëpunimin - dhe kjo duket qartë në normativën mbi vuajtjen e dënimit – shprehet edhe gjatë procesit”.

Kështu që, ky legjislacion, edhe pse paraqet aspekte kufizuese në krahasim me disiplinën e përgjithshme të së drejtës së përbashkët (mendoni për ndarjen e saj në sektorë dhe veçantësinë e regjimit sanksionues), nuk është në kundërshtim me parimin kushtetues të arsyeshmërisë, i cili i referohet përdorimit të duhur të diskrecionit politik të ligjvënësit (duhet vlerësuar tani, jo vetëm në mënyrë abstrakte, *ex ante*, por edhe e sidomos konkretisht, *ex post*, nën dritën e rezultateve të arritura nga e njëjta disiplinë shpërblyese).

Pas këtij saktësimi paraprak, nuk mund të mendohet në asnjë mënyrë që legjislacioni në shqyrtim paraqet një *vulnus* ndaj parimit të barazisë, ish neni 3 Kusht.: të gjithë ata që kanë ndër mend të bashkëpunojnë me drejtësinë kanë, në situata të ngjashme, të njëjtën të drejtë për të përfituar nga benefitet shpërblyese. Kësaj i shtohet edhe fakti që, pas ndryshimit të paragrafit 1 të nenit 4-bis të legjislacionit mbi vuajtjen e dënimit, zëvendësuar në mënyrë të plotë nga neni 1 i ligjit 279³⁰⁸, dt.23 dhjetor 2002, u zhduk një mundësi pabarazie në trajtim mes situatave të barazueshme (edhe në perspektivën e përbashkët që lidhet me funksionin riedukues dhe atë të integritetit të të dënuarit në shoqëri), duke e pranuar të dënuarin në benefitet e vuajtjes së dënimit edhe në situatat ku pjesëmarrja e kufizuar në krim apo prova e plotë e fakteve dhe përgjegjësi e bën sidoqoftë të pamundur një bashkëpunim me drejtësinë. Po ashtu, nuk mund të konsiderohet si i prekur parimi kushtetues në fjalë, nën profilin arsyeshmëri/proporcionalitet, meqenëse legjislacioni shpërblyes në shqyrtim, edhe pse paraqet aspekte të rëndësishme kufizuese, sidomos për sa i përket ekzekutimit të dënimit dhe benefitet e vuajtjes së dënimit, nuk ofron rrugë shpëtimi dhe garanci për pacenueshmëri, por vetëm një trajtim penal të diferencuar, gjë që e tërheq mjaft përfituesin e mundshëm sa të gjejë justifikim të gjerë, në nivelin e parimit kushtetues arsyeshmëri/proporcionalitet, nëse ky lidhet me “nevojën për të luftuar krimin e organizuar, agresiv e të përhapur”, e që vlerësohet, edhe pse në tjetër aspekt, nga Gjykata Kushtetuese për të justifikuar zgjedhjet e ligjvënësit për sa u përket këtyre çështjeve³⁰⁹. Duhet mbajtur gjithashtu parasysh, me qëllimin që të vlerësohet raporti racionalitet/proporcionalitet (në krahasim me qëllimet që kanë të bëjnë me parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm) të regjimit të diferencuar që futet nga këto norma shpërblyese, që, nëse nga njëra anë, statusi si bashkëpunëtor i drejtësisë, ish neni 58-ter Legjislacioni i Vuajtjes së dënimit, lejon të kapërcehen pengesat dhe kufizimet e dënimit, me qëllim dhënien e

³⁰⁸ Kjo dispozitë ka përfutur përmbajtjen e vendimeve të Gjykatës kushtetuese nr.357, viti 1994, dhe n.68, viti 1995.

³⁰⁹ Krs. Gjyq.Kusht., 8 korrik 1993, nr.306, cit. *supra*, shënimi 38.

benefiteve të vuajtjes së dënimit sipas nenit 4-bis të Legjis. Vuajtjes Dënimit, nga ana tjetër, ky status nuk përjashton mundësinë e revokimit të këtyre benefiteve, në rastet e parashikuara në mënyrë të përgjithshme nga Legjis. Vuajtjes Dënimit (për kujdestarinë në provë në shërbimet shoqërore: neni 47, paragrafi 11; për arrest shtëpie: neni 47-ter, paragrafët 6,7,8,9 dhe 9-bis; 47-quater, paragrafët 6 dhe 7; për gjendjen gjysëm të lirë: neni 51; dhe më në përgjithësi, për sa i përket ndalimit të dhënies së benefiteve dhe revokimit të benefiteve të punës në ambiente të jashtme, të lejeve shpërblyese dhe të masave të tjera veç burgimit, të parashikuara në Kapitullin IV të Legjis. Vuajtjes Dënimit, edhe ndaj të dënuarve për një nga veprat penale të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 4-bis, shih neni 58-quater, paragrafi 5).

Nën një tjetër aspekt, kritikata në lidhje me ekzistencën e një shmangieje të mundshme të hetimit e lidhur me legjislacionin shpërblyes, duhet të rishikohen edhe njëherë në këndvështrimin e ndryshimeve të fundit të kodit të procedurës penale, ndryshime të cilat janë bërë për shkak të zbatimit të parimit të *procesit gjyqësor të drejtë*, me vëmendje të posaçme ndaj vlerave të vetë deklarimeve që i pandehuri për vepra penale të lidhura ka bërë përpara prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, për rënien e tyre të mundshme në kontradiktë gjatë procesit, qoftë nëpërmjet riprodhimit të proces verbaleve përkatës, ashtu edhe nëpërmjet mekanizmit të kundërshtimit si dhe kritereve të vlerësimit të vetë deklaratave me qëllim marrjen e vendimit.

Me sa duket, duhet përjashtuar fakti që legjislacioni shpërblyes bie në konflikt me parimet kushtetuese që përcaktojnë funksionin e dënimit (ish neni 27 Kusht.). Për këtë qëllim, hyn në punë orientimi i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese i përmendur më sipër³¹⁰, sipas të cilit, mungesa e arbitraritetit dhe, si pasojë, përdorimi i duhur i diskrecionit politik të ligjvënësit, edhe në profilin e arsyeshmërisë, duhet vlerësuar duke marrë parasysh mbizotërimin e funksioneve të dënimit të parashikuar nga neni 27 Kusht., ndaj “qëllimeve të parandalimit të përgjithshëm dhe të sigurisë së komunitetit, duke i dhënë avantazhe të caktuara të burgosurve që bashkëpunojnë me drejtësinë”³¹¹.

Mbetet për t’u vlerësuar, në fund, çështja që ka lidhje me mungesën e kufizimeve kohore të parashikuara për zbatimin e legjislacionit shpërblyes. Siç e kemi thënë, mospërcaktimi i këtyre kufizimeve, do të mundte, në rastin e një ndërprerjeje të situatës emergjente kriminale, të hidhte poshtë

³¹⁰ Shih *supra*, shënimi 38.

³¹¹ Shih *supra*, shënimi 38.

ligjshmërinë kushtetuese të legjislacionit shpërblyes, për shkak të mungesës së kërkesës racionalitet/proporcionalitet të vetë legjislacionit shpërblyes, në krahasim me mbrojtjen e të mirave/interesave me karakter kushtetues që ajo merr përsipër të zbatojë, duke kufizuar parimet e përgjithshme të sistemit penal, gjyqësor dhe atyre të vuajtjes së dënimit. Për këtë qëllim, duke lënë mënjanë çdo aspekt tjetër në lidhje me rëndësinë e domosdoshmërisë së respektimit të kriterit kohor të normës shpërblyese, mjafton të vihet re që aktualisht nuk ka rënë aspak, madje është rritur, nevoja e jashtëzakonshme për ruajtje të rendit publik të brendshëm dhe të lirive individuale që sulmi i tmerrshëm i viteve '90 të shekullit të kaluar, i kryer nga e ashtuquajtura Mafia historike (*cosa nostra*, *'ndrangheta*, *camorra*, *sacra corona unita*) e që gjeti kulmin e tij me masakrat, i kishte dhënë rëndësinë më të madhe. Madje, pas *fundosjes së Mafias*, që u pasua nga përfitimi i një strategjie kriminale me profil (në dukje) të ulët, vihet re ende sot nevoja për të kapërcyer murin e heshtjes mafioze për të nxjerrë më në fund, nga brendësia, strukturën aktuale, organizative dhe logjistike, strategjitë kriminale, sidomos në planin ekonomik-financiar, aftësinë për t'u futur në organizmat politike dhe administrative të Shtetit dhe niveli i kushtëzimit kriminal të ushtruar nga e ashtuquajtura *mafia sipërmarrëse* ndaj biznesit të lirë. Edhe nën këtë profil, nuk duket se ka dyshime mbi arsyeshmërinë e opsionit shpërblyes në kushtet e një emergjence kriminale të zgjatur në kohë, që akoma sot karakterizon sistemin penal të luftës kundër krimit të organizuar të tipit mafioz.

Pasi i zgjidhim dyshimet e mundshme mbi kushtetueshmërinë e legjislacionit shpërblyes, duhet verifikuar gjithashtu edhe rëndësia e interpretimit të tyre sipas këndvështrimit të pozicioneve më domethënëse të ndërmarra nga doktrinën dhe nga jurisprudenca.

Ndërkaq, duke lënë mënjanë, për arsye kohe e vendi, analizën e thelluar të dispozitave shpërblyese sipas nenit 6, dekreti ligjor nr. 8 viti 1991 (në lidhje rrëmbimin e personave me qëllim përfitimi), nuk mund të na shpëtojë fakti që formulimi i nenit 8 të dekretit ligjor nr.152 viti 1991, shtron probleme interpretimi, pjesa më e madhe të cilëve janë të njohura dhe zgjidhur nga jurisprudenca e cila, ishte marrë edhe më parë me *ration-n* dhe me rëndësinë e zbatimit të formulave të ngjashme ligjore, në plotësim të fakteve të pavarura shpërblyese.

Duhet theksuar, gjithashtu, që, ndër elementët e përbashkët me fakte të tjera shpërblyese, dispozita (neni8,cit.) që ka parashikuar këtë rrethanë të posaçme lehtësuese kërkon:

1. që i pandehuri të marrë një qëndrim të qartë distancues nga organizatat e llojit mafioz apo nga veprimtaria kriminale e bashkëfajtorëve të tjerë, në rastin kur krimi është kryer duke shfrytëzuar kushtet e parashikuara në nenin 416-bis K.penal., apo me qëllimin që të lehtësohet veprimtaria e organizatave mafioze³¹², duke u distancuar nga të tjerët” (bashkëfajtorë të mundshëm e/o të domosdoshëm); bëhet fjalë për një kërkesë të përbashkët me të tjera fakte të ngjashme shpërblyese³¹³, përkufizimi i saktë i së cilës, në mungesë të çfarëdolloj saktësimi ligjor, i është besuar përpunimit të doktrinës dhe të jurisprudencës;

2. që ai të përpiqet për të “shmangur faktin që veprimtaria kriminale të ketë pasoja të mëtejshme edhe duke ndihmuar konkretisht autoritetet policore apo gjyqësore për mbledhjen e elementëve vendimtare për rikrijimin e ngjarjes, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorëve të krimit”: formula legjislativë prek të njëjtin parashikim që përmban edhe neni 73, paragrafi 7, DPR, nr. 309 – nga shprehja “shfrytëzon” deri te fjalët “autoritet gjyqësor” – duke bërë ndryshim vetëm për përcaktimin e objektit të ndihmës së dhënë “autoriteteve”;

3. që objekti i ndihmës – parashikuar në termat e lejm/shpjegimit (siç e tregon edhe përdorimi i lidhëzës “edhe”) ndaj veprimtarisë themelore, e rëndësishme për sa i përket profilin shpërblyes, të përpiqet për të mos lejuar veprimtarinë kriminale të ketë pasoja të mëtejshme – të ketë një objektiv të dyfishtë konkret: “mbledhjen e elementëve vendimtarë”.

a) “për rikrijimin e ngjarjes, dhe

b) për identifikimin apo kapjen e autorëve të krimeve”: një formulë kjo që sjell, të paktën në pjesën e dytë, të njëjtën formulë të përdorur nga neni 4, dekreti ligjor nr. 625 viti 1979 (“...ndihmon konkretisht autoritetet e policisë dhe ato gjyqësore për të

³¹² Sipas jurisprudencës së ligjshmërisë (shih Kas. 11 mars 1997, Santise, në C.E.D. Kas. nr. 207818), “mungesa e një kundërshtimi formal i rrethanës rënduese sipasnenit 7 të dekretit ligjor nr.152 datë 13 maj 1991, konvertuar në ligjin nr. 203 datë 12 korrik 1991, (...) nuk pengon zbatimin e rrethanës së posaçme lehtësuese, sipas nenit 8 të të njëjtit ligj”.

³¹³ Shih, p. sh.: neni 4, dekreti ligjor nr. 625 datë 15 dhjetor 1979, në lidhje me organizatat terroriste, cit. *supra*, shënimi 28; neni 1, ligji nr. 34 datë 18 shkurt 1987 i cili, duke iu referuar veprave penale të terrorizmit dhe të shkeljes së kushtetutës, sjell një përkufizim të qartë ligjor të sjelljes së “veçimit nga organizata” (shih *supra*, shënimi 32); neni 6 i dekretit ligjor nr. 8, datë 15 janar 1991, konvertuar me ndryshim në ligjin nr. 82 datë 15 mars 1991 (aty ku i referohet “kontributit të dhënë nga bashkëpjesëmarrësi në veprën penale i shkëputur nga të tjerët...”, cit.*supra*. Nuk kërkohet shprehimisht kriteri i “veçimit” nga dispozitatat shpërblyese në lidhje me trafiqet e paligjshme të lëndëve narkotike e psikotrope (nenet 73, paragrafi 7, dhe 74, paragrafi 7, d.P.R. nr. 309 viti 1990).

mbledhur provat vendimtare për identifikimin apo kapjen e bashkëfajtorëve...”), për ngjashmërinë e dukshme mes veprave penale ku ndërftuen rrethanat përkatëse zbutëse *shpërblyese*.

Ky saktësim me karakter semantik, na lejon të vazhdojmë më të sigurt në interpretimin e dispozitës shpërblyese, që këtu është zbërthyer sipas elementëve të saj përbërës. Do të mjaftonte në fakt, t’i drejtohem orientimeve të jurisprudencës, të cituara më parë, në lidhje me interpretimin e disa shprehjeve (si përdorimi i fjalëzës “edhe” me kuptim lejues/shpjegues, apo të ndajfoljes *konkretisht*, për të theksuar konkretësinë e efikasitetit të ndihmës së dhënë); apo konceptesh (si ai i të përpjekurit) të përdorura nga ligjvënësi për të përcaktuar mundësinë e veprimit të fakteve të ngjashme shpërblyese.

Ndonjë saktësim tjetër, megjithatë, do të ishte i nevojshëm për të përkufizuar më mirë konceptin e “distancimit”, me referim veprave penale të parashikuara në pjesën e parë të nenit nr. 8 të dekretit ligjor nr. 152 viti 1991 cit.

Duke iu referuar një organizate të tipit mafioz e/o veprave penale të kryera me anë të metodave mafioze, ose e thënë ndryshe me qëllimin e posaçëm për të favorizuar organizatën sipas çka parashikohet në nenin 416-bis, K. Penal, shprehja “duke u distancuar nga të tjerët” mund të marrë, në rastin e parë, kuptimin e largimit përfundimtar nga organizata kriminale, duke zgjidhur kështu në mënyrë të pashmangshme lidhjen me organizatën për shkak të prishjes së *pactum sceleris* me bashkëfajtorët³¹⁴ (e shprehur edhe *per facta concludentia*); sigurisht, për natyrën konkrete që karakterizon legjislacionin shpërblyes, ky “distancim” nuk duhet kërkuar vetëm në *forumin e brendshëm* të anëtarit në organizatë, por duhet të përkthehet në forma të sjelljes konkrete. Të njëjtën renditje idesh kishte marrë parasysh ligjvënësi gjatë *viteve të plumbit*, atëherë kur mendoi se ishte e domosdoshme të shpjegonte qartë, për sa i përket veprave penale të terrorizmit dhe prishjes së rendit demokratik, përkufizimin ligjor të “sjelljes me qëllim shpëputjen” parashikuar nga neni 1 i ligjit nr. 34 viti 1987. Në vazhden e këtyre udhëzimeve ligjore, të pasuruara nga të dhëna të tjera që

³¹⁴ Për këtë pikë, shih C.MARINELLI, *Crimine organizzato: doppio binario cautelare e diritto premiale*, në Kas. Pen. 2001, f. 945. duhet theksuar për këtë qëllim, që prova e shpëputjes së lidhjes me organizatën mund të ketë rëndësi edhe në planin gjyqësor, me vëmendje të veçantë ndaj kapërcimit të rrezikshmërisë së presumuar, diktuar nga neni 275, paragrafi 3, K.p.p.: krs. 8 shkurt 1995, Bonventre, në *Mass.Kas. Pen.*, 1995, fash. 8, f. 97, sipas të cilit ky presumim mund të quhet i kapërcyer vetëm “kur provohet që pjesëmarrësi në organizatë I ka prerë përfundimisht lidhjet me organizatën kriminale”.

rrjedhin nga paradigmat e neneve 416-bis K.Penal dhe nr. 7 të dekretit ligjor nr. 152 viti 1991, mund të pohojmë, pa asnjë dyshim, që *distancimi* nga organizata kriminale të llojit mafioz e/o nga veprat penale me karakter mafioz (me rrethana të rënduara sipas ish nenit 7 cit. fundit, ose, sidoqoftë, të kryera me metoda e/o për qëllime mafioze) duhet të konkretizohen, përveçse – duke iu rikthyer qëllimit të tyre – në zgjidhjen e lidhjes mafioze edhe:

- në pranimin e veprimtarisë kriminale të kryer nga subjekti brenda organizatës kriminale mafioze apo si bashkëpunëtor në vepra penale me karakter mafioz;
- në mbajtjen e qëndrimeve objektive në mospërputhje të plotë me vazhdimësinë e lidhjes me organizatën;
- në mohimin e plotë e të pakthyeshëm të *metodës mafioze*, siç rezulton nga përshkrimi i paradigmave të normave të sipërpërmendura, gjë që sjell si rrjedhojë heqjen dorë nga heshtja e qëllimshme dhe nga qëndrimet e përdorimit të kanosjes nga ana e organizatës si dhe e gjendjes së nënshtrimit që vjen si pasojë edhe e vetë heshtjes së qëllimshme.

Megjithatë, distancimi nga organizata në vetvete nuk mjafton për të plotësuar paradigmen e rrethanës lehtësuese³¹⁵. Siç është theksuar kohët e fundit në jurisprudencë, zbatueshmëria e kësaj të fundit nuk mund të varet nga një qëndrim i qartë pendimi³¹⁶, nga rrëfimi i përgjegjësive të veta apo nga tregimi i fakteve dhe rrethanave jo shumë të rëndësishme për qëllimet e hetimit e të gjykimit³¹⁷. Me fjalë të tjera, distancimi nga organizata kriminale duhet të konsistojë në “kryerjen e një veprimtarie të kundërt me atë të bashkëpunimit, në dhënien e kontributit konkret të mbrojtjes së shoqërisë nga organizata kriminale”³¹⁸. Nga kjo rrjedh që një mohim i thjeshtë i organizatës mafioze apo i metodës kriminale që ajo përfaqëson, në lidhje me çdo shprehje tjetër pendimi apo shkëputjeje, edhe të rëndësishme për kontekstin e veçantë kulturor mafioz, nuk mund të ketë asnjë rëndësi për

³¹⁵ Shih Kas. 23 janar 1997, Settineri e të tjerë, në C.E.D. Kas. nr. 207123, sipas të cilit, për pranimin e trajtimit shpërblyes, nuk është e mjaftueshme shkëputja në terma të përgjithshëm, por është e nevojshme një sjellje aktive për dhënien e një kontributi konkret e domethënës për hetimin, vendimtare për rikrijimin e ngjarjeve dhe kapjen e bashkëfajtorëve.

³¹⁶ Krs. Kas., 13 dhjetor 2006, Cirillo e të tjerë, në C.E.D., Kas. nr.236230.

³¹⁷ Krs. Kas., 4 korrik 1997, Cariolo e të tjerë, në C.E.D., Kas. 2 nr.08579.

³¹⁸ Kas., 27 prill 2001, Riina S. e të tjerë, në C.E.D., Kas. nr.219436.

konfigurimin e rrethanës lehtësuese të bashkëpunimit me drejtësinë³¹⁹. Për këtë qëllim, është përjashtuar rrethana lehtësuese në fjalë në favor të të pandehurit, i distancuar nga organizata kriminale të llojit mafioz, i cili, edhe duke pasur mundësinë, nuk ka pranuar të japë të dhëna mbi identitetin e bashkëpunëtorëve të tij, duke u mjaftuar me një apel për braktisjen e veprimtarisë kriminale³²⁰.

Duke thënë këtë, mbetet për t'u sqaruar kuptimi i përpjekjes për mbledhjen e elementëve *vendimtarë* për rikrijimin e ngjarjeve dhe për identifikimin ose kapjen e autorëve të veprës penale”.

Për sa i përket termit “*vendimtar*”, po i lejojmë vetes t’ia lëmë këtë çështje zgjidhjes hermeneutike të përdorur në lidhje me interpretimin e një përcaktimi të ngjashëm qoftë mbi “provat” “për identifikimin dhe kapjen e bashkëfajtorëve” për veprat penale të terrorizmit (shih neni 4 dekreti ligjor nr. 625 viti 1979 cit.), qoftë “burimet” për kryerjen e veprave penale që kanë lidhje me lëndët narkotike. Në thelb, “elementët” e mbledhur duhet të rezultojnë konkretisht, pra në përfundim të një gjykimi *ex post*, cilësisht përcaktues për rikrijimin e ngjarjeve dhe për identifikimin apo kapjen e autorëve të veprës penale, në kuptimin që, pa këto elementë, nuk do të ishte e mundur të arrihej rezultati përfundimtar i parashikuar me ligj³²¹. Karakteri “*vendimtar*” dhe përcaktues i kontributit bashkëpunues, duhet përjashtuar kur ai ndërhyr në një kuadër provash i cili kishte bërë të mundur më parë identifikimin apo kapjen e bashkëpunëtorëve në krim³²².

Përdorimi i lidhëzës “dhe” që lidh dy qëllimet e ligjit, na shtyn të mendojmë që këto qëllime janë edhe kriteret interpretuese plotësuese për të vlerësuar karakterin *vendimtar* të elementëve në fjalë. Nga kjo rrjedh që të dyja objektivat e mësipërme (pra “rikrijimi i ngjarjeve” dhe “identifikimi” apo “kapja e autorëve të krimin”) duhet të realizohen konkretisht apo, të paktën, elementët e mbledhur duhet të jenë të përshtatshëm konkretisht, për arritjen e këtij qëllimi të dyfishtë: është plotësisht e qartë, në fakt, që ndërkaq mund të justifikohet, edhe nën profilin e aryeshmërisë/proporcionalitetit (ish neni 3 Kusht.), një ulje e dënimit me peshë kaq të madhe (siç është ai i përcaktuar nga neni 8 i dekretit ligjor nr. 152, cit.), i

³¹⁹ Krs. Kas. Cit. fundit.

³²⁰ Kas., 19 janar 1998, Moccia, në C.E.D., Kas. nr. 209577.

³²¹ Krs. Kas., 7 tetor 1996, Giuliano e të tjerë, në C.E.D., Kas. 205915, sipas të cilit “neni 8 I dekretit ligjor nr. 152 date 13 maj 1991, konvertuar në ligjin nr. 203 datë 12 korrik 1991, konfiguror një rrethanë lehtësuesë të posaçme arsyeja e ekzistencës të së cilës është një sjellje active nga ana e të pandehurit për dhënien e një kontributi konkret e domethënës mbi hetimet, **përcaktues** për rikrijimin e ngjarjeve dhe kapjen e bashkëfajtorëve”.

³²² Krs. Kas.cit. fundit.

aftë të fshijë, në mënyrë domethënëse, deri edhe efektin e burgimit të përjetshëm, meqenëse sjellja e *shpërblyer* me dhënien e rrethanës së posaçme lehtësuese është po aq domethënëse në kuptimin e shlyerjes së fajit në fazën e paskryerjes së krimit, gjithmonë në perspektivën e dyfishtë të përcaktuar nga ligji. Pra, nuk do të jetë i mjaftueshëm një kontribut i thjeshtë bashkëpunimi që mbetet në kuadrin e rikrijimit të qartë, pse jo edhe vendimtar, të ngjarjeve, pa u bërë i mundur, nën dritën e këtij rikrijimi apo, sidoqoftë, mbi bazën e një sjelljeje bashkëpunuese, identifikimi i autorëve të veprës penale (edhe kur këta nuk janë më gjallë) apo kapja e tyre (përveç rastit kur kjo është bërë e pamundur nga pikëpamja juridike apo materiale, për shkak të fakteve që nuk varen nga vullneti i bashkëpunëtorit). Në të kundërt, nëse kontributi bashkëpunues rezulton vendimtar, përcaktues për rikrijimin e ngjarjeve, mjafton që ai shfaqet si i tillë për arritjen e njërit prej objektivave të parashikuara nga ligji. Përdorimi i lidhëzës “ose” (“për identifikimin ose kapjen e autorëve të krimit”), nuk lë hapësirë për dyshime: kjo do të thotë, në fakt, që mund të përfitojë nga rrethana lehtësuese e posaçme edhe ai që, duke dhënë një kontribut vendimtar në rikrijimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe për hetimin dhe gjykimin (në bazë të ngjarjeve që lidhen me strategjitë e masakrave, vënë në jetë nga *Cosa Nostra* në fillimet e viteve '90) bën të mundur identifikimin (termi, për mendimin tonë, duhet parë në një kuptim më të gjerë se sa i tekniko-gjyqësor që i jepet zakonisht nga neni 361 K.p.p.) e autorëve të veprave penale.

Është e udhës të saktësojmë që rrethana e posaçme lehtësuese e parashikuar nga neni 8 cit. është e paracaktuar të veprojë vetëm në proceset ku veprimtaria e bashkëpunimit me drejtësinë është kryer qartë e realisht³²³. Në këtë kuptim, duket se parashtrohet i njëjti formulim i ligjit që vë në lidhje të ngushtë distancimin e të pandehurit dhe ndihmën e dhënë hetuesve me rezultatet konkrete që janë arritur nëpërmjet bashkëpunimit gjatë një procesi të vetëm ku edhe është kryer bashkëpunimi. Nëse e mendojmë ndryshe, pra duke i dhënë rrethanë lehtësuese bashkëpunimit të kryer, edhe kur ai ka pasur rezultat pozitiv, në një proces tjetër, procedura shpërblyese

³²³ Krs. Në këtë kuptim orientohet jurisprudenca e vazhdueshme e ligjshmërisë: krs., *ex pluribus*, Kas., 23 janar 1997, Settineri e të tjerë, në C.E.D. Kas. Nr. 207123, sipas të cilit duhet të përjashtohet zbatimi i rrethanës lehtësuese *de quo* “kur shkëputja nga organizata kriminale – për më tepër e njohur zyrtarisht me pranimin e të interesuarit në programin e veçantë të mbrojtjes për bashkëpunëtorët e drejtësisë – u përket fakteve të ndryshme nga ato për të cilat kërkohet rrethana lehtësuese apo kur kontributi ndërhyrës në kuadrin e provave që kishte bërë të mundur më parë identifikimin e bashkëpunëtorëve në veprën penale”.

do të rezultonte, në mënyrë të palogjikshme dhe të jashtëligjshme (ish nenet 3 dhe 27, paragrafi 3, Kusht.), pa asnjë lidhje me vlerësimin e kontributit të mundshëm bashkëpunues të dhënë nga i njëjti i pandehur në një proces ku duhet përcaktuar masa e përgjegjësisë së tij, mbi bazën e një gjykimi dënues për *veprën e kryer* dhe jo për personalitetin e *autorit* të saj³²⁴.

Edhe një herë, duke iu referuar karakterit vendimtar të kontributit bashkëpunues, u shtrua problemi nëse ka kufizime kohore për deklarimet e “të distancuarit”. Në të vërtetë neni 8 cit. nuk parashikon asnjë kufizim të këtij lloji për sa i përket dhënies së rrethanës lehtësuese: nga kjo rrjedh që kontributi bashkëpunues, me karakteristikat e sipërpërmendura, mund të shpjegojë qëllimet e tij për përfitimin e rrethanave shpërblyese në çdo gjendje e nivel gjykimi, përfshirë edhe rigjykimin. Natyrisht, hap pas hapi që gjykimi ndjek rrugën e tij, ky kontribut duhet të jetë i tillë që t’i shtojë kuadrin të provave – që ndërkohë është ravijëzuar ose konsoliduar me konture të qarta e gjithmonë e më të plota – elementë të reja të rëndësishme, në perspektivën e qartë e konkrete të përcaktuar nga ligjvënësi (rikrijim i ngjarjeve, identifikim apo kapje e autorëve të veprave penale). Për këtë arsye, kur deklarimet me qëllim bashkëpunues, edhe kur janë një element i dobishëm plotësues i një kuadri provash të përcaktuar mirë, përdoren nga gjykatësi i çështjes me qëllimin e vetëm që të mbërrijë në mënyrë të qetë në përfundimin e pranimit të përgjegjësisë së të pandehurve, duhet përjashtuar konfigurimi i rrethanës së posaçme lehtësuese³²⁵.

U shtrua gjithashtu edhe çështja e varësisë – ose jo – të rrethanës lehtësuese që po shqyrtohet gjatë gjykimit sipas nenit 69 K. Penal. Për këtë çështje, duhet vënë re paraprakisht, në planin e gjykimit, që zgjidhja përkatëse dhe, në mënyrë të veçantë, pranimi i mundshëm i balancimit (në

³²⁴ Për këtë, krs. Kas. 4 dhjetor 1996, *Femino’* dhe të tjerë, në C.E.D. Kas. Nr. 206907, i cili pohon se “shqyrtimi i çështjes nga ana gjykatësit, për sa i përket konfigurimit të rrethanës së posaçme lehtësuese që vjen si pasojë e distancimit të të pandehurit nga organizata kriminale, parashikuar në rastet e veprave penale të krimit të organizuar nga neni 8 i dekretit ligjor nr. 152 datë 13 maj 1991, konvertuar në ligjin nr. 203 datë 12 korrik 1991, nuk mund të mos jetë i kufizuar nga sa ka referuar I pandehuri gjatë gjykimit të veçantë të veprave penale për të cilat është duke u gjykuar, meqenëse është vetëm në lidhje me ato që gjykatësi mund të vlerësojë karakterin vendimtar dhe konkret të ndihmesës së dhënë nga bashkëpunëtori; mbetet, kështu jashtë këtij gjykimi ndihma e dhënë për vepra kriminale që ligjen me procese të tjera gjykimi”.

³²⁵ Në përputhje me këtë, shih Kas., 22 qershor 1998, *Baglio* e të tjerë, në C.E.D. Kas. Nr. 211286 (ndërsa pranon vendimin e gjykatësit të çështjes, Gjykata kishte përjashtuar rrethanën lehtësuese për shkak të karakterit jo vendimtar të kontributit të dhënë nga I pandehuri gjatë rigjykimin të çështjes, meqenëse pjesa më e madhe e të pandehurve kishte marrë dënime të rënda të gjitha pas një vendimi të formës së prerë).

favor të të pandehurit) të rrethanës lehtësuese me rrethanat rënduese që e bëjnë këtë veprë penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, nuk duket se influencon në ndonjë farë mënyre zbatueshmërinë e procedurës së shkurtuar. Dhe në të vërtetë, pas denoncimit të karakterit aspak kushtetutës të nenit 442 të K. P.p., në pjesën ku lejohet gjykimi i shkurtuar edhe për veprat penale të dënueshme me burgim të përjetshëm dhe zëvendësimin e dënimit të përhershëm me atë të burgosjes së përkohshme³²⁶, duhet menduar që balancimi i mundshëm i rrethanave është, sidoqoftë, i penguar nga dijenia e gjykatësit në instancë paraprake, në fazën e marrjes së vendimit mbi pranimin ose jo të procedurës alternative, duke qenë se kjo gjë i është lënë dorë dijenisë së gjykatësit në proces.

Në planin e të drejtës penale substanciale, çështja duket shumë më e komplikuar për sa i përket doktrinës dhe jurisprudencës.

Teza sipas së cilës rrethana me efekt të posaçëm parashikuar në nenin 8 të ligjit nr. 203 viti 1991 nuk është objekt i thirrjes për paraqitje sipas ish nenit 69 K. penal³²⁷, mbështetet mbi dy këndvështrime: *ratio* e rrethanës

³²⁶ Gjyk. Kushtetuese, 22 prill 1991, nr. 176.

³²⁷ Në jurisprudencë, krs. Kas., 12 prill 2002, Condello, *Dir. E Giust.* 2002, fash. 38, f. 78; Kas., 7 nëntor 2001, Alfieri, në *Kas.pen.2002*, F. 2748. për një ekspozim të qartë e të përmbledhur të pozicioneve jurisprudenciale dhe doktrinale mbi këtë çështje, shih G. De Amicis, me shënimin e redaktorit në Kas. 7 nëntor 2001, Alfieri e të tjerë (i cili përjashton varësinë e rrethanës lehtësuese nga thirrja për paraqitje, ish neni 69 K. Penal). *Kas. Pen.* 2002, F. 2750 e vijues. Për një ekspozim të qartë të argumentave në mbështetje të tezës sipas së cilës rrethana lehtësuese është e balancueshme, shih P. Giordano, *Profili premiali della risposta punitiva dello Stato*, në *Kas. Pen.* 1997, f. 925-926, i cili, megjithatë, duket se priret nga teza e balancueshmërisë. Teza që kundërshton balancueshmërinë e rrethanës lehtësuese, është konfirmuar sërish kohët e fundit nga Kas., 20 prill 2005, nr. 6221, Aglieri e të tjerë, në C.E.D. *Kas.*, nr. 233088, duke theksuar se “dekreti ligjor nr. 152 datë 13 maj 1991, neni 8, konvertuar në ligjin nr. 203 datë 12 korrik 1991, përcakton që, në rastin kur është provuar qëndrimi distancues nga e njëjta normë e parashikuar, “dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me atë të burgimit me 12 deri në 20 vjet burg, dhe dënimet e tjera zbriten në masën 1/3 deri në 1/2 e tyre”. Gjykarta, në mënyrë të veçantë, nuk merr parasysh vërejtjen e palës paditëse, sipas së cilës, në rastin kur vepra penale dënohet me dënim të përhershëm, dënimi bazë mbi të cilin aplikohet ulja nuk ishte burgimi i përjetshëm, por, në bazë të nenit 69 K. Penal, për shkak të gjykimit mbizotërues të rrethanës lehtësuese (konkretisht: rrethana lehtësuese parashikuar në nenin 8 cit. dhe rrethanat lehtësuese me karakter të përgjithshëm ish neni 62-bis K. Penal), është ajo e burgimit me 21 vjet (*recte*: nga 21 në 24 vjet burgim, ish nenet 23 dhe 575 K. penal) parashikuar për vrasjen të thjeshtë e të qëllimshme. Duke i qëndruar këtij kriteri interpretues – vëren Gjykata – parashikimi i uljes së dënimit nga burgim i përjetshëm në burgim me 12 deri në 20 vjet, parashikuar nga legjislacioni mbi këtë çështje, mund të gjejë zbatim praktik në rastet shumë të rralla kur dënimi me burgim të përjetshëm është parashikuar me ligj nga hipoteza e veprës penale të thjeshtë, sepse, nëse burgimi i përjetshëm do të vinte si pasojë e një rrethane rënduese, kjo

lehtësuese është pikërisht “dhënia e arsyeje konkrete dhe thjesht rastësore për distancimin aktiv nga krimi i organizuar”³²⁸; për këtë arsye, nëse do të zbatohet parimi i balancimit, rrethana lehtësuese e parashikuar nga neni 8 cit., do të rrezohet, në mënyrë hipotetike, përpara rrethanave të mundshme rënduese, “gjë që do të sillte dënimin – në rast vrasjeje – me burgim të përjetshëm: kjo do të çonte në zhdukjen e *ratio legis*, ndërsa logjika e sistemit vendos që dënimi i caktuar pas dhënies së rrethanës lehtësuese i shmanget thirrjes për paraqitje, meqenëse ulja e dënimit nuk është gjë tjetër veçse përgjigjja ndaj bashkëpunimit, me të cilin është i lidhur pazgjydhshmërisht³²⁹. Nga ana tjetër – është vënë re gjithashtu – “fakti që ligjvënësi përjashton bashkëfajësinë me rrethanën rënduese të parashikuar në nenin 7 ligji nr. 203/91³³⁰ do të thotë që – sipas një kriteri hermeneutik të arsyeshmërisë – nuk do të mund të konsiderohej një rrethanë tjetër rënduese (e përbashkët apo e veçantë) e njëjtë apo mbizotëruese ndaj kësaj rrethane lehtësuese. Kjo pjesë e ligjit (që flet për zëvendësimin e dënimit me burgim të përjetshëm) nga ana tjetër do të na lërë të kuptojmë që rrethana lehtësuese nuk është e balancueshme³³¹”. Në thelb, dispozitat e nenit 8 të cituar më sipër duhet të konsiderohet të *posaçme* në krahasim me ato të nenit 69 paragrafi 2 K. Penal, meqenëse ligjvënësi ka përcaktuar, në linja të përgjithshme e të pakthyeshme, rëndësinë përcaktuese të rrethanës

do të binte poshtë nga rrethana lehtësuese, gjë që do të bënte të mundur kthimin në dënimin me burgim të përkohshëm, ta parashikuar për veprat penale të thjeshta.

Duke i dhënë zbatim parashikimit, duhet të pohohet që, në rastin kur pranohet rrethana lehtësuese e *posaçme* sipas dekret ligjit nr. 152 viti 1991, neni 8, në kundërshtim me nenin 69 K. penal, diktohen nga i njëjti nen kriteret e *posaçme* për uljen e dënimit, duke vendosur që, në vend të burgimit të përjetshëm, edhe pse ky ka ardhur si pasojë e rrethanave rënduese apo se është parashikuar si dënim ligjor i veprës kriminale, aplikohet dënimi me burg nga 12 deri në 20 vjet.

Ulje të mëtejshme të dënimit që vijnë si pasojë e rrethanave të tjera lehtësuese aplikohen mbi dënimin e përcaktuar në këtë mënyrë (nga 12 deri në 20 vjet), sipas nenit 63 K. penal, paragrafi 3. në këtë interpretim na shtyn edhe pjesa e ligjit që merr në konsideratë “dënimin me burgim të përjetshëm” dhe jo “veprat penale të ndërshkuara me burgim të përjetshëm”, duke iu referuar kështu veprave konkrete, përfshirë edhe ato rrethanoresh.

³²⁸ Kështu Kas., 7 nëntor 2001, Alfieri, cit. *Supra*.

³²⁹ Kështu Kas., 12 prill 2002, Condello, cit. *Supra*

³³⁰ Shih neni 8, cpv 1, ligji nr. 203 viti 1991, cit.

³³¹ Teza që kundërshton balancimin është përmbledhur më së miri nga P.GIORDANO, vep. cit., f. 925-926, i cili propozon këtë paraqitje: “...një vepër penale çfarëdo (p.sh. vrasje) që për shkak të një rrethane rënduese (p.sh. paramendimi) dënohet me burgim të përjetshëm, zbatimi i rrethanës lehtësuese çon në mënyrë automatike në zëvendësimin e dënimit të përjetshëm me dënimin e përkohshëm. Nëse marrim një vepër penale të dënuar që në fillësë me burgim të përjetshëm (422 k.p.): asnjë rrethanë rënduese nuk është e pranueshme dhe vihet në zbatim rrethana lehtësuese”. Sipas autorit, megjithatë, “mungesa e balancimit, duke qenë një kriter për moszbatimin e kuadrit ligjor, duhet të jetë e përcaktuar shprehimisht”.

lehtësuese që lidhet me distancimin e kryer, duke përcaktuar gjithashtu në mënyrë të pavarur masën e dënimeve të aplikuara, që do të sillnin si pasojë edhe përjashtimin e disiplinës së Kodeve të përbashkëta për sa i përket balancimit të rrethanave heterogjene, e cila presupozon pranimin e kompetencës së gjykatësit e cila, nëse i referohemi rrethanës lehtësuese, përjashtohet që në rrethje³³².

Teza që mbështet balancimin ish neni 69 K. Penal ka gjetur mbështetje në jurisprudencën e kohëve të fundit të Gjykatës Kushtetuese³³³, sipas së cilës, neni 8 i dekretit ligjor nr. 152 viti 1991 “parashikon thjesht një rrethanë lehtësuese (kështu quhej në të njëjtin nen nr. 8, paragrafi 3, shfuqizuar nga ligji nr. 45 datë 13 shkurt 2001, neni 23) edhe pse me efekt të posaçëm”. Për këtë arsye, kjo rrethanë lehtësuese nuk mund t’i shmanget, pa asnjë lloj parashikimi, rregullit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 69 K. Penal; aq është e vërtetë kjo, sa në brendësi të masës legjislative (neni 7, paragrafi 2), kur ligjvënësi ka ndërmend të përjashtëj thirrjen për paraqitje, e ka shprehur këtë gjë në mënyrë të qartë”. Në mbështetje të kësaj teze, është vënë re që, edhe duke iu referuar normave që parashikojnë rrethana lehtësuese të posaçme si ajo që është marrë në shqyrtim (neni 630 K. Penal, paragrafi 4), është konsideruar e pranueshme thirrja për paraqitje³³⁴. “Tek e fundit – vëren Gjykata Kushtetuese – kur ligjvënësi do ta përjashtëj balancimin e rrethanave, moszbatimi i nenit 69 K. Penal është qartësisht i parashikuar”³³⁵.

³³² Kas., 11 korrik 2001, Benfante, nr. 36954, e papublikuar, cituar nga G.DE AMICIS, shenim cit., *supra*, f. 2751.

³³³ Kas., 12 korrik 2006, nr. 34193, Cotugno e të tjerë, C.E.D., Kas., nr. 2354419. në përputhje me të, shih Kas., 29 nëntor 2001, Barra, C.E.D. Kas., nr. 221933; Kas., 21 janar 1998, Alfieri e të tjerë, *këtu*, nr. 210884, sipas të cilit rrethana lehtësuese e posaçme parashikuar në nenin 8 cit. “nuk mund t’i shmanget thirrjes së zakonshme për paraqitje, pa qenë kjo gjë e parashikuar shprehimisht me ligj”.

³³⁴ Kas., 2 dhjetor 1985, nr. 1553, Zii, C.E.D. Kas., nr. 171935

³³⁵ Krs. Kas., 12 korrik 2006, Cotugno, cit. I cili, për shkak të përjashtimit nga parimi i përgjithshëm i balancimit të rrethanave, përcaktuar nga neni 69 K. penal, na drejton tek përjashtimet e vetë ligjit: në nenin 291-ter, paragrafi 3, d.P.R. nr. 43 datë 23 janar 1973; neni 1, paragrafi 3, dekreti ligji nr. 625 datë 15 dhjetor 1979, konvertuar në ligjin nr. 15 datë 6 shkurt 1980; në nenin 7, paragrafi 4, dekretligji nr. 419 datë 31 dhjetor 1991, konvertuar në ligjin nr. 172 datë 18 shkurt 1992; neni 3, paragrafi 2, Dekretligji nr. 122 dt. 26 prill 1993, konvertuar në ligjin nr. 205 dt. 25 qershor 1993; në nenin 12, paragrafi 3-quarter, dekreti legjislativ nr. 286 dt. 25 korrik 1998. Mbi këtë pike të shihet edhe, për referime doktrimore, G.DE AMICIS, *vep. cit.*, 2751.

Sipas mendimit tonë, kjo teza e fundit, megjithë disa vështirësi të zbatimit të vëna në dukje nga doktrina dhe jurisprudenca³³⁶, e meriton të bashkëndahet.

Shtirja aktuale e paradigmës ligjore të nenit 69 K.P. lejon, në fakt, pohimin, në përgjithësi, se i takon gjykatësit vlerësimi tërësor i faktit, në të gjithë përbërësit e tij rrethanorë, pozitivë dhe negativë. Gjykimi krahasimor mes rrethanave heterogjene, të çdo lloji natyre (me përjashtim të atyre shprehimisht të treguara nga ligji, të përjashtuara nga balancimi) merr, në këtë mënyrë, karakter detyrues dhe njësuës me qëllim përcaktimin konkret të dënimit³³⁷, duke i kushtuar vëmendje marrëdhënies së nevojshme të përpjestueshmërisë, arsyeshmërisë (neni 3, Kusht.) dhe subsidiaritetit (nenet 2, 3, 13, 25 paragrafët 2 dhe 3 Kusht.) të kësaj të fundit në lidhje me krimin, duke mbajtur parasysh, edhe, mbrojtjen e duhur të dinjitetit të autorit të krimit (nenet 2, 3, paragrafi 1, 27 paragrafët 1 dhe 3, 32, paragrafi 2, 41, paragrafi 2, Kusht.), si dhe të personalitetit të përgjegjësive penale (neni 27, paragrafi 1, Kusht.) dhe të rëndësisë tërësore të sjelljes kriminale, të çmuar në ofensivën e tij objektive në lidhje me të mirat/interesat e mbrojtura me kushtetutë³³⁸. Gjykata kushtetuese, duke iu referuar një rasti, në të cilin ligji,

³³⁶ Në jurisprudencë, të shihet Kas., 7 nëntor 2001, Alfieri e të tjerë, *cit.*, e cila sjell në vëmendje “rjedhoja irracionale” të tezës në favor të balancimit, e cila “do të sillte lehtësimin e domosdoshëm të dënimit për krimet më të rënda që në vetvete duhet të dënohen me burgim të përjetshëm, nëse nuk janë përcaktuar ndryshe, ndërsa për krimet e sanksionuara me dënim të përjetshëm vetëm nëse në prani të rrethanave rënduese rrethana lehtësuese *ish* neni 8 mund të humbasë konsistencë nga gjykimi krahasimor”; në doktrinë, shih. P.GIORDANO, *vep. cit.*, 926.

³³⁷ Sipas doktrinës më të fundit (A.VALLINI, *Circostanze del reato*, në *Dig. Disc. Pen.*, Torino, 2000, 47) norma mbi balancimin mes rrethanave bashkëvepruese, sipas nenit 69 K.P., ka vlerën e “rregullës së përgjithshme”. Edhe jurisprudenca e Gjykatës së kasacionit, në gjetjen e synimeve të institutit në nevojën për të “vlerësuar personalitetin e fajtorit dhe entitetin e vërtetë të faktit me qëllim përshtatjen e përkryer të dënimit me rastin konkret” (khs. Kas., 29 nëntor 1985, Catalizzo, në *Kas. pen.* 1987, 1103), ka pohuar se “gjykimi i krahasimit sipas nenit 69 K.P. ka karakter të pandashëm” (Kas., 9 tetor 2003, nr. 39456, në *Kas. pen.* 2005, 58).

³³⁸ Megjithatë duhet të kemi parasysh se disiplina aktuale e nenit 69 K.P. është konsideruar si “një lloj heqje dorë e legjislatorit, i cili, i paaftë për të hequr vijat e një politike sanksionuese moderne të bazuar mbi Kushtetutën, ia delegon ushtrimin gjykatësit, me një transpozim të funksioneve jo të parëndësishëm, pasi vetëm legjislatori është në gjendje të shprehë detyrime të përgjithshme dhe të njëtrajtshme, jo gjykatësi, që nga konkretësia e çështjes nuk mundet (dhe nuk do të duhej ta bënte) të mbërrijë në rregullën universale, por anasjelltas. Rreziku që është nën reformën e nenit 69 K.P. është pra “t’i japim vetes për herë të parë një ‘të drejtë të lirë’ të lënë në zgjedhjet vetjake të gjykatësit””: shih. T.PADOVANI, *Concorso tra circostanze eterogenee e “reati aggravati dall’evento”*, në *Rev. it. dr. e proc. pen.*, 1975, 3.

për shkak të disa rrethanave rënduese të posaçme, kishte vendosur shprehimisht një disiplinë shmangëse në lidhje me atë të përgjithshmen parashikuar nga neni 69 K.P.³³⁹, në pohimin e ligjshmërisë kushtetuese të këtyre rrethanave rënduese, ka përjashtuar veprueshmërinë e gjykit krahasimor *ish* neni 69 K.P. vetëm për rastet në të cilat ai zgjidhet në kuptimin e barazvlefshmërisë apo të mbizotërimit të rrethanave lehtësuese: në rastet e tjera, në të cilat balancimi zgjidhet në kuptimin e mbizotërimit të rrethanave rënduese, gjykatësi mbetet sërish i lirë të ushtrojë pushtetin e tij vetëgjykimor në përcaktimin e dënimit³⁴⁰. Në çdo rast, urojmë të kemi një ndërhyrje të shpejtë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen përfundimtare të kundërshtisë së madhe jurisprudenciale mbi këtë pikë.

Në mënyrë analoge vihet re prania e mendimeve të ndryshme në jurisprudencën e ligjshmërisë së çështjes lidhur me pranimin e bashkëndarjes së rrethanës lehtësuese në shqyrtim me rrethanat e tjera lehtësuese të posaçme sipas neneve 73, paragrafi 7, dhe 74, paragrafi 7, të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 309 dt.1990. Për zgjidhjen pohuese është orientuar jurisprudenca më e fundit, si duke iu referuar rrethanës lehtësuese të posaçme të nenit 73, ashtu edhe në lidhje me rrethanën lehtësuese analoge të nenit 74. Për sa i përket përballjes mes të parës dhe nenit 8, Gjykata e Lartë, në pohimin e bashkëpunimit, ka vënë re se, edhe pse të dyja hamendësojnë se sjellja e atij që heq dorë duhet të ketë si qëllim që krimi mos të çohet në pasoja më të rënda, rrethana lehtësuese e posaçme e parashikuar me nenet 73, paragrafi 7, parashikon një hamendësi specifike, e zbatueshme vetëm në lidhje me veprimin e kundërshtimit të trafikut të narkotikëve, që konsiston në ndihmesën e dhënë autoriteteve në marrjen e burimeve të rëndësishme nga bashkëpunëtorët për porositjen e krimit³⁴¹. Në përfundime të njëjta, me motivim analog, ka mbërritur jurisprudenca e ligjshmërisë rreth bashkëpunimit mes rrethanës lehtësuese të posaçme të

³³⁹ Shih. p.sh., disiplinën shtyrëse të parashikuar për rrethanën rënduese të përfutur me nenin 1 të ligjit nr. 15 dt. 1980 dhe atë të parashikuar për rrethanën rënduese të nenit 280 paragrafi 5 K.P.

³⁴⁰ Shih. Gjyk. kusht., 13 shkurt 1985, nr. 38, në *Rev. it. dr. e proc. pen.*, 1986, 1293; G.DE AMICIS, *vep. cit.*, 2752, me referime doktrinale të mëtejshme.

³⁴¹ Khs. Kas., 23 prill 2002, Apicella, në *Kas. pen.* 2003, 1894; Kas., 12 prill 2002, Condello, cit. *supra*, që ka saktësuar se, nëse njëra nga dy rrethanat lehtësuese quhet si e zbatueshme, *favor rei* duhet të detyrojë që të orientohet drejt rrethanës lehtësuese të nenit 73, paragrafi 7, Dekreti i Presidentit të Republikës, nr. 309 dt. 1990.

nenit 74, paragrafi 7, Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 309 dt. 1990 dhe asaj të nenit 8 të dekretligjit nr. 152 dt. 1991³⁴².

Le të lemë mënjanë çështjet e mëtejshme, të trajtuara në rrafsh jurisprudencial, rreth caqeve të operativitetit të rrethanës lehtësuese sipas nenit 8, në pasqyrimet e tij në rrafshin gjyqësor dhe të burgjeve. Megjithatë është interesante të gjejmë një vijë të përbashkët prirëse, në kuptimin që njohja e rrethanës së mësipërme lehtësuese nuk sjell aktivizimin automatik të përfitimeve të tjera eventuale apo të reduktimit të dënimit, që në mënyrë abstrakte mund t'u jepen personave që bashkëpunojnë me drejtësinë. Për shembull, nëse qëndron rrethana lehtësuese sipas nenit 8, nuk do të thotë se detyrimisht, në rrafshin substancial, duhen dhënë rrethana lehtësuese të përgjithshme bazuar mbi kushte të ndryshme, si vlerësimi i përgjithshëm i rëndësisë së faktit dhe i aftësisë së autorit të krimit³⁴³. Në rrafshin gjyqësor, duke iu referuar posaçërisht motivimit të vendimit, kujtesa e arsyeve që kanë justifikuar dhënien e rrethanës lehtësuese sipas nenit 8, mund të përforcojë besueshmërinë subjektive të të thirrurve në bashkëfajësi vetëm nëse është bazuar mbi një itinerar argumentues që merr parasysh të gjitha elementet e tjera të provës që, sipas nenit 192, paragrafët 3 dhe 4, pohojnë besueshmërinë e deklaruësit³⁴⁴.

Në fund, autonomia vlerësuese e Gjykatës së mbikëqyrjes, mbi vërtetimin e kushteve për bashkëpunimin, është pohuar së fundmi për sa i përket dhënies së masave alternative ndaj burgimit ndaj të ashtuquajturve bashkëpunëtorë të drejtësisë. Në fakt është menduar se zbatimi – i negociuar në fazën e kompromisit për dënimin – i rrethanës lehtësuese të posaçme sipas nenit 8, ligji nr. 203 dt. 1991 nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e

³⁴² Shih. Kas., 29 janar 2007, Aloisio e të tjerë, C.E.D. Kas., nr. 236260. Bashkëveprimi mes dy rrethanave lehtësuese të posaçme është përjashtuar në një tjetër vendim të vonë (Kas. 28 prill 2004, nr. 26637, Cicciù, C.E.D. Kas., nr. 229871), në të cilin është pohuar se “të dyja rrethanat përbëjnë parashikim shpërblimi pasi kanë fusha të ndryshme veprimi, pasi kanë qëllimin të mënjanojnë, përmes një lloji pendimi postkrimit, që krimi i organizuar, të cilit i referohen përkatësisht, të mos ketë rrjedhoja të tjera”.

³⁴³ Khs. Kas., 3 shkurt 2006, Cariolo dhe të tjerë. C.E.D., Kas., nr. 233938.

³⁴⁴ Khs. Kas., 11 shkurt 2005, Barbato e altri, C.E.D., Kas., nr. 234409, sipas të cilit “gjykatësi i apelit e kryen detyrën e motivimit për besueshmërinë subjektive të të thirrurve në bashkëfajësi nëse kujton dhënien e rrethanës lehtësuese sipas nenit 8 të dekretligjit nr. 152 dt. 1991, konvertuar me ligjin nr. 203 dt. 1991, kryer nga gjykatësi i shkallës së parë, i cili është shprehur mbi këtë pikë në mënyrë përfundimtare, sepse ridërgon, me zhvillimin argumentues të ligjshëm, në vlerësimet e shprehura mbi këtë nga gjykatësi i parë, nga të cilat vlerësime nuk mendon se duhet të tërhiqet”.

përmbajtjes dhe të meritës mbi kushtet paraprake për dhënien e përfitimeve në burgje, parashikuar në nenin 16-*nonies* ligji nr. 45 dt. 2001³⁴⁵.

§ 6. Rrethana të tjera lehtësuese “shpërblyese” të parashikuara kundrejt atyre që bashkëpunojnë me drejtësinë dhe ndikimet përkatëse në planin procedural dhe të burgimit.

Regjimi shpërblyes i parashikuar, për disa lloje krimesh, në favor të atyre që bashkëpunojnë me drejtësinë pasqyrohet, përgjithësisht, edhe në rrafshin gjyqësor dhe të burgjeve. Me fjalë të tjera, parashikimit të një rrethane lehtësuese të posaçme që, në lidhje me hamendësitë specifike të krimit dhe situatat që meritojnë një “shpërblim”, që konsiston në lehtësimin e dënimit të dhënë, normalisht i përgjigjet, për personin përftues të trajtimit shpërblyes, një situatë e favorshme në terma të përfitimeve të fitueshme gjatë gjyqit ose, pas dënimit përfundimtar, në fazën e ekzekutimit të dënimit. Në këtë këndvështrim të fundit, dalin në pah, sidomos, normat e rendit të burgjeve që përcaktojnë kushtet paraprake, objektin (neni 58-*ter*) dhe fushën (neni 4-*bis*) e shpërblimit në drejtimin e ekzekutimit të dënimit.

Kjo premisë e nevojshme na lejon të kuptojmë më mirë teknikën ligjore, jo gjithnjë koherente me impostimin e mësipërm parimor, të përshtatur nga legjislatori këto vitet e fundit për të zgjeruar progresivisht hapësirën e shpërblyeshmërisë, në shfaqjen e saj të trifishtë ligjore (substanciale, gjyqësore, të burgjeve), në situata të tjera, që çojnë më së shumti, në krimin e organizuar transkombëtar ose, sidoqoftë, në forma të krimit gjithnjë e më të ndërlikuara dhe të vështira për t’u vërtetuar. Edhe për të tilla fenomene kriminale legjislatori ka menduar se ka rëndësi themelore, në funksionin reintegruës të së mirës juridike të cenuar ose në rrafshin e pendimit post-krim, bashkëpunimi me *të brendshmit* e organizatave kriminale, deri sa i konsideron se meritojnë një trajtim të ndryshëm në rrafshin substancial, gjyqësor dhe të qëndrimit në burg.

Gati gjithnjë zgjerimit të hapësirës së shpërblimit, le të themi substancial, në lidhje me krimet fenomene të krimit të organizuar³⁴⁶, i është përgjigjur një shtrirje paralele e kompetencës në Drejtoritë antimafie të rretheve nga njëra anë, dhe e funksioneve të koordinimit dhe nxitjes që i

³⁴⁵ Në këtë drejtim, shih. Kas., 7 shkurt 2006, Zampina, C.E.D. Kas., nr. 233527.

³⁴⁶ Shih. neni 291-*quater* d.P.R., nr. 43 dt. 23 janar 1973, përftuar me nenin 1, paragrafi 1, shkronja a) ligji nr. 92 dt.19 mars 2001; nenet 419, paragrafi i gjashtë, 600, 601, 602 K.P., përftuar me nenin 6, paragrafi 1, shkronja b), ligji nr. 228 dt. 11 gusht 2003, që përmban “*Masa kundër trafikut të qenieve njerëzore*”.

lihet Prokurorit kombëtar antimafie, nga ana tjetër, në bazë të neneve 51, paragrafi 3-bis dhe 371-bis K.P.P. Përveç kësaj është zgjeruar veprimtaria propozuese, informuese dhe këshillimore e Drejtorisë kombëtare antimafie në fushën e zhvillimeve të ndryshme gjyqësore kryesore apo anësore, ose në zhvillime në të cilat është në lojë dhënia, ndryshimi ose revokimi i përfitimeve *shpërblyese*, të lidhura me forma pak a shumë intensive të bashkëpunimit me drejtësinë.

Sidoqoftë duhet vërejtur se teknika ligjore e përmendur më lart [parashikim i një rrethane lehtësuese të posaçme për rastet e bashkëpunimit me drejtësinë / njohje e një *statusi* të bashkëpunëtorit (neni 58-ter Ren. Bur.) / mënjanim i regjimit të zakonshëm për dhënien e përfitimeve në burgje (neni 4-bis Ren. Bur.)] rezulton gati gjithnjë e zbatuar. Kështu, për shembull, përshtatja e rrethanës lehtësuese të posaçme të bashkëpunimit për krimet në fushë të kontrabandës (nenet 291-bis, 291-ter dhe 291- quater të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 43 dt. 1973, risuar me ligjin nr. 92 dt. 19 mars 2001) ka gjetur një zgjerim kontestual të sistemit shtyrës për sa i përket kushteve për dhënien e përfitimeve në burgje³⁴⁷.

Për sa u përket krimeve të ndërfutura nga ligji nr. 228 dt. 2003 (që përmban "*Masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore*"), për të cilat, në rastin e bashkëpunimit me drejtësinë të autorëve përkatës ose bashkautorëve, parashikohet i njëjti regjim i ndryshëm, duhet vënë në pah se teknika ligjore e lartpërmendur është përshtatur vetëm pjesërisht.

Ligji i sipërpërmendur nr. 228 ka sjellë në fakt disa ndryshime në kodin penal. Në veçanti:

1. me nenet 1, 2 dhe 3 janë rishikuar dhe përditësuar rastet e parashikuara nga kodi në nenet 600 (Vënie ose mbajtje në skllavëri ose në robëri)³⁴⁸, 601 (Trafikim i qenieve njerëzore)³⁴⁹, 602 (Blerje dhe tjetërsim i

³⁴⁷ Regjimi i ndryshëm parashikuar në nenin 4-bis, paragrafi 1, Rend. Bur. edhe për krimet e mësipërme ka të bëjë posaçërisht: me caktimin në një punë të jashtme, lejet shpërblim dhe masat alternative ndaj burgimit [besimi në provë tek shërbimi social (neni 47 rend. bur.), burgimi në kushtet e shtëpisë (neni 47-ter Rend. bur.), liria e pjeshme (neni 48 rend. bur.), me përjastim të lirimit të parakohshëm].

³⁴⁸ Për lehtësi të leximit sjellim këtu më poshtë tekstin e nenit 600 K.P., zëvendësuar me nenin 1, ligji nr. 228 dt. 11 gusht 2003:

“Kushdo që ushtron mbi një person pushtet të njëjtë me atë të të drejtës së pronës ose kushdo që rrëgjon ose mban një person në një gjendje nënshtrimi të vazhdueshëm, duke e shtrënguar të kryejë veprimtari në punë ose seksuale ose lypje ose sidoqoftë veprimtari që sjellin si pasojë shfrytëzimin, dënohet me burgim nga tetë deri në njëzet vjet.

Rrëgjimi ose mbajtja në kushtet e nënshtrimit ndodhin kur sjellja kryhet përmes dhunës, kërcënimit, mashtrimit, abuzimit me autoritetin apo përfitimit nga një situatë inferioriteti

skllevërve)³⁵⁰, edhe me parashikimin e disa rrethanave rënduese të posaçme³⁵¹;

2. me nenin 4 është krijuar, përmes shtesës së një paragrafi të gjashtë në nenin 416, një figurë e re krimi (organizata kriminale me qëllim porositjen e njërit prej krimeve sipas neneve 600, 601, 601), dënuar me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet në rastet e parashikuara nga paragrafi i parë i të njëjtit nen 416 dhe nga katër deri në nëntë vjet në rastet e parashikuara nga paragrafi i dytë;

3. me nenin 11 (Dispozita të rendit të burgjeve dhe në lidhje me personat që bashkëpunojnë me drejtësinë), përveç parashikimit të shprehur të zbatueshmërisë së normave mbi marrjen e masave të posaçme të mbrojtjes

fizik a psikik a të një situatë të nevojës, a përmes premtimit a dhënies së shumave të parave apo avantazheve të kujt ka një autoritet mbi personin.

Dënimi shtohet me një të tretën deri në një të dytën nëse faktet sipas paragrafit të parë janë kryer në dëm të një të mituri tetëmbëdhjetëvjeçar apo kanë si qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose synimin e nënshtrimit të personit të cenuar ndaj heqjes së organeve”.

³⁴⁹ Teksti i nenit 601 K.P., zëvendësuar me nenin 2 ligji nr. 228 dt. 11 gusht 2003, është si më poshtë:

“Kushdo që kryen trafikim të qenies njerëzore që gjendet në kushtet sipas nenit 600 ose, me qëllim kryerjen e krimit sipas paragrafit të parë të të njëjtit nen, e detyron përmes mashtrimit ose e shtrëngon përmes dhunës, kërcënimit, abuzimit të autoritetit ose përfitimit nga një situatë inferioriteti fizik apo psikik ose të një situatë të nevojës, ose përmes premtimit ose dhënies së një shume parash ose të avantazheve të tjera personit që ka autoritet mbi të, të hyjë ose të qëndrojë ose të dalë nga territori i një Shteti ose të zhvendoset në brendësi të tij, dënohet me burgim nga tetë deri në njëzet vjet.

Dënimi shtohet me një të tretën deri në një të dytën nëse faktet sipas paragrafit të parë janë kryer në dëm të një të mituri tetëmbëdhjetëvjeçar apo kanë si qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose synimin e nënshtrimit të personit të cenuar ndaj heqjes së organeve”.

³⁵⁰ Teksti i nenit 602 të k.p., siç rezulton nga ndryshimet e sjella nga neni 3, i ligjit nr.228, dt. 11 gusht 2003, është si vijon:

“Kushdo që, përveç rasteve të treguara në nenin 601, ble ose tjetëron, apo cedon një person që gjendet në një prej kushteve siç në nenin 600 dënohet me burgim nga tetë deri në njëzet vjet”.

Dënimi shtohet nga një e treta në gjysëm nëse personi i dëmtuar është i mitur nën tetëmbëdhjetë vjeç apo nëse veprat, siç në parag.e parë kanë për qëllim shfrytëzimin e prostitucionit apo ta nënshtrajnë personin e dëmtuar ndaj heqjes së organeve”.

³⁵¹ Këto rrethana rënduese konfigurohen përkatësisht nëse faktet e vënies apo mbajtjes në skllavëri apo robëri (neni 600) apo krimet e trafikut të qenieve njerëzore (neni 601) kryhen në dëm të të miturit nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç apo u drejtohen shfrytëzimit të prostitucionit apo qëllimit për ta nënshtruar personin e cenuar ndaj heqjes së organeve, apo nëse personi i dëmtuar nga krimi i blerjes apo tjetërsimit të skllevërve (neni 602) është i mitur nën moshën 18 vjeç apo nëse faktet si në paragrafin e parë të neni 602 kanë për qëllim shfrytëzimin e prostitucionit apo ta nënshtrajnë personin e dëmtuar ndaj marrjes së organeve.

në favor të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, edhe duke iu referuar krimeve sipas neneve 600, 601, 602 (tani të përfshirë në nenin e ri 51, paragrafi 3-bis, K.P.P.), 600-bis (Prostitucioni i të miturve³⁵²), 600-ter (Pornografia e të miturve)³⁵³, 600-quater (Mbajtje e materialit pornografik)³⁵⁴ dhe 600-quinquies (Nisma turistike me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit tek të

³⁵² Teksti i nenit 600-bis i k.p. (i ndërfutur nga neni 2 i ligjit n.269, dt. 3 gusht 1998), siç rezulton nga ndryshimet e sjella nga neni 1 i ligjit n.38, dt.6 shkurt 2006, është si vijon:

“Kushdo që shtyn në prostitucion një person në moshë më të vogël se tetëmbëdhjetë vjeç apo favorizon apo shfrytëzon prostitucionin e tij dënohet me burgim nga gjashtë deri dymbëdhjetë vjeç dhe me gjobë nga 15.493 në 154.937 euro.

Përveç se kur vepra përbën një krim të rëndë, kushdo që kryen marrëdhënie seksuale me një të mitur të moshës mes katëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç, në këmbim të parave apo të një tjetër përfitimi ekonomik, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë jo më të vogël se 5.164 euro.

Në rastin kur vepra e parashikuar në paragr. 2 kryhet kundrejt një personi që nuk ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjeç, zbatohet dënimi i burgimit nga dy deri në pesë vjet.

Nëse autori i veprës siç në parag. e dytë është person i mitur në moshën tetëmbëdhjetë vjeç zbatohet dënimi i burgimit si dhe i gjobës, që zbritet nga një e treta në dy të tretat”.

³⁵³ Teksti i nenit 600-ter, i k.p. (i ndërfutur nga neni 3, i ligjit n.269, dt. 3 gusht 1998), siç rezulton nga ndryshimet e sjella nga neni 2 i ligjit n.38, i dt. 6 shkurt 2006, është si vijon:

“Kushdo që, duke përdorur të mitur më pak se tetëmbëdhjetë vjeç, realizon shfaqje pornografike apo prodhon material pornografik apo shtyn të mitur nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç të marrin pjesë në shfaqje pornografike dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë vjet dhe me një gjobë nga 25.822 euro deri në 258.228 euro.

Të njëjtit dënim i nënshtrohet kushdo që bën tregti me material pornografik siç në paragrafin e parë.

Kushdo që përveç rastit të parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë, me çdo mjet, edhe në rrugë telematike, shpërndan, përhap apo i bën publicitet materialit pornografik siç në paragrafin e parë, apo shpërndan dhe përhap të dhëna apo informacione që kanë për qëllim rekrutimin apo shfrytëzimin sektual të të miturve nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga 2.582 euro në 51.625 euro.

Kushdo që përveç rasteve të parashikuar në parag.e parë, të dytë dhe të tretë, ofron apo u cedon të tjerëve, edhe falas, material pornografik siç në paragrafin e parë, dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë nga 1.549 euro deri në 5.164 euro.

Në rastet e parashikuara nga paragrafi i tretë dhe i katërt dënimi shtohet në masën që nuk i kalon dy të tretat atëherë kur materiali është në sasi shumë të madhe”.

³⁵⁴ Teksti i nenit 600-quater, i k.p., i ndërfutur nga neni 4 i ligjit n.269, i dt. 3 gusht 1998, dhe më pas i zëvendësuar nga neni 3, i ligjit n.38, dt. 6 shkurt 2006, është si vijon:

“Kushdo që përveç rasteve të parashikuara nga neni 600-ter, në mënyrë të vetëdijshme siguron apo mban material pornografik të realizuar duke përdorur të mitur nën tetëmbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë jo më të vogël se 1.549 euro.

Dënimi shtohet në masën që nuk i kalon dy të tretat atëherë kur materiali i mbajtur është në sasi të shumë të madhe.

miturit) të kodit penal³⁵⁵, është ndërftuar një ndryshim i rëndësishëm në nenin 16-*nonies* të dekretligjit n. 8 dt. 1991, kthyer në ligjin nr. 82 të të njëjtit vit; kjo normë lejon, në fakt, zbatimin e dispozitave të nenit 16-*nonies*, në lidhje me dhënien e përfitimeve gjatë burgimit³⁵⁶, “edhe për personat e dënuar për një nga krimet e parashikuara nga libri II, titulli XII, kreu III, seksioni I, i kodit penal³⁵⁷ që kanë mbajtur sjellje bashkëpunimi edhe pas dënimit sipas kushteve të parashikuara nga neni 9, paragrafi 3”³⁵⁸.

4. në fund, me nenin 15 (Norma koordinimi), për pasojë të shartimit në tekstin origjinal të nenit 600-*sexies*, paragrafi i katërt, K.P., pas fjalëve “600-*ter*”, të fjalëve “si dhe nga nenet 600, 601 dhe 603”, rrethana lehtësuese e posaçme e parashikuar në favor të atij që, në rastet e prostitucionit dhe pornografisë së të miturve (nenet 600-*bis* dhe 600-*ter* K.P.), “përpiqet konkretisht në mënyrë që i mituri nën 18 vjeç të rifitojë autonominë dhe lirinë e vet” shtrihet edhe për rastet e rrëgjimit apo mbajtjes në skllavëri ose shërbim (neni 600 K.P.), trafikimit të qenieve njerëzore (neni 601 K.P.) dhe blerjes apo tjetërsimit të skllavëve (neni 602 K.P.).

³⁵⁵ Këto dispozita kanë të bëjnë me dhënien, në kushte të caktuara, të përfitimeve gjatë qëndrimit në burg në favor të personave “të dënuar për një krim të kryer me qëllime terrorizmi apo përmbysjeje të rendit kushtetues apo për një nga krimet e parashikuara në nenin 51, parag. 3-*bis*, të kodit të procedurës penale, “që edhe pas dënimit, kanë pasur sjellje bashkëpunimi të tillë që mundëson dhënien e rrethanave lehtësuese të parashikuara nga kodi penal apo nga dispozitat e posaçme”.

³⁵⁶ Bëhet fjalë për këto përfitime gjatë qëndrimit në burg: lirim me kusht, leje shpërblim, pranim i masës së burgimit në shtëpi parashikuar nga neni 47-*ter* i ligjit n.354, i dt. 26 korrik 1975, dhe i ndryshimeve të mëvonshme.

³⁵⁷ Bëhet fjalë pikërisht për krimet e parashikuara nga nenet nga 600 deri në 604, të cilave, pas ndryshimit të sjellë nga neni 4 i ligji n.38, dt. 6 shkurt 2006, u duhet shtuar krimi i “Pornografisë virtuale” (“Dispozitat siç në nenet 600-*ter*, 600-*quater* zbatohen edhe kur materiali pornografik përfaqëson imazhe virtuale të realizuara duke përdorur imazhe të të miturve nën tetëmbëdhjetë vjeç apo pjesë të tyre, por dënimi ulet nga një e treta. – Me imazhe virtuale kuptohen imazhe të realizuara me teknika të përpunimit grafik që nuk lidhen plotësisht apo pjesërisht me situata reale, cilësia e shfaqjes së të cilave i bëjnë situatat të duken si reale”), tani parashikuar dhe dënuar nga neni 600-*quater* të k.p..

³⁵⁸ Në bazë të nenin 9 parag.3 i dekretligjit n.8, të vitit 1991 cit., “Për qëllime të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes marrin rëndësi bashkëpunimi apo deklaratat e dhëna gjatë një çështjeje penale. Bashkëpunimi dhe deklaratat duhet të jetë mirëfilltasi të besueshme. Gjithashtu duhet të përmbajnë informacione të reja apo plotësuese apo për elementë të tjerë duhet të duken si shumë të rëndësishme për zhvillimin e hetimeve apo për qëllime të gjykimit apo për veprimtaritë hetimore mbi tiparet strukturore, pajisjen me armë, lëndë shpërthyesë apo të mira, degëzimet dhe lidhjet e brendshme apo ndërkombëtare të organizatave kriminale të llojit mafioz apo terroristo-subversiv apo mbi objektivat, qëllimet dhe modalitetet operative të këtyre organizatave”.

Tani, nuk mund të na shpëtojë fakti që formulimi i rrethanës lehtësuese sjell jehonën e paradigmave analoge të lehtësimit të posaçëm të dënimit, me funksion shpërblyes, të shqyrtuar më parë, mbi të cilët është e tepërt të ndalim vëmendjen e interpretuesit. Nga ana tjetër, mekanizmi i shpërblimit është zhvilluar përmes parashikimit të një rrethane lehtësuese të posaçme, parashikuar për një mbrojtje më të madhe të autonomisë dhe lirisë së viktimës së mitur, pa u vlerësuar dhe stimuluar absolutisht, përmes dhënies së një rrethane lehtësuese të posaçme, si ajo e përftuar me nenin 8 të dekretligjit nr. 152 dt. 1991, bashkëpunimi gjyqësor i autorit të krimeve të mësipërme, edhe në drejtime të tjera, duke mos e nënvleftësuar me përpjekjen e thjeshtë konkrete në mënyrë që i mituri nën tetëmbëdhjetëvjeçar, viktimë e krimit, të rifitojë autonominë dhe lirinë e tij³⁵⁹.

Parashikimi i munguar i një rrethane lehtësuese për bashkëpunimin, me gjithë një regjim të favorshëm në burgje, për bashkëpunëtorët e drejtësisë që janë përgjegjës të krimeve të trafikut të qenieve njerëzore dhe të pedopornografisë, mund të përbëjë një fre, deri edhe një pengesë serioze, për sjellje bashkëpunimi me synim përfitim të përfitimeve domethënëse, jo vetëm për sa i përket burgimit, por edhe e sidomos me qëllim një ulje të ndjeshme të dënimit.

Caqet e kësaj trajtese nuk na lejojnë të trajtojmë, me përjashtim të ndonjë shpjegimi të shkurtër, problematikat e shumta dhe të ndërlikuara në lidhje me pasqyrimet e shpërblimit gjatë gjykimit dhe burgimit³⁶⁰.

Është megjithatë për t'u përmendur fakti se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 45 dt. 2001, që ka ndryshuar në mënyrë domethënëse disiplinën zanafillore të mbrojtjes dhe të trajtimit sanksionues të atyre që bashkëpunojnë me drejtësinë, përfitimi substancial i shpërblyeshmërisë rezulton në njëfarë mënyre i prekur, si në një sistem të enëve komunikuese, nga ai administrativ-i burgjeve.

³⁵⁹ Lidhur me këtë pikë, krs. E.ROSI, *Tutela della vittima ed azione di contrasto alla tratta degli esseri umani: strumenti, normative e strategie in Italia ed in Europa*, relacion i paraqitur në Forumin ndërkombëtar dhe evropian për kërkim mbi migracionin, 2 mars 2006, fq. 17-18.

³⁶⁰ Për një pasqyrim përmbledhës të instituteve kryesore përkatëse, *lato sensu*, problematika e shpërblyeshmërisë, në sistemin procedural dhe të burgimit, shih G.SPANGHER, *La protezione del testimone*, në *Studium juris*, 1999, 1339 e në vijim; P.GIORDANO, *vep.cit.* 921 e në vijim.

Megjithatë nuk ka një marrëdhënie të ndërvartësisë automatike mes marrjes së masave të posaçme të mbrojtjes për bashkëpunëtorët e drejtësisë dhe lëshimit, në favor të tyre, të përfitimeve gjatë burgimit, duke kufizuar ndalesat dhe kufizimet sipas nenit 4-*bis* të sistemit të burgjeve³⁶¹. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 45 dt. 2001, dhënia e përfitimeve në fjalë është akoma e çliruar nga përftimi eventual i masave administrative të mësipërme me qëllim garantimin e paprekshmërisë së subjektit bashkëpunues, ndërsa marrin një rëndësi të jashtëzakonshme sjelljet e bashkëpunimit të vlefshme gjatë gjyqit dhe objekt vlerësimi nga ana e gjykatësit për trajtimin sanksionues³⁶². Në një këndvështrim të tillë, kushti i pendimit, shprehimisht i kërkuar nga neni 16-*nonies* përftuar me dekretligjin nr. 8 dt. 1991 me ligjin nr. 45 dt. 2001, merr një rëndësi autonome, duke mos mundur të jetë objekt i vlerësimeve hamendësore, të formuluar vetëm mbi bazën e një bashkëpunimi të kryer dhe të mungesës së lidhjeve aktuale të të dënuarit me krimin e organizuar. Në të kundërt një kusht i tillë duhet vërtetuar me elemente të tjera specifike të çdo lloji natyre por të tilla që të tregojnë konkretisht ekzistencën efektive, qoftë edhe në terma probabiliteti racional³⁶³.

Neni 9 i dekretligjit nr. 8 dt. 1991, i zëvendësuar nga neni 2 i ligjit nr. 45 dt. 2001, duke vendosur “kushtet e zbatueshmërisë të masave të posaçme të mbrojtjes”, sjell një sërë kriteresh normative që përcaktojnë karakteristikat e “sjelljes së bashkëpunimit” qoftë edhe me qëllim zbatimin e këtyre masave. Paragrafi i tretë i nenit *të ri* nr. 9 vendos se “bashkëpunimi dhe deklaratat” (dallimi terminologjik duket se pasqyron dallimin mes bashkëpunëtorëve dhe dëshmitarëve të drejtësisë) duhet të kenë tiparet e mëposhtme:

1. besueshmëri të brendshme
2. risi, ose, si alternativë,
3. plotësi ose, për elementet e tjera, duhet të duken
4. me rëndësi të madhe për zhvillimin e hetimeve ose me qëllim gjykimin ose për veprimtarinë hetimore
 - a) mbi tiparet strukturore, pajisje me armë, lënë plasëse apo pasuri, nyjëtimet dhe lidhjet e brendshme dhe ndërkombëtare të organizatave kriminale të llojit mafioz ose teroriste eversive ose

³⁶¹ Përpara shfuqizimit të nenit 13 – *ter* të dekret ligjit n.8 të vitit 1991, kryer me ardhjen në fuqi të nenit 7 të ligjit n.45 të vitit 2001, ky automatizëm ish konfirmuar në jurisprudencë (shih Kas., 23 nëntor 2000, Prudenzano, në *C.E.D. Cass.*, N.217510.

³⁶² Krs.Kas., 21 shtator 2004, Fabiano, *C.E.D.cass.*, n.229782.

³⁶³ Në këtë kuptim, krs.Kas., 18 nëntor 2004, Furioso, *C.E.D. Cass.*, n.230137.

b) mbi synimet dhe mënyrat operative të këtyre organizatave.

Përveç kësaj, nga përmbajtja e nenit 16-*quater* e ligji nr. 82 dt. 1991, përfutur me nenin nr. 141 numër 45, deduktohen kërkesa të tjera formale dhe substanciale të cilat kërkojnë nga ligji “me qëllim lëshimin e masave të posaçme të mbrojtjes” (paragrafi 1): në fakt është e nevojshme që deklaratat bashkëpunuese, “të dokumentuara në një procesverbal që quhet ‘procesverbali tregues i përmbajtjes së bashkëpunimit’”, që hartohet nga prokurori i Republikës brenda 180 ditësh nga shfaqja e vullnetit për të bashkëpunuar, të përmbajnë jo vetëm “të gjitha të dhënat” në zotërim të deklaruesit, “me dobi për rindërtimin e fakteve dhe rrethanave mbi të cilat është marrë në pyetje si dhe për faktet e tjera me rëndësi më të madhe dhe alarm shoqëror që ai e njeh përveçse për identifikimin dhe kapjen e autorëve të tyre si edhe informacione të nevojshme që të mund të veprohet me identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të hollave, të pasurive dhe çdo përfitimi që” vetë bashkëpunëtori “ose, duke iu referuar të dhënave të njohura prej tij, pjesëtarë të tjerë të grupit kriminal disponojnë drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt”.

Por nuk mjafton. Në bazë të paragrafit 4 të të njëjtit nen 16-*quater*, bashkëpunëtori duhet të vërtetojë³⁶⁴, veç të tjerash, “se nuk zotëron të dhëna dhe informacione që mund të përdoren në gjyq mbi fakte dhe situata të tjera, edhe nëse nuk janë të lidhura me ato të sjella, me rëndësi të veçantë ose sidoqoftë të tilla që të vënë në dukje rrezikshmërinë shoqërore të subjekteve ose grupeve kriminale”. Po ta shohësh mirë, përmbushja e këtij detyrimi nga ana e bashkëpunuesit mund të sjellë një element të ri me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së brendshme të vetë deklaratës bashkëpunuese e cila, sipas pritshmërisë së arsyeshme të hetuesve, duhet patjetër të përmbajë një referim, qoftë edhe përmbledhtas, tek të ashtuquajturat *fakte të paharrueshme*. Bëhet fjalë, në këtë rast, për fakte që, edhe pse nuk rezultojnë të lidhura me ato që përbëjnë objektin kryesor të deklaratave bashkëpunuese, janë (dhe perceptohen nga deklaruesi si të tilla) kaq të rënda, ose vënë në dukje situata rrezikshmërie shoqërore të subjekteve apo grupeve kriminale sa të mos kapërcehen racionalisht pa i vajtur kundër, për këtë, besueshmërisë së brendshme të vetë bashkëpunimit.

Caqet e kësaj trajtëse nuk na lejojnë të përthellojmë më tej problematikën në lidhje me çështjet e lartpërmendura. Këtu mjafton të vëmë në dukje se, përmes sa vendos neni nr. 45 dt. 2001, është realizuar një lloj zhvendosje normative e dispozitave në lidhje me kushtet dhe mënyrat

³⁶⁴ Termi “vërteton”, i përdorur në paragrafin 4 të nenit 16-*quater*, tregon detyrueshmërinë e vërtetimit.

formale të bashkëpunimit, të vendosura me qëllim dhënien e masave të posaçme mbrojtëse, në të njëjtën paradigëm legislative të “rrethanave lehtësuese që kodi penal dhe dispozitat e veçanta parashikojnë në fushë të bashkëpunimit, në lidhje me krimet sipas nenit 9, paragrafi 2”. Në fakt, dhënia nga ana e gjykatësit e rrethanës lehtësuese të posaçme i nënshtrohet shprehimisht kushtit që (“...mund t’i jepen vetëm...”) ai që ka bërë deklaratat bashkëpunimi të ketë nënshkruar, në kohën e parashkruar me ligj, *procesverbalin tregues*. Përmbushja e një kushti të tillë, për t’u vërtetuar “edhe me nismën vetjake” (shih. Neni 16-*quinquies*, paragrafi 2) nga ana e gjyqtarit, me përjashtim të rasteve të bashkëpunimit të shfaqura gjatë shqyrtimit gjyqësor³⁶⁵, sjell zbatimin e normave të vendosura nga neni 16-*quater*, në lidhje me mënyrat formale dhe të kërkesave substanciale të deklaratave të përmbajtura në *procesverbalin tregues*. Dhe as nuk mund të kundërshtohet fakti që këto kërkesa, që i referohen nga ana e tyre përmbajtjes së vetë deklaratave bashkëpunuese, duhet t’u përgjigjen “karaktereve” të treguara në nenin 9 (besueshmëri e brendshme, risi, plotësi, etj.). Ja, pra që të paktën në rrafshin e kushteve paraprake përkatëse të zbatimit, vërtetohet një përzierje mes shpërblimit (të së drejtës substanciale) dhe mbrojtjes (në rrafshin administrativ të përfuturit të masave të mbrojtjes), me gjithë ndarjen e pastër mes dy çasteve, me të drejtë e dashur nga doktrina³⁶⁶.

Për sa i përket institutit të burgimit, hartimi i procesverbalit që tregon përmbajtjen e bashkëpunimit, pasi përbën, siç u tha, kushtin themelor për dhënien e “lehtësimeve në rast bashkëpunimi” cekur në nenin 16-*quinquies*, do të bëhet, njëkohësisht, të paktën për bashkëpunimet me drejtësinë të shfaqura pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 45 dt. 2001³⁶⁷, një nga kushtet paraprake për zbatimin e përfitimeve gjatë burgimit të treguar në nenin 16-

³⁶⁵ Në këtë rast, në bazë të nenit 16-*quinquies*, parag.3.

³⁶⁶ Lidhur më këtë pikë, shih F.ROBERTI, *Nella netta distinzione tra premio e tutela un contributo al superamento delle distorsioni*, në *Guida al dir.*, 2001, nr.11, 45 e vijuese.

³⁶⁷ Sipas R.ALFONSO, *Sorte dubbia per chi ha già riferito ai magistrati*, në *Guida al dir.*, 2001, nr.11, 72, “nuk duket (...) se dispozita [e nenit 16-*quinquies*: shënim i redaktorit] mund të gjejë zbatim për bashkëpunëtorët që, në bazë të ligjit parashikues, i nënshtrohen programit të mbrojtjes apo masave urgjente të mbrojtjes, dhe që, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara nga po këto dispozita, kanë rënë dakord në momentin e ardhjes në fuqi të ligjit të ri për bashkëpunimin e tyre, në kuptimin që i kanë lëshuar prokurorit deklaratat mbi të gjitha faktet për të cilat ata janë në dijeni”. Sipas autorit, do ish e nevojshme të futej në ligjin nr.45, të vitit 2001 një dispozitë e ngjashme me atë që përmban ligji antiterrorizëm nr.34, i vitit 1987, në sajë të të cilit i njëjti bashkëpunëtorit e drejta t’i kërkonte prokurorit të plotësonte deklaratat mbi fakte për të cilat ende nuk ish shprehur.

nonies të të njëjtit ligj³⁶⁸. Bëhet fjalë për mundësinë për të dhënë, “edhe duke u larguar nga dispozitat në fuqi, përfshi ato që kanë të bëjnë me kufizimet e dënimit sipas nenit nr. 176 K.P. [lirim me kusht: shën. i red.] dhe neneve 30-ter [leje si shpërblim: shën. i red.] dhe 47-ter [arrest shtëpie] të ligjit nr. 34, dt. 26 korrik 1975 dhe ndryshimeve të mëvonshme” një nga përfitimet e burgimit të lartpërmendura, duke mbetur i pandryshueshëm kushti që në rastin e masave të dhënies së përfitimeve që largojnë nga caqet e dënimit, këto mund të merren vetëm nëse, brenda kohës së parashkruar nga neni 16-*quater*, hartohet procesverbali që tregon përmbajtjen e bashkëpunimit dhe, vetëm nëse nuk bëhet fjalë për një leje shpërblim, vetëm pasi të ketë shlyer të paktën një të katërtën e dënimit ose, nëse bëhet fjalë për një të dënuar me burgim të përjetshëm, pas shlyerjes së të paktën dhjetë vjetëve³⁶⁹.

Mbi këtë pikë, është e rëndësishme të nënvizohet roli i rëndësishëm propozues apo këshillimor i caktuar, për sa u përket kompetencave përkatëse, për prokurorët e rretheve dhe prokurorin kombëtar antimafie, të cilët, në bazë të nenit 16-*nonies*, jo vetëm që “japin çdo informacion të dobishëm mbi karakteristikat e bashkëpunimit të dhënë (formula ligjore kujton parametrat e treguara në paragrafin e tretë të nenit 9 të po këtij ligji), por “me kërkesë të gjykatës apo të gjykatësit të mbikëqyrjes, i bashkëlidhin propozimit ose mendimit të tyre një kopje të procesverbalit që tregon përmbajtjen e bashkëpunimit dhe, nëse bëhet fjalë për një person që është nën masa të posaçme mbrojtjeje, masën përkatëse të zbatimit”. Në zbatim të paragrafit të tretë të të njëjtit nen, propozimi apo mendimi duhet të

³⁶⁸ Për çështjet në lidhje me regjimin kalimtar të zbatueshëm për bashkëpunëtorët “e vjetër” të pranuar më parë në programin e mbrojtjes, shih *Aut.dhe vep.cit e fundit*, fq. 71 e vijuese. Sipas Kas., 16 tetor 2003, Bertolotto, *C.E.D. Cass.*, n.225752, në lidhje me përfitimet gjatë qëndrimit në burg, rregullimi më i rreptë që diktohet në lidhje me zbatueshmërinë e tyre në favor të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, nga neni 16-*nonies cit.*, gjen zbatim edhe ndaj personave bashkëpunimi i të cilëve ka nisur ndërkohë që ish në fuqi rregullimi më i volitshëm që diktohej nga neni i shfuqizuar 13-ter i dekretligjit nr.8, i vitit 1991, pasi nuk mbështetet në lëndë ligjesh penale substanciale dhe duke mos gjetur kështu zbatim parimi i mosprapaveprueshmërisë së përcaktuar, për ato më të disfavorshme, nga neni 2 i k.p. (për këtë shih Kas., 12 korrik 2005, Pepe, *C.E.D., Cass.*, n.232218). Gjykata e kasacionit (vend.N.39722 dt. 19 tetor 2005, *C.E.D.Cass.*, n.232952) ka saktësuar gjithashtu se regjimi i mëparshëm dhe më i volitshëm ligjor është i zbatueshëm vetëm nëse është në ekzekutim e sipër trajtimi alternativ në kohën e ardhjes në fuqi të *ius superveniens* më restriktive.

³⁶⁹ Është ngritur problemi i zbatueshmërisë së kushteve të mësipërme restriktive edhe për bashkëpunëtorët që e kanë dhënë gjithë ndihmën e tyre përpara ardhjes në fuqi të ligjit nr.45, të vitit 2001. Për ndikimet e qarta substanciale *de libertate* të këtij rregullimi, më pak i volitshëm se ai parashikues, i ndërfutur nga ligji nr.45 i vitit 2001, duket se nuk mund të bëhet pjesë e legjislacionit jurisprudencial të Gjykatës së kasacionit.

përmbajnë, përveç kësaj, vlerësimin e sjelljes dhe të rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit bashkë me saktësimin specifik që ky nuk ka refuzuar kurrë t'i nënshtrohet marrjes në pyetje apo shqyrtimit apo ndonjë akti tjetër hetimor gjatë procedimit penal në të cilin ka dhënë bashkëpunimin e tij. Përveç kësaj duhen saktësuar “elementet e tjera të rëndësishme me qëllim vërtetimin e pendimit edhe duke iu referuar aktualitetit të lidhjes me krimin e organizuar ose subversiv”.

Doktrina është marrë edhe me pasqyrimin, në rrafshin gjyqësor penal, të disiplinës së re mbi bashkëpunëtorët e drejtësisë përfutur me ligjin nr. 45³⁷⁰. Mirë pra, duke lënë mënjanë çdo vërejtje tjetër mbi këtë pikë, duhet përmendur se një aspekt i rëndësishëm i shpërblyeshmërisë, le të themi, gjyqësore, përbëhet nga mundësia, për bashkëpunëtorin e drejtësisë, që i është nënshtuar masës së paraburgimit, i cili gjendet në kushtet që “lejojnë dhënien e rrethanave lehtësuese parashikuar nga kodi penal ose nga dispozita të veçanta”, që të mund të përfitojë revokimin ose zëvendësimin e paraburgimit (neni 16-*octies*). Kjo masë mund të merret, pasi të jenë dëgjuar prokurori kombëtar antimafie ose prokurorët e përgjithshëm pranë gjykatave të apelit përkatëse, vetëm nëse rezultojnë se janë përmbushur dy kushte:

1. Së pari, gjykatësi nuk duhet të ketë marrë “elementë nga të cilët deduktohet aktualiteti i lidhjeve [të bashkëpunëtorit të drejtësisë: shën. i red.] me krimin e organizuar të llojit mafioz ose terrosist eversiv”;

2. Së dyti – dhe përngjitazi - , që bashkëpunëtori, në rastet kur është subjekt i masave të posaçme të mbrojtjes, ka respektuar angazhimet e marra në bazë të nenit nr. 12³⁷¹.

³⁷⁰ Për “shpërblyeshmërinë procedurale” flet G.SPANGHER, *La protezione del testimone*, cit., 1340. Sipas autorit, “sistemi i shpërblyeshmërisë substanciale dhe i shpërblyeshmërisë gjatë qëndrimit në burg është i destinuar të shkojë drejt procesit penal. Pra në rastet kur ndihma e bashkëpunimit, si mbi veprën e krye rvetë, ashtu dhe – mbi të gjitha – mbi veprën e kryer nga të tjerët, vlerësohet shumë”. Për një kuadër përmbledhës të “aspekteve shpërblyese në sistemin procedural”, shih edhe P.GIORDANO, *Profili prmeiali della risposta punitiva dello Stato*, cit., 926-927.

³⁷¹ Përveç detyrimeve për njoftim në lidhje me gjendjen civile, të familjes dhe pasurisë dhe detyrimeve të tjera siç në paragrafin e parë, neni 12, parag.2, i dekretligjit n.8, të vitit 1991 përcakton se bashkëpunëtorët e drejtësisë, në aktin e nënshkrimit të programit të mbrojtjes, angazhohen personalisht të:

- a) respektojnë normat e sigurisë të përcaktuara dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në zbatimin e masave;
- b) nënshtrohen marrjes në pyetje, verifikimit apo ndonjë veprimi tjetër hetimor përfshirë këtu atë që parashikon hartimin e një procesverbali shpjegues të përmbajtjes së bashkëpunimit;

Para se ta mbyllim këtë pasqyrë të dispozitave kryesore ligjore të ligjit me natyrë shpërblyese të pranishme në sistemin tonë në fushë të krimit të organizuar, nuk është e tepërt të përmendim disa masa ligjore që, edhe pse kanë të bëjnë me lëndë dhe masa të natyrës administrative, mbeten gjithnjë brenda sistemit të kundërshtimit të krimit të organizuar, duke përbërë një front, mund të themi, të përparuar, një lloj pozicioni të përparuar normativ të shpërblyeshmërisë. Duam t’i referohemi dispozitave të përmbajtura në nenin 18 të tekstit unik të ligjeve mbi emigracionin³⁷² dhe normave në fuqi që kanë të bëjnë me themelimin dhe administrimin financiar të Fondit anti-fajde³⁷³, të cilat, barabar me dispozitat në lidhje me krijimin e Fondit të mbështetjes për viktimat e kërkesave për zhatje³⁷⁴ dhe Fondit për masat

-
- c) përbushin detyrimet e parashikuara nga ligji dhe nga detyrimet për të cilat është rëndë dakord;
 - d) mos lëshojnë para subjekteve të ndryshëm nga autoriteti gjyqësor, forcat e policisë dhe avokati i vet mbrojtës deklarata në lidhje me fakte që paraqesin sidoqoftë interes për çështjet lidhur me të cilat kanë dhënë apo japin bashkëpunimin e tyre dhe të mos takojnë dhe as kontaktojnë, me asnjë mjet apo ndërmjetës, asnjë person që merret me krimin, as, përveç rastit kur autorizohet nga autoriteti gjyqësor nëse ekzistojnë nevoja të rënda lidhur me jetën familjare, asnjë nga personat që bashkëpunojnë me drejtësinë;
 - e) specifikojnë në hollësi të gjitha pasuritë që zotëron apo kontrollon, drejtpërsëdrejti apo përmes një personi tjetër, dhe dobitë e tjera që disponon drejtpërsëdrejti ose jo, si dhe, menjëherë pas pranimit në masat e posaçme të mbrojtjes, të derdhë paratë të ardhura nga veprimtari të paligjshme. Autoriteti gjyqësor kujdeset të sekuestrojë menjëherë paratë dhe të mirat dhe dobitë e lartpërmendura”.

³⁷² Dekreti legjislativ n.286, i dt.25 korrik 1998 (Teksti unik i dispozitave në lidhje me rregullimin e migracionit dhe normat mbi gjendjen e të huajit).

³⁷³ I krijuar pranë zyrës së Komisarit të jashtëzakonshëm të Qeverisë për bashkërendimin e veprimtarive anti-racket, “Fondi i solidaritetit për viktimat e fajdes”, siç në nenin 14 të ligjit n.108, dt. 7 mars 1996, kujdeset të japë kredi pa interes me një kohëzgjatje jo më të madhe se dhjetë vjet në favor të personave që ushtrojnë veprimtari sipërmarrëse, tregtare, artizanale apo sidoqoftë ekonomike, apo një zanat apo profesion i lirë, të cilët deklarojnë se janë viktimat të krimit të fajdes dhe rezultojnë palë të dëmtuara në çështjen përkatëse penale.

³⁷⁴ Shih dekretligjin n.419, dt. 31 dhjetor 1991, kthyer me ndryshime në ligjin n.172, dt. 18 shkurt 1992. Kjo normativë parashikon ndër të tjera, dhënie fondesh financiare për rimëkëmbje ndaj dëmeve të shkaktuara si pasojë e mospranimit të kërkesave për zhatje. Ndër kushtet që mundësojnë këtë është edhe ai – sigurisht me karakter *promovues*, në kuptimin e treguar më lart – që “vepra kriminale është denoncuar para autoritetit gjyqësor pa vonesë dhe duke treguar të gjitha hollësitë për të cilat është në dijeni”. Gjithashtu, edhe në rastin kur viktimat e kërkesave zhatëse rezultojnë se u është nënshtruar masave parandaluese apo akteve që vendosin ndalime, pezullime apo shfuqizime në bazë të nenit 10 dhe 10-*quater*, paragrafi i dytë, ligji nr.575, dt.31 maj 1965 (situata që pengojnë në vetvete dhënie e financimit si më lart), financimi jepet njësoj “kur viktimat i jep një ndihmë të madhe autoritetit të policisë dhe autoritetit gjyqësor në mbledhjen e elementëve

anti-trafik³⁷⁵, përbëjnë një stimul të padyshimtë për bashkëpunimin me drejtësinë për viktimat e këtij lloji krimesh, shpesh të kryer nga veprimtaria dhe interesat kriminale të krimit të organizuar.

Është me interes të vëmë re se me masat ligjore të lartpërmendura është vënë në vijë një strategji e re e kundërshtimit të krimit të organizuar e realizuar përmes masave të duhura të mbrojtjes dhe të mbështetjes materiale dhe morale të viktimave të fakteve të rënda kriminale (trafikimi i qenieve njerëzore, shfrytëzimi i prostitucionit dhe fenomene të tjera të rënda kriminale si rrëmbimi dhe fajdet), në shumicën e rasteve të kryera nga krimi i organizuar. Njëherësh – si në rastin e nenit 18 të lartpërmendur – është parashikuar marrja e masave, në rrafshin administrativ, e masave të natyrës shpërblyese, si dhënia për të huajt, edhe pse të hyrë si klandestinë në territorin e Shtetit, e një “lejeje të posaçme qëndrimi” “për motive të mbrojtjes shoqërore”. Në të vërtetë një masë e tillë nuk zbaton vetëm një qëllim me karakter humanitar³⁷⁶, por merr një karakter të vërtetë shpërblyes, në kuptimin që parashikon një shpërblim të posaçëm, në formën e lëshimit (gati gjithmonë i shumëpritur) të lejes së qëndrimit në favor të të huajit viktimë e gjendjeve të dhunës apo të shfrytëzimit të rëndë dhe, për këtë, në gjendje rreziku për jetën e tij, “si pasojë e përpjekjeve për t’iu shmangur kushtëzimeve të një organizate” me qëllim një nga krimet e rënda të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr. 75, dt. 1958 apo neni 380 K.P., ose si rrjedhojë e deklaratave (bashkëpunuese) të lëshuara gjatë hetimeve paraprake apo gjyqësore. Prej këtej, nuk mund të mohohet se dispozita shpërblyese përmban në vetvete një karakter padyshim *promovues*, në kuptimin që synon të promovojë sjellje të largimit nga kushtëzimet materiale dhe/ose psikologjike që grupet kriminale me qëllim shfrytëzimin e emigrantëve klandestinë janë në gjendje të provokojnë gati gjithmonë. Bëhet fjalë për “largime nga organizata” që më tepër shfaqen gjatë gjykimit penal dhe marrin, më së shumti, tiparet e sjelljeve të tjera bashkëpunuese tipike, posaçërisht të marra në konsideratë nga e drejta *shpërblyese* penale, substanciale, e gjyqit, e burgimit.

përcaktues për rindërtimin e fakteve dhe për zbulimin dhe kapjen e autorëve të krimit nga ku ka rrjedhur dëmi, apo të krimeve që lidhen me të në bazë të nenit 12 të kodit të procedurës penale”.

³⁷⁵ Shih nenin 12 të ligjit nr.228, të dt.11 gusht 2003. Fondi për masat anti-trafik të qenieve njerëzore është i destinuar të financojë programet e përkujdesjes dhe të rehabilitimit në shoqëri në favor të viktimave, si dhe të qëllimeve të tjera të mbrojtjes sociale të parashikuara nga neni 18 i tekstit unik të dispozitave në lidhje me rregullimin e migracionit dhe normat mbi gjendjen e të huajit, siç në dekretin legjislativ nr.286, të dt. 25 korrik 1998.

³⁷⁶ Siç duket se sygjeron titulli i kreut III (Dispozita me karakter humanitar).

Siç mund ta shohë kushdo, horizonti i së drejtës shpërblyese larg nga ideja e një *trafiku* të dyshimtë *ndjesish*, duket se përfaqon tani edhe perspektivën humanitare të mbrojtjes së viktimave, në një shikim modern të së drejtës procedurale që nuk lë pas dore rolin qendror të këtyre të fundit në procesin penal.

CORRADO LEMBO
Prokuror Kombëtar Antimafie
Drejtoria e Kombëtare Antimafie

Romë, Tetor 2007

3.3. Arsyetimi i provës, rregulla të vlerësimit dhe pranimit të provës dhe relacioni përfundimtar i prokurorit. Përdorimi i sistemeve dhe teknologjive në relacionin përfundimtar të prokurorit.

§ 1. Parimi i bindjes së lirë të gjyqtarit dhe ligjësimi i marrjes së provës.

Është e njohur tashmë se ligjvënësi italian i 1988 gjatë rishikimit të gjithë sistemit procedural – në përputhje me zakonet e “sistemit” akuzator – zgjodhi haptazi – ligjësimin e mënyrës së krijimit dhe vlerësimit të provës.

U riafirmua dhe një herë parimi i bindjes së lirë të gjyqtarit, duke përjashtuar kështu ato mënyra arsyetimi që prireshin të paracaktonin – në mënyrë abstrakte – vlerat e çdo elementi njohës, por në të njëjtën kohë u bë e mundur të parashikohej një “tërësi normash” të cilat nga njëra anë ishin në gjendje të siguronin:

- përdorimin, me synim marrjen e një vendimi, e elementëve të veçantë të përftuar në përputhje me rregullat e debatit gjyqësor. Bëhet fjalë për ato rregulla me anë të të cilave përcaktohen “ato çka duhet të përdoren për marrjen e vendimit”;

- përdorimi, me synim marrjen e një vendimi, i rregullave të arsyetimit gjatë vlerësimit të provave, për të cilat gjyqtari duhet të përgjigjet në paraqitjen e fjalës së tij. Bëhet fjalë për ato rregulla me anë të të cilave përcaktohet “mënyra e marrjes së provave”.

Para së gjithash kemi të bëjmë me një segment normativ që lidhet me përzgjedhjen e materialit të provës tek i cili gjyqtari mund të mbështesë vendimin e tij:

Paraqesin rëndësi këto norma:

- neni 191 k.p.p. (Kodi Procedurës Penale), mbi ndalimin e përdorimit të provave të përfuara në mënyrë të paligjshme;

- neni 526 k.p.p., mbi provat që mund të përdoren për marrjen e vendimit;

- neni 606, paragrafi 1, germa c) k.p.p. që parashikon mundësinë e rekursit në Kasacion në rast të mosrespektimit të normave procedurale të përcaktuara si të pavlefshme, të papërdorshme apo të pa dobishme

Ndërsa në themel qëndrojnë normat që mbrojnë krijimin e provave të cilat bazohen në parimin e krijimit të provës gjatë debatit gjyqësor, që tashmë renditet ndër parimet Kushtetuese (neni 111, paragrafi 3 i Kushtetutës).

Më tej kemi normat të cilat e detyrojnë gjyqtarin që të zbatojë kritere juridike në marrjen e provave:

- përdorimin e kritereve vlerësuese transparente dhe që mund të vërtetohen (krs. nenin 192, parag. 1 sipas të cilit gjyqtari e vlerëson provën duke dhënë llogari për arsyetimin (motivimin) e rezultateve të përfuara dhe të kritereve të përdorura; neni 546, parag. 1, germa e), sipas të cilit vendimi duhet të përmbajë paraqitjen e saktë të motiveve faktike dhe ato të së drejtës në të cilat bazohet ky vendim, duke përcaktuar provat mbi të cilat mbështetemi në marrjen e vendimit si dhe në shpalljen e arsyeve sipas të cilave konsiderohen si jo të besueshme provat e kundërta me to; neni 606, paragr. 1, germa e) k.p.p.);

- përdorimi i kritereve vlerësuese “të modeluara” sipas *llojeve të ndryshme* (e për më tepër në bazë të “aftësive të ndryshme treguese”) të elementëve të veçantë të provës, objekt i arsyetimit (krs. nenin 192, parag. 2, 192, parag. 3 si dhe, në lidhje me rrethanat përfutuese, nenin 500, parag. 4 dhe parag. 5 k.p.p.).

Pra, kuptimi i normativizimit (ligjësimit) është më se i qartë: nuk nënkupton paracaktimin e rezultatit të vlerësimit, çka i përket aftësive rikrijuese të subjektit që gjykon, aftësi të përfuara në bazë të përvojës perceptuese dhe zbatimit të kritereve të zakonshme logjike – empirike të gjetjes së kuptimit në çdo element apo ndihmesë, por vendos:

- “kritere metodike” (debati gjyqësor) për krijimin e provës;
- rregulla formale për marrjen dhe përdorimin e plotë të një të dhëne e “aftë” të arsyetojë vendimin gjyqësor;
- “kritere minimale vlerësimi”, fryt i kristalizimit të përvojës, të cilat, ushtrimin e aftësisë rikrijuese priren ta udhëheqin në përputhje me parametrin e *kujdesit të natyrshëm* të gjyqtarit teksa ndalet në disa “kategori ontologjike” të veçanta të elementëve të provës.

§ 2. Veçoritë dhe vlerësimi i provës së dyshuar në veçanti.

Dallimi kryesor, në rrafshin e “aftësisë përfaqësuese” të elementëve të provës, është ai midis provës “historike” (apo “te drejtpërdrejtë”) dhe asaj “kritike” (apo “të dyshuar”).

Dihet se kjo ndarje nuk ka të bëjë me “llojin” e burimit të provës (për shembull, një dëshmitar mund të jetë mbartës si i “grupit” të parë ashtu dhe i

“grupit” të dytë të elementëve), por me lidhjen që ekziston ndërmjet “aftësisë treguese” të secilit prej elementëve të marrë në shqyrtim dhe “faktit që duhet provuar”, çka përshkruhet në akuzë, marrë në tërësinë e materialitetit të tij objektiv. Nga kjo pikëpamje, si provë kritiko – dyshuese, mund të konsiderohet çdo ndihmesë njohëse e cila, dhe pse drejtpërdrejt nuk përfaqëson faktin që duhet provuar, – mbi bazën e një bashkërendimi logjik të disa rrethanave apo ngjarjeve – jep ndihmesë në zbulimin e tij (nga fakti i njohur arrihet në faktin e panjohur).

Përkufizim: prova (e dhëna) është një fakt konkret prej të cilit, si rezultat i përfundimit logjik bazuar në rregullat e një përvoje të konsoliduar dhe të besueshme, arrihet në zbardhjen e faktit që me vështirësi mund të zbulohet nëse do të ndiqnim skemën e silogjizmit gjyqësor.

Ndërkaq, prova (e dhëna) ka një aftësi përfaqësimi të vetën, që falë pjesshmërisë së saj – apo për faktin se ndalet mbi një tjetër rrethanë (por të ndërlidhur) e ndryshme nga fakti që duhet provuar bën të mundur që, në mendjen e subjektit i cili duhet ta rikrijojë atë, të vihet në punë një mekanizëm i përfundimit logjik, i aftë ta udhëheqë drejt një rezultati të pranueshëm njohës të asaj çka përbën interes për gjykimin.

Dhe pikërisht, si rrjedhojë e kësaj “mangësie” strukturore të aftësisë treguese, prova dyshuese përbën objektin e kujdesit të veçantë vlerësues nga ana e ligjvënësit, teksa “rezultati i provës” lidhet me praninë e karakteristikave të veçanta të elementëve që përbëjnë bazën e këtij përfundimi (*rrethana rënduese, saktësia, përputhja*).

Në mënyrë logjike, nga një fakt i vërtetuar, mund të arrihet vetëm në një rezultat (e ashtuquajtura provë e domosdoshme), por, në bazë të normave, fakti provues nënkupton një sërë faktesh të panjohura. Me fjalë të tjera, një provë e caktuar mund të mbartë një dyzim relativ dhe një domethënie të vetën – me përjashtim të së ashtuquajturës provë e domosdoshme, prej së cilës në mënyrë logjike rrjedh vetëm një rezultat – paraqet vetëm rëndësi hamendësimi;

§ 2.1. Kërkesat e të dhënave.

- elementi mbartës i njohjes “jo të drejtpërdrejtë” duhet të jetë i qartë, apo të rrjedhë nga një e dhënë objektive e të mos jetë fryt i hamendësimeve (shih Kas. 13.12.’91, i pandehuri Grillo: - rrethana e marrë si e dhënë, në mënyrë që prej saj të arrihet në përfundimin e ekzistencës së një fakti, duhet të jetë e qartë. Kjo kërkesë, dhe pse neni 192 nuk e parashikon shprehimisht,

duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e tij. Në të vërtetë, nëpërmjet qartësisë së të dhënave, postulohet kontrolli procedural mbi ekzistencën e vetë provës, për të mos lejuar kështu që prova kritike (jo e drejtpërdrejtë) të bazohet mbi një fakt që mund të ketë ndodhur apo hamendësohet se ka ndodhur, çka bën që pashmangshmërisht të vlerësohen – në kundërshtim me parimet juridike – përshtypjet apo fantazia e atij që merr vendimin, apo gjyqtarit...);

- zbatimi i parimeve që rrjedhin nga përvoja e cila bën të mundur që kuptimi “provues” ti njihet të dhënave provuese, të cilat duhet të jenë jo vetëm të qarta dhe të përcaktueshme, por duhet të bazohen dhe në elementë provues rëndues: rënduese janë të dhënat që i rezistojnë kundërshtimeve gjatë debatit, pra që në vetvete kanë një përmbajtje të besueshme dhe bindëse (kërkesa e rrethanës rënduese);

- bëhet fjalë për të dhëna jo të përgjithshme, e që synojnë arritjen e një rezultati të caktuar njohës (kërkesa e saktësisë);

- të dhëna që nuk duhet ti nënshtrohen debatit duke përdorur elementë të ngjashëm apo të një lloji tjetër (kërkesa e përputhjes).

Cilësimi provë logjike, nuk është tregues i një mënyre më pak të kualifikuar në marrjen e provës së drejtpërdrejtë apo historike, nëse kjo kryhet sipas një metode rigoroze e cila mbështet parimin e bindjes së lirë të gjyqtarit (krs. Kas. Pen. Sek. 04.06.1992, nr. 6682, Musumeci e të tjerë).

Ky dyzim i provave apo i të dhënave mund të kapërcehet duke zbatuar rregullin metodologjik që parashikohet në nenin 192, paragrafi II I k.p.p., nëpërmjet një vlerësimi të përgjithshëm, me synim shqyrtimin e faktit nëse kuptimi jo i qartë i tyre mund të zgjidhet në mënyrë tërësore Pra nuk është aspak i drejtë vlerësimi i segmentuar apo i copëzuar i të dhënave të mbledhura.

Vlerësimi tërësor i të dhënave që shërbejnë për të vërtetuar faktin se ato shpiten drejt një qartësie vendimtare, e aftë të sigurojë qartësinë logjike të ekzistencës së faktit që duhet provuar, përbën një veprim logjik që nënkupton vlerësimin paraprak të secilës prej tyre, vec e vec, për të provuar rëndësinë cilësore të secilës në përputhje dhe me parametrat e rrethanës rënduese (apo të bashkëekzistencës së tyre), të saktësisë (pra jo përgjithësuese) dhe të përputhjes (pra që të mos bien në kundërshti me njëra – tjetrën apo me të dhëna të tjera të qarta).

Prej nga rrjedh se çdo e dhënë para së gjithash duhet shqyrtuar në vetvete në cilësinë e objektit të provës për të bërë më tej të mundur rikrijimin, në mënyrë sa më të natyrshme, të ngjarjes mbi të cilën mbështetet akuza.

Këto parime u rrënjosën duke marrë shkas nga vendimi i Kasacionit Penal Sek. i bashkuar nr. 6682, 04.06.1992, i cili u përforcua më tej nga vendimi i Kasacionit Penal Seksioni i Bashkuar nr. 33748 i vitit 2005 (Vendimi Maninno).

Qëllimi: gjatë arsytimit provues një rëndësi të veçantë paraqet shkaku, apo shqyrtimi i qëllimit të krimit. Në këtë lloj hetimesh, hulumtimi duhet të jetë i qartë në mënyrë që të përftojë rëndësinë e duhur në vlerësimin dhe bashkërendimin logjik të përfundimeve të gjykimit, me qëllim që gjyqtari të bindet e të jetë i qartë rreth përgjegjësisë së të pandehurit (krs. Kas. Pen. Sek. I, nr. 1428, 07.02.1996).

Në proceset e vërtetimit të provës, marrja në shqyrtim e qëllimit të krimit nuk përbën një provë tjetër, por është ai element bashkërendues dhe përforcues i efikasitetit provues i çdo të dhëne (Kas. Pen. Sek. I, nr. 12422, 15.12.1995).

Gjatë vlerësimit të materialit provues duhet tu përmbahemi dhe disa **rregullave të tjera juridike**. Për shembull, mjaft elementë të provës janë përftuar nga përmbajtja e përgjimeve telefonike dhe mjedisore. Ndaj, në rastin e përgjimeve nuk gjejnë zbatim nenet 62 e 63 të k.p.p., pasi pohimet me vlera provuese të bëra nga i pandehuri në mënyrë krejt spontane gjatë bisedave telefonike apo mjedisore, përgjimi i të cilave duhet të jetë i autorizuar, nuk mund të përftohen nga dëshmitë apo nga deklaratat e lëshuara gjatë marrjes në pyetje në prani të Autoritetit Gjyqësor apo të atij të Policisë Gjyqësore, sikurse dhe regjistrimet e tyre nuk mund të plotësojnë rripodhimin fonik apo më shkrim të këtyre deklaratave, të cilat na përcjellin në mënyrë të menjëhershme e pa keqkuptime përmbajtjen e tyre.

Ato përbëjnë apo mund të përbëjnë drejtpërsëdrejti provën e fakteve që dokumentojnë. Janë të shumta vendimet e Gjykatës së Lartë që i zbatojnë dhe i përforcojnë më tej këto parime.

E pra, me plotësimin e kërkesave të përmendura më lart, prova (qoftë element plotësues për rikrijimin e ngjarjes, e bazuar kryesisht në burime të një lloji tjetër, apo element “i vetëm” në mbështetje të provës) merr po atë rëndësi dëshmuese sikurse dhe prova e ashtuquajtur “e drejtpërdrejtë”, dhe

kjo e fundit objekt i kujdesit “të natyrshëm” vlerësues (shih Kas. 5.3.’91, i pandehuri Calò, ndër të tjera, Kas. 21.10.’91, i pandehuri Cosseddu).

Në fakt, duhet nënvizuar se dhe në rastin kur gjyqtarit i paraqitet në mënyrë të “drejtpërdrejtë” fakti që duhet provuar (për shembull, rrëfimi i dëshmitarit okular që veprimin kriminal e ka perceptuar si të tillë, duke njohur autorin e krimit), “burimi” i kësaj ndihmese për të qenë sa më larg “zhvendosjes si mirëqenë” në mekanizmin e vendimmarrjes, i nënshtrohet shqyrtimeve të mëtejshme mbi besueshmërinë (në rrafshin e përputhjes logjike, e pranisë së aftësive të përshtatshme perceptuese të tjetrit), gjithnjë e më të hollësishme në raport me interesin e subjektit “rrëfyes” ndaj marrjes së vendimit (shih p.sh. për sa parashikohet lidhur me dëshmitë e personit të dëmtuar që përfaqëson palën civile, në vendimin nr. 115, ’92 të Gjykatës Kushtetuese në të cilin theksohet domosdoshmëria e vlerësimit të deklaratave bazuar në një shqyrtim të kujdesshëm dhe me frymë kritike).

§ 3. Ndihmesa deklaruese dhe vlerësimi i akuzës së bashkëfajësisë.

Pjesa më e madhe e ndihmesës në vjeljen e të dhënave e të provave gjatë hetimeve përbëhet nga dëshmi apo deklaratat të lëshuara nga subjekte të cilat **nuk mund të bëjnë pjesë në kategorinë juridike të dëshmitarëve**, pasi janë të përfshirë, direkt apo indirekt, në faktet objekt i gjykimit (subjekte që nuk pajtohen me cilësinë e dëshmitarit, sipas nenit 197 k.p.p.). Kështu, në mënyrë të pashmangshme lind nevoja për të saktësuar fushën vepruese të rregullave të vlerësimit parashikuar në nenin 192 k.p.p., paragrafi 3 (lidhur me deklaratat e bashkë të pandehurit apo të subjektit të pandehur në një proces të lidhur me të) dhe 4 (rregull që e shtrin kujdesin vlerësues dhe mbi deklaratat e lëshuara nga subjekti i pandehur për një krim të kryer në bashkëpunim).

§ 3.1. Premisa në vlerësimin e këtyre ndihmesave deklaruese: mos interesimi.

Zakonisht, këto deklaratat, pikërisht nisur nga fakti se rrjedhin nga subjekte që marrin përsipër – hamendësojmë – se janë autorët apo bashkautorët e fakteve në gjykim (të cilësuar si elementë në ngarkim), shpesh herë kanë si objekt, në mënyrë të drejtpërdrejtë, faktin kriminal, ndaj dhe bëjnë pjesë në “**kategorinë ontologjike**” të provave “**të drejtpërdrejta**”, “**historike**” apo “**përfaqësuese**”. Dhe pse ligjvënësi efikasitetin rikrijues e kushtëzon shprehimisht nga prania e “...elementëve të tjerë të provës, që të pohojnë besueshmërinë...”, sipas parimit të “*corroboration*” këto elemente vendosen

në kushte juridike krejtësisht “të pamjaftueshme” për marrjen e vendimit, duke e detyruar gjyqtarin – në mungesë të kundërshtive – ta konsiderojë si jo të arrirë paraqitjen e fakteve.

Shkaqet e këtij “kujdesi vlerësues” e mjaft të rëndësishëm, duhen gjetur në “hamendësimin” e pranisë së një interesi (krh. Kas. 30.1.'97, i pandehuri Barcella) tek subjekti rrëfyes (si “i përfshirë”, dhe pse në shkallë të ndryshme, në faktet e rrëfyera):

- interes që mund të vërtetohet në mënyrë abstrakte teksa përpiqet të rrisë ndjeshëm përgjegjësinë e të tjerëve, duke ulur nga ana tjetër përgjegjësitë e tij.

- përdorimi i procesit gjyqësor ndoshta si një mjet për larjen e hesapeve apo zgjidhjen e konflikteve të mëparshme.

- ndoshta nevoja për të realizuar përfitime me karakter procedural e thelbësor.

Pra, kemi të bëjmë me një “mangësi të pjesshme” të besueshmërisë, e cila mund të plotësohet me ndihmesën e elementëve të pavarur, të aftë të përforcojnë vërtetësinë e përmbajtjes përfaqësuese. Në këtë rast, është pikërisht “cilësia subjektive” e deklaruësit që ushtron ndikim mbi mekanizmin rikrijues duke vënë në punë një mjet “kontrolli gjyqësor të besueshmërisë, e cila, vini re, rezulton i ndryshëm (si pasojë e *ratio* [arsyes] apo mënyrës) nga ai i provës dyshuese.

§ 3.2. Akuza e fajësisë dhe akuza e bashkëfajësisë.

Në rastet e deklaratave akuzuese të lëshuara nga bashkëfajtori, arsyen e kujdesit në vlerësim nuk duhet ta kërkojmë tek “pjesshmëria e natyrshme” e ndihmesës – sikurse në rastin e provës dyshuese – ndaj, për pasojë, nuk paraqet një rëndësi – tërësisht ligjore – vendimtare për gjyqtarin, i cili bazohet në arritjet e përvojës së përftuar e të kodifikuar, kjo me qëllim që të sigurohet njëtrajtshmëria zbatuese në një sektor kaq delikat.

Pra, kemi të bëjmë me dallime ontologjike midis të dhënave dhe deklaratave të lëshuara nga “bashkëfajtori” me zgjidhjen e të cilave duhet saktësuar se, edhe pse norma që parashikohet në nenin 192 (parag. 3 dhe parag. 4 k.p.p.) përgjithësisht synon të rregullojë vlerësimin e çdo lloji të dhëne provuese deklaruese të lëshuara nga subjektet e lart përmendura, jurisprudenca vë në pah dallimet e domosdoshme në lidhje me “përmbajtjen” e deklaratave dhe të “mënyrave të përftimit” e të “transmetimit” të të dhënave paraqesin rëndësi.

Në të vërtetë mund të flasim për “akuzën e bashkëfajësisë” vetëm në rast se subjekti deklarues përfaqëson qartazi përfshirjen e tij të drejtpërdrejtë (në çdo lloj cilësie) në faktet kriminale objekt i akuzës dhe më pas të tjerëve u njihet roli i pjesëmarrësve.

Nëse subjekti deklarues “nuk merr përsipër” të cilësohet si pjesëmarrës në krim, deklarata e tij konsiderohet si “akuzë e fajësisë” që në të shumtën e rasteve njihet si “*de relato*”, gjithnjë nëse deklaruesi dhe pse i vetëdijshëm për rrethanat *de qua* e “përkatësisë” në një grup kriminal (përndryshe do të merrej në cilësinë e dëshmitarit, pa qenë nevoja e zbatimit të masave vlerësuese të kujdesshme) apo të pjesëmarrjes në krime të ndryshme, duke qenë se nuk ka marrë pjesë në një veprim të caktuar kriminal “e ndryshon” njohjen e faktit nga të tjerët (në të shumtën e rasteve nga vetë autorët, apo nga subjekte të cilat vihen në dijeni të ngjarjes).

Akuza për *bashkëfajësi* duke qenë se ka për objekt bashkëpjesëmarrjen e deklaruesit, përbën në vetvete një “provë” parësore e mjaft të rëndësishme besueshmërie të padiskutueshme, e cila qëndron pikërisht në zbulimin e përgjegjshmërisë së tij (pjesa rrëfyese) ndaj një fakti të caktuar në gjykim, duke u pajtuar kështu me pasojat juridike jo të favorshme të deklaratave. Kjo deklaratë, teksa drejtpërdrejt ofron mënyrat e kryerjes së faktit, bën të mundur gjithashtu një hulumtim më të gjerë e më të thellë të rezultateve si në planin material apo konkret ashtu dhe në atë subjektiv.

Ndërsa, akuza e fajësisë, duke qenë kryesisht *de relato* (të paktën për sa i përket faktit të dhënë në gjykim), jo vetëm që nuk paraqet veçori të natyrshme por mbart në vetvete të gjitha “rreziqet” që lindin si rezultat i kalimit të të dhënave nga një subjekt tek tjetri (rrezik logjik i pasaktësisë, rrezik si pasojë e sjelljes së deklaruesit fillestar i cili priret ti zmadhojë ngjarjet, dallim në perceptimin e atij që “përjeton” dhe atij që “tregon” si dhe pasoja të tjera që lidhen me aftësinë e kujtesës..).

Por kjo nuk do të thotë se vendimi, me kapërcimin e pragut të besueshmërisë së padiskutueshme dhe përputhjes logjike, si dhe me verifikimin e pranisë së reagimeve të jashtme, nuk mund të bazohet dhe në “akuzën e fajësisë”.

§ 3.3. *Shqyrtimi i deklaratave.*

Aspekti i parë ka të bëjë me shqyrtimin e besueshmërisë së padiskutueshme, *sub specie* “besueshmëri” e deklaruesit (edhe në lidhje, sikurse është afirmuar nga Seksioni i Bashkuar i Gjykatës së Lartë në vendimin e marrë më datë 21.10.1992, ndaj të pandehurit Marino, me personalitetin e tij, me

kushtet e tij ekonomike dhe familjare, me të kaluarën e tij, me marrëdhëniet me personat bashkëfajtorë, si dhe me fillesat e tij të hershme apo të vona me rrëfimin dhe me akuzën ndaj bashkautorëve dhe bashkëpunëtorëve);

Vijon më tej shqyrtimi i bashkekzistencës së padiskutueshme dhe i veçorive të deklaratave (në përputhje me parametrat e saktësisë, përputhjes logjike, qëndrueshmërisë dhe natyrshmërisë apo spontanitetit);

- më tej akoma, kemi shqyrtimin e reagimeve të jashtme, apo ndryshe, të atyre elementëve të provave të pavarura dhe të ndryshme nga akuza, që kanë të bëjnë me secilin nga fajtorët dhe me secilën nga akuzat.

(krs. së fundmi, Kas. Sek. VI, gjyqi 6.3.2000, i akuzuar Fortugno, sipas të cilit: “... si rezultat i reagimeve mund të parashtrohen elementë krejt të ndryshëm për nga lloji apo prejardhja, dhe pse mund ti referohen fakteve dytësore, falë të cilave mund të arrijmë deri tek objekti i akuzës, por, gjithsesi këto elementë duhet të kenë një prejardhje të ndryshme nga ajo e bashkëpunëtorit dhe duhet tu përmbahen fakteve, dhe jo analizave apo arsyetimeve me karakter logjik...”, si dhe Kas. 16.4.’98, i pandehuri Craxi, sipas së cilës, gjatë debatit gjyqësor, reagimet objektive ndaj deklaratave të të akuzuarit si bashkëfajtor, duhet të jenë domosdoshmërisht të përcaktuara).

Për sa më sipër, duhet nënvizuar se, për sa i përket shqyrtimit të besueshmërisë së padiskutueshme të deklaruesit, sigurisht që nuk mund të varet nga fakti se parametrat “e zakonshëm” të besueshmërisë subjektive kanë të bëjnë me kushtet e veçanta të subjektit, i cili nuk është një dëshmitar “i huaj”, por – si rregull – subjekt i përfshirë në dinamikën kriminale rezultat i së cilës ka është kryerja e krimit.

Çka do të thotë se të gjitha hierarkitë e zakonshme “hidhen poshtë” (sidomos kur kemi të bëjmë me procese për krime të kriminalitetit të organizuar), ndaj njohja e fakteve kriminale duhet konsideruar po aq e thellë dhe e plotë sikurse ka qenë “niveli” i përfshirjes së deklaruesit në to (shih Kas. 17.2.’96, i pandehur Cariboni, sipas të cilit: ... një vlerësim negativ i personalitetit të të akuzuarve si bashkëfajtorë, në vetvete, nuk shërben për të përjashtuar besueshmërinë e padiskutueshme. Në të vërtetë, bëhet fjalë për të njëjtat veçori të të gjithë të pandehurve për të njëjtin krim apo për krime të bashkëlidhura, veçori që merren parasysh nga ligjvënësi teksa vë në pah ndërvarjen e këtyre burimeve të provës nga shqyrtimi i saktë i besueshmërisë së padiskutueshme të akuzës dhe i ekzistencës së reagimeve të jashtme...”).

Gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së rrëfimit, ndër të tjera, pasi vlerësohen parametrat e përputhjes së natyrshme logjike e aftësisë së kujtesës, e

thelësisë së përmbajtjes, e përsëritjes, etj., “vendimtar” është gjykimi mbi “aftësinë dëshmuuese” të të ashtuquajturve “elementë të reagimit”, dhe pse kryhet në kuadër të një vlerësimi “jo të copëzuar” por të përbashkët dhe të vetëm i të gjithë materialit provues të përftuar. Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes në shqyrtim, vlen të ndalemi sidomos në përpunimin e nocionit “reagim”.

§ 3.4. Nocioni i reagimit dhe parimi i segmentimit.

Saktësuam se rikrijimi i ngjarjes kriminale, duke interpretuar nenin 192 k.p.p., nuk mund të bazohet mbi “besueshmërinë e përgjithshme të deklaruësit”, por, domosdoshmërisht duhet të ndalet në ekzistencën e elementëve të jashtëm të pavarur, saktësisht të afta “të pohojnë” deklaratat, të cilat kanë të bëjnë me përfshirjen e secilit prej të pandehurve nën akuzë. Sigurisht, kjo nuk nënkupton faktin se në ngarkim të çdo subjekti të përmendur në deklaratë duhet të ekzistojë detyrimisht një “provë” e pavarur e përgjegjësive, por thjesht se reagimi “pozitiv” ndaj një “pjesë” të deklaratës apo ndaj njërit prej subjekteve të akuzuara – dhe pse rrisim vlerën e përgjithshme të burimit të provës – nuk mund të bjerë mbi subjekte apo rrethana të tjera, dhe e bën të padobishme rregullimin normativ, i cili priret (në bazë të parimeve kushtetuese të prezumimit të pafajësisë e të personalitetit të përgjegjësive penale) të mbrojë çdo të pandehur.

Nga ana tjetër, mungesa e “pohimeve të jashtme” ndaj një apo më shumë fajtorëve apo akuzave, – në vetvete – nuk e bjerr ndihmesën provuese që realizohet nëpërmjet deklaratave “bazë”, të cilat në këtë fazë nuk mund të përbëjnë burim përgjegjësie, por që gjithsesi mund të përdoren kundër të tjerëve, në prani dhe të kërkesave të tjera ligjore, për atë pjesë ndaj së cilës ka reagime, (krh. Kas. 30.1.’92, i pandehur Altadonna: “... vlerësimi i segmentuar i deklaratave akuzuese të lëshuara nga njëri prej subjekteve të parashikuara në parag. 3 dhe 4 të nenit 192, është më se i ligjshëm duke i cilësuar kështu më se të besueshme e me vlerë provuese të gjitha apo një pjesë të atyre deklaratave që duket se mbështeten nga elementët e duhur..”, dhe më gjerësisht Kas. 8.1.’97, i pandehur Consoli: “...në rast se kemi të bëjmë me më shumë se një akuzë bashkëfajësie të ngritura nga i njëjti person për të njëjtën ngjarje, nuk mund të përdoren elementët reagues – të vërtetuara ndaj një të pandehuri – në mbështetje të akuzave që i drejtohen dhe një tjetër të pandehuri. Kështu, nëse deklaruesi bën bashkëfajtorë disa persona për disa krime të kryera dhe, nëse nga rrëfimet e të akuzuarve apo si rezultat i elementëve të tjerë të provës vërtetohen disa apo pjesa më e madhe e akuzave, atëherë këto përdoren thjesht për të gjykuar mbi

besueshmërinë e deklaruesit dhe nuk mund të përbëjnë një element tjetër prove në mbështetje të bashkëfajësisë kundrejt subjektit tjetër që nuk mund të reagojë, çka do të ishte shkelje e hapur e parimit të vlerësimit të provës për sa në nenin 192. Për rrjedhojë, duhet të konsiderohet plotësisht e besueshme dhe me vlera provuese e gjitha apo një pjesë e deklaratës akuzuese të cilat gjejnë mbështetje dhe në elementët e tjerë...”).

Me fjalë të tjera parimi “i segmentimit” – gjithnjë mbi bazën e një vlerësimi pozitiv të besueshmërisë së deklaruesit dhe të përputhjes logjike të rrëfimit – është pasojë e drejtpërdrejtë e ekzistencës së rregullit ligjor i cili efikasitetin “e plotë” provues të deklaratës e kushtëzon me ekzistencën e reagimeve të jashtme nëpërmjet arritjes, në mënyrë të natyrshme, drejt një “pohimi” të mundshëm, tërësor apo të pjesshëm, të asaj çka është deklaruar. Por gjithë sa kemi parashtruar deri tani, në mungesë të një treguesi (dhe pse të përgjithshëm) “të pranueshëm” të asaj çka duhet vlerësuar realisht gjatë procesit të marrjes dëshmuere të vendimit, mund të mos përbëjë kahun real të vlerësimit si një “reagim i jashtëm” ndaj deklaratave.

§ 3.5. Nisma e lirë e gjyqtarit në vlerësimin e reagimeve.

udhëzimet e jurisprudencës mbi ligjshmërinë i hapin rrugën një iniciative më të gjerë të gjyqtarit, sikurse nevojitet për një sistem që ende sot frymëzohet nga parimi i bindjes së lirë dhe mbështetet në arsyetimin e detyrueshëm të masave dhe të vendimeve. Prej nga rrjedh se elementët e tjerë të provës të parashikuara nga ligjvënësi mund të jenë të natyrave apo llojeve të ndryshme (Sek. Bashkuar 6.12.’91, i pandehuri Scala) çka do të thotë se mbështeten në elementë dëshmuere (sikurse, për shembull, vërtetimi pozitiv i ekzistencës së qëllimit rrëfyer nga bashkëpunëtori, sipas Kas. 3.4.’97, i pandehuri Pesce), të provave “të drejtpërdrejta” apo në akuza të tjera të bashkëfajësisë, nëse gjithnjë ekzistojnë kushtet e përputhjes të së ashtuquajturës ‘pavarësi gjenerike apo të përgjithshme’ midis burimeve të ndryshme, të tilla që të përjashtojnë dyshimet mbi ndikimet e ndërsjella (krh. ndër të tjera, Kas. 31.3.’98, i pandehur d’Amora). Në fakt, kjo përbën pasojën e drejtpërdrejtë të rregullimit ligjor në atë masë në të cilën ndryshimi i elementit tek i cili mbështetet mekanizmi i “vlefshmërisë” nënkupton dallueshmërinë dhe pavarësinë e burimit të provës (sikurse dihet tashmë), por që kurrsesi nuk mund të nënkuptojë ndryshueshmëri “tipologjike”, çka na shpie drejt përfshirjes së mundshme të elementëve “të ndryshëm” që i përkasin kategorisë bazë (“akuza” të tjera dhe pse në prani të treguesve të besueshmërisë). Megjithatë, duhet theksuar se, ligjvënësi teksa kërkon praninë e “elementëve të tjerë të provës” të afta të rrisin

aftësinë dëshmuere të deklaratës, përdor gjithsesi një nocion “teknik” i cili nuk mund të mos përballet me:

- rregullat e vlerësimit “tipik” të elementëve të përdorur si reagues qoftë dhe në kuadër të “një harmonizimi” të domosdoshëm me “parimin e provës” që përfaqësohet nga akuza e bashkëfajësisë;

- parimin e përputhjes së çdo “elementi të provës” me akuzën (neni 187), kështu që reagimi – qoftë dhe në mënyrë të menjëhershme – nuk mund të kufizohet thjesht me rritjen e besueshmërisë së deklaruës, por duhet ti referohet (dhe pse vetëm në rrafshin logjik – deduktues) dhe fakteve kriminale që i atribuohen të pandehurit.

Sigurisht, kjo aftësi provuese e elementit reagues nuk duhet nënkuptuar si “pamjaftueshmëri” pasi në të njëjtën kohë shërben si “plotësues i domosdoshëm” i dëshmisë objekt i shqyrtimit (ndër të tjera, krh. Kas. 22.1.’97, i pandehuri Dominante, në të cilën saktësohet se: “...funksioni procedural i “elementëve të tjerë të provës” është thjesht ai i pohimit të besueshmërisë së deklaratave akuzuese, cka do të thotë se këta elementë, duke qenë se në lidhje me *thema decidendum* gëzojnë aftësi provuese vetëm në rast se i referohen akuzës, në raport me provën që rrjedh nga akuza e bashkëfajësisë janë të ndërvarur dhe dytësorë. Përndryshe, në prani të elementëve dëshmuar të përgjegjësisë së të pandehurit, nuk futet në lojë rregulli i parashikuar në nenin 192, parag. 3, por rregulli i përgjithshëm që lidhet me shumëllojshmërinë e provave si rezultat i vlerësimit të lirë nga ana e gjyqtarit.”).

Pra, gjatë veprimtarisë vlerësuese, gjyqtari duhet të përcaktojë praninë ose jo të një lidhjeje midis:

dëshmisë akuzuese e lëshuar nga subjekti deklaruës;

elementit të aftë të “rrisë” ndihmesën njohëse, duke ndikuar pozitivisht mbi besueshmërinë;

faktit kriminal për të cilin akuzohet i pandehuri.

§ 4. *Bashkëpunëtorët e drejtësisë, ndihmesa deklaruese dhe vlerësimi i akuzës së bashkëfajësisë.*

§ 4.1. *Hyrje.*

Për veçoritë e shumta që shfaq nga pikëpamja normative – si dhe për pasojat që rrjedhin e që përdoren për qëllime provuese – ndihmesa provuese që ofrohet nga bashkëpunëtorët e drejtësisë meriton të trajtohet në mënyrë të veçantë. Një nga mjetet kryesore të luftës ndaj krimit të organizuar të tipit mafioz është dhe ndihmesa e deklaratave të lëshuara nga bashkëpunëtorët e drejtësisë, apo të atyre që dhe pse kanë qenë pjesë e organizatave të rrezikshme kriminale apo kanë kryer krime të rënda, vendosin ti rrëfejnë Autoritetit Gjyqësor mbi çdo rrethanë apo të dhënë për të cilat janë në dijeni. Përvoja gjyqësore italiane si dhe kritikën që i janë drejtuar sistemit të sipër përmendur nga dekretligji 8/91, bënë që në 2001 të hartohej një teksti i ri normativ me ligjin nr. 4/2001.

§ 4.2. *Qëllimet e ligjit të ri.*

- sigurimi i një sistemi të aftë për mbrojtjen e bashkëpunëtorit;
- të veçojë momentin e mbrojtjes nga ai i shpërblimit;
- të ndryshojë trajtimin e dëshmitarëve të drejtësisë nga ai i subjekteve me prejardhje nga krimi.

Për sa i përket aspektit të parë, ligji parashikon një sistem mbrojtjeje më përkallëzimin e masave të zbatueshme të cilat përfshijnë:

- masa të zakonshme të marra nga Autoriteti Gjyqësor i P.S.
- masa të mbrojtjes së veçantë të marra nga komisioni qendror kompetent (parashikon mundësinë e transferimit në një vend tjetër, të ndryshëm nga ai i prejardhjes, ndërhyrje me karakter ekonomik apo masa të tjera që synojnë ri-integrimin shoqëror);
- një program të veçantë mbrojtjeje (që përfshin masa të tjera të jashtëzakonshme e të domosdoshme me qëllim që të përkrahin ri-integrimin dhe të mbrojnë bashkëpunëtorin).

Përzgjedhja midis masave të veçanta dhe programit nuk varet nga rëndësia e ndihmesës së ofruar, por nga rrethanat e rrezikshme dhe nga niveli i rrezikshmërisë.

§ 4.3. Vlerësimi i rrethanave të rrezikshmërisë.

Krahas vëllimit të deklaratave merren në konsideratë dhe veçoritë reaguese të grupit kriminal nisur nga forca e tyre kërcënuese. Masat e veçanta të sigurisë mund të zbatohen dhe ndaj atyre që bashkëjetojnë me bashkëpunëtorët e drejtësisë si dhe ndaj atyre që nuk bashkëjetojnë me ta por për shkak të lidhjeve që ekzistojnë mes tyre. Ndërsa për lidhjet farefisnore të cilat nuk karakterizohen nga bashkëjetesa nuk mund të gjejnë zbatim masat e veçanta të mbrojtjes.

§ 4.4. Kushtet për të qenë pjesë e masave të veçanta të mbrojtjes apo të programit mbrojtës.

Vetëm për disa lloje krimesh (por kjo nuk vlen për dëshmitarët e drejtësisë): këto masa janë të zbatueshme vetëm për ato bashkëpunime të cilat lidhen me krime të kryera me karakter terrorist apo për krime mafioze ose të kriminalitetit të organizuar në përgjithësi, e në bazë të ligjit nr. 228/2003 dhe për krime të kryera me karakter skllavërues dhe të trafikimit të qenieve njerëzore;

- bashkëpunimi i ofruar duhet të konkretizohet në deklarata të besueshme, të cilat duhet të përbëjnë risi e të jenë plotësuese apo të paraqesin rëndësi të veçantë për:
 - a) zhvillimin e hetimeve të çdo procesi;
 - b) qëllimin e gjykimit;
 - c) për veprimtarinë hetimore mbi përbërjen strukturore të organizatave apo të pajisjes së tyre me armë, eksplozivë apo të mira të tjera.

§ 4.5. Procesverbali ilustrues i përmbajtjes së bashkëpunimit: kusht për zbatimin e sistemit mbrojtës.

Procesverbali ilustrues përbën thelbin e ligjit të ri i cili zëvendëson marrëveshjen e vjetër parashikuar nga ligji i mëparshëm. Ky procesverbal duhet të përmbajë të gjitha të dhënat që zotëron deklaruesi apo fakte të tjera rënduese për të cilat ka dijeni si dhe të gjitha informatat e domosdoshme për të bërë të mundur kapjen e autorëve të krimit, të të mirave apo çdo lloj pasurie tjetër që i përket deklaruesit apo subjekteve të tjerë anëtarë të organizatës.

Pra, procesverbali ilustrues, krahas të qenit një akt me karakter investigues, përbën një akt hetimor dhe bashkëpunëtori së fundmi duhet të dëshmojë që nuk është në dijeni të fakteve apo të të dhënave të tjera të cilat mund të përdoren në rrethana të tjera.

Në mbrojtje të qartësisë së deklaratave, këto duhet të plotësohen brenda 180 ditëve nga momenti i shfaqjes së vullnetit për të bashkëpunuar. Gjithashtu, bashkëpunëtori duhet të përgjigjet dhe për rastet kur mund të jetë marrë nën hetim. Deklaratat nuk mund të jenë të përdorshme pasi kanë kaluar gjashtë muaj nga momenti i lëshimit.

Krahas faktit se përbën një akt hetimor, proces verbali mund të përmbajë elementë të domosdoshëm e të dobishëm për hetime të tjera në lidhje me çështje të ndryshme, ndaj është parashikuar një mekanizëm i tillë që këtë proces verbal ta përfshijë në një dosje që mbahet nga Prokurori prej nga dalin dhe proces verbalet që lidhen me çështje të ndryshme gjyqësore.

Nga ana tjetër, brenda këtij afati kohor, personi duhet të lëshojë deklaratat e parashikuara me ligj deri në përfundimin e deklaratës përfundimtare të përmendur më lart. Në rast se këto deklarata nuk lëshohen brenda afatit të parashikuar, nuk mund të zbatohen masat e mbrojtjes, e në rast të zbatimit të tyre, këto masa revokohen.

Prej nga arrijmë në përfundimin se proces verbali që përmban bashkëpunimin, në rast se mungojnë rrethanat e rrezikshmërisë për bashkëpunëtorin, nuk përcakton zbatimin e masave mbrojtëse, por në prani të këtyre rrethanave, është pikërisht proces verbali dhe plotësimi i tij të cilat bëjnë që të lindë e drejta për të gëzuar masat e sigurisë, të cilat nëse gjejnë zbatim, mund të revokohen në rast se personi të cilit i referohen nuk i lëshon këto deklarata në kuadër të proces verbalit ilustrues.

§ 4.6. Efekte të tjera të shpërblimit që rrjedhin nga bashkëpunimi: dhënia e masave lehtësuese.

Neni 8 i Ligjit 203/91 parashikon një ulje të dënimit për krimet me karakter mafioz, në rast se këta persona duke u shkëputur nga të tjerët vihen në shërbim për të shmangur faktin që veprimtaria kriminale të prodhojë pasoja të tjera, qoftë duke ndihmuar konkretisht autoritetin e policisë apo autoritetin gjyqësor në mbledhjen e të dhënave kryesore e më të rëndësishme për rikrijimin e fakteve si dhe për përcaktimin dhe kapjen e autorëve të krimit. Dënimi me burgim të përjetshëm është zëvendësuar nga ai me burgim nga 12 deri në 20 vjet, ndërsa dënimet e tjera janë ulur nga një e treta në një të dytën. Këto rrethana të veçanta si dhe rrethana të tjera të

parashikuara nga kodi penal mund të realizohen vetëm ndaj atyre që nënshkruajnë proces verbalin. Nëse bashkëpunimi shfaqet gjatë procesit, gjyqtari mund të japë masat lehtësuese, pa lënë pas dore nevojën e përpilimit të tij brenda afateve të parashikuara.

§ 4.7. Efekte të tjera të shpërblimit që rrjedhin nga bashkëpunimi: përfitimet në dënimin me burgim.

Proces verbali ilustrues i bashkëpunimit bën që të lindin dhe përfitime të tjera në dënimin me burgim, për sa parashikon neni 16 i po këtij ligji. Në këto raste, lirimi me kusht (që parashikohet për ata që janë penduar e që kanë kryer të paktën gjysmën e dënimit), dhënia e lejeve si shpërblim apo burgimi në kushtet e shtëpisë, me përjashtim të kujdestarisë së përkohshme në qendrat sociale, mund të jepen:

- përjashtimisht nga ligjet në fuqi, përfshi këtu ato të kufizimit të dënimit (me të vetmin kufizim, që të jetë kryer të paktën një e katërta e dënimit, e nëse bëhet fjalë për dënim me burgim të përjetshëm, të paktën pas 10 vitesh);

- gjithnjë nëse është përpiluar paraprakisht e brenda afateve të parashikuara proces verbali ilustrues;

- gjithnjë, nëse nuk ekzistojnë elementë të tillë që të provojnë lidhjet me kriminalitetin e organizuar dhe atë subversiv.

§ 4.8. Serioziteti i bashkëpunëtorit.

Në mbrojtje të pastërtisë dhe qartësisë së bashkëpunimit si dhe për të tërhequr vëmendjen e bashkëpunëtorit për të qenë serioz në bashkëpunim nëpërmjet deklaratave që lëshon, neni 16 i ligjit nr. 45/2001 parashikon një sërë masash.

§ 4.8.1. Masa e parë: kthimi në afat.

Paragrafi 6 parashikon se në rast se vërehen rrethana apo vërtetohet se deklaratat e lëshuara janë të rreme apo të munguara, ose nëse subjekti i cili ka përfituar nga rrethanat brenda 10 vjetëve nga dhënia e dënimit kryen një krim për të cilin arrestimi në flagrancë është i detyrueshëm, aktet që vërtetojnë falsitetin, duhet ti përcillen Prokurorit pranë Gjyqtarit që ka dhënë vendimin ose pranë Gjyqtarit që duhet të vendosë për anullimin i cili,

brenda 30 ditëve, mund të kërkojë kthimin në afat për të propozuar anulimin vetëm për atë pikë të vendimit që lidhet me rrethanat lehtësuese.

§ 4.8.2. Masa e dytë: rishikimi i vendimit.

Janë parashikuar kategori të reja rishikimi:

- për zbardhjen e deklaratave të rreme apo të munguara;
- për mospërmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të detyrimeve të tjera të kontraktuara.

§ 4.9. Pasojat ndaj masave mbrojtëse.

Masa e burgimit pa afat nuk mund të revokohet apo të zëvendësohet me një tjetër masë më pak të rëndë për faktin se personi ndaj të cilit është marrë ka qenë i gatshëm të bashkëpunojë apo dhe ka bashkëpunuar. Revokimi apo zëvendësimi mund të kryhet vetëm në rast se në kuadër të shqyrtimeve e verifikimeve të kryera del në pah se bashkëpunëtori nuk është më i lidhur me krimin e organizuar dhe se ka respektuar të gjitha impenjimet e marra.

§ 5. Kriteret e vlerësimit që rrjedhin nga neni 238 bis k.p.p.

Teksa ndalemi ende në kriteret e “vlerësimit” me karakter të përgjithshëm, vlen të përmendim – duke pasur parasysh dhe ndikimin sasior dhe cilësor të të dhënave të marra në shqyrtim – kriteret e vlerësimit të përmbajtjes së vendimeve të pakthyeshme në procese të ndryshme gjyqësore. Në fakt, këto vendime përfaqësojnë jo vetëm rezultatin përfundimtar (dhënien e dënimit apo të pafajësisë) të një procesi por mbartin – në pjesën e arsytimit – dhe rezultatet paraprake të të dhënave që kanë shërbyer si mbështetje për marrjen e vendimit, qofshin këto dhe të “situra” përgjatë arsytimit të bërë nga përpiluesi. Në të njëjtën kohë, përkundrajt të dhënës ligjore (... *vendimet ... mund të përftohen me qëllim që të provohet fakti që ka ndodhur dhe të vlerësohen në bazë të neneve 187 dhe 192, parag. 3...*), është e nevojshme të përcaktojmë nëse dobia e përfutimit ka të bëjë me vetë “të dhënë historike” të vendimit të marrë (akuzë + vendim) apo nëse përmbajtja reale e arsytimit përbën objektin e vlerësimit (në përputhje dhe me nenin 192, parag. 3), të asaj çka lidhet me përfundimet e fazës paraprake (i rëndësishëm ish neni 187) të një procesi tjetër.

Në mbështetje të asaj çka parashtruam më sipër, duhet pasur parasysh se:

- në përputhje me nenet 431, parag. 1, germa g) dhe 236 të k.p.p., me synim gjykimin e personalitetit të të pandehurit, të personit të dëmtuar apo të një dëshmitari, është e lejueshme marrja e certifikatës së gjendjes gjyqësore apo e vendimeve të pakthyeshme; çka shpie në faktin se dhe përftimi për sa në nenin 238 *bis*, për renditjen e normës, synon qartazi të bëjë pjesë të procesit dhe “një element njohjeje”;

- ky “element” i veçantë (vendimi i pakthyeshëm), nuk mund të mos merret në shqyrtim në gjithë tërësinë e tij, duke qenë se dispozitivi përfaqëson rezultatin përfundimtar të një vendimi që – si rregull – ndikohet nga *an* dhe nga *quantum* të provave të mbledhura gjatë atij procesi gjyqësor;

- vetëm një analizë e bashkërenduar midis dispozitivave dhe “të dhënave reale” të vendimit bën të mundur që të kuptojmë arsyet e vërteta që na shpjen ta ngarkojmë ose jo të pandehurin me përgjegjësi penale.

Por, sigurisht kjo nuk do të thotë se gjatë shqyrtimit të të dhënave paraprake të një tjetër procesi (e në mënyrë të veçantë, në rast se në këtë proces nuk kanë qenë pjesëmarrës të pandehurit aktualë) nuk duhet të tregojmë kujdes të veçantë meqenëse bëhet fjalë – me përjashtim të rasteve kur përftojme dhe proces verbalet e provës, ish neni 238 – për të dhëna “të paraqitura” gjatë arsyetimit, por, sikurse thamë, vlerësimi nuk mund të mos përfshijë “arsyet” e *decisium*, çka do të përbënte një mangësi të thellë me karakter logjiko – juridik. Dhe është pikërisht mungesa e çdo lloj lidhjeje “të paragjykimit penal” që e detyron gjyqtarin e procesit (me të vetmin kufizim të *ne bis in idem*) a *quo* të kryejë një vlerësim të matur të përmbajtjes që “përfaqësojnë” të dhënat e përdorura në marrjen e vendimit të pakundërshtueshëm, vlerësim që duhet të karakterizohet nga fryma e kritikës dhe nga mundësia për të arritur (për sa theksohet gjatë verifikimeve të kryera) dhe në marrjen e vendimeve të tjera si pasojë e ekzistencës dhe e provave të tjera. Shih Kas. Sek. I, 2.12.’98, i pandehuri Archinà: “... në bazë të një gjykimi të pavarur, është i ligjshëm vlerësimi i rrethanave faktike të përfuara gjatë një procesi tjetër i cili ka përfunduar me marrjen e një vendimi të pakundërshtueshëm të pafajësisë, pasi pengesa e një gjykimi tjetër qëndron vetëm në ushtrimin e veprimit penal ndaj një krimi i cili është gjykuar më parë, por nuk prek aspak vlerësimin rishtas të këtyre rrethanave, nëse i përcaktojmë si të dobishme e të rëndësishme për vërtetimin e krimeve të ndryshme nga ato që janë gjykuar tashmë ...”, si dhe Kas. 16.11.’98, i pandehuri Priebke: “... marrja e vendimeve të pakundërshtueshme nuk përbën kurrfarë automatizmi në përfitim dhe në përdorimin si të fakteve me synim marrjen e një vendimi, ashtu dhe të gjykimeve faktike që përfshihen në pjesët arsyetuese të vendimeve të sipër përmendura pasi

gjyqtari duhet të ruajë të paprekshme pavarësinë dhe lirinë e veprimeve logjike në vërtetimin dhe hartimin e gjykimit, detyrime këto që i njihen atij me ligj ...”. Pra, mund të themi se si vendimi i dënimit (në një tjetër proces) nuk krijon asnjë lidhje absolute në gjykimin *a quo*, – krahas nevojës për të vlerësuar të dhënat e provës të përfutuara në atë kohë thjesht si “elementë të provës” (nëse dhe sa të dobishme janë për rikrijimin e ngjarjes) –, dhe vendimi i pafajësisë, në lidhje me fakte të ndryshme, nuk pengon aspak vlerësimin rishtas të të dhënave paraprahe që në atë kohë kanë shërbyer si mbështetëse. Ndërkohë, gjyqtari që përfton rezultatin e gjykimit tjetër nuk mund të mos kryejë – në bazë dhe të shtysave që mund të lindin gjatë debatit gjyqësor – një bashkërendim logjik midis vendimit dhe arsyesimit për të arritur më tej në një vlerësim të fakteve më të rëndësishme, sipas asaj çka parashikon dhe ligji (neni 192, parag. 3).

Arsyet e kujdesit vlerësues: është më se e qartë se në një kontekst të tillë, shkaku i “kujdesit vlerësues” duhet kërkuar në atë mori shkaqesh të cilat i përmendëm teksta trajtuam “deklaratat e bashkëfajtorit”, duke pasur parasysh faktin se nga njëra anë rrjedh nga parimi i “pavarësisë” së gjykimeve (mungesa e paragjykimit) dhe nga ana tjetër nga fakti se e dhëna paraprahe që krijohet gjatë procesit (e cila gjithsesi duhet shqyrtuar në përputhje me veçoritë e saj) është subjekt i përpunimit, pra i një veprimi vlerësues që kërkon një “sterilizim” i aftë të realizojë ndarjen e së dhënës, si e tillë, nga “deklaratat që lëshohen”.

§ 6. Arsyetimi i vendimit dhe aftësia bindëse që lidhet me cilësinë e provave të mbledhura.

Arsyetimi i gjyqtarit është i lidhur ngushtë me llojin e provave të përfutuara gjatë procesit, të cilat detyrimisht janë të lidhura me karakteristikat thelbësore, objekt i shqyrtimit. Kur merren në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, detyrimisht duhet të përballemi me modele shqyrtimi që bazohen tek përdorimi i burimeve “të veçanta” (si për shembull deklaratat e bëra nga bashkëpunëtorët e drejtësisë, që shpesh herë përfshihen në ngjarjet në gjykim), pra duhet të përpiqemi të administrojmë më së miri rregullat e vlerësimit të materialit të përftuar.

Në të njëjtën kohë, gjyqtari, shqyrtimin e materialit provues duhet ta mbështesë në rregullat juridike “të përgjithshme” duke shprehur qartazi e me ndershmëri intelektuale kriteret logjike reale të përdorura në rastin konkret si dhe duke “respektuar” hamendësimet e formuluar nga palët në

fazën e diskutimeve (duke dhënë llogari përse priret ndaj hamendësimit të njëjës apo të tjetrës palë).

Ai duhet të arrijë në një pohim të përgjegjësishë të të pandehurit nëse ky duhet të konsiderohet si fajtor përtej çdo dyshimi të arsyetuar (neni 533, paragrafi parë).

Gjyqtari duhet të shpallë vendimin e pafajësisë nëse mungojnë, janë të pamjaftueshme apo kontradiktore provat se fakti qëndron, se i pandehuri e ka kryer, ose ky fakt përbën krim ose krimi është kryer nga një person që nuk mund të ndëshkohet (neni 530 k.p.p.).

Së fundmi, rëndësia kushtetuese e detyrimit të arsytimit të vendimeve është dhe mbetet si në qendër të një metode “të brendshme” të juridiksionit (në një farë mënyre vendos se dhe kur mund të shprehë saktësisht, në rrafshin logjik/juridik, arsyet e atij vendimi), e sidomos në atë të një mundësie verifikimi “të jashtëm” e “kolektiv” të veprimtarisë së gjyqtarit nëpërmjet një analize të asaj çka e ka shtyrë drejt marrjes së vendimit (*decisium*). Ndërsa transparenca dhe qartësia shprehëse e vendimeve besoj se përbën një të dhënë absolutisht të padiskutueshme (çka, ndër të tjera, e dëshmojnë ‘akrobacitë’ e famshme në gjykimet e shkallës së parë, në ato të apelit dhe të kasacionit që janë hasur së fundmi në çështjet me rëndësi të madhe kombëtare).

Problemi i rikrijimit të një ngjarje që i përket “së shkuarës”, (ku si rregull nuk kemi qenë të pranishëm), qëndron pikërisht në njohjen e drejtë të “vlerës bindëse” të çdo elementi të provës krahasuar me faktin që duhet provuar. Në lidhje me këtë duhet të theksojmë se:

jo pak rëndësi paraqet Metoda Përfutuese, duke qenë se vetëm nëpërmjet debatit gjyqësor real e të mundshëm mund të vërtetojmë konkretisht “shkallën” e besueshmërisë së burimit deklarues (tashmë përbën një metodë të konstitucionalizuar, sipas nenit 111 të tekstit kushtetues të rishikuar);

është e domosdoshme ti drejtohem logjikës si një mënyrë për të “shmangur” çdo rrezik që haset në çdo veprimtari vlerësuese. Çka nënkupton se gjithnjë duhet ti nënshtrohemi analizës nëse ajo provë shpie drejt shpjegimeve alternative;

është i nevojshëm një vlerësim tërësor dhe i bashkërenduar i elementëve përfaqësues qofshin këto me karakter “historik-përfaqësues” apo më karakter “provues”.

Mbi bazën e të dhënave të përvojës mund të përcaktojmë dhe “rreziqet vlerësuese” që hasen më shpesh, krahasuar me llojet e ndryshme të elementëve tregues (në një numër të madh nga pikëpamja statistikore).

§ 7. *Lloji i Burimit – Lloji i rrezikut.*

§ 7.1. *Burimi deklarues (dëshmitari).*

Dëshmitari okular dhe viktimë e veprimit kriminal që cilësohet si subjekt i PANJOHUR nga ana e deklaruesit. Me kapërcimin e shqyrtimit “të besueshmërisë së përgjithshme” të burimit (logjika, përputhshmëria e rrëfimit, etj.) **rreziku** qëndron në gabimin “perceptues” (kuptimi i fjalës *i ndryshëm* është zgjeruar më tej duke nënkuptuar veprimin e tjetrit) ose në gabimin “përfaqësues” sidomos kur trajtohen tema me karakter fizionomik të autorit të kimit (gabim që fut në lojë mirëbesimin e deklaruesit). Prej nga rrjedh, edhe në rrafshin normativ, analiza e nevojshme gjatë debatit gjyqësor e besueshmërisë “së përgjithshme” dhe e “kompleksitetit” të veprimeve të njohjes subjektive (njohja formale).

Dëshmitari okular ose viktimë e veprimit kriminal i cili lëshon deklarata ndaj subjektit të njohur. Me kapërcimin e shqyrtimit të “besueshmërisë së përgjithshme” të burimit (logjika, përputhshmëria e rrëfimit, mungesa e “zgjerimit”, etj.) rreziku qëndron në faktin se veprimi i paligjshëm i atribuohet artificialisht personit ndaj të cilit ushqehen ndjenjat e hakmarrjes për shkaqe të tjera (sidomos në marrëdhëniet familjare apo sentimentale si dhe në ato të interesit). Këtu hyn në lojë keqdashja e deklaruesit.

Rrëfimi hetero-akuzues i bërë nga subjekti i përfshirë në ngjarjen e paligjshme objekt i gjykimit (si bashkautor apo autor i krimeve të lidhura me njëra-tjetrën): me kapërcimin e “besueshmërisë së përgjithshme” të burimit (logjika, përputhja e rrëfimit, përsëritja e ngjarjeve të paraqitura, qëndrimi vetjak i deklaruesit, etj.), rreziku qëndron në përdorimin e deklaratave (haset mjaft tek dëshmitarët e zakonshëm) si mjet me synim dëmtimin e personave ndaj të cilëve ekzistojnë ndjenjat e hakmarrjes si dhe me qëllim “zvogëlimin” e shkallës së përfshirjes së tij në faktet (ose për të “mbrojtur” persona të tjerë miq të tij) apo sigurimin e përfitimeve (masa e sigurisë, e burgosjes apo përfitime me karakter ekonomik) që lidhen me gëzimin e “statusit” të bashkëpunëtorit të drejtësisë.

Rrëfimi “i pastër” (pa akuza ndaj të tretëve). Këtu, “mirësia” e shqyrtimit ndalet në saktësinë e rezultateve të përvojës sipas së cilës “askush (nëse gëzon aftësitë e duhura mendore) nuk mund të lëshojë deklarata

paragjyqese ndaj vetes nëse faktet e dëshmuara nuk përputhen me të vërtetën”. Megjithatë, dhe në këtë rast hamendësimi mund të jetë i rremë, pasi deklaruesi, me qëllim që të mbrojë autorin e vërtetë të krimit, merr përsipër të gjithë përgjegjësinë e veprimit të paligjshëm i kryer nga i treti.

Biseda telefonike apo mjedisore objekt i përgjimit. Me kapërcimin e problemit të shqyrtimit të identitetit të bashkëbiseduesve, rreziku qëndron në domethëniet e pasakta me të cilat mund të vishen fjalët e përdorura gjatë bashkëbisedimit, duke pasur parasysh se gjuha e përdorur shpesh herë është e kodifikuar, por nga ana tjetër nuk mund të përjashtojmë faktin se, si pasojë e “shitmendjes” nga ana e bashkëbiseduesit, përmbajtja mund të jetë e rreme. Pra, çdo bisedë duhet analizuar në lidhje me kontekstin “historik” dhe me personalitetin e bashkëbiseduesve. Me mjaft kujdes e maturi duhet shqyrtuar dhe qartësia e rrethanave në të cilat kryhen bisedat si dhe vetëdija e personave që bashkëbisedojnë se ndodhen nën përgjim.

Pamja filmike që lidhet me veprimin e paligjshëm. Këtu kemi të bëjmë me rrezikun “teknologjik” përse i përket manipulimeve të mundshme të të dhënave (që mund të përjashtohet nëpërmjet ekspertizës) apo përcaktimit të gabuar të identitetit që kryhet vetëm në bazë të krahasimeve me pamje të tjera (dhe në rast se shkalla e besueshmërisë së këtyre verifikimeve është mjaft e lartë).

Zbulimi i gjurmëve të gjakut, gjurmëve biologjike, etj. Këtu, krahas pjesshmërisë përfaqësuese “strukurore” të elementit me natyrë logjike/provuese (që mundëson “shpjegimin alternativ” të faktit), rreziku, me karakter teknik, qëndron në gabimet që mund të kryhen në momentin e “marrjes” apo të “analizës” së të dhënave (dhe pse teknikat e përpunimit, tashmë të sofistikuar, garantojnë besueshmërinë e rezultateve, gjithnjë nëse kemi të bëjmë me “ruajtjen” e mirë të provave, si për shembull rasti i bishtave të cigares).

Dokumentacioni shkresor. Efikasiteti përfaqësues varet nga shqyrtimi i “prejardhjes” dhe nga mungesa e manipulimeve. Sigurisht që, dhe në këtë rast, mund të lindë nevoja e kryerjes së ekspertizave të afta të shmangin rrezikun e falsitetit. Pra, është më se e qartë se veprimtaria për marrjen e vendimit, e nënkuptuar si “fiksimit i fakteve”, kërkon kryerjen e një sërë “verifikimesh rastësore” (mbi besueshmërinë e një burimi, mbi mënyrat e përfutimit të një të dhëne, etj.) të cilat, teksa i referohen të gjithë materialit të përfutur, përpiqen të formojnë “kuadrin” e përshtatshëm për të përcaktuar, në respektim dhe të normave metodologjike (para së gjithash atë të nevojës së pafajësisë në rastin e “dyshimit të arsyeshëm” ish neni 530, parag. 2 k.p.p.), zgjedhjen e gjyqtarit nëse “përkrah” ose jo hamendësimin e ngritur

nga akuza gjatë debatit gjyqësor (*rectius* ta konsiderojë si të provuar). Kjo është detyrë e gjyqtarit, i cili ndër të tjera duhet të dëshmojë se e “meriton”, në bazë dhe të vlerësimeve të vërtetueshme, “besimin” e gjithë shoqërisë për punën e kryer prej tij.

§ 8. Nevoja e fjalës së fundit të Prokurorit, e strukturuar më së miri me synim bindjen e gjyqtarit.

Nëse në formulimin e provës ekziston debati, i ngritur tashmë në nivelin e parimit kushtetues, por ndoshta i lindur me vetë sistemin, për sa parashikohet në nenin 24 të Kushtetutës, ekziston dhe debati arsyetues në të cilin, krahasuar me provat e formuluar tashmë, palët përballen për të shprehur vlerësimet e tyre mbi kuptimin që mund të paraqesë secila prej tyre, me synim bindjen e gjyqtarit. Pra kemi të bëjmë me një moment që nuk ka të bëjë me fazën dëshmuese të provës si e tillë por me aftësinë e palëve në proces për të bindur gjyqtarin:

- mbi provat e mbledhura;
- mbi lidhjet e tyre logjike;
- mbi forcën e tyre dëshmuese në lidhje me temat objekt i provës, duke pasur parasysh se faktet objekt i provës janë fakte që i referohen akuzës, ndëshkueshmërisë, përcaktimit të dënimit apo masave të tjera të sigurisë;

Pra, në procesin midis palëve kemi të bëjmë me detyrimin e palës me funksion dëshmues dhe bindës, pa anashkaluar parimin e bindjes së lirë të gjyqtarit në vlerësimin e provës së marrë, duke pasur parasysh se veprimtaria vlerësuese e gjyqtarit udhëhiqet dhe rregullohet nga normat e pranueshmërisë, formimit dhe vlerësimit të provës.

Pra, mbi Prokurorin rëndon detyra e arsyetimit, përmbushja e së cilës i hap udhë dimensionit të barazisë së palëve në proces të cilat i drejtohen gjyqtarit duke i parashtruar një pyetje.

Prokurori dhe pala mbrojtëse janë palë të domosdoshme në proces; qoftë kjo publike apo private, por me një ndryshim të madh, e që mua më pëlqen ta nënvizoj, pasi natyra e prokurorit nuk mund të arrijë në “njëanshmëri”. Nëse pala private, mbrojtja teknike, është e bindur për përgjegjshmërinë e palës që ajo përfaqëson, duhet të kërkojë një vendim tjetër për pafajësi. Nëse prokurori është i bindur për pafajësinë e të pandehurit të tij, nuk duhet të kërkojë dënimin por pafajësinë e tij, pikërisht në bazë të natyrës publicistike që e karakterizon. Qëndrimi i tij nuk është e nuk mund të jetë kurrësi një qëndrim akuzues pa kufij, por duhet që të sigurojë një rezultat në përputhje me drejtësinë. Ja përse një prokuror nuk mund të merret kurrë me një

rezultat pafajësie, nëse është në përputhje me drejtësinë, por vetë ai duhet ta nxisë atë.

Në proceset disi të ndërlikuara, mund të jetë e dobishme, së bashku me prezantimin gojor, dhe paraqitja e një teksti të shkruar çka përbën një pikë të rëndësishme referimi për gjyqtarin, i cili pasi tërhiqet në dhomën këshillimore, duhet të marrë një vendim duke marrë parasysh provat e mbledhura e të paraqitura si dhe arsyetimet e kryera nga palët. Njëkohësisht, një hap i tillë paraqet dobi nëse kemi parasysh veçoritë e tjera të procesit sikurse:

- rrethana rënduese dhe numri i akuzave;
- numri i të pandehurve;
- lloji i provës së mbledhur, pasi është më se e qartë se fjala e fundit e prokurorit duke qenë e shkruar do të jetë mjaft e dobishme në rast se prova e përfutur gjatë procesit ka karakter dyshues.

FILIPPO SPIEZIA

Prokuror

Prokuroria pranë Gjykatës së Salernos

Tiranë, Mars 2007

